





**SHEFQET JASHARI STROFCI**

# **QË TË SHPËTOJË KOSOVA**

Le Locle (Zvicer) - Prishtinë 2005

## **Redaktor**

Vehbi Skënderi

## **Recensentë**

Dr. Mehmet Rrukiqi

Bajrush Morina

## **Lektor**

Vehbi Skënderi

## **Kopërtina**

Malik Filali

## **E drejta e botimit**

© Shefqet Jashari-Strofici 2005

[www.shefqet-jashari-strofici.ch](http://www.shefqet-jashari-strofici.ch)

"...Dhe sikur Allahu të mos i mbronte njerëzit me disa prej disave të tjerëve, do të shkatërrohej toka, po Allahu është Bamirës i madh ndaj njerëzimit."  
(*Kur'an - Suretu El Bekare, ajeti 251*)

"Pasha kohen! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm."  
(*Kur'an - Suretu El Asr*)



# NË VEND TË HYRJES

"Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të botëve! Bëmirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit! Sunduesit në Ditën e Gjykimit! Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti ndihmë kërkojmë! Udhëzona (përforcona) për në rrugën e drejtë; në rrugën e atyre të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër vetes tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!" (Kur'an-i, Suretu El Fatiha).

"I famshëm je vetëm Ti, o All-llahu im dhe lavdërimi të qoftë Ty! I lartë është emri Yt dhe Madhëria Jote është shumë e madhe. Nuk ka Zot tjetër përveç Teje." ("Mburoja e muslimanit"- Lutja me të cilën fillohet namazi.)

"O Zoti im, Ty të takon falënderimi, Ti je Nuri (Drita) i qiejve dhe i tokës dhe asaj ç'ka në to, Ty të takon falënderimi; Ti je ngritës i qiejve dhe i tokës dhe asaj ç'ka në to, Ty të takon falënderimi; Ti je Zot i qiejve dhe i tokës dhe asaj ç'ka në to, Ty të takon falënderimi; Ti je Sundues i qiejve dhe i tokës, Ty të takon falënderimi; Ti je i vërtetë dhe premtimi Yt është i vërtetë, fjala Jote është e vërtetë, takimi Yt është i vërtetë, Xhenneti është i vërtetë, Xhehennemi është i vërtetë, Pejgamberët janë të vërtetë, Muhamedi (Paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të!) është i vërtetë, Kijameti është i vërtetë. O Zoti im, Ty të jam nënshtruar dhe në Ty jam mbështetur, Ty të kam besuar dhe Ty të drejtohem, për Ty (urdhërat Tua) hasmohem dhe te Ti kthehem për gjykim, mi fal mëkatet e mia, të mëparshmet dhe të tanishmet, ato që i kam bërë fshehurazi dhe haptazi. Ti je i Pari dhe Ti je i Fundit, s'ka të adhuroar tjetër përveç Teje; Ti je Zoti im, s'ka Zot tjetër përveç Teje". ("Mburoja e muslimanit"-Lutja në fillim të namazit)

"O Zoti im, më bëj mua prej atyre që Ti i ke udhëzuar dhe më bëj prej atyre që Ti i ke falur, më bëj prej të dashurve Tu; më beko mua në atë që më ke dhënë dhe më mbroj nga dëmi i asaj që Ti ke caktuar. Vërtet, Ti je Ai i Cili cakton, dhe askush s'mund të caktojë asgjë kundër Teje. Me të vërtetë s'ka mposhtje për atë të cilin Ti e do dhe s'ka ndihmë për atë që është armiku Yt. I Madhëruar dhe i Lartësuar je, o Zoti ynë!

O Zoti im, të lutem me anë të kënaqësisë Sate të më mbrosh nga hidhërimi Yt dhe me faljen Tënde, nga dënimi Yt ! Kërkoj mbrojtjen

Tënde nga Ti. Unë nuk mund të të madhëroj ashtu siç e meriton Ti. Ti je i Madhëruar, ashtu siç e ke përshkruar Vetën.

O Zot, vetëm Ty të adhurojmë, për Ty falemi dhe vetëm Ty të përulemi; kah Ti vijmë dhe shpejtojmë, shpresojmë në mëshirën Tënde dhe i frikohemi dënimit Tënd. Vërtet, dënimim Yt do t'i arrijë kafirat (pabesimtarët). O Zot, prej Teje kërkojmë ndihmë dhe falje, Ty të falënderojmë me çdo gjë të mirë, nuk të mohojmë dhe vetëm Ty të besojmë. Vetëm Ty të përkulemi dhe braktisim atë që Ty të mohon (s'të beson)". ("Mburoja e muslimanit"- Duaja e Kunutit)

"S'ka të adhuruar tjetër përveç All-llahut të Madhëruar e të Urtë. S'ka të adhuruar tjetër përveç All-llahut, Zotit të Arshit të lartësuar. S'ka të adhuruar tjetër përveç All-llahut, Zotit të qiejve dhe të tokës dhe Zotit të Arshit Fisnik." ("Mburoja e muslimanit"-Lutja me rastin e vështirësive)

Me rastin e botimit të librit "Që të shpëtojë Kosova" e falënderoj me përulësi (me sexhde) dhe me adhurim, siç e meriton vetëm All-llahu, Zoti i njerëzve, Sunduesi i njerëzve dhe i Adhuruari i njerëzve, Krijusi i Vetëm i gjithësisë dhe i të gjitha krijesave (të dukshme dhe të padukshme) që gjenden në tokë, në qiej dhe në mes tyre, që më frymëzoi, më udhëzoi dhe më ndihmoi që, nëpërmjet shkrimeve, t'i rrahë "friska duarve" dhe "gugjuma kresë" bajraktarët e "farës ruse" dhe "pehlivanët" e Nanosit për veprimtarinë e tyre antikombëtare. E falënderoj me përulësi (me sexhde) dhe me adhurim All-llahun, Krijuesin e Gjithdijshëm dhe Fuqiplotë që i bëri hi e pluhur planet dhe skenarët antishqiptar të Beogradit, Moskës dhe të Athinës për zhdukjen e popullit dhe kombit shqiptar, duke i detyruar fuqitë e mëdha të botës për të ndërhyrë në Gadishullin Ilirik, në të gjitha periudhat historike kur vëhej në rrezik ekzistenca e popullit dhe kombit shqiptar.

Shqiptarët, kudo që jetojnë dhe gjallërojnë në rruzullin tokësor, janë të detyruar ta falënderojnë dhe ta adhurojnë vetëm të Madhin Zot, që na shpëtoi nga "çakejtë" e Ballkanit, në të gjitha situatat dhe periudhat historike, kur neve na përgatiteshin kurrthe, varre dhe humnera për të na zhdukur nga faqja e dheut. Ta lusim All-llahun, Lutjepranuesin, Zotin e Gjithdijshëm dhe Fuqiplotë, t'i mposhtë dhe t'i shkatërroi grupacionet e bajraktarëve të farës ruse dhe grupacionet e "pehlivanëve" të Nanosit, që ishin dhe janë dorë e zgjatur dhe argatë e rrogatë të "çakajve" të Ballkanit e të aleatëve të tyre.



Pra, vetëm All-llahun, Zotin e Vetëm të gjithësisë, ta falënderojmë dhe ta lusim që të na ndihmojë për punë dhe vepra të mira, ta lusim All-llahun Fuqiptotë që të na mëshirojë duke na udhëzuar në Rrugën e Tij të Drejtë, Rrugë kjo e vetme, që do të na bëjë të suksesshëm në këtë botë, dhe në botën tjetër, si individ dhe si popull e komb. E lusim Zotin e Madhërishëm që paqja mëshira dhe bekimi i Tij të jenë mbi Pejgamberin e fundit, Muhamedin, (s.a.s.) familjen, shokët dhe gjithë pasuesitë e tij.

Po ashtu, e lusim All-llahun që t'i udhëzojë në rrugën e Tij të drejtë të gjithë popujt dhe gjithë njerëzit e botës.

E lusim All-llahun, Pendimpranuesin e Vetëm që mua dhe lexuesit e shkrimeve të mia, të na falë, po që se, pa vetëdije i kemi bërë shok (kemi bërë shirk).

Me rastin e botimit të këtij libri, e përshëndes dhe e falënderoj përzemërsisht dhe me gjithë zemër redaktorin e këtij libri, mikun tim shumë të nderuar e të dashur, poetin e shkrimtarin e mirënjohur, zotëri Vehbi Skënderin, për punën e madhe që bëri në redaktimin dhe lekturimin e librit. Po ashtu, e përshëndes dhe e falënderoj singërisht redaktorin e rubrikës së jashtme të "Bota sot", mikun tim të nderuar, zotëri Llukman Halilin, që shkrimeve të mia të para ua hapi rrugën e botimit. Përshëndetje të përzemërta dhe nderime të thella ka miku im dhe miku i familjes sime të gjerë, dr. Mehmet Rrukiqi, për recensimin e këtij libri. E përshëndes dhe e falënderoj ngrohtësisht mikun e vëllait tim dhe mikun tim, Bajrush Morinën, që bëri një punë të mirë, duke gjetur nëntituj shumë të qëlluar për fejtounin tim "Pse jemi kështu siç jemi" që u botua në "Bota sot" dhe për recensimin e këtij libri. I jam mirënjohës dhe e falënderoj shumë mikun e djemve të mi, zotëri Malik Filalin, që e bëri ballinën e këtij libri. Përshëndes përzemërsisht stafin e "Botës sot" në krye me zotëri Skënder Buçpapaj, kolektivin, bashkëpunëtorët dhe lexuesit e saj. Me kënaqësi i përshëndes lexuesit e shumtë të librit tim të parë "Pse jemi kështu siç jemi", të cilët me rastin e botimit më përgëzuan dhe më uruan nëpërmjet shkrimeve, letrave dhe telefonatave të shumta.

Rob i All-llahut, Zotit Fuqiptotë!

Shefqet Jashari-Strofc

*Le Locle, më 25 mars 2005*

# PARATHËNIA

## MOS I FALNI VRASËSIT!

Ndër këto ditë të zhurmshme, kur thuajse çdo orë e çdo minutë botohen libra, revista, buletine e gazeta, kur në çdo kënd vërshojnë lajme, ese, intervista, reportazhe, deklarata, komunikata, proklamata, madata (midis shiritave të zinj), kontrata, ankande bashkëjetese, ankande pronash, hotelesh, fejesash, martesash. Ankande automobilësh, mobilesh, bezhdilesh e fosilesh politike.

Ndër këto ditë të pluhurosua, të tymosura, të dyllosura, të ballsamosura e të murosura. Ndër këto ditë të murme e monotone, ku ta thajnë fytin smogu, zagushia e mërzia. Recetat e vjetëruara. Barnat e skaduara, që i blejnë pacientët mjeranë. Orët e minutat e linçuara, në një Dushk-Parlament. Vite të harxhuara kotmëkot! Ndër këto ditë të ngarkuara e të stërngarkuara me mesazhe e sinjale interneti e zilka celularësh. Kur lëvrijnë çdo sekondë veturat, trenat, anijet, avionët. Kur bubullojnë dhjetëra herë në ditë kambanat, ndërsa peshkopët e kardinalët merren me biznes e pedofili. Kur 24 orë në ditë, nga ekranet e vegjël, ta zënë reklamat frymën. Markat e fundit të veturave. Markat e fundit të urave "globale". Fytyrat e futbollistëve që duan të shiten, të rishiten e stërshiten. Markat e fundit të çokollatave, të topmodeleve, të antenave, të çorapeve, sytjenave, sandaleve, papagallëve, enëve, maceve, mendallave (që bëjnë politikë botërore), kristaleve, gerdallave, karnavaleve, homoseksualëve, skandaleve! Reklamat janë zhurmueset e kambanat më të bezdisshme e më të lemerishme.

Ndër këto kohë kaq kryesëprapi! Ndër këto kohë ku ngatërrohen shijet, fijet e hafijet e panumurta. Ku ngatërrohen midis tyre të thjeshtat me të ndërlikuarat, të ulëtat me madhështoret, heronjtë, betejat, komandantët, gjeneralët, legenhanët, sharlatanët, rrufjanët. Libri i Shefqet Jasharit Strofcit vjen për të thënë fjalën e vet, fjalë që i hedh rrënjët si shkëmbinjtë që kanë mbirë në këtë tokë të Kosovës të ujitur me gjak. Fjala e Shefqet Jasharit Strofcit është një shkëmb që zë vend e nuk e luan dot kush në trojet e Kosovës dhe në krejt hapësirën Shqiptare, prej nga i merr ngjarjet, mbresat, portretet autori.

Shkëmbi me rrënjë që mban autorësinë e Shefqet Jasharit Strofcit e ndjen veten natyrshëm në peizazhin tragjik të Kosovës martire. Sekret i shkrimit të Shefqet Jasharit Strofcit qëndron në faktin. Ai e vendos faktin në vendin e duhur, pa ia shkundur pluhurin e pa ia gërryer baltën. Pa ia fshirë ngjyrën, pa ia fshehur moshën, pa ia prekur tërësinë gjenealogjike. Faktet në librin e autorit nuk kanë grada, nuk zënë radhë sipas ndonjë hierarkie të porositur apo të komanduar nga dikush tjetër përveç realitetit të imponuar në vetëdijen e autorit.

Për autorin Shefqet Jashari Strofcit FAKTI është i pashfronëzueshëm. Madhëria e Tij Mbreti FAKT. I paprekshëm. Është një copër tempulli apo vetë tempulli. Tempulli i Madhërueshëm FAKT. Jo kurrë! Kështu, duke i qëndruar besnik Kosovës martire dhe martirëve të Kosovës, autori saktëson pa ndërprerë faktet e njohura, si arkeolog pedant, ashtu sjell vazhdimisht lëndë e fakte të panjohura. Ai ka vetëm tre-katër vjet që është shfaqur përpara lexuesve. Por ai ka mbi 50 vjet që e shfleton realitetin e Kosovës, prej sot e deri në kohët IliroDardane, nëpër Kosovë e nëpër Diasporë, parreshtur. Mbi 50 vjet që kërkon, gërmon, zbulon, shpalos. Shënon papushim ngjarje të hidhura që janë ngulitur në ashtin e shpirtit e të ndërgjegjes së kombit. Ekspedita çetnike në Drenicë, Masakra e Tivarit, Qëndresa e masakrimi i familjes Jashari, Reçaku. Por esetë e autorit, përveç vlerave historike e publicistike, kanë vlera të veçanta në portretizimin e martirëve. Tiparet e protreteve të martirëve, të dhënat, hollësitë rreth këtyre portreteve mbeten përjetësisht të gdhendura në shpirtin e lexuesit. Sikurse edhe konkluzioni i librit për martirët.

Kosovës nuk i kanë munguar kurrë as trimat as të urtët. Libri përshkohet fund e krye nga një pikëpyetje që herë- herë kthehet në ankth: " Ku janë vrasësit " Mirë, të varrët i kemi para syve, thotë ai. Bile mund t'ua numërojmë edhe plagët. Edhe plumbat e plagëve. Po vrasësit, " argatët e ndyrë ", siç përsërit ai shpesh, ku fshihen! Kjo pyetje gërryese ka ngelur si gozhdë në ashtin kombëtar e në ndërgjegjen e kombit. Sepse pothuaj të gjitha vrasjet e shqiptarëve më në zë janë kryer prapa shpine, janë kryer nëpër prita, shqiptarët më në zë janë korrur e grirë nga detektivët e UDB-së, nga serbët e Kosovës të importuar nga Serbia, nga " argatët shqipfolës " të serbëve. Vrasësve nuk ia ka hyrë gjemb në këmbë, as para luftës, as pas luftës. Madje ata shëtisin të lirë sot në Kosovë, vazhdojnë veprën e tyre sipas porosive të Beogradit, vrasin, terrorizojnë. Në të gjitha krimet që Serbia dhe serbët kanë kryer kundër shqiptarëve,

konkludon autori, kanë gishtë edhe PKSH-ja (më vonë PPSH-ja dhe sot PSSH-ja), kjo kolonë e pestë agjenturore " internacionaliste " antishqiptare në shërbim të sllavo-ortodoksizmit e strategjisë së elaboratëve të Graçaninit e akademikëve serbë. Ripushtimi i Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, masakrimi barbar i 60 mijë Shqiptarëve nga çetnikët serbë e nga bandat e Mihajllloviçit, pastaj nga partizanët e Titos është bërë pikërisht me mbështetjen logjistike të divizioneve që vinin nga Shqipëria e në shumë raste përpar syve të partizanëve shqiptarë ose e shoqëruar nga këngë e marshe partizane shqiptare. Masakra e Tivarit, me 12 mijë martirë, të gjithë nën moshën 20-vjeçare është një vepër e përbashkët e Tiranës dhe Beogradit. Një anëtar i Byrosë Politike të PKSH-së, kur i është raportuar gjëma e Tivarit, ka thënë: " Mirë ua bënë! Ishin ballistë, që të gjithë. " Ata ishin pothuaj fëmijë, e kanë sqaruar anëtarin e Byrosë. " Pse kujtoni se për 12 mijë kosovarë ballistë të fëlliqur do të sakrifikojmë ne shokun Tito dhe Jugosllavinë komuniste, " ua ka kthyer me zemërim ai.

Ky bashkëpunim e bashkëveprim midis serbëve dhe komunistëve me origjinë shqiptare, që ka vazhduar pa ndërprerje, pavarësisht " prishjeve " midis Tiranës e Beogradit, mbetet një nga shqetësimet më të mëdha që sjell autori Shefqet Jashari-Strofcij në faqet e këtij libri.

Sado të gërmoni nëpër arkivat shqiptare apo të huaja nuk do të gjeni asnjë telegram, asnjë radiogram, ankese, proteste, apo qoftë çfarëdo komunikimi midis komunistësh, komisarësh apo luftëtarësh partizanë ku serbëve t'ju jenë shtruar pyetjet: Pse po e vrisni Kosovën? Ç'ndryshim ka midis bëmave të bandave të Drajzhe Mihajllloviçit dhe bëmave të brigadave tuaja partizane? Prandaj e derdhëm gjakun për çlirimin e Jugosllavisë deri në Suhagorë që të kryeni masakra si ajo e Tivarit e t'i mbushni burgjet me shqiptarët e Kosovës? Duke vështruar ngjarjet, figurat, martirët, fatin e tyre nëpër faqet e librit, lexuesi arrin në përfundimin se i njëjti mekanizëm, e njëjta dorë ka vepruar pavarësisht kohës dhe hapësirës në të cilën janë realizuar ato.

Dy vjet para se të vdiste, shkrimtari i mirënjohur Petro Marko, i rrëfente gazetës "Kosova" sesi, pikërisht në kuadrin e një mekanizmi të tillë, fati i Bedri Pejani kishte rënë në duart e Hysni Kapos. Njëpërmjet një miku shkodran, ku ishte strehuar, Bedri Pejani, lideri i Lidhjes së Dytë Shqiptare të Prizrenit, politikani e publicisti i shquar, ishte lidhur me Petro Markon që ky ta ndërmjetësonte te Hysni Kapo që Bedri Pejani të

dorëzohej në besë të komunistët me të vetmin kusht: që këta të mos e dorëzonin të serbët, të shqijet, siç kishte thënë ai. Disa orë pasi ishte dorëzuar në besë, Hysni Kapo e kishte dorëzuar në duart e UDB-së dhe Bedri Pejani, burri i shquar i Kosovës, i moshuar në atë kohë, kishte vdekur në burgjet serbe. Petro Marko e ka treguar këtë ngjarje në vitet e fundit të jetës së tij si një nga pengjet më të mëdha të jetës. Komunistët, pra, kishin besë me Beogradin, me serbët e s'kishte si të kishin besë me Kosovën, me shqiptarët. Këtë besë me Beogradin dhe serbët, komunistët e mbajtën gjithmonë. Nga plot të dhëna të vërtetuara e të dokumentuara del se edhe pas "letrave të Informbyrosë" e shkëputjes së PKSH e Shqipërisë nga Jugosllavia, lidhjet agjenturore kanë vazhduar pa ndërprerje. (Mos u çuditni : ato vazhdojnë edhe sot!) Pak kohë para "letrave shpëtimtare", siç janë quajtur në atë kohë, Qemal Agolli, shkon në KQ të PKSH dhe raporton se shqiptarët në Kosovë e në Maqedoni po torturohen e masakrohen barbarisht nga serbët. Dhe "se ne ish-partizanëve e ish-komisarëve, na vjen turp që të ndeshemi me sytë e njerëzve nëpër rrugë". Kur kthehet nga Tirana, me të shkelur në Beograd, një shoku i vet ia tregon një radiogram që e kishte marrë nga Sigurimi i Shqipërisë, ku ai personalisht dhe vëllai i tij damkoseshin si "nacionalistë të tërbuar". Qemal Agolli e Nexhat Agolli burgosen në Idrizovë. Nexhati vdes në qeli, ndërsa Qemali dënohet me 14 vjet burg në Goli Otok! Pas kryerjes së dënimit, Qemali lejohet të vijë në Shqipëri, por Sigurimi i Shqipërisë, natyrisht me porosi të UDB-së, e ndalon të kthehet në shtëpinë e vet në Tiranë dhe e internon në Sarandë.

Por radiogramet, informacionet me shifër e pa shifër që denonconin me qindra e me mijëra shqiptarë nuk pushojnë. Falë këtyre shkëmbimeve të informacionit midis Sigurimit dhe UDB-së Idrizova, Dubrava, Sremi, Mitrovica, me një fjalë të gjitha burgjet e Jugosllavisë mbushen me shqiptarë të Kosovës, ashtu si edhe Spaçi, Bulqiza, Burreli, Cerriku etj. të Shqipërisë. Falë këtyre shkëmbimeve të frytshme midis Tiranës e Beogradit hekurat e burgjeve, në të dy shtetet fqinje, mbetën krahëhapur për shqiptarët e Kosovës. Në Jugosllavi shqiptarët e Kosovës akuzoheshin si "nacionalistë", "irredentistë", "enveristë", "terroristë", "fashistë", "ballistë" etj. etj., ndërsa në Shqipëri linin kockat nëpër burgje si "titistë", "revizionistë", "ballistë", "nacionalistë", "spiunë të UDB-së" etj. etj.

Në këtë vijimësi, duke ardhur deri në ditët e sotme, nuk mund të mos shtrohet pyetjet: Kush e vrau 23-vjeçarin Ali Uka, gazetarin e guximshëm, zëdhënësin e parë zyrtar të UÇK-së? A ka gisht në këtë vrasje shërbimi sekret serb? Po SHIK-u i Fatos Klosit? Cili ka qenë roli i shërbimit sekret serb në këtë vrasje dhe cili ka qenë rolo i SHIK-ut? Në ç'shikallë ka qenë bashkëpunimi midis tyre për ta realizuar këtë masakër mu në mes të Tiranës? Shefqet Jashari Strofci, përveç aftësisë që ka për të sjellë fakte të pafundme, ia arrin që këto fakte t'i nxjerrë në dritë të diellit, duke mos iu lënë asnjë rrugëdalje vrasësve. Në qoftë se SHIK-u nuk ishte ortak në krim, pse nuk e ndaloj, pse e liroi nga burgu vrasësin e dyshuar dhe pse e pezulloi tërësisht hetimin e çështjes? Dhe pyetjet që shtron libri nuk kanë mbarim:

Pse brenda disa muajve në Tiranë, pikërisht në mes të Tiranës, u kryen tri vrasje mizore që e qëllonin Kosovën në lule të ballit: ekzekutimi i Azem Hajdarit (me tiparet burrërore të Azem Galicës së ri), kolonel Ahmet Krasniqit, ministër i Mbrojtjes (në kulmin e luftës) dhe djaloshin sypatrembur Ali Uka, i thirrur shpesh altoparlanti i UÇK-së? Në qoftë se nuk ka marrë pjesë SHIK-u në këto krime monstruoze, atëherë sa milionë dollarë kanë marrë spiunët e SHIK-ut, qeveritarët e Shqipërisë për krijimin e kushteve të komoditetit maksimal në kryerjen e këtyre vrasjeve?

Nga këto që shtron libri lexuesve iu lindin domosdo një sërë pyetjesh të ligjshme: Pse detektivët serbë e zgjedhin Shqipërinë Amë (në kufijtë e Londrës) dhe kryeqytetin e saj si shesh ekzekutimesh dhe si qendër komode për "larje hesapesh". Kemi të bëjmë me një rastësi, me një mirëkuptim intuitiv apo me një marrëveshje bashkëpunimi e "kooperimi" të gjatë dhjetërvjeçarë midis UDB-së dhe Sigurimit të Shqipërisë, falë të cilit janë vrarë me mijëra të pafajshëm në të dy anët e kufirit? Autori i librit pohon në një ese se Zahir Pajaziti, një nga figurat më të ndritura të fundshekullit që iku, u vra vetë i tretë vetëm disa ditë pasi qe kthyer nga Shqipëria. Prandaj në libër arrihet në konkluzionin e drejtë se fijet e rrjetës së merimangës midis Tiranës dhe Beogradit janë të endura, të tjerrura e të sofistikuara me kujdes e kultivuar nga Tirana e Beogradi deri në labirintet më të imta e më të thella. Autori vëren se këto fije misterioze që ua shtrëngojnë fytyrën shumë prej shqiptarëve, ai i ka parë edhe në 17 janarin e vitit 1982, atë ditë të zezë kur u vranë vëllezërit Isuf Gërvalla e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. Po ato i ka parë edhe në vitet e

mëvonshme pa ndërprerë të kenë korrur e kositur figurat më të ndritura kombëtare.

Të gjitha këto tragjedi të pashoqe kanë krijuar një plagë të madhe në trupin e shpirtin e kombit tonë, plagë që në vend të shërohet, vetëm sa vjen e rritet dhe pezmatohet. Sado therëse të jenë plagët, sado të rënda të jenë traumat e sado të dhimbshme, i shëron koha, siç kanë thënë të urtët. Ndoshta mund të jetë edhe kështu. Po a thua do të ndodhte kjo spontanisht, pra vetvetiu, pa u kujdesur askush, pa çarë kokën askush, pa përdorur asnjë mjet shërues, pa treguar askush vëmendje apo përkushtim? Ndoshta, po të kishte pasur një Nuremberg edhe për atë që bëri Serbia në Kosovë, po të ishin treguar me gisht fytyrat e vrasësve, po të ishin dhënë me emër, mbiemër, numër e kod agjenturial vrasësit, po të ishin damkosur dhe vulosur spiunët, punëdhënësit e ideatorët e tyre, pra po të ishin shkukur një më një rrënjët e së keqes, po të kishte vepruar ligji, drejtësia e urtësia, po të mos ishte shpallur e harruar dhe e falur tragjedia makabre që u krye në Kosovë. Duke mos ndodhur Nurembergu, atëherë ndodh e kundërta. Në Kosovë tani nuk qajnë prindërit dhe të afërmit e të vrarëve, por vrasësit, nuk ankohen viktimat, por xhelatët.

Në emër të bizneseve të tyre dhe të interesave të tjera të tyre, një kope diabolike e satanike, janë gati që t'i djegin sërish kockat e viktimave, madje edhe t'i bluajnë ato në mokrat e mullirit, duke iu thirrur viktimave: "Qofshi të mallkuar! Ju i prodhuat vrasësit!" Vazhdojnë ata në këtë mënyrë sipas parimit të tyre të përmbysur se "po të mos ishin viktimat nuk do të ishin vrasësit". Pra, sipas filozofisë së xhelatëve, fajin për varrezat masive, për Reçakun, Krushën e Madhe, Rahovecin, Gjakovën, këto Srebrenica të Kosovës e kanë ata që janë varrosur atje, madje edhe për së gjalli, mijëra foshnja, pleqtë, gratë, invalidët, civilët e paarmatosur. Janë, ata, pra që e kanë prodhuar xhelatin!!!

Pikërisht kësaj stërtragjedie, që synon të harrohen të gjitha tragjeditë e tjera që ka kaluar Kosova i kundërvihet me librin e tij Shefqet Jashari Strofci. Duke bërë objekt të tij përvojën e 60 viteve të fundit e sidomos të njëzet viteve të fundit të shekullit që shkoi. Libri ngul këmbë se vrasësit, hafijet, tëra mekanizmat e tjera vrastare duhet të zbulohen e të shkatërrohen patjetër. Vrasësit dhe fijet e tyre misterioze të merimangës sllavoortodokse duhet të dalin në shesh, t'iu hiqen të gjitha maskat, sado të kamufluara të jenë ato. Përndryshe, sipas librit, vrasjet që prapa ferrave, te pragu i shtëpive, në rrugë pas shpine nuk do të reshtin kurrë.

Libri thotë se janë të njëjtat këto fije që kanë endur vrasjen e Jusuf Gërvallës, Bardhosh Gërvallës e Kadri Zekës, që kanë vrarë Azem Hajdarin e Ahmet Krasniqin, që kanë vrarë Fehmi Aganin, Latif Berishën, Bajram Kelmendin, që kanë vrarë Ali Ukën, Enver Malokun, Ekrem Rexhën, Shaban Manajn, që kanë plagosur Sabri Hamitin, që kanë vrarë Agim Ramadanin e Sali Çekun. A nuk janë kryer të gjitha këto vrasje sipas numrit rendor të listave të zeza! A nuk tregon kjo se vrasësit, gjashtëdhjetë vjet rresht nuk janë penduar kurrë dhe nuk e kanë ndërprerë kurrë veprën e tyre vrastare? " Ka vetëm një mjet: zbulimi, çrrënjësja dhe djegia e asgjësimi total i këtyre fijeve të nemuna. Dyllosja, vulosja e damkosja e këtyre vrasësve. Vënia e tyre në bankën e të akuzuarit, cilëtdo qofshin. Gjykimi e mallkimi i paprapsueshëm dhe i patjetërsueshëm. "Përndryshe", thekson autori, "do të përsëritet sërish çdo gjë". Autori vëren plot hidhërim: "Fara e keqe e gramit prodhon e do të prodhojë gram pareshtur". "Gjarpërinjtë do të na ngatërrohen nëpër këmbë duke tundur bishtat e zinj nëpër listat e zeza". "Në qoftë se nuk do të zbulohen vrasësit e krimet e që ata kanë kryer, atëherë vrasjet nuk do të prajnë kurrë! Nga gjenerata në gjeneratë".

Megjithë dashurinë, deri në kult, që ka për vëllezërit Gërvalla, autori nuk është dakord me porosinë në formë testamenti, që ia la gruas së vet, Suzanës, Isuf Gërvalla: "Po që vrasësi im shqiptar, kurrë mos u zbuloftë emri i tij". Shefqet Jashari Strofcit shikon te Isuf Gërvalla Poetin, Atdhetarin, Militantin, shikon mitin e qëndresës Shqiptare, ai e shikon atë si njëri të pakrahasueshëm, por nuk është dakord me testamentin e tij, ndonëse ai e ka shkruar atë me gjakun e tij. "Vrasësit duhet të zbulohen e të damkosen patjetër. Çfarëdo kombësie e çfarëdo ngjyre të kenë". "E ca më tepër kur janë të kombësisë shqiptare". "Përndryshe", vijon autori, "prita, si një gijotinë makabre do të jetë përherë në veprim e përherë e mbuluar me gjak të freskët". Autori duke buzëqeshur hidhur ndaj këtij përbindëshi të verbër që nuk ngopet me krime në Kosovë, shton: "E, pasi ka ngrënë gjyshërit e etërit, do t'iu turret bijve, nipave dhe stërnipave" Prandaj, Shefqet Jashari Strofcit, në çdo kapitull të librit të tij, në çdo faqe, në çdo rresht, të shkruar e të pashkruar, na thërret: "Mos i falni vrasësit!"

Nga pikëpamja gjinore libri i Shefqet Jashari Strofcit i përket publicistikës. Por publicistika e Shefqetit është publicistikë e dokumentit, pra gjithnjë tenton drejt letërsisë dokumentare. Autori i librit ka kultin e



faktit, kultin e dëshmisë, kultin e dokumentit. Ai shkruan vetëm mbi bazën e njohjes së afërt, njohjes së besueshme, asaj njohjeje që e bën atë dëshmitar për njerëzit dhe ngjarjet e kohës së vet. Në një rast, autori, duke folur për njërin nga personazhet e tij më të dashur, thotë se do të duhej talenti i shkrimtarit, do të duheshin romane të tëra për të portretizuar madhështinë e personazhit të tij historik. Në fakt, shkrimet e Shefqet Jasharit Strofcit shpesh janë në vetvete romane, pa çka se romane ku personazhet janë me emrat dhe mbiemrat e tyre të vërtetë, pa çka se romane, pra, me personazhe historikë.

Si në romanet e dokumentit, autori vë në shkrimet e tij një mori versionesh rreth ngjarjeve, dukurive dhe personazheve të tij, ku, natyrisht, fiton ai version në anën e të cilit janë faktet më kokëforta, në anën e të cilit është e vërteta.

Stili letrar i shkrimeve ka tipar kryesor sigurinë e autorit për atë që shkruan, çka tregon se ai shkruan rreth atyre temave për të cilat ka njohje të plotë dhe të thellë. Çka tregon se autori nuk është nga ata që i bazojnë shkrimet e tyre në hamendjet, në supozimet, në të thënat e stërthënat, por vetëm në të vërtetat. Kjo bën që një logjikë e fortë dhe e shëndoshë, një logjikë e pakundërshtueshme t'i përshkojë shkrimet e tij. Ky është tipari tjetër thelbësor i shkrimeve të Shefqet Jasharit Strofcit.

Pikërisht ky stil i shkrimit bën që publicistika e autorit të jetë e papolemizueshme. Askush, me dy para mend, nuk e merr dot penën që t'iu kundërvihet atyre që shkruan Shefqet Jashari Strofcit. Ndonëse shkrimet e tij nuk kanë natyrë shtruese, për aq sa ato e kanë objektin e tyre vihet re se autori në ato çka thotë me sukses ia del të verë pikën mbi i.

Në pajtim të plotë me stilin e autorit është përdorimi tejte i dendur i emrave të përveçëm, sidomos i emrave të përveçëm të njerëzve, çka flet në të mirë të argumentit se Shefqet Jashari Strofcit bën publicistikë të adresuar, madje saktësisht të adresuar. Për më tepër asnjë nga emrat e përveçëm nuk është emër listash të rëndomta, çdo emër i përveçëm përmban në vetvete emocione të caktuara, ndjenja të caktuara, ngarkesa të caktuara pozitive apo negative të cilat i përjeton thellësisht lexuesi. Kjo është një dhunti tjetër e rrallë e publicistikës së Shefqet Jashari Strocit.

Pikërisht kulti i fakti, kulti i së vërtetës dhe i së drejtës ka përcaktuar që pjesa më e madhe e shkrimeve të këtij libri dhe, në përgjithësi, e krijimeve publicistike të tij të jenë botuar tek gazeta kombëtare "Bota

sot". Gazeta më e madhe shqiptare e ka gjetur veten te bashkëpunëtori i saj i suksesshëm Shefqet Jashari Strofcit, aq sa edhe Shefqet Jashari Strofcit e ka gjetur veten plotësisht tek kjo gazetë, pra tek gazeta "Bota sot".

Në stilin dokumentar është karakteristikë shpesh mungesa e patosit, e dinamikës. Përkundrazi, në shkrimet e Shefqet Jashari Strofcit, patosi, dinamika janë karakteristika të veçanta që jo vetëm nuk e zbehin por edhe e fuqizojnë vlerën e fakteve. Lexuesi e ka të lehtë ta kuptojë se personazhin më përzemër autori e ka Ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës Ahmet Krasniqin. Kjo anësi e autorit vjen nga fakti se ai dhe Ahmet Krasniqi kanë qenë shokë, se miqësia e tyre ka lindur nëpërmjet miqësisë familjare dhe është forcuar nëpërmjet miqësisë së idealeve nacionaliste për Kosovën e lirë dhe për Shqipërinë Etnike të bashkuar. Autori veçanërisht ndjen borxh për Ahmet Krasniqin të ta mbrojë ndaj sulmeve të liga e shpifëse me anë të cilave armiqtë e Kosovës dhe të Shqiptarisë ia përgatitën vdekjen heroit. Autori e ndjen këtë borxh sidomos nga fakti që Ahmet Krasniqi, kur ishte gjallë, nuk i kishte kushtuar kurrë rëndësi këtij aspekti, ndërsa më vonë, për së vdekuri, nuk mund ta mbronte dot më veten.

VEHBI SKËNDERI

# KAPITULLI I PARË

## I. NGA KUSH I VIJNË TË LIGAT KOSOVËS

## NGA KUSH I VIJNË RREZIQET KOSOVËS

Kosova me bukuritë e saj natyrore, me pasuritë e shumta mbitokësore dhe nëntokësore, me pozitën e saj strategjike që zë në Evropën Juglindore ka qenë, është dhe do të mbetet objekt interesash të ndryshme të Qendrave të vendosjes ndërkombëtare.

Po shqiptarët a janë duke i shfrytëzuar koniunkturat e favorshme politike dhe shansin historik për t'i arritur objektivat e tyre kombëtare? Përgjigja gjithsesi do të jetë negative. Dhe faji i takon vetëm klasës politike që interesat e saj personale, grupe, ideologjike dhe partiake i vë mbi ato kombëtare. Në këtë gjendje tragjiko-komike në të cilën ndodhet kombi ynë, me shumë udhëheqje axhamish dhe me shumë argatë të huaj, është e pamundur për t'i realizuar synimet madhore kombëtare. Është e pamundur për ta përfutur faktorin e huaj ndërkombëtar për të na përkrahur pavarësinë e Kosovës; është e pamundur për t'i hudhur poshtë shpifjet serbo-sllavo-greke se shqiptarët "nuk janë popull shtetëformues" e përralla të ngjashme.

Fitorja e NATO-s në Kosovë dhe kthimi masovikisht i shqiptarëve në vendlindjet e tyre, edhe pse pa kushte elementare për jetesë; stabilizimi në disa aspekte i gjendjes në Republikën e Kosovës me kthimin e Kryetarit të saj Ibrahim Rugovës në Kosovë; fillimi i konsolidimit të LDK-së dhe forcave tjera demokratike dhe dobësimi i ndikimit të kolonës së pestë në Shqipëri dhe në Kosovë; përkrahja e pavarësisë së Kosovës nga personalitete të njohura publike dhe diplomatë të shquar ndërkombëtar etj., bëri që Qendra antishqiptare serbo-sllavo-greke të alarmohet seriozisht. Diplomacia greke dhe ajo ruse bënë dhe po bëjnë ç'është e mundur për t'i amortizuar grushtat dërmuese që i muarën nga NATO-ja ato dhe politika antishqiptare dhe antinjerëzore e aleatëve të tyre: Serbisë, Maqedonisë, Sorosit dhe llumpenproletariatit ndërkombëtar. Shqipëria u bë han i diplomatëve grekë, për t'i kontrolluar dhe për t'i mbushur me programme të reja Robotët e tyre që i vunë në pushtet. Roboti i parë i quajtur Kryexhadallnanoi, për të cilin shumica e njerëzve mendonin se ka dalë nga përdorimi nga puna e tepërt që bëri për patronët, pas një pushimi të shkurtër u përtëri, shkeli Shqipërinë kryq e tërthorë dhe rrahi gjoks se ai ende është "Roboti i parë". I vuri në veprim metodat e përdorura shumë herë më parë, dhe kështu e mundi

Majkohallëligun në Kongresin e llumpenploretariatit të Shqipërisë dhe në vend tij u bë vet kryetar. Dhe tani si edhe më parë Kryexhadallnanosi me xhadallët e tij: Milosin, Mejdanosin, Cekoviçin, Klosin dhe kryedjajt kuqaloshë, që e kanë zënë Parlamentin e Shqipërisë po i kryejnë urdhërat e patronëve të tyre me mjeshtëri, duke penguar çdo proces që do të qonte në stabilizimin e Shqipërisë, duke dalë në anën e forcave antishqiptare, që po e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës, stabilizimin e Shqipërisë dhe forcimin e faktorit shqiptar. Ata pasi mbollën farën e përçarjes në Kosovë me anë të dy Kryedjajve bajraktarë, që patën marrë urdhër LDK-në ta përçajnë dhe pastaj ta pjellin LBDK-në për t'i bashkuar enveristët kosovarë, dhe pastaj në bashkëpunim me pararojën staliniste të LPK-së, edhe në Kosovë t'i krijojnë kushtet për lindjen e një "revolucion të vonuar demokratik" të ngjashëm me atë të Shqipërisë. Dhe kështu, pas shumë kompleteve të njëpasnjëshme që Xhadallnanosi ia bëri Kosovës, u dha urdhur stalinistëve të LPK-së dhe enveristëve të LBDK-së për ta formuar të ashtuquajturën "Qeverinë e Përkohshme të Kosovës", kur Kosova përjetonte goditjet më të rënda në historinë e saj. Dhe kur hordhitë e shkijeve u detyruan nga NATO-ja të ikin me bisht për këmbë, ia mësyen Kosovës enveristë, stalinistë, titistë, karrieristë të të gjitha ngjyrave, rrugaçër, hajna e kriminelë për të marrë dhe përfituar për çka ishin munduar dhe kishin luftuar: Vjedhën, rrafën, vranë, zunë pozita udhëheqëse dhe të mira materiale përfituan. Formuan një herë një parti dhe kur e panë se kryepartiakun e saj Bardhucin nuk e njeh në Kosovë njeri i gjallë, përpos disa dhjetëra stalinistëve të gjorë, atëherë u detyruan nga bërthama e saj dhe prej ca të tjerëve që vendin aty s'e kanë, ta riformojnë partinë tjetër me Thaçin kryetar të saj.

Formimi i partisë së pararojes staliniste të LPK-së dhe ngatërresat artificiale që po i shpikin në mes veti përfaqësuesit e Sorosit me përfaqësuesit e LPK-së e të LBDK-së, janë aktrime për të realizuar shumë qëllime, por ndër kryesorët është që forcat e shëndosha t'i venë në gjumë duke i bindur se pushtetin në Kosovë pa vështirësi do ta marrin edhe pa u organizuar mirë, ndërsa vetë po i bëjnë të gjitha përgatitjet për t'i fituar zgjedhjet dhe për t'i marrë votat e popullit me hatër apo me zor, me mjete "demokratike" dhe me mjetet bolshevike siç i patën përdorur në Shqipëri gjatë "zgjedhjeve të lira" më 1997. Kur dihet se ato zgjedhje i patën shpallur të "suksesshme" dhe të "pranueshme" organet udhëheqëse të Bashkësisë Evropiane dhe Organizata të ndryshme joqeveritare, që

ishin nën ndikimin e të majtës evropiane e të forcave të errëta të llumpenproletariatit ndërkombëtar, si dhe të sigurimeve të fshehta të Rusisë-Serbisë dhe Greqisë. Pse edhe tash mos t'u dalin në ndihmë stalinistëve, enveristëve, karrieristëve dhe partiakëve të shtirë të Kosovës për ta marrë pushtetin në Kosovë, si shpërblim për punën e bërë, duke ditur se me ta shumë më lehtë do ta kanë për të bërë pazarllaqe në dëm të Kosovës dhe kombit shqiptar?

Po qe se edhe më tutje shqiptarët rrinë indeferentë ndaj dukurive të shëmtuara që po ndodhin sot në gjithë hapësirën kombëtare, bartësit e të cilave janë shqiptarët dhe shqipfolësit, shansi historik do të na dalë nga dora; Kosova do të mbetet për një kohë të gjatë "utrinë katundi" për ta kullotur atë "thiu e i biri thiut" e për ta tollovitur "qen e i biri qenit". Do të dergjen mijëra shqiptarë nëpër burgjet e Serbisë, që janë kidnapuar nga shkiet gjakatarë! Paramilitarët serbë sëbashku me stalinistë të prishur mendsh do të vrasin çdo ditë shqiptarë. Lufta e partiakëve të shtirë dhe karrieristëve të sëmurë për pushtet dhe privilegje do të jetë edhe më e ashpër se deri më tash! Shqipëria do të mbetet edhe më tutje në agoninë e vdekjes, arenë interesash serbo-sllavo-greke dhe moçal i karrieristëve dhe partiakve të shtirë, ndërsa mafitë e ndryshme kriminele të vendit dhe të huajat do të lulëzojnë duke nxjerr përfitime të mëdha në kurriz të popullit të gjorë! Kosova Lindore do të zbrazet nga shqiptarët! Trepçën do ta marri shkau! Viset tona në Maqedoni nën pushtimin e magjupve sllavë edhe më tutje do të rrënojnë! Kaosi, krimi dhe mafitë në gjithë hapsirën kombëtare do të sundojnë!

Dihet se planet dhe skenarët e Qendrës Antishqiptare serbo-sllavo-greke nuk u realizuan në tërësi. Njeriu më besnik i saj Kryexhadallnanosi disa i realizoi me sukses, disa i vuri në veprim, disa që më së shumti shpresonte në suksesin e tyre muarën tjetër kahje zhvillimi dhe ai dështoi plotësisht.

Me siguri po të kishte pasur sukses të plotë tash i gjori do të bënte ahengje nëpër botë, por pasi në shumë plane ai dështoi, e futën edhe një herë kokëkrisurin në lojë. Dhe dihet se sa herë të huajt atë e kanë shtirë në lojë, kombin tonë e kanë qitur në dy gjunj. Xhadallnanosi me argatët e tij edhe këtë herë dëme të mëdha do të na bëjë, por me siguri këto do të jenë të ligat e tyre të fundit, sepse populli ynë këto vitet e fundit aq shumë ka mësuar, sa që nuk e ka të vështirë për të kuptuar, se kush punoi për Kosovë e kush për shkini, Greqi dhe Rusi; kush i bëri shqiptaret pikë e

pesë duke i ndarë dhe përçarë, e kush u mundua t'i bashkojë dhe t'i bëjë faktor me rëndësi; se kush shpifi, gënjeu, e vrau shqiptarë, dhe kush të vërteten e mbrojti dhe të ligat i kundërshtoi; se kujt duhet për t'i besuar e prej kujt duhet ruajtur edhe kur flet ëmbël e bukur; kënd duhet për ta dashur dhe për ta afruar e kend për ta urrejtur dhe larguar.

Më në fund, duhet shpresuar se intelegjencia jonë e pa komprometuar, veprimtarët e dalluar, atdhetarët nacionalistë, rinia jonë heroike që i mbushi radhët e UÇK-së, besimtarët që i besojnë Një Zoti të vërtetë, masat e gjëra të popullsisë që e kanë urrejtur komunizmin sikur shkaun, do ta dënojnë dhe do ta "rrahin" këtë klasë politike, siç e ka merituar, atë ditë kur do të mbahen zgjedhjet e lira në Kosovë. Do t'i dënojnë veçmas enveristët dhe titistët e përbetuar, të cilët ende nga kjo ideologji e djallit të mallkuar nuk u shëruan, dhe nuk po kuptojnë se vetëm debilët ende nuk kanë mësuar se bolshevizmi ishte një kancer, ishte një kolerë dhe priftim, ishte një

mish i egur për popujt që ajo i përfshiu, ndësa kokëkrisurit shqiptarë ende në ideologjinë e pansllavizmit kanë besim, dhe shpresojnë se me mjetet staliniste të dhunës e të frigës synimet e tyre do t'i arrijnë.

Dhe për të arritur objektiva madhore kombëtare është e domosdoshme që në Kosovë sa më parë të fillojnë përgatitjet për formimin e një partie nacionaliste, nga idealistët e nacionalizmit shqiptar, intelektualë dhe veprimtarë të dalluar të çështjes kombëtare dhe atdhetarë, që me programin e saj kombëtar, me punën me përkushtim të çdo anëtari të saj, do të arrijnë t'i bashkojnë rreth vetes shtresat e ndryshme të popullsisë dhe me votat që do t'i marrin bijtë dhe bijat më të mirë të kombit, përfaqësues të partisë nacionaliste, do të jenë në gjendje t'i realizojnë synimet shekullore të popullit shqiptar, ndërsa gjaku i dëshmorëve tanë nuk do të shkonte huq si shumë herë më parë. Kosova do ta fitonte pavarësinë e saj, dhe kështu, shqiptarët do të bëhen një forcë reale në Ballkan, që me zgjuarësi dhe trimëri do të arrijnë realizimin e programit kombëtar të përcaktuar nga ideologët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe rilindasit tanë.

*Botuar: "Bota sot" më 31 tetor 1999*

## PËRÇARËSIT E KANË VENDIN TE DERA

Derisa forcat e vendosjes ndërkombëtare NATO-ja, SHBA-të, etj., po merren seriozisht për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, duke iu dhënë dajakun e merituar barbarëve sllavë të Karpateve të Rusisë, klasa politike shqiptare nuk po vetëdijësohet dot, për dëmet e mëdha që i sollën zgjidhjes së drejtë të çështjes sonë kombëtare në përgjithësi, dhe zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës në veçanti, me komplotet dhe përçarjet e thella ndëreshqiptare dhe ndërnjerëzore që ata krijuan në këto tri vitet e fundit, që kur në Shqipëri u vunë në veprim skenarët antishqiptarë të armiqve tanë shekullor sebo-sllavo-grekë nëpërmjet rebelimit komunist të 1977.

Shqiptarët edhe pas përvojave të shumta të hidhura gjatë historisë së tyre të gjatë, të mbushura me plot përpjekje të vazhdueshme për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar, paqe dhe begati, nuk arritën dot t'i realizojnë aspiratat e tyre, jo siç thonë komunistët shqiptarë me fajin e "Evropës shtrigë..." por me fajin e prijesve shqiptarë, që gjithmonë në momentet vendimtare, kur qendrat e vendosjes ndërkombëtare vendosnin për fatet e atdheut të tyre, ata ndaheshin e përçaheshin për shkaqe banale, siç janë interesat apo inatet personale dhe kështu, serbo-grekëve u ndihmonin që të gllabëronin pjesë të mëdhe të trojeve shqiptare.

Është fakt që, më tepër se një herë, shqiptarët kanë qenë të rrezikuar nga fqinjët e tyre nga zhdukja fizike apo shkombëtarizimi, sikur të mos kishin ndërhyrë forcat jashtëballkanike, siç ndërhyjnë edhe sivjet, për t'i penguar planet dhe skenarët antishqiptarë të serbo-sllavo-grekëve me në krye Rusinë. E kush sot nuk e ka të qartë se i ashtuquajtimi "revolucion i vonuar demokratik" i Shqipërisë ishte vepër e një skenari antishqiptar serbo-sllavo-grek, ndërsa gjenocidi dhe pastrimi etnik i Kosovës gjatë tri viteve të fundit vazhdim i fazës së dytë të të njëjtit skenar, për ta përfunduar zgjidhjen e çështjes shqiptare ashtu siç e donin interesat serbo-sllavo-greke.

Fatkeqësisht, udhëheqja e subjekteve shqiptare edhe pas kësaj tragjedie që e goditi Kosovën me fajin e saj, po vazhdon lojën e djallit të mallkuar, duke i ndarë dhe përçarë shqiptarët, dhe kështu faktorin shqiptar e bën të paafte për t'i marrë fatet e kombit në duart e tij, kur i



është dhënë shansi historik me përkrahjen e pakursyer të NATO-s dhe të opinionit demokratik ndërkombëtar.

Opinionin ynë demokratik dhe miq e dashamirë të kombit tonë duke ditur se çlirimi i Kosovës nga kthetrat serbe nuk është aq i lehtë, siç mendonin grupe injorantësh dhe analfabetikë politikë, kërkuar me ngulm nga udhëheqjet shqiptare, që të dalë me një zë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, duke i bashkuar subjektet e tyre politiko-ushtarake dhe resurset kombëtare për arritjen e objektivave madhore kombëtare. Fatkeqësisht ndarjet dhe përçarjet po rriten dhe thellohen dhe nuk duhet pritur ndonjë ndryshim radikal në kokat e përçarësve, pasi që zemrat e tyre janë të mbushura me helm, ndërsa shpirtin ua kanë shitur djajve të mallkuar. Ata do të vazhdojnë edhe më tutje luftën për pushtet duke mos zgjedhur as mënyra dhe as mjete për të zënë pozita udhëheqëse në momentin e duhur kur NATO-ja dhe UÇK-ja ta çlirojnë Kosovën. Fatmirësisht, koha nuk po punon për karrieristët e sëmurë për pushtet dhe partiakët e shtirë, pasi që, me përçarjet dhe dëmet që i sollën çështjes sonë kombëtare, nuk do të kenë më kredibilitet për të zënë vende udhëheqëse në institucionet shtetërore të Kosovës. Vendi i tyre me siguri do të jetë në bankën e zezë, për të dhënë llogari para organeve të drejtësisë shqiptare, për dëmet e mëdha që i shkaktuan çështjes sonë kombëtare në përgjithësi dhe UÇK-së në veçanti. Planet e tyre për ta marrë pushtetin në mënyrë komuniste, jo me votën e popullit por me "grykën e pushkës" do t'iu dështojnë me siguri. Nga radhët e UÇK-së do të dalin politikanë të zotë e atdhetarë, që nuk janë të infektuar dhe të sëmurë nga ideologjia pansllaviste-marksiste-leniniste, por që janë të brumosur me ideologjinë nacionaliste.

Të kërkosht sot bashkimin e përçarësve të subjekteve shqiptare, në vend që të kërkosht dënimin moral dhe pas çlirimit të Kosovës dënimin ligjor të tyre, është mosnjohje elementare e karakterit të tyre të lig, e zemrës katran. Ata duhet demaskuar pa mëshirë, pasi që nuk dëgjuan fare për kërkesat e opinionit të gjërë dhe as për këshillat e dashamirëve dhe miqve të kombit tonë, që t'i bashkojnë subjektet politike dhe ushtarake të Kosovës, për të dalur me një zë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Por, më në fund,

shumë komplete djallëzore të tyre, që mirreshin më parë nga një pjesë e popullsisë si xhevahir të shpëtimit të çështjes sonë kombëtare, muarën kuptimin e tyre të plotë e të vërtetë, në momentet më të vështira që përjetoj populli ynë në Kosovë gjatë fushatës së egër të barbarisë serbe të

gjenocidit, pasi që ata, edhe kur Kosova rrënkonte nga masakrat serbe, vazhduan dhe po vazhdojnë të ndajnë e të përçajnë shqiptarët, duke e shpallur vetveten si shpëtimtarë të kombit, si udhëheqës politikë të UÇK-së, apo udhëheqës shtetërorë, edhe pse tani vetëm të verbuarit politikë, të marrët dhe bashkëpunorët e tyre në komplete dhe në krime nuk i shohin, nuk donë t'i shohin, apo nuk donë t'i pranojnë dëmet e mëdha që ata ia sollën Kosovës. Në bazë të fakteve që sot njeh opinionin ynë i gjerë, mund të thuhet me plot të drejtë se përgjegjësinë më të madhe e mbajnë për dështimet e shumta të Lëvizjes sonë kombëtare gjatë këtij dhjetëvjeçari këto klane të individëve që u vunë në ballë të subjekteve partiake apo shtetërore të Republikës së Kosovës: Me siguri përgjegjësia më e madhe bie mbi Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, Bukoshin dhe klanin e tij, që mund të thuhet se çdo gjë tjetër ka punuar, por jo edhe për detyrat shtetërore për të cilat Kushtetuta e Kosovës e ka ngarkuar. Mjafton për t'i cekur vetëm ca fakte, që tregojnë për fajet e tij, që UÇK-ja nuk u institucionalizua, që nuk u forcua në pikëpamje profesionale dhe as materiale, edhe pse ai kishte mundësi ta ndihmonte që në hapat e parë të saj, pasi që ai kishte kontakte me Adem Jasharin, prijsin e saj legjitim. Pra me fajin e tij pararoja staliniste e LPK-së bëhet udhëheqje politike e UÇK-së, në sajë të ndihmave që ata i tubuan nga mërgimtarët. Ai bëri përpjekje maksimale që UÇK-ja të mbetej një organizatë ilegale, me një veprim të kufizuar ushtarak, vetëm sa për t'i ndihmuar atij dhe klanit pararojë të LDK-së për t'i filluar bisedimet me Jugosllavinë, për të fituar çfarëdo autonomie, vetëm që ata vendet udhëheqëse t'i mbajnë për disa mandate me radhë. Pas Bukoshit vjen pararoja staliniste e LPK-së, e cila UÇK-së dëme të rënda i shkaktoi. Në fillim, me sjelljet e tyre të papërgjegjshme UÇK-në e rrezikuan të shpallet komuniste, enveriste, maoiste, teroriste etj. Pas vrasjes së Adem Jasharit ndërruan simbolin e UÇK-së, që mbështetej në dy parime bazë, që ishin të shkruar në emblemen e saj, që atë e rrethonte: "Në emër të Zotit dhe Kosovës" me shkurtësin " UÇK" në ballë, dhe me ushtarin e armatosur në mbrendësinë e saj. Bënë edhe shumë "marifete" tjera, por mbi të gjithat UÇK-në e penguan të forcohet e të bëhet ushtri e fortë kombëtare, nuk lejuan institucionalizimin e saj, nuk lejuan të armatoset mirë e të kompletohet me kuadra të afta profesionale.

E shpallën vetveten krah politik të saj, edhe pse SHP i UÇK-së njoftonte opinionin e gjerë se ajo nuk është ushtri e asnjë partie dhe subjekti politik

shqiptar. Por UÇK-ja, edhe pse i kërcënoi individët e LPK-së për të mos folur në emër të saj, ajo nuk e mbylli gojën, i dërgoi njerëzit e saj në Tiranë, që nëpërmjet kryespiunit greko-serb Nanos, të bëhen me ndikim në SHIK-un e Shqipërisë dhe çka të dojnë të bëjnë, për të mos pasur mundësi askush ta ndihmonte UÇK-në pa lejen dhe kontrollin e tyre. Në këtë mënyrë lëpëkistat e penguan UÇK-në për t'u bërë ushtri moderne, e fortë në pikëpamje profesionale dhe e pajisur me armatime të rënda dhe moderne, të cilat Ministria e Republikës së Kosovës kishte mundësi t'i siguronte edhe pa të holla nga shtete vëllezër dhe miq të kombit tonë, por si t'i siguronte ato, kur asgjë nuk futej në Shqipëri pa e ditur e pa lejuar përgjegjësit e LPK-së dhe SHIK-ut të Shqipërisë. Nanosi nuk donte armatime të rënda e moderne për UÇK-në, sepse me to rrezikoheshin interesat e patronëve të tij serbo-grekë, prandaj ai lejoi që aktivistët e LPK-së t'ia mbledhin kallashnikovët e dalë nga përdorimi, që kishte mjaft në veri të Shqipërisë, me të cilët bandat e tij më 1997 e patën kallur Shqipërinë dhe betohej Nanosi i lëpëkistave se me ta do të shkatërrohet shumë lehtë armata e Jugosllavisë.

Por dëmet që ia sollën Kosovës R. Qosja dhe H. Hyseni me kompani nuk janë më të vogla se të Bukoshit dhe pararojës staliniste të LPK-së, të cilët, të gjithë sëbashku, bënë aleancë për pengimin dhe mospranimin e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe kështu bënë përçarje të thella ndërshqiptare dhe ndërnjerëzore, jo për shkaqe të mirëvajtjes së punëve rreth çështjeve kombëtare siç arsyetoheshin ata, por për interesat e tyre klanore dhe personale.

Duke e ditur kryepërçarësit se autoriteti i Rugovës është më i madh se i të gjithë atyre sëbashku, nuk pranuan të marrin pjesë në zgjedhjet e dyta presidenciale dhe parlamentare të Kosovës, fillimisht me arsyetimin se nuk mund të bëhet fushatë zgjedhore në kushte të robërisë, ndërsa pasi u bënë masakrat e para serbe në Drenicë, gjetën një "arsye" tjetër për t'i bojkotuar ato. Dështimi i karrieristëve u tregua i plotë, kur përfaqësuesit legjitim të Drenicës kërkuan të mbahen zgjedhjet dhe veçanërisht pasi populli i injoroi ata dhe masovikisht muarën pjesë në zgjedhje. Karrieristët e Prishtinës, pasi u bindën se me votën e lirë të popullit nuk do të vijnë në pozita të institucioneve shtetërore të Kosovës, i bashkuan "subjektet" e tyre dhe bënë aleancë me pararojën staliniste të LPK-së e me Bukoshin që nëpërmjet tyre t'i fusin gishtat në udhëheqjen e UÇK-së, jo për ta çuar përpara zgjedhjen e çështjes së Kosovës, por për t'i bërë të

pavlefshme zgjedhjet e dyta të Kosovës dhe subjektet shtetërore të dala nga ato zgjedhje: Presidencën dhe Parlamentin. Më vonë dalja e Bukoshit nga aleanca për t'iu bashkuar Rugovës e ka dobësuar aleancën shumë. Edhe sa do të ketë jetë aleanca në mes LPK-së dhe LBDK-së, në rend të parë mëvaret se a do ta ndajnë gjahun sipas "meritave" apo në bazë të mashtrimeve dhe kurthave reciproke. Qosja me klanin e tij dhe me pararojën staliniste të LPK-së formuan " Qeverin e Përkohshme të Kosovës " pa e respektuar procedurën e formimit të një qeverie me rregulla demokratike, në momentet e krizave ekonomike apo politike. Tani u bë e kjashtë se për ta nuk ka shumë rëndësi se a e njohin apo s'e njohin atë Qeveri faktorët e vendosjes ndërkombëtare, a i sjellin dëme apo dobi Kosovës; për ta ka shumë rëndësi, që nga situa e krijuar, kur Kosova masakrohej, të nxjerrin për vete dhe klanet e tyre sa më shumë dobi. Fatmirësisht NATO-ja dhe shtetet përfundimtare, për të mos e bërë Kosovën Afganistan të Evropës, nuk po e njohin qeverinë e Thaçit dhe as të Bukoshit, por po e njohin vetëm Delegacionin e Rambujesë, që sipas tyre i përfaqëson pothuajse të gjitha subjektet e Kosovës.

Fatmirësisht Kosovën po na e çliron NATO-ja me ndihmën e pakursyer të trimave të UÇK-së. Më në fund do t'i këshilloja partiakët e shtirë dhe karrieristët e sëmurë për pushtet e, në veçanti, kryepërçarësit: Qosjen, Bukoshin, H. Hysenin dhe pararojën komuniste të LPK-së, që u transferuan në udhëheqje politike të UÇK-së, ta fusin bishtin nën shalë e të mos iu ndihet zëri se gjenden dikund gjallë, pasi iu kanë " cofur morrat " e, kurrën e kurrës më, popullit të Kosovës nuk do t'i dalin në ballë. Në kohën sa do të zgjatë protektoriati ushtarak dhe civil ndërkombëtar, nuk mund të mendohet se do ta kenë besimin e faktorit ndërkombëtar, por edhe kur do të krijohen kushte për zgjedhje të lira në Kosovë, mos tua "pijë mendt sorra" e të konkurojnë për pushtet, duke shpresuar se me të hollat që i kanë tubuar në emër të UÇK-së, dhe që ende po mbledhin, do të gjejnë të marrë për t'i votuar, sepse tani të gjithë i njohim si parën e kuqe, pasi që më nuk do ta shikojmë askend se çka flet, por çka dhe si vepron.

*Botuar: "ZËRI DITOR" 30.06.dhe 01.07.1999*

## PUSHTETARË, MOS LUANI ME FATET E KOMBIT DHE TË ATDHEUT

Kush nuk e ka ende të qartë se klasa politike e Kosovës, Qeveria dhe Presidenti i saj kanë rënë në provimin e jetës më shumë se një herë. Veçmas, çoroditja e tyre në këto momente tragjike që po përjeton populli ynë, vërteton më së miri papërgjegjësinë, joseriozitetin dhe mjerimin e tyre shpirtëror.

Kur opinioni ynë, personalitete e politikanë të qendrave të vendosjes dhe miq e dashamirë të popullit tonë u bënë thirrje kryepartiakëve dhe pushtetarëve të Kosovës t'i bashkojnë forcat, veprimet dhe qëndrimet për të dalë me një zë para faktorit ndërkombëtar dhe atij serb për çështjen e Kosovës, ata na i zgjatën veshët, duke pritur se kur do të dalin me " Qeverinë e Shpëtimit Kombëtar ". Kur njëra palë donte të formohej Qeveria, tjetra palë donte të formohej " Këshilli Kombëtar ". Kur të Rugovës donin formimin e një Qeverie të përbashkët ata të Qosjes nuk pranonin. Kur ata të Qosjes u pajtuan të vazhdojnë bisedimet (në pakufi) për të marrë pjesë në Qeveri, ata të Rugovës formuan Grupin Negociues, që do të bisedonte me palën serbe dhe kështu, po vazhdohet politika dështuese tetëvjeçare "dikush thumbit, dikush patkoit".

Derisa çetnikët e Beogradit në fushatën e fundit kundër Kosovës, masakrojnë gra, fëmijë pleq e njerëz të pa armatosur dhe me topat dhe avionin e tyre po hedhin hekur e zjarr mbi vendbanimet shqiptare të Drenicës dhe të Dukagjinit, duke i kthyer në gërmadha fshatra dhe qytete të tëra, duke na sjellë vaj, lot, vuajtje, mjerim dhe varre, klasa politike dhe shtetarët e Kosovës ende nuk po vetëdijësohen për përgjegjësinë e madhe kombëtare dhe historike që kanë në këto momente dramatike dhe vendimtare për kombin tonë.

" Subjektet " dhe " pushtetarët " tanë e kanë humbur busullën e jetës. Zemrat e tyre guri, nuk ndiejnë për vajin e fëmijëve dhe nënave të strukur nëpër gërmadha të shtëpive e në male, pa ushqim, pa veshmbathje, pa kujdesin e askujt e të trishtuar nga thika e çetnikve gjakatarë. Ata nuk dëgjojnë as gjamën e të plagosurëve dhe të sëmurëve për ilaçe dhe për kujdesin mjekësor. Zemra e tyre hekur është e

pandishme ndaj lotëve dhe mallkimit të nënës për fëmijën e masakruar, për djalin e rrëmbyer.

" Subjekte " e " pushtetarë " shqiptarë të Kosovës ejani në veti sa më parë!

Lerini anash ngatërresat e përçarjet e vjetra dhe mos na krijoni përçarje, ngatërresa dhe pengesa të reja!

Dëgjoni zërin e arsyes, zërin e popullit!

Mos shkelni gjakun e derdhur rrëke të dëshmorëve dhe heronjve tanë!

Mos luani me fatet e kombit dhe të atdheut!

Lerini inatet, xhelozitë dhe marrëzitë e tjera që i bëni për interesa personale dhe partiake!

Mos punoni për hesape të armiqve tanë se turpi i botës do të bjerë mbi ju, e do t' u varrosë për së gjalli me faqe të zezë.

*Botuar: në " Rimëkëmbja " më 1 shtator 1998 dhe në " Bota sot " në shtator 1998*

## PSE PO PENGOHET FORMIMI I QEVERISË SË KOSOVËS

Një popull i lashtë e fisnik, siç është ky yni, trim, krenar e zemërgjërë, që i Madhi Zot ia dhuroi Viset më të bukura dhe më të pasura të kontinentit të Evropës, nuk e pati lehtë t'iu përballonte sulmeve të njëpasnjëshme të armiqve të shumtë, të afërt e të largët, fqinjve tinzarë dhe ardhacakëve barbarë. Vetëm luftërat e vazhdueshme për jetë a vdekje me serbo-sllavo-grekët në mënyra të ndryshme dhe rrethanat lehtësuese që u krijuan në Siujdhesen Ballkanike nga faktorët e huaj jashtëballkanikë, në periudha historike kur populli ynë gjendej në situata tejet të vështira, e shpëtuan nga zhdukja e sigurt.

Thuhet se historia është "mësuesja e jetës" dhe se ajo nuk përsëritet. Këto thënie i kanë hudhur poshtë prijësit dhe udhëheqsit shqiptarë me veprimet e tyre, në të gjitha ngjarjet e rëndësishme të vendit të tyre, pasi që të njëjtat gabime dhe faje janë përsëritur gjeneratë pas gjenerate. Të gjitha luftërat që i ka bërë populli ynë, që nga Teuta e deri në ditët e sotit janë bërë të pa përgatitura mirë sa duhet (përpos të periudhës së Skënderbeut) dhe pothuajse të gjitha kanë filluar jo në momentet më të përshtatshme, por gjithnjë, parakohe apo pas kohe, kur më së miri iu shkonin për shtati interesave të armiqve tanë. Çka është më e keqja, prijësit dhe udhëheqësit e popullit tonë, në të gjitha ngjarjet e rëndësishme që vendosej për fatet e atdheut janë ndarë dhe përçarë për interesa personale apo për kapriçio, xhelozitë dhe inate që kishin ndaj njëri tjetrit. Në mënyrën më të zezë dhe më të vrazhdë po përsëriten të njëjtat dukuri edhe në ditët e sotit, kur qenia jonë kombëtare është e rrezikuar më tepër se kurrë më parë, ndërsa Kosovës po i kanoset rreziku i coptimit nga kasapët serbë me përkrahjen e drejtpërdrejt apo tërthorazi të klasës politike të Kosovës.

Dihet se roli i individit, i personaliteteve që kanë bërë emër kanë luajtur rol me rëndësi në rrjedhat e ngjarjeve shoqërore, kulturore dhe politike të popullit tonë. Armiqtë tanë gjithmonë kanë ditur të na godasin aty ku më së shumti na sjellnin dëme dhe pasoja. Ata me mjete perfide ditën të na i zhdakin moralisht dhe pastaj fizikisht prijësit dhe udhëheqësit tanë më të zotë, që patën zotësi, autoritet, guxim, dije organizative dhe trimëri për t'ua shkatërruar planet antishqiptare atyre që

kishin pikësynim gllabërimin e trojeve tona. Mjafton t'i përmendim personalitetet historike të shekullit 20-të, pa i përmendur edhe personalitetet e mesjetës e të shekullit 19-të, që u zhdukën nga armiqtë tanë duke paguar injorantë dhe tradhtarë nga radhët tona, për ta ngrehur gishtin e krimit për hesapet dhe interesat e tyre. I vranë, i mbytën nëpër burgje, apo vdiqën menjëherë pasi u liruan nga burgjet, si pasojë e torturave të bëra nga shkijet xhelatë. Bënë atentate politike ndaj Isa Bolitinit, Hasan Prishtinës, Luigj Gurakuqit, Avni Rustemit, Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, Enver Hadrit, Azem Hajdarit, Ahmet Krasniqit etj. Ndërsa i mbytën nëpër burgje, apo vdiqën po sa dualën nga burgu, vdiqën nga pasojat e torturave: Shaban Shala, Fazli Grajqefci, Zija Shemsiu, Metush Krasniqi, etj.

Armiqët tanë serbo-grekët po i venë në jetë planet e tyre antishqiptare sipas skenareve të përgatitura mirë. Goditjen për vdekje ia bënë kombit tonë vitin që shkoi nëpërmjet të ashtuquajturit "revolucion të vonuar demokratik". Skenarët e tyre po i realizojnë shkallë-shkallë me mjete sadiste. Kolona e pestë po vepron në të gjitha trojet shqiptare. Ushtria greke në Tiranë ruan pushtetarë të cilët i marrin urdhërat dhe planet nga Athina dhe Beogradi për ta goditur Shqipërinë tinëz nga mbrenda, për të mos e lënë t'i çelë sytë, që të mos bëhet e zonja as për vetveten e lere më të jetë në gjendje të kujdesej për bashkëkombasit e saj në Çamëri, Kosovë dhe Vise tjera shqiptare. Toplicën dhe Çamërinë i pastruan etnikisht qysh moti, dhe në ato vise me shqiptarë më nuk kanë probleme. Tani po bashkëveprojnë serbo-grekët për ta pastruar etnikisht Kosovën, ndërsa Shqipërinë e Jugut për ta shkombëtarizuar me anë të helenizimit, dhe pastaj me krijimin e kushteve dhe rrethanave të përshtatshme të kalojë nën okupimin e drejtpërdrejt të Greqisë. Fatkeqësisht, serbo-grekëve sot po iu ndihmojnë, me vetëdije apo pa vetëdije, në planete tyre djallëzore, pushtetarët dhe subjektet politike të Shqipërisë dhe të Kosovës. Edhe partiakët e shtirë, që veprojnë nëpër degët e partive shqiptare të formuara në diasporë, dhe pararoja komuniste e LPK-së, i kanë përçarë dhe po i përçajnë gurbetqarët tanë, duke i vënë interesat e tyre partiake, personale dhe klanore mbi ato kombëtare. Ata janë bërë pengesë e madhe për ta organizuar diasporën në baza të shëndosha kombëtare, dhe kështu, po e bëjnë punën e armiqve tanë shekullorë duke i ndarë dhe përçarë shqiptarët në baza partiake, klanore dhe regjionale.



Me daljen në skenën politike të Unionit të Pavarur Studentor, dhe të UÇK-së, shqiptarët e "mundën frigën", prishën edhe status-quonë " shtreje qafën e mos baj zâ " në Kosovë. Rezistenca burrërore e prijësit të UÇK-së Adem Jasharit me familjen e tij dhe masakrat e fëmijëve e grave nga serbët e ndërkombëtarizuan çështjen e Kosovës dhe ngritën në këmbë rininë tonë heroike për t'i rrokur armët e për t'i dhënë UÇK-së forcë dhe krah, për t'u rritur e forcuar më një shpejtësi të rrufeshme. Subjektet tona politike dhe shtetërore, e në veçanti Qeveria e Bukoshit, në vend se t'i bashkojnë veprimet dhe qëndrimet për ta forcuar me kuadro dhe armatime të rënda UÇK-në e për ta institucionalizuar atë, vazhduan me politikën e tyre "dikush thumbit dikush patkonit" thuajse asgjë nuk po ndodh, edhe pse Drenica dhe Dukagjini po digjeshin flakë. Presidenti i Kosovës më në funt e formoi Parlamentin e Kosovës me përkrahjen e faktorit ndërkombëtar. Në vend se të përkrahet themelimi i Parlamentit si një institut me rëndësi të madhe shtetërore, nga të gjitha forcat politike të Kosovës, formimi i këtij instituti nuk u përkrah, dhe u shpall jo legjitim nga Qosja, Demaçi, Hyseni, UÇK-ja dhe Beogradi. Një anomali e tillë mund të ndodhë vetëm tek shqiptarët. Qosja me kompani bashkë me Demaçin, në vend se ta përgëzojnë Rugovën për këtë fitore të shtetësisë së Kosovës, duke punuar pa hile në formimin e Qeverisë së përbashkët, me të gjitha forcat politike që përfshiheshin apo nuk përfshiheshin në Parlament, për të cilën çështje ishin dakort Presidenti dhe Parlamenti i Kosovës, ata donin ta formonin një Qeveri të dalë nga një forum partiak, i ashtuquajtur " Këshilli Kombëtarë " me të cilin do të injiroheshin institucionet shtetërore. Diplomacia amerikane, më në fund, arriti t'i detyrojë udhëheqësit e përçarë të Kosovës për të filluar bisedimet për formimin e Qeverisë. Në vend se të formohet Qeveria nga i gjithë spektri politik dhe ai ushtarak, pasi që amerikanët njohën faktorin e UÇK-së si forcë serioze, pa të cilën nuk mund të bisedohet për çështje të Kosovës, bisedimet edhe pse zgjatën më tepër se një muaj përfunduan pa sukses. Fatëkeqësisht subjektet politike dhe shtetërore të Kosovës, ende po e luajnë lojën e djallit të mallkuar "dikush thumbit dikush patkonit" duke bërë luftë për pushtet dhe pozita udhëheqëse, pa e krijuar shtetin. Ata po e fajësojnë njëri-tjetrin për fajet e bëra ndaj çështjes së Kosovës, dhe po i thellojnë përçarjet në ekstremitetet. Opinioni ynë, miqtë dhe dashamirët e kombit tonë, kanë pritur që sëpaku, pas fushatës së Ushtrisë serbe kundër

UÇK-së dhe masakrave të bëra ndaj popullsisë së Drenicës dhe Dukagjinit, udhëheqja shtetërore dhe partiake e Kosovës do të vetëdijësohet për dëmet që ajo ia solli popullsisë së Kosovës, UÇK-së dhe çështjes sonë kombëtare, që s'i dëgjuan kërkesat e miqve, dashamirëve, diplomatëve të SHBA-ve, dhe opinionit tonë për të dalë me një zë para faktorit ndërkombëtar dhe atij serb për çështjen e Kosovës. Ata duhet ta dijnë se ndajnë bashkëfajësinë me çetnikët e Beogradit, sepse sjellja e tyre me papërgjegjësi ndaj kërkesave të faktorit ndërkombëtarë për ta institucionalizuar jetën politike të Kosovës, ua mundësuan çetnikve të Beogradit të marrin dritën e gjelbërt nga faktori ndërkombëtar për fushatën e fundit kundër UÇK-së dhe popullsisë së paarmatosur.

Duhet ta kenë të qartë udhëheqja e Kosovës se lufta e tyre për pushtet nuk do t'u sjellë atyre koltuqet e dëshëruara të pushtetit, as Kosovës çlirimin nga kthetrat serbe, dhe as lirinë shqiptarëve të Kosovës. Veprimet e tilla me siguri do t'i sjellin kob, mjerim, vaj dhe varre Kosovës, ndërsa atyre vetëm turpin dhe mallkimin.

Si nuk muar mësim klasa politike e Kosovës se në çfarë gjendjeje e prunë dhe si e katandisën Shqipërinë karrieristët e sëmurë për pushtet dhe stalinistët e përбетuar që e muarën pushtetin me rebelim e dhunë. A thua i duhet Kosovës një "revolucion" i tillë? Kush ia dha për detyrë Qosjes të bëjë një përçarje kaq të shëmtuar të subjekteve politike të Kosovës? Është vallë në pyetje karrierizmi i tij për privilegje dhe pushtet, apo është në pyetje kryerja e detyrës që ia ka caktuar Fatos Nano? Si po shihet zotëri Qosja ka vendosur t'ia sjellë Kosovës një "revolucion"- variant të ngjashëm me atë të "revolucionit të vonuar demokratik të Shqipërisë".

Ngjashmëria e kacafytjeve për pushtet, që u zhvillua në Shqipëri në pranverën e vitit të shkuar në mes forcave që e kishin pushtetin dhe forcave opozitare, dhe luftës për pushtet që po bëhet sot në Kosovë në mes subjekteve politike të përfshira në Parlamentin e Kosovës, dhe bllokut opozitar të Rexhep Qosjes, japin të kuptohet se të njëjtin skenar që e përdorën social-komunistët e Shqipërisë, të njëjtin skenar po e përdorin enveristët e Kosovës me në krye Qosjen. Për fat të mirë UÇK-ja është deklaruar se nuk përkrah këto përçarje dhe ka kërkuar nga subjektet politik që të mos krijojnë aleanca dhe grupime partish, por sëbashku t'i krijojnë institucionet shtetërore.

Fatkeqësisht, Qosja e Hyseni me kompani, e kanë bërë veshin shurdhër ndaj këtyre kërkesave shumë me vend. A thua nuk e ka të qartë Qosja me piunët e tij se pavarësia e Kosovës nuk mund të arrihet pa formimin e subjekteve shtetërore, pa pasur përkrahjen e një fuqie të madhe botërore, dhe pa bashkimin e të gjitha forcave njerëzore, intelektuale dhe financiare të popullsisë shqiptare të Kosovës dhe ndihmës së pakursyer të çdo shqiptari kudo që gjendet në globin tokësor, në të mirë të çështjes sonë kombëtare, sepse kemi të bëjmë me një armik të pashpirt dhe barbar, që ka një përkrahje të fuqishme nga "majka Rusia" dhe aleatë e miq të shumtë e të fuqishëm. Kemi të bëjmë me një armik, që në përpikëri po i realizon qëllimet e tij në këto dhjetë vitet e fundit, duke e bërë spastrimin etnik të Kosovës me mjete dhe mënyra të llojllojshme.

Po qe se udhëheqja e Kosovës vazhdon edhe më tutje të veprojë në këtë mënyrë, duke i ndarë forcat politike të Kosovës në dy taborre kundërshtarë, zgjidhja e çështjes së Kosovës do të zhagitet tamam siç i pëlqen Serbisë dhe aleatëve të saj. Lumi i shpërnguljeve për në Evropë dhe kontinente tjera nuk do të ndalet. Kosova do të mbetet pa rininë e saj vitale. UÇK-ja nuk do të ketë mundësi të forcohet dhe të modernizohet po qe se ajo nuk institucionalizohet dhe depolitizohet për t'u bërë ushtri e rregullt e shtetit të Kosovës, e jo siç po kërkojnë disa të mbetet edhe më tutje krah politik i partive apo klaneve të ndryshme.

Duhet ta ketë të qartë Qosja me kompani se, me mosnjohjen e institucioneve të Republikës së Kosovës të dala nga zgjedhjet e vitit të kaluar, si dhe me blokimin e përpjekjeve për ta formuar Qeverinë e Kosovës, po i bëjnë përçarjet më të mëdha ndërshqiptare dhe ndërnjerëzore dhe po i sjellin dëme të mëdha çështjes sonë kombëtare. Po ashtu kërkesa e Qosjes, Demaçit, Hysenit e ca forcave tjera për formimin e një Asambleje me metoda komuniste, duke injoruar institucionet e formuara shtetërore, nuk do ta kishte krebilitetin më të fortë se organet shtetërore të formuara nga zgjedhjet e marsit të vitit të kaluar në asnjë mënyrë, por do t'i zhvlersonte të gjitha institucionet shtetërore, përfshirë këtu edhe Referendumin dhe shpalljen e Kosovës Republikë. Mosformimi i një Qeverie të përbashkët në afatin sa më të shkurtër nga spektri i gjerë politik i Kosovës, do të ketë pasoja tepër të rënda për çështjet madhore kombëtare, kurse përgjegjësinë për to do ta mbajnë ata që po pengojnë formimin e saj me kryepërçarësin dhe kryekallauzin e të

gjitha mosmarrëveshjeve, ndarjeve, ngatërresave dhe përçarjeve  
ndërshqiptare dhe ndërnjerëzore të klasës politike të Kosovës në krye, pra  
Rexhep Qosjen.

*Botuar në "Bota sot" më 24 nëntor 1998 dhe në "Rimëkëmbja" dhjetor  
1998*

# ME MBROJTJEN E GAZETËS KOMBËTARE "BOTA SOT" MBROHET FJALA E LIRË, MBROHET E VËRTETA, MBROHET DREJTËSIA DHE MBROHET SHQIPTARIA

Plaçkitja e gazetës kombëtare "Bota sot" në disa pika të shitjes dhe pastaj mbyllja e shtypshkronjës që e bënte shtypjen e saj në Maqedoni është një akt i shëmtuar, është një vepër e ligë, është një komplot kundër gazetës kombëtare "Bota sot" që me përkushtim po e mbron fjalën e lirë, të vërtetën, drejtësinë dhe shqiptarinë. Sulmi kundër gazetës që po e ringjall nacionalizmin shqiptar, të cilin e dënuan me vdekje për gjysmë shekulli komunistët e Shqipërisë nuk është befasi dhe as e papritur, pasi që është vazhdim i skenarëve dhe kompleteve të shumta kundër kombit shqiptar të hartuara nga armiqtë tanë shekullorë e të vëna në veprim nga kryekuqaloshët shqiptarë të Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit, të cilët për ta marrë pushtetin mbi shqiptarë u bënë vasalë dhe spiunë të grekut, rusit dhe shkaut. A nuk ishin kryekuqaloshët shqiptarë ata që me ndihmën e grekut dhe shkaut para tri vitesh e kallën Shqipërinë për ta marrë pushtetin dhe për ta rrëzuar demokracinë?! A nuk e bënë të njëjtën punë edhe kryekuqaloshët e Prishtinës të cilët bënë shumë komplete kundër UÇK-së duke mos lejuar bashkimin e faktorit ushtarak dhe politik të Republikës së Kosovës, dhe sot pas çlirimit të saj, po i vazhdojnë të njëjtat ligësi, edhe pse me plotë gojën po flasin për "demokraci", "bashkëpunim", "tolerancë", besa në tubime përkujtimore për dëshmorët po flasin edhe për "Pavarësinë e Kosovës"?! Po kryekuqaloshët e Shkupit Arbër Xhaferi dhe Menduh Thaçi me kompani, përpos kolltuqeve që i nxorrën për vete dhe për të afërmit e tyre duke u shndërruar në vasalë të armiqve tanë, çfarë të mire i sollën popullit të gjorë nga ato që ia premtuan?!

Komploti kundër gazetës kombëtare "Bota sot" duhet t'i mobilizojë dhe të mos i lejë të qetë lexuesit e saj, intelektualët e mirëfilltë dhe veprimtarët atdhetarë në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe në diasporë për ta mbrojtur gazetën e tyre që, me të gjitha forcat e saj, po e mbron çështjen shqiptare dhe po i lufton me sukses armiqtë tanë shekullorë dhe vasalët e tyre, që i gjetën me bollëk nga radhët e kuqaloshëve shqiptarë, nga radhët e karreristëve të sëmurë për pushtet

dhe nga radhët e partiakëve të shtrirë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe në diasporë.

Është më se e domosdoshme që, sa më parë, të bëjmë presion të fuqishëm në organet e pushtetit civil ndërkombëtar të Kosovës duke i dërguar nga një letër zotëri Kushnerit për të kërkuar prej tij që t'ia mundësojë Redaksisë së Bota sot ta bëjnë shtypjen e Gazetës në Prishtinë për lexuesit e Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare. T'u dërgohen letra edhe Qendrave të vendosjes ndërkombëtare duke kërkuar përkrahje në mbrojtje të Botës sot dhe të çështjes shqiptare. T'u dërgohen letra edhe burrave të mëdhenj të shteteve që vendosën të intervenojë NATO-ja për ta shpëtuar Kosovën nga kthetrrat serbe, e popullit të shumëvuahtur për t'ia hjekur nga qafa robërinë e egër të shkaut. Të kërkojmë përkrahje edhe më tutje jo vetëm për mbrojtjen e gazetës tonë kombëtare Bota sot por edhe mbrojtjen e kombit tonë nga Ujqit e uritur të Ballkanit dhe mbrojtje nga Ariu i Zi i Karpateve të Rusisë, që janë hasëm të shqiptarëve dhe të gjithë njerëzimit.

Këta armiq të kombit shqiptar po përdorin në mënyrë djallëzore shumë mjete dhe forma për t'i bindur Qendrat e vendosjes ndërkombëtare se "shqiptarët nuk janë popull shtetformues" e përralla tjera të këtij lloji, duke i futur në lojrat e tyre të ndyra kryekuqaloshët dhe sorrosët shqiptarë, që po ju premtojnë se do t'i mbajnë në pushtet në Shqipëri, Kosovë dhe në Maqedoni, me kusht që t'i kryejnë urdhërat dhe detyrat e tyre pa kundërshtim dhe me përpikëri. Për kend ende nuk është e qartë se me urdhërat e armiqve tanë kryekuqaloshët shqiptarë e bënë Shqipërinë koloni të grekut dhe utrinë të mafias ndërkombëtare, që po bëjnë krime të llojllojshme: politike, ekonomike dhe kulturore ndaj çdo gjëje të vlefshme shqiptare?! Kush nuk e ka të qartë që këto forca të errëta të njerëzimit, këta djaj të mallkuar, këta internacionalistë proletarë të pa fe, dhe të pa atdhe, pasi e shtruan për toke Shqipërinë ia mësyen Kosovës për t'ia bërë edhe më zi, pasi që, edhe pse u çlirua nga NATO-ja dhe luftëtarët trima të UÇK-së, qytetarët e saj ende nuk po e gëzojnë lirinë. Vetëm atëherë kur shqiptarët në Atdheun e tyre janë të lirë t'i shprehin mendimet e tyre lirisht pa pasur frikë se për to do të pësojnë, siç e patën pësuar gjatë robërisë së shkaut; vetëm atëherë kur shqiptarët do të qarkullojnë dhe do të punojnë në gjithë hapsirën e tyre etnike pa frikë se do të rrëmbehën, do të dhunohen apo edhe do të vriten nga maskarenjtë me maska, që po i kryejnë urdhërat e kryemaskarenjve pa maska, të cilat

ua grisi " revolucioni i vonuar demokratik " i Qosjes, mund të thuhet se shqiptarët e kanë fituar lirinë. Nuk ka rëndësi se çfarë kombësie kanë kriminelët që sot veprojnë në hapësirën etnike shqiptare. Ata janë të njëjtë. Bile kriminelët shqiptarë janë shumëfish më kriminelë se kriminelët serbë, se ata- me vetëdije por edhe pa vetëdije- po i kryejnë urdhërat e patronëve të tyre që gjenden në Athinë, Moskë, Beograd dhe Tiranë, të cilët kanë për qëllim që shqiptarët të mbesin të shtrirë për toke dhe të mos ngriten kurrë në këmbë për të ecur sh lirë dhe drejt në horizontet e përparimit, të dijes, prosperitetit dhe begatisë, siç i ka hije racës njerëzore, që i Madhi Zot e bëri zëvendës të Tij në tokë.

Kaosi politik, plaçkitjet, dhunimet, rrëmbimet dhe vrasjet e shqiptarëve me autoritet, dhe atdhetarëve demokratë, si dhe vrasjet që po i bëjnë paramilitarët serbë në Kosovë duke vrarë shkina plaka dhe shkije pleq apo edhe shkiqë që nuk kanë bërë krime ndaj shqiptarve, bëhen për të njëjtin qëllim, që Kosova të mos arrijë pavarësinë e merituar, që munda dhe gjaku i bijve më të mirë të kombit të cilët ranë në fushën e nderit apo që u masakruan nga shkiqet të shkojnë huq, siç shkuan shumë herë më parë. Këto urdhëra për të bërë krime jepen në Beograd, Athinë dhe Tiranë, e shumë të gjorë "shqiptarë" që e ngrehin gishtin e krimit nuk janë të vetëdijshëm se urdhërat e kujt i kryejnë. Ata të gjorë, nuk e dinë se strategët dhe urdhëruesit e krimeve, që ata i bëjnë, kryhen edhe për ta zhvlerësuar punën e madhe që bëri NATO-ja dhe burrat e mdhenj të botës për kombin tonë.

Dërgimi i një letre apo disa letrave nga lexuesit e rregullt të Bota sot, nga veprimtarët atdhetarë dhe intelektualët e mirëfilltë në qendrat e vendosjes ndërkombëtare dhe zotëri Kushneri do të kenë efektin e duhur tek faktorët e lartëpërmendur, por është edhe më e rëndësishme që forcat e shëndosha kombëtare do të fillojnë të organizohen konkretisht. Sot, duke mbrojtur gazetën kombëtare Bota sot jo vetëm me fjalë, por me punë, shqiptarët do të shohin nevojën e organizimit për ta mbrojtur Shqiptarinë, atdheun e tyre, jo vetëm verbalisht por me punë konkrete, duke ua pamundësuar kuqaloshëve dhe sorrosëve shqiptarë, që edhe më tutje të punojnë për grekun, rusin dhe shkaun. Vetëm atëherë kur dimë të organizohemi në baza kombëtare, vetëm atëherë kur me organizimin tonë të shëndoshë kombëtare jemi në gjendje t'i pengojmë keqbërësit e ndryshëm, (që nuk kanë vetëdije njerëzore dhe kombëtare) për të mos bërë vepra kriminele, që kryespiunët

dhe kryekuqaloshët i kanë bërë argatë, me një pagesë të vogël, dhe t'i vemë para drejtësisë shqiptare patronët e argatëve të mjerë, do të jemi të sigurtë se jemi në rrugë të mirë, që aspiratat e popullit dhe amanetin e dëshmorëve të kombit do ta çojmë në vend, duke e bërë Kosovën Shtet të pavarur dhe pastaj me zgjuarsi dhe me punë të mbarë, hap pas hapi, dhe me ndihmën e aleatëve tanë të natyrshëm, SHBA, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Turqisë, dhe aleatëve tjerë që do t'i bëjmë duke i bindur se serbi, greku dhe rusi nuk janë vetëm armiq të tanë, por janë edhe armiq të Francës, Italisë, shteteve Skandinave, shteteve të Lindjes së Afërt dhe të Lindjes së Largët, janë armiq të shteteve muslimane, janë armiq të egër të demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë, janë armiq të përbetuar të Zotit dhe gjithë njerëzimit, atëherë ata do të bëhën aleatët tanë dhe do të na përkrahin për ta zënë vendin që e meritojmë në qendrat e vendosjes ndërkombëtare, ndërsa populli ynë do të jetojë i lirë, duke ndërtuar ardhëmërinë e tij të shkëlqyer në trojet më të pasura dhe më të bukura të Evropës, që i Madhi Zot ia dhuroi për t'i punuar dhe për t'i gëzuar brez pas brezi deri sa kjo botë të ekzistojë.

*Botuar: "Bota sot" më 4 korrik 2000*



## PAS NGJARJES SË STRELLCIT RAMUSH HARADINAJ DUHET TA THOTË TË VËRTETËN EDHE PSE ËSHTË E HIDHUR

Me kthimin e Ramush Haradinajt në Prishtinë nga Spitali i Ushtrisë Amerikane që ia mjekoi plagët e marra para pragut të derës së shtëpisë së Ramë Musajt në Strelle, përfundoi akti i dytë i dramës tragjike shqiptare, duke qitur në shesh edhe për të verbërit të vërtetën e hidhur se lufta e fundit serbo-shqiptare ka lënë pasoja tepër të rënda tek shqiptarët, çka duhet trajtuar sa më parë me zgjuarsiri dhe drejtësi, po qe se ia duam të mirën pasardhësve tanë, po qe se e duam Pavarësinë e Kosovës, po qe se duam zgjidhjen drejt të çështjes madhore shqiptare. Akti i parë i dramës tragjike shqiptare filloi të luhet me daljen e UÇK-së në skenën politike, ku bajraktarët e LPK-së dhe të LBDK-së i përdorën të gjitha mjetet komplotiste për ta përvetësuar dhe privatizuar atë për qëllimet e tyre karrieriste.

Siç dihet, këto forca të djallit të mallkuar e prishën marrveshjen e arritur për bashkimin e UÇK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të arritur në maj të 1998 në mes Adem Demaçit dhe Ahmet Krasniqit, dhe kështu u krijuan dy krahë të UÇK-së. Njëri që ishte nën udhëheqjen e Ahmet Krasniqit dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, që donte krijimin e një ushtrie kombëtare të departizuar, të institucionalizuar, të profesionalizuar dhe të komanduar sipas hierarkisë ushtarake bashkarisht nga komandantët e parë të UÇK-së dhe ushtarakët madhorë që i kishin kryer akademitë ushtarake, dhe krahu tjetër, që udhëhiqej nga Xhavit Haliti, Rexhep Qosja, Fatos Nanosi, Hydajet Hyseni, Bardhyl Mahmuti, Hashim Thaçi dhe Ibrahim Kelmendi me Kompani, që donin të bëhet UÇK-ja ushtri e LPK-së dhe LBDK-së, qëllimi i të cilëve ishte marrja e pushtetit mbi shqiptarët e Kosovës pas përfundimit të luftës. Kjo politikë antikombëtare e kryekuqaloshëve shqiptarë solli likuidimin fizik të shumë luftëtarëve dhe veprimtarëve, që kundërshtuan politikën e tyre destruktive dhe antikombëtare, ku në mesin e të zhdukurëve janë edhe katër ushtarë të Brigadës "Mërgimi" të Kolonel Tahir Zemës, të cilët u kidnapuan nga ushtarët e besueshëm të Ramush Haradinajt, në mesin e të cilëve ishte edhe Sinan Musaj nga Strellci. Me çlirimin e Kosovës shumë familje kërkojnë shpjegim nga "komandantët" e vetëshpallur të UÇK-së

për t'i zbardhur rastet e zhdukjeve të bijve të tyre, që ishin rrëmbyer nga "Policia sekrete" e UÇK-së. Këtë gjë e bëri me të drejtë edhe kryefamiljari Ramë Musaj nga Strellci duke kërkuar nga Ramush Haradinaj shpjegime dhe informata të hollësishme për rastin e rrëmbimit dhe zhdukjes pa shej të djalit të tij, Sinanit. Familja Haradinaj, në vend që t'i përgjigjet sipas zakoneve shqiptare familjes Musaj, zgjodhën mënyrën më të keqe duke iu mos u përgjegjur fare kërkesave legjitime të saj. Çka është më e keqja, vëllezërit Haradinaj organizohen për ta zgjidhur problemin me familjen Musaj në mënyrën e kaubojve të perëndimit të egër, dhe më 7 korrik të këtij viti- me një numër të madh njerëzish të armatosur, pas mesit të natës- sulmojnë familjen e Ramë Musajt. Ndihma e të Madhit Zot ishte në anën e familjes Musaj, pasi që sulmuesit detyrohen të ikin kah kanë ardhur, të marruar dhe të përgjakur, pa e realizuar planin e tyre mafioz dhe të shëmtuar.

Për dy javë sa ishte Ramush Haradinaj në Spital u pa mjerimi intelektual dhe shpirtëror i shumë "intelektualëve", "politikanëve" dhe "gazetarëve" që edhe aktin e shëmtuar të vëllezërve Haradinaj e arsyetonin duke e fajësuar familjen Musaj për të vetmen arsye se u detyrua ta mbronte integritetin e familjes dhe integritetin e pragut të shtëpisë. Arsyetimet e vëllezërve Haradinaj se kanë shkuar në Strellc për "bisedime me familjen Musaj", nuk pijnë ujë fare. Për çfarë "bisedimesh" mund të bëhet fjalë kur dy palët nuk ishin të barabarta në asnjë mënyrë. Vëllezërit Haradinaj kishin me vete jo pleqnarë apo njerëz autoritativë, por kishin me vete argatët e tyre të mjerë, të armatosur dhe të gatshëm për të rrëmbyer e për të vrarë njerëz, që asnjë të keqe nuk i kishin bërë askujt, ndërsa kryefamiljari Ramë Musaj ishte vetëm me anëtarët e familjes së tij të ngusht që fatmirësisht i kishte pasur ca bomba dore sa për t'ia shpëtuar nderin e familjes. Po sikur vëllezërit Haradinaj të ishin ftuar në bisedime nga familja Musaj, me siguri zhvillimi i ngjarjeve kishte për të shkuar krejt ndryshe, pasi që dihet mirë se si zhvillohën bisedimet në mes dy familjeve shqiptare në ngatërresa apo të hasmuara kur nuk funksionon shteti dhe as ligji. Prandaj, variantin e mbrojtjes së vëllezërve Haradinaj, nuk e beson njeri i gjallë i nënqiellit shqiptar, e lere më opinionin i huaj. Ngjarja e Strellcit përfundoi siç është më së miri. Familja e Ramë Musajt u mbrojt si i ka hije shqiptarit, që dëshiron ta ruajë lirinë dhe nderin e tij, por që e respekton lirinë dhe nderin e tjetrit, që nuk i hyp kujt në qafë, por as nuk lejon t'i hypi njeri i gjallë në qafë. Vëllezërit Haradinaj dhe disa

nga argatët e tyre u përgjakën dhe u bë shumë mirë, që e muarën denimin e merituar. Më së keqi e pësuan fëmijët që i zgjoi nga gjumi krisma e kallashëve të vëllezërve Haradinaj dhe argatëve të tyre dhe gratë e fisit, që u trishtuan për fatin e fëmijëve të tyre të paafte për luftë. Plagët fizike të Ramush dhe Daut Haradinajt u shëruan shpejt. Po vallë kur do të shërohën plagët shpirtërore të familjes Musaj që u krijuan para një viti kur ia rrëmbyen njeriun e tyre të dashur argatët e vëllezërve Haradinaj dhe u ripërtërinë e u rihapën përsëri pas një viti kur u sulmua në pikë të natës familja e Ramë Musajt!

Fatkeqësisht "Ngjarja e Strellcit" nuk u trajtua siç duhej nga mjetet e informimit publik, pasi që asaj i dhanë karakter të njëanshëm, karakterin e një ngatërrese familjare. Po e vërteta u pa se ishte krejt tjetërfare. Familja Musaj e Strellcit dhe familja Haradinaj e Glogjanit nuk kishin pasur kurrë ngatërresa familjare. Familja Musaj e Strellcit kërkon shpjegim nga Ramush Haradinaj për birin e tij të rrëmbyer dhe të zhdukur para një viti nga ushtarët e këtij? Në këtë rast Ramush Haradinaj është i detyruar ta zbardhi rastin e kidnapimit të katër ushtarëve të Tahir Zemës në mesin e të cilëve ishte edhe Sinani, i biri i Ramë Musajt nga Strellci. Pra, nga Ramushi lypet të tregojë të vërteten e plotë për rastin e ushtarëve të zhdukur.

Po qe se Ramush Haradinaj mendon se me një kërkim faljeje publike familjes Musaj, duke ia ngarkuar asaj edhe gjysmën e fajeve të tij për sulmin e 7 korrikut, do ta mbylli dosjen " Strellci " gabohet rëndë. Po qe se edhe më tutje Ramush Haradinaj e mbyll gojën për të mos treguar të vërtetën e plotë për rastin e ushtarëve të rrëmbyer e të zhdukur, kjo do të thotë se Ramushi është fajtor dhe përgjegjës për zhdukjen e tyre. Atëherë familja Haradinaj i ka në qafë katër gjaqe se edhe ushtarët tjerë nuk ishin kopila por kanë lënë dikend pas vetes. Po vallë, ishte vetëm ky rast i zhdukjes fizike të ushtarëve dhe veprimtarëve gjatë luftës, para luftës dhe pas luftës? Ngjarja e Strellcit e bëri aktuale emërtimin e njerëzve që janë përgjegjës për përpilimin e listave dhe dhënien e urdhërit për vrasje politike. Me ngjarjen e Strellcit duhet të përfundojë akti i dytë i dramës tragjike të luajtur nga kryekuqaloshët shqiptarë, që filloi me çlirimin e Kosovës, kur ata i futën në veprim maskat për t'i vrarë kundërshtarët e tyre politikë që kishin mbetur pa u zhdukur gjatë luftës, por edhe për të krijuar psikozën e frikës tek shqiptarët, që të mos flasin për të ligat dhe krimet e tyre, dhe kështu t'u lihen duart e lira të bëjnë çka të donë jo

vetëm me pasurinë shoqërore të Kosovës por edhe me jetën e qytetarëve të saj. Me përfundimin e aktit të dytë të dramës tragjike duhet të fillojë akti i tretë i zbërthimit në detaje të aktit të parë dhe aktit të dytë të dramës tragjike shqiptare para organeve të drejtësisë. Organet e administratës ndërkombëtare të vendosura në Kosovë dhe Gjygi i Hagës kanë mjaft fakte dhe prova për t'i burgosur dhe për t'i qitur para drejtësisë shumë kriminelë shqiptarë, që vranë shqiptarë vetëm pse këta shqiptarë i njihnin legjitime institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, që i përkisnin krahut institucional të UÇK-së dhe që kishin autoritet në rrethin ku jetonin e punonin për veprimtarinë e tyre kombëtare.

Por, e mira e së mirës është për Ramush Haradinajn të tregojë jo vetën për rastin e katër ushtarëve të rrëmbyer të UÇK-së po edhe për likuidimet që i ka bërë kriminelit me damkë njëfarë Idriz Balaj i njohur me pseodenimin "Togeri " që ishte dora e djathtë e tij. Po qe se Ramush Haradinaj dhe "komandantët" e "udhëheqësit" e vetëshpallur të UÇK-së, që ishin nën urdhërin e Nanoisit mendojnë se pozitat dhe gradat që ia dhanë vetes apo që ua dhanë klanet e tyre pas çlirimit të Kosovës do t'u shërbejnë si alibi për shfajësim nga përgjegjësia që kanë për vrasjet politike, gabohen shumë rëndë. Çdo ditë që po kalon, po dalin në shesh fakte të reja që i akuzojnë ata për komplotistë dhe vrasës. Sado që e hidhur është e vërteta, gjithsej është më e mirë se gënjeshtria, se ajo nuk mund të fshihet dhe as të vritet.

Pranimi i fajit dhe pendimi i sinqertë për fajet e bëra do t'ua zbusin zemrat njerëzve që ua kanë tharë zemrën dhe i kanë veshur në të zeza. Populli shqiptar është një popull zemërgjërë dhe zemërbardhë. Veçmas u tregua se është popull zemërmadh dhe me vetëdije të lartë kombëtare në të gjitha periudhat historike që bëheshin përgatitjet për luftë çlirimtare duke i falur ngatërresat dhe gjaqet. Këtë gjë e bëri edhe në fillim të viteve '90-ta kur fali më tepër se njëmijë gjaqe në emër të Zotit për Kosovën, se ishte i bindur që ka ardhur koha për t'u bërë gati për t'i prerë prangat e robërisë shekullore. Edhe tash populli ynë do të vepronte në të njëjtën mënyrë, po qe se Rexhep Qosja, Hydajet Hyseni, Xhavit Haliti, Azem Syla, Bardhyl Mahmuti, Ibrahim Kelmendi, Ramush Haradinaj, Hashim Thaçi, Salih Veseli, Bislim Zurapi, Jakup Krasniqi, Nasim Haradinaj, Naim Maloku, e të tjerë, do të pranonin fajet dhe do të pendoheshin sinqerisht për fajet e tyre të rënda, që i bënë me vetëdije dhe pa vetëdije, me kusht që të mos i pengojnë proceset e Pavarësisë së Kosovës, dhe të

mos i pengojnë njerëzit që dijnë dhe dëshirojnë të punojnë për realizimin e interesave madhore kombëtare, me zgjuarësi dhe trimëri, duke i përdorur me përpikëri mjetet e demokracisë së Evropës Perëndimore.

*Shënim i autorit: Është shkruar më, 21.7.2000 në La Chaux-de-Fonds. Ky shkrim i është dërguar menjëherë Redaksisë së "Bota sot" për botim, por, për arsye të asaj kohe, nuk është botuar.*

## KONFERENCA E RAMBUJËS PËRFUNDOI ASHTU SIÇ DËSHËROI KASAPI I BALLKANIT

Opinionin ynë dhe ai i huaj për sa zgjati Konferenca e Rambujës i kishte drejtuar sytë dhe mendjen në atë kështjellë të lashtë historike, duke shpresuar se më në fund do të dënohet, siç e meriton kasapi i Ballkanit për masakrimin, shfarosjen dhe spastrimin etnik të popullit shqiptar të Kosovës, që ka për synim ta bëjë Kosovën tokë serbe siç e bëri krahinën shqiptare Toplicën tokë serbe para 120 vitesh.

Populli ynë gjatë këtij dhjetëvjeçari të fundit të shekullit 20-të përjetoi të papritura dhe anomali të shumta nga prijësit e tij, por ajo që ndodhi më 23 shkurt të këtij viti në Rambujë, arrinë kulmin të gjitha anomalive të mëparshme. Si të mos merret për anomali dhe potez politik i papjekur, që delegacioni i Kosovës në momentet vendimtare kur duhej ta nënshkruante Marrëveshjen e Grupit të Kontaktit, të përçahet dhe të kërkojë shtyrjen e bisedimeve, ashtu siç i konvononte më së miri diplomacisë serbo-ruse për të fituar kohë, dhe për t'ia mundur pastaj Moskës dhe Beogradit për të bërë ç' është e mundur për të dështuar kjo Konferencë, për të dështuar diplomacia amerikane dhe Pakti i NAT-os, që ishin zotuar se do t'i godasin objektet ushtarake serbe në Serbi dhe në Kosovë po që se pala shqiptare e nënshkruan ndërsa pala serbe nuk e nënshkruan Marrëveshjen.

Nuk duhet për të shkrirë shumë mend për të kuptuar gabimin e rëndë të delegacionit shqiptar në Rambujë, që refuzoi ta firmosë Marrëveshjen, pasi që, nënshkrimi i saj nga pala shqiptare do ta vënte në sprovë të rëndë diplomacinë evro-amerikane dhe paktin e NAT-s, për kërcnimet që ia bënë regjimit komunist të Beogradit, ku me siguri pakti i NAT-s, dhe diplomacia amerikane nuk do ta humbnin autoritetin e tyre dhe nuk do të kurseheshin për ta shkatërruar forcën ushtarake të një regjimi kriminal, që aq shumë u solli vuajtje dhe mjerin fqinjëve të saj: kroatëve, boshnjakëve dhe së fundi edhe shqiptarve.

Nuk mund të mirret i arësyeshem arësyetimi i zotri Bukoshit se delegacioni i Kosovës ka bërë kërkesë për shtyrjen e bisedimeve në mes Beogradit dhe Prishtinës për dy javë për arsye të "konsultimeve me Institucionet shtetërore të Kosovës", apo arësyetimi i zotëri Thaçit se duhet "konsultuar me komandantët e UÇK-së dhe popullin" sepse

delegacioni ishte kompetent për nënshkrimin e Marrëveshjes, pasi që përfaqësonte forcat kryesore politike dhe ushtarake të Kosovës. Shkakun e shtyrjes së bisedimeve duhet kërkuar në ca individ, që duan ta përgadisnin terrenin, për marrjen e pushtetit nga faktori ndërkombëtar në momentin e duhur, jo me mjete të votës së popullit, por me manipulime dhe mjete jodemokratike.

Të mos nënshkruhet një Marrëveshje, që faktikisht Serbisë ia heq duart nga Kosova pothuajse plotësisht në periudhën kalimtare tre vjeçare, dhe që garanton se: "Tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, do të thirret një takim ndërkombëtar për të përcaktuar një mekanizëm për zgjedhjen përfundimtare për Kosovën, në bazë të vullnetit të shprehur të popullit..." që do të ishte garant Pakti i NAT-os, dhe SHBA-të, për t'i hudhur në ujë të gjitha planet djallëzore të Serbisë, për pastrimin etnik të Kosovës dhe ndarjen dhe coptimin e saj, është e pa kuptueshme. Kështu do t'i mundësohej Kosovës t'i krijojë Institucionet shtetërore legjitime të pavarura nga Serbia, duke forcuar gjendjen matrxiale të shqiptarve dhe forcuar qenjen së tyre kombëtare me kthimin e gjysmë milioni shqiptarësh që sot gjenden në Evropën Perendimore, dhe shumë gjëra tjera që kanë rëndësi të madhe kombëtare. Shtrohet pyetja se kujt do t'i shkonte për shtati, Kosovës apo Serbisë për realizimin e aspiratave kombëtare pas një periudhe kalimtare trevjeçare, kur dihet se Kosova do ta kishte: Presidentin, Qeverinë, Parlamentin, Gjygin, dhe Policin e saj, që do të ishin plotësisht të pavarura nga Serbia. Ndërsa Pakti i NATO-s do të ishte faktor i stabilitetit politik dhe ekonomik i Kosovës, jo vetëm për tri vjet sa është planifikuar, por deri sa të zgjedhet përfundimisht çështja e Kosovës në bazë "të vullnetit të shprehur të popullit".

Me mos nënshkrimin e Marrëveshjes nga ana e përfaqësuesve të subjekteve shqiptare në Rambujë, shqiptarve të Kosovës, në vend se t'i shkurtohen vuajtjet e sakrificat, asaj tani do t'i shumohen, shtohen, por edhe është vu në rrezik tërësia toksore e Kosovës, është vu në rrezik të dështoj Marrëveshja e Grupit të Kontaktit, është rrezikuar përkujdesi i diplomacisë amerikane për zgjedhjen e drejt të çështjes së Kosovës. Përgjegjësinë për dështimin e saj duhet kërkuar tek personat që e penguan nënshkrimin e saj në afatin e përcaktuar nga çendrat e vendosjes ndërkombëtare. Pra, përgjegjës do të jenë ata që nuk kuptuan apo nuk deshën të kuptojnë për strategjinë dhe taktikën amerikane, për t'i dhënë

dënimin e merituar piunit rus të Ballkanit, e për ta ndihmuar popullin shqiptar të Kosovës për ta hjekur nga qafa zgjedhen serbe. Deri sot nuk njihet një rast që SHBA-të të mos e realizojnë premtimin që ua kanë dhënë aleatëve të tyre, prandaj edhe delegacioni ynë është dasht të tregoi më tepër mirëkuptim, rrespekt dhe besim ndaj përfaqësuesve të SHBA-ve, që ishin dhe janë aleatë të sinqert të popullit tonë.

*Botuar: "Bota sot" 26.02.1999*



## KRIMINELËT JANË TË HUMBUR, PËRFUNDIM I KEQ PO I PRET

Armiaqtë e kombit tonë, edhe pse janë të vetdijshëm se koha po punonë për ne, edhe pse po e kuptojnë se faktori shqiptar në Gadishullin Ilirik do të luajë rolin kryesor në një të afërme jo të largët, ata i kanë shumfshuar forcat që të na godasin me të gjitha mjetet që mund t'i vënë në veprim, që sëpaku të na pengojnë, që rruga deri në realizimin e synimeve tona të jetë sa më e gjatë dhe shumë e mundishme.

Fatkeqësisht edhe pas çlirimit të Kosovës çetnikët e Beogradit po i shfrytëzojnë mbeturinat e shoqërisë shqiptare, nanoistët e gjorë, për t'u ndihëmuar në realizimin e skenarit të ndyrë antishqiptarë, për ta bindur botën në kopallat e tyre të vjetra se "shqiptarët janë popull jo shtetfirmues". Siç dihet serbo-grekët dhe aleatët e tyre qysh kur ia vunë flakën Shqipërisë nepërmjetë bajraktarëve të farës ruse dhe kriminelëve të kuq me të ashtuquajturin "revolucion i vonuar demokratik" më 1997, realizuan gjysmën e skenarit dhe e bindën një pjesë të opinionit botëror në shpifjet e tyre se ne shqiptarët "nuk dimë të mbajmë shtet", se ne shqiptarët "jemi destabilizues të Ballkanit" dhe shpifje tjera të ngjajshme. Fatmirësisht pjesa e dytë e skenakit u mbet e pa realizuar, në sajë të ndihmës së të Madhit Zot që i detyroi SHBA-të dhe aleatët e saj, për t'i bënë pluhur dhe hi skenarët antishqiptarë të serbo-ruso-grekëve dhe aleatëve të tyre, kur me forcën e tyre të përbashkët NATO-n na e çliruan Kosovën. Populli ynë me pjekurinë e tij të lartë politike dhe atdhedashurinë e flaktë e habiti botën, kur mbrenda një kohe të shkurtër u kthye në vatrat e shkrumbuara dhe të plaçkitura nga kriminelët serb. Fatmirësisht serbo-ruso-grekët dështuan, por përpjekjet e tyre për realizimin e skenarit të tyre të pa kryer i shumëfshuan, duke i vënë në veprim bishtat e tyre që i kishin lënë të paprekur në subjektet shqiptare, politiko-ushtarake. Veçmas u treguan të suksesshëm dhe të fuqishëm, siq ishin edhe gjatë luftës, bishtat e tyre që i kishin futur në strukturat udhëheqëse të UÇK-së. Mënyra, vendi, dhe koha e formimit të Qeverisë së Thaçit dhe veprimtaria e saj në Kosovën e çliruar, ua hapi rrugën bishtave serb në Kosovë të punojnë pa pengesë në realizimin e skenarit serb për ta bindur botën se "shqiptarët nuk janë të aftë as të bëjnë dhe as të mbajnë shtet". Uzurpimet, kërcnimet dhe vrasjet që i bënë dhe po i

bëjnë pehlivanat e Nanosit dhe argatët e tyre në Kosovën e çliruar, është ndihma dhe përkrahja më e fortë që po i bëhet Beogradit, Moskves dhe Athinës, nga bajraktarët e farës ruse, shqipfolës, që u ëshë bërë ndonjëherë më parë. Pra, ndihma e pehlivanave të Nanosit dhe argatëve të tyre është shumëfish më e madhe se ndihma dhe përkrahja që u është bërë këtyre qendrave antishqiptare nga vetë "babai" i farës ruse Enver Hoxha dhe kukullat serbe që qenë vënë në Kosovë nga Beogradi gjatë sundimit të tyre.

**Kryekriminelët po mendojnë se pasuria e fituar me anë të krimeve politike dhe të krimeve ekonomike do t'i bëjnë të fuqishëm dhe të pa prekshëm, por siç po shihet kanë gabuar rëndë.**

Tentimi i fundit i pehlivanave të Nanaosit për t'i sjallur Kosovës njërën ndër tragjeditë më të rënda pas luftës, që kishin për qëllim vrasjen e kolonel Tahir Zemës, njërit ndër komandantët më të suksesshëm të UÇK-së, tregon se bajraktarët e farës ruse dhe shërbëtorët e tyre, që po luajnë rolin e ushëheqësve të subjekteve politike dhe shtetërore të Kosovës, janë në fazën e fundit të çmendurisë, sepse e kanë të qartë se krimet e tyre që i bënë para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës janë të zbuluara, dhe se nuk do të shkojë shumë larg kur policia do të jetë e detyruar t'i arrestojë për të dhënë llogari për krimet e bëra. Dihet se kriminelët janë pa shpirt dhe pa zemër, por kriminelët e kuq shqiptarë po tregojnë edhe një veti të veçantë. Me siguri, kjo veti e veçantë e tyre, është krijuar nga përdorimi i gjatë i egjërës komuniste, prandaj mënyra se si po i bëjnë krimet po tregohën se janë shumë të lig dhe të marrë. Mjafton të përmendet rasti i fundit, kur planifikuan t'i vrasin me dhjetëra njerëz, gra, fëmijë, qytetarë të pafajshëm, vetëm për të realizuar një vrasje, që bajraktarët e farës ruse dhe shërbëtorët e tyre t'i gëzonin, që në atë krimë kundër njerëzimit të gjente vdekjen Tahir Zemaj, një burrë i fortë i shqiptarisë, që i pari ua dha hakun e merituar hordhive serbe në Logjë e gjetiu.

Kryekriminelët po mendojnë se pasuria e fituar me anë të krimeve politike dhe krimeve ekonomike do t'i bëjë të fuqishëm dhe të paprekshëm, por siç po shifet kanë gabuar rënd. Ishin llumperproletarë dhe ashtu do të mbesin. Pasurinë e vjedhur dhe të uzurpuar do t'ua marrim(nacionalizojmë). Do të mbesin edhe pa pozita udhëheqëse, ashtu

siç mbeti "babai i farës ruse"Qosja. Këtë radhë qytetarët e Republikës së Kosovës në zgjedhjet lokale nuk do të kenë mëshirë ndaj nanoistëve dhe neostalinistëve, që po mundohën për ta destabilizuar Kosovën, që po punojnë për interesa të huaje dhe për interesa personale e klanore, duke i shkelur interesat madhore kombëtare. Por këto mbeturina të shoqërisë shqiptare, prapëseprapë, kanë fat se ne nacionaldemokratët kemi mëshirë. Do t'u sigurojmë mbrojtje sociale. Mos t'i frigohen pleqërisë, nuk do t'i lëmë të lypin rrugëve. Do t'i vëmë në shtëpi të pleqëve, se jemi të sigurtë se as fëmijët dhe as farefisi nuk do të kujdesen për ta kur t'u dalin në shesh të gjitha të ligat që ia bënë Kosovës, kur të dalin në shesh të gjitha krimet dhe të zezat që ua bënë shqiptarëve.

### **Një këshillë për kriminelë që vrasin pas shpine**

Këshilla e fundit për kriminelët : Ju kriminel të vegjël, ju doras të mjerë, ju qytetarë anonim me emra shqiptarë, që ua ka pirë sorra mendtë dhe asgjë nuk po kuptoni se në dorë të kujt kenë rënë. Mos u bëni të marrë, se vrasja dhe krimi në as një mënyrë nuk mund të quhën "vepër patriotike". Vrasja është krim. Ai që vranë njerëz pa hak, ai që vranë njerëz pas shpine, ai që vret njerëz me para, nuk është njeri, ai është më i keq se bisha e e gër, ai është kriminel! Mos harroni se populli na mëson nga përvoja e tij se "gjaku nuk humbet". Pra, një ditë, heret a vonë, do të zbulohën të gjitha vrasjet, do të zbulohen të gjitha krimet! Populli ynë është human dhe zemërgjërë! Ai për hirë të Zotit për ta forcuar Kosovën i fali më tepër se 1000 gjaqe, kur ishte koha t'i bashkojmë forcat, kur erdhi momenti për t'i bashkuar radhët, se donim t'i këpusim prangat e robërisë! Kosova sot është çliruar në saje të mundit të madh të shumë gjeneratave. Por, Kosova sot, e ka edhe një betejë shumë të rëndësishme. Ka mbetur beteja përfundimtare për të realizuar pavarësinë e Kosovës. Dhe pastaj me zgjuarsi dhe me punë të mbarë do t'i realizojmë edhe shumë synime tjera madhore. Ju, kriminel të vegjël, ju doras të mjerë, pendohuni sa më parë për krimet që i bëtë! Juve ju mashtruan kriminelët e mëdhenj, që luajtën rolin e "udhëheqësit ushtarak" apo të "ushëheqësit partiak". Pranimi i fajit para organeve gjyqësore merret si rrethanë lehtësuese, kur ju shqiptohen denimet, por pranimi i fajit edhe me ligjet e Kanunit do të merret si rrethanë lehtësue. Prandaj, sa më parë të paraqiteni në organet e policisë për t'i treguar krimet që i bëtë ju apo të afërmit e tuaj. Merrnie

shembull Daut Haradinajn, i cili vullnetarisht u paraqit në organet e hetusisë për të treguar se si u vranë katër ushtarë të UÇK-së, dhe kush i vrau ata. Po qe se ia doni të mirën Kosovës, po qe se ua doni të mirën fëmijëve tuaj dhe të dashurëve tuaj, lajmërohuni sa më parë në organet hetimore, apo në organet e policisë për ta paraqitur krimin që e bëtë ju, apo shokët tuaj. Populli ynë ka zemër të madhe, ai do t'ua fal fajin, se e din se "shtisi ëshë më fajtor së bërsi" se e di se juve kriminelët e mëdhenjë u kanë mashtruar, përndryshe, po qe se nuk lajmëroheni vetë, por hetimet e policisë do të zbulojnë krimin e juaj, juve nuk do t'u falet kurrën e kurrës faji i krimit. Edhe kur ta kryeni dënimin Kanuni i Lekë Dukagjinit do t'ju dënojë edhe njëherë. Juve dhe familjet e juaja do t'ju leqitim. Edhe kur të vdisni nuk do t'ju lëmë në varreza të qytetarëve. Varri i juaj do të jetë i mallkuar dikund nepër përrpcka dhe moqale.

Po ju kriminel të mëdhenj, çka po pritni. Vranie veten më së miri ju bjen. Për ju nuk ka falje! Ju nuk meritoni mëshirë. Juve ju pretë mallkimi i Zotit dhe i popullit! Ju jeni farë e djallit të mallkuar! Ju jeni zogj shkau! Ju jeni tharmi i të gjitha të ligave që e gjetën popullin tonë! Ju njohim shumë mirë se kush jeni! Me emra dhe mbiemra të plotë ju njohim! Koha e juaj po i afrohet perëndimit! Ju jeni të mbaruar! Ju jeni coftina! Kundërmoni erë coftine, edhe pse vesheni me rrobe të reja, edhe pse veni krovata kuq e zi, edhe pse flisni për patriotizëm, edhe pse me plot gojën folni për pavarësinë e Kosaovës, edhe pse flisni për dëshmorët e kombit, edhe pse flisni për familjet e të masakruarëve dhe invalidët e luftës, ju jeni kryekriminelë! Ju jeni ata që e keni krijuar Qendrën e Krimit në Kosovë, ju jeni ata që e keni krijuar mafinë politike dhe ekonomike në Kosovë! Ju jeni vazalët e Nanosit, ju jeni sëbashku me Nanosin shërbëtorët e Athinës, Beogradit dhe Moskvës! Ju jeni "njerëz" të vdekur për së gjalli!

*Botuar : "Bota sot", më 9 gusht 2002*

## SA ZOTRA KANË SHQIPTARËT?!

Po tu lëshohet një sy revistave dhe gazetave tona do të shohim se fjalët e huaja po zënë me të madhe vendin fjalve tona të bukura. Kjo mund të kuptohet deri dikund, pasi që, si komb dhe si shoqëri gjendemi në një kaos politik dhe organizativ, prandej kjo sëmuarje shoqërore solli përpos krizës politike dhe atë morale dhe kulturore. Me këtë shkrim nuk do të bëhet fjalë për përdorimin e fjalëve të huaja, që i kanë vërshtuar gazetatat dhe revistat tona, por do të bëhet fjalë për përdorimin gabimisht në të shkruar dhe në të folur të fjalës Zoti... në vend të fjalës zotëri... Pra thuhet gabimisht: Zoti Kryetar, Zoti X.. në vend që të thuhet: Zotëri Kryetar, Zotëri X. etj. Dihet se prej fjalës Zot-i rrjedhin shumë fjalë, që kanë marrë kuptim të veçantë psh.: zotëri, i zoti i shtëpisë, e zonja e shtëpisë, njeri i zoti, njeri zotëri, i zoti i fjalës, i zoti pushkës, i zoti i pendes etj. Populli ynë me fjalën Zot-i kupton Krijuesin e vetëm të gjithësisë, qiejve dhe tokës dhe jetes në të. Me fjalën zotëri i drejtohem i një njeriut që nuk e njohim, apo që e njohim, por i drejtohem i në mënyrë zyrtare dhe me nderim. Ndërsa me fjalën i zoti i shtëpisë kuptojmë kryefamiljarin apo përgjegjës të familjes. Të përdoret fjala Zoti në vend të fjalës zotëri, jo që në pikpamje gjuhësore është shkelje e rënd, pasi që po e varfërojmë gjuhën tonë me një fjalë që ajo e ka, por edhe po bëjmë shkelje të rëndë etike dhe morale sepse të Madhin Zot po e fyejmë duke shpikur e shpifur zotëra-njerëz, pra po i shoqërojmë Atij shokë.

Dihet se gjatë sundimit të diktaturave të kuqe, diktatorët e patën mohuar Zotin e vërtetë për ta bërë vetveten e tyre pronarë (zotëri)dhe Zot jo vetëm të pakurrizorve, që e shoqëronin për tua bërë aminin urdhërave të tyre, por me mjete më barbare i detyronin banorët e"torishtës" së tyre t'i konsideronin ata zotëra të vërtetë, por t'i quanin thjeshtë shokë. Dihet se fillozofia sllavo-orthodokse-komuniste përdorin demagogjinë dhe rrenën si mjet manipulimi dhe mashtrimi, prandej edhe për këtë qëllim komunistët shqiptarë e patën zëvendësuar fjalalën zotëri me fjalën shok. Sot, e kundërta e sundimit të diktatorve ateistë, fjala shok-u është hjekur nga përdorimi dhe në vend të saj me të madhe po përdoret gabimisht fjala zoti në vend të fjalës zotëri. Këtë far lloj pështjellimi të fjalve dhe kuptimeve nuk mund ta arësyetoj arsyeja e shëndosh dhe nuk dihet se për çfarë arsyeje u bë dukuri e gjër tek ne shqiptarët. Kjo mund të jetë edhe

një anomali më shumë në mozaikun e anomalive të shumta shqiptare, që u krijuan në dhjetëvjeçarin e fundit të këtij shekulli.

Deri sa redaktorët e gazetave dhe revistave tona nuk kanë mundësi të zgjedhin krizën e thellë politike dhe morale në të cilën e futën kombin tonë karrieristët e sëmuar për pushtet dhe partiakët e shtir, ata kanë mundësinë që sëpaku këtë dukuri të shëmtuar, të zëvendësimit të fjalës zotëri me fjalën Zoti, ta korigjojnë dhe përmirësojnë me anë të lektorëve që i kanë punësuar në redaksitë e tyre. Por, përgjegjësia më e madhe duhet të bie në gazetarët dhe intelektualët të cilët merren me shkrime dhe nuk dijnë, apo nuk don të dijnë se nuk bënë të përzihet dhe të përdoret gabimisht fjala Zoti... në vend të fjalës zotëri...

*Botuar: "Bota sot" më 22 korrik 1999*

## KAPITULLI I DYTË

### II. KOSOVA NË UDHËKRYQIN E SAJ HISTORIK

## KOSOVA NË UDHËKRYQIN E SAJ HISTORIK

Shekulli njëzet i solli kombit tonë tragjedira të mëdha. Kosova me vise ra nën kthetrat serbo-sllave. Çamëria u masakrua dhe u shkombëtarizua në mënyrën më barbare nga grekët gjakatarë në të njëjtën mënyrë si Toplica në shekullin e 19-të. Shqipëria e cunguar nuk u rimëkëmb as deri në ditët e sotit për ta kryer detyrën që i takon ndaj vëllezërve të robëruar. Rezistenca e shqiptarëve të Kosovës në fillim të viteve '90 e kurorëzoi Lëvizjen tonë kombëtare me suksese të pamohueshme. Kosova u shpall Republikë. U miratua Kushtetuta. U kryen me sukses zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare.

Procesi i filluar drejt pavarësisë dhe lirisë zuri në thue menjëherë pas sukseseve fillestare. Lëvizja e shpallur paqësore, në vend që të bëhet aktive- për të mos lënë të qetë në as një moment okupatorin,- ajo kaloi në pasivitet të plotë dhe kështu Serbia i arriti qëllimet e saj të zbrazjes masive të Kosovës dhe serbizimit kulturor të saj. E shkatërroi bazën materiale të shqiptarëve dhe e pacifizoi Kosovën. Ndërsa udhëheqja e Kosovës e vuri në gjumë krenarinë kombëtare të shqiptarëve, etj. Fatmirësisht Lëvizja studentore për rimarrjen e objekteve shkollore dhe dalja në skenë të UÇK-së më 1997 e ndërruan status-quonë në Kosovë. UÇK-ja u bë faktor i rëndësishëm ushtarak dhe politik. Mjerisht klasa politike e Kosovës nuk e kreu detyrën që i takoi për ta ndihmuar dhe për ta institunacializuar UÇK-në, por ata bënë çmos për ta privatizuar dhe për ta bërë atë ushtri partiake apo ushtri të klaneve të ndryshme për interesa të sëmura karrieriste apo përfitime personale.

Masakrat serbe ndaj popullsisë së paarmatosur dhe familjeve të tëra, në vend që të ndikonin tek subjektet shqiptare për t'u bashkuar e për të marrë vendime të përbashkëta për çështjet strategjike, taktike dhe diplomatike të Lëvizjes sonë kombëtare, duke e kombinuar faktorin ushtarak e atë politik për të arritur synimet e çlirimit dhe bashkimit tonë kombëtar, ata s'po e ndalin luftën për pushtet, duke i përdorur të gjitha mjetet e lejuara dhe të palejuara për të zënë pozita sa më të favorshme, që një ditë ta marrin pushtetin pasi Kosova ta fitojë autonominë apo pavarësinë.

"Zotrat-njeri" që i krijuan shqiptarët në dhetëvjeshin e fundit të këtij shekulli, apo edhe më herët, çdo ditë që po kalon, po zhvishen nga



petku i idhujve dhe po e tregojnë vetveten me aftësitë e tyre gjysmake, logjikën e pasistemuar mirë, shpirtvogëlsinë e njerëzve të zakonshëm, me të meta dhe vese të shumta, të sëmurë nga xhelozia, smira, kryeneçësia, mendjemadhësia, lideromania dhe karrierizmi i shëmtuar. Po të mos ishte i vërtetë ky vlerësim, sot realiteti politik në Kosovë do të ishte krejt tjetërfare dhe shumë më i favorshëm për zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare. Republika e Kosovës do të funksiononte me të gjitha institucionet shtetërore- Qeveria, Parlamenti, Ushtria, Diplomacia etj.- dhe do të kryenin detyrat e përcaktuara nga Kushtetuta. Faktorët e jashtëm ndërkombëtarë do të kuptonin se kanë punë me një popull të organizuar në baza institucionale, kanë punë me një popull të disiplinuar, që nuk mund ta ndalë asnjë forcë, sado e madhe qoftë, nga synimet dhe përpjekjet për pavarësi, çlirim dhe bashkim kombëtar.

Kosova sot po përjeton tragjedi të mëdha familjare dhe kombëtare. Ajo po përgjaket e po masakrohet në mënyrën më barbare nga dora katile e shkaut. Qosja, Demaçi Bukoshi, Hyseni etj. Nuk po e ndijnë vajin e fëmijëve të trishtuar nga lufta, të ftohtit dhe urija. Masakrat serbe ndaj popullsisë së paarmatosur nuk po i vetëdijësojnë ata se përçarjet e tyre po i japin forcë dhe fuqi kasapit të Ballkanit. Këta " idhuj " të Kosovës martire nuk po gjejnë kohë të takohen për t'u marrë vesh për çështjet madhore kombëtare. Ata duhet të jenë faktor i bashkimit të të gjitha forcave politike dhe ushtarake të Republikës së Kosovës e jo faktor ndarjesh dhe përçarjesh. Masakrat e Reçakut dhe të Rugovës kursesi nuk është dashur t'i gjejnë të përçarë e të ndarë shqiptarët në dy tabore kundërshtarë. Marrëveshjen që po na e ofron faktori ndërkombëtar, duhet studjuar në shumë aspekte, jo vetëm nga udhëheqja shtetërore dhe ushtarake e Republikës së Kosovës, por edhe nga ekspertë të të gjitha fushave dhe lamive shoqërore. Në këto rrethana tejet të vështira dhe të komplikuar, pa përkrahjen e asnjë fuqije të madhe për pavarësi të menjëhershme, e me një udhëheqje të paaftë dhe të papërgjegjshme, po bëhet edhe më e vështirë e më e komplikuar zgjidhja e çështjes së Kosovës në favorin tonë.

Është më se e domosdoshme, që udhëheqja e Kosovës, pa hamendje, dhe sa më parë, të dalë me Qeveri të përbashkët që e përfaqëson faktorin politik dhe ushtarak të Republikës së Kosovës. Të gjitha mosmarrëveshjet, ngatërresat dhe inatet që i kanë krijuar në mes tyre të shpallen publikisht të tejkaluara. Të mirren vendime të arsyeshme

e të studjuara mirë e mirë, që do të obligonin çdo shqiptar dhe shqiptare kudo qoftë në rruzullin tokësor, për ta shpëtuar Kosovën nga kasapët serbo-sllavë dhe aleatët e tyre. Shqiptarëve nuk u shkon për shtati status-quoja e një lufte që do të zgjatej e përgjatej me vite të tëra. Duhet me çdo kusht ta pengojmë zbrazjen dhe copëtimin e Kosovës, që është objektiv i veprimeve serbe, me karakter strategjik, diplomatik e ushtarak.

Edhe diasporën shqiptare partiakët e shtirë dhe karrieristët e sëmurë me hyzmeqarët e tyre e ndanë dhe e përçanë si është zi e më zi. Të ashtuquajturat subjekte politike shqiptare që veprojnë jashtë atdheut nuk po janë në gjendje të organizojnë sëpaku një protestë, që do t'i tubonte, jo dy mijë vetë, siç ndodhi para një kohe, por me dhjetëra mijë shqiptarë që do t'i dridhnin të gjitha kryeqytetet e shteteve ku jetojnë ata. Kjo do të arrihej me siguri po të ishin shqiptarët të organizuar në baza kombëtare, e jo siç janë tash në baza partiako-regionale.

Po qe se Kosova mbetet edhe për një kohë nën thundrat serbe, përgjegjësia dhe mallkimi i popullit në rend të parë do të bjerë në udhëheqjen e saj shtetërore e partiake, dhe pastaj në çdo pjesëtar të kombit tonë, varësisht prej pozitës që ka pasë dhe rolit që ka luajtur në rrjedhat e ngjarjeve kombëtare. UÇK-ja duhet ndihmuar pa rezervë moralisht, materialisht e fizikisht jo vetëm nga shtetasit e Republikës së Kosovës, por edhe nga të gjithë shqiptarët dhe shqiptaret që kanë gjak dhe prejardhje shqiptare. Por ndihma më e madhe do t'i bëhet asaj po qe se subjektet shtetërore dhe politike të Republikës së Kosovës- sa më shpejt- dalin me një Qeveri të përbashkët duke i njohur subjektet e krijuara shtetërore, por edhe duke i krijuar ato që i mungojnë. Dalja e shqiptarëve me një zë para faktorit ndërkombëtar nuk duhet kuptuar dhe nuk duhet të vijë deri te kapitullimi i tyre para presionit të faktorit ndërkombëtar, por, përkundrazi, do të vijë te forcimi i pozitave gjatë bisedave me faktorin ndërkombëtar dhe atë serb.

*Botuar: "Bota sot" më 5 shkurt 1999*

## VETËM BASHKIMI YNË E SHPËTON KOSOVËN

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërsit!

Të punojmë për ta shpëtuar Kosovën martire!

Të punojmë për ta quar në vend amanetin e dëshmorëve dhe të martirëve tanë që fëmijët dhe rininë tonë të mos e lëmë pa atdhe, pa dinjitet njerëzor dhe pa krenari kombëtare nëpër rrugët e botës!

Të punojmë për bashkimin e të gjitha forcave shqiptare pa dallim bindjesh politike a ideologjike, regionale a besimit fetar.!

Është koha e fundit të shuhet jeta partiake në diasporë, që do ta lehtësonte riorganizimin e diasporës shqiptare në bazë të shëndoshë kombëtare, që do t'i forconte Bashkësitë shqiptare ku janë formuar dhe do të lehtësonte të formohen aty ku ende nuk janë formuar. Është koha e fundit që shqiptarët të organizohen si komb e të sillen si komb. Është koha e fundit që të mbyllen të gjitha polemikat! Të mos fajësojmë askend deri sa ta çlirojmë Kosovën nga shqijet! Vetëm atëherë kur Kosova të jetë e lirë, do të kërkohej fajtorët që na prunë në këtë tragjedi kombëtare! Tani nuk është koha për t'i emruar fajtorët! Tani është koha e fundit për mobilizim gjithëkombëtar! Mobilizim të të gjithë shqiptarëve, të të gjitha moshave dhe të të gjitha viseve shqiptare!

Kosova është në rrezik! Kombit shqiptar po i kanoset zhdukja fizike! Vetëm formimi i një Fronti të përbashkët gjithëkombëtar do të na shpëtojë si popull e si komb. Vetëm mobilizimi ynë për luftë kundër barbarëve serbë, me të gjitha forcat tona njerëzore, intelektuale dhe financiare, duke i përdorë të gjitha format dhe mënyrat e luftës, do ta shpëtonte Kosovën nga kthetrat e shkaut, e kombin tonë nga turpi dhe mallkimi!

Për arritjen e këtyre objektivave është detyrë parësore e njerëzve që sot gjenden në krye të subjekteve shqiptare: ushtarake, politike e shtetërore, t'i lënë anash interesat e ngushta, duke iu përkushtuar me mish e me shpirt bashkimit të të gjitha forcave që ata i përfaqësojnë në një Front të përbashkët organizimi dhe mobilizimi, me një Udhëheqje që do të përfaqësonte të gjitha forcat në Kosovë dhe diasporë, ku do të krijoheshin një udhëheqje politike dhe ushtarake kompakte dhe autoritative para faktorit tonë të brendshëm dhe atij të jashtëm. Detyrë mbi të gjitha detyrat e udhëheqjes që do të krijoheshin do të jetë që aleatët tanë: SHBA,

NATO-ja, Bashkësia Evropiane etj., të kenë besim të plotë në atë Udhëheqje, kur dihet se pa ndihmën e tyre ne do ta humbnim Kosovën për gjithmonë, mu nga papërgjegjësia dhe veprimet e papërgjegjshme dhe synimet karrieriste të shumicës së udhëheqësve që janë vënë në ballë të strukturave udhëheqëse shtetërore, partiake dhe ushtarake të Kosovës. Për arritjen e objektivave kombëtare është më se e nevojshme që- në afatin sa më të shpejtë (prej dy-tri ditësh)- të tubohën përfaqësuesit e të gjitha subjekteve shqiptare të Kosovës e të diasporës shqiptare në Tiranë apo në Zvicër. Mendoj se në atë takim që do të quhet " Kuvendi i bashkimit dhe mobilizimit tonë për ta shpëtuar Kosovën dhe nderin e kombit. " Duhet të marrin pjesë këto subjekte të Kosovës dhe diasporës me nga një apo tre përfaqësues:1).UÇK-ja 2).LKÇK-ja.3).Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës.4). Bashkësitë Shqiptare në Zvicër, në Gjermani, në Austri dhe në Belgjikë.5).LDK-ja, LBDK-ja, LPK-ja, 6. Partitë politike nga Maqedonia dhe Kosova Lindore që i kanë degët e tyre në diasporën tonë.7) Ibrahim Rugova, Hashim Thaçi dhe Bujar Bukoshi apo përfaqësuesit e tyre që ata i autorizojnë.8). Përfaqësuesit e Fondit " Vendlindja thërret " dhe ata të " Trepërqindshit ". Nga ky Kuvend do të dilej me një udhëheqje të përbashkët politike dhe ushtarake, që mund të quhej me një emërtim simbolik, që do t'i afronte dhe mobilizonte të gjitha forcat dhe shtresat e popullit tonë rreth udhëheqjes së zgjedhur. Me siguri me këtë "organizim" që e kemi sot, ku interesat partiake dhe klanore janë vënë mbi interesat kombëtare, është e pamundur ti arrijmë objektivat madhore kombëtare.

I Madhi Zot na ndihmoftë!

Dalshim faqebardhë para kombit dhe historisë!

*Botuar në "Bota sot " 8 prill 1999*

*P:S:Lutën të gjithë ata që kanë ndikim në këto subjekte të bëjnë presion për bashkimin e tyre për të formuar një subjekt të vetëm udhëheqës dhe organizativ.*

*Shënim i autorit: Me qëllim që nga shkrimi të largohen ca paqartësi i bëra ca ndryshime në katër fjalitë e para të këtij shkrimi.*

## TË MËSOJMË NGA PËSIMET

Se a do të dinë shqiptarët ta shfrytëzojnë për të mirën e tyre të përgjithshme perspektivën e shkëlqyer që ua krijuan Qendrat e vendosjes ndërkombëtare dhe burrat e mëdhenj të këtij shekulli- zotërinjtë Clinton, Bler, Shirak, Klark dhe zonja Olbrajt, të cilët shqiptarët duhet t'i nderojnë me nderimet më të larta kombëtare duke i shpallur qytetarë nderi, por edhe duke u lënë emrat e tyre shesheve më të bukura të qyteteve të Kosovës, që gjatë sundimit serbo-sllav u dhunuan me emra okupatorësh e gjelatësh serbo-jugosllav,- varet shumë se sa kanë mësuar shqiptarët nga pësimet e tyre të shumta gjatë historisë së tyre të gjatë.

Një gjë duhet ta kenë të qartë shqiptarët kudo që gjenden në botë dhe të çfarëdo niveli kulturor apo statusi social që kanë, se armiqtë e tyre serbo-sllavo-grekët kurrën e kurrës nuk do të heqin dorë nga planet e tyre djallëzore kundër kombit tonë. Dështimi i planeve të tyre për zhbërjen e Shqipërisë, spastrimin etnik të Kosovës dhe ndarjen e viseve shqiptare ndërmjet tyre, si dhe zhdukjen e kombit shqiptar e subjektivitetit të tij ndërkombëtar, nuk do të thotë se ata nuk do të bëjnë përpjekje edhe më të mëdha, që të na godasin me mjete edhe më perfide, duke i përdorur të gjitha format e një lufte speciale dhe tinzare me ndihmën e aleatëve të tyre, që do t'i ndihmojnë haptas apo fshehtas. Por ndihmën më të madhe atyre po ua bëjnë "udhëheqjet" shqiptare të ndara e të përçara, që edhe pas gjithë këtyre të ligave që na gjetën, po vazhdojnë t'i thellojnë përçarjet dhe kështu me veprimet e tyre skandaloze, e të papërgjegjshme po e ndihmojnë propogandën e ndyrë të shkijeve dhe grekve se populli shqiptar "nuk është popull shtetëformues", se është "i pa aftë për ta qeverisur vetveten", "shkatërrues" i vlerave kulturore e shpifje dhe rrena të llojllojshme shumë qesharake.

Fatëkeqësisht, edhe pse shqiptarët po e shohin se Greqia po i realizon planet e saj në Shqipëri nëpërmjet spiunëve të saj Nanosit me kompani, nuk po janë në gjendje të bëjnë asgjë që do ta pengonte realizimin e planeve kolonizuese dhe helenizuese të saj. Me siguri, Serbia, po ashtu do të bëjë Ç'është e mundur për ta rikthyer integritetin e saj mbi Kosovën, ndërsa aleatët e saj do ta ndihmojnë pa kursim.

Po qe se "udhëheqjet" e shqiptarëve edhe më tutje vazhdojnë të sillen si fëmijët kalamaj, po qe se ata edhe më tutje do të tregohen të

pandërgjegjshëm dhe nuk e kuptojnë se luftën me shkaun ende se kemi fituar, dhe se duhet shumë mund e energji për të derdhur në frontin e përbashkët gjithëshqiptar për t'i mundur armiqët tanë të ligj dhe tinzarë, shansi historik që na është dhënë mund të humbë, dhe pastaj nuk do të vlejë më mekanizmat mbrojtëse të rrejshme se "Evropa shtrig na mashtroi" se "Evropa lavire na tradhtoi "etj.

#### TË MOS DËSHTOJMË EDHE NJË HERË

Dihet mirë se Lufta e Dytë Botërore na e pat dhënë shansin ta kurorëzojmë bërjen e Shqipërisë etnike, por fatkeqësisht, forcat tona nacionaliste, ishin më dobët të organizuara sesa kolona e pestë serbo-sllave, që e pati legalizuar veprimtarinë e saj antishqiptare, duke formuar të ashtuquajtën Partia Komuniste Shqiptare, e cila për gjysmë shekulli Shqipërinë e bëri siç e deshën serbo-sllavët-grekët: "të dobët ekonomikisht dhe ushtarakisht", dhe "pa kurrfarë autoriteti e aleati të fuqishëm ndërkombëtar". Sesa janë të fuqishme çerdhet e sigurimeve të huaja në Shqipëri u vërtetua shumë herë, por "revolucioni i vonuar demokratik " i Qosjes duhet t'ua hapë sytë shqiptarve për të kuptuar se kombi ynë është i rrezikuar prej të papriturave të vazhdueshme, siç janë krizat politike dhe ekonomike, kaosi, pasiguria, rrëmuja, aferat e ndryshme që i krijojnë serbo-grekët sa herë që kanë nevojë nepërmjet social-komunistëve dhe spiunëve të tyre në krye me Nanosin, Milon, Gjinushin, Klosin, Cekën etj.

Po qe se shqiptarët duan të mos u përsëritet historia me dështime dhe pësime; po qe se shqiptarët duan ta shohin Kosovën Shtet të pavarur e të lirë, nuk duhet lënë fatin e kombit në duar të "udhëheqjeve" dhe njerëzve që janë bashkëfajtorë me kriminelët serbë për tragjedinë e fundit të kombit tonë, tragjedinë më të madhe që njih historia jonë. Me siguri, kjo tragjedi nuk do të kishte ndodhur me këtë masë, dhe në këtë formë, po qe se udhëheqjet e subjekteve politike dhe shtetërore të Republikës së Kosovës zotrinjtë Bukoshi, Qosja, Demaçi, Rugova, dhe Hyseni të kishin gjetur mirëkuptim dhe bashkëpunim vëllazëror në mes tyre, duke i vënë interesat kombëtare mbi ato partiake dhe klanore. Me siguri rrjedhat e ngjarjeve në Kosovë do të ishin shumë më të favorshme për shqiptarët dhe do t'i kishim në funksion të plotë institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës si Presidencën, Qeverinë, Parlamentin, Organet e pushtetit lokal, dhe me siguri UÇK-ja do të bëhej ushtri e institucionalizuar e Republikës së Kosovës, e armatosur mirë, me kuadër

të aftë komandues, që do t'i bënte ballë me sukses maqinerisë ushtarake serbe, dhe do ta mbronte me të gjitha mënyrat popullsinë e Republikës së Kosovës, për të mos u katandisur siç u katandis e u masakrua pa mëshirë nga shkijet gjakatarë. Me siguri nuk kishte për të ndodhur që një grusht enveristësh të padijshëm të cilët me vite të tëra bridhnin rrugve të Evropës duke mbrojtur marksizëm-leninizmin dhe internacionalizmin proletar, të bëhej udhëheqja politike e UÇK-së.

#### PARIA NUK E KALOI PROVIMIN

Ngjarjet e zhvilluara në hapësirën shqiptare pas rrëzimit të stalinizmit në Shqipëri dhe fillimit të zhbërjes së Jugosllavisë bëri që shqiptarët të diferencohen, por jo si më parë nga pushtetarët komunistë dhe kukullat e tyre, por ata u vetëdiferencuan në bazë të qëndrimeve që mbajtën ndaj ngjarjeve që u zhvilluan dhe punës së tyre konkrete në ato ngjarje.

Shqiptarët më në fund duhet të bëjnë një llogari përfundimtare për sukseset dhe mossukseset e tyre gjatë këtij dhjetvjeçari. Siç dihet, klasa politike pati ca suksese në dy vitet e para të viteve '90, kur i vuri themelet e shtetësisë së Kosovës, por si duket i muar mësysh vetes, dhe kështu, e kaploi plogështia, e zuri vetëknaqësia, filluan përçarjet, u rritën xhelozitë, u shtuan urrejtjet, filluan kërcënimet, atentatet politike, dhe- si pasojë e të gjitha këtyre- na e humbën Kosovën. Por i Madhi Zotë nuk lejoi një tragjedi kaq të rëndë për kombin tonë, dhe të Mëdhejt e botës i urdhëroi që popullin Shqiptarë ta ndihmojnë. NATO-ja na i preu prangat e robërisë. Na e hapi rrugën e lirisë. Na thanë miqtë e kombit "ashkohuni o shqiptarë se vetëm nuk mund t'i bëni asgjë Serbisë". Por, kujna me i thënë? Prej njerëzve të parisë askush provimin s'e kaloi dhe shumica prej tyre horë u bënë, duke vënë interesat e tyre personale dhe klanore para interesave kombëtare.

Populli ynë udhëheqjen e tij e dëgjoi. E thirrën për t'i falur gjaqet në emër të Kosovës dhe lirisë së saj. Po. I falën gjaqet, besa edhe shumë gjaqe që nuk është dasht për t'i falë. Kur e thirrën për t'u bërë antarë partie, nuk ngurroi, u bënë anëtarë partie, të rinj e të vjetër, gra e burra. E thirrën popullin të bëjë zhurmë me lugë, pjata, çelsa, legena etj., për t'ua thënë shkiqeve se këtu jemi, etj. Urdhëri u krye! Aksioni mbaroi me sukses! Shkijet u egërsuen! Na i helmuan fëmijët dhe nxënësit! Na i mbyllën shkollat dhe fakultetet! Po udhëheqja e dashur tha: "Shkau është i pa rahmet". Të jeni gjakftohtë. "Durim! Durim!"! Po si ta kundërshton

udhëheqjen e tij populli?! Atë udhëheqje që kishte kryer shkolla të larta! Njerëz akademikë! Doktora shkencash, shkrimtarë, poetë, politikanë! Të dijshtëm sa të duash!

I ftuan puntorët në grevë të përgjithshme. Si të mos dëgjohet udhëheqja e pavarur sindikale? Greva filloi dhe mbaroi qysh urdhëroi "më i madhi" i punëtorëve. Shkijet gjetën shkakun për t'i larguar nga puna punëtorët.

Ju thanë: "Mos bëni zë! Mos bëni ekcese! Rrini në shtëpia!". U sosën kursimet, u sosën rezervat e ushqimeve. Duhet ngënë. Iu piku "rahmeti" shkijeve dhe na i çelën dyert e gurbetit. U ndanë familjet! Mbet Kosova pa rininë e saj! Plakej Kosova e gjorë, plakej! Ani nuk është gajle thonte udhëheqja e dashur, se edhe jashtë Kosovës i kemi bërë degët e pipat e partive! Mos e ndërpreni stazhin e partisë! Urdhëronin partiakët e shtirë! Do të na forcohen partitë! Do të na rriten të ardhurat! Gëzoheshin Kryepartiakët e partiakëve të shtirë!

#### POPULLI E KREU PUNËN E TIJ

Pastaj, urdhëruan ta "varrosin dhunën". Populli i gjorë nuk din të thotë jo, edhe pse ishte një veprim i palogjikshëm. Dhunën e kujt donte ta varrosi paria vallë?! Kush bënte dhunë në Kosovë? Shqiptarët apo serbët?! Zgjedhjet e para edhe zgjedhjet e dyta u kryen me sukses. Populli e kreu punën e tij. Ua dha votën atyre që premtuan se Kosovën do ta bëjnë Shtet të pavarur. Ua dha votën atyre që kishin shkollë, e besa edhe atyre që ia kishin bërë nga një argat Kosovës në kohërat më të vështira. Te populli asgjë nuk humb. As e mira dhe as e keqja. Ai vështroi e nuk bën fjalë shumë. Dalleverxhinjtë mendojnë se populli mashtrohet lehtë, prandaj aq të zëshëm bëhën kur flasin, kur i kanë afër vetes sëpaku nja dy-tre vetë. Sa hollë e gjatë i tjerin llafët! Sa gojambël bëhën, sidomos kur kanë nevojë për votat e popullit!

Por kur të bëhën të "fortë" i harrojnë fjalët! Fjalët shumë burra i hangrën! Deputetët e parë nuk patën kohë të tubohen për ta konstituuar Parlamentin, apo u friguan nga kërcënimet e shkijeve?! Ku ta dijmë ne të gjorët...?!

Por, prapë mirë prej tyre, që sëpaku ua lanë amanet deputetëve të zgjedhur në Zgjedhjet e Dyta ta konstituojnë Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Këta besa i çuan në vend premtimet. E thirrën dhe e mbajtën mbledhjen e parë të Kuvendit. E zgjodhën edhe udhëheqjen e Parlamentit. Beogradi reagoi shpejt. Reagoi edhe më shpejt R.Qosja dhe H. Hyseni me Kompani. Komunikatë plotësisht e njëjtë e Beogradit dhe LBDK-së!



Parlamenti i Kosovës shpallet jo legjitim nga të dy palët! Nuk i njohin kurrsesi vendimet e tij. Me të ra pika, kur e sheh udhëheqjen e një partie që me aq fanatizëm mbron të prapshtën, të ligën, të keqen! Mbron institucionet e Serbisë dhe nuk i mbështet të Republikës së Kosovës. Anomali apo marri, si të quhet veprimi i një pjese të parisë së Kosovës, që don të bëjë shtet por pa institucione shtetërore! Shtet i vetëm në rruzullin tokësor pa institucione shtetërore! Shpikje kosovarçe! Shpikje origjinale shqiptare! Studentët u lodhën nga kjo gjendje e mjerë!

Duan ta ndërrojnë status-quonë. I bënë demonstratat e para. Bëhen përgatitjet për të dytat. Populli i gJORë si të mbyllet nëpër shtëpia, e bijtë e bijat e tyre të kacafytën me shkije. Këtë radhë, për herë të parë, populli nuk i dëgjoji prijësit e tij, që kërkonin të mos dilnin në demonstrata. U mbushën rrugët e qyteteve të Kosovës me të rinj e të reja, me burra e me gra. Krah për krah, për t'u bërë më të fortë, për tu bërë më të fuqishëm. Dhe arritën ta ndërrojnë atë gjendje tmerri, atë mjegullnajë që e kishte mbuluar Kosovën. Ta mundin frigën! "E mundën frigën shqiptarët"- thanë amerikanët! Do të na dalë punë me shqiptarët, thanë evropianët! Shkijet i bënë planet e tyre të fshehta. Edhe aleatja e saj Greqia i bënte planet e veta. Gjetën gjuhë të përbashkët si çdoherë më parë. Shqipëria e Jugut sipas marëveshjes së tyre, duhet t'i takonte Greqisë, ndërsa Kosova dhe Shqipëria e Veriut Serbisë.

Drenica si çdo herë na e zbardhi fytyrën. Familja e Shaban Murat Jasharit u bë kurban për t'u treguar shqiptarëve se si fitohet liria, si mundet shkau i shkinës. Adem e Hamzë Jashari kanë ditë se do të vijë dita e Trimave dhe Burrave të Dheut: Ishin të zgjedhur për të shkuar në Shqipëri për t'u përgatitur së bashku me shumë burra të ardhur nga Kosova dhe diaspora për t'u aftësuar ushtarakisht dhe për t'i dalë zot Kosovës! Po ishin djemtë e Shaban Murat Jasharit: Ademi, Hamza dhe Rifati me shokë që i vunë themelin UÇK-së. A mund të bëhet themel më i fortë se ai themel që bëhet: "NË EMËR TË ZOTIT". Po enveristët pas vrasjes së Ademit dhe Hamzës nuk e patën vështirë t'ia ndërronin UÇK-së jo vetëm emblemën, por edhe themelin.

**BASHKIMI I ELITËS NACIONALISTE, ÇËSHTJE QË NUK DURON ZHAGITJE**

Trimat e UÇK-së i ndërmuarën aksionet e para. I vranë ca kriminelë shkije. I vranë edhe ca spiunë...U ndërruan rolet. Frigën e shqiptarëve e muarën policët dhe kriminelët e Serbisë. Trimat e Drenicës,

të Llapit dhe të Dukagjinit dhe rinia jonë heroike e ndërruan status-quonë në Kosovë. Fitore e rëndësishme e shqiptarëve. Po edhe armiqtë tanë nuk rrinë. Kërkojnë ta gjejnë udhëheqjen e UÇK-së. Të gjitha sigurimet e huaja interesohen për UÇK-në. Më shumë për ta penguar se sa për ta ndihmuar. Më së lehti për të dëpërtuar në udhëheqjen e UÇK-së e pati Sigurimi Shtetëror i Shqipërisë. Nanosit i erdhën të mirat për "dere dhe për dritare". Ai kishte besimin e plotë tek sebet e grekët, por e kishte besimin e plotë edhe te enveristët e Kosovës. Shumë të holla që i mblodhën LPK-istat nga mërgimtarët në emër të Kosovës, i pat bërë "rrush e kumbulla" Nanosi. Nga të gjithë enveristët e Kosovës që Nanosin e konsideronin babë dhe nënë, Xhavit Halitin e bënë bajraktar, se ai ishte sokoli i Nanosit dhe i Partisë, prandej edhe i takonte që t'i jepte detyra udhëheqjes së LPK-së. Ua la duart e lira Nanosi të blejnë kallashnikova në veri të Shqipërisë me një kusht që mos ta lënë pa bakshish.

Adem e Hamzë Jashari dhe ca prijës të UÇK-së ranë dëshmorë. Humbje e madhe për Kosovën dhe UÇK-në. Kosova kishte hyrë në luftë me Serbinë, por subjektet tona shtetërore në vend se të marrin kontrollin e UÇK-së për ta forcuar me kuadra profesionale dhe armatime moderne, bën siç tregohet anekdota për një gomar, që ujku ia rrjepte kofshët, ndërsa ai thoshte: "në ëndërr ishalla jam". Në këto rrethana nuk e patën vështirë LPK-istat të bëhen udhëheqje politike e UÇK-së, sepse kishin përkrahjen e Nanosit me kompani, por edhe kishin shumë të holla që i mblidhnin në emër të UÇK-së. Shumë shpejt u mbush Dukagjini me kallashnikovë të dalë nga përdorimi në Shqipëri. Edhe 40-60% të teritoreit të Kosovës thonin LPK-istat e kanë çliruar, por ishte dikund një defekt në këto shifra, sepse nuk ishte marrë nga armiku asnjë postë policie, apo garnizon ushtrie. Po ku t'i dinin enveristët dredhitë dhe hilet e Nanosit, marrëveshjet e Kretës. Për ta Nanosi ishte zot i vërtetë. Vepruan si i këshilloi ai për çështje të ushtrisë, armatimit, kuadrove, marrjes së pushtetit me mjete komuniste etj, por kurrë nuk ua tregoi marrëveshjet që i pat lidhur në Kretë. Po dashti Zoti dhe nuk u bë qysh planifikuan sebo-grekët me Nanosin e Klosin, se ndërhyri CIA dhe i bëri planet dhe marrëveshjet e tyre pluhër e hi, që kishin të bënin për Kosovë dhe për Shqipëri.

NATO-ja na i hoqi shkijet prej qafe. Qinda mijë shqiptarë që iu shpëtuan masakrave serbe duke ikur për Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të

Zi, u kthyen shumë shpejt në vatrën e tyre të shkrumbuara. Kosova ishte mbushur me varre masive. Bota u habit me solidaritetin e popullit shqiptar. Po bota u habit edhe me shpejtësinë e kthimit të të përzanëve nga Kosova në vatrën e tyre, menjëherë pas ikjes së ushtrisë dhe policisë kriminale serbe nga Kosova.

Pra, populli shqiptarë e tregoi veten e tij se është një popull i mrekullueshëm, një popull me një ndishmëri të thellë, me një solidaritet të pasqorë, me një dashuri të fuqishme për trojet dhe Atdheun e tij, një popull që meriton jo vetëm lirinë, por edhe një udhëheqje që do të dinte ta çonte përpara zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe në përgjithësi zgjidhjen drejt të çështjes kombëtare, pra çlirimin dhe bashkimin kombëtar.

### HISTORIA DO TË BËJË TË VETEN

Sot pas gjithë të ligave që e gjetën Kosovën, shqiptarët e Kosovës kanë një përvojë të mjaftueshme për të ditur se kush ka fajë më të mëdha e kush më të vogla nga udhëheqja e tij. Ato udhëheqje dhe ata individë që i përçanë shqiptarët për interesat e tyre personale, klanore dhe partiako-ideologjike, e që edhe sot po e bëjnë të njëjtën punë, historia me siguri do t'i shpallë ortakë në masakra dhe në spastrimin etnik të Kosovës me shqijet, sepse nuk lejuan bashkimin e faktorit politik dhe ushtarak të Kosovës, nuk lejuan institucionalizimin e UÇK-së, nuk i njohën dhe nuk po i njohin institucionet e krijuara të Republikës së Kosovës, dhe kështu shqijeve ua mundësuan të bëjnë masakra të papara mbi popullsinë e pambrojtur të Kosovës, me të vetmin qëllim që Kosovën ta pastrojnë etnikisht dhe ta bëjnë tokë të tyre, siç e patën bërë Toplicën tokë të tyre para 120 vitesh, me të njëjtat mjete të gjenocidit siç i përdorën sivjet në Kosovë.

Sot vetëm naivët politik nuk e kanë të qartë se Kosovën na e qitën prej dore udhëheqjet politike dhe shtetërore të Kosovës sëbashku me pararojën staliniste të LPK-së dhe ia dhuruan Serbisë për të mos e nxjerrë kurrë më nga kthetrat e saj, ndërsa shqiptarëve ua dhanë rrugët e botës, për të humbur çdo gjë të vlefshme kombëtare. Vetëm mrekullia e të Madhit Zot bëri të pamundshmen, duke e detyruar NATO-n dhe të Mëdhenjtë e botës t'i dalin krah popullit të gjorë të Kosovës. "Udhëheqjet" e Kosovës së paku tash, kur në Kosovë është vëndosur protektoriati ushtarak dhe civil ndërkombëtar është dashtë të vetëdijësohen dhe t'i përmirësojnë gabimet e rënda që i bënë më parë, është dashur t'i njohin institucionet e formuara shtetërore të Republikës së Kosovës dhe t'i

krijonin ato që i mungojnë, me qëllim që të bashkëpunojnë me Organet e pushtetit të protektoriatit ndërkombëtar, për të mirën e Kosovës dhe çështjes sonë kombëtare, e jo siç po punojnë edhe më tutje, për interesat e tyre partiake, klanore apo individuale, siç vepruan edhe më parë.

Mjerisht Kosova sot po përjeton vështirësi të mëdha të krijuara nga partiakët e shtirë dhe karrieristë të sëmurë për kolltuqe, pozita dhe privilegje, duke krijuar dy "qeveri", që nuk i njeh faktori ndërkombëtar dhe as shunica absolute e shqiptarëve, pasi që u vetëzgjodhën në pozita dhe poste, ku në vend se të krijojnë rregullsi dhe siguri, krijuan kaos dhe pasiguri, në vend se të krijojnë bashkëpunim të mirëfilltë me pushtetin e Protektoriatit ndërkombëtar për të mirën e Kosovës, po kryejnë punën e vasalëve dhe kështu po i sjellin dëme të mëdha çështjes madhore kombëtare, duke e ndihmuar propagandën serbo-sllavo-greke me veprimet e tyre konkrete, se shqiptarët nuk kanë aftësi shtetformuese, e rrena tjera, që "akademikët" serbë i kanë mbushur bibliotekat e Evropës me qindra libra të shkruara për qëllimet e tyre propagandistike.

Për të dalë nga kjo situatë tejet e vështirë, nuk duhet krijuar shpresa të rrejshme se "udhëheqjet" e tanishme të Kosovës do të kurorëzojnë pavarësinë e Kosovës, prandaj forcat e shëndosha, intelektualët nacionalistë, si dhe intelegjencia e lartë dhe e mesme, e cila deri tash ka ndejtë anash në luftën për pushtet e kolltuqe, duhet të marrë masat e duhura për t'u organizuar dhe për t'i marrë fatet e atdheut në duart e tyre.

### TË MOS PRESIM GJITHÇKA NGA TË TJERËT

Pra, është domosdoshmëri që sa më parë forcat e shëndosha kombëtare të bëjnë përgatitjet e duhura për formimin e një partie nacionaliste, që do t'i çonte përpara synimet shekullore të popullit shqiptar për çlirim dhe bashkim kombëtar, duke iu përshtatur rrethanave ndërkombëtare, por duke e forcuar miqësinë me SHBA dhe Britaninë e Madhe, të vetmet aleate të sinqerta të kombit tonë.

Këto synime do të arrihen me siguri, po qe se partia që do të formohet do të përfshinte njerëz autoritativë, atdhetarë e intelektualë, numri i të cilëve nuk është i vogël, që interesat kombëtare kurdoherë i kanë vënë mbi ato partiake dhe personale, njerëz të pakomprometuar në afera të ndryshme.

Të gjithë ata njerëz që janë të pakënaqur apo të demoralizuar me "udhëheqjen" aktuale të Kosovës, do ta kenë vendin në partinë e re të Kosovës, e cila me siguri do t'i fitonte zgjedhjet e lira vet, apo me ndonjë

forcë tjetër demokratike, që i njeh vlerat demokratike të Evropës Perindimore.

Shqiptarët duhet ta kenë të qartë se me këtë "udhëheqje" e cila vetë është zgjedhur në Kosovë që nuk njeh punën e të tjerëve që ndërkombëtarizuan çështjen e Kosovës, që nuk njeh institucionet shtetërore të Kosovës, Presidencën dhe Parlamentin, të cilat kanë dalë me anën e votës së lirë të popullit, që penguan dhe nuk lejuan institucionalizimin e UÇK-së, që i përçanë dhe ende po i përçajnë shqiptarët, që kërcënuan dhe po i kërcënojnë shqiptarët të cilët nuk mendojnë dhe veprojnë si ata, nuk do të jenë të zot të arrijnë Pavarësinë e Kosovës, pasi që interesat personale, ideologjike dhe klanore i kanë vënë mbi ato kombëtare.

Nuk duhet të presim nga të tjerët, nga Qendrat e vendosjes ndërkombëtare, të na njohin neve dhe të na ndihmojnë sinjerisht për t'i fituar të drejtat tona legjitime, kur ne nuk e njohim njëri- tjetrin, dhe nuk bashkëpunojmë vëllezërisht, duke respektuar forcën e argumenteve e jo forcën e dredhive, kërcënimeve, ndërskamsave, atentateve politike etj.. Më në fund shqiptarët duhet ta kenë të qartë se faktorët e vendosjes ndërkombëtare nuk do të rrezikojnë të krijojnë një Liban apo Afganistan në zemër të Evropës. Vetëm prezenca e faktorit ndërkombëtar e ka larguar kacafytjen e drejtpërdrejtë të partiakëve të shtirë dhe karrieristëve të sëmurë për pushtet, prandaj po qe se nuk tejkalohen këto anomali sa më parë, Kosova dhe çështja kombëtare do të pësojnë dëme me pasojat tepër të mëdha, ku përgjegjësia do të bjerë në këtë "udhëheqje". Por a do t'i ndihmonte gjë Kosovës edhe sikur tërë këtë udhëheqje do ta lëshonte toka për të humbur me shenjë e nishan, si dënim që do t'i vinte nga i Lumi Zot, po qe se Kosova nuk do të arrinte Pavarësinë e saj?!

*Botuar në "Bota sot", më 10 dhe 11 shtator 1999*

*PS. Nëntitujt i ka vënë redaksia.*

## SHQIPTARËT DO TË SHPËTOJNË NGA KTHETRAT SERBO-GREKE VETËM ME NACIONALIZËM

Siç po duket zgjidhja e drejt e çështjes së Kosovës do të zhagitet edhe për shumë kohë, vuajtjet e shqiptarve do të vazhdojnë edhe më tutje, shansi historik mund të na dalë nga dora, jo për fajin e faktorëve ndërkombëtarë por për fajin e klasës politike shqiptare dhe "udhëheqjeve" që u vetëzgjodhën, apo që ne i zgjodhëm.

Qendrat e vendosjes ndërkombëtare ua kanë bërë të qartë shqiptarëve se zgjidhja e çështjes së Kosovës nuk është aq e lehtë dhe e thjeshtë siç dëshirojnë ta paraqesin shqiptarët, por është një ndër problemet më të komplikuar e më të vështira në shkallë ndërkombëtare, dhe se faktori shqiptar duhej ta luante rolin kryesor për të ndikuar në faktorët e vendosjes ndërkombëtare për t'u përcaktuar që Kosova ta gëzojë lirinë dhe pavarësinë, pas mbarimit të fazës kalimtare të protektoriatit ushtarak dhe civil ndërkombëtar.

Duhet ta kemi të qartë se jemi në provimin e fundit si popull dhe si komb para qendrave të vendosjes ndërkombëtare. Se a do ta kalojmë provimin, për ta zënë edhe ne vendin në bashkësinë e kombeve të lira të Evropës Perëndimore, apo do të mbesim lëndë e parë ndërtimi për serbo-grekët dhe tokat tona

t'u mbeten "utrinë" të shteteve të tyre, varet në rend të parë prej organizimit të forcave të shëndosha kombëtare në krye me intelektualë dhe nacionalistë të shquar, që sot i ka kombi ynë në numër të mjaftueshëm.

Të pritësh diçka të mirë, nga këto "udhëheqjet" shqiptare të cilat janë në vllugun e luftës për pozita e pushtet, duke mos i zgjedhur mjetet, është qesharake dhe jo reale, kur dihet se një pjesë e saj është e paformuar kombëtarisht dhe politikisht, pjesa më e madhe është e sëmure nga karrierizmi, xhelozia dhe bajraktarizmi, por që janë pehlivana e xhambazë të shkathtë politikë, ndërsa pjesa më e vogël janë spiunë të regjur të serbo-grekve e të dajve komunistë të Moskës dhe Sorosit.

Faktorët e jashtëm, SHBA me aleatët e saj dhe NATO- n na krijuan kushte dhe rrethana shumë të përshtatshme për realizimin e objektivave madhore kombëtare, por fatkeqësisht, rrethanat e brendshme i kemi shumë kaotike në gjithë hapsirën kombëtare. Për këtë situatë

shumë të tendosur që sot mbretëron në Shqipëri më së tepërmi kanë të drejtë të gëzohen grekët dhe serbo-sllavët, pasi që njerëzit e tyre i kanë duart e lira t'ia bëjnë të gjitha të ligat shtetit dhe popullsisë së gjerë, që është mbetur nën mëshirën e spiunëve të regjuri serbo-grekë dhe social-komunistëve të marrë. Ndërsa Kosova martire e masakruar, e djegur dhe e shkatërruar nga barbarët shkje, ende s'i ka varrosur martirët, "udhëheqja" e saj- edhe në këto kushte- po vazhdon pa fije turpi luftën për pushtet, duke u vetëzgjedhur në pozita udhëheqëse pa e bërë ende shtetin. Të ligat që po ia bëjnë Shqipërisë bastardhët e kombit në krye me Nanosin & kompani, po ia bëjnë Kosovës enveristët në krye me qosiqët e hysenët të bashkuar rreth të ashtuquajtës LBDK dhe nxënësit dhe argatët e Nanosit, pararoja staliniste e LPK-së në krye me Xh. Halitin, I. Kelmendin, H. Thaqin e Bardhyl Mahmutin. Se sa do të zgjatë ky terr mbi trojet tona, varet në rend të parë prej forcave të shëndosha kombëtare, që duhet t'u prijnë nacionalistët e dëshmuar dhe intelektualët që nuk punuan kurrë për interesa të huaja. Ata nuk guxojnë që tërë veprimtarinë e tyre ta kufizojnë vetëm në konstatimin e gjendjes ku gjendet kombi dhe rreziqet që i kanosen, por duhet- sa më parë që është e mundur- të vetorganizohen, për të marrë qëndrime, për ta përcaktuar strategjinë dhe taktikën e veprimit, për të marrë detyra e për të ndarë përgjegjësi, me qëllim të organizimit të të gjithë forcave të shëndosha kombëtare, për ta zgjidhur njëherë e përgjithmonë çështjen tonë kombëtare dhe për t'ua treguar vendin e merituar spiunëve serbo-grekë dhe argatëve të tyre stalinistë e pansllavistë. Shqiptarët nuk duhet t'i përsërisin gabimet e bëra gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe pas luftës, ku me mosorganizimin e duhur të nacionalistëve dhe forcave të shëndosha kombëtare, serbo-sllavët shfrytëzuan situatën për ta legalizuar veprimtarinë e tyre antishqiptare duke e formuar të ashtuquajten "Parti Komuniste Shqiptare" një bar të keq të mbjellur në truallin virgjër të tokës shqiptare, që shqiptarëve u solli vuajtje, mjerim, tragjedira e të liga tjera të panumërta.

Po qe se intelektualët nacionalistë nuk veprojnë konkretisht, dhe nuk bashkohen për të gjetur mënyrën dhe mjetet e përshtatshme për të dalë nga kjo situatë e mjerë dhe kaotike, jo vetëm se nuk do të zgjedhet mirë dhe drejt çështja e Kosovës, por kombi ynë do të jetë përherë i rrezikuar nga shkombëtarizimi, zhdukja, apo do të bëhet gazi i botës, duke u kthyer në rob të përjetshëm shpirtërisht dhe ekonomikisht të serbo-grekve e djajve të mallkuar komunistë.

Po qe se forcat e shëndosha kombëtare, organizohen sa më parë dhe si duhet, do ta ndryshojnë gjendjen ekzistuese dhe do t'i marrin fatet e kombit në duart e tyre, pasi që kemi intelektualë burra, të aftë e të dijsëm, shkencëtarë, politikanë e diplomatë, që dinë si të dilet nga kjo krizë e thellë politike, ekonomike, organizative e morale, në të cilën na futën karrieristët e partiakët e shtirë dhe spiunët serbo-grekë. Fatëmirësisht ideologu i nacionalizmit shqiptar, intelektual, politikani dhe diplomati i shquar i kombit shqiptar zotëri Abdi Baleta e ka formuar " Rimëkëmbja Kombëtare " partinë e vetme të nacionalizmit shqiptar, dhe- nëpërmjet organit " Rimëkëmbja " dhe kombëtarës Bota sot po i demaskon pa mëshirë spiunët dhe argatët e serbo-grekve, dhe po e përgatit opinionin e gjerë se Shqipëria, Kosova dhe Viset tjera shqiptare do të shpëtojnë nga kthetrat serbo-sllavo-greke vetëm me anë të nacionalizmit.

Gëzon fakti se gazeta kombëtare " Bota sot " po e ngrit zërin e të vërtetës jo vetëm në diasporë por edhe në Kosovë, dhe po luan rol me rëndësi, duke ua bërë të mundshëm lexuesve të shumtë të njihen me ngjarjet që po ndodhin në gjithë hapësirën kombëtare e më gjerë, por po i demaskon edhe bartësit e dukurive të shëmtuara, që e kanë kapluar shoqërinë shqiptare. Veçmas, lufta e saj pa kompromis kundër protagonistëve kryesorë të këtyre dukurive, ka një rëndësi të madhe jetike për zhvillimin e ngjarjeve të ardhshme pozitive, pas mbajtjeve të zgjedhjeve të lira në Kosovë dhe Shqipëri, ku forcat e shëndosha kombëtare dhe demokratike do të korrin fitore të plotë mbi social-komunistët dhe spiunët serbo-grekë, që Shqipërinë më 1997 e shtrinë për tokë, ndërsa Kosovës ia përgatitën varrin, e shqiptarëve dyert e botës, por i Madhi Zot edhe këtë radhë si shumë herë më parë nëpërmjet NATO-s e shpëtoi kombin shqiptar.

Më në fund kisha për të bërë publike dëshirën e shumë bashkëkombasve që kërkojnë nga intelektualët dhe afaristët atdhetarë, ta organizojnë një tryezë të rumbullakët për marrjen e qëndrimeve dhe vendimeve të përbashkëta, për caktimin e përgjegjësive dhe detyrave, për gjetjen e mënyrës dhe mjeteve të përshtatshme për të dalë nga kjo situatë kaotike, dhe krizë e thellë kombëtare me zgjuarsin dhe mençurinë, me qëllim që sa më mirë t'i shfrytëzojmë rrethanat e përshtatshme ndërkombëtare për realizimin e synimeve tona kombëtare.

Iniciativën për organizimin e një tryeze të rumbullakët duhet ta mari gazeta kombëtare "Bota sot" pasi që Botuesi, Kryeredaktori dhe



Redaksia e saj i kanë meritat kryesore që kjo gazetë u bë me të vërtetë gazetë kombëtare, në sajë të bashkëpunimit që krijuan me intelektualë atdhetarë dhe personalitete të shquara të kombit: Abdi Baleta, Skënder Buçpapaj, Teki Dervishi, Mero Baze, Nexhmedin Spahiu, Hysamedin Feraj, Vehbi Skenderi, Veli Karahoda, Esat Stavileci, Agim Shehu, Ali Podrimja, Rudolf Marku, Bardhyl Londo, Arbër Ahmetaj etj, që me pendat e tyre të mprehta po i trajtojnë si duhet temat aktuale dhe çështjet madhore kombëtare.

*Botuar: " Bota sot " më, 19 gusht 1999*

## ATA QË E MUARËN FLAKARESHËN E POPULLIT DUHET TË RRINË KOKËULUR DHE NË MARRE

Me siguri 28 tetori i vitit 2000 do të jetë datë e rëndësishme e historisë sonë kombëtare, po qe se fitorja e popullit të shumëvuajtur të Kosovës dhe fitorja e LDK-së do të ruhet dhe do të forcohet, duke ia sjellë pavarësinë Kosovës, lirinë dhe demokracinë shqiptarëve në trojet e tija etnike, prosperitetin, rritën dhe begatinë çdo familje shqiptare.

Po qe se shqiptarët vetëkënaqen me këtë fitore duke menduar se punët e mira do të vijnë vetvetiu, pasi që me votën e tij të lirë i mundën forcat e djallit të mallkuar, rëndë gabohen. Populli e fitoi një betejë shumë të rëndësishme, por kanë mbetur edhe shumë beteja tjera të pakryera, ku moskryerja e tyre do ta kthente fitoren në humbje. LDK-ja dhe Ibrahim Rugova e fituan besimin e popullit, por ky besim duhet ruajtur duke korrë suksese të njëpasnjëshme në të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë shqiptare. Sukseset e njëpasnjëshme në Kosovë fuqishëm do të ndikojnë edhe në Viset tjera shqiptare e në Shqipëri që edhe atje të fitojnë forcat e shëndosha kombëtare. Për realizimin e këtyre qëllimeve LDK-ja në radhë të parë duhet ta "pastrojë" shtëpinë e saj nga klanet dhe individët të cilët LDK-në e dëmtuan me veprimtarinë e tyre përçarëse dhe destruktive, duke bërë aleanca të fshehta dhe të hapta me pehlivanat dhe argatët e Nanoisit për përfitimet e tyre personale dhe klanore. Për dëmet që ata ia sollën LDK-së, institucioneve shtetërore dhe çështjes kombëtare duhet të japin llogari e kurrresi të fitojnë pozita në udhëheqjet partiake dhe shtetërore të Republikës së Kosovës. LDK-ja në vitet e para të "90- tës ishe Lëvizje kombëtare e cila i vuari themelet e shtetësisë së Kosovës.

Edhe tash në fillimin e këtij mijëvjeçari LDK-ja duhet të bëhet Lëvizje kombëtare. Anëtarësia dhe simpatizuesit e saj nuk kanë kohë të pushojnë. Fronti i punës i pret në të gjitha vendëbanimet e Kosovës. Të regjistrohesh dhe të ndihmohen familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës dhe skamnorët. Të kujdesen dhe t'u sigurojnë qetësinë, paqen dhe sigurinë të gjithë banorëve të Kosovës. T'i regjistrojnë argatët e argatëve të Nanoisit, që bënë dhe po bëjnë krime, vjedhje dhe kërcënime. Të mbledhin dëshmi të vërtetuara për krimet e tyre dhe t'u japin organeve gjyqësore të Kosovës dhe Gjyqit të Hagës. Shkencëtarëve materialisht t'u ndihmohet për botimin e punimeve shkencore në gjuhë të huaja dhe

përkthimin e librave të botuara më parë që dëshmojnë me fakte për terrorin dhe gjenocidin e serbo-jugosllavëve mbi popullsinë shqiptare që kur shkeli këmba e tyre në tokën tonë, por të botohen edhe libra për rezistencën dhe qëndresën e vazhdueshme të shqiptarëve për ta ruajtjur qenien e tyre kombëtare. Të gjitha këto dëshmi që i kemi të botuara në gjuhën tonë duhet t'i bëjmë të njohura edhe për Qendrat e vendosjes ndërkombëtare dhe për opinion ndërkombëtar. Vetëm atëherë kur të fitohet Pavarësia e Kosovës LDK-ja duhet të bëhet parti e mirfilltë e cila do të jetë motor i zhvillimit, përparimit dhe begatisë së shoqërisë shqiptare.

PNDSH në këto zgjedhje nuk ka humbur pasi që aleatja e saj bindshëm ka fituar në saje edhe të një pjese të madhe të anëtarësisë dhe simpatizantëve të saj, që votuan për përfaqësuesit e LDK-së, duke qenë të vetëdijshëm se duhet bashkuar forcat për të fituar mbi argatët e Nanosit, Mejdanit dhe Klosit. PNDSH në të ardhshmen duhet të jetë forca kryesore opozitare e LDK-së e cila do të ketë për detyrë që zgjidhjen e çështjes kombëtare ta kërkojë në krijimin e Shqipërisë Etnike duke ia bashkangjitur Shqipërisë Kosovën dhe Viset tjera shqiptare edhe ato vise që çakaj të Ballkanin i shkombëtarizuan me anë të terrorit dhe gjenocidit që ushtruan mbi popullsinë shqiptare të Toplicës dhe Sanxhakut të Nishit, Pazarit të e Ri, Peshterit dhe Çamërisë.

Këto vise shqiptare që na i shkombëtarizuan çakaj të Ballkanit do t'i bashkangjiten Shqipërisë Mëmë se janë gjymtyrët e saj, pa të cilat ajo nuk mund lirshëm të frymojë dhe të gjallërojë. Detyrë parsore e PNDSH nuk do të jetë pushteti por ngritja e vetëdijes nacionaliste tek shqiptarët duke bërë luftë të pakompromis me bërësit e internacionalizmit proletar, duke i luftuar dhe çrrënjësuar mbeturinat e komunizmit, siç janë demagogjia, gënjeshtria, shpifja, tradhtia, mashtrimi me lajka, kërcënimi, vrasja pas shpine, ateizmi, etj. Shqiptarët sot për sot nuk kanë fuqi t'i kthejnë krahinat e tyre që me gjenocid i shkombëtarizuan kasapët e Ballkanit. PNDSH e riorganizuar dhe e forcuar me intelektualë, shkencëtarë dhe veprimtarë të çështjes kombëtare, do të duhej t'i bindnin qendrat e vendosjes ndërkombëtare dhe opinionin ndërkombëtar me fakte të dokumentuara, shkencore dhe historike se Toplica me Sanxhakun e Nishit dhe Pazari i Ri me Peshterin para një shekulli ishin toka shqiptare, që Serbia me gjenocid dhe mjete tjera perfide i bëri "tokë serbe", dhe se Çamëria në Dy luftat e fundit Botërore me gjenocidin grek pothuajse

krejtësisht u shkombëtarizua. Pasi që me ligjet ndërkombëtare krimi dhe gjenocidi ndaj njerëzimit nuk vjetërohen, shqiptarët kanë të drejta morale dhe ligjore t'i kërkojnë viset e tyre duke i përdorë të gjitha format e veprimit, e në rend të parë, të kërkohet nga faktori ndërkombëtar, veçmas nga aleatët tanë të natyrshëm jashtëballkanik, që të na ndihmojnë. Por më në fund shqiptarët në Ballkan dhe në Evropë pas disa dhjetëvjeçarëve apo më së voni pas një shekulli do të bëhen forcë e respektuar që do t'i shkojë zani, do t'i ecë fjala, do t'i rritet fuqia e autoriteti, dhe me të mirë apo me të keq tokat shqiptare që na i shkombëtarizuan barbarët do të bëhen prapë tonat.

PDKSH si edhe më parë është në udhën e Zotit, që gjithmonë do të prijë mbarë, përkrahu LDK-në, përkrahu institucionet shtetërore, punoi me të gjitha forcat për bashkimin e faktorit politik dhe ushtarak shqiptar. Fitorja dhe sukseset e LDK-së, janë edhe sukseset dhe fitorja e saj.

LBDK-ja u shafit për toke. Ideologu i saj që ishte edhe Rrenatari i argatëve të Nanoisit "vdiq për së gjalli". Vetëm tash ai do ta kuptojë se sa e rëndë dhe sa e fuqishme është shuplaka e popullit, flakaresha e atij populli që ai aq shumë e shfrytëzoi dhe aq shumë e keqpërdori për të fituar privilegje gjatë periudhës së robërisë së Jugosllavisë Socialiste. Veçmas, në këto zgjedhje populli u tregua ndaj tij i pamshirshëm, se edhe ai ishte i pamshirshëm ndaj tij në këto vitet e fundit, kur ai i thynte prangat e robërisë duarthatë.

Armët që u blenë nga Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës Kolonel Ahmet Krasniqi në qershor të vitit 1998, për t'ua dërguar forcave elite të UÇK-së, nuk lejuan të futen në Kosovë nga kryexhadall Qosja me xhadallët tjerë të LBDK-së, dhe me xhadallët e LPK-së. Ai nepërmjet Arbër Xhaferit e Menduh Thaçit intervenoi te shteti mik që mos t'i jipen armët Ahmet Krasniqit pasi që ai nuk pranoi të bëjë komplete kundër Institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, pasi që nuk pranoi të ngrinte krye kundër Presidentit dhe as kundër Parlamentit të Republikës së Kosovës. Kryexhadalli i LBD-së nuk e kishte hallin e shqiptarëve se a do të vriten e masakrohen me "gajret" apo pa "gajret". Ai dhe pehllivanat e Nanoisit kishte hallin e kolltukut, të pozitës dhe privilegjeve. Ai donte të bëhet "Baba i Kombit" "idhull", po u tregua se "kaqik" nuk kishte për të qenë një njeri i zakonshëm me vetëdije, dhe me përgjegjësi njerëzore, e lere më të bëhet një tribun apo udhëheqës i shqiptarëve.

PDK-ja e Gjarpërit edhe pse disa herë "ndrroi lëkurën" për të ardhur deri te ky emër i bukur dhe simpatik, qëllimi i të cilës ishte t'i humbi gjurmët e gjenezës dhe të trashëgimisë, për t'i fshehur gjurmët e një robi, që ishte në shërbim të Nanoisit, Mejdanit dhe Klosit, por edhe për të bërë përgatitjen e terrenit për falsifikimin e votës së lirë të popullit. Të gjitha këto munde i shkuan kot se edhe ky e muar shuplakën e popullit. Kot i harxhoi paratë e plaçkitura nga pompat e benzinit për blerjen e votave, kot i përkëdheli njerëzit, kot bëri premtime qesharake. Edhe pse nepërmjet argatëve të tij njerëzit i kërcënoi, apo ua qiti në pritë maskat, nuk arriti ta marrë pushtetin për të cilin aq shumë punoi me mjetet komuniste në bazë të parimit se "qëllimi i arësyeton mjetet". Fitoi pushtetin aty ku më së paku është dashur të fitojë, se mirë e kanë njohur bashkëfshatarët e tij se kush është, por ata i mashtroi që t'ia japin votën nepërmjet demagogjisë komuniste dhe propogandes lokaliste që një kohë të gjatë në ato anë me argatët e tij e zhvilloi.

AAK-bëri aleanca të fshehta dhe të hapta, bëri plane mbi plane, por edhe këta populli i shporri. Flakaresha i përplasi për toke, ua thei buzë e dhëmballë, nuk ua pati besën, se edhe këta si ata të Gjarpërit e kanë një nënë. LPK-ja i polli dhe i rriti të dy palët rrugëve të metropoleve të Evropës dhe i edukoi me edukatën e llumpenproletariatit ndërkombëtar.

PQLK-ën populli fare nuk e njohu dhe as nuk e bëri "hesap"se më i madhi i tyre pshtjelloi e çpshtjelloi, foli jerm e foli në kllapi, dhe askund "sopata si preu në një vend". Ndërroi profesion, ndërroi patron. Edhe pse "shumë lartë i vjerri qepët", mundi i shkoi kot se "kapsollat ia hangrën pulat"se asnjë nuk e shkrepri për të treguar të vërteten se çfarë e shtyu t'i hajë fjalët, t'i njollosë dhe shpifë kolegët, t'i ndërrojë kampet, të bëhet argat i argatëve të Nanoisit, Mejdanit dhe Klosit?!

Zgjedhjet vendore në Kosovë i ndërruan raportet e forcave të cilat i vunë me dhunë pehllivanat e Nanoisit pas çlirimit të Kosovës nga NATO-ja dhe luftëtarët trima të UÇK-së. Populli me votën e tij të lirë i rrahu me shuplakën e tij të fuqishme këta argatë të huaj, që punuan dhe po punojnë për interesa të grekut dhe të shkaut, për ca eshtëra që po i lëpijnë. Edhe pse janë të rrahur e të dërrmuar kjo farë e keqe po mundohet të ngrihet në këmbë, për t'u hakmarrë për dajakun që e fituan. Forcat demokratike që besimin e popullit fituan, duhet të ringjallën, të këndellen, të përtrihen me gjak të ri, të forcohen dhe pa fije frike të ecin

përpara duke e hapur rrugën e lavdisë. Atë rrugë që Kosovës do t'ia sjellë Pavarësinë. Atë rrugë që shqiptarëve do t'iu sjellë lirinë, demokracinë, zhvillimin, përparimin, paqen dhe begatinë. Ajo rrugë që shqiptarëve do t'ua sjellë edhe bashkimin kombëtar me hapa të matur por të sigurtë dhe shkallë -shkallë. Atë rrugë që shqiptarin do ta bëjë zot të tokave të tij që i Madhi Zot ua dhuroi.

Shtrohet pyetja si të arrihen këto qëllime të larta njerëzore dhe kombëtare? Dihet se vetëm me fjalë asgjë nuk bëhet. Pra, duhet mund, djersë dhe gjak të derdhen ende shqiptarët për t'i arritur gjithë këto të mira. Edhe pse shkau u detyrua të largohet nga Kosova, ajo është e mbushur me spiunë të saj e me spiunë të grekut, rusit e të birit të thiut. Dihet mirë se grekët dhe serbët i kanë instaluar spiunët dhe vasalët e tyre në Qeverinë e Shqipërisë, dhe në institucionet tjera të shtetit shqiptar. Kryespiuni i armiqve tanë Nanoisi me Kompani pasi Shqipërinë e bëri si është më zi, ashtu si ua dashti zemra grekut dhe shkaut, të njëjtën gjë kërkon t'ia bëjë edhe Kosovës. Ky xhadall në fillim pati ca suksese kur e dëmtoi shumë Kosovën, i cili me anën e argatëve dhe pehlivanave të tij e prishën çdo nismë të mirë të shqiptarëve. E përçanë faktorin politik dhe ushtarak të Kosovës, e përvetësuan UÇK-në dhe nuk lejuan institucionalizimin e kthimin e saj në ushtri kombëtare. Bënë krime dhe dhunime të ndryshme mbi shqiptarë që nuk pranuan të bëhën skllëvër të tyre dhe të punojnë për shkaun. Dashti i Madhi Zot e na e dha të mbarën, dhe në zgjedhjet vendore nanoistët dështuan. Ky është dështimi i tyre i parë. Me punën e forcave të shëndosha kombëtare do të vijnë edhe fitore dhe suksese tjera.

Pranvera e vitit të ardhshëm do të na sjellë fitoren e zgjedhjeve nacionale. Tash është i hapur fronti i punëve të mbara. Kryesitë dhe elektorati i LDK-së duhet ta kenë të qartë se është e domosdoshme t'i shtërnojnë rradhët. Të bëhen këmbëngulës, që të bëhen ndryshime rrënjësore në organet udhëheqëse të Kosovës.

Ata që e fituan flakareshën e popullit, duhet të rrijnë kokëulur dhe me marre, e jo t'u dëgjohet zëri në RTK, thuajse ata janë të parët e Kosovës. Populli ua tregoi vendin ku e kanë, aty pas derës, dhe një pjesë e tyre e ka vendin në Gjygiin e Hagës, e jo në ballë të votrës.

Fatëkeqësisht në klanet e farës së keqe janë kurthuar edhe ca burra të mirë e atdhetarë, që pa vetëdije apo edhe me grackat dhe kurthat që ua kanë përgatitur, janë bërë argatë të argatëve të Nanoisit, kur kanë pranuar

të futën në organe udhëheqëse të partive që i polli LPK-ja. Tashpërtash vetëm një rrugëdalje e kanë, që sa më parë të largohen prej tyre, se një ditë kur të dalin në shesh të gjitha të ligat që ata i bënë, duhmi i erës së keqe do t'ua zërë frymën dhe do t'u bjerë të fiktë, e do të rrëzohën me krye për toke, dhe nuk do të dali kush që do t'i arsyetojë. Do të konsiderohen me ta bashkëfajtorë edhe pse ndoshta nuk do të burgosën me ta për të vuajtur denime të gjata, por moralisht do të jenë të dënuar sa të jenë gjallë. Po me siguri, nuk do të vonojë dhe në zgjedhjet parlamentare e presidenciale që do të mbahen vitin e ardhshëm dajakun që e muar LBDK-ja e Qosjes, në zgjedhjet vendore do ta marin edhe udhëheqjet e partive që i polli LPK-ja. Dhe kështu do të plotësohen kushtet që Kosova të fitojë pavarësinë e saj. Shqiptarët si komb do të ringjallen se forcat demokratike do të fitojnë në gjithë truallin shqiptar, ndërsa forcat e huaja, spiunët e grekut e të shkaut, majtistët shqiptarë, kurrën e kurrës më nuk do të kenë mundësi t'i marrin frejtë e shtetit shqiptar dhe as të manipulojnë me popullin për të na bërë dëme, se mirë e dijmë se kush janë, dhe për interes të kujt punojnë, edhe pse me bulçitë e tyre të forta dhe me gojën plotë jargë përbehen në "pavarësinë" e Kosovës dhe "lirinë" e shqiptarëve.

*Botuar: "Bota sot" 24 nëntor 2000.*

## ZGJEDHJET NACIONALE DO TË VENDOSIN PËR FATIN E KOSOVËS DHE TË SHQIPTARISË

Pas zgjedhjeve të suksesshme lokale që u mbajtën në Kosovë më 28 tetorin e vitit të kaluar, qendrat e vendosjes ndërkombëtare kanë vendosur t'i mbajnë edhe zgjedhjet nacionale. Ashtu sikurse për zgjedhjet lokale që faktori ndërkombëtarë ishte i ndarë në dysh, ku miqtë e Serbisë dhe pehlivanët e Nanosit donin që zgjedhjet të shtyhen sa më vonë, apo për një kohë të pacaktuar, ashtu edhe për zgjedhjet nacionale miqtë e Serbisë dhe pehlivanët e Nanosit do të shpikin lloj-lloj pengesash dhe arsyesh që këto zgjedhje të shtyhen për "më vonë", në një kohë të pacaktuar. Përpjekjet e tyre do të jenë të kota se miqtë e shqiptarëve janë shumë herë më të fortë sesa miqtë e Serbisë, ndërsa populli shqiptar i Kosovës i tregoi tërë botës se ka vetëdije të lartë politike, ka aftësi të mëdha organizative dhe shtetformuese, ka kulturë të gjërë qytetare, se di t'i dallojë miqtë e tij të vërtetë nga miqtë e pa besë, di t'i dallojë se kush janë aleatët e tij të natyrshëm dhe kush janë armiqtë e tij të përbetuar. Ai me sukses e dha provimin e pjekurisë në zgjedhjet lokale. Pa fije dyshimi, në zgjedhjet nacionale do të dijë t'i zgjedhi bijtë e tij më të mirë, ata bij dhe bija të tij që për këto dhjetë vitet e fundit treguan me vepra se për ta çështje kombëtare ishte gjithmonë mbi interesat partiake, grupe dhe personale.

Sa i përket intelegjencës sonë të lartë, një pjesë e vogël e saj ra në provimin e jetës. Një pjesë prej tyre u manipulua nga pehlivanët e Nanosit me demagogjinë perfide të tyre se gjoja ata përfaqësojnë UÇK-në dhe kështu pa vetëdije u shndërruan në argatë të tyre. Ca të tjerë nga lakmia për pushtet, pozita udhëheqëse dhe të mira materiale me vetëdije të plotë u bënë argatë të argatëve të Nanosit. Fatmirësisht shumica dërrmuese e intelegjencës sonë të lartë nuk ra në provimin e jetës, pasi që nuk u bënë argatë të argatëve të Nanosit, dhe as nuk u bënë argatë të partiakëve të shtirë, të atyre partiakëve që formuan klanet e tyre në partitë që ata u kyçën, me qëllim që të dominojnë mbi të tjerët dhe pastaj partia të punojë për interesat e tyre personale dhe klanore. Një pjesë e intelegjencës u kyçën në jetën politike të Kosovës dhe me punën e tyre të pakursyer ndikuan shumë në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës por edhe në çlirimin e saj. Pjesa tjetër nuk u kyç në jetën politike të



Kosovës duke e parë të arsyeshme dhe të nevojshme të mirren me veprimtari kulturore, arsimore dhe shkencore duke qenë të bindur se edhe kështu ndihmohet rezistenca jonë kombëtare.

Rinia jonë heroike si çdo herë më parë e kreu detyrën si është më së miri. Ajo ndërroi status-quonë e Kosovës kur u pa se është e nevojshme dhe u kyç në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës duke treguar heroizëm të pashoq dhe moral të lartë luftarak, edhe pse i mungonte kuadri ushtarak dhe armatimi i nevojshëm për t'i bërë ballë një armiku të lig siç është shkau, që ishte i armatosur deri në dhëmbë.

Sa i përketë ish të burgosurve politik të Kosovës, mund të themi pa pasur frikë se mos po gabojmë, ishte kategoria e cila luajti rol me rëndësi në ngritjen e vetëdijes kombëtare, dhe mbajti barrën kryesore të rrezistencës sonë kombëtare. Por, në vitet e fundit të shekullit që e lamë pas, edhe kjo kategori u shpërbë. Një pjesë e saj u manipulua nga pehllivanat e Nanosit dhe pa vetëdije u bënë argatë të tyre, një pjesë me vetëdije u bënë argatë të argatëve të Nanosit për realizimin e interesave të tyre personale dhe klanore, një pjesë luajti rol me rëndësi në jetën politike të Kosovës duke punuar me mish e me shpirt për ndërkombëtarizimin dhe çlirimin e Kosovës. Ndërsa pjesa tjetër ishte e paangazhuar në jetën politike të Kosovës pasi që nuk kishte informata të nevojshme se në cilën anë mbrohet drejtësia dhe në cilën anë mbrohet dredhia, në cilën anë ishte shpëtimi dhe rimkëmbja kombëtare dhe në cilën anë ishte humnera dhe katastrofa për shqiptarët.

Sa i përketë klases politike të Kosovës, marrë në përgjithësi, ajo ra në provimin e jetës më shumë se një herë. Katër vitet e para të "90-tës ishte produktive dhe e suksesshme, por pastaj filluan ngecjet. Vetëkënaqësia dhe lufta ndërklanore u bën smundje kronike e të gjitha partive politike shqiptare të Kosovës. Kjo ndikoi që shqiptarët të merren më tepër me vetveten se sa me shkaun. Fatkeqësisht udhëheqjet e ngushta të partive nuk ishin në gjendje t'i izolojnë dhe t'i përjashtojnë elementët destruktivë, karrieristët dhe partiakët e shtirë, në mesin e të cilëve kishte njerëz të UDB-së së Jugosllavisë dhe njerëz të Sigurimit të Shqipërisë, të cilët krijuan klanet e tyre dhe- në momentet e përshtatshme- edhe bënë thyerje të thella në subjektet politike, ku ata ishin të kyçur.

Me thyerjet dhe ndarjet në dysh (krah) të partive të vogla nuk pati edhe aq pasoja të rënda për Kosovën. Pasoja të rënda pati me përçarjet dhe luftën për pushtet në mes klaneve që ishin krijuar në LDK. Tentimi

për shkatërrimin e LDK-së apo ndarjen e saj në dysh nga ana e individëve që ishin të lidhur këmbë e krye me Nanosin apo me Millosheviqin i solli dëme të rënda çështjes madhore kombëtare. Pasojat ishin dhe ende janë të mëdha dhe duhet të harxhohet kohë, mund dhe energji nga politikanë të zgjuar, atdhetarë dhe veprimtarë të drejtë dhe nga intelegjencia jonë e pa parti, që nuk janë të komprometuar me asgjë, për tejkalimin e këtyre pasojave, për krijimin e një klase politike të re, me njerëz të rinj dhe ide të reja, që e njohin lojen politike, dhe si pozita ashtu edhe opozita bashkëpunojnë dhe e korrigjojnë punën e njëra-tjetrës në dobi të interesave kombëtare, siç veprohet në shtetet e zhvilluara të Evropës Perendimore dhe SHBA.

Siç dihet LDK-ja në shumicën dërmuese të komunave të Kosovës e fitoi besimin e popullit. Në opozitë mbetën dy parti të dala nga LPK-ja: PDK-ja dhe AAK-ja. Shtrohet pyetja: Kjo klasë politike që e kemi sot, a do të jetë në gjendje t'i realizojë synimet tona kombëtare? A do të jetë e aftë t'i zgjidhë problemeve sociale? A do të jetë e zonja t'u sjellë qytetarëve siguri, liri qytetare dhe të drejta njerëzore? A do të jetë e aftë ta luftojë dhe të fitojë mbi mafinë politike dhe ekonomike e cila pas luftës përvetësoi pasuri shoqërore duke keqpërdorur uniformën dhe gradat ushtarake të UÇK-së?

LDK-ja, partia më e madhe dhe më e organizuar e Kosovës, kreu detyra më rëndësi në ndërkombëtarozimin e çështjes së Kosovës, në ngritjen e themeleve të shtetësisë së Kosovës, ndërsa UÇK-ja pati më së shumti ushtarë nga anëtarësia e gjërë e saj. Me fitoren që arriti në zgjedhjet lokale u bë parti e pozitës. Shtrohet pyetja a do të jetë në gjendje kjo parti t'i realizojë synimet tona kombëtare po që se nga radhët e saj nuk largohen apo nuk përjashtohen individët dhe klanet e tyre që e dëmtojnë dhe po e dëmtojnë në vazhdimësi këtë parti dhe çështjen shqiptare? Përgjigja është negative.

PDK-ja me AAK tash me votat që i fituan në zgjedhjet lokale po llogariten parti të opozitës. Shtrohet pyetja se a do të jenë opozitë konstruktive këto dy parti, kur udhëheqësit e vërtetë të tyre rrinë prapa skenës, por edhe ata që përbëjnë udhëheqjen e ngushtë të tyre, shumica dërmuese janë argatë apo pehlivana të Nanosit, të cilët me komplete, tradhti, ndërskamsa dhe kurthia e muarën udhëheqjen e njërive guerile të Kosovës dhe nuk lejuan institucionalizimin, aftësimin dhe forcimin e saj me kuadro të afta ushtarake dhe armatosjen e ushtarëve me armatime

moderne, pasi që ashtu kishte urdhëruar Nanosi. Është e tepërt të flitet për veprimtarinë kriminele të pehlivanave dhe argatëve të Nanos gjatë luftës, dhe pas luftës, pasi që për to dinë të flasin shumë qytetarët e Kosovës. Dhe tani kur është më se e qartë se Nanosi është i lidhur këmbë e kokë me Athinën e Beogradin, shtrohet pyetja se çka do ta presë Kosovën po qe se Pehlivanat e Nanosit luajnë rolin e opozitës në jetën politike dhe institucionale të Kosovës kur dihet se ata i marrin urdhërat për veprimtarinë e tyre nga Nanosi dhe Klosi.

Fatmirësisht në të gjitha subjektet politike gjenden njerëz konstruktivë dhe atdhetarë. Dikund ju shkohet fjala, dikund nuk hjekin fare në kandar, prandaj është koha e fundit që të rebelohen aty ku nuk u shkon fjala! Të tregojnë guximin e tyre qytetar, duke kërkuar me zë të lartë që kriminelët, Pehlivanat e Nanosit, spiunët e Beogradit dhe Athinës, karrieristët e sëmurë për pushtet, partiakët e shtirë dhe individët e komprometuar me vjedhje, plaçkitje dhe uzurpime të pasurisë shoqërore, të largohen nga udhëheqjet e subjekteve politike shqiptare, apo t'i përjashtojnë në mënyrën institucionale duke kërkuar ndihmën e opinionit demokratik të Kosovës, duke ua qitur në shesh të ligat që ua bënë individëve, familjeve dhe Kosovës. Vetëm po qe se veprimtarët e atdhetarët e mirëfilltë dominojnë në subjektet tona politike dhe përjashtohen të ligtë, ata që e dëmtuan shumë çështjen madhore kombëtare, Kosova do të ketë një klasë të zonjën politike e cila do të dijë ta çojë përpara zgjidhjen e çështjes së Kosovës, dhe në përgjithësi zgjidhjen e çështjes madhore kombëtare.

Me siguri LDK-ja do të gjejë forcë t'i largojë shtriganat e saj para se të dilet në zgjedhjet nacionale dhe do të forcohet me kuadro të reja. Po a do të arrijnë vallë ta bëjnë një gjë të tillë forcat e shëndosha në partitë e opozites? Duke ditur se sa krime kanë bërë Pehlivanat dhe argatët e Nanosit gjatë luftës dhe pas saj për ta marrë pushtetin e Kosovës, nuk diskutohet fare që ata me vetëdëshirë t'i lëshojnë pozitat dhe privilegjet, të cilat i kanë zënë në parti edhe pse e kanë të qartë se kanë dështuar në qëllimet e tyre të marra, edhe pse e kanë të qartë se populli do t'i rrahë edhe më tepër se sa në zgjedhjet lokale. Atëherë i patë rrahur me flakaresha fytyrës e turijve, dhe tani në zgjedhjet kombëtare do t'i hanë gugjumat kresë, dhe pastaj nuk mbetet tjetër pos që drejtësia shqiptare t'ua vejë në kandar gjynahet, dhe sipas peshës së tyre ta marrin dënimin e merituar.

Për të ecur përpara në synimet tona, intelegjenca jonë e pakompremetuare cila nuk është e kyçur në jetën politike të vendit, dhe në përgjithësi njerëzit pa parti, duhet të bëhen faktor i stabilitetit dhe përparimit. Ajo duhet të bëhet faktor i vendosjes në jetën politike dhe kulturore të vendit, jo duke u bërë argatë të klaneve të ndryshme të subjekteve politike të Kosovës, por duke e krijuar subjektivitetin e tyre politik, që do të neutralizonte në masë të madhe veprimtarinë e njerëzve pa përgjegjësi morale, politike dhe kombëtare. Ky subjekt politik që duhet të formohet sa më parë do të bënte ndryshime rrënjësore në jetën politike dhe kulturore të Kosovës, pasi që nuk do të udhëheqej nga synimet e ulta karrieriste dhe as të përfitimeve personale por do të udhëhiqej nga synimet e larta njerëzore dhe kombëtare, që qytetarët e Kosovës ta gëzojnë lirinë e fituar, të kenë kushtet e jetesës për të jetuar si i ka hije njeriut. Kjo forcë e re që do të krijohej, me besimin që do ta gëzonte tek qytetarët e Kosovës, do të fitonte besimin edhe te qendrat e vendosjes ndërkombëtare se është e aftë ta udhëheqi Shtetin e Kosovës dhe kështu do të njihet Pavarësia e Kosovës.

*Botuar: "Bota sot" 2-3 mars 2001*

## PEHLIVANËT E NANOSIT, ARGATËT E TYRE DHE KRIMINELËT, LARG PARLAMENTIT TË KOSOVË

Fushata e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës së shpejti do të përfundojë. Qytetarët e saj pas një "ditë qetësie" do të votojnë për përfaqësuesit e tyre që do të zënë vend në Parlamentin e ardhshëm të shtetit të Kosovës. Faktori ndërkombëtar me njohjen e institucioneve shtetërore, që do të dalin nga këto zgjedhje, do të krijojnë kushte dhe rrethana për njohjen e pavarësisë së Kosovës, po qe se faktori shqiptarë dhe klasa politike e Kosovës i kryejnë detyrimet që i kanë ndaj votuesve dhe qendrave të vendosjes ndërkombëtare. Pra, Kosova është futur në procesin e pavarësimit të saj, por si çdo proces shoqërorë edhe ky proces, mund të përshpejtohet, të ngadalësohet apo edhe të marrë kahje të kundërt, varësisht si do të përfundojnë zgjedhjet nacionale të 17 nëntorit të këtij viti dhe kush nga subjektet politike do t'i fitojë ato. Suksesi i klasës politike të çdo vendi, pra në këtë rast edhe i Kosovës, varet nga forcat politike që do të luajnë rolin e pozitës dhe të opozitës në Parlamentin e Kosovës. Fatmirësisht, sipas të gjitha parashikimeve LDK-ja do t'i fitojë edhe zgjedhjet nacionale ashtu siç i fitoi zgjedhjet vendore, me një dallim, se fitorja do të jetë edhe më bindëse dhe më e madhe. Pra, qysh tash dihet se fituesi i këtyre zgjedhjeve do të jetë LDK-ja e cila do t'i fitojë afër 70 vende në Parlamentin e Kosovës. Për 30 vendet tjera (që janë caktuar për subjektin politik shqiptar) do të luftojnë partitë e spektrit djathtist dhe partitë majtiste e disa subjekte tjera në formim e sipër, që nuk treguan sukses në zgjedhjet vendore të mbajtura para një viti. Ndërsa pakicat kombëtare do t'i fitojnë vendet e tyre në Parlamentin e Kosovës ("paushall") në bazë të numrit të votuesve të mundshëm, apo në bazë të votave që do t'i fitojnë nga zgjedhësit. Tash për tash ende nuk është e qartë sa vende do t'i fitojnë në Parlamentin e Kosovës partitë djathtiste dhe sa vende do t'i fitojnë partitë majtiste. Me siguri do të ishte një fitore e madhe për Kosovën dhe për kombin shqiptar, po qe se forcat majtiste të Kosovës, PDK-ja, dhe AAK, që janë bisht i Partisë Socialiste të Shqipërisë, të pësojnë humbje të thellë në këto zgjedhje, që kurrë më të mos vijnë në vete, kur dihet se kryepëhlivanët e Nanosit Xh. Haliti dhe I. Kelmendi janë patronët e tyre, ndërsa bajraktarët e farës ruse dhe argatët e tyre i përbëjnë kryesitë e këtyre partive.

Analfabetët politikë, kokëboshët dhe pshtjellakët dyfyrsha do të mundohen të m'i hedhin poshtë argumentet e mia, duke u mbështetur në faktin se majtistët e kanë pushtetin në shumë shtete të Evropës Perendimore. Argumenti i tyre do të merrej parasysh sikur populli ynë të mos e kishte fituar një përvojë tepër e hidhur gjatë sundimit të majtistëve dhe komunistëve shqiptarë. Nuk është e nevojshme të përmenden të gjitha të ligat që ia bënë popullit tonë bajraktarët e farës ruse, kur dihet se, që kur është mbjellë fara ruse në truallin shqiptar, populli ynë pati shumë vështërsi, kaloi periudha të rrezikshme, prej të cilave i kanosej qenia e tij kombëtare, por fatmirësisht Burrat e Dheut iu shmangën me mençuri, dije dhe trimëri shumë humnerave që ia përgatitën çakajtë e Ballkanit dhe aleatët e tyre, nëpërmjet majtistëve, komunistëve, rankoviqistëve, enveristëve, nanoistëve dhe "pionerëve të Enverit".

Është e mjaftueshme të përmendën vetëm ca fakte që dëshmojnë se në të gjitha periudhat e rëndësishme që kaloi kombi ynë, që nga përfundimi i Luftës së Parë Botërore e deri në ditët e sodit, bajraktarët e farës ruse luajtën rol tejet destruktiv dhe antishqiptar në të gjitha periudhat e rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Vlen të përmendet shkëlja e Marrëveshjes së Mukjes nga komunistët e Shqipërisë pas urdhërit të M. Popoviqit dhe D. Mugoshës, që ajo marrëveshje të shpallet e pavlefshme, ku si pasojë pati fillimin e luftës civile në Shqipëri në mes komunistëve shqiptarë, që përkraheshin nga komunisto-çetnikët serbo-jugosllavë, dhe nacionalistëve dhe ballistëve shqiptarë që nuk arritën të organizohen si duhet. Shkëlja e Rezolutës së Bujanit, që parashihte bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, pati për pasojë masakrimin e Drenicës dhe të Ana Moravës me Gjilanin, si dhe përgjakjen e të gjitha territoreve shqiptare që mbetën nën robërinë serbo-jugosllave. Veçmas duhet cekur masakren e Tivarit, që ishte kryevepër e përbashkët e komunistëve shqiptarë (të Shqipërisë dhe të Kosovës) dhe atyre serbo-jugosllavë. Po ashtu duhet të ceket edhe "Aksioni i armëve" që e organizoi Beogradi gjatë dimrit të vitit 1956, me pëlqimin e kukullave dhe këlyshëve të tyre, që i kishin vënë në pozita "udhëheqëse" në Kosovë, etj.

Edhe komunistët e Shqipërisë i sollën shumë të liga popullit dhe kombit shqiptar. Një kohë u bënë këlyshë dhe vasalet serbo-jugosllavë dhe pranuan t'ua japin edhe Kosovën me vise tjera shqiptare që t'iu ndihmojnë për ta marrë pushtetin në Shqipëri. Edhe për ta ruajtur

pushtetin u bënë rrogëtarë dhe papagaj ruso-sovjetikë. Dhe së fundi, kur rusët donin t'i ndërronin stalinistët e kompromituar me komunistë të moderuar, banda kriminele e Enver Hoxhës pranoi të bëhet zagare kineze, vetëm për ta ruajtur lëkurën dhe pushtetin mbi shqiptarët e gjorë, që i kishin trulluar me egjren komuniste duke i "bindur" se Shqipëria është "kopsht i socializmit" dhe "fener ndriçues i Evropës", se qytetarët e Shqipërisë janë njerëzit më të "lumtur" të botës e kopalla tjera të ngjashme. E zhvilluan luftën e klasave, vranë nacionalistë, ballistë, shpianikë, atdhetarë dhe i favorizuan llumpenploretarët, pakicat kombëtare dhe llumin e shoqërisë shqiptare për të zënë vende udhëhqese në shtetin e vetëm ateist në botë.

Skenari për zhdukjen e kombit shqiptar që u vu në veprim me firmën "Revolucioni i vonuar demokratik" i Shqipërisë- Qosjes, që filloi më 1977 e po vazhdon nga një fazë në tjetrën deri në ditët e sodit, i tregoi gjithë botës se komunistët e Shqipërisë, edhe në ditët e sotit, kur komunizmi pësoi humbje në gjithë botën, po e venë në veprim teorinë e marksizëm-leninizmit se komunistët nuk kanë atdhe dhe nuk kanë komb, se komunistët janë kundër vlerave të shoqërisë kapitaliste, se ata për të arritur qëllimin i përdorin të gjitha mjetet dhe mënyrat, duke u mbështetur në parimin e Makiavelit se "qëllimi i arsyeton mjetet". Të njëjtën gjë e treguan para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës majtistët, lëpëkistët, enveristët dhe nanoistët e Kosovës, që janë skllëvër dhe rrogëtarë të Nanosit, Mejdanit dhe Klosit, kur mohuan punën dhe sukseset e gjeneratave të tëra, dhe i vranë institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, që u krijuan dhe u mbrojtën me sakrificë të mëdha nga populli ynë dhe veprimtarë të dalluar të çështjes kombëtare. Siç dihet, këta kokëkrisur penguan çdo organizim të mbarë, penguan bashkimin e faktorit politik dhe ushtarak të Republikës së Kosovës, që do të sillte çlirimin e Kosovës nga vetë shqiptarët. Sabotuan Luftën çlirimtare të Kosovës, vranë veprimtarë të dalluar të çështjes madhore kombëtare, vetëm pse nuk pranuan të bëhen argatë dhe rrogëtarë të tyre.

Këto forca të territ, këta djaj bolshevikë, edhe pse gjatë luftës e dëmtuan shumë rëndë Kosovës dhe popullsinë e saj, me çlirimin e Kosovës nga NATO-ja, në vend se të pendohen për të ligat që ia bënë Kosovës, ata i shumëfishuan krimet pas krijimit të Qeverisë së Thaçit në Tiranë. Nga Kosova ikën forcat e krimit serb, por nga Tirana në Kosovë erdhën kryepëhlivanat e Nanosit, argatët e tyre dhe pionerët e Enverit, për

të marrë pushtetin e shumpritur mbi shqiptarët. Krijuan frikë, dhunë, pasiguri, padrejtësi dhe korrupsion. Përvetësuan pasuri të huaj dhe pasuri shoqërore. Kërcënuan, shpifën dhe vranë veprimtarë të dalluar të çështjes madhore kombëtare. Krijuan sigurimin e fshehtë në gjithë territorin e Kosovës në bazë të shkollës ruse të KGB-së dhe asaj jugosllave UDB-së, që e drejtonin udbashë (të dyfishtë) të Tiranës dhe të Beogradit. Udbashët e Tiranës i zëvendësuan udbashët e Beogradit, që udhëhiqeshin nga kryepëhlivanat e Nanosit. Sabit Geci që njihej në Drenicë dhe më gjerë për mjeshtëri të thyerjes së kotecëve të pulave dhe ahrijeve të bagtive, na u bë i pari i Sigurimit të fshehtë të Qeverisë së Hashim Thaçit, i cili me stafin e tij krijoi rrjetin e spiunimit, të shpifjes dhe të krimit të organizuar në gjithë territorin e Kosovës. Në anën tjetër SHP i UÇK-së që udhëheqej nga argatët e Xh. Halitit, i ndihmuan kriminelët serbë të bëjnë enklavizimin e disa teritoreve të Kosovës.

Një ditë do të japin llogari "Gjeneralat e Hashimit", të cilët, në vend se ta vendosin selinë e Shtabit të UÇK-së në veri të Mitrovicës, (përtej Urës së Ibrit) ata e vendosën në Tamnik dhe kështu ua mundësuan kriminelëve serbë të enklavizojnë një pjesë të Mitrovicës dhe disa teritore tjera të Kosovës. Dhe sot, kur gjatë fushatës zgjedhore dëgjon bajraktarët e farës ruse dhe rrogëtarët e H. Thaçit dhe I. Kelmendit me tituj dhe pa tituj shkencorë që rrahin gjoks se do ta "bashkojnë Mitrovicën", se partitë e tyre "do të kujdesën" për "mirëqenien e të gjithë shqiptarëve pa marrë parasysh bindjet e tyre politike" dhe premtime tjera të perealizuara, të detyrojnë t'ua bësh këto pyetje: Gjatë luftës i diferencuat shqiptarët në baza partiake dhe nuk lejuat të bëhet bashkimi i shqiptarëve në baza kombëtare për t'i luftuar okupatorët. E krijuat SHIK-un, për të mbjellë frikë dhe pasiguri duke vranë burrat më të mirë të kombit, ndërsa pas luftës u bëtë pasanikë të njohur të Kosovës edhe pse sa ishin në Evropën Perëndimore mbaheshin gjallë me ndihma sociale të Kryqit të Kuq të shteteve ku jetonit. Çka ndikoi që tash në kohën e fushatës së zgjedhjeve na u bëtë aq "zemërbardhë", që i urdhëruar argatët e juaj aq shumë të "ndryshojnë".

Nuk e di se kush është ai kokëkrisur që do t'i besojë "Gjarpërit"-Hashimit dhe shërbëtorëve të tij kur "premtojnë" se do të sigurojë "mirëqenie, begati dhe siguri për të gjithë qytetarët e Kosovës", kur më shumë se një herë kanë dëshmuar se kanë punuar dhe po punojnë për të pasur mirëqenie begati dhe siguri, familjet dhe klani i tyre. A nuk



ishte vetë ai Gjarpëri- Hashimi që i diferencoi edhe dëshmorët, kur në fjalimin e tij me rastin e "festimit" të zhbërjes së UÇK-së, ("Marrshin e Prishtinës") nuk i përmendi heronjtë e kombit Agim Ramadanin, Salih Çekun, Adem Ukëhaxhën dhe as njësitë operative të UÇK-së që ata i komanduan. Apo rasti tjetër para tri javësh kur me rastin e varrimit të Bekim Kastratit dhe të Besim Dujakut, nuk i dërguan të marrin pjesë pjesëtarët e TMK-së. Po si nuk turpërohet Hashimi dhe "gjeneralat" e tij, të cilët aq shumë përbehen se e kanë "dashur" dhe "i kanë kryer urdhërat e komandantit legjendar të UÇK-së Adem Jasharit", kur- edhe pas tri vjetësh nga ramja e familjes së Shaban Murat Jasharit në fushën e nderit-, nuk u kujtuan së paku t'ua rregullojnë varrezat.

Nuk e kam të qartë pse lejohet Hashimi dhe "gjeneralët" e tij ta turpërojnë Drenicën, Kosovën dhe Shqiptarinë, kur para Kullës Heroike të Shaban Murat Jasharit qëndron një "bust" që më shumë e shëmtton se sa e nderon dhe lartëson figurën e ndritur të heroit tonë kombëter, komandantit legjitim të UÇK-së Adem Jasharit. Ai "bust" duhet të hiqet sa më parë nga burrat e fortë të Drenicës, që mos ta zerë aty edhe një herë 28 Nëntori, që është ditëlindja e Heroit dhe Dita e Flamurit tonë kombëtar! Po si nuk turpërohet Hashimi, "gjeneralat" dhe argatët e tij kur premtojnë se partia e tyre për të gjithë shqiptarët do të jetë "nënë", kur premtimet e tyre i demantojnë 300 familjet e Drenicës, që edhe pas tri vjetësh të përfundimit të luftës jetojnë në tenda. Familja Thaçi dhe "gjeneralët" e tij kanë para të ndërtojnë pallate mbretrore, kanë para për të blerë vetura, çka ua kanë lakmi pasanikët zviceranë. Po besa kanë para për të blerë "intelektualë" siç i blejnë tregtarët në treg bagtinë, por nuk kanë para të japin për jetimët e luftës dhe për fëmijët e dëshmorëve, që aq shumë e keqpërdorën dhe e shfrytëzuan gjakun e derdhut të prindërve të tyre për të fituar pozita udhëheqëse, për të përvetësuar pasuri të huaj, për t'ua luluar me grada ushtarake që nuk i kanë merituar. Ata kanë kohë të merren me lloj-lloj aventurash por nuk kanë kohë të kontaktojnë me organizata humanitare për gjetjen e mundësisë për t'ua siguruar nga një shtëpizë bashkëfshatarëve të tyre që ende banojnë në tenda.

A nuk ishte vetë "Gjarpëri" ai i cili pasi u bë argat i Xh. Halitit shkatarroi çdo organizim të mbarë të shqiptarëve dhe, sot e kësaj dite, nuk dha kurrfar përgjigjeje për akuzat e bazuara se është i përzier në vrasjen e Ali Ukajt, Ahmet Krasniqit, Haki Imerit, Bekim Kastratit dhe Besim Dajakut. Drenica ia ka borxh Kosovës dhe Shqiptarisë t'ua uli

bishtin argatëve të Xh. Halitit në krye me H.Thaçin dhe t'u tregojë se nuk e kanë vendin në krye të vendit por pas dere, kur kanë pranuar të bëhën bajraktarë të farës ruse, kur kanë pranuar të bëhën dorë e huaj dhe rrogëtarë të spiunëve të serbit, rusit dhe grekut, të cilët kanë zënë pozita udhëheqëse në institucionet shtetërore të Shqipërisë. Drenica dhe Kosova nuk e kanë për nder t'iu dalin në krye komunistët, nanoistët, enveristët dhe bajraktarët e farës ruse, që baballarët e tyre shpirtërorë e përgjakën dhe e masakruan Drenicën dhe Kosovën, që nga 1944 e deri në ditët e sotit. Atentati i Skenderajt i organizuar para tri javësh nga bajraktarët e farës ruse dhe nga "gjeneralët e Hashimit" e përgjaku Drenicën dhe Kosovën, kur me tradhti dhe pas shpine ia vranë dy burra të fortë Kosovës, Bekim Kastratin dhe Besim Dajakun dhe e plagosën komandantin më të suksesshëm të UÇK-së pas Adem dhe Hamz Jasharit, Zahir Pajazitit dhe Salih Çekut, njërin ndër Shtatë Vëllazërit Geci, (që me të gjitha forcat luftuan për çlirimin e Kosovës) bashkëluftëtarin e Adem Jasharit, Gani Gecin, tregon se janë të pashpirt, janë të marrë, janë kriminelë kokëtrashë, janë tradhtarë të kombit. Ata i dëmtuan tri familjet që (kanë bërë emër) kanë zë të madh në Kosovë, Shqipëri dhe në Viset shqiptare për burrëri, trimëri dhe atdhetarizëm.

Sa iu përket premtimeve të R. Haradinajt M. Bakallit M. Kelmendit etj, duhet ta kenë të qartë se, për t'iu zënë besë se e kanë përnime, duhet të përgjigjën në këto pyetje: R. Haradini duhet opinionit të gjërë t'i tregojë se kush është komandant "Togeri" i cili në Dukagjin ka bërë krime kundër shqiptarëve. Të japë shpjegime se me urdhërin e kujt dhe kush e bëri zhdukjen e katër ushtarëve të UÇK-së që i përkisnin Brigadës "Mërgimi" të cilën e komandonte kolonel Tahir Zemaj. Ndërsa M. Bakalli duhet të tregojë se gjatë dhjetë viteve të robërisë më të egër serbo-jugosllave të përjetuar Kosova, ç'bëri ai që askund nuk iu dëgjua zëri? I pat njohur apo nuk i pat njohur institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, kur siç dihet ishte dhe është këshilltarë i ca komplotistëve që punuan me mish e me shpirt për shkatërrimin e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës. Dhe sot kur dëgjon premtimet e bajraktarëve të farës ruse e të rroghtarëve të tyre, habitesh që toka nuk hapet për t'i përbi në brendësinë e saj, për t'ua mbuluar turpin dhe për t'ua dhënë hakun, për shumë të liga që ia bënë dhe po ia bëjnë Kosovës.

Po qe se votuesit shqiptarë janë të vetëdijshëm se me çfarë rreziqesh ka qenë i detyruar të përballët kombi ynë gjatë periudhës së robërisë komunisto-bolshevike, në Shqipëri, Kosovë dhe Viset tjera shqiptare, me siguri vota e tij nuk do të shkonte në dobi të forcimit të bishtave të Partisë Socialiste të Shqipërisë, që patronët e tyre Xh. Haliti dhe I. Kelmendi për qëllime taktike dhe strategjike i pagëzuan me PDK dhe AAK. Me siguri vota e tyre do të shkojë në dobi të forcave institucionale të Republikës së Kosovës: LDK-së, PNDSH-së, PSHDK-së, PLK-së dhe PSDK-së. Atëherë me siguri ardhmëria e popullit tonë do të jetë e ndritur. Kosova do të fitojë pavarësinë e shumëpritur. Qytetarët e saj do të gëzojnë lirinë e zhuritur. Të drejtat e njeriut, dhe të drejtat e pakicave kombëtare do të respektohen. Do të ketë siguri, përparim, mirëqenie dhe begati për të gjitha shtresa e popullsisë. Kriminelët do të ulën në bankën e zezë për të dhënë llogarinë përfundimtare për krimet e bëra. Kosova dhe shqiptarët si komb do ta fitojnë të drejtën që u ka takuar qysh moti, për të jetuar të lirë, të pavarur dhe të barabartë me popujtë e lirë të Evropës së bashkuar demokratike.

*Shkruar më 11 nëntor 2001*

*Ky shkrim i është dërguar redaksisë së "Bota sot" në Prishtinë, por mbeti pa u botuar për shkaqe të paditura.*

## PSE PO LIHEN TË LIRË KRIMINELËT

Qendra e Krimit e krijuar në Kosovë nga pehllivanat e Nanosit, bajraktarët e farës ruse, agjencurat serbo-sllavo-greke, dhe mafija e kuqe ndërkombëtare, si shumë herë më parë gjatë këtij viti dhe viteve të mëparshme e përgjakën Drenicën, Kosovën dhe Shqiptarinë me atentatin e 19 tetorit të këtij viti kundër tre pjesëtarëve të ish UÇK-së, që me punën e tyre gjatë luftës dhe pas luftës, i dëmtuan interesat karrieriste të krerëve të forcave kundrainstitucionale të Kosovës dhe argatët e armiqve tanë shekullorë.

Qendra e Krimit këtë radhë me atentatin e Skënderajt, goditi përnjëherë tri vlera tona të çmueshme kombëtare dhe njerëzore: Me vrasjen e Bekim Kastratit dhe Besim Dajakut dhe plagosjen e Gani Gecit goditën vlerat më të çmueshme të Luftës çlirimtare të Kosovës, goditën bartësit e vërtetë të asaj lufte, që nuk patën sukses t'i manipulojnë gjatë luftës për t'i luftuar institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, dhe pas luftës nuk arritën t'i bindin për të zënë pozita udhëheqëse dhe pasuri të huaj.

Po dora e zgjatur serbe vrau Bekim Kastratin, ish- ushtarin e UÇK së, që e dashti lirinë dhe çlirimin e Kosovës më tepër se jetën dhe familjen e tij. Ai pas luftës vazhdoi punën e nisur. E dinte se pas çlirimit të Kosovës qytetarëve të saj i duhet liria e fjalës për ta thënë të vërtetën, dhe mu për atë edhe u punësua në gazetën kombëtare Bota sot, për të mbrojtur me trimëri Fjalën e Lirë në Kosovë, për ta thënë të vërtetën, për ta ndihmuar drejtësinë të ngadhënjë mbi gënjeshtren dhe shpifjen. Ai sa punoi në "Bota sot", ua grisi maskën e krimit dhe të tradhtisë kombëtare pehllivanave të Nanosit, argatëve të tyre dhe bajraktarëve të farës ruse. Ja pra se për çka ia shuan jetën tradhtarët e kombit Bekim Kastratit.

Po veglat serbe që u bënë bajraktarë të fares ruse në Kosovë, e vranë Besim Dujakun, që iu shpëtoi pa ia dhënë një plumb pas shpinës sa ishte luftëtar i UÇK-së. Kriminelët me vrasjen e Besim Dajakut, njërin prej anëtarëve të rojës personale të Kryetarit të LDK-së dhe Kryetarit të Republikës së Kosovës, Dr. Ibrahim Rugovës, goditën institucionin shtetëror: Presidencën e Republikës së Kosovës. Goditën shtetin dhe pavarësinë e Kosovës, goditën mundin dhe luftën e shumë gjeneratave për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar.

Pehlivanat e Nanosit dhe argatët e tyre e vranë Gani Gecin, por i Madhi Zot na e ruajti këtë Burrë të Dheut. Na e ruajti i Lumi Zot këtë pasardhës të denjtë të Bajraktarit të Llaushës. Na e ruajti të "përkëdhelurin" e Shtatë Vëllazërve Geci, si shpërblim për punën e tyre me përkushtim në realizimin e objektivave madhore kombëtare. Po i Madhi Zot na e ruajti nga më e keqja Gani Gecin, për ta vazhduar misionin e lartë njerëzor dhe kombëtar që i ka rënë hise ta ndriçojë të vërtetën e hidhur, t'i vejë në dukje të ligat e pehlivanave të Nanosit dhe të argatëve të tyre, që me anë të komploteve i përvetësuan njësitë guerile të Republikës së Kosovës. Gani Geci ishte, është dhe do të jetë në shënjestër të kriminelëve dhe tradhtarëve të Kosovës dhe të Shqiptarisë, vetëm pse ai dhe vëllazërit tjerë Geci i ruajtën dhe po i ruajnë me përkushtim vlerat kombëtare, trashëgiminë familjare të të parëve të tyre, që me trimëri i dolën zot Atdheut dhe Kombit, dhe po luftojnë me të gjitha forcat për realizimin e synimeve tona kombëtare.

Ky krim i kryer në zemër të Drenicës nga veglat e çetnikëve të Beogradit, duhet t'ua hapi sytë shqiptarëve kudo që janë, për ta parë rrezikun që i kanosej Kosovës me Vise, Shqipërisë dhe Shqiptarisë nga neokomunistë shqiptarë. Ata kanë mbetur të njëjtë. Nuk ka dallim në mes komunistëve shqiptarë të 1941-1948 që e mbollën farën ruse në truallin shqiptar, që e përgjakën Shqipërinë dhe Kosovën (në veçanti Drenicën dhe Gjilanin) dhe nanoistëve shqiptarë, që nuk lejuan bashkimin e faktorit politik dhe ushtarak të Kosovës, që prishën çdo organizim të mbarë që do të çonte në çlirimin e Kosovës nga vet shqiptarët, që shpifën, kërcënuan dhe vranë atdhetarë e veprimtarë të dalluar të çështjes madhore kombëtare dhe të njëjtën punë ende po e bëjnë, për ta marrë pushtetin e Kosovës me mjete dhune, ashtu siç e muarën mësuesët dhe patronët e tyre në krye me Nanosin, Mejdanin dhe Klosin në Shqipëri.

Këta djaj bolshevik e kthyen Shqipërinë në koloni greke dhe krijuan mafinë e kuqe ndërkombëtare në gjithë hapësirën tonë kombëtare. Të njëjtën gjë donë ta bëjnë edhe me Kosovën kryepehlivanët e Nanosit, bajraktarët e farës ruse dhe agjenturat e armiqve tanë shekullorë. Populli ynë fisnik si çdo herë më parë edhe në zgjedhjet e 17 nëntorit do të dijë se kend duhet votuar. Vota e tij do të vendosë se cilat forca do të fitojnë. Do të fitojnë forcat e së mirës, apo do të fitojnë forcat e së keqes, do të vendosë vota e tij e lirë. Populli ynë sot nuk e ka të vështirë të vendosë se cilës forcë politike duhet t'ia japë votën e tij. Nuk e ka vështirë nga fakti

se shqiptarët e të gjitha shtresave shoqërore gjatë viteve të fundit të shekullit të 20-të dhe fillimit të shekullit të 21-të u vetëdiferencuan dhe treguan me argumente të shumta se për çka punuan dhe vepruan, për cilat synime luftuan. Populli ka sy dhe veshë, ai sheh dhe vëzhgon e vlerëson. Ai e ka syrin kandar. Syri i tij kurrë nuk mashtrohet. Dhe sot kahdo që të lëvizë njeriu nëpër Kosovë e ka të qartë se kush punoi për interesat e Kosovës dhe popullit të saj, e kush luftoi për interesat personale grupe dhe klanore. Kriminelët i kanë ditët e numëruara në Kosovë. Fitorja e forcave institucionale demokratike të Republikës së Kosovës me në krye LDK-në, do t'u sjellin qetësi shpirtërore, siguri dhe lirinë e vërtetë qytetarëve të Kosovës, ndërsa kriminelët do ta marrin dënimin e merituar.

*Botuar: "Bota sot" më 26 tetor 2001*

## KAPITULLI I TRETË

### III. KAH PO SHKON KOSOVA?

## KAH PO SHKON KOSOVA

### INTERVENIMI I NATO-S NË GADISHULLIN ILIRIK BËRI QË SKENARËT SERBO-GREKO-RUSË PËR ZHDUKJEN E KOMBIT SHQIPTAR TË DËSHTOJNË

Lufta në mes të mirës dhe të keqes, lufta në mes të shëmtuarës dhe të bukures e përcjellën njerëzimin këmba këmbës, që kur i Madhi Zot e krijoi njeriun, njërën ndër shumë mrekullitë e kësaj bote. Shumë popuj u zhdukën nga faqja e dheut si pasojë e luftës së ashpër që u zhvillua në mes këtyre forcave të pa pajtueshme në mes vedi. Populli ynë shpëtoi nga më e keqja (zhdukja) në saje të përpjekjeve të tijë të vazhdueshme për të mundur të keqen, por mbi të gjitha, ndihma e të Madhit Zotë bëri që fuqitë e mëdha të botës të na gjinden krah për krah në momentet më të vështira, kur na kanosej qenja e jonë fizike dhe kombëtare nga çakajtë e uritur të Gadishullit Ilirik.

Shqiptarët dhe shqiptaria si shumë herë më parë, edhe tash gjenden në një udhëkryq historik. Se cilën rrugë do ta marrin shqiptarët ende nuk është e qartë. A do të marrin rrugën që qon në forcimin e faktorit shqiptar në Gadishullin Ilirik, në krijimin e shtetit të dytë shqiptarë në Evropën Juglindore, dhe krijimin e kushteve dhe rrethanave të bashkimit të tij kombëtarë, apo do të vazhdojë rrugën e nisur para dy mij vjetëve, që na katandisi në këtë gjendje të mjerë, mëvaret prej shumë faktorëve. Faktorit i jashtëm kurrë më parë nuk ka qenë më i favorshëm se sot për popullin tonë, por a do të jetë ai në favorin tonë apo nuk do të jetë, mëvaret nga klasa politike shqiptare dhe paria e tij, se a do të jetë e aftë t'i qojë përpara proceset e mëkëmbjes së shqiptarëve si komb, apo do të vazhdojë si deri më tani "dikush thumbit dikush patkonit". Po qe se edhe më tutje forcat majtiste dhe forcat demokratike –djathtiste nuk e ndryshojnë rrënjësishtë politikën e tyre të deritashme, çështja shqiptare përfundimisht do të zgjidhet në favor të interesave të çakajve të ballkanit. Shqiptarët do të katandisen si është më zi. Ata do të jenë të detyruar të zgjedhin njërën nga dy të këqijat. Të bëhën materjal ndërtimi për popujt e plakur të Evropës, apo do të shëndërrohen në rrogatë apo skllëvër të çakajve të Ballkanit.



Intervenimi i fundit i NATO-s në Gadishullin Ilirik bëri që planet dhe skenarët serbo-greko-ruse për zhdukjen e kombit dhe faktorit shqiptar të dështojnë. Por siç dihet, armiqët e kombit tanë kurrë nuk e kanë ndaluar veprimtarinë e tyre që të na dëmtojnë me të gjitha mënyrat. Tani ata me ndihmën e forcave majtiste shqiptare : PSSH, PDK-së, AAK-së, etj, janë në turrin më të madh për të na kompromituar para botës se gjoja ne "nuk jemi të aftë as të bëjmë dhe as të mbajmë shtet". Kthimi i Shqipërisë në një koloni greke dhe në një qendër të krimit të organizuar politik, ekonomok dhe mafioz, është ndihma më e madhe që i është bërë ndonjëherë qendrave antishqiptare, Moskvës, Athinës dhe Beogradit nga vetë "shqiptarët". Krimi i organizuar politik, ekonomik dhe mafioz që po bëhet sot në Kosovë nga organizata gjysmë ilegale, SHIK-u, që e krijoi "Qeveria e Thaçit" sëbashku me pararojën staliniste të ish LPK-së, me karrieristët e sëmuar për pushtet të LBDK-së, dhe ekspertëve të SHIK-ut të Shqipërisë, është ndihma më e madhe që po i bëhet Serbisë dhe armiqve tjetër të kombit tonë.

### **Pse po lejojmë të na përseritet historia?**

Shtrohet pyetja : Ç' po ndodhë me ne? Pse po lejojmë të na përseritet historia? Pse paria shqiptare nuk mori dhe nuk po merrë përvojë nga e kaluara e hidhut e popullit tonë?! Si është e mundur që të përputhën aq shumë ngjarjet historike që ndodhën gjatë Luftës së Dytë Botërore me ngjarjet që ndodhën në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit të 20-të dhe po ndodhin në fillimit të shekullit 21. Siç dihet, komunistët serbo-jugosllav dhe vazalët e tyre shqipfolës e formuan "Partinë Komuniste Shqiptare" më 1941 në Tiranë, ndërsa nanoistët kosovarë me udhëzimin e Nanosit dhe Klosit (PSSH) u bënë ndriklla duke i pagëzuar njësitë guerile të Republikës së Kosovës që i komandonin Adem Jashari, Salih Çeku dhe Zahir Pajaziti me "UÇK", dhe më vonë me mjetet e "marrjes së kalasë nga mbrenda", ato njësi i përvehtësuan, me qëllim që forcat demokratike që i kishin vu themelet e shtetësisë së Kosovës të përjashtohën nga pjesmarrja në Luftën Çlirimtare. Dhe kështu planifikonin mendjeshkurtërit, se në rrethanat që do të krijohën në Kosovë pas intervenimit të faktorit ndërkombëtarë, ata do ta marrin pushtetin mbi shqiptarët. Nanoistët kosovarë e kishin të trasuar rrugën e tradhtisë kombëtare, sepse në përpikëri ju përmbajtën "Rrugës së Partisë" së Enver

Hoxhës. Ashtu siç vepruan partizanët e Enverit, vepruan edhe LPK-istët e Xh. Halitit dhe LBDK-istët e Qosjes dhe Hysenit. Nuk donin bashkëpunim me partitë institucionale, por donin "bashkëpunim" me individ të këtyre subjekteve politike. Ashtu siç i tradhtoi forcat demoktatike (djathtiste) të Shqipërisë E. Hoxha me Marrëveshtjen e Mukjes, ashtu i tradhtuan forcat institucionale të Kosovës nanoistët e LPK-së dhe të LBDK-së me Marrëveshtjen e Osllos. Ashtu siq u shkel marrëveshtjea e Mukjes, që i bashkonte të gjitha forcat shqiptare për çlirim dhe bashkim kombëtarë, ashtu u shkel edhe marrëveshtja e Osllos, që i vuri themelet e bashkimit të të gjitha forcave ushtarake dhe politike të Republikës së Kosovës. Ashtu siç i vranë me pabesi dhe pas shpine atdhetarë dhe ushtarakë nacionalistë banadat kriminele të E. Hoxhës, ashtu i vranë pas shpine dhe duke i qitur në pritë të shkaut, ushtarakët dhe luftëtarët që nuk i përkisnin kopesë së pararojes staliniste të LPK-së dhe karrieristëve të sëmuar të LBDK-së. Edhe pse nanoistët kosovarë me veprimet e tyre ndihmuan realizimin e skenarëve serbë për pastrimin etnik të Kosovës, i Madhi Zot dashti që planet serbe të mos realizohën, kur e detyroi fuqinë më të madhe ushtarake të kësaj bote NATO-n t'i përzen nga Kosova hordhitë serbe. Siç dihet bandat e E. Hoxhës i masakruan burrat më të mirë të kombit, duke vu pushtetin stalinist në Shqipëri, të njëjtën gjë e bëri "Qeveria e Thaçit" me "xheneralët" e Xh. Halitit dhe rrogtarët e tyre, pas largimit nga Kosova të forcave policore dhe ushtarake serbe. OZN-a jugosllave ia krijoi E. Hoxhës "Sigurimin", që u bë "arma e partisë" së tij. Ky fëmijë i OZN-ës jugosllave bëri shumë krime në Shqipëri, duke vrarë nacionalistë dhe duke ia vrarë kundërshtarët politik Enver Hoxhës dhe bandës së tij.

Kryekuqaloshët e Kosovës mbetën pa Enverin, por amanetin e tij e qoj në vend Nanosi, i cili u kujdes që kuqaloshët e Kosovës ta kenë "Sigurimin" e tyre. Nanosi në bazë të obligimeve që i kishte marrë kur u nënshkrua Marrëveshtja e Zyrihut në mes krerëve të PSSH-së dhe të LPK-së më 1993, ua krijoi SHIK-un kryekuqaloshëve kosovarë (Qendren e krimin), që u vu nën komandën LPK-së dhe pastaj edhe të LBDK-së. (Qosjes, Halitit, Hysenit, Thaçit, Haradinajt, Remit, etj.)

**VRASËSIT E KOSOVËS JANË KRIJESA PA KOMB, PA ATDHE DHE PA FE, ASHTU SIÇ I KA MËSUAR LENINI DHE STALINI**

Ashtu sikur që Enveri e mori pushtetin me dhunë pas përfundimit të luftës, ashtu Nanosi & Kompani e rimuarën dhe po e mbajnë pushtetin

me dhunë. Të njëjtën gjë po mundohën ta bëjnë edhe nanoistët e Kosovës, edhe pse populli ua tregoi me votën e tij të lirë se ku e kanë vendin. "Qeveria e Thaçit" nuk pati mundësi të vras me mija shqiptarë, siq vrau Enveri në fillim të sundimit të tij, sepse forcat e KFOR-it nuk i lejuan, por për një kohë të shkurtër e pruri sistemin e Rankoviçit në Kosovë. Populli me votën e tij të lirë ua dha denimin e merituar enveristëve, stalinistëve, nanoistëve, titistëve, por këto forca të djallit, këta llumperploretarë, po i përdorin të gjitha mjetet për ta dënuar Kosovën, për ta dëmtuar popullin e saj duke i vrarë bijtë më të mirë të kombit.

Kryekuqaloshët, nanoistët, stalinistët, të padijshmit, qyqarët, sahanlëpisët, pakurrizorët dhe dështakët e Kosovës donë ta marin pushtetin në Kosovë me mjete të dhunës ashtu siç e muar Nanosi me kompani më 1997, por nuk e kanë të qartë të gjorit se me krimet që po i bëjnë në Kosovë, po ju ndihmojnë armiqëve tanë shekullorë në kopallat e tyre se "shqiptarët janë popull jo shtetformues". Ata po i pengojnë miqtë tanë për të na ndihmuar që sa më parë ta jetësojmë pavarësinë e Kosovës. Por kunistët dhe nanoistët shqiptarë me fakte të shumta kanë treguar dhe po tregojnë se ata janë qenie hibride, kanë shpirtë llumperperproletari, dhe se nuk kanë nevojë dhe nuk ju duhet shteti ligjor. Janë krijesa pa kombësi, pa atdhe dhe pa fe, ashtu siç i ka mësuar Lenini dhe Stalini.

Është për t'u habitur që kriminelët e kuq nuk kanë mësuar asgjë nga historia njerëzore dhe ajo shqiptare. Pse nuk marrin mësim së paku nga pjesa e fundit e jetës së babai të tyre shpirtëror Enverit? Siç dihet ai pasi i vrau shokët e tij më të ngusht, i Madhi Zot e çmendi, dhe pasi ia muar shpirtin, nuk e la të qetë as në varr. Edhe krimineli tjetër Mehmet Shehu pati një përfundim që e meritoi. Shoku më i ngusht i tij Enveri e vrau, apo e detyroi ta vrasë veten, dhe pastaj e hudhi në "plehrat e historisë".

Kriminelët e kuq shqiptarë duhet të kuptojnë, se, edhe pse po kanë sukses t'i frikësojnë ca individë të dobtë, ata kurrën e kurrës nuk do të arrijnë ta frikësojnë tërë një popull, për t'i detyruar t'ua japin votën, që pastaj t'u hypin në shpinë dhe t'i konsiderojnë rob. Populli shqiptarë është i zgjuar, është trim dhe fisnik. Ai diti t'u përballojë shumë fortunave, që ishin shumëfish më të fuqishme dhe më të forta se kjo

furtuna e kuqaloshëve dhe nanoistëve të Kosovës, që e ka burimin nga Beograpi, Athina dhe Moska.

Por mos harroni o të gjorë, o llumi i kombit shqiptar, se ato qendra antishqiptare nuk e kanë më fuqinë që e kishin më parë, kur populli ynë, edhe pse i pa shkollë dhe i dobët nga pasuria, përballej me ta, me trimëri dhe zgjuarësi, dhe dilte gjithmonë faqebardhë.

Ju o mendjeshkurtër, ju turpi i kombit, ju o tradhtarë, që nëpër ndeja rrahshi gjoks se "jemi patriotë", se e keni luftuar "titizmin dhe Jugosllavinë", në momentet kur Atdheu ngulfatej nga llumperploretarët e Shqipërisë dhe dora kriminele e serbit dhe grekut më 1997, juve ua "piu sorra mentë" dhe kaluat në taborrin e armiqve tanë. E atëherë kur Shqipërinë e veshët në të zeza, u vutë në shërbim të spiujve serbo-rus në Kosovë.

## KRIMINELËT E VRAN TAHIR ZEMËN DUKE MENDUAR SE DO TA VRASIN TË VËRTETËN

I vratë institucionet shtetore të Republikës së Kosovës, shkatërruat dhe nuk lejuat kurrfarë organizimi të mbarë, që do të qonte në çlirimin e Kosovës dhe viseve shqiptare nga vet shqiptarët. Filluat me krime, siç filloi babai i juaj shpirtëror Enveri, me Ali Ukën, i cili u mundua t'ju ndalë nga rruga e tradhtisë kombëtare. I vratë pastaj me tradhti dhe pas shpine me dhjetëra burra të fortë të shqiptarisë dhe arrijtët ta pushkatoni më në fund ushtarakun më të aftë që e kishte Kosova kolonel Tahir Zemën, me djal dhe nip, i cili ua tregoi serbëve se kur shqiptari është i organizuar, dhe çdokush e kryen punën që i takon, sipas aftësisë dhe dijes, nuk ka kush që i del përpara, nuk ka kush që e mund në luftë.

Ju o tradhtarë, ju o kriminel të kuq, ju fundrina të kombit shqiptarë, ju që u bëtë dorë e zgjatur e Serbisë, po tregoni se jeni frikacakë, jeni edhe të marrë! Jeni pa shpirt edhe katilë! Jeni farë e huj! Jeni farë e prishur! Jeni farë ruse, jeni zogj shkau, se shqiptari s'e ka pasur kurrë zakon të bëjë vrasje pas shpine! Kësò vrasjesh ka bërë vetëm "cërrna ruka" serbe, për t'ia vrarë Shqipërisë burrat më të fortë të kombit, por tani këtë punë shkau po e bëni ju! Ju jeni të mallkuar! Ju do të jeni farë e sosur! Ju do ta merrni denimimin e merituar prej drejtësisë së shtetit të Kosovës! Ju do ta merrni pastaj edhe denimin sipas kanunit të Lekë Dugagjinit! Por mos harroni se kjo jetë është shumë e shkurtër. Ju do ta merrni denimin më të madh edhe prej të Madhit Zot, në këtë botë dhe në

botën tjetër. Të mjerët ju! Mjerë nëna çfarë pjelle rriti, mjerë shtëpia, mjerë vendlindja që ju rriti! Mjerë Kosova, mjerë kombi, mjerë toka që ju mbanë! Ju e vratë kolonel Tahir Zemën me djal e nip, duke menduar se do ta vrani të vërtetën që ai e qiti në dritë! Jeni mashtruar keq o kriminel të gjorë! Tahir Zemës ia dhatë përjetësinë. Ai ishte luftëtarë i suksesshëm i shqiptarisë para se e vratë, tani u bë hero, se dorë e zgjatur e Serbisë e vrau. Shqiptarët janë ende në luftë. Shqiptarët në Kosovë janë në luftë me Serbinë dhe me klyshët e saj! Nuk ka dallim në mes shkaut dhe argatit të tij shqipfolës. Njësoj është të vrau shkau apo argati i tij! Shqiptarët në Shqipëri janë në luftë që një gjysmë shekulli me llumperploretarë, që u bënë argatë dhe klysh serbë, rusë dhe kinezë. Prej vitit 1997 Shqipëria është në luftë me grekun, argatët e grekut dhe argatët e shkaut. Shqiptarët në Maqedoni janë në luftë me sllavët, llumperploretarë dhe me argatët e tyre. Edhe në viset tjera shqiptare shqiptarët janë ngusht prej klyshëve serbë dhe malazez. Tahir Zemaj u vra nga një dorë e zgjatur serbe. Edhe urdhëri për vrasje erdhi nga Qendra e krimit (SHIK-u) që e komandojnë spiunët serbo-rusë. Ai e ka ditur se edhe mund të vrahët, por ai s'e bëri hesap as vrasjen, as vstarët! Ai kurrë nuk u frikësua nga kriminelët edhe pse shpesh e kërcnuan dhe disa herë tentuan ta vrasin! Burrat e mëdhenjë nuk i frigohën vdekjes dhe as nuk i frikohen armikut! Ai me vepra tregoi se ishte një trim që nuk i gjindet shoku. Mu për atë kriminelët e gjorë nuk patët guximin t'i dilnin përpara, por e vranë me tradhti dhe pas shpine! Ai me vepra tregoi se ishte burrë i fortë i shqiptarisë. Po, Kolonel Tahir Zemaj tregoi në Betejën e Logjës, në Betejën e Llukës dhe në mbrojtjen e popullësisë civile nga masakrat serbe, se ishte edhe strateg dhe ushtarak shumë i zoti. Tahir Zemaj pas çlirimit të Kosovës i ra asaj kryq e tërthuar, duke i ndriçuar shumë të vërteta, që ishin shumë të rëndësishme për të fituar e vërteta mbi të pavërtetën, për të fituar drejtësi mbi tradhtinë, dhe as që i bëri hesap kriminelët se janë të gjallë. Ai nuk u muar me shpifjet e shpifarakëve që villnin nga goja helm, ndytësira dhe qelbësira, që kishin për qëllim ta njollosin Komandantin e dëshmuar si më i suksesshmi në luftën frontale me Serrbinë. Po kolonel Tahir Zemaj nuk deshë të bëjë marrëveshje me gjarpërinj, hardhuca, dhëlpëra, kryma, këlyshë dhe zagarë, që punonin për interesa personale dhe klanore në dëm të interesave madhore kombëtare, se kishte vetëdije të lartë kombëtare dhe e dinte se qysh formohet ushtria dhe shteti! E dinte mirë ushtaraku madhor i Republikës së Kosovës se si mund të çlirohej Kosova dhe të fitohën

beteja, por këlyshët e nanosit e pengonin.

Ishte i singertë, ishte zemërgjërë, ishte i drejtë dhe ballhaput. E thonte atë që e mendonte pa ngurrim. Ishte i dashur dhe i rrespektuar nga ushtarët, kolegët dhe shokët e tij për virtytet që i kishte. Kishte zemër të madhe. Ishte Lis i Madh Kosove dhe me rrënjë të thella në tokën mëmë. Ai nuk veproi siç vepruan këlyshët e Nanosit që e nxitnin ushtrinë dhe policinë serbe për t'i kallur fshatrat shqiptare me topa dhe mortaje, duke i shkrepur disa rafalle në drejtim të tyre dhe pastaj iknin si lepuj përpjetë maleve. E kundërta e tyre komandant Tahir Zemaj i detyroi serbët të iknin në Betejën e Loxhës dhe në Betejën e Llukës.

**POLICIA NDËRKOMBËTARE DUHET TË ÇRRËNJOSE NGA KOSOVA KRIMIN E ORGANIZUAR**

Është për t'u habitur që ende nuk po e kuptojnë nanoitët dhe stalinistët e Kosovës se me krime nuk do të realizojnë kurrë ëndrrën e tyre për ta marrë pushtetin me mjete dhune. Kjo tregon se sa të marrë, të mjerë dhe kokëbosh janë. Po të kishin vepruar ndryshe pasi përfundoi lufta, po të kishin vepruar me urtësi dhe me drejtësi, edhe pse bënë tradhti kombëtare (para luftës dhe gjatë luftës,) duke i kërkuar falje popullit, me siguri populli do t'i falte, dhe besa do t'ua jepnin edhe votën për ta qeverisur Kosovën. Këtë gjë nuk e bën, dhe as që kanë mundur ta bëjnë se në krye i patën dhe i kanë spiunët serbo-ruso-grekë. Prandaj këta nuk mund të kthehen më mbrapa. Me siguri këta të gjorë do të futën edhe më thellë në shamakun e trashtisë kombëtare deri sa të ngulfatën në ujrat e zeza, apo do të bëhen "hakubeta" të vdekur për së gjalli.

### **Atdheu po masakrohet nga vampirët komunistë!**

Ka ardhur momenti i fundit që shqiptarët që kanë vetëdije kombëtare, kudo që janë në Atdhe apo jasht Atdheut, të bëjnë që është e mundët për të mirën e kombit. Kombi është në rrezik! Atdheu po masakrohet nga vampirët komunistë! Çdokush duhet ta kryejë punën që mund ta kryejë në të mirë të ardhmërisë së fëmijëve tanë. Me këto vrasje që po i bëjnë tradhtarët e kombit, po ja përgadisnin humnerën kombit shqiptarë. A thua edhe pas gjithë këtyre vrasjeve LDK-ja nuk do të merrë masat e duhura për mbrojtjen e udhëheqjes dhe aktivistëve të saj. Athua edhe pas gjithë këtyre vrasjeve të burrave më të mirë të kombit, një numër i konsiderueshëm i intelektualëve do të vazhdojnë të qëndrojnë

antarë apo udhëheqës në bishtat e Partisë Socialiste të Shqipërisë që u krijuan në Kosovë (PDK-ja dhe AAK-ja). A thua shumë burra dhe vasha që nuk i përkasin subjekteve politike shqiptare, do të bëjnë "seri" me këto skena trishtuese të vrasjes pas shpine, të atdhetarëve dhe veprimtarëve që punuan për shqiptari? A thua rinia jonë heroike pas gjithë këtyre krimeve që po bëhen në Kosovë do të mbetet e painteresuar për pasojat që do t'i ketë Kosova dhe çështja madhore kombëtare?!

Arsyeja e shëndoshë, mendje dhe logjika e shëndoshë, dhe shpirti liridashës i shqiptarëve do të bëjë mrekullira, ku njëra ndër të parat do t'i vërë në lëvizje shqiptarët për ta ndaluar këtë të keqe, për ta ndaluar këtë tragjedi, që po i përgaditet popullit tonë të shumëvujtur të Kosovës. LDK-ja sa më parë duhet ta krijojë pararojën, e cila do ta mbrojë udhëheqjen e saj. Ajo duhet të ketë burime financiare të mjaftueshme për aktivitete politike dhe aktivitete mbrojtëse, por edhe për aktivitete humanitare, që të kujdeset për familjet e veprimtarëve të saj që i pushkatoi shkau me dorën tradhtare shqiptare. Ndërsa antarët dhe udhëheqësit e dy bishtave të Partisë Socialiste Shqiptare (PDK-ja dhe AAK-ja) që janë të ndershëm dhe ia donë të mirën Kosovës dhe kombit shqiptarë duhet të kërkojnë diferencimin e antarëve të partive ku gjindën, dhe të kërkojnë largimin nga partia të frymëzuesve dhe urdhëruesve të krimit politik dhe ekonomik që po e shëmtojnë Kosovën dhe shqiptarinë. Po qe se nuk kanë sukses të arrijnë ndryshime rrënjësore në të mirë të stabilitetit dhe të sigurisë së Kosovës, në partitë ku veprojnë, atëherë nuk ju mbetet tjetër përpos të zgjedhin, të mbesin edhe më tutje të "burgosur" në partitë ku prodhohet krimi i organizuar, dhe të jetojnë jetën e një robi, të një krijese që është i vdekur për së gjalli, apo të largohen, dhe të jetojnë me faqe të bardhë, duke bërë përpjekje që kriminelët ta marrin dënimin e merituar. Rinia jonë heroike, që kombit i dha trima për të luftuar për ideale madhore kombëtare, do t'i japë edhe më tutje kombit burra të zot, që do të gjejnë forma të nevojshme për t'i shkatërruar qerdhet serbo-rusogreke që janë formuar dhe po veprojnë në gjithë hapsirën tonë kombëtare. Edhe populli më nuk do të jetë vetëm "kamerë e msheft" për t'i përcjellë se çka po bëjnë ata që i kanë dalur në ballë të oxhakut, por do të bashkëpunoj me KFOR-in, policinë ndërkombëtare dhe policinë e vendit, për t'i lajmëruar keqbërësit, dhe kriminelët të pjellës së tij, që janë bërë argatë të shkaut.

Nuk guxon të ndodhë si deri më tash që njeriu të vrahët në pikë të ditës, pata syve të botës, apo para pragut të shtëpisë dhe fqinjët, qytetarët dhe kalimtarët e rastit, të mos i japin shënime policisë se çka kanë parë, apo të rrefuzojnë të dëshmojnë për atë që kanë parë. Vetëm atëherë kur qytetarët e Kosovës bashkëpunojnë me policinë për t'i qitur para drejtësisë keqbërësit dhe kriminelët e Kosovës, kemi të drejtë morale dhe ligjore të kërkojmë nga policia që të na i qet para drejtësisë, për ta marrë denimin e merituar kriminelët e vegjël-dorasët, dhe kriminelët e mëdhenj me kravata kuq e zi, që po blejnë kriminelë të gjorë për të na e vrarë ardhmërinë e Kosovës, për të na vrarë lirinë e shqiptarëve, për të na e vrarë pavarësinë e Kosovës.

### **Cilët janë qëllimet e qendres së krimit në Kosovë të dirigjuara nga UDB-ja e Tiranës dhe UDB-ja e Beogradit?**

Po qe se Kosova edhe më tutje përgjaket nga dora e zgjatur serbe, siç u përgjak deri tash. Po qe se nuk zbulohet qendra e krimit, që policia ndërkombëtare e ka lehtë ta gjejë, kur dihet se Hashim Thaçi e "shuajti"veprimtarinë e Qeverisë së tij, por ai kurrë nuk e shuajti veprimtarinë e SHIK-ut. Ndërkombëtarët duhet t'i kërkojnë nga Xh. Halitit (që është padroni i PDK-së dhe i SHIK-ut), H.Thaçit që është argati më besnik i Halitit, dhe R. Haradinut, që edhe ai e ka nën komandën e tij një klan të SHIK-ut, emrat e udhëheqjes qendrore dhe lokale të SHIK-ut që e krijuan në Kosovë ekspertët e UDB-ës së Tiranës dhe strategët e UDB-ës së Beogradit. Vetëm atëherë kur policia ndërkombëtare dhe ajo e vendit do t'i ketë shënimet e duhura për këtë organizatë gjysmëlegale, dhe disa tjera që kjo i bëri krejt ilegale, mund të shpresohet se krimi i organizuar do të çrrënjohet nga Kosaova.

Populli na mëson se "çka ndodhë te fqija prite te shpija", prandaj vetëm një zemër e zezë mund të pajtohet me padrejtësinë, me dhunën dhe krimin. Dhuna mjell dhunë, por dhuna ndalohet vetëm me dhunë. Ta lusësh kriminelin që të mos bëjë dhunë, të mos bëjë krime dhe të mos vrajë njerëz, arrihet efekt i kundërt me atë që dëshërohet, sepse aspak nuk i zbutet zemra katran kriminelit, por ia forcon, për të bërë edhe më shumë krime. Gjeniu popullor na mëson se helmi e lufton helmin, të ftoftit e hjek të ftoftit, të nxehtit e largon të nxehtit. Kriminelët duhet t'i qesim para drejtësisë. Kështu siç vepruam deri tash, duke menduar se



kriminelët do t'i zbusim me vaj, dhe me lutje, u treguan të pasuksesshme, qesharake dhe shumë të dëmshme. Sa më parë që të organizohemi në luftë kundër krimit të organizuar, aq më mirë. Vetëm të bashkuar në luftë kundër krimit të organizuar, mund të dalim fitues ndaj kësaj të lige të shëmtuar, që ia qiti futën Kosovës, dhe po e ndihmon propagandën serbo-greke se shqiptarët janë "destabilizues të Ballkanit", nuk dinë të "bëjnë dhe të mbajnë shtet" dhe kopalla tjera si këto.

Sot kur shqiptarët (e Kosovës) gjenden para një prove të rënd para faktorit ndërkombëtar, për të treguar aftësitë e tyre qeverisëse, është detyrë mbi të gjitha detyrat që klasa politike t'i rishqyrtojë veprimet e deritashme. Intelejencia e lartë të mos rrijë e pa interesuar për proceset çoroditëse të një pjese të klasës politike, që kanë uzurpuar pozita udhëheqëse (dhe pasuri shoqërore dhe private), dhe po bëjnë krime të llojllojshme, por të kyçen në jetën politike ku jetojnë dhe punojnë, për ta ndryshuar këtë situat tejet tragjike, në të mirë të çështjes sonë kombëtare, në të mirë të qytetarëve të Kosovës.

Po qe se institucionet shtetërore të vendit dhe ato ndërkombëtare dhe forcat demokratike në Kosovë do të vazhdojnë punën e deritashme, "fol e mos luaj nga vendi" duke bërë sehir dhe duke i vështruar rrënuesit e themeleve të demokracisë, shtetësisë, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, dhe nuk do të marrin asgjë konkrete për ta penguar atë dorë katile, që aq shumë po na i dëmtojnë interesat tona kombëtare, Serbia dhe aleatët e saj do të realizojnë skenarin e tyre antishqiptar, skenar shumë perfid dhe shumë i rrezikshëm për pengimin e realizimit të synimeve tona kombëtare, që kanë për qëllim destabilizimin dhe dështimin e faktorit ndërkombëtarë në Kosovë. Me formimin e Qendrës së krimit në Kosovë nga UDB-ja e Tiranës dhe UDB-ja e Beogradit, qendrat antishqiptare kanë për qëllim që popullin e shumëvuaftur të Kosovës ta gjunjëzojnë me varfëri, skamje, dhunë, krime politike dhe ekonomike. (të llojllojshme). Dhe si rrjedhim skenari serb i parasheh këtë rezultat. Ndarjen e Kosovës, apo futjen e Kosovës nën sqetullat e saj, në bazë të kërkeses së një pjese të popullësisë së dëshpruar nga lulëzimi i krimit politik dhe ekonomik, që Beogradi të vijë në Kosovë për ta luftuar atë dhunë. Siç dihet Beogradi edhe në të kaluarën kur klyshët e tij zbuloheshin dhe bëheshin " batall " i zëvendësonin me të tjerë, duke i hudhur të parët si lecka apo liman i shtrydhur në bërlllok Serbia nuk e ka vështitë t'i largojë spiunët e saj nga Kosova që po bëjnë krime të llojllojshme, për të fituar të drejtën që edhe

një herë Kosovën ta pushtojë, sepse nuk do ta ketë vështirë që ata t'i zëvendësojë me të tjerë të moderuar, kur dihet se këta spiunë që na i pruri Serbia në Kosovë nepërmjet Nanosit, janë spiunët më të ndyrë dhe më të pashpirtë, shumë më kriminelë se sa rankoviqistët barbarë. Varianti i dytë : destabilizim të Kosovës, ku shqiptarët do të detyrohën të kërkojnë strehim politik në Evropën Perendimore, për t'u mbrojtur nga dhuna e vanpirëve të kuqë, ndërsa Kosova do të vazhdojë të përgjaket nga kriminelë të kuq shqiptarë dhe kriminelë të zi serbë, si u masakrua edhe më parë, gjatë sundimit të Rankoviqit, Titos, Fadilit, Bakallit.

Shqiptarë kudo që jeni, shpëtonie Kosovën! Shpëtonie Shqipërinë! Shpëtoni Viset shqiptare, se armiqtë tanë shekullor po na përgadisin mjegull, terr dhe dimër. Po na përgadisin helme, sëmuarje kanceri. Po na përgadisin kurrthe! Po na përgadisin humnera!

*Botuar: "Bota sot", më 12.04-14.01.2000*

## PSE KA KRIM TË ORGANIZUAR NË KOSOVË DHE A MUND TË ÇRRËNJOSET AI NGA TROJET TONA ETNIKE?

Me çlirimin e Kosovës dolën në shesh shumë dukuri të shëmtuara si pasojë e robri së dyfishtë komunisto-serbojugoallave që më parë nuk egzistonin në shoqërinë shqiptare. Duke marrë për bazë traditën, zakonet dhe trashëgiminë tonë kulturore, krimi i organizuar që po lulëzon në gjithë hapsirën tonë kombëtare, është e keqja dhe e liga më e madhe që e ka goditur kombin tonë. Është futa e zezë që po e nxin çdo shqiptar, është kulmi i çmendurisë dhe degjenerimit shqiptar.

Çka po ndodhë me ne shqiptarët, është pyetja më e shpeshtë që dëgjohet ndër shqiptarë (në këto vitet e fundit), kur mjetet e opinionit publik lajmërojnë për vrasjet që bëhen sot në gjithë hapsirën tonë kombëtare, nga dorasë të porositur profesionistë. U vranë dhe po vriten atdhetarë, veprimtarë e Burra të Dheut, por edhe gra, djem, vasha e fëmijë, që në momentin e egzekutimit gjendeshin së bashku me ta. U rrëmbyen dhe po rrëmbehen fëmijë e vasha për t'ia shitur mafisë ndërkombëtare. U helmuan dhe po helmohen dhe çoroditen të rinj dhe të rritur në forma të ndryshme. U kërcnuan dhe po kërcënohen, por edhe po blehen si bagëti, persona e personalitete nga mafia e kuqe shqiptare.

Se armiqtë tanë po punojnë kundër interesave tona, siç kanë punuar edhe më parë, është e ditur dhe normale, kur dihet se të gjithë popujt e shtypur, edhe pse e kanë fituar "pavarësinë", nuk po mundin të ecin me këmbët e tyre, se okupatorët i lënë krimbat dhe këlyshët e tyre, kur u detyrun të ikin nga vendet e huaja. E njëjta gjë ka ndodhur dhe po ndodh me ne shqiptarët që 20 shekuj. Vazalë e tradhtarë, krimba e këlyshë, që punuan për të huaj, pati në vazhdimësi atdheu ynë. Dhe çka është më e keqja, këta degjenerikë na u bënë dhe po na bëhen "të parë", "shtetarë", "çlirimtarë", "shpëtimtarë", edhe pse ishin dhe janë dorë e zgjatur dhe rrogatë të çakajve të Ballkanit dhe aleatëve të tyre. Ne shqiptarët e ndarë dhe të përçarë, ne shqiptarët e robëruar e të sëmuar nga shumë sëmuarje kronike si komb, nuk mund të ecim përpara dhe as të ndryshojmë gjendjen tonë në të mirë, përderisa të "mos e ndryshojmë vetveten", përderisa të mos i luftojmë me të gjitha mënyrat kriminelët e

mëdhenjë (politikanët që japin urdhrin për krime) dhe kriminelët e vegjël(dorasit e mjerë) që po manipulohën nga qendra e krimit.

Shtrohet pyetja : a mundemi apo nuk mundemi ta luftojmë krimin e organizuar ne shqiptarët që po e quajmë veten"nacionalistë", "nacionaldemokratë", "djathtistë", "forca demokratike", në mënyrën siç vepruan më parë këto forca, dhe siç po veprojnë sot. Përgjigjja gjithsej do të jetë negative për këto arsye : Derisa forcat antishqiptare (forcat e krimit të organizuar) kanë një qendër komanduese (nga sigurimet e mshefta serbo-ruso-greko-shqiptare) që veprojnë në gjithë hapsirën tonë kombëtare, forcat tona " djathtiste", "nacionaliste" dhe "demokratike"-me një fjalë "forcat e durimit" nuk kanë qendër komandimi.

Derisa forcat antishqiptare kanë përkrahje (të drejtëpërdrejtë dhe tërthorazi) nga mafia e kuqe ndërkombëtare dhe nga armiqtë tanë shekullor, forcat e "durimit"nuk kanë kurrfarë përkrahje nga forcat djethtiste të shteteve të Bashkësisë Evropiane.

Derisa forcat antikombëtare (forcat e krimit të organizuar) duke u mbështetur në parimin e Makiavelit "se qëllimi i arsyeton mjetet" i përdorën dhe po i përdorin të gjitha mjetet (shpifjet, kërcnimet, plaçkitjet, rrëmbimet, vrasjet, etj.) për ta marrë pushtetin në Kosovë siç e muarën në Shqipëri më 1997, forcat e "durimit" nuk po i përdorin as mjetet legjitime (demokratike dhe institucionale) për t'i luftuar këto forca të djallit. Forcat e durimit në vend se t'i sulmojnë me fakte forcat antikombëtare (forcat e krimit), për dëmet e mëdha që ia sollën atdheut dhe kombit tonë, (para lufte, gjatë lufte dhe pas lufte), janë kthyer në "aman"-xhi- lutës, për t'i shtënë në "gjynah" kriminelët që ta "ndalin dorën" dhe të "mos bëjnë më krime".

Deri sa forcat antikombëtare (forcat e krimit) po forcohen ekonomikisht me punë të pista, dhe as që po e kanë gjale për fytyrë (se fytyrë kanë me hektarë) dhe as që po ua ndien për ligj, (se kanë blerë apo ua kanë "shti lepujt në bark" një numri të konsiderueshëm të autoriteteve të UNMIK-ut, SHPK-së, TMK-së, etj.), forcat e durimit as nuk tentuan së paku të bijnë ligjin për caktimin e prejardhjes së pasurisë, dhe as që kërkuan ndonjëherë nga qendrat e vendosjes ndërkombëtare që të shkarkohën udhëheqës të UNMI-kut, SHPK-së, TMK-së, për shkak të aferave të shumta (që u kompromituan se po bashkëpunojnë me qendrën e

krimit të organizuar) dhe moskryerjes së detyrave për të cilat janë përcaktuar.

Derisa forcat antikombëtare po blejnë "intelektualë" dhe "veprimtarë" si bagtinë në treg, forcat e durimit nuk kanë mundësi t'i ndihmojnë intelektualët e vërtetë me as një ndihmë materjale, së paku për botimin e veprave shkencore (kapitale), që do të ndihmoheshin qendrat e vendosjes dhe opinioni ndërkombëtarë për ta kuptuar drejt dhe mirë problemin e Kosovës dhe çështjes së pazgjedhur shqiptare.

Derisa forcat antikombëtare i kanë përvehtësuar (uzurpuar) të gjitha mjetet e informimit publik (të shkruara dhe elektronike), përpos "Botës sot", (dhe ndonjë revistë javore) forcat e durimit as që planifikojnë ta kanë së paku një kanal televiziv dhe një radio, siç i kanë forcat djathtiste dhe demokratike në Evropë e vende tjera të botës.

Derisa forcat antikombëtare e shtruan për toke Elektroenerxhetikën e Kosovës, Universitetin e Prishtinës dhe Qendren Spitalote, forcat e durimit po bëjnë seri dhe asgjë nuk po ndërmarin që sëpaku t'u bëhet me gisht bartësve të varrmihësëve të këtyre institucioneve të rëndësishme (të kulturës- ekonomisë- dhe shëndetësisë) së Kosovës.

Derisa forcat antikombëtare po bashkëpunojnë në gjithë hapsirën tonë kombëtare dhe në diasporë, forcat e durimit nuk po kanë nevojë për një bashkëpunim të tillë!

Derisa forcat antikombëtare po bëjnë finansimin e familjave dhe individëve që u vuan në shërbimin e tyre, forcat e durimit nuk po kanë mundësi të kujdesen as për fëmijët jetimë të heronjve dhe martirëve tanë, që u vranë pas shpine apo me atentate nga shqipfolësit e marrë, që u bënë sharovë serbi dhe klyshë greku.

Derisa forcat antikombëtare po bëjnë plane dhe skanare për atentate të reja politike, forcat e durimit po vajtojnë dhe po u bëjnë "aman" kriminelëve me kravata kuq e zi, që të mos bëjnë më krime, dhe nuk po e dinë apo nuk po duan të dinë se kriminelët nuk e kuptojnë gjuhën e arsyes, të mirëkuptimit dhe tolerancës, por e kuptojnë vetëm gjuhën e forcës.

Derisa forcat e durimit me fjalë dhe me punë (deri dikund) po punojnë për pavarësinë e Kosovës, forcat antikombëtare me fjalë janë shumë të zëshëm për pavarësinë e Kosovës, por me punë dhe vepra janë armiqtë më të mëdhenj të pavarësisë së saj.

## INSTITUCIONET NACIONALE TË PAFUQISHME TA LUFTOJNË KRIMIN

Këto forca të djallit e dëmtuan rënd Luftën Çlirimtare të popullit tanë, (atë fazën e parë- paqësoren dhe fazën e dytë - luftën e armatosur) kur nuk lejuan bashkimin e faktorit politik dhe ushtarak të Republikës së Kosovës, ndërsa me krimet e rënda politike dhe ekonomike që i bënë dhe po i bëjnë në vazhdimësi, po e ndihmojnë shumë propagandën serbo-greke se "shqiptarët nuk janë popull shtetformues" dhe "nuk dinë të bëjnë dhe të mbajnë shtet ligjor" dhe kështu po ia përgadisin humnerën Kosovës dhe çështjes shqiptare. Këta mendjeshkurtër dhe kokëkrisur, duke punuar me të gjitha mjetet dhe mënyrat vetëm për interesat e tyre personale, klanore dhe partiake, po i dëmtojnë tepër rënd interesat madhore kombëtare, duke e bërë Kosovën pikën më të zezë në Evropë, pas Shqipërisë. Pra stalinistët e Shqipërisë dhe nanoistët e Kosovës me veprimtarinë e tyre antikombëtare po e ndihmojnë shumë makinerinë propaganduese dhe diplomatike të Beogradit, Moskves dhe të Athinës, kundër interesave tona madhore.

Edhe institucionet e përkohshme nacionale të Kosovës janë të pafuqishme për ta luftuar krimin e organizuar, kur siç dihet Qeveria e Kosovës është vënë në shërbim të dy bishtave të PSSH-së : PDK-së dhe AAK-së. Në veçanti, Kryeministri dhe ministrat që i kanë caktuar kryepëhlivanat e Nanosit, po punojnë në dobi të subjekteve të tyre e jo në dobi të Kosovës. Parlamenti, siç dihet, i ka arritur ca suksese në sajë të punës vetmohuese të disa personaliteteve të shquara të kombit tonë në krye me Nexhat Dacin, dhe Fadil Gecin. Radiotelivizioni i Kosovës, SHPK-ja dhe TMK-ja plotësisht janë vënë në shërbim të PDK-së dhe AAK-së. Gazetarët, policët dhe ushtarakët më të aftë të Kosovës janë penguar dhe po pengohën me të gjitha mënyrat për të mos i zënë vendet e merituar në këto institucione të rëndësishme të Kosovës. Fatmirësisht Presidenca dhe kryetari i Kosovës kanë punuar dhe po punojnë me përkushtim në realizimin e synimeve tona kombëtare, por sharovët e Xh. Halitit dhe baloshët e Nanosit me të gjitha mjetet po mundohen për ta penguar veprimtarinë shtetlore dhe diplomatike të burrështetit dhe diplomatit më të shquar të kombit tonë dr. Ibrahim Rugovës.

Siç dihet populli ynë në Kosovë tregoi pjekuri dhe vetëdije të lartë politike dhe kombëtare, kur në të gjitha zgjedhjet që u mbajtën në Kosovë (para lufte dhe pas lufte) besimin dhe votën e tij ua dha forcave

demokratike (forcave të durimit), dhe kështu i pengoi forcat e territ, forcat e krimit, forcat antikombëtare, pra i pengoi rrogatëtarët e Nanosit për ta realizuar një variant të "revolucionit të vonuar bolshevik të Qosjes-Shqipërisë" në Kosovë. Kjo fitore e rëndësishme e popullit tonë u bë në sajë të kombëtarës "Bota sot", e cila i ndihmoi qytetarët e Kosovës për ta kuptuar të vërtetën. Ajo me përkushtim e mbrojti Kosovën dhe forcat demokratike të saj, por edhe i luftoi me të gjitha forcat armiqte e kombit dhe veglat e tyre- (bajraktarët e farës ruse, dhe pehlivanët e Nanosit). Punë të madhe në mbrojtjen e Kosovës nga stalinistët e çartur të Shqipërisë dhe nanosët mendjeshkurt të Kosovës bëri dhe KFOR-i.

Qytetarët e Kosovës ende nuk i kanë kryer detyrimet që i kanë ndaj vendit të tyre, për- derisa të mos zhdukët krimi i organizuar. Duhet të jemi të vetëdijshëm se Kosova nuk do ta fitojë pavarësinë për derisa të lulëzojë krimi i organizuar. Qendrat e vendosjes ndërkombëtare i kanë të qarta rrethanat në të cilat ndodhet kombi ynë. Ata në asnjë mënyrë nuk do të krijojnë një shtet të ri në Gadishullin Ilirik, kur e dijnë se "shteti" do të bëhet qendër e krimit të organizuar evropian. Pra, është e pamundshme dhe joreale t'i jepet pavarësia Kosovës në këto kushte kur kriminelët e mëdhenj (që japin urdhra për krime) kanë zënë pozita të larta shtetërore dhe partiake, ndërsa kriminelët e vegjël (dorasët) lirshëm po sillen nëpër Kosovë dhe kohë pas kohe edhe nëpër Evropë për të bërë ahengja pas kryerjes së atentateve. Pra, vetëm atëherë kur ne t'i vëmë para drejtësisë kriminelët dhe ta shkatërrojmë qendren e krimit, do të fitojmë pavarësinë dhe lirinë e vërtetë, dhe do të hapën dyert e përparimit dhe realizimit edhe të synimeve tona tjera madhore, që sot për sot nuk kemi mundësi t'i realizojmë.

Shtrohet pyetja çka duhet të bëjnë forcat demokratike – forcat e durimit, që ta mundim krimin dhe kriminelët t'i vëmë para drejtësisë për të dhënë llogari për krimet e bëra, që është parakusht kryesor për të ecur përpara në realizimin e synimeve tona kombëtare. Përgjigjja nuk është aq lehtë dhe e thjeshtë kur, siç dihet, këto forca antikombëtare në gjithë hapsirën tonë kombëtare janë forcuar (me punë të pista dhe vepra të liga) ekonomikisht dhe politikisht, por edhe kanë përkrahje të fuqishme jo vetëm nga armiqët tanë shekullor por edhe nga struktura të caktuara të UNMIK-ut, që i kompromituan me rryshfet (i blenë si bagtinë në treg) ose i frigëuan me kërcnime të llojllojshme.

Luftën kundër kësaj të keqeje që po e ngulfatë kombin tonë çdo ditë e më shumë, duhet ta marim seriozisht, kur dihet se kryekriminelët e kuq- nanoistët dhe pionerët e Enverit janë kriminel të regjur. Po t'i bëjmë një vështrim të thjeshtë veprimtarisë së tyre kriminele, do të përfundojmë se të gjithë të "zgjedhurit" e tyre që i kanë vënë në " lista të zeza" për vrasje, kanë luajtur dhe po luajnë rol me rëndësi në Lëvizjen tonë për bashkim dhe çlirim kombëtar. Nanoistët dhe LBDK-istët e Kosovës duke ditur se janë kurrkushi, se janë të padijshëm dhe të paautoritet, se për të parë nuk i njeh as mëhalla e lere më Kosova, e vunë në përdorim strategjinë dhe taktikën e prijesve të tyre ideorë : E. Hoxha, K. Xoxe, M. Popoviqi dhe F. Nano. Të vetmen mëryrë për t'u bërë "të parë" e shihnin duke i vranë (me shpifje dhe me plumba) burrat më të mirë të kombit, që, pastaj, me mjetet e njohura komuniste të vihen në krye të vendit. Pengesë e parë për ta u bë intelektualit dhe gazetari i shquar- zëdhënsi i parë i UÇK-së, Ali Ukaj. E vrau në Tiranë pararoja e LPK-së, sepsa ai nuk e përkrahu strategjinë e tyre të përvehtësimit të Ushtrisë së Kosovës (" Ushtria e Kosovës", i quante Adem Jashari njësitë guerile që drejtoheshin nga ai, Salih Çeku dhe Zahir Pajaziti), me mjete komuniste, me marrjen e kalasë nga mbrenda. E vranë Enver Malokun mbrojtësin më të zëshëm të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës. Pas shumë atentateve e vranë Azem Hajdarin, se i demaskonte dhe i luftonte spiunët serbo-ruso-grek dhe bënte përpjekje që me të gjitha mënyrat dhe mjetet ta ndihmonte forcimin e Ushtrisë së Republikës së Kosovës dhe krijimin e Shqipërisë etnike. E vranë LPK-istët së bashku me nanoistët e LBDK-së Ahmet Krasniqin pasi që punonte për ta bërë UÇK-në ushtri të institucionalizuar të Republikës së Kosovës- ushtrinë më të madhe dhe më të fuqishme të Gadishullit Ilirik, ushtri kjo që do ta çlironte vet Kosovën dhe visev tjera shqiptare.

Nanoistët dhe LBDK-istët pasi nuk arritën t'i vrasin gjatë luftës të gjithë ushtarakët e zotë që i njihnin institucionet e Republikës së Kosovës dhe që treguan aftësi dhe suksese në luftën çlirimtare të Kosovës, po i vrasin pas çlirimit të Kosovës. E vranë ushtarakun e shquar Ekrem Rexhën (komandant "Drinin"), se gjatë lufës nuk pranoi të bëhej argat i tyre, ndërsa pas lufte i frikësoheshin autoritetit dhe të dhënave që ai i kishte për veprimtarinë e tyre antikombëtare. Për të njëjtat qëllime i veranë edhe komandantët e UÇK-së dhe veprimtarët e shquar të LDK-së Smajl Hajdaraj dhe Ukë Bytyqin.



## LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR ËSHTË ME RËNDËSI TË MADHE KOMBËTARE

Ndërkaq, lista e veprimtarëve të shquar të LDK-së dhe njerëzve të penës që u vranë nga nanoisto-çetnikët e gjorë nuk ka të sosur. U vra intelektual i shquar Xhemal Mustafa në pikë të ditës, para derës së shtëpisë, dhe organet e policisë dhe të drejtësisë ndërkombëtare dhe të vendit as që bënë përpjekje për t'i qitur para drejtësisë dorasit e kësaj vrasje të rënd politike. U vra gazetari i " Botës sot" Bekim Kastrati, dhe pjesëtari i Presidencës së Kosovës Besim Dajaku, si dhe u plagos për vdekje bashkëluftëtari i Adem Jasharit, Gani Geci, ndërkaq organet e hetuesë po i lanë të lirë kriminelët për të bërë edhe mëtej krime. U rrëmbye dhe u vra Haki Imeri nga policia sekrete e UÇK-së, që e komandonte Sabit Geci, dhe organet e ndjekjes në Kosovë nuk ndërmorën asgjë për t'i dënuar kriminelët, edhe pse kanë mjaft të dhëna për ta. U vranë dhe po vriten dëshmitarët që e thanë të vërtetën në procesin gjyqsor të "Grupit të Dukagjinit" dhe Derek Çapell nuk do, apo nuk guxon të thotë të vërtetën, se vrasjet e dëshmitarëve nuk mund të konsiderohen ndryshe, pos vrasje politike. Pra, kush ka logjikë dhe arsye të shëndosh, e ka të qartë se dëshmitarët po vriten nga kriminelë profesionistë, të paguar nga familjet e të dënuarëve në procesin e "Grupit të Dukagjinit". Por, zotëri D. Çapel me vetëdije i jep tjetër karakter dhe kahje kësaj vrasje të rënd politike kur thotë se "nuk di për motivin e këtyre vrasjeve".

Vritet Burri i madh i kombit kolonel Tahir Zemaj me gjithë djalë dhe nip në mes të rrugës, para dhjetëra njerëzëve, dhe policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja nuk paskan" informata" se kush duhet të jenë kriminelët, dhe nuk po "ditkan" se për çfarë motivesh është bërë ky krim, krimi më i rëndë pas luftës. UNMIK-u i paguan shumë shtrenjtë informatat që bëjnë të mundëshme kapjen e kriminelëve që bënë disa vrasje mbi pjestarë të pakicës serbe në Kosovë, por të njëjtën gjë nuk e bënë edhe për vrasjet e burrave më të shquar të kombit tonë. Zotëri Çepelli (dhe të tjerët) duhet ta kenë të qartë, se po ta luanin këtë rol, që po e luajnë sot në Kosovë, në vendin e tyre, opinioni i vendeve të tyre do t'ua bënte jetën e padurueshme dhe do t'i detyronte së paku të japin dorëheqje.

Siç po shihet, Kosova dhe çështja shqiptare janë të rrezikuara nga shumë drejtime. Duhet ta kemi të qartë, se e keqja vetvetiu nuk largohet. Po që se deri tash nuk e kemi kuptuar se forcat antikombëtare janë të

organizuara në nivelin më të lartë për të na sjellë humbje dhe dështime dhe po qe se forcat e durimit nuk organizohen sa më parë, në nivelin më të lartë, për ta fituar luftëm mbi të keqën dhe të ligën që po mbretëron në gjithë hapsirën ton kombëtare, ne nuk meritojmë të hami buk, por duhet të hamë dushk e barë.

Forcat demokratike, forcat që i krijuan themelet e shtetisë së Kosovës dhe e ndërkombëtarizuan çështjen e Kosovës, pra me një fjalë forcat e durimit, duhet të bashkëpunojnë me forcat demokratike në gjithë hapsirën tonë kombëtare dhe ta ndihmojnë njëra -tjetren në të gjitha lëmitë e jetës. Të caktohen detyrat parësore dhe dytësore. T'i gjejnë aleatët në Bashkësinë e shteteve evropiane dhe të kërkojnë përkrahjen e tyre morale dhe materjale. Të demaskohen kriminelët serb, maqedonas dhe shqiptar, se kriminelët janë vëllezër, e kanë një gjuhë të përbashkët, e kanë gjuhën e forcës dhe kanë karakterin e dhelpëres dhe të qenit. Të përkrahen moralisht dhe materjalisht familjet e dëmtuara nga kriminelët e të gjitha ngjyrave. Në veçanti, të përkrahën familjet shqiptare, të cilave iu rrëmbyen të dashurit e tyre nga këmishëzinjtë e UÇK-së së XH. Halitit & H.Thaçit-R. Haradinaj, pasi që xhambazët e PDK-së dhe AAK-së, të tubuar në "tri shoqatat e dalura nga lufta", po bëjnë presione të llojllojshme mbi to për ta mbyllur gojën. Forcat demokratike që gjenden në Parlamentin e Kosovës e kanë për detyrë që sa më parë të nxjerrin ligjin (të bëjnë përpjekje maksimale) për ta caktuar prejardhjen e pasurisë së qytetarëve të Kosovës. Qytetarët e Kosovës do ta humbin besimin shumë shpejt në subjektet politike dhe shtetore, po qe se të zgjedhurit e tyre i mbyllin sytë dhe veshët para keqpërdoruesve të funksionit të një pjesë të lidershipit shqiptar që u bënë pasanikë të fuqishëm të Kosovës, edhe pse para luftës nuk kishin asgjë, ishin proletarë që i ushqenin shoqatat humanitare të shteteve të Evropës Perendimore. Të krijohen lidhje bashkëpunimi me afaristë demokrat dhe atdhetarë, kudo që gjenden në vend dhe jasht vendit, që edhe ata ta japin kontributin e tyre për realizimin e synimeve tona kombëtare. Të demaskohen dhe të ndiqen penalisht barësit e krimit ekonomik në Elektroenergjetikën e Kosovës. Të demaskohen dhe të shkarkohen nga vendet udhëheqëse të Univerzitetit të Prishtinës rroghtarët e H.Thaçit dhe R. Haradinajt, që këtë institucion të rëndësishëm të kulturës dhe të arsimit e bënë pronë personale të klaneve dhe subjekteve të tyre politike. Të mbrohet ministri ligjitim i Shëndetësisë zotëri Baliqi, të cilin pa kurfarë të drejte e shkarkoi argati i

H.Thaçit, Bajram Rexhepi, vetëm pse muar hapa të guximshëm për ta nxjerrë Shëndetësinë e Kosovës nga humnera që e futi Plerat Sejdiu&company dhe që nuk pranoi të bëhet argat i PDK-së dhe AAK-së. Të mbledhen të dhënat dhe dëshmitë e qytetarëve që u kërcënuan ose u rrëmbyen të afërmit e tyre kriminelët e huaj ose kriminelët tanë. Të përkthehet i tërë matricjali propagandistik i shërbëtores së Beogradit, Athinës dhe Moskvës- Kosovapres-i, dhe t'i dërgohet organeve të ndjekjes, sepse të gjitha vrasjet politike që u bënë, iu parapriu një propagandë dhe shpifje e shfrenuar nga gazetarët-sahanlëpirës të Kosovapres-it, të gazetave të Sorrosit, dhe të mafisë së kuqe ndërkombëtare, që botohen dhe shpërndahen në Kosovë e diasporë, për t'i helmuar dhe verbuar mendjeshkurtit, zemërzinjtë dhe shpirtkatilët. Të krijohet sa më parë një shoqatë humanitare në gjithë hapsirën tonë kombëtare dhe në diasporë, që do të mirret me përkujdesjen e familjeve të heronjëve dhe martirëve tanë, (edhe për shkollimin e fëmijëve të tyre) që u vranë që nga viti 1997 (gjatë luftës dhe pas luftës) nga naoisto-çetnikët e gjorë, me atentate ose me tradhti.

Vetëm organizimi ynë (i forcave të durimit) në nivelin e duhur, duke i kryer detyrat me përgjegjësi dhe ndërgjegje të lartë, do të na sjellte fitorën mbi forcat e krimit të organizuar në gjithë hapsirën tonë kombëtare, pra mbi nanoisto-çetnikët e çartur. Por, është ligj i Zotit se pa punë nuk ka suksese. Pra, forcat demokratike të Kosovës- forcat e durimit, në krye me LDK-në, kanë përgjegjësi njerëzore, politike dhe kombëtare, që luftën kundër krimit të organizuar ta organizojnë dhe ta bëjnë të fuqishme, që kriminelët e mëdhenj dhe të vegjël t'i vëmë para organeve të drejtësisë. Populli ynë u tregua dhe po tregohet largpamës, i drejtë dhe inteligjent, kur kriminelët, vasalët dhe tradhtarët që punuan dhe po punojnë për interesa të huaja i rrahiu dhe po i rrah me mjete shumë të përshtatshme, me votën e tij të lirë. Populli ynë i rrahu dhe i rrëzoi nga pushteti stalinistët e Shqipërisë, këtë farë të keqe ruse, me demonstrata dhe me votën e tij të lirë. Fatkeqësisht udhëheqja e PDSH-së bëri gabime të rënda dhe me fajin e saj e rimorën pushtetin stalinistët, në krye me Nanosin. Edhe në Kosovë, populli ynë i rrahi bishtat e Nanosit në tri zgjedhjet e pasluftës që u bënë në Kosovë. Sivjet do të mbahen zgjedhjet e katëta, zgjedhjet vendimtare që do të vendosin se a do të ecë përpara Kosova drejt realizimit të synimeve, ose do të shkojë drejt humnerës. Fitorja e thellë e forcave të durimit në krye me LDK-në,

Kosovës dhe popullit të saj do t'ia hapë dyert e zhvillimit dhe përparimit. Qytetarët e saj do ta gëzojnë lirinë. Forcat antikombëtare, forcat e krimit të organizuar, rrogarët e Nanosit, të Sorrosit dhe të Xhinxhiqit, do t'i rrahë populli me gugjuma kres, që më kurrë të mos u bjerë ndërmend të kërkojnë pushtet. Kryekriminelët dhe kriminelët do ta marrin denimin e merituar. Ata ia kanë siguruar vetes, sa të jenë gjall, mallkimin, injorimin, faqen e zezë, dhe veshmbathjen dhe ushqimit pa pagesë në shtëpinë përmirësuese të Dubrvës. Populli ynë është i urtë, i zgjuar dhe human. Ai do të gjejë forma dhe mjete për t'i shëruar këta kodoshë, ahmakë, të sëmuarë psikikë dhe të marrë, që të huajt dhe djalli ua kanë mbushër mendjen se duhet të jenë të parë, shtetarë, pushtetarë, pasanikë të Kosovës, se ata duhen të bëjnë çka të duan me Kosovën, me njerëzit dhe pasurinë e saj. Pra, fitotja e forcave demokratike- forcave të durimit, do të ndikonte te qendrat e vendosjes ndërkombëtare për t'ia njohur Kosovës pavarësinë e shpallur Pra, lufta kundër krimit të organizuar, lufta kundër kësaj të keqeje të madhe që e ka kapluar kombin tonë, është me rëndësi të madhe kombëtare. Ajo do të jetë e rëndë dhe e vështirë, por gjithsesi do ta fitojmë, se në anën tonë është i Madhi Zot, i cili garanton se,... kriminelët do t'i poshtërojnë dhe do t'i dënojnë në këtë botë dhe në botën tjetër."

*Botuar : "Bota sot", më 10-12. Janar 2004*

## PSE DËSH TAKËT E KOSOVËS PO E FORMOJNË PARTINË E TYRE.

Kryedështaku i dështakëve të Kosovës, kryekomplotisti i komplotistëve të Republikës së Kosovës, kryepërgjegjësi i të gjitha të ligave që e gjetën Kosovën në vitet e fundit të shekullit të 20-të, Bujar Bukoshi, paralajmëroi opinionin e gjërë se së shpejti do ta formojë partinë e tij të re, që do t'ia mundësonte atij për të vazhduar lojën e deritashme politike "hudhe gurin e mshehe dorën", qëllimi i të cilit ka qenë dhe është që ai dhe klani i tij të bëhën skllavopronarë të Kosovës. Me siguri opinionin ynë do ta miratonte, dhe do ta përgëzonte paraqitjen e Bukoshit në jetën politike të Kosovës, po që se ai në kohën sa e mbajti postin e Kryeministrit t'i kishte kryer detyrat me përgjegjësi, që ia pat parashtruar Kushtetuta e Kaqanikut dhe organet shtetërore të Republikës së Kosovës.

Siç dihet, ish kryeministri Bukoshi dhe Qeveria e tij (ishte qeveri e tij se punoi për interesat e tija dhe të klanit të tij, e jo për interesa të Kosovës) nuk e kanë kryer as një detyrë që është dashur ta kryenin. Ai kurrë nuk e kompletoi Qeverinë e Republikës së Kosovës me ministra dhe ministri, që ishin më se të nevojshme. Nuk bëri kurrëfarë përgaditjesh për çlirimin e Kosovës, edhe pse për atë qëllim kishte dalur në egzil. Krijimin e Ministrisë së Mbrojtjes nuk e bëri për realizimin e synimeve tona kombëtare, por e bëri për shkatërimin e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, të LDK-së dhe largimit nga skena politike të Ibrahim Rugovës. Mospranimi i kolonel Ahmet Krasniqit për t'u bërë shërbëtor dhe instrument i "trojkes": "Bukoshi-Qosja-Kelmendi", apo rrogat për pararoje staliniste të LPK-së, që udhëheqej nga Xh. Haliti dhe A.Syla, pati për pasojë vrasjen e tij nga UDB-ja e Beogradit dhe UDB-ja e Tiranës, që i kishin njerëzit e tyre në ish SHP të UÇK-së, LPK-në, LBDK-në dhe në Qeverinë e Bukoshit. E tërë veprimtaria e tij dhe e Qeverisë së tij, me përjashtim të ministrit të arsimit z. Bicës, ishte drejtuar për të mbledhur tatimet (e 3%-shit) nga qytetarët e Kosovës. Çka është më e keqja "Fondi i Qeverisë së Kosovës" u përvehtësua nga Bukoshi dhe klani i tij, për të përgaditur terenin, që ai të bëhet njeri i parë dhe i përjetshëm (kryeministër) i Republikës së Kosovës, apo i Krahinës Autonome të Kosovës, varësisht se ç'farë statuti do të "bënte rahmet" t'i

siguronte Kosovës faktori ndërkombëtar. Për të arrijtur këto qëllime, Bukoshi e "shkelmonte" dhe e "pështynte" LDK-në dhe Rugovën që e kishin bërë Kryeministër të Qeverisë së parë të Republikës së Kosovës, për t'u bërë qefin R.Qosjes dhe I. Kelmendit, por bëri ç'mos për ta blerë Xh. Halitin, duke i dhënë me miljana DM nga fondi i "Qeverisë së tij", që ai t'ia siguronte postin e Kryeministrit në Kosovën e pasluftës, po që se dështojnë planet dhe komplotet e "trojkes" ("Bukoshi-Qosja-Kelmendi") që ai e udhëheqte. Pra, Bukoshi gjatë gjithë kohës sa ishte Kryeministër, që kujdesur që gjithmonë të jetë lojtarë i mirë i "degërshikut politik" me "shulevek të gatshëm".

Ai donte të jetë në krye të të gjitha rrymave politike, që ishin krijuar në Kosovë. Kuptohet që atij i bie "merita" kryesore e ndarjeve dhe përçarjeve të thella që u bënë në klasën politike të Kosovës. Është e kuptueshme se Bukoshi dhe klani i tij do të bëjnë përpjekje të mëdha për të zënë vendin e humbur dhe të merituar në mesin e kryepëhlivanave të Nanosit, për të marrë pjesen e pushtetit lokal dhe të atij qëndror që ju "takon". Kjo nënkupton se Bukoshi dhe klani i tij, do të fitojnë të drejtën për t'u bërë artak në uzurpimin e pasurisë shoqërore, me "trojkën" aktuale: "Thaçi-Haradinaj- Rremi", që po ua siguron SHIK-u dhe mafia e kuqe shqiptare. Kërkesa e Bukoshit për t'u ulur në sofrën e Xh. Halitit dhe shërbëtorëve të tij, është e drejt kur dihet se pa ndihmën e tij të drejtpërdrejtë, dhe të tërthortë, pararoja staliniste e LPK-së, (kryepëhlivanat e Nanosit, argatët, dhe shërbëtorët e tyre) nuk do të kishin pasur kurrëfarë mundësie, për t'u bërë faktorë të përvehtësonin njësitë guerile, (dhe as shkatrimin e institucioneve shtetërore) të Republikës së Kosovës.

Shtrohet pyetja, pse në këtë moment Bukoshi dhe klani i tij vendosën për të bërë përgaditjet e duhura, për të formuar subjektin e tyre politik? Janë shumë faktor, që ndikuan në Bukoshin dhe argatët e tij për të marrë një vendim të till, që me siguri nuk do t'u sjellë suksese por vetëm dështime.

Siç dihet, LDK-ja ka vendosur të mbaj Kuvendin e katërt zgjedhor, në fillim të majit të këtij viti. Bukoshi edhe pse nuk ka kurrëfarë posti udhëheqës në LDK-në, ai në të gjitha nivelet udhëheqëse të kësaj partie i ka lënë bishtat e tij. Ai duke ditur se Rugova "do t'i fshijë me rrometë", bishtat e tij, dhe pleshtat dhe morrat e ish LBDK-së, që kanë zënë pozita udhëheqëse në LDK-në, po bënë përpjekje, që ai dhe

bishtat e tij, të mos e përjetojnë fatin e "babës së farës ruse" –Qosjes, të fitojnë statusin e qytetarëve "të vdekur për së gjalli". Pra, Bukoshi dhe rrogtarët e tij, ashtu sikurse i mbyturi, që shpëtimin shpreson ta gjejë në shkumën e ujit, edhe këta dështakë të Kosovës, të vetmën rrugdalje e shohin në krijimin e një subjekti të ri politik, që do t'i ngjante "strajces së lypsakut", që në rradhët e saj do t'i pranonte karrjeristët e dështuar të LDK-së, PDK-së dhe të AAK-së. Vendi i meritur do tu takojë në këtë parti edhe individëve që i bleu Bukoshi me mjetet e Fondit të Qeverisë së tij. Bukoshi dhe argatët e tij parashohin se partija e tyre do të forcohej dhe rritet me dobësimin apo shkatërrimin e PDK-së dhe të AAK-së, që sipas të gjitha gjasave pritet se do të ndodhë sivjet, kur do të zbulohën faktet e pamohueshme se kreu i këtyre partive është i kyqur në krimet politike dhe ekonomike, që e përulanë Kosovën gjatë luftës dhe pas luftës, deri në ditët e sotit. Me burgosjen e Sabit Gecit, shefit të policisë sekrete të UÇK-së, të ushtarakut të SHP të UÇK-së Salih Veselit, dhe së fundi të tre ish pjestarëve të Policisë sekrete të UÇK-së, po ju ngushtohet rrethi kriminelëve, dhe një ditë jo të largët do t'i shohim në pranga edhe kryepëhlivanët e Nanosit, argatët dhe shërbëtorët e tyre, që kanë zënë vende udhëheqëse në Parlamentin e Kosovës, TMK-në, PDK-në dhe AAK-në. Faktori tjetër që ka ndikuar në Bukoshin dhe argatët e tij për të formuar "Partinë e Re të Kosovës" është që veprimtaria e tyre antikombëtare të mos vlerësohet si e till, por të marri notë kaluese nga subjektet shtetërore të Kosovës. Ata shpresojnë se subjekti i tyre politik do t'i bllokonte të gjitha përpjekjet e individëve të pa parti, që do të mundohën t'i ndriqojnë keqpërdorimet e mjeteve finansiare të Fondit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nga ana e Bukoshit, Sugarit dhe rrogtarëve të tij, që i kishte bërë Bukoshi "ministra" në qeverinë e tij. Pra krijimi i një subjekti politik, që do ta drejtonte Bukoshi, do t'ia mundësonte atij, dhe shërbëtorëve të tij, të fitojnë imunitetin e udhëheqësve të subjekteve politike dhe shtetërore të Republikës së Kosovës, gjegjësisht të Kosovës, që pastaj me parat e Fondit të Qeverisë së Kosovës, që i kanë fëshefur në bankat private, të blejnë njerëz të subjekteve tjera politike, të blejnë parlamentarë, të blejnë "intelektualë", gazetarë-sahanlëpirës dhe analistë-kakuda, që kanë zënë pozita udhëheqëse në mjetet e opinionit publik, për të kryer punën e skllavit me urdhërin e kryesklavopronarit Bukoshi. Siç dihet, deri tash vetëm kombëtarja "Bota sot", ka mbajtur qëndrim kritik ndaj punës së Bukoshit

dhe qeverisë së tij.

Gazetarët që shkruajnë për qefin e kryekuqaloshve të Kosovës në gazetat që i drejtojnë hyzmeqarët e Xh. Halitit dhe të B. Bukoshit, i kanë mëshelur sytë dhe veshët, dhe me as një fjalë nuk e kanë kritikuar punën antikombëtare të Bukoshit, edhe pse pretendojnë se janë të pavarur. Përpjekjet e Bukoshi dhe klanit të tij, për t'u bërë faktor politik në Kosovë kanë për qëllim edhe të pengojnë fillimin e procedurës për të vlerësuar (Parlamenti dhe organet hetimore dhe gjykata) se si janë qeverisur mjetet e Fondit të Qeverisë së Kosovës. Me siguri kur Bukoshi nuk ka mundur t'i arsyetonte hargjimet e Fondit të Qeverisë së tij, në seancën e parë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, pas çlirimit të Kosovës, nuk do të ketë sukses t'i arsyetonte as tash, prandaj edhe ky faktor, faktori për t'i bllokuar hetimet përkitazi me qeverisjen e Fondit të Qeverisë së tij kanë qenë vendimtare që e shtynë Bukoshin për të filluar formimin e partisë së tij.

Bukoshi dhe argatët e tij kanë bërë llogarinë pa hanxhiun. Përpjekjet e tyre për t'u bërë faktorë politik "që do t'u shkojë zani" do të dështojnë, sepse ideologu i "Partisë së Re" është kryedështaku i dështakëve të Kosovës, i cili duhet të japi llogari para drejtësisë së shtetit të Kosovës, për komplotet që i bëri kundër institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, kundër njësive guerile dhe prijësve dhe komandantëve të tyre Adem dhe Hamz Jasharit, Zahir Pajazitit, Salih Çekut e të tjerëve. Bukoshi dhe argatët e tij nuk e kanë vendin në institucione shtetërore të Kosovës, se ai mori pjesë në shkatërrimin e tyre së bashku me R.Qosjen, A. Demaçin, H. Hysenin, Xh. Halitin. I. Kelmendin, H.Thaçin, R. Haradinajn, N.Malokun, A.Çekun, J. Krasniqin dhe me shërbëtorët e tyre. Vendi i Bukoshit, i dështakëve të Kosovës dhe i komplotistëve të Republikës së Kosovës është në Dubravë apo në lagjën e "të vdekurëve për së gjalli", që me padurim po i pret "babaj i farës ruse" R.Qosja.

*Botuar: "Bota sot", më 6 prill 2002*



## LUFTA KUNDËR KRIMIT NË KOSOVË

### KUSH PO IA PËRGADITË HUMNERËN KOSOVËS?

Shqiptarët gjatë gjithë historisë së tyre të gjatë bënë luftë për jetë a vdekje. U kacafytën me armiq të shumtë, që i përgaditën kurrthe të rrezikshme për asgjesimin e tij fizik. U përkëdhelën nga djaj të ndryshëm për ta futur në udhë të pakrye, që kurrë të mos shohë dritë. U vra, u masakrua nga okupatorë të ndryshëm, por prapë shpëtoi nga ma e keqja në sajë të rezistencës së tij të vazhdueshme, por mbi të gjitha ishte mëshira e të Madhit Zot, që na i dërgoi në ndihmë në momentet më të vështira, fuqitë më të mëdha të botës, për të na shpëtuar nga më e keqja, siç është rasti me SHBA-të, që na shpëtuan disa herë nga ujqërit e uritur të Karpateve të Rusisë, dhe hienat dhe qakajtë e Ballkanit me intervenime diplomatike, por ndihma e tyre e fundit ishte një mrekulli e vërtetë kur forcat e NATO-s e detyruan kasapin e Ballkanit t'i largojë forcat e krimit nga Kosova. Fatkeqësishtë ariu i zi i Karpateve të Rusisë dhe qakajtë e Ballkanit sëbashku me miqtë e tyre evropianë po ia përgadisnin Kosovës dhe kombit tonë humnerën më të rrezikshme që i është përgaditur ndonjëherë më parë nepërmjet pehlivanëve të Nanosit dhe bajraktarëve të farës ruse.

Vampirët e kuq që i polli "revolucionin e vonuar demokratik" i R.Qosjes e shëndrruan Shqipërinë në një koloni greke dhe krijuan mafinë e tyre ekonomike dhe politike. Krimi i organizuar, varfëria dhe skamja po bëjnë kërda mbi shqiptarët që nuk pranuan të bëhën robër të bandave të Nanosit, Mejdanit dhe Klosit, që erdhën në pushtet edhe me bekimin e Dean Everesit ("kranës së xhehnemit") i cili zgjedhjet parlamentare dhe parlamentin e kallashnikovëve i shpalli "të pranueshëm për shqiptarët". Edhe Kosovës iu përgaditën skenarë të rrezikshëm nga të njejtat forca që Shqipërinë e çuan në buzë të greminës. Siç dihet kryepehlivanët e Nanosit, I. Kelmendi dhe Xh. Haliti, argatët e tyre H.Thaçi, A.Demaçi, R.dhe N. Haradinaj, R. dhe S. Selimi, F.Lima, J. Krasniqi, vëllazërit Bujaj, etj, babai i farës ruse R.Qosja dhe pionerët e Enverit H. Hyseni, B.Luzha, G.Syla, etj, u vuan nën komandën e Nanosit, Mejdanit dhe Klosit, për t'i luftuar forcat demokratike -kombëtare të Kosovës, në bazë të marrëveshtjes që është lidhur në Cyrih ndërmjet Partisë Socialiste të

Shqipërisë dhe LPK-së, në marsin e vitit 1993. Siç dihet, kjo luftë e tyre pati për pasojë përçarjen e faktorit politik dhe pamundësoi bashkimin e forcave ushtarake të Republikës së Kosovës. Këta vampirë të kuq shkelën Marrëveshtjen e Osllos që parashihte formimin e FARK-ut. Njësitë e UÇK-së në vend se të bëhen brigada operative të FARK-ut siç e parashihte Marrëveshtja e Osllos, me shkeljen e marrëveshtjes ato u bënë mekanizëm ushtarak në duar të kryepëhlivanëve të Nanosit, për t'i luftuar forcat institucionale në krye me LDK-në, institucionet shtetërore, dhe Presidentin e Republikës së Kosovës I.Rugovën. Si rrjedhojë e gjithë këtyre kompleteve, Serbia nuk e pati vështirë t'i masakronte qytetarët e paarmatosur të Kosovës dhe të bënte pastrimin etnik të saj.

Fatkeqësisht të njëjtat forca që vranë dhe plagosën veprimtarë të dalluar të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës dhe nuk lejuan bashkimin e faktorit shqiptarë gjatë luftës, të njëjtat forca, edhe pas çlirimit të Kosovës i filluan komplotet kundër Kosovës dhe popullit të saj. "Qeveria" e Thaçit e krijuar në Tiranë në momentet më tragjike të popullit tonë, pasi u këthye në Kosovë, usurpoi pasuri shoqërore dhe private. Edhe Qeveria e Bukoshit u këthya në Kosovë, por Bukoshi nuk kishte nevojë për të usurpuar pasuri shoqërore dhe as private. Ai kishte nevojë për të fituar poena politikë, që edhe njëherë të bëhet kryeministër i Kosovës. Mjetet e informimit publik përpos gazetës kombëtare "Bota sot", nuk guxonin ta kritikonin as kryeministrin e vjetër dhe as kryeministrin e ri, se nuk ishin të sigurtë se kush do të bëhet i "fuqishëm" pas qetësimit të situatës politike, dhe tejkalimit të euforisë që erdhi si rrjedhojë e çlirimit të Kosovës nga NATO-ja. SHIK-u i "Qeverisë" së Thaçit i krijuar gjatë luftës nga ekspertë të Sigurimit të fsheftë të Shqipërisë filloi të kërcnojë dhe të vrasë veprimtarë të dalluar, që ishin apo mund të ishin pengesë e madhe në realizimin e synimeve të tyre për marrjen e pushtetit me mjete "demokratike" apo me mjete të dhunës.

Kriminelët që ishin nën komandën e tyre, kryenin akte të krimit politik dhe ekonomik, ditën dhe natën, të maskuar me maska. Në Kosovë mbretëronte friga dhe pasiguria. Kryekriminelët e kuq shqiptarë, që japnin urdhra për të bërë krime, u treguan shumëherë më të pashpirtë se udbashët e Rankoviqit. Populli filloi të vetëorganizohet. Kur populli filloi t'i vrasë kriminelët e maskuar, maskat më nuk u paraqitën në Kosovë. Edhe "Qeveria" e Thaçit e "shoi" veprimtarinë e saj politike dhe destruktive kur Thaçi e firmosi vendimin që ia ofroi administratori i parë

i protektoriatit të Kosovës zotëri Kushneri. Shumica e ministrave të "Qeverisë" së Thaçit ende po i mbajnë pozitat udhëheqëse në organet udhëheqëse të Kosovës që i krijoi UNMIK-u dhe OSBE-ja.

**NANOISTËT E SOTIT ISHIN DHE JANË TË MANIPULUAR NGA SIGURIMET E FSHEHTA SERBO-RUSO-GREKE DHE JANË KOLERA E KOMBIT**

Fatkeqësishtë, argatët e Xh. Halitit që e krijuan SHIK-un (përpos Sabit Gecit që gjendet në burg) po veprojnë edhe mëtutje në gjithë Kosovën. Të gjitha vrasjet politike që u bënë gjatë luftës dhe pas luftës, dëshmojnë se Qendra e krimit -SHIK-un e drejtojnë politikanë që kanë përvojë të gjatë në krime, njerëz që janë të lidhur me sigurimet e fshehta serbo-ruso-greke, sepse çdo vrasje politike që e bënë argatët e tyre, pati pasoja të rënda për çështjen madhore kombëtare. Me vrasja e Azem Hajdarit u dëmtuan rënd forcat demokratike të Shqipërisë, por u dëmtuan edhe forcat institucionale dhe demokratike të Republikës së Kosovës, sepse ai ishte në gjendje për t'i vu të gjitha resurset e Shqipërisë në shërbim të Kosovës dhe të Shqiptarisë. Vrasja e Ahmet Krasniqit pati pasoja të rënda për faktorin ushtarak të Republikës së Kosovës, pati dhe ende do të ketë pasoja për Kosovën dhe për shqiptarinë, pasi që mbetën përgjysmë dhe të pa kryera projektet e tia për formimin e Ushtrisë së rregullt të Republikës së Kosovës, që do të bëhej ushtri kombëtare, njëra ndër ushtritë më të mëdha të Gadishullit Ilirik. Me siguri ajo ushtri do të realizonte vetë çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, kuptohet me ndihmën morale dhe materjale të miqve të sinqertë të kombit tonë. Vrasja e Enver Malokut pati për pasojë dëmtimin e Qendres së Informimit të Republikës së Kosovës, që lunte rol të rëndësishëm në informimin e opinionin ndërkombëtarë dhe atij vendës për veprimtarinë e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës dhe për dhunën serbe në Kosovë. Me vrasjen e Haki Imerit u dëmtua rënd Drenica dhe Kosova po qe se merren parasysh aftësitë, përvoja dhe autoriteti që ai e kishte në popull. Me vrasjen e Shaban Manajt vampirët e kuq donin të mbjellnin frikë tek veprimtarët e shquar të forcave të shëndosha kombëtare, dhe "me të mirë" apo "me të keq" t'i detyronin të bëhën argatë të argatëve të pehlivanëve të Nanosit. Me plagosjen e Sabri Hamitit (kriminelët e patën vrarë, por Zoti nuk e vrau) dhe vrasja e Xhemal Mustafës, Qendra e krimit donte jo vetëm t'i dëmtonjë rëndë institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës por donte që Rugovën ta lënë pa bashkëpunorët

më të aftë dhe më të besueshëm që i kishte. Me vrasjen e komandant "Drinit", Qendra e krimit donte për t'i zhdukur gjurmët e krimeve që i kishin bërë pehlivanët e Nanosit dhe bajraktarët e farës ruse gjatë luftës dhe pas luftës, për të cilat komandant "Drini" kishte faktet të dokumentuara. Me vrasjen e Bekim Kastratit talibanët e kuq të Kosovës donin për ta vrarë fjalën e lirë, donin për ta vrarë të vërtetën, donin për ta vrarë shqiptarinë, që me aq përkushtim i mbron gazeta kombëtare "Bota sot" dhe vetë i ndjeri Bekim Kastrati. Me vrasjen e Besim Dajakut dhe plagosjen e Gani Gecit, (I Madhi Zot e ruajti Ganiun për të dëshmuar për të ligat që ia bënë Adem dhe Hamzë Jasharit rrogatët e XH. Halitit). Më këtë atentat politik nanosët i vranë bashkëluftëtarët e parë të Adem dhe Hamzë Jasharit, shkelën mbi xhakun e dëshmorëve të kombit, vranë trashëgiminë tonë patriotike, politike dhe luftarake. Me vrasjen e deputetit të Parlamentit të Kosovës dhe ish komandantit të Shtabit të Brigadës 136, "Rugova" Smail Hajdaraj më 17 janar 2002, që përputhet me 20 vjetorin e atentatit të Shtutgardit, tregon se enveristet e djeshëm dhe nanoistët e sotëm ishin dhe janë të manipuluar nga sigurimet e fshehta serbo-ruso-greke, pra janë kolera e kombit. Veprimtaria e tyre destruktive dhe kriminele ka shkuar dhe po shkon në interesin e çakajve të Ballkanit dhe në dëm të interesave tona kombëtare. Motivet e kësaj vrasjeje është lehtë të kuptohën, kur dihet se argatët e Xh. Halitit dhe të I. Kelmendit (që kanë zënë nja 34 karrika në Parlamentin e Kosovës), i përdorën të gjitha mjetet e bllokimit (kurrthe të llojllojshme deri te mjetet e rrugaçërisë) të procesit të krijimit të institucioneve demokratike-shtetore të Kosovës dhe bënë presione të shumta për uzurpimin e organeve ekzekutive të Kosovës. (Edhe pse elektorati nuk ia kishte dhënë këtë të drejtë).

Si çdo vrasje politike edhe vrasja e deputetit Smail Hajdaraj ka për qëllim arritjen e objektivave politike. Me këtë vrasje Qendra e krimit ka për qëllim për t'i frikësuar dhe për të bërë presion të fuqishëm mbi deputetët e luhatshëm të LDK-së, (pasi i frikësuan dhe i bënë argatë shumicën e deputetëve të pakicave hashkali, boshnjake, rome etj.) që në rundin e ardhshëm të votimit për Kryetar të Kosovës të mos e votojnë Ibrahim Rugovën dhe si përfundim i gjithë këtyre presioneve PDK-ja ta marrë postin e kryeministrit të Qeverisë së Kosovës. Po që se i analizojmë ngjarjet që ndodhën në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit 20-të dhe këto që po ndodhin në fillimin e shekullit 21 do të kuptojmë se

Shqipërisë, Kosovës dhe Viseve të tjera shqiptare po i përgaditet humnera nga çakajtë e Ballkanit, ariu i zi i Karpateve të Rusisë, mafija e kuqe ndërkombëtare dhe nga nanosët-talibanët e kuq shqiptarë. Siç dihet, Qendra antishqiptare e krijuar nga armiqtë tanë shekullor, e realizoi pjesën e parë të skenarit për zgjedhjen e qështjes shqiptare si u shkon për shtati atyre më 1997.

## KUSH PO MBJELL FRIKË DHE KUSH PO BËN KRIME TË LLOJLLOJSHME NË KOSOVË?

Ata pasi e kallën dhe e veshën në të zeza Shqipërinë, i prunë në pushtetë spiunët dhe vasalët e tyre : Nanosin, Mejdanin, Klosin & kompani, që t'u ndihmojnë në realizimin e qëllimeve të tyre përfundimtare, që shqiptarët të vazhdojnë edhe më tutje jetën e robit, nën diktatin e tyre edhe për një mijëvjeçarë tjetër. Këta djeg komunistë Shqipërinë shumë shpejt e bënë koloni greke. Krimi i organizuar po lulëzon. Varfëria, skamja dhe padrejtësia po rriten dita ditës, ndërsa mafiozët e kuq po pasurohen dhe po e bëjnë ligjin e xhunglës.

Fatkeqësisht këto forca të djallit të mallkuar që sot po e sundojnë Shqipërinë nuk janë të kënaqur me këto që kanë arritur. Ato duan që edhe Kosovën dhe Viset tjera shqiptare t'i sundojnë pehlivanët e tyre dhe bajraktarët e farës ruse. Mu për këtë njerëzit e tyre edhe pse janë të paktë në numur, po mbjellin frigë dhe po bëjnë krime të llojllojshme në Kosovë, dhe po kanë aftësi të madhe manovruese në saje të ndihmës së pakursyer të vampirëve stalinistë të Tiranës, që ua kanë lanë në shërbim kuadrot më të afta të Sigurimit të fsheftë të tyre, të cilët gjatë sundimit të bandës kriminele të Enver Hoxhës, burgosën dhe vranë pa gjyq nacionalistë, shpianikë dhe intelektualë të vërtetë të Shqipërisë dhe të Kosovës që ikën në Shqipëri nga presioni i dhunës serbo-jugosllave. Këta mjeranë shqipfolës nuk e kanë përkrahjen e popullit shqiptarë të Kosovës. Përkrahja e tyre vjen nga individë të Sigurimit të fsheftë të Beogradit, dhe individëve (dhe ndoshta edhe të familjeve të tyre) që ju dhanë banesa të uzurpuara, vende të punës në TMK-në, apo ju dhanë shitoret e uzurpuara. Por vampirët e kuq të Kosovës po përkrahën edhe nga analfabetë politikë, gazetarë sahanlëpirës, analistët kakuda- ish klyshët dhe zagarët e vetqeverisjes jugosllave, që këtë radhë u shitën për ca eshtra, që po ua hudhin para këmbëve pehlivanët e Nanosit dhe argatët e tyre. Këta mjeranë në cilësinë e redaktorëve dhe të gazetarëve (pothuajse të të gjitha gazetave dhe revistave që botohen në Kosovë) janë të detyruar t'i lehin të

gjithë kundërshtarët politikë të pehlivanëve të Nanosit dhe argatëve të tyre, kur padronët e tyre ju japin urdhra dhe detyra konkrete.

**Talibanët e kuq të Kosovës sytë dhe mendjen i kanë drejtuar në postin e kryeministrit të Kosovës.**

Në veçanti po i ndihmojnë vampirët e kuq të Kosovës "intelektualët" e gjorë që kanë zënë vendin e bordit udhëheqës në RTK-në, apo janë bërë gazetarë dhe udhëheqës të programeve të RTK-së. Këta të gjorë me sukses po i përdorin mjetet e manipulimit dhe po çojnë hi dhe pluhur për ta trulluar arsyen dhe mendjen e shëndoshë të qytetarëve të Kosovës. Sidomos këta qyqarë u treguan manipulus dhe rrogatë të shkathët të kryepehlivanëve të Nanosit, gjatë zgjedhjeve nacionale, dhe gjatë fillimit të ndërtimit të institucioneve demokratike dhe shtetore të Kosovës, kur me mjete perfide, kiminelët e kuq i paraqitnin si "demokratë" të vërtetë, apo i paraqisnin "zemërgjërë", edhe pse u bënë : "lypës dhe zgjedhës". Shpeshherë ata paraqiteshin "engjëj" edhe kur refuzuan pesë ministri që ua fali I.Rugova me të pa drejtë. Por nuk kënaqeshin me kaq talibanët e kuq të Kosovës! Sytë dhe mendjen i kanë të drejtuar në postin e kryeministrit të Kosovës, pra atë post që do t'ua mundësonte që edhe mëtutje t'i vjelin takstat dhe "tatimet" nga shitoret private, ta kenë nënë kontroll manapolin e duhanit, të kefesë, alkooholit, të benzinës dhe naftës. Ky post do t'u mundësojë edhe përvehtësimin e pasurisë shoqërore që do të privatizohet. Por posti i kryeministrit mbi të gjitha do t'ua mundësonte zhdukjen e gjurmëve të krimeve politike dhe ekonomike që i kryen kryepehlivanët e Nanosit, argatët e tyre dhe bajraktarët e farës ruse.

Shtrohet pyetja : Me çfarë formash duhet kundërshtuar dhe me cilat mënyra duhet penguar realizimin e synimeve antishqiptare të armiqve tanë shekullorë, të cilët me mjete perfide i kanë futur në lojrat e tyre stalinistët e Shqipërisë, nanosët dhe kuqaloshët e Kosovës.

LDK-ja dhe forcat tjera demokratike të Kosovës duhet ndërruar formën e veprimtarisë së tyre të deritashme. Mjaft më me "dënime"verbale të krimeve politike! Mjaft më me politikën vajtuese! LDK-ja dhe forcat tjera demokratike kanë mjete shumë më të suksesshme për pengimin dhe zhdukjen e krimit politik dhe ekonomik! LDK-ja dhe forcat tjera demokratike duhet ta ngrisin zërin e protestes edhe me mjete

tjera më efikase. LDK-ja dhe veprimtarët e dalluar të çështjes kombëtare duhet të kërkojnë nga populli i Kosovës, që të bashkëpunojnë me policinë e UNMIK-ut, dhe me SHPK-në, për zbulimin e rrjetit të SHIK-ut, i cili po kërcënon veprimtarë dhe aktivistë të forcave të shëndosha kombëtare, për të ndërprerë veprimtarinë e tyre kombëtare, dhe po kërkojnë prej tyre që të bëjnë argatë dhe klyshë të bajraktarëve të farës ruse. Forcat e shëndosha kombëtare duhet ta krijojnë Qendrën për mbledhjen e fakteve që do ta detyronte policinë e UNMIK-ut për t'i burgosur kriminelët.

**PSE NUK BURGOSËN DHE NUK DËNOHEN KRIMINELËT QË E VRANË XHEMAJL MUSTAFËN?**

LDK-ja dhe forcat tjera demokratike të Kosovës duhet sa më parë të organizojnë qytetarët e Kosovës për të protestuar në mënyrë të qetë, kundër dhunës politike, kundër uzurpimeve ekonomike dhe për të kërkuar nga qendrat e vendosjes ndërkombëtare, nga KFOR-i, UNMIK-u, SHBA-të dhe Anglia që sa më parë të burgoset kreu i mafisë politiko-ekonomike, që kanë zënë pozita udhëheqese në subjekte politike shqiptare, dhe janë bërë deputetë në Parlamentin e Kosovës. LDK-ja, forcat tjera politike, dhe Parlamenti i Kosovës duhet sa më parë të kërkojnë përgjegjësi nga përgjegjësit e Polisisë së UNMIK-ut, që nuk e ndriquan as një vrasje politike, që nuk e dënuan as një kriminel që dha urdhër për të bërë krime politike, edhe pse kanë njohuri dhe fakte të shumta për aktorët e të gjitha krimet politike që janë bërë në Kosovë gjatë luftës dhe pas luftës. Pse zhagitet dënimi i kriminelëve që e vranë Shaban Manajn dhe komandant "Drinin"? Pse nuk burgosen dhe nuk dënohen kriminelët që e vranë Xhemal Mustafën, kur policia e UNMIK-ut ka fakte të mjaftueshme? Pse nuk fillohet procedura për dënimin e Sabit Gecit për krime lufte, kur policia ka fakte të mjaftueshme se ai e ka vrarë Haki Imerin dhe ka marrë pjesë në vrasjen e Ahmet Krasniqit dhe ka bërë vrasje tjera?! Pse nuk po burgosen kriminelët që e vranë Bekim Kastratin dhe Besim Dajakun dhe plagosën e Gani Gecin, kur policia e UNMIK-ut i di të gjithë pjesëmarrësit e këtij krimi?! Pse...Pse...Pse...?!

Mosefikasiteti i plicisë së UNMIK-ut, në kapjen dhe dënimin e kriminelëve, po u japin forcë dhe sinjale të gabuara bajraktarëve të farës ruse, dhe kreut të SHIK-ut, se duhet për të vazhduar me shantazhe, kërcënime dhe krime. Prandaj subjektet politike dhe Parlamenti i Kosovës duhet t'ua bëjnë të qartë qendrave të vendosjes ndërkombëtare dhe aleatëve tanë të sinqertë se moszbulimi i Qendrës së krimit dhe

mosburgosja dhe dënimi i kriminelëve të të gjitha kategorive (kriminelëve që japin urdhëra për krim dhe dorasve që bëjnë krime), nga ana e Policisë së UNMIK-ut, që është përgjegjëse për sigurinë e qytetarëve të Kosovës, po u japin forcë politike dhe përkrahje morale kriminelëve të Kosovës për të bërë krime edhe më të mëdha dhe më të rrezikshme. Po qe se vazhdohet me politiken e deritashme ndaj kriminelëve, krimi i organizuar do të organizohet dhe forcohet edhe më shumë. Në Kosovë do të mberërojë krimi i organizuar. SHIK-u i Kosovës edhe tash është më i pamëshirshëm se sa UDB-ja e Rankoviqit, pasi që udbashët në kohë paqeje nuk kanë vrarë shqiptarë pas shpine, nuk kanë vrarë shqiptarë në këtë mënyrë qyqare, qysh po na vrasin nanoistët, bajraktarët e farës ruse dhe "pionerët e Enverit". Po qe se lihën të lirë kriminelët, po qe se nuk ndërmerren masa të duhura për shkatërrimin e Qendrës së krimit, në Kosovë do të mbretërojë regjimi i talibanëve të Avganistanit. I vetmi dallim në mes talibanëve afganë dhe nanoistëve (talibanëve të kuq të Kosovës) do të ishte se talibanët e Avganistanit e keqpërdorën fenë dhe Zotin për të mbajtur pushtetin e tyre të dhunës dhe të terrorit, ndërsa talibanët e kuq të Kosovës, (nanoistët) pasi që fe dhe Zot nuk kanë, ata po e keqpërdorin çlirimin e Kosovës dhe gjakun e derdhur të dëshmorëve të kombit për interesat e tyre personale, klanore dhe grupe. Këto interesa këta qyqarë nuk mund t'i mbrojnë në mënyrë tjetër përpos me dhunë, prandaj Kosovës po i përgaditët një tragjedi edhe më e madhe se atë që e përjetoi gjatë luftës së fundit që u zhvillua në Kosovë.

Dhuna sjell dhunën. Padrejtësia sjell skamje, varfëri dhe revoltë. Dhe të gjitha këto së bashku sjellin luftën. Një luftë vëllavrasëse nuk u duhet shqiptarëve, por serbët dhe grekët atë e duan. Bajraktarët e farës ruse, që sot kanë përkrahjen e çakajve të Ballkanit, të Rusisë dhe të mafisë së kuqe ndërkombëtare, po i përdorin të gjitha mjetet e dhunës për ta marrë pushtetin mbi shqiptarët e Kosovës, edhe pse e dijnë fort mirë se nuk e kanë përkrahjen e popullit. Vota e tij e lirë ua tregoj se ku e kanë vendin. Edhe pse Daen Everts bëri manipulimin e rezultatit të votave, edhe pse ky mik i Serbisë i falsifikoi numrin e votave në dobi të dy bishtave të Partisë Socialiste të Shqipërisë : PDK-së dhe AAK-së, edhe pse pehlivanat e Nanosit i murën ato vota në saje të kërcënimeve dhe në saje të premtimeve boshe, numri i vendeve që muarën në Parlamentin e Kosovës tregon se ato forca të djallit të mallkuar nuk e kanë vendin në



ballë të votrës, por e kanë vendin pas derës. LDK-ja dhe forcat e shëndosha kombëtare në as një mënyrë nuk duhet lejuar që vendin e kryeministrit t'ia falin PDK-së. Të gjitha krimet politike që i kanë bërë pehlivanët e Nanosit dhe argatët e tyre gjatë luftës dhe pas luftës, patën për qëllim marjen e pushtetit dhe shtrirjen për tokë të nacionalizmit shqiptarë, që për ta dhe ideologët e farës ruse ishte dhe është armiku më i madh i tyre. Shqipëria, Kosova, Viset tjera shqiptare dhe shqiptaria do të jenë në stam të humnerës për derisa forcat e shëndosha kombëtare nuk arrijnë fitorën përfundimtare mbi forcat e djallit të mallkuar : stalinistët, nanoistët, bajraktarët e farës ruse, "pionerët e Enverit" dhe rroghtarët e tyre, të cilët ishin dhe janë mashë në duar të sigurimeve të fshehta të Sebisë, të Greqisë dhe të Rusisë.

*Botuar: "Bota sot" 27.01.-30.01.2002*

## KUSH E KA KEQËPËRDORË DHE KUSH PO E KEQËPËRDORË LUFTËN ÇLIRIMTARE TË POPULLIT TONË?

Është e njohur se të gjitha luftat çlirimtare, kudo që janë zhvilluar në botë, kanë filluar me synimet më të mira, për realizimin e qëllimeve madhore të popujve të shtypur. Por në shumicën e rasteve, këto luftëra, në fazat e mëvonshme të zhvillimit, e veçmas në fazën përfundimtare të tyre, janë degjeneruar nga grupe karrieristësh, për qëllime karrieriste, dhe kanë përfunduar pa arritur realizimin e synime për të cilat kanë filluar. Sa për ilustrim mund të mirret lufta çlirimtare të popullit kinez. Lufta për pushtet në mes komunistëve dhe nacionalistëve solli luftën qytetare, që për pasojë pati krijimin e dy shteteve kineze. Të njëjtin fat e pati edhe lufta çlirimtare e popullit vietnamez dhe atij korean. Ndërsa populli algjeran edhe pse i shporri okupatorët franqezë nga vendi i tij para dyzet vitesh, ende nuk po arrin t'i shërojë plagët e degjenerimit të luftës së tij çlirimtare, si pasojë e luftës për pushtet të grupeve rivale.

Edhe lufta e popullit tonë për çlirim dhe bashkim kombëtar dështoi në të gjitha periudhat e zhvillimit të saj, si pasojë e degjenerimit, e kapriceve të parisë shqiptare apo ashpërsimit të luftës për pushtet. Po që se analizojmë luftën e popullit tonë për çlirim dhe bashkim kombëtarë gjatë Luftës së Dytë Botërore do të shohim se degjenerimi i saj ndodhi mu në fillimin e saj, atëherë kur sigurimi serb arriti të krijojë kolonen e pestë në Shtabin komandues të Ushtrisë Çlirimtare të Shqipërisë. Siç dihet Millan Popoviqi dhe Dushan Mugosha u bënë skllavopronarë të udhëheqjes ushtarake të partizanëve shqiptarë, (Enver Hoxha, Koçi Coxë, Fadil Hoxha e të tjerë), që i kontrollonin se a po i kryejnë urdhërat e Titos, Moshe Pijadës, Bakariqit dhe të Rankoviqit. Dhe sot pas gjysmë shekulli mund të thuhet me plot të drejtë se Shqipëria arriti të bëhet koloni greke, arriti të bëhet qendra e krimit të organizuar për gjitha trojet etnike shqiptare, u bë gazi i botës, si pasojë e thyerjes së Marrëveshtjes së Mukjes, që parashihte krijimin e një fronti të përbashkët në mes forcave nacionaliste dhe majtiste të Shqipërisë për çlirim dhe bashkim kombëtar. Siç dihet këtë marrëveshtje e theu M. Popoviqi dhe D. Mugosha kur e detyruan skllëvin e tyre E. Hoxhën ta shpallë të pa vlefshme. Fatkeqësisht neve shqiptarëve qysh moti na ka "humbur rruga në oborr" që kur po na

përsëritet historia, po na përsëriten dështimet, dhe nuk po mund të vijmë në veti fare. Ende nuk kemi filluar të ecim me këmbët tona përpara, siç po ecin popujt tjerë të Evropës! Po zhagitem në këmbë e duar, dhe po sillemi rreth vetvetes, dhe kështu siç jemi, nuk kemi mundesi të merremi me ato forca që në këtë gjandje na prunë. Dhe për çudi, po qe se ndodh të lindë ndonjë burrë nënë, që fillon të eci dhe t'i mësojë të tjerët të ecin përpara, do t'i qitën kurthe nga gjytyrimët dhe sakatët në kokë, nga shpirtëzinjtë, nga kriminelët. Do të pengohën me të gjitha mënyrat, nga ajo fara e keqe që na e mbollën kryedjajtë e Karpateve. Fillimi i viteteve të "90-ta, sollën ndryshime të mëdha në Evropë dhe në botë. Kryedjalli komunist u shtri për tokë! Edhe ne shqiptarët filluam të gëzohemi dhe të shpresojmë se më në fund na erdhi "vera te dera"! I arritëm ca suksese. Në Tiranë u shemb diktatura e kuqe! Në Prishtinë krijoheshin parakushtet për t'i prer prangat e robritë serbo-jugosllave! Por egjra komuniste nuk po i lëshonte edhe aq lehtë shqiptarët! Fjalë shumë e punë pak kishin demokratët! Punë shumë dhe fjalë pak kishin komunistët! Komunistët shqiptarë bënë marrëveshtje dhe aleanca në mes tyre për t'ua marrë pushtetin demokratëve. E dinin komunistët se me votën e popullit nuk vinë dot më në pushtet, por nuk mërzhiteshin ata për votën e tij, se kishin metoda tjera, shumë të sigurta që do t'i sjellin ata përsëri në pushtet. Ishte Makjaveli ai që komunistët i udhëzoi se si ta mbajnë pushtetin. Pse të mos kërkojnë prap ndihmën e tij, që prap ta rikthejnë pushtetin, duke u mbështetur në parimin e tij se "qëllimi i arsyeton mjetët?" Dhe ashtu ndodhi. Komunistët e Shqipërisë e dinin se lëpëkistët e diasporës shqiptare kanë fonde. Nanosi bëri përgaditje të duhura. Ishte i zoti në demagogji. I përkdheli krerët e LPK-së sikut të ish-in fëmijë qilimi. I ngriti "në pyka", i bëri "subjekt politik" i bëri "palë të barabartë", qëllimi i të cilit ishte, t'ua marrte fondet që i kishin krijuar me djerësën e kurbetçarëve, që i kishin ndarë nga kafshata e gojës, për ta ndihmuar rezistencën që bëhej në Kosovë kundër dhunës serbo-jugosllave. Dhe të dy palët arritën një marrëveshtje. Marrëveshtja u lidh në Zürih (Zvicër) në pranverën e vitit 1993, ku morën pjesë krerët e LPK-së në krye me Xh. Halitin, dhe krerët e PSSH në krye me Fatos Nanosin. Marrëveshtja parashihte që të "dy palët" ta ndihmojnë njëra -tjetren pa hile për të ardhur në pushtet. Lëpëkistët u zotuan se do t'ua japin të gjitha fondet që i kishin, por edhe do të krijojnë fonde të reja, për ta rrëxuar demokartin e brishtë të Shqipërisë, që shumë ngadal forcohej. Ndërsa

Nanosi & kompani u zotua se pasi ta rrëzojnë demokracinë dhe Salih Berishën dhe ta forcojnë pushtetin e tyre në Shqipëri do t'u ndihmojnë për ta shkatërruar LDK-në dhe për ta larguar nga skena politike Ibrahim Rugovën, që lëpëkistët pastaj të bëhën padronët e Kosovës, ndërsa LPK-ja forca politike kryesore në viset shqiptare të pushtuara nga serbo-jugosllavët. Të dy palët u ndanë të kënaqur nga kjo marrëveshje, Nanosi i mbushi xhepat me franga zvicëra (kisti i parë përbëhej prej 600.000 frangave), ndërsa lëpëkistët që nuk kishin kurrfarë force politike në Kosovë dhe në diasporë, filluan të azganojnë, duke shpresuar se paraqja që e investuan në rrëzimin e demokracisë në Shqipëri një ditë do t'i bënte të "fuqishëm".

Siç dihet të dy palët thurnin komplotte, ndërkamsa dhe kurthe kundër forcave demokratike shqiptare, por lëpëkistët kishin për të realizuar edhe një detyrë të rëndësishme strategjike. Duhet përvetësuar njësitë guerile të Republikës së Kosovës. Por pa ndihmën e Bukoshit ishte iluzore edhe të mendohet realizimi i këtij objekti. Bukoshi lidhi bishta me I. Kelmendin, me Qosjen, Hidajetin dhe jaranat e tyre, që i kishte në kabinetin e Qeverisë së tij. Nuk arriti tu përballonte presioneve të tyre. Ia mbushën mendjen t'i tradhtonte shokët e tij më të ngushtë, që e bënë faktorë të rëndësishëm të Republikës së Kosovës. Më në fund Bukoshi u bë tradhtar! Arsimin nuk e ndihmonte me rregull. Presidencën kohë pas kohe e bllokonte, por kulmin e të gjitha të ligave e arriti kur njësitë guerile të Republikës së Kosovës nuk ju dha kurrfarë ndihmash edhe pse personalisht i njihte komandantët e tyre. Ai u bë dorëllirë për t'i dhënë tëholla Xh. Halitit me kompani, që në procesverbale e kishin krijuar subjektin ushtarak-UÇK-në, me Shtab Qendror, me udhëheqje politike, por u bë dorështërnguar për njësitë guerile të Republikës së Kosovës që i komandonin Adem dhe Hamzë Jashari, Salih Çeku dhe Zahir Pajaziti dhe kështu mbetën pa përkrahjen materjale të Qeverisë së Kosovës. Ky ishte një komplot perfid i Bukoshit, Xh. Halitit, H. Hysenit dhe i R. Qosjes që këto njësi dhe këta komandantë të futën nën komandën e njerëzëve të besueshëm të tyre. LPK-ja ishte e vogël me anëtarësi por sherrin e kishte të madhë. Ajo menjëherë pas arritjes së Marrëveshtjes së Zërihit e krijuan në procesverbalet e tyre subjektin ushtarak dhe e pagzuan UÇK, duke shpresuar se emni i bukur dhe tërheqës, dhe ndihma materjale që ju ofruan komandantëve të parë të njërive guerile që vepronin në Kosovë do t'i qesin në kurthë, dhe pastaj me mjete perfide do

t'i përvehtësojnë ata së bashku me njësitë e tyre. Më vonë u bënë edhe shumë komplete tjera, (që natyra e këtij shkrimi nuk lejon të përmendën të gjitha, kur veç njëherë më herët janë thënë).

## ARGATË TË NANOSIT DHE TË KLOSIT E KRIJUAN QENDRËN E KRIMIT (SHIK-un) NË KOSOVË

Dhe pas katër vitesh pune me përkushtim, stalinistët shqiptarë arritën ta rrëzojnë demokracinë e brishtë në Shqipëri, por u rrëzua edhe Shqipëria "me krye për dhe". Ia shtinë flakën Shqipërisë komunistët së bashku me bandat greke, të ndihmuar edhe nga paraja e shkaut dhe e lëpëkistave të Kosovës. Viti 1997 do të jetë viti më kobzi në historinë tonë kombëtare! Shqipëria u mbulua me të zeza! Kosova mbet pa krah! Asaj i përgaditej humnera! Në këto kushte tejet të vështira për kombin shqiptarë LPK-ja arriti të bëjë përvehtësimin e njërive guerile të Republikës së Kosovës. Bukoshi haptas kaloi në anën e komplotistëve të Kosovës. "Pionerët e Enverit" që ishin futur në LDK për ta marrë "kalanë nga mbrenda" nuk lan gjë pa bërë vetëm ta shkatërrojnë LDK-në. Drenica kallej flakë, si pasojë e veprimtarisë antishqiptare të argatëve të Nanosit, të cilët donin ta fusnin në luftë frontale komandantin legjitim të njërive guerile të Republikës së Kosovës, Adem Jasharin, që Serbia t'ua hiqte qafe, sepse nuk arritën ta hasmojnë me subjektet shtetore të Republikës së Kosovës edhe pse i përdorën të gjitha mjetet e presionit. Dhe ashtu ndodhi siç planifikuan strategët e LPK-së. Adem dhe Hamzë Jashari me familje u bënë kurbanë të çështjes madhore kombëtare, çëndruan si burrat jo vetëm ata, por edhe fëmijët edhe gratë e fisit. Ademi, Hamza, Mixha Shaban me nipa e mbesa e mbajtën frontin e luftës çlirimtare me Serbinë tri ditë të gjata, por zëri i pushkës së lëpëkistëve askun nuk u dëgju! Tradhtia nuk ka fund! Kosova përjetonte ditë të vështira! Në ato kushte Qosja me Hydajet Hysenin dhe me Bajram Kosomin krijuan LBDK-në, e cila së bashku me Beogradin nuk i njohën institucionet shtetore të dala nga vota e lirë e popullit! Tani ndryshuan raportet ndërshqiptare dhe ato regjionale! Faktori shqiptar nuk kishte kurrfarë rëndësie praktike për Beogradin, sepse tehu i luftes së shqiptarëve nuk ishte i drejtuar kundër Serbisë, por ishte i drejtuar kundër njëri tjetrit! Nanosi që ishte miku i grekëve dhe i serbëve dhe padroni i lëpëkistëve, e dirigjonte frontin e luftës në Kosovë, në bazë të marrëveshtjes së Zürihut dhe më vonë edhe në bazë të marrëveshtjes së Kretës (që u lidh në mes Nanosit dhe Milloshit).

Në anën tjetër oficerët tanë që ishin shkolluar jashtë Kosovës, e dinin se ishte koha t'i tregojnë aftësitë e tyre organizative dhe komanduese. Kur u kall Shqipëria nga komunistët shqiptar dhe grupet kriminele greke, shprehën gatishmerinë t'i dalin në ndihmë Shqipërisë po qe se forcat greke futën në Shqipëri. E krijuan subjektin ushtarak që do t'i kordinonte të gjitha punët rreth mbrojtjes së Kosovës nga forcat serbe. Kjo punë e tyre e qitën para aktit të kryer Bujar Bukoshin, kur delegacioni i përbërë nga ushtarakët që i përfaqësonin të gjitha grupet ushtarake në diasporë dhe në Kosovë e caktuan kolonel Ahmet Krasniqin kordinator për të gjitha grupet ushtarake që ishin krijuar në të gjitha shtetet ku jetonin dhe punonin shqiptarët. Ministria e Mbrojtjes u krijua në krye me Ahmet Krasniqin, por LBDK-ja dhe LPK-ja nuk donin kurrfar bashkëpunimi me LDK-në dhe as me institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, Presidencën-Presidentin, Parlamentin, Kryeparlamentarin, ndërsa me Qeverinë e Kosovës kishin kontakte të mshefta dhe kontakte të hapta. Këto forca të përçarjes shqiptare, këta plangëprishës të Kosovës, këta argatë të Nanosit na e dëmtuan shumë çështjen kombëtare, kur e shkelën marrëveshtjen e Oslos që u lidh në mes Ahmet Krasniqit dhe Adem Demaçit, që parashihte bashkimin e faktorit ushtarak shqiptar (Ministrinë e Mbrojtjes dhe UÇK-në) në një forcë të vetme në FARK. Shkelja e kësaj marrëveshjeje nga Xh. Haliti, LPK-ja dhe krerët e LBDK-së, pati dhe do të ketë pasoja tepër të rënda për Kosovën, për Shqipërinë dhe çështjen madhre kombëtare, siç pati pasoja për Shqipërinë dhe për shqiptarë thyerja e marrëveshtjes së Mukjes nga ana e komunistëve shqiptarë. Siç dihet komunistët në të dy anët e kufirit shqiptaro-shqiptarë, duke u nisur nga parimi se "qëllimi i arsyeton mjetet" i vranë kundërshtarët e tyre politik gjatë luftës së Dytë Botërore. Të njëjtën rrugë e ndoqën nanoitët e Shqipërisë më 1997 dhe nanoistët kosovarë gjatë periudhës 1998/ 2003. Të gjitha vrasjet politike që u bënë në Kosovë gjatë luftës dhe pas luftës duhet kërkuar te krerët e ish- LBDK-së dhe te krerët e dy bishtave të Partisë Socialiste të Shqipërisë që u krijuan pas lufte në Kosovë, (PDK-ja dhe AAK-ja). Ndërkaq qerdhën e kriminelëve duhet kërkuar në TMK-në e A. Çekut. Këta argatë të Nanosit dhe të Klosit e krijuan qendren e krimit (SHIK-un) në Kosovë. Ka shumë fakte se SHIK-u i tyre i ka shtrirë rrënjët në të gjitha vendbanimet e Kosovës, por edhe jashtë saj, ku pjesëtarët e tij merren me tubimin e informatave, me kërcënime, por kur të jepen urdhëra prej së larti, bëjnë përgaditjet e duhura që kriminelët

profesional pe pengesa( pa vështirësi) të realizojnë detyrën që ua ka dhënë qendra e krimit për t'i pushkatuar kundërshtarët politik të padronëve të tyre. Ka shumë fakte se në krime janë të përzier kreu i ish -LBDK-së, kreu i PDK-së, AAK-së, dhe i TMK-së. Shtrohet pyetja, pse edhe pas katër vitesh nuk u shtrua çështja e zbulimit të sigurimsave të Serbisë (nga krerët e subjekteve politike dhe të sigurisë civile që u përmendën më lart), që u futën në njësitë e UÇK-së, për t'i qitur në prita ushtarët dhe komandantët e vërtetë të UÇK-së në Shqipëri dhe në Kosovë. Asnjë fjalë nuk e flasin krerët e subjekteve politike dhe të sigurisë civile të cekura më lartë, se kush e zbuloi Zahir Pajazitin dhe kush e qiti në pritën e shkaut! As një fjalë nuk e flasin plangprishësit e Kosovës për të mësuar se si dhe kush e qiti në pritën e UDB-së së Tiranës Ilir Konushëcin në Tropojë! Asnjë fjalë nuk follet për të zbuluar se kush e qiti në pritën e shkaut komandant Tonin me shokë në Rahovec. Nuk flasin as për atentatet dhe komplotet që iu bënë komandantëve të njësisë operative të UÇK-së, që ishin nën komandën e Ministrisë së Mbrotjtjes të Republikës së Kosovës. Asnjë fjalë nuk e flasin këta mjeranë për të mësuar se kush i qiti në pritën e ushtrisë serbe qindra djem, që ende nuk i kishin rënë brisk ftyrës, të cilët nga diaspora shqiptare ktheheshin në vendlindje për ta ndihmuar luftën çlirimtare të Kosovës. Dhe krerët e "shoqatave të dala nga lufta" byrytën nepër tubimet që ata i organizojnë, për ta mbrojtur Fatmir Limën, të mos i nënshtrohet hetimeve për dyshimin se ai është përgjegjës për rrëmbimin, maltretimin dhe vrasjen e civilëve serb dhe shqiptar. A thua nuk e dinë këta argatë të Xh. Halitit e të H.Thaçit se Fatmir Limaj është përgjegjës së bashku me Musë Jasharin, H.Thaçin, J. Krasniqin dhe Xh. Halitin për masakren e Rahovecit, sepse e thyen marrëveshjen që e lidhën me komandant Tonin, që të mos qelet kurrfarë front lufte në Rahovec, por ata e shfrytëzuan mungesën e tij (që kishte shkuar për armë në Shqipëri) dhe e filluan avanturën, që i kushtoi shumë shtrenjtë Rahovecit dhe Kosovës. Siç dihet aventura e tyre ushtarake i solli jo vetëm tragjedi Rahovecit por i solli tragjedi gjithë Kosovës kur me kaqikun e tyre të streincës në dijet e artit ushtarak, e bënë planin për thyerjen e kufirit shqiptaro-shqiptarë në afërsi të Morinës, me emrin "Shigjeta". Një avanturë edhe më e trashanike se e Rahovecit. Vetëm mëshira e të Madhit Zot i shpëtoi me mijëra djelmosha tanë, që i komandonin analfabetët ushtarakë: Fatmir Limaj, Jakup Krasniqi, Musa Jashari, Hashim Thaçi etj, nga vdekja e sigurt, kur në momentet kur jeta e

ushtarëve tanë ishte vu në bahe nga "eprrorët e tyre ushtarak" aeroplanët e NATO-s i sulmuan njësitë elite serbe që i kishin rrethuar njësitë e "strategut" dhe "komandantit" më të "suksesshëm të UÇK-së", "komandant çelikut"- pshtjellakut dhe bërblaqit Fatmir Limës. Dhe si të mos habitesh me paftyresinë e krerëve të "shoqatave të dala nga lufta", që në vend se të mirrëm me problemet sociale të shtreses së popullësisë që më së shumti janë dëmtuar nga lufta, për çka edhe janë formuar ato shoqata, (a thua sa të holla i kanë derdhur në fondet e këtyre shoqatave pasanikët e Kosovës-komandantët e UÇK-së, që po i mbrojnë krerët e këtyre shoqatave?) ata po kryejnë punën e rroghtarëve dhe të shërbëtorëve të pasanikëve të Kosovës, që u bënë të pasur në saje të punëve të pista dhe në saje të përvehtësimit të luftës, mundit dhe gjakut të burrave më të mirë të kombit.

Zhurma që këto ditë u bë nga mjetet e opinionit publik që drejtohen nga rroghtarët e Xh. Halitit me kompani dhe të sorrosëve të Kosovës, se me burgosjen e "çlirimtarëve" të Kosovës nga Gjykata e Hagës po "shkelet gjaku i dëshmorëve" dhe po "shkelën vlerat e luftës", ka një prapavijë që ka për synim mbylljen e dosjeve të luftës, që do të qonte në amnestimin e spiunëve dhe kriminelëve të ndryshëm që hynë në radhët e UÇK-së. Vetë fakti se strukturat udhëheqëse të TMK-së, krerët e ish -LBKD-së, krerët e PDK-së dhe të AAK-së nuk e ngritën çështjen e zbulimit të spiunëve që i qitën në prita të shkaut komandantët e vërtetë të UÇK-së, (që nuk pranuan të bëhën shërbëtorë të nanoistëve) tregon se në dosjen e krimit janë të përzirë edhe shumë mjeranë të këtyre subjekteve politike që kanë ndikim të madh në subjektet e lartëpërmendura.

Pas çlirimit të Kosovës, lufta e popullit tonë për çlirim dhe bashkim kombëtarë u keqpërdor në shumë mënyra, mu nga ato forca dhe individë që e keqpërdorën dhe e penguan atë, para, gjatë dhe pas luftës. Pra gjakun e dëshmorve e shkelën dhe po e shkelin ata individ dhe grupe individësh që sot po rrahin gjoks se ata janë që e " çliruan Kosovën", edhe pse është e ditur se ishin dorë e djathtë e Beogradit, pasi që nuk lejuan të bashkohet faktori politik dhe ushtarak i Republikës së Kosovës. Ata e thyen marrëveshtjen e Osllos që i bashkonte forcat ushtarake të Republikës së Kosovës në një subjekt të vetëm ushtarak, në FARK. Ata nuk lejuan të bëhet UÇK-ja ushtri e institucionalizuar, ushtri kombëtare e Republikës së Kosovës, ushtria më e madhe e Ballkanit e cila do të bënte vetë çlirimin e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare, kuptohet me ndihmën



morale, materjale dhe diplomatike të miqve dhe aleatëve tanë. Pra, se kush e keqpërdori luftën çlirimtare të Kosovës dhe e shkeli gjakun e dëshmorëve tanë është shumë lehtë për ta kuptuar. Mjafton një vizitë t'i bëhet Kosovës. Në qytete dhe fshatra bijnë në sy pallatet shumëkatshe dhe veturat e bukura të ish komandantëve të UÇK-së. Dhe shtrohet pyetja kah i bënë gjithë këto pasuri azilantët e Kosovës që sa jetonin në shtete të Evropës Perendimore jatonin prej ndihmave sociale?! Përgjigja është e qartë dhe e lehtë, sepse siç thotë dr. Mehmet Rrukiçi : „Populli është kamerë e fshehtë”. Populli i vëzhgoi të "merituarit e Kosovës" që na e "çliruan Kosovën" dhe nuk ju bëri zë dhe as nuk i çortoi, edhe pse i shihte se e kanë rrokur kajten. Përvehtësuan, lokale, pasuri private dhe shoqërore. Zapunë troje, punishte dhe fabrika. Ju qitën tatime të varfërve që i mbanin shitoret në shtëpitë e tyre. U lidhën me "afaristët" që Jugosllavia pak para luftës i bëri pasanikë të Kosovës, dhe së bashku me ta (dhe me ndërkombëtarë të komprimuar) e bënë mafinë e Kosovës (ekonomike dhe politike) që më lehtë të bëjnë kontrabandë me kontrabandistë serbë, bullgarë, turq e djaj të ndryshëm ndërkombëtarë. Një pyetje për krerët e shoqatave të dala nga lufta, avokatët e rrugës. A thua kështu siç po veproni ju mbrohen vlerat e luftës çlirimtare, mbrohen dëshmorët?! Athua kështu siç veproni ju mbrohet drejtësia, mbrohen invalidët e luftës, jetimët, familjet e dëshmorëve dhe të masakruarëve?! Jo zotëri gjeniu popullor na mëson se s'ka mal pa ujë dhe mësimi tjetër se shtëpia duhet pastruar nga bërllogu. Pra zotërinjë UÇK-ja ishte një mal, ku përpos luftëtarëve të lirisë kishte në mesin e tyre edhe ujë, dhelpra dhe çakaj. Po që se shiqohën gjërat me arsyen e juaj të verbuar, edhe spiunët serbë që u futën në radhët e UÇK-së me uniforma dhe grada dhe tituj të lartë të komandimit, do të amnastohën vetëm që i bajtën uniformat e UÇK-së, dhe do të mbajnë edhe më tutje pozitat e larta që i kanë zapuar në institucionet partiake, shtetore dhe shoqërore të Kosovës. Pra ata edhe pse i bënë shumë kurtha dhe ndërskamsa Luftës Çlirimtare të popullit tonë, edhe pse bënë përçarje të thella në mes subjekteve shqiptare, edhe pse e penguan UÇK-në në të gjitha mënyrat, edhe pse kërcnuan, rrëmbyen, maltretuan, burgosën, dhunuan, dhe vranë qytetarë të Kosovës, për shkakun e thjeshtë se nuk i përkisnin kopesë së tyre komuniste, (por i përkisnin forcave demokratike që i njihnin institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës) duhet të janë të paprekshëm dhe të konsiderohen vlera të luftës çlirimtare.

## RROGTARËT E NANOSIT PO ORGANIZOJNË DEMONSTRATA DUKE I MANIPULUAR MENDJESHKURTËRIT.

Sot kur Gjykata Ndërkombëtare e Hagës i arrestoi shqiptarët e parë të dyshuar për krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, siç janë arrestuar dhe po arrestohen në gjithë hapsirën teritoriale të ish Jugosllavisë, kryepëhlivanët e Nanosit nepërmjet rrogëtarëve të tyre që i kanë vënë në krye të "shoqatave të dala nga lufta" po organizojnë demonstrata nepër qytetet e Kosovës, duke i manipuluar mendjeshkurtërit dhe ata që "hunda nuk i lejon të hanë barë", me anë të parullave demagogjike, se me arrestimin e "çlirimtarëve" (ushtarëve dhe komandantëve të vetëshpallur të UÇK-së) nga Gjykata e Hagës, "po shkelen vlerat e luftës" dhe po "shkelet gjaku i dëshmorëve" tanë. Siç dihet kryepëhlivanat e Nanosit në të njëjtën mënyrë, si tash, organizuan demonstrata kundër arrestimit (nga policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i) të ish - "komandantëve" të vetëshpallur të UÇK-së siç ishte rasti me burgosjen e Sabit Gecit, kryshefit të Policisë sekrete të UÇK-së, Salih Veselit & kompani, Grupit të Deçanit dhe Grupit të Llapit, që disa prej tyre janë duke i vuajtur dënimet dhe të tjerët së shpejti do ta marrin dënimin e merituar për krimet që i bënë kundër bashkëkombasve të tyre, që nuk i përkisnin kopesë së tyre ideologjike të pansllavizmit rus.

Për njohësit e rrethanave ballkanike dhe ndërshqiptare nuk janë të papritura këto veprimtari antishqiptare të kryepëhlivanëve të Nanosit, që nën sundimin e tyre i kanë futur përpos ish-sigurimsat e ish -UDB-ës jugosllave, edhe shumë mjeranë "intelektualë", ish - "atdhetarë" karrieristë, dhe "gazetarë" sahanlëpirës, të cilët për të arritur synimet e tyre personale, pranuan të bëhën shërbëtorë pa gojë e pa bosht kurrizor (në politikë, ekonomi dhe në mjetet e opinionit publik). Fatkeqësisht këto mbeturina të robërisë serbo-jugosllave, këta qyqarë, nuk janë të vetëdijshëm për dëmet që i sollën dhe po i sjellin luftës sonë çlirimtare, Kosovës dhe synimeve madhore të qytetarëve të saj, me veprimtarinë e tyre kriminele dhe destabilizuese, duke u mbështetur në parimin e Makiavelit se "qëllimi i arsyeton mjetet".

Të demostrosht nepër rrugët e qyteteve të Kosovës dhe të kërkosh lirimin e të dyshuarëve për krime të luftës, pa përfundimin e procedurës hetimore, (që mbështetet vetëm në fakte të dokumentuara mirë) nuk është "vepër kombëtare", apo "mbrojtje e vlerave të luftës dhe mbrojtje e gjakut të dëshmorëve tanë" siç thonë plangprishësit e Kosovës, (që e udhëheqin

qendrën e krimit në Kosovë) dhe shërbëtorët e tyre "papagaj", por përkundrazi është një vepër antishqiptare, është një vepër e shëmtuar, që kanë për qëllim ta njollosin edhe luftën çlirimtare të popullit tonë edhe gjakun e derdhur rrëke të dëshmorëve dhe martirëve tanë, vetëm që ta shpëtojnë lëkurën e tyre prej gjarpri, vetëm të shpëtojnë nga dënimi që po i pretë, për të ligat që ia sollën Kosovës, shqiptarisë dhe qytetarëve të Kosovës. Por ata edhe pse janë të vetëdijshëm se nuk mund t'i shpëtojnë dënimit, se e "vërteta vonon por nuk harron", po bëjnë përpjekje ashtu sikur se ai i mbyturi në lum, që kapet edhe për një fije bari, që kapet edhe për shkumë, duke shpresuar se e ka gjetur shpëtimin.

**ME PARULLAT DEMOGAGJIKE NANOISTËT DREDHAXHI, PO I ORGANIZOJNË "PROTESTAT"!**

Organizatorët e "protestave" nuk e kanë hallin e F.Limajt dhe as të ushtarëve që i kanë kryer urdhërat e tyre, (se janë të vetëdijshëm se protestat e tyre nuk kanë kurrfar efekti në Gjykatën e Hagës), por e kanë hallin e tyre, që një ditë do të detyrohën të japin llogari para organeve të drejtësisë së vendit apo ndërkombëtare, për të ligat që ia bënë Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Pra kryepëhlivanët e Nanosit dhe argatët e tyre që po i organizojnë demonstratat shpresojnë se me protesta do të arrijnë disa objektiva që janë shumë të rëndësishëm për ta. Do të arrijnë t'i frigojnë dhe t'ua mbyllin gojën atyre familjeve që u dëmtuan prej tyre gjatë luftës dhe pas luftës, që të mos flasin për të dashurit e tyre, që u keqtrajtuat u keqpërdorën(u dhunuan) dhe u pushkatuan nga personat me uniforma të zezë të UÇK-së, që ishin dhe që janë nën sundimin e tyre. Presion edhe më të madh mbi familjet që u dëmtuan nga pëhlivanat e Nanosit dhe dëshmitarët okular për t'ua mbyllur gojën, po bëjnë edhe gazetarët sahanlëpirës, që po i drejojnë dhe po punojnë për mjetet e opinionit publik, që janë bërë lavire të pëhlivanave të Nanosit dhe të kryekuqaloshve shqiptarë, por do të jenë të kota përpjekjet e tyre, se një ditë edhe ata do të përgjigjen për veprimtarinë e tyre kriminale, që u bënë shërbëtorë të kriminelëve, duke i përgaditur dhe arsyetuar apo duke i fshehur krimet e tyre.

Opinionit ynë nuk mund të mashtrohet me parullat demagogjike të nanoistëve dredhaxhi, që po i organizojnë "protestat", dhe as nuk e humb arsyen dhe nuk e mjugullon mendjen nga zhurma shurdhuese e "protestuesëve papagaj", që janë manipuluar nga gazetarët sahanlëpirës,

apo e kanë shitur gërmazin e tyre për një vend pune, për një "pozitë udhëheqëse", apo për një shërbëtorë të tyre, sepse opinioni i ka të qarta synimet e tyre karrieriste dhe djellëzore. Duhet ta kenë të qartë mendjeshkurtërit dhe të manipuluarit e ndryshëm se vlerat e luftës çlirimtare të popullit tonë, dhe gjaku i derdhur rrëke i deshmorëve dhe i martirëve të kombit nuk mbrohet duke i mbrojtur kriminelët e luftës vetëm se ata i kishin veshur uniformat e UÇK-së, por mbrohën duke kërkuar nga organet e drejtësisë ndërkombëtare dhe të vendit, që të arrestohen dhe të denohen me dënimin e merituar të gjithë kriminelët, pa përjashtim, pa marrë parasysh se janë të vegjël me pozita udhëheqëse apo janë të "mëdhenj"; ishin me uniforma të UÇK-së apo ishin civil. Kosova do të ecë përpara drejtë pavarësisë së saj, vetëm atëherë, kur kriminelët e luftës, dhe kriminelët e pasluftës, ta marrin dënimin e merituar. Organet e drejtësisë ndërkombëtare dhe të vendit duhet ta kenë të qartë se në asnjë mënyrë nuk do të arrijnë zhdukjen e krimit të organizuar, po që se i dënojnë vetëm kriminelët e vegjël-kriminelët dorasë. Zhdukja e krimit të organizuar arrihet vetëm atëherë kur drejtësia ua jep hakun kriminelëve të mëdhenj : 1. Kriminelët që e udhëheqin qendrën e krimit, (politikanët që nuk lejuan bashkimin e faktorit politik dhe ushtarak të Republikës së Kosovës, politikanë karrieristë dhe spiun serbo-ruso-grekë që i luftuan dhe i vranë institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës); 2. Kriminelët që e përgadisnin krimin, gazetarë sahanlëpirës, redaktorë dhe gazetarë të shtypit majtist, të shtypit harrën-pandël, që janë të lidhur drejtpërdrejt me qendrën e krimit. Ata në mënyrë perfide po e mbrojnë veprimtarinë kriminale të padronëve të tyre. Pothuajse të gjitha vrasjeve politike që u bënë gjatë luftës dhe pas luftës, u parapriu vrasja morale nga gazetarët sahanlëpis- gazetarët kriminelë. 3. Kriminelët që e ngrejnë gishtin e krimit, kriminelë profesionalë dhe grupe kriminelësh që udhëheqen dhe paguhën mirë nga qendra e krimit. Këta mjëranë pa kokë e pa zemër kanë për detyrë të bëjnë egzekutimin e kundërshtarëve politik të bajraktarëve të farës ruse, kur atyre ju vie urdhëri.

Përpjekja e kryepërlivanëve të Nanosit për t'i mbrojtur argatët e tyre që i futën në krime, që i detyruan ta pengojnë luftën çlirimtare të popullit tonë dhe që i detyruan t'i rrëmbejnë, maltretojnë, dhe t'i vrasin kundërshtarët e tyre politik dhe veprimtarët që nuk arrijtën t'i bëjnë shërbëtorë, nuk është asgjë tjetër vetëm përpjekja e fundit e tyre për ta mbrojtur vetveten nga

dënimi i merituar që po i pret nga drejtësia Kosovës apo ajo ndërkombëtare. Por dënimet e tyre do të jenë edhe më të mëdha, kur dihet se shtisi, nxitësi dhe urdhëruesi i krimit janë shumëfish më fajtorë se sa dorasit (egzekutorët e krimit).

## KRYEPEHLIVANËT E NANOSIT VRANË E DHUNUAN

Kryepehlivanat e Nanosit duhet ta kanë të qartë se më nuk kanë fuqi dhe as mundësi të mbjellin frikë në zemrat e atyre që ua kanë plasur zemrën, ua kanë nxirë jetën, dhe ua kanë qitur futën e zez, duke ua maltretuar, vranë apo dhunuar të dashurit e tyre. Përpjekjet e tyre për shfrytëzimin e uniformës së UÇK-së si alibi dhe mbrojtje për kriminelët e luftës, që ishin nën komandën e tyre, është sa qesharake aq edhe e palogjikshme dhe e perealizueshme, kur dihet se gjatë luftës së fundit në Kosovë shumë grupe të rinjesh, ushtarë të UÇK-së dhe veprimtarë të dalluar ushtarakë dhe civilë janë qitur në kurrth të serbe gjatë kalimit të kufirit shqiptaro-shqiptar, apo u janë organizuar prita dhe atentate në Kosovë dhe në Shqipëri nga poicia sekrete e tyre. Ata duhet t'i ndriqojnë shumë krime që u bënë në Kosovë dhe Shqipëri gjatë luftës dhe pas luftës. Një ditë do të japin llogari edhe për përgaditjen e rrethanave që komandantët e parë të njësisë të para guerile të Republikës së Kosovës u vranë në mënyrë perfide, duke i qitur në prita të serbit apo duke ua krijuar rrethanat që të futën në luftë frontale me ushtrinë e serbit para kohe, me qëllim që pastaj ata vet ta marin udhëheqjen e luftës. Shuajtja (fshehja) e këtyre krimeve, nga kryepehlivanët e Nanosit dhe argatët e tyre që sot janë bërë udhëheqje e subjekteve politike dhe organeve shtetore dhe shoqërore (civile) tregon se këta djaj janë të lidhur këmb e krye me krimin e organizuar politik dhe ekonomik që sot po ushtrohet në Kosovë.

Ndërkaq krerët e "shoqatave të dala nga lufta" po qe se e kanë për detyrë për t'i mbrojtur shtresën e popullsisë që më së shumti janë prekur nga lufta, atëherë ata është dashur që përpos kujdesit të parreshtur për gjendjen e tyre sociale dhe shëndetësore të kujdesen (a thua kanë kohë të kujdesen për ta, kur veç janë bërë avokatë të individëve të dëshmuar për krime të luftës?!) edhe për zbulimin e kriminelëve që mbanin pozita të rëndësishme në radhët e UÇK-së. Beogradi në sajë të veprimtarisë së tyre antishqiptare arriti me lehtësi t'i krijojë kushtet dhe rrethanat për ta bërë pastrimin etnik të Kosovës. Por i Madhi Zotë e shpëtoi Kosovën dhe popullin e saj martir nga më e keqja. Kriminelët serb i dënoi i

Plotfuqishmi nepërmjet NATO-së. Tani e kanë radhën të dënohen personat që më së tepërmi kanë merita për tragjedinë që e përjetoi populli ynë gjatë luftë dhe po i përjeton pas luftës. Haga dhe Prishtina i shqiptuan denimet e para. Sukses u deshërojmë në punën e mëtutjeshme që këmbë kriminelit të mos e shkel tokën e shejtë të Kosovës. Po shpresojmë se një ditë jo të largët kështu si Haga do të veprojnë Prishtina, Shkupi dhe Tirana. I Madhi Zot na ndihmoftë për ta pastruar hapsirën tonë kombëtare nga kriminelët e llojllojshëm!

*Botuar: "Bota sot", më 06.03-09. 03. 2003*

## KAPITULLI I KATËRT

### IV. SI U KRIJUA UÇK-JA, KUSH DHE KUR E KRIJUAN ATË

## SI U KRIJUA UÇK-ja, KUSH DHE KUR E KRIJUAN ATË

Me rrëzimin e Murit të Berlinit filloi procesi i shkatërrimit të sistemit të djallit të mallkuar të mbështetur në demagogji, gënjeshtëri, dhunë, gjakderdhje dhe krime të llojllojshme. Diktatorët e kuq të Evropës Lindore filluan të bien nga pushteti njëri pas tjetrit sikut të ishin "tigra prej letre". Shovenizmi serb nuk kishte të ndalur. Dita ditës rriteshin kundërthëniet në mes udhëheqjes serbe dhe atyre slloveno-kroato-boshnjake. Pritej fillimi i zhbërjes së Jugosllavisë. Pa mëdyshje, përpos faktorëve të brendshëm, edhe faktorët e jashtëm ndikuan fuqishëm në përsheptimin e zhbërjes së Jugosllavisë së Versajës dhe të AVNOJ-it. Shovinizmi serb i çuar peshë nga privilegjet që ia kishte rezervuar vetvetes dhe nga friga se ato privilegje do t'i humbë, nuk dinte se ku ta zbrazë vënerin e urrejtjes së përgatitur nga Akadima e Shkencave të Serbisë dhe strukturat shtetërore të Beogradit.

Shqiptarët e ndarë po nga Fuqitë e Mëdha sikurse edhe gjermanët, nuk i kishin mundësitë, rrethanat dhe as aleatët siç i kishte Gjermania, për t'i realizuar synimet shekullore siç i realizuan gjermanët. Lëvizja jonë kombëtare për çlirim dhe bashkim kombëtar u detyrua të bënte hapa të matur, që do të çonin në suksese të njëpasnjëshme deri të na vijë "shteku" për t'i këputur prangat e robërisë. Pajtimi i gjaqeve ishte një fitore e rëndësishme që ndikoi në homogenizimin e shqiptarëve. Formimi i LDK-së dhe ndryshimi i rrethanave të brendshme në Jugosllavi bëri që aspiratat shekullore të popullit tonë të shprehen në mënyrë legale, ndërsa përcaktimi i LDK-së dhe i partive tjera për realizimin e atyre aspiratave në mënyrë paqësore, mundësuan krijimin e themeleve të shtetësisë së Kosovës, pa u konfrontuar seriozisht me pushtuesit serbë. Miratimi i Deklaratës Kushtetuese dhe i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga Parlamenti i Kosovës, zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare, mbajtja e Referendumit për Pavarësinë e Kosovës, konstituimi i Presidencës dhe formimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, përgaditjet për formimin e njësisë ushtarake të Republikës së Kosovës duke i dërguar në Shqipëri për të ushtruar djem dhe burra atdhetarë nga Kosova dhe Diaspora, ishin suksese të pamohueshme të



Lëvizjes sonë kombëtare në vitete e para të '90-tave, nën udhëheqjen e LDK-ës dhe subjekteve shtetërore të Republikës së Kosovës.

Edhe pse plani i paraparë nga organet shtetërore dhe partiake të Republikës së Kosovës për t'i bërë përgatitjet e duhura për fillimin e luftës çlirimtare, nuk u kryen në tërësi, për shkak se diplomacia amerikane dha urdhër të ndërpriten përgatitjet e mëtutjeshme, me arësyetimin se Kosova nuk duhej të hynte në luftë me Jugosllavinë në këto kushte dhe në këto rrethana, udhëheqjet e Kosovës dhe të Shqipërisë u pajtuan në princip me qëndrimin e SHBA-ve, por në anën tjetër lejuan të formohen celulatat e para të Ushtrisë Çlirimtare të Republikës së Kosovës me veprimtarë dhe burra atdhetarë, të cilët do t'i krijonin njësitë e para guerile në Kosovë për të kryer aksione ilegale të kohëpaskohshme por të kontrolluara nga Udhëheqja e Kosovës. Për arritjen e këtyre qëllimeve duhej të dërgoheshin armatime dhe municione të domosdoshme nga Shqipëria në Kosovë. Këtë punë e kreu me sukses pas përgatitjeve të duhura Njësia e parë ushtarake e Republikës së Kosovës e formuar në Shqipëri në tetorin e vitit 1981. Njësia përbëhej nga 43 ushtarë të zgjedhur nga grupi i dytë i rekrutëve të ardhur nga Kosova dhe Diaspora, të cilët i bënë përgatitjet e duhura fizike dhe ushtarake në dy garnizonet e Shqipërisë, që Kosovës iu patën lejuar t'i përdorë për aftësimin e rekrutëve dhe kuadrin ushtarak. Njësia ishte formacion ushtarak i veshur dhe i armatosur mirë. Komandohej nga Salih Çeku, i cili me veti kishte marrë 74 kallashnikovë të prodhimit kinez, bomba dore dhe municion, ndërsa në radhët e tij ishte edhe Adem Jashari. Kjo ishte njësia e parë ushtarake që e shkeli kufirin shqiptaro-shqiptar në historinë tonë më të re (50 vjeçare) pa u hetuar nga forcat okupuese serbe dhe hyri në Kosovë.

Njësia kishte për detyrë ta fshehë armatimin në baza të sigurta, çka do të shërbente për armatosjen e njësive të para guerile të Republikës së Kosovës. Duke ditur se sigurimi jugosllav i kishte futur hundët kudo ku jetonin dhe vepronin shqiptarët, ishte e domosdoshme që armatimi i sjellë nga Shqipëria të ndrronte vend kohë pas kohe. Në fillim ai u fsheh në Voksh të Sali Panxha. Pastaj armatimin e muar për ta fshehur Demë Tolaj me njerëzit e tij në Pobergj. Pas një kohe armatimi kalon në Broliq të Salih Çeku, ku një pjesë i tij (43 copë kallashnikovë me municion të nevojshëm) e muarën Saim Tahiraj me Xhemajl Berishën dhe e dërguan në shtëpinë e Saimit në Beleg të Deçanit. Për shkaqe sigurie pas një kohe

vëllezërit Tahiraj armatimin e kanë strehuar në plemen e Avdyl Mulliqit, prej nga- brenda muajit tetor- shpërndahet në pika të ndryshme të Kosovës, ku tashmë ishin formuar njësitet e para guerile të Republikës së Kosovës. Ndër të parët kanë arritur për të marrë armatimin Adem Jashari nga Prekazi së bashku me Xhafer Zenën nga Prishtina, të cilët i kanë marrë 16 copë kallashnikovë, bomba dore dhe municion. Për Njësitin gueril të Podujevës armatimin e ka marrë Salih Zeqiri, për Mitrovicë Nazmi Bajrami, ndërsa për Shkup "Hoxha".

Pas shpërndarjes së armatimit në muajët nëntor- dhjetor të 1991 kanë filluar aksionet e para të armatosura kundër pushtuesve serb. Adem Jashari me njësitin e tij sulmoi kamponjollin e policisë serbe afër Glllogocit. Ekrem Sheholli me njësitin e tij e sulmoi punktin e policisë në Podjevë. Ndërsa Salih Çeku me njësitin e tij bëri një sulm mbi patrullën e policisë në rrugën Deçan-Lumbardh. Këto aksione dhe aksionet tjera të njësiteve guerile që u kryen me sukses në Llap, Drenicë dhe Dukagjin mbollën frikë tek okupatorët serbo-sllavë dhe bënë jehonë e ngjallën komente të ndryshme në opinionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Në këto rrethana UDB-ja jugosllave u detyrua të ndërmarrë aksionin për bastisjen e familjeve të cilat - sipas informatave që kishin-, ishin baza të guerilës së Republikës së Kosovës. Kështu, më 29 dhjetor të 1991, në të njëjtën kohë, u bastisën shumë familje në Kosovë. U bastis familja e Shehollve në Podujevë, familja e Ramadan Berishës në Prishtinë, Familja e Saim Tahirajt në Beleg, familja e Osman Ferizit në Kodrali, familja e Demë Tolajt dhe Salih Panxhës në Voksh, familja e Salih Çekut në Broliq. Po familja e Shaban Jasharit në Prekaz nuk lejoi të bastisej nga policia serbe dhe kështu filloi lufta e armatosur në mes njësitit të parë gueril të Drenicës që e kishin formuar vëllezërit Adem, Hamzë dhe Rifat Jashari dhe policisë Jugosllave. Kjo ishte betejë e parë frontale që u zhvillua në mes njësitit gueril të Republikës së Kosovës dhe forcave policole të Jugosllavisë, që pati jehonë të madhe në vend dhe në botë, dhe i dha mësim okupatorit serb se Kosova në tërësi dhe Drenica në veçanti do të jetë "dardhë e egër" për ta.

Sukseset e para të Lëvizjes sonë Kombëtare në Kosovë, bëri që makineria shtypëse e Beogradit lypte shkahun për ta përgjakur Kosovën si shumë herë më parë. Subjektet politike dhe shtetërore të Kosovës ishin të vetëdijshëm se vëneri i urrejtjes patologjike serbe do të derdhet dikund në Jugosllavi. Udhëheqjet sllovene dhe kroate kishin synime që

shovinizmi serb të shfryhet në Kosovë për t'ua mundësuar atyre pastaj për të dalë "pa një therrë në këmbë" nga Federata Jugosllave. Në këto rrethana të komplikuar kishte dy rrugë: Të bëhet konfrontimi i drejtpërdrejtë me përmasa të mëdha me makinerinë e Armatës Jugosllave, apo të bëhet zhagitja e konfrontimit për një kohë më të përshtatshme. U zgjodh me plot arsye varianti i dytë. Serbia e vetëdijshme për gjendjen në të cilën gjendet kombi ynë, me një Shqipëri të katandisur siç është zi e më zi, e sakatosur shpirtërisht dhe e varfëruar ekonomikisht përtej mase, pa një ushtri të fortë, pa një autoritet e ndikim ndërkombëtar dhe pa një aleat të fuqishëm, kishte synime ta zgjedhte çështjen e Kosovës ashtu siç kishte lakmuar gjithmonë, ta bënte Kosovën tokë serbe nëpërmjet shpërnguljeve dhe gjenocidit, siç e patën bërë tokë serbe krahinën shqiptare të Toplicës dhe sanxhakun e Nishit. Në këto rrethana Presidenti i Republikës së Kosovës Ibrahim Rugova luajti potezin më të mirë. Nga popullsia kërkoi urtësi dhe durim, ndërsa nga Prijësit e njësiteve guerile të Republikës së Kosovës nëpërmjet Fehmi Aganit kërkoi ndërprerjen e veprimtarisë ushtarake për një kohë. Një pjesë e ushtarëve të njësiteve guerile u detyruan të largohen në Evropën Perendimore, një pjesë e tyre ngelën nëpër burgjet e Jugosllavisë, ndërsa një pjesë mbeti në Kosovë dhe kështu njësitet guerile mbetën në formacion të plotë. Ato në Drenicë komandoheshin nga Adem dhe Hamzë Jashari, në Llap nga Zahir Pajaziti dhe në Dukagjin nga Salih Çeku. Këto masa u muarën pasi që udhëheqjet shtetërore dhe partiake të Republikës së Kosovës miratuan kërkesen e diplomatëve të SHBA për të mos e hapur frontin e luftës në Kosovë. Udhëheqja serbe e vetëdijshme se shqiptarët nuk i kanë rendet për të hyrë në luftë me serbët, nuk e patën vështirë për t'ua marrë shqiptarve të gjitha të drejtat që i kishin fituar me sakrificë të mëdha. Serbia pasi e zhvlerësoi Kushtetuten e 1974-ës, shqiptarëve ua helmoi fëmijët dhe nxënësit nëpër shkolla, ua muar objektet shkollore dhe universitare, Radion dhe TVP-ën, i larguan nga puna dhe kështu krijuan apartheidin në zemër të Evropës. Në këto kushte shqiptarët u detyruan të krijonin sistemin e tyre paralel në arsim, shëndetësi, kulturë dhe pritnin ditë më të mira për t'u konfrontuar me serbët kur do t'u vinte "shteku". Kur serbët u siguruan se shqiptarët u "dorëzuan" e sulmuan Slloveninë dhe Kroacinë dhe të dy luftërat i humbën. Në Bosnje bënë krime të mëdha, por e muarën atë çka e kishin planifikuar në sajë të ndihmës së pakursyer të aleatëve të saj të vjetër, Francës, Anglisë dhe "majka"Rusisë.

Anëtarët e njësiteve guerile që ishin larguar nga Kosova në Evropën Perëndimore u vetorganizuan duke krijuar grupe shokësh që njiheshin mirë në mes veti për t'i ndihmuar njësitet Guerile të Republikës së Kosovës me armatime dhe pajisje të ndryshme. Me të hollat që i tubonin nga radhët e tyre, në baza vullnetare, me një konspiracion të plotë, blenin armatime dhe mjete të ndryshme në Zvicër, Gjermani dhe Shqipëri e i futnin brenda në Kosovë deri te njësitet e tyre në Llap, Drenicë dhe Dukagjin. Këto grupe atdhetarësh të vetëdijshëm se për betejat e ardhshme që do të bëhen me Jugosllavinë duhet përgatitur mirë, bënë presion të pandërprerë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, veçmas në Kryeministrin Bukoshi, që të lejojë mjete financiare për blerjen e armatimeve dhe municioneve për t'i dërguar në Kosovë. Më në fund- pas shumë presioneve- në gjysmën e dytë të vitit 1993 Bukoshi pranon një takim me Salih Çekun, Zenun Idrizin, Saim Tahirajn dhe Ismet Avdullahun. Ky Këshill koordinues, para se të takohet me Bukoshin, u takua në Aeroportin e Shtutgardit me Fehmi Aganin. Këshilli kërkoi nga Agani që të përkrahë vazhdimin e aksioneve guerile në Kosovë, të cilat qenë ndërprerë përkohësisht me kërkesën e tij më 1992. Po ashtu nga Agani kërkoi që të ndikojë në Qeverinë e Kosovës për të lejuar mjete financiare për blerjen e armatimeve etj.

#### DHE, SI MUND T'U NDALET TURRI VJEDHËSVE TË HISTORISË?

Sipas dëshmisë së Saim Tahirrit dhe Ismet Avdullahut, Agani i paska përkrahur në tërësi propozimet dhe kërkesat e këtij Grupi koordinues duke shtuar se "Është e domosdoshme ta kemi edhe një krah radikal për ta provokuar situatën kohë pas kohe, por duhet të jetë nën kontroll dhe mbikqyrje. Ne edhe për atë qëllim e kemi qitur jashtë për të vepruar Bukoshin", kishte pas thënë Fehmi Agani. Të kënaqur me përkrahjen e Aganit ky Këshill koordinues po atë ditë është pritur nga Bukoshi, ku edhe ai i paska përkrahur propozimet dhe kërkesat e tyre, me një kusht- që ta zgjedhin një përgjegjës grupi.

Siç thonë dëshmitarët e përmendur më lart, përgjegjës i Grupit koordinues është caktuar Salih Çeku. Pas një kohe Grupi i paska marrë 10.000 DM nga Bukoshi. Me këto të holla dhe të hollat që i kanë tubuar vet Grupi ka blerë armatime në Zvicër dhe Gjermani me një vlerë prej 30.000 DM. Këto armatime pastaj i kanë dërguar në Kosovë në fund të korrikut të 1993 Salih Çeku, Zenun Idrizi, Zymer Luli, Saim Tahiraj, Osman Ferizi, Ismet Avdullahu dhe Nazmi Ajeti.

Studimi dhe ndriçimi i rrethanave të lindjes, rritjes dhe zhvillimit të UÇK-së është detyrë parësore e studjuesve, historianëve dhe analistëve shqiptarë. Një ndihmesë të rëndësishme në këtë drejtim duhet të japin individët që kanë marrë pjesë drejtëpërdrejt apo tërthorazi në krijimin e bërthamave të para të UÇK-së, individë që kanë mbajtur ditarë apo shënime për takimet që i kanë pasur me atdhetarë dhe veprimtarë të dalluar të Lëvizjes sonë kombëtare për çlirim dhe bashkim kombëtar, siç ishin Adem Jashari, Salih Çeku dhe Zahir Pajaziti. Në bazë të kriteriumeve shkencore këta ishin krijuesit e drjtëpërdrejtë të UÇK-së, që fatkeqësisht sot nuk i kemi të gjallë fizikisht në mesin tonë, pasi që ranë dëshmorë në altarin e lirisë për të mos vdekur kurrë. Vetëm atëherë kur ndriçohen rrethanat që sollën formimin e njësive të para guerile në Drenicë, Llap dhe Dukagjin në mënyrë objektive, mund të jipet vlerësim i drejtë, i paanshëm dhe shkencor për të gjitha periudhat e zhvillimit të UÇK-së, që njohu rënie dhe ngritje sasiore e cilësore.

Me çlirimin e Kosovës nga NATO-ja dhe luftëtarët trima të UÇK-së në opinionin tonë kanë filluar të bëhen manipulime të llojllojshme në lidhje me UÇK-në. Manipulues të ndryshëm, partiakë të shtirë, karrieristë të sëmurë për pushtet, vjedhës të historisë, falsifikues të vërtetës, po bashkëveprojnë në mes tyre për të përfutur me çdo kusht dhe në çdo mënyrë nga gjaku i derdhur i bijve më të mirë të kombit, për interesa të tyre personale dhe klanore.

Janë të njëjtat forca destruktive, të njëjtët individë dhe grupe individësh që penguan bashkimin e forcave politike shqiptare, që penguan institucionalizimin e jetës politike në Kosovës, që penguan formimin e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës dhe nuk i njohën institucionet e formuara të saj. Janë të njëjtët karrieristë që e penguan UÇK-në me të gjitha mënyrat për të mos u bërë ushtri e fortë e Republikës së Kosovës, por për të mbetur ushtri klanesh të ndryshme partiake dhe individuale. Një ndër mjetet më efektive për t'ua ndalur turrin këtyre forcave të djallit të mallkuar, për të mos arritur qëllimet e tyre djallëzore, për të mos i degjeneruar qëllimet e shenjta të luftëtarve të lirisë, është lufta e pakompromis kundër tyre me anë të vërtetës.

Duhet t'u thuhet shkurt e trup xhambazëve politikë të mos na i fyejnë dëshmorët tanë duke i ndarë ata në të "tanët" dhe të "tyre", se ata i përkasin kombit shqiptar, se gjaku i tyre rrëkë i bëri të fortë themelet e Republikës së Kosovës, se Ata e dëgjuan zërin e Atdheut, zërin e

Kosovës martire, se ata ju përgjigjën kushtimit të Shaban, Adem e Hamëz Jasharitit, se ata i dëgjuan thirrjet dhe porosinë e Salih Çekut, Zahir Pajazitit, Ilir Konoshefit, Fehmi e Xheva Lladrocit, Ahmet Krasniqit, Ismet Jasharit, Agim Ramadanit, Adem Ukëhaxhës e qindra dëshmorëve tjerë, për t'i dalë zot Kosovës e jo zërit të tyre përçarës, punës së tyre të prapshtë, veprës së tyre të shëmtuar, që punuan dhe po punojnë me vetëdije apo pa vetëdije për interesa të huaja, për interesat e armiqve tanë shekullorë.

Historianët, analistët dhe studjuesit e lamive të ndryshme, për të dhënë vlerësim të drejtë dhe objektiv për UÇK-në, duhet t'iu përgjigjen këtyre pyetjeve: 1. Cilët faktorë dhe rrethana ndihmuan në themelimin e UÇK-së? 2. Kur u formua UÇK-ja dhe kush e formoi atë? dhe 3. Kush e pengoi zhvillimin dhe forcimin e natyrshëm të UÇK-së për tu bërë një ushtri e fortë e Republikës së Kosovës, e cila nuk do të lejonte të masakrohej e të përzihej me dhunë nga vatrata e saj popullsia e paarmatosur, dhe as nuk do të lejonte partiakëve të shtirë, karrieristëve të sëmurë për pushtet dhe pararojes staliniste të LPK-së të luante me fatet e kombit dhe të atdheut, për tekant, xhelozitë dhe interesat personale e klanore të tyre. Në këtë shkrim i është dhënë përgjigje pyetjes së parë, ndërsa pyetjes së dytë ka mbetur pa iu thënë se UÇK-ja është formuar në tre muajt e fundit të vitit 1991, atëherë kur u formua njëësia e parë ushtarake e Republikës së Kosovës në Shqipëri dhe pastaj u formuan njësitet guerile të Republikës së Kosovës në Drenicë, Llap dhe Dukagjin, të cilat kryen aksione të armatosura dhe, më në fund, njësi guerile i krijuar nga vëllezërit Adem, Hamzë dhe Rifat Jashari u konfrontua drejtpërdrejt e bëri luftë frontale me policinë e okupatorit më 30 dhjetor të vitit 1991. Dhe kështu, kjo betejë luftarake e drejtpërdrejtë dhe frontale, luftën guerile e ngriti në një shkallë më të lartë organizimi dhe të gatishmërisë, në atë të Ushtrisë Çlirimtare të Republikës së Kosovës. Ndërsa krijuesit ideorë të njësiteve guerile të Ushtrisë Çlirimtare të Republikës së Kosovës duhet gjetur në subjektet partiake dhe shtetërore të Republikës së Kosovës, por idenë e bënë vepër atdhetarët trima, veprimtarët e dalluar të Lëvizjes sonë kombëtare vëllazërit Adem, Hamzë dhe Rifat Jashari, Salih Çeku, Zahir Pajaziti dhe bashkëluftëtarët e tyre trima, që punuan me mish dhe me shpirt për idealet e larta njerëzore dhe kombëtare, për qëllimet që i kishte shtruar Lëvizja jonë kombëtare për çlirim dhe bashkim kombëtar. Sa i përket pyetjes së tretë opinioni ynë

dhe ai ndërkombëtar ëshë i njohur pjesërisht për pengesat dhe dëmet e mëdha që ia bënë UÇK-së partiakët e shtirë, karrieristët e sëmurë për pushtet të subjekteve politike dhe shtetërore të Republikës së Kosovës dhe pararoja staliniste e LPK-së nën drejtimin e Xhavit Halitit, Ibrahim Kelmendit, Azem Sylës, Hashim Thaqit, Bardhyl Mahmutit dhe Ali Ahmetit- "Abazit", me të cilin lexuesit e nderuar të "Bota sot" dhe të "Rimëkëmbja" do të njihen me anë të një shkrimi tjetër.

*Botuar: "Bota sot" më 2-3 dhjetor 1999*

## DY ATENTATE ME PASOJA TË RËNDA PËR LËVIZJEN TONË KOMBËTARE

Shqiptarët në ndeja dhe biseda, në takime të rastit apo në takime të organizuara shtrojnë pyetje: Pse vallë jemi në këtë gjendje të mjerë organizimi? Pse ende nuk kemi udhëheqje të aftë për t'i zgjedhur çështjet madhore kombëtare? Pse udhëheqjet aktuale shqiptare bën dhe po bëjnë përçarje ndërshqiptare dhe ndërnjerëzore si pasojë e luftës për interesa të ngushta personale, klanore dhe grupe?! Si u bë që një popull i lashtë e fisnik me tradita të vjetra të atdhedashurisë, solidaritetit, besës dhe trimërisë të katandiset në këtë gjendje vetëshkatërruese, kur dihet se nuk i ndali kurrë përpjekjet për realizimin e aspiratave shekullore, çlirimin dhe bashkimin e tij kombëtar?! Pse të mos e kemi edhe ne shqiptarët Shqipërinë tonë etnike, një Shtet të fortë demokratik, që do t'i mbronte interesat e popullit shqiptar duke mos lejuar të mbetej nën këmbën serbo-sllavo-greke asnjë pllëmbë e territorit të tij etnik?! Pse të mos jemi edhe ne shqiptarët faktor i rëndësishëm i stabilitetit, paqës dhe i vendosjes në Ballkan? Pse të mos e kemi edhe ne vendin e merituar në qendrat e vendosjes ndërkombëtare?! Pse qytetarët e Shqipërisë të mos kenë mirëqenie, paqë, zhvillim dhe perspektivë për t'i kultivuar traditat, zakonet dhe vrytytet kombëtare?!

Pothuajse çdonjëri që di të mendojë me logjikë dhe që i njeh rrethanat e zhvillimit të Historisë sonë kombëtare, do t'iu përgjigjet pyetjeve të shtruara, se ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar dhe po ndikojnë për të qenë shqiptarët në këtë gjendje dhe situatë tragjiko-komike, padyshim është se armiqët tanë në gjithë hapësirën tonë etnike e kanë krijuar kolonën e tyre të pestë, e cila nëpërmjet njerëzëve të saj dhe karrierristëve e partiakëve të shtirë krijuan kaos, përçarje dhe mosmarrëveshje në strukturat udhëheqëse të shoqërisë shqiptare, duke i kryer shërbime të mëdha grekut dhe shkaut. Pothuajse në të gjitha periudhat më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, armiqtë tanë shekullor për t'i arritur qëllimet e tyre, për ta paaftësuar Lëvizjen tonë kombëtare në realizimin e objektivave të saj madhore, na i vranë prijësit tanë vizionarë, trima dhe atdhetarë. Na i vranë ata që mishëronin vrytytet e prijësve popullorë; që dinin se çka është parësore, dytësore dhe e parëndësishme fare. Na i vranë ata që dinin si t'i bashkonin shqiptarët dhe



që dinin si t'i dëmtounin armiqtë tanë tinzarë, që dinin kah të orientohen për të gjetur miq dhe aleatë të sigurtë të kombin tonë. E vranë në vazhdimësi shkijet dhe grekët lulen e burrërisë shqiptare! Na i vranë burrat e mëdhenj të kombit dhe veprimtarë të dalluar në burgje e në prita, me dru, plumb e helme dhe me atentate.

Po, kolona e pestë i vrau edhe shumicën e udhëheqësve shqiptarë me mjete të stërholluara, duke i bërë të vdekur për së gjalli, pasi që i futi në luftë për interesa të ngushta personale, klanore dhe grupore, në vend se të luftonin për çështje madhore kombëtare.

Të gjitha vrasjet politike që u kryen ndaj udhëheqësve shqiptarë, u bënë me dorën tradhtarë të shqipfolësve, por me porositë e grekut apo të shkaut, pa marrë parasysh se a i bënë krimet me helme apo me plumb, nëpër prita apo nëpër burgje, që nga Papo Kristo Negovani, Haxhi Zeka, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, Xhon Sereçi, Marije Shllaku, Ajet Gërguri, Shaban Shala, Fazli Grajqefci, Regjep Elmazi, Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla, Kadri Zeka, Zija Shemsiu, Metush Krasniqi, Nuhi Berisha, Rexhep Malaj, Enver Hadri, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu, Edmond Hoxha, Besnik Restelica, Ilir Konushefci, Luan Haradinaj, Azem Hajdari, Ahmet Krasniqi, Enver Maloku, Fehmi Agani e të tjerë.

Vrasja e çdonjërit prej tyre pati pasoja për Lëvizjen tonë për çlirim dhe bashkim kombëtar, por dy atentate që i bëri shkaut, të parin më 17 janar të 1982 në afërsi të Shtutgardit dhe të dytin më 31 janar të 1997 në afërsi të Vushtrisë, Lëvizja jonë kombëtare për çlirim dhe bashkim kombëtar mbeti pa dy vizionarë, mbeti pa dy burra të mëdhenj të kombit tonë, Jusuf Gërvallën i cili i vuri themelet e një organizimi të shëndoshë kombëtar, dhe Zahir Pajazitin i cili sëbashku me Adem e Hamzë Jasharin, Salih Çekun dhe me bashkëveprimtarë i vunë themelet e Ushtrisë së Kosovës, që ishte qëllimi parësor i të gjitha organizatave ilegale të krijuara në Kosovë, që nga Organizata e NDSH-së, e deri te LKÇK-ja.

## **Jusuf Gërvalla u përpoq për bashkimin e faktorëve politikë shqiptarë**

Lëvizja jonë kombëtare parashikonte se me vdekjen e Titos, Jugosllavia do të shkatërrohej si pasojë e luftës pa kompromis në mes shovenizmit serb dhe nacionalizmit kroato-sllloven dhe luftës së drejtë të shqiptarëve për çlirim dhe bashkim kombëtar. Për të mos e gjetur të pa

përgatitur popullin tonë momenti i duhur, kur duhet të bëhet" dasma", u krijuan disa organizata ilegale në Kosovë: "Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe e Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi" (LNÇKVSHJ) e udhëhequr nga Metush Krasniqi, Sabri Novosella, Jusuf Gërvalla e tjerë, ishte një Organizatë që për ideologji kishte për bazë nacionalizmin shqiptar, ndërsa" Partia Komuniste Marksiste Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi", (PKMLSHJ) e udhëhequr nga Avdullah Prapashtica, Osman Osmani etj. dhe " Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës" (OMLK) e udhëhequr nga Hydajet Hyseni, Kadri Zeka etj. udhëhiqeshin nga ideologjia e proletariatit ruso-orthodoks (marksizëm- leninizmi), që kishin dallime të mëdha në çështje oranzative dhe çështje tjera me LNÇKVSHJ.

Siç dihet para dhe pas demonstratave të ``81-it në Evropën Perëndimore kishin ikur për t`iu shpëtuar ndjekjeve dhe arrestimeve udhëheqës dhe veprimtarë të organizatave ilegale. Në këto rethana ishte aktuale bashkimi i të gjitha organizatave ilegale në një Front të përbashkët veprimi dhe organizimi. Në fillim bisedimet për atë qëllim i nisën në Kosovë Metush Krasniqi dhe Hydajet Hyseni. Ata pasi nuk arritën bashkimin e organizatave të tyre, për shkak të rrethanave objektive, vendosën që ato të vazhdohen jashtë atdheut në Evropën Perëndimore. LNÇKVSHJ mbronte qëndrimin se të gjitha organizatat ilegale duhet të arrijnë bashkimin duke u shkrirë në një organizatë të përbashktë, që do të udhëheqej nga një udhëheqje e vetme e dalë nga përfaqësuesit e organizatave që do të bashkoheshin, me një Program, me një Statut dhe Organ të vetëm. Dy organizatat tjera, OMLK dhe PKMLSHJ, mbronin qëndrimin se të gjitha organizatat dhe grupet ekzistuese duhet të shkriheshin në një " Front për Republikën e Kosovës", përpos organizatave të tyre, të cilat do të mbesin organizata pararojë (për të udhëhequr dhe për të sunduar) me program, statut dhe organ të vetin, që kanë për detyrë për ta udhëhequr " Frontin..."

Edhe pse Jusuf Gërvalla bëri çmos për të ardhur deri te bashkimi i organizatave, duke e ndërprerë edhe botimin e organit të Organizatës së tij "Lajmëtari i Lirisë", për të treguar me fakte se duhet ndërtuar diçka më të madhe dhe më të fortë bashkarisht, përkundrazi, prijësit e OLMK-së donin t`i forconin radhët e organizatës së tyre, pasi që filluan përgatitjet për botimin e organit të tyre "Liria ". Jusuf Gërvalla nuk u kursye dhe punoi me përkushtim për ta përgatitur për shtyp organin e tyre "Liria",

duke shpresuar se, me të mirë, do t'ua ndërronte mendjen. Po ashtu Jusuf Gërvalla e pat ndihmuar edhe Ibrahim Kelmendin për ta nxjerrë fletushkën "Bashkimi"- organin e "Frontit të Kuq Popullor"-, që ai e kishte formuar, i ndikuar nga e njëjta qendër që i pat krijuar "Brigadat e Kuqe" në Gjermani dhe Itali. Por, kur Jusuf Gërvalla u muar me botimin e Zërit të Kosovës, dhe nuk kishte kohë e as që donte të merrej me "Frontin e Kuq" e as me "brigada të kuqe" që i kishte formuar shërbimi i fshehtë i BRSS. Ibrahim Kelmendi filloi të bënte shpifje kundër tij, duke e shpallur "spiun të Beogradit" dhe "tradhtar", siç e kanë zakon t'i shpallin komunistët kundërshtarët e tyre politikë, por edhe shokët më të ngushtë, për t'i likuiduar pastaj, siç qe rasti me Mehmet Shehun e raste të shumta në praktikën komunisto-staliniste.

Pas vrasje së Jusuf Gervallës, Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, Avdullah Prapashtica ndërroi qëndrimin që e kishte më parë përkitazi me bashkimin e organizatave, dhe u pajtua plotësisht me qëndrimin e LNÇKVSHJ. Dhe kështu, më 17 shkurt të vitit 1982, në takimin që mbahet në Stamboll në mes përfaqësuesve të këtyre dy organizatave, nënshkruhet Vendimi për bashkimin e këtyre Organizatave në një Organizatë të vetme që do të quhej: "Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi- LRSHJ". Vendimin e nënshkruan Sabri Novosella dhe Xhafer Durmishi për LNÇKVSHJ-në, ndërsa Avdullah Prapashtica, Faton Topalli dhe Osman Osmani për PKMLSHJ-në. Ndërsa më 15 maj të 1992 u mbajt një takim në mes Xhafer Shatrit si përfaqësues i OMLK-së dhe Xhafer Durmishit e Osman Osmanit si përfaqësues të LRSHJ-së, ku u muar vendimi që OLMK-ja t'i bashkohet LRSHJ-së. Ky "bashkim" nuk pati jetë të gjatë dhe pas disa muajsh lindën probleme "të pakapërcyeshme" pasi që kishte qenë bashkim i rrejshëm, bashkim sa për sy e faqe, vetëm sa për t'i përballuar presionit të mërgimtarëve që e kërkonin bashkimin e organizatave pas atentatit që u bë afër Shtutgardit më 17 janar 1982.

U bënë pikë e pesë dhe u hasmuan mes tyre veprimtarët e dikurshëm të rrezistences tonë dhe sa mund t'i bashkosh pleshtat, aq mund t'i bashkosh bajraktarët dhe karrieristët e Organizatave ilegale.

U krijuan dy-tri lëvizje, një komitet, Organizata e Gruas, Organizata e Punëtorëve, etj. Botoheshin në të njëjtën kohë dy fletushka me emrin "Zëri i Kosovës". Botohej edhe "Pararoja", "Punëtori", etj.

## **Përçarjet e bajraktarëve të organizatave ilegale në diasporë, sollën përçarjen edhe në Kosovë.**

Përçarjet e bajraktarëve të organizatave ilegale në diasporë sollën përçarjen edhe në Kosovë. Me këtë rastë nuk do t'i ve në dukje të gjitha dëshmitë për të parë se në çfarë moçalesh dhe ujërash të zeza e futën Lëvizjen tonë kombëtare për çlirim dhe bashkim kombëtar udhëheqjet e oranzatave ilegale.

Të mbrosh markësizëm-leninizmi dhe internacionalizmi proletarë në zemër të Evropës kapitaliste, t'i përçash shqiptarët në bazë të bindjeve politike dhe ideologjike, në vend se t'i bashkosh në baza kombëtare, të mos njohësh organet dhe udhëheqjet shtetërore të dala nga votat e lira të popullit, të bësh komplete kundër njësive guerile të Kosovës, duke e përsheptuar fillimin e luftës frontale me shkaun pa u bërë parapërgatitjet e domosdoshme, ta përdorësh "Kalin e Trojës" për ta marrë udhëheqjen e njësive guerile të Republikës së Kosovës, për të mos lejuar institucionalizimin e saj, kështu do të arrihej të pengohej që UÇK-ja të mos bëhej " Ushtria më e fortë e Ballkanit". Si mund të quhet ndryshe kjo veprimtari përpos veprimtari që çoi ujë në "mulli të shkaut".

Të gjitha këto të liga që e gjetën lëvizjen tonë kombëtare, janë pasojë e përçarjes së udhëheqjes së LRSHJ të nxitur nga udhëheqja e Shqipërisë, por edhe nga lufta e karrieristëve dhe partiakve të shtirë për të dominuar mbi njëri- tjetrin, pasi që në krye të saj mungonte një personalitet i fortë dhe i shquar siç ishte Jusuf Gërvalla, i cili nuk do të lejonte që Lëvizja të bëhej vegël e verbër e Sigurimit të Shqipërisë dhe as e UDB-së jugosllave, por do të luftonte që ajo të bëhej një organizatë e fortë, e aftë për ta udhëhequr popullin drejtë lirisë.

Jusufi për një kohë të shkurtër sa jetoj në Gjermani i vuri bazat e shëndosha të një organizimi të shëndoshë kombëtar, duke u nisur nga parimi : "Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s' do të ketë forcë të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme". Jusuf Gërvalla me autoritetin që kishte kudo tek shqiptarët, me aftësitë e tij intelektuale, me shpitrin e madh të sakrificës, me zemërgjerësinë dhe dhimbssurinë prindërore që kishte ndaj mërgimtarve për punët e vështira që i kryenin dhe për mallin që kishin për familjen, fëmijët, vendlindjen dhe Atdheun e copëtuar e të ndarë nga kasapët sllavë, u bë udhëheqësi më i respektuar, më i nderuari dhe më i

dashuri nga të gjitha shtresat e popullsisë së Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare. Shembulli i tij në punë konkrete, trimëria e pashembullt për të ecur në rrugën e bashkimit të gurbetçarve, i jepte të drejtën të kërkonte nga shqiptarët t'i lënë anash të gjitha mosmarrëveshjet, ngatërresat, përçarjet, interesat e ngushta personale, grupe dhe regionale, për ta bërë një bashkim të fort dhe të fuqishëm. Ai me punën e tij prej një atdhetari të flaktë, intelektual të vërtetë, bashkëkombësi të përvuajtur, bëri që t'i përfitojë zemrat e mijëra e mijëra bashkëkombësve nga të gjitha trojet shqiptare. Ua hoqi frikën njerëzve dhe iu dha zemër për t'u marrë me mish e me shpirt për zgjidhjen e çështjes madhore kombtare e jo të çojnë jetën e robit, jetën e sahanlëpirësit, jetën e të marrëve. Sukseset e Jusuf Gërvallës, të bashkëpunëtorëve dhe shokëve të tij të idealit, bënë që UDB-ja jugosllave dhe Sigurimi i Shqipërisë të ndërmarrin masat e nevojshme për ta ndërprerë aktivitetin e tij politik dhe organizativ sa nuk është bërë tepër vonë, pasi që të dy regjimeve, atij të Beogradit dhe të Tiranës, iu pëlqente të kenë organizata të vogla ilegale në Kosovë dhe në diasporë, por jo edhe të kenë një Organizatë të fortë për çka punonte Jusufi, e cila do të jetë e zonja të merret seriozisht me çështjen e çlirimit dhe bashkimit kombëtar. Këto synime të Jusufit me shokë ishin në kundërshtim me synimet e PPSH -së, pasi që ajo çështjen e Kosovës e kishte lënë për t'u zgjedhur pas ngadhënjimit të "revolucionit proletar botëror", ndërsa Jugosllavia kishte bërë planet afatgjata për ta zgjedhur çështjen shqiptare siç e donte interesi i shkaut. Mugosha dhe Popoviqi i kishin vënë njerëzit e tyre në pushtet në Tiranë, të cilët kryenin planet serbe me përpikëri, duke e bërë Shqipërinë " fanar të markësizëm-leninizmit " në Evropë, të mbyllur ndaj përparimeve teknologjike, ideve dhe kapitalit evropian, por të hapur dhe të lidhur ngushtë me grupe mjëranësh, "sakatësh në kokë" të " Grupeve marksiste-leniniste", që ishin ndarë nga partitë komuniste të vendeve të tyre, për ta përkrahur Enver Hoxhën që e "demaskonte" revizionizmin jugosllav, sovjetik dhe kinez, dhe që e mbronte "pastërtinë e markësizëm-leninizmit dhe internacionalizmit proletar"!

Atentati i kryer më 17 janar të 1982 në afërsi të Shtutgardit, është llogaritur mirë nga projektuesit e tij për pasojat që do të ketë në Lëvizjen tonë për çlirim dhe bashkim kombëtar. Pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit dhe Kadriut, pararoja staliniste e LRSHJ-së nuk e pati vështirë t'i kryente detyrat dhe urdhërat që i vinin nga Tirana, kryerja e të cilave nuk shkonte

në interes të Kosovës, po shkonin në interes të pushtetmbajtësve të Shqipërisë e të Jugosllavisë. Vrasja e Jusuf Gërvallës në vlugun e punëve, kur Lëvizja kishte marrë hov, kur asaj i duhej zotësia dhe trimëria që e kishte Jusufi dhe pastaj vdekja e Metush Krasniqit në Spitalin e Prishtinës nga pasojat e torturimit të tij nga udbashët shqiptarë me në krye tradhtarin me damkë Zymber Zybmerin, Lëvizjen e dëmtoi tepër rëndë, pasi mbeti pa dy udhëheqësit e saj më të zotë, pa dy udhëheqësit e saj vizionarë, pa dy udhëheqësit e saj që kurrë nuk u manipuluan nga ideologjia e pansllavizmit dhe e djallit, që ishin demokratë të vërtetë, të cilët mirë e kishin kuptuar se shqiptarët sa herë këmbët i kanë lidhur me sllavo-grekët dhe me majtistë dhe komunistë, kanë punuar kundër interesit të vetë. Fatkeqësisht lëvizja ra në duar të njerëzve pa përgjegjësi dhe pa vetëdije kombëtare, por që i kishin shumë të zhvilluara instiktet klasore, siç i kanë të zhvilluara instiktet grabitqare ujçit, dhelpërat dhe çakallët.

Mbeti shkret diaspora shqiptare. U dëmtua tepër rëndë LNÇKVSHJ-ja. Iu thyen krahët shokëve të idealit. Por rininë tonë heroike nuk e demoralizuan, siç pritnin armiqtë tanë të hapët, të fshehtë dhe tinzarë. Përkundrazi, atë e forcuan, pasi që djemtë dhe vashat më të mirë të kombit ndoqën shembullin e Metushit dhe të Jusufit dhe- me tërë qenien- iu përkushtuan idealeve të larta të popullit. Organizuan demonstrata nëpër rrugët e qyteteve të Kosovës. Mbrojtën me sukses çështjen kombëtare para hetuesve dhe gjykatësve të shkaut. Në asnjë mënyrë nuk ua thyen moralin e lartë vuajtjet e dënimeve të gjata nëpër burgjet jugosllave, por u kalitën dhe u bënë më të mençur dhe më të zotë se gjeneratat e mëhershme, që zbuloheshin shumë shpejt posa shkruanin ca parulla. Ajo tani e ngriti nivelin e organizimit në sasi dhe cilësi. Ajo bëri një punë të mençur duke i pajtuar gjaqet. Iu ndihmua gjeneratave të vjetra për t'i ndërtuar institucionet e Shtetit të Kosovës. Ajo i formoi bërthamat e para të Ushtrisë së Kosovës, me stërvitjet ushtarake që i bëri në Shqipëri, për të mësuar artin ushtarak, që me dijen e fituar i aftësuan edhe shumë atdhetarë si përdoret arma, si vritet shkau i shkinës, që e rrihte shqiptarin në prag të shtëpisë, para gruas dhe fëmijës. Ajo i krijoi njësitë e para të Ushtrisë së Kosovës në Llap, Drenicë dhe Dukagjin, pasi arriti njësia e parë e Ushtrisë së Kosovës nga Nëna Shqipëri në Dukagjin, e armatosur dhe e udhëhequr nga komandanti i parë i saj Salih Çeku. Ishte Adem e Hamzë Jashari, Salih Çeku, Zahir Pajaziti e shumë të rinj e Burra të Dheut nga të gjitha viset e Kosovës, që ia vunë qysh në fillim të

viteve '91 bazat e Ushtrisë së Kosovës, që vritnin policë dhe masha të shkaut dhe nuk zbuloheshin as pas akcioneve të para, as pas akcioneve të dyta, as pas akcioneve të njëpasnjëshme disa vjeçare, duke ua futur leprin në bark kriminelëve shkje dhe tradhëtarëve.

ISHTE ZAHIR PAJAZITI PËRFAQËSUESI I UNIVERZITETIT TË KOSOVËS, PËRFAQËSUESI I DENJË I GJENERATËS HISTORIKE QË I RA HISE TË VIHET NË BALLË TË NJËSIVE GUERILE TË KOSOVËS

Ishte Zahir Pajaziti përfaqësuesi i Universitetit të Kosovës, përfaqësuesi i denjë i gjeneratës historike, që i ra hise të vihët në ballë të njësive guerile të Kosovës. Ishin djemtë e shpianikut trim e atdhetar Mixhës Shaban, Rifat, Adem dhe Hamzë Jashari, që luftën guerile të njësive të para të Ushtrisë së Kosovës e ngritën në një nivel më të lartë organizimi, duke i dalur karrshi shkaut haptas! E krisën Pushkën Kryengritëse të Kosovës për të mos u ndalur zëri i saj as Kryengritja për të mos u shuar! Nuk pati çdo ditë dhe çdo javë tim dhe flakë, por zjarri mbahej i ndezur që nga ajo natë kur shkrepë pushka e Jasharëve të Prekazit Legjendar; që kur u përgjakën shkijet mizorë nga Sali Çeku me shokë në Dukagjinin plak, qëkur njësitet e Llapit bënë roje për ta mbrojtur Kosovën në Pollatë. Pati pushime të kohëpaskohshme, për shkaqe taktike, por 31 dhjetori i 1991-it, në Historinë tonë do të shënohet me shkronja të arta se Kosova e filloi Kryengritjen! Se aty e ka burimin e kthjelltë Ushtria Çlirimtare e Kosovës, që i parapriu Lëvizja paqësore e Rugovës dhe e prijësve tjerë që s'e tradhtuan Kosovën. Se zjarri mbetë i ndezur, se zjarri nuk u shua fare, por as nuk u hap, ishte strategji dhe taktikë e përpunuar mirë nga Koka të zgjuara, që kokëkrisurit kurrë s'kanë për ta kuptuar. Po prijësit e njësive guerile ishin të ndërgjegjshëm për rolin që kishin marrë, ishin të zgjuar, trima dhe atdhetarë.

Adem e Hamzë Jashari, Zahir Pajaziti dhe Salih Çeku me bashkëveprimtarët nuk rrinin kot, por punonin si bletë, tubonin armatime të nevojisme, gjenin shokë, ushtronin e stërvitnin ushtarët e njësive të tyre duke ua dhënë dijen e fituar në ushtrimet që ata i patën bërë në Shqipëri në fund të vitit 1981. Por kur shkau mendoi se Kosova mbeti shkret, se shkijet mund të luajnë trup e tërthor nëpër tokën e saj të shenjtë, i hangrën plumbat kresë. U tmerruan shkijet, u gëzuan shqiptarët, por kokëkrisurit mendonin se është kohë e medaljeve, se është kohë e rrahgjoksëve, prandaj akuzonin udhëheqjen e Kosovës, që nuk po i pranonin se ato

aksione po i bënë njësitë e Kosovës. Nuk dinin të gjoir se politika ka rregullat e saj, se shpeshherë nuk bënë të thuhet gjërat ashtu si janë. Tjetër mendohet, diçka tjetër thuhet, e tjetër vepohet, se varet nga rrethanat e situatat e krijuara, por te caku (rrugës së shkurtë apo rrugës së gjatë) gjithëseqysh shkohet.

Atentati i 31 janarit të vitit 1997 në afërsi të Vushtrisë u organizua nga UDB-ja e Jugosllavisë, me ndihmën e pakursyer të SHIK-ut të Shqipërisë, për ta vranë Zahir Pajazitin, udhëheqësin dhe komandantin e Ushtrisë së Republikës së Kosovës, ashtu siç u organizua dhe u krye më parë atentati afër Shtutgartit më 17 janar të vitit 1982, për ta vranë Jusuf Gërvallën, nacionalistin dhe udhëheqësin vizionar, vepimtarin dhe intelektualin më të zotin që e kishte Lëvizja në radhët e saj.

E vranë Komandantin e UÇK-së, Zahir Pajazitin me bashkëluftëtarët Hakif Zejnullahun dhe Edmond Hoxhën, që pati pasoja të njëjta për Ushtrinë çlirimtare të Kosovës, siç pati pasoja vrasja e Jusuf Gërvallës për Lëvizjen tonë ilegale shumë vjet më parë. Atëherë Lëvizjen e muarën stalinistët e LRSJ-së, për ta bërë plaçkë të Sigurimit të Shqipërisë. Me vrasjen e Komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Zahir Pajazitit, Adem dhe Hamzë Jasharit, ajo ra në duart e komplotistëve nanoistë, që bënë komplot pas komploti për të pamundësuar të bëhet ajo ushtri e institucionalizuar e Republikës së Kosovës, që ishte kushti i parë për tu bërë "ushtria më e fortë e Ballkanit".

Po ku do të lejonte Nanosi të rrezikohen interesat e grekut dhe shkaut në Ballkan, kur pararojën staliniste të LPK-së dhe enveristët karrieristë të LBDK-së i kishte ca në xhep dhe ca në dorë, dhe i thërriste herë njëren palë dhe herë tjetren palë në Tiranë që t'i ia bëjnë temenanë, por dhe për t'i marrë urdhërat që duhet t'i kryejnë, pa guxuar me asnjë fjalë ta kundërshtojnë, dhe kështu të gjoirët i bëri horë. Pasojat e atyre vrasjeve atëherë askush nuk i ka mundur t'i parashikonte. Edhe tash vetëm njohësit e mirë të ngjarjeve dhe rrethanave që pasuan pas atyre atentateve, dinë të na tregojnë se Lëvizja jonë për çlirim dhe bashkim kombëtar qysh nga '82-shi muar ramje të fortë, u rrëzua për tokë dhe më kurrë nuk u ngrit në këmbë. Kjo ndodhi për shkak se atë e "drejtonin" stalinistë dhe karrieristë të marrë, që ishin vegla të verbëta të Sigurimit të Shqipërisë e tërthorazi ishin të lidhur edhe me UDB-në e Jugosllavisë.



Edhe kur shpresohet se Lëvizja shpëtoi nga kthetrat e stalinistëve dhe karrieristëve të marrë, pasi që nga ilegaliteti në legalitet të plotë kaloi, kur u formuan themelet e shtetit të dytë shqiptar në Ballkan, edhe kur njësitë e Ushtrisë së Kosovës në ilegalitet vepronin, pararoja staliniste e LPK-së me ndihmën e SHIK-ut, Nanosit dhe Mejdanit arritën të bëjnë komplot pas komploti në bërthamat e Ushtrisë së Republikës së Kosovës, ku vrasja e Komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Zahir Pajazitit më 31 janar të 1997 është grushti i dytë i "nokdaunit klasik" që Lëvizja jonë muar pas atentatit të Shtutgardit. Vetëm të zotët e mendjes dhe njohësit e ngjarjeve më të reja të Historisë sonë dinë të na tregojnë me fakte të shumta se njësitë ushtarake të Republikës së Kosovës kurrë nuk do të binin në duar të pararojes staliniste të LPK-së, sikur të mos kishte ndodhur kjo vrasje mizore e pas pak edhe vrasja e Adem dhe Hanz Jasharit, që ranë dëshmorë dhe u bënë kurban me 20 anëtarë të familjes për t'iu dhënë zemër të gjithë shqiptarve të botës, për t'ua hequr frikën, për t'ua rikthyer shpresën në fitore, për t'ua ringjallur trimërinë dhe krenarinë kombëtare! Ata me shembullin e trimërisë së tyre të pashoq dhe shpirtin e sakrificës për t'u flijuar me gjithë familje me emrin e Zotit për ta shpëtuar Kosovën iu treguan të gjithë shqiptarëve, jo me fjalë por me vepër, se si fitohet liria, qysh çlirohet Kosova dhe bëhet Shqipëria Etnike!

Çka të flas më parë për jetën dhe veprën e Zahir Pajazitit, atij burri të madh të Kosovës martire, i cili që nga rinia e hershme u kyç në lëvizjen tonë ilegale. Për shkaqe objektive nuk do të flas për veprimtarinë e tij të paraviteve të '90-ta. Nuk do të flas as për "aventurën" e tij sa ishte i ri ende pa i mbushur 18 vjet, për ta vizituar Shqipërin më 1980, kur e pat kaluar lumin e Bunës me not së bashku me tre shokë. Në vend se të përgëzohet i riu për guximin e tij dhe gjestin atdhetar, organet e shtetit të Shqipërisë e dënuan me 15 ditë burg të riun kureshtar, pse pati guximin të mos e njohë kufirin që na e vunë me të padrejtë dhe me dhunë serbo-sllavët gjakatarë. Nuk do të flas për jetën e tij sa ishte nxënës i Shkollës së Mesme të Milicisë në Vushtrri dhe largimin e tij nga kjo shkollë, pasi i kreu dy vitet e para. Nuk do të flas as për jetën e tij studentore sa ishte student në Universitetin e Prishtinës. Nuk do të flas as për veprimtarinë e tij legale, ku ai kreu me sukses detyrën që ia besoi Qeveria e Kosovës duke i mbledhur 3%-in, kontributet e qytetarëve. Nuk do të flas as për punën e tij në organizimin e jetës politike të Kosovës, duke kryer detyrën e Kryetarit të Degës së PPK-së në vendlindjen e tij në Orllan.

Këtë radhë do të ndalem shkurtimisht në punën e madhe të Zahir Pajazitit në formimin e njësive ushtarake ilegale të Ushtrisë së Kosovës në Llap, Prishtinë, dhe në Gjakovë, si dhe aksionet guerile që i kryen ato njësi, ku në shumicën e rasteve Zahiri i famshëm ishte edhe vetë pjesëmarrës. Do t'i ndriçoj deri diku rrethanat që ndikuan në Zahir Pajazitin të ndërmernte iniciativën për formimin e një Këshilli koordinues, që do të udhëhiqte veprimtarinë e njësive ushtarake ilegale që ekzistonin në Kosovë dhe pasojat që rrodhën pastaj me formimin e atij Këshilli, kur pararoja staliniste e LPK-së i futi njerëzit e saj në atë këshill. Këta njerëz, pastaj, me komplete përvetësuan njësitë guerile që i formuan Zahir Pajaziti dhe Adem Jashari duke bërë grushtshtet në radhat e tyre. Është me rëndësi të prekën edhe rrethanat e vrasjes së Zahir Pajazitit, Haki Zejnullahut dhe Edmond Hoxhës, për të ardhur te e vërteta një ditë se kush ishin ata, me emër dhe mbiemër të plotë, që i ndihmuan shkaut në krime, së paku për t'i leqitur dhe për t'i mallkuar dhe për ta lutur Zotin që fara e tyre të jetë e sosur! Cilët ishin ata tradhtarë, që u bënë opingë, papagaj dhe klysh të shkaut?!

Zahir Pajaziti ishte rritur dhe edukuar nga një familje me tradita të atdhedashurisë. Por edhe rrethanat e vështira të robërisë së shkaut që i përjetonte Zahiri çdo ditë, krijuan luftëtarin trim, atdhetarin e pathyeshëm, burrin e fjalës dhe besës. Tek ai rritej çdo ditë e më tepër dashuria e pakufishme për komb, shqiptarë dhe shqiptari, vyrtete këto që e bënë udhëheqës të dashur e të nderuar, kryetrimin dhe komandantin e njësive guerile, vëllain e madh të bashkëluftetarëve të tij.

Vitet e bujshme të Lëvizjes tonë kombëtare në vitet e para të '90-ës, Zahirin e kishin gjetur me një përvojë të mirë organizimi në veprimtarinë ilegale. Atë dije dhe atë përvojë Zahiri e shfrytëzoi shumë mirë në veprimtarinë e tij legale, në jetën politike të Kosovës. Si njohës i mirë i strategjisë së Lëvizjes tonë kombëtare, që në rrethanat aktuale të viteve 90-ta u detyrua të përcaktohet për realizimin e qëllimeve madhore të saj me mjete paqësore, për ta ndërkombëtarizuar si duhet çështjen shqiptare të Kosovës, por edhe për shkaqe të rrethanave në Jugosllavi dhe atyre ndërkombëtare, Zahiri u kyç në jetën politike të Kosovës dhe nuk u kursye të japë mundin e tij në të gjitha aspektet shoqërore. Ai, duke qenë i sigurtë se vetëm me mjetet paqësore nuk do të arrijmë realizimin e objektivave madhore kombëtare, iu përkushtua formimit të njësive guerile, duke bërë kështu punë dhe veprimtari paralele, legale dhe ilegale.

Vetëm një burrë i fortë nga karakteri, një vizionar me energji të pashtërrëshme, që kishte vullnet të fortë veprimi si ai, do t'i kryente me aq përpikëri detyrat që ia kishte ngarkuar vetes dhe që ia kishte ngarkuar shoqëria. Ai i vuri themelet e shëndosha të një organizimi ilegal për kryerjen e aksioneve ushtarake, sipas nevojës dhe rrethanave që paraqiteshin në jetën politike të Kosovës, jo për ta penguar, por për ta ndihmuar Udhëheqjen e Kosovës në ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare të Kosovës. Ai i formoi njësitë guerile në Llap, Prishtinë dhe në Gjakovë me shokë dhe bashkëveprimtarë, për të cilët çështja kombëtare vihej kurdoherë mbi interesat personale, partiake dhe regjionale. Në organizimin e veprimtarisë ushtarake ilegale i ndihmuar shumë dijet e arritura nga arti ushtarak sa ishte nxënës i Shkollës së Mesme të Milicisë në Vushtri dhe pjesëmarrja në ushtrimet dhe stërvitjet ushtarake në Shqipëri në shtator të vitit 1991, atëherë kur udhëheqja e Kosovës dhe e Shqipërisë u muarën vesh që në dy qendra stërvitore në Shqipëri të ushtrohen burra të zgjedhur atdhetarë të Kosovës, që me dijen të cilën do ta fitojnë nga ushtarakët e Shqipërisë të bëhen të aftë t'i formojnë njësitë ushtarake ilegale të Kosovës.

Zahiri pas kthimit nga Shqipëria, me armatimet që u sollën më vonë nga Shqipëria dhe ato që i kishte siguruar më parë, formoi njësitë guerile në Llap, Prishtinë e më vonë edhe në Gjakovë. Ai, edhe para se të shkonte në stërvitje në Shqipëri, i kishte formuar krye në veti disa grupe, që bënin stërvitje fizike dhe ushtarake për të qenë të gatshëm dhe të aftësuar për aksione guerile. Në organizimin e njësive ilegale ushtarake i ndihmoi shumë edhe përvoja e Çetës së Llapit. Zahiri u kujdes shumë që ta sigurojë Hasan Ramadanin, njërin nga anëtarët e Çetës së Llapit, i cili nuk pati mundësi të kalonte në Evropën Perëndimore për tu strehuar siç u strehuan shokët e tij për t'i shpëtuar ndjekjes penale nga gjykata e shkaut.

Pas formimit të njësive guerile të Kosovës dhe aksioneve të para që pasuan në fund të vitit 1991 e në fillim të vitit 1992, udhëheqja e Kosovës, për shkaqe strategjike, pat kërkuar nëpërmjet Fehmi Aganit nga udhëheqësit e njësive guerile ta pushojnë aktivitetin luftarak për një kohë. Shumë pjesëtarë të njësive ushtarake patën ikur në Evropën Perëndimore, për t'iu shmangur ndjekjeve dhe burgosjeve, në mesin e të cilëve ishte edhe Salih Çeku, komandanti i parë i njësisë së parë të ushtrisë së Kosovës, e formuar në Shqipëri, për ta sjellë armatimin e nevojshëm për njësitë e para që u formuan në Llap, Drenicë dhe Dukagjin. Rifat Jashari

u detyrua të kalonte ilegalisht kufirin Kosovë- Shqipëri për të arritur në vendin e punës në Gjermani se duhej të mbahej familja e gjerë, por Ademi e Hamzë Jashari dhe Zahir Pajaziti e të tjerë, mbetën në Kosovë për t'i mbajtur të gjalla njësitë guerile, duke e plotësuar me ushtarë të rinj vendin e atyre që ranë nëpër burgjet jugosllave, apo u larguan jashtë Kosovës.

Siç dihet subjektet politike dhe organet shtetërore në fillimin e viteve 90-ta i kryen shumicën e objektivave që ishin të domosdoshme për ta çuar përpara zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit ishte në radhë zgjidhja e çështjes së Kosovës. Kuptohet që Serbia i kishte bërë të gjitha përpjekjet, planet dhe skenarët që Kosova të mos i dalë prej dorës, pas dështimeve të njëpasnjëshme që pati. Po shqiptarët ishin përgatitur për atë ndeshje vallë? Pak apo aspak do të thoshin njohësit e mirë të situatës në vend dhe të rrethanave ndërkombëtare. Siç po shihet, politika e Lëvizjes kombëtare për homogenizimin e shqiptarëve, përpos të mirave që ia solli në fillim Kosovës, i solli më vonë edhe dëme të mëdha. Në udhëheqjet partiako-shtetërore të Republikës së Kosovës u kyçën edhe shumë elementë destruktivë, karrieristë dhe bashkëpunëtorë të shkaut. Kjo bëri që në udhëheqjet e Kosovës në të gjitha nivelet, partiako-shtetërore, bëhej luftë e pakompromis për pushtet, pa e bërë ende shtetin, ku si pasojë pati përçarje të thella. Në vend se të bashkëpunojnë subjektet shqiptare, për të vepruar sëbashku sikur të ishin një subjekt i vetëm, luanin lojën "dikush thumbit, dikush patkoit" dhe krijuan status-quonë: "prit gomar sa të dali bar".

Kjo çoroditje e të "mëdhenjve" solli në Kosovë plogështi, pesimizëm, kaos politik dhe organizativ. Në anën tjetër, policia serbe filloi të egërsohet; rrihte dhe burgoste shqiptarë me preteksin e dorëzimit të armëve. Shkijet me sllavët e Maqedonisë bënë plane të hapta për hapjen e një koridori nëpër Maqedoni për përcjelljen e 400 mijë shqiptarëve të Kosovës për në Shqipëri. Shesheli ankohet në Parlamentin e Serbisë se janë në hall paramilitarët e tij, që nuk po e kanë një forcë të denjë shqiptare në Kosovë për t'i provuar forcat dhe për t'i qeruar hesapet njëherë e përgjithmonë me shqiptarë. Trajkoviqi, udhëheqësi i shkijeve të Kosovës, haptas, disa herë i thërret shqiptarët për mejdan, pasi sipas tij "vetëm me luftë shqiptarët mund ta bëjnë shtetin e tyre në Kosovë".

Kombi shqiptar ishte i rrezikuar më tepër se kurrë më parë. Në këto kushte tejet të komplikuar udhëheqja e Kosovës nuk e kishte edhe aq lehtë të vepronte. Sidomos hapja e një fronti të luftës në Kosovë, kur Shqipëria- në vend që ta ndihmonte çështjen e Kosovës- ajo u bë brengë e madhe për burrat dhe rininë heroike të Kosovës, pasi kallej flakë nga bandat e grekut dhe bandat staliniste-tradhtare shqiptare. Zhdukja e faktorit shqiptar në Ballkan ishte realizimi i një skenari antishqiptar të një Qendre antishqiptare, të udhëhequr nga serbo-sllavo-grekët, që kishte për synim zhdukjen e kombit shqiptar, duke e bërë Shqipërinë koloni greke, ndërsa Kosovën me Viset tjera shqiptare për ta shkombëtarizuar siç e shkombëtarizuan shkijet Toplicën dhe grekët Çamërinë më parë. Vetëm Qosja me një grup stalinistësh të LPK-së dhe ca karrieristëve të sëmurë për pushtet të LBDK-ës i gëzoheshin triumfit të "revolucionin të vonuar demokratik " të Shqipërisë, duke shpresuar se Nanosi me kompani do t'u ndihmonin për triumfin e një varianti të " revolucionit..." të Shqipërisë edhe në Kosovë, me anën e të cilit do të fitojnë vende udhëheqëse, pushtet dhe privilegje.

Pasi që të gjitha partitë shqiptare të Kosovës ishin përcaktuar për zgjedhjen e çështjes së Kosovës me mjete paqësore, ishte një defekt dhe punë jo serioze që shqiptarët të mos e kenë një forcë radikale, që zgjidhjen e çështjes shqiptare e sheh vetëm me krijimin e Shqipërisë etnike, që do të propagandonte edhe luftën e armatosur. Pasi këtë detyrë të vështirë nuk kishte mundësi ta bënë subjektet legale shqiptare, ishte e domosdoshme që atë punë ta kryente një forcë ilegale, që do të merrte aksione të kohëpaskohëshme ushtarake, për ta sensibilizuar opinionin e gjerë dhe për të ndikuar në qendrat e vendosjes ndërkombëtare, për t'u marrë më seriozisht me zgjedhjen e çështjes shqiptare të Kosovës. Ajo forcë u krijua nga Lëvizja jonë kombëtare, e cila ishte legalizuar në fillimin e viteve të '90-ta, duke i krijuar njësitë ushtarake guerile më 1991/92. Pas aksioneve të para në Llap, Drenicë dhe Dukagjin, në fund të vitit 1991 dhe fillim të vitit 1992, udhëheqja e Kosovës nga presioni që iu bë nga diplomacia e SHBA-ve, kërkoi nga udhëheqësit e njësive guerile të mos bëjnë aksione ushtarake për një kohë. Vetëm kur Këshilli koordinues i krijuar më 1993 nga Salih Çeku, Zenun Idrizi, Saim Tahiri dhe Ismet Avdullahu, muar pëlqimin dhe përkrahjen e Aganit dhe Bukoshit për domosdoshmërinë e rifillimit të aksioneve të kontrolluara ushtarake në Kosovë, dhe premtuan mbështetje morale e përkrahje

financiare, aksionet rifilluan. Këshilli kishte për detyrë për t'i mbajtur lidhjet në mes Bujar Bukoshit dhe udhëheqësve të njësive guerile të Republikës së Kosovës, por edhe të bënte furnizimin e njësive me mjete ushtarake dhe financiare.

Udhëheqësit e njësive ushtarake ilegale të Kosovës, duke e parë se shkau i ka hangër në sy shqiptarët dhe është trimërrur shumë duke i keqtrajtuar për shkak të mosdorëzimit të armëve, i rifilluan aksionet për t'u dhënë plumb xhelatëve të Beogradit, por edhe tradhtarëve në radhët tona. Veçmas ishte rrezik i madh për Kosovën që refugjatët e Kroacisë dhe të Bosnjes ta shohin perspektivën e tyre në Kosovë. U vran ca policë, u vranë ca spiunë tradhtarë, por edhe u sulmuan shtëpitë e kolonëve në ndërtim dhe aty ku banonin nëpër konvikte të shkollave të Kosovës, (Podujevë, Prishtinë, Deçan etj.), që të kuptojnë mirë se Kosova nuk mund t'ua zëvendësojë Krainën serbe të Kroacisë dhe as të bëhet për ta Serbi. Pas këtyre akcioneve policia e shkaut e uli bishtin dhe më nuk guxonte në fshatrat e Kosovës për të rrahur shqiptarë. Morali i shqiptarëve u ngrit. Frika u largua shpejt. Zahir Pajaziti, pasi muar lajmin për arritjen e Marrëveshjes në mes Aganit, Bukoshit dhe Këshillit koordinues që udhëhiqej nga Salih Çeku, e dërgoi në Shqipëri Blerim Azemin për të kontaktuar me ushtarakët madhorë të Shqipërisë, me të cilët ai kishte krijuar miqësi sa ishte në stërvitjet ushtarake në shtator të vitit 1991, për të kërkuar ndihmë, duke ia gjetur një kanal furnizimi për njësitë guerile të Republikës së Kosovës, që të siguronte materiale ushtarake.

Pasi që Blerimi nuk pati sukses në detyrën që ia shtroi Zahiri, ky vendosi të shkojë vet në Shqipëri në prill të vitit 1994, ku pas kontakteve me të njohurit e tij, arriti të sigurote mjete ushtarake të domosdoshme për aksionet që i kishte paraparë t'i kryejnë njësitë guerile që i komandonte ai. Duhej ta kalonte kufirin shqiptaro-shqiptar në afërsi të Kukësit. Për fat të keq takohet me kufitarët e Shqipërisë. E ndalin me shokun e tij që ishin ngarkuar me bomba dore dhe monicione e mjete tjera ushtarake, e burgosin dhe me 30 ditë burg e dënojnë. Pas një muaji kthehet në Prishtinë te vëllai i tij Agimi, më 26 prill të vitit 1994, në Konviktin e studentëve, i lodhur dhe i mërzitur për kohën e humbur në burg dhe për mjetet e luftës që ia muarën kufitarët e Shqipërisë. Njësitë guerile të udhëhequra nga Zahir Pajaziti gjatë vitit 1994/95 ishin zgjeruar dhe rritur shumë. Ishin rritur edhe nevojat për mjete luftarake dhe

finansiare. Ishte e domosdoshme që të bëhej një takim në mes Zahir Pajazitit dhe përfaqësuesve të Këshillit kordinues për t'i trajtuar shtruar çështjet organizative të njësive guerile, çështjet financiare, çështjet e strategjisë dhe taktikës së njësive ushtarake. Nga Zvicra për në Shqipëri ishin nisur së bashku me një komb Ismet Avdullahu, Nazmi Ajeti, Zenun Idrizi dhe Saim Tahiraj, ku përpos mjeteve ushtarake kishin marrë me vete edhe mjetet financiare, të cilat ua kishte dhënë Bukoshi dhe që i kishin tubuar shokët e organizuar.

Më 24 dhjetor të 1994 Zahir Pajaziti arriti në Shqipëri me një bashkëlufëtari, ndërsa një natë më vonë arritën nga Zvicra Ismet Avdullahu me shokë. Zahir Pajaziti ka folur me të gjithë bashkarisht por edhe me secilin veç e veç. Nazmi Ajeti ia ka dhënë adresat se ku mund t'i gjejë ca armatime të cilat i ka lënë ai para se ta lëshojë Kosovën. Zenun Idrizi e ka këshilluar që të ketë kujdes në Shqipëri nga LPK-istat, ndërsa bisedat më të gjata Zahir i ka pasur me Ismet Avdullahun, ku janë biseduar çështje të ndryshme organizative, çështjet e financimit, çështjet e taktikës dhe strategjisë së luftës. Siç thotë Ismet Avdullahu dhe Nazmi Ajeti, Zahir Pajaziti paska kërkuar më tepër mjete financiare nga Bukoshi. Ndërsa koncepti i tij për luftën kishte qenë se ajo duhet të vazhdohet në formë të ilegalitetit të plotë, duke kryer aksione të kohëpaskohshme, por duke pasur kujdes që të mos kalohet në luftë të haptë dhe frontale pa u pjekur kushtet e brendshme dhe ato të jashtmet, pa u bërë përgatitjet e nevojshme psikike, organizative dhe ushtarake. "Qëllimi i aksioneve ushtarake, ka cekur Zahir Pajaziti, është që nëpërmjet tyre t'ua bëjmë me dije Qendrave të vendosjes ndërkombëtare se jemi në gjendje t'i përdorim të gjitha mjetet e luftës çlirimtare për arritjen e qëllimeve tona të drejta, ndërsa popullit t'ia bëjmë me dije se duhen të bëhen gati për ndeshjen përfundimtare, që do ta kemi me serbët, por edhe policisë serbe dhe spiunëve të regjur të tyre t'ua futë frikën në shpirt, që të mos ndihen të sigurt as në familjet e tyre e lere më nepër qytetet dhe fshatrat e Kosovës".

Siç thotë Ismet Avdullahu: "Bujar Bukoshi- gjatë vitit 1996- i ndërpreu ndihmat financiare për njësitë guerile që komandoheshin nga Zahir Pajaziti. I vetmi burim financimi për ato njësi mbeti ndihma vullnetare nga një grup bashkëkombësish dhe bashkëvendasish që jetonin dhe punonin në Zvicër dhe Gjermani". Sipas tij, e vetmja rrugëdalje mbeti të kërkojmë ndihmë financiare nga "aktivistët e LPK-ës, të cilët

mbilidhnin ndihma në emër të Kosovës, ndërsa në tubimet informative që i organizonin rrihnin gjoks se njerëzit e tyre po kryejnë aksione ilegale në Kosovë".

I vumë kontaktet e para, thotë Ismet Avdullahu, "me " Abazin " Ali Ahmetin, që bënte pjesë në udhëheqjen e LPK-së dhe kërkuam bashkëpunim për t'i ndihmuar njësitë ilegale që vepronin në Kosov. " Abazi " na premtoi ndihmë financiare dhe material ushtarak, po qe se bëhemi të sigurtë dhe flasim shtruar e pa dorëza. Takimi përfundoi pa kurrfarë marrëveshjeje, pasi që ne nuk kishim të drejtë dhe as që guxonim t'i zbulonim fshehtësitë ushtarake, por edhe për shkak se "Abazi " u vetëzbulua se nuk kishin njerëz dhe as njësi guerile, pasi që gjatë bisedës për të na bindur se ata kanë bërë punë të mëdha dhe kanë kryer aksione të rëndësishme në Kosovë, i pëvetësoi aksionet që i kishin kryer njësitë guerile nën komandën e Zahir Pajazitit dhe Salih Çekut, për të cilat ne ishim njoftuar saktësishtë prej njerëzve tanë". Iniciativën e dytë për bashkëpunim e muar Pajazit Jashari dhe kështu u organizua takimi i dytë në mes "Abazit", që përfaqësonte LPK-në, dhe Ismet Avdullahut dhe Pajazit Jasharit që përfaqësonin njësitë guerile të Llapit. Të dy palët u pajtuan që në Kosovë ta organizojnë një takim në mes përfaqësuesve të njësive guerile të Llapit dhe të LPK-ës.

Takimi u mbajt në fillim të vitit 1996 në një park të Prishtinës (afër varrezave të qytetit) në mes Zahir Pajazitit, udhëheqësit dhe komandantit të njësive guerile të Llapit dhe të Prishtinës, i cili kishte një përvojë të gjatë të organizimit legal dhe ilegal, pjesëmarrës në shumë aksione të armatosura kundër okupatorëve serbë, dhe zotëri N.N-it, përfaqësuesit të LPK-së, që nuk kishte as njësi guerile dhe as që kishte marrë ndonjëherë pjesë në ndonjë aksion gueril, pra një person pa përvojë në atë drejtim, por i cili kishte mbështetjen e LPK-së, me mjete financiare e materiale ushtarake. Për t'i ikur ndonjë befasië të papritur Zahir Pajaziti e kishte pas caktuar një njësit prej tre vetësh, njëri prej të cilëve kishte qenë mësuesi Ismajl Sejdiu, për ta siguruar me armë vendin ku mbahej takimi. Takimi përfundoi me marrëveshjen për bashkëpunim duke e ndihmuar njëri- tjetrin me përvojë dhe materiale ushtarake.

Zahir Pajaziti, duke e parë domosdoshmërinë e një bashkëpunimi në mes njësive guerile që vepronin në Kosovë, e bindi N.N.-in të organizojnë një takim tjetër ku do të merrnin pjesë përfaqësuesit e njësive guerile të Llapit, të Drenicës dhe të Dukagjinit. Takimi u mbajt poashtu



në Prishtinë dhe, përpos Zahir Pajazitit dhe N.N-it, në atë takim muarën pjesë edhe tre persona, njëri me pseudonimin "Mustafa " që përfaqësonte LPK-në, ndërsa dy të tjerët përfaqësonin njësitë guerile të Drenicës dhe të Dukagjinit. Në atë takim, të cilin pjesëmarrësit e quajtën Grup koordinues u muar vendimi për marrjen e një aksioni të përbashkët në nivel të vendit. Disa ditë pas përfundimit të atij takimi, më 11 shkurt 1996, njësitë guerile të Republikës së Kosovës kryen një aksion me bomba dore në disa qytete të Kosovës (Podujevë, Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Suharekë dhe Pejë), në vendet ku ishin strehuar kolonët serbë të ardhur nga Kraina e Kroacisë. Qëllimi i këtij aksioni nuk ishte për të vrarë dhe plagosur shqije, por ishte thjesht për të mbjellë frikë dhe pasiguri tek kolonët serbë, dhe për t'ua bërë me dije se kanë ardhur në tokë dhe vend të huaj dhe nuk kanë kurrfarë perspektive jetësore në Kosovën shqiptare.

Pararoja staliniste e LPK-së, e gëzuar përtej mase, se më në fund, pas përpjekjeve disavjeçare për t'i futur njerëzit e tyre në bërthamat e ushtrisë së Republikës së Kosovës dhe pastaj me mjetet e " marrjes së kalasë nga brenda " t'i marrin frenjtë e udhëheqjes së saj, lëshuan Komunikatën nr.18, më 14 shkurt të vitit 1996, me anën e së cilës njoftuan opinionin se përgjegjësinë për aksionin e 11 shkurtit e merr UÇK-ja, e cila drejtohet nga Shtabi Qëndror. Pra, siç po shihet, Grupin koordinues e shpallën Shtab Qendror, ndërsa njësitë guerile të Llapit, Drenicës dhe të Dukagjinit i shpallën Ushtri Çlirimtare të Kosovës. Siç dëshmon Ismet Avdullahu, udhëheqja e LPK-ës nuk është konsultuar me të gjithë anëtarët e Grupit koordinues kur e kanë lëshuar Komunikatën nr.18, pasi që Zahir Pajaziti e paska pas thirrë me telefon Ismet Avdullahun për ta shprehur pakënaqësinë dhe revoltën që LPK-ja nuk e ka pyetur dhe as është konsultuar me të për emërtimin e ushtrisë, (të njërive guerile) dhe as për emërtimin e organit udhëheqës të saj. Siç dëshmon Ismet Avdullahu, Zahir Pajaziti- edhe pse nuk ishte i kënaqur me veprimet e LPK-së, ai nuk e prishi marrëveshjen për bashkëpunim duke shpresuar se do të tejkalohen mosmarrëveshjet.

Në takimin e Grupit koordinues që është mbajtur në Prishtinë pas shpalljes së Komunikatës nr.18, Zahir Pajaziti përpos që ka shprehur pakënaqësinë e tij me udhëheqjen e LPK-së në atë takim, që nuk kanë pyetur askënd për asgjë në lidhje me Komunikatën nr. 18, por edhe paska pas kërkuar nga Këshilli koordinues i njërive guerile të Kosovës- i formuar në maj të vitit 1993 në Zvicër- dhe nga udhëheqësia e LPK-së

për ta formuar së bashku një Grup koordinues në diasporë prej veprimtarëve të dëshmuar, të cilët shqiptarinë e kanë ideologji dhe parti, që nuk anojnë nga ngjyrat ideologjike dhe partiake, të cilët do të qeverisin me Fondin që do të krijohej në botën e jashtme për ta ndihmuar Ushtrinë e Republikës së Kosovës. Siç dëshmon Ismet Avdullahu, Udhëheqja e LPK-së ishte kundër propozimeve të Zahir Pajazitit, prandaj edhe kërkuan që (grupi koordinues) - SHQ i UÇK-së të dalë jashtë Kosovës, dikund në Evropën Perëndimore, pasi që ishin të sigurtë se Zahir Pajaziti me karakterin e një burri të fortë e të vendosur dhe me autoritetin e respektin që e kishte jo vetën në radhët e njërive guerile, por edhe tek përfaqësuesit e LPK-së që bënë pjesë në (Grupin koordinues) SHQ i UÇK-së, nuk do t'ia lejonte pararojes staliniste të LPK-së ta fusin hundën ku nuk e kanë vendin, prandaj edhe kërkuan që udhëheqja e UÇK-së, që ishte formuar pa dëshirën e tyre, të kalonte dikund në Evropën Perëndimore për të manipuluar më lehtë me të.

Zahir Pajaziti e kishte kundërshtuar me argumente kërkesën e LPK-së duke e arsyetuar se "lufta nuk mund të udhëhiqet nga jashtë", se "në Kosovë duhet të vijnë për të luftuar nga jashtë e jo për të ikur nga ajo posa ta kryejnë një aksion" etj. Kur pararoja staliniste nuk arriti ta largonte nga Kosova Zahir Pajazitin, që ishte pengesa kryesore për realizimin e qëllimeve të tyre për ta marrë udhëheqjen e ushtrisë, atëherë vendosën që përfaqësuesve të tyre t'u caktojnë detyra udhëheqëse. Zahir Pajaziti i paska treguar më vonë në një takim Ismet Avdullahut se në një mbledhje të Grupit Koordinues, (SHQ të UÇK-së) kur bisedohej për përgjegjësitë që duhet t'i ndanim në mes nesh, N.N. paska pas thënë se "mua nga jashtë më kanë zgjedhur përgjegjës për mjete financiare", ndërsa pas tij edhe "Mustafa" paska thënë se edhe atë "nga jashtë e kanë zgjedhur përgjegjës për materiale ushtarake". "U krijua një atmosferë jo serioze dhe qesharake", i kishte pas thënë Zahir Ismet Avdullahut. Zahir Pajaziti paska pas kundërshtuar në fillim një veprim të tillë të LPK-së dhe paska pas thënë se "ne këtu e bëjmë luftën e jo ata jashtë, prandaj ne duhet të vendosim për çdo gjë, pra edhe për përgjegjësitë e çdo sektori e jo ata nga jashtë". Zahir duke ditur nevojën e madhe që kishin për materiale ushtarake, e pranoi një vendim të tillë, edhe pse e dinte se kush i ka financat mund të manipulojë shumë me njerëz të dobët për interesa personale apo klanore. Kuptohet, pararoja staliniste duke ditur se nuk do të kenë sukses për ta marrë udhëheqjen e njërive në ato momente, i

muarën për vete dy sektorët më të rëndësishëm, pa funksionimin e të cilëve as që mund të mendohet kurrfarë suksesi. Sa i përket komandimit, ai mbeti në kuadër të njësive regjionale, përpos kur ishte fjala për aksione të përbashkta në nivel të vendit, atëherë për to duhet të jepte pëlqimin komandant Zahir Pajaziti dhe t'i raportohet atij për kryerjen apo moskryerjen e tyre.

Me kalimin e kohës u bë e qartë si drita e diellit se LPK-ja jo se nuk kishin njësi guerile në Kosovë, por nuk kishin as individë që do të kryenin ndonjë aksion si duhet. Vlen të përmendet vetëm një rast ku shihet papërgjegjësia jo e një ushtari, por e një udhëheqësi të LPK-së, i cili kishte marrë për detyrë përgatitjen e terrenit për ta kryer një aksion Zahir Pajaziti bashkë me Qerim Kelmendin. Ishte vera e vitit 1996, kur Zahir Pajaziti kishte vendosur t'ia japë dënimin e merituar një këlyshi të Beogradit, udbashit më të urryer Zymber Zymberit, që kishte keqtrajtuar me qindra djem e burra të Kosovës, të cilët e mbajtën të ndezur zjarrin e rezistencës sonë kombëtare. N.N.-i, kishte marrë për detyrë të përgatiste terrenin për ta kryer atë aksion. Pas një kohe N.N.-i e paska caktuar ditën dhe kohën kur do të gjendet spiuni i shkaut në restorant. Zotëri N.N.-i, iu kishte shpjeguar Zahirit dhe Qerimit se pasi ta kryenin aksionin duhet të largohen nëpërmjet derës rezervë të restorantit që është e hapur. Ndërsa ai u zotua se do t'i presë aty afër pallatit të shtypit me veturë. Zahir Pajaziti dhe Qerim Kelmendi ishin bërë gati ta kryenin aksionin. Hynë mbrenda në sallë në kohën e caktuar. Nuk ishte aty Zogu i shkaut. U mërzitën shumë që aksioni dështoi, por nga inati nuk u kthyen mbrapa në derën hyrëse të restorantit, por vazhduan të ecin drejt derës rezervë për të dalur dhe për të shkuar në vendin ku duhej t'i priste N.N.-i me veturë. Dera nuk kishte qenë e hapur siç kishte thënë N.N.-i, por kishte qenë e mbyllur. U habitën edhe më shumë që nuk ishte zotëri N.N.-i në vendin ku ishin marrë vesh! E lypën dhe e gjetën në qytet, e muarën dhe e çuan në restorant ku duhej ta kryenin aksionin, për ta bindur atë se ai nuk e ka përgatitur fare terrenin për të pasur sukses atentati i planifikuar. E pranoi fajin që nuk kishte bërë kurrfarë përgatitjesh, por zbuloi edhe faje tjera edhe shumë më të rënda që kishte bërë më herët.

Duhet cekur se nga të gjitha ato premtime që i kishte dhënë "Abazi " për ta bindur Ismet Avdullahun dhe Pajzit Jasharin se njësitë guerile do t'i ndihmojë me të gjitha llojet e armatimit të nevojshëm, dualën të pavërteta, pasi që LPK-ja ia dha Zahirit vetëm një automat, për

të cilin Zahir Pajaziti ka shkuar në Klinë bashkë me Avni Ajetin për ta marrë. Ata është dashur ta bëjnë tërë atë rrugë këmbë nga Klina deri në Podjevë vetëm për një armë. Gjatë vitit 1976 i muarën dhe ca ndihma financiare që nuk çuan kandar fare në plotësimin e nevojave të mëdha që kishin njësitë guerile të komanduara nga Zahir Pajaziti.

Afrohej fundi i vitit 1996, i cili ishte i suksesshëm për njësitë e Republikës së Kosovës, që po krijoheshin dhe po forcoheshin dita ditës. Veçmas njësitë të komanduara nga Zahir Pajaziti u treguan shumë aktive dhe të suksesshme. Ishin zgjeruar radhët, por u mungonin mjetet financiare dhe materialet ushtarake. Nga marrëveshja me LPK-në, Zahir Pajaziti nuk pati kurrfarë dobie, pasi që ndihmat financiare ishin simbolike ashtu siç ishin edhe ndihmat me materiale ushtarake. Ndërsa bashkëpunimi në aksione guerile u tregua i pa suksesshëm.

Në këto kushte tejet të vështira për njësitë guerile Zahir Pajaziti kërkoi një takim me Ismet Avdullahun, i cili e kishte një pjesë të fajit që kishte bërë kontakte me LPK-në, duke e ditur se ata tjetër flasin e tjetër veprojnë. Takimi u vendos të bëhet në Shqipëri. Ismeti tuboi mjete financiare si herat tjera nga grupi i organizuar i bashkëvendasve që njiheshin mirë mes tyre. Në fund të dhjetorit të vitit 1996 takohen në Tiranë Zahir Pajaziti me Ismet Avdullahun, ku i rrahën shumë çështje që kishin të bënin me njësitë guerile, sukseset e tyre dhe bashkëpunimin me LPK-në. U pranua nga të dy se ishte një hap i pa studiuar mirë, kur vendosën kontakte me përfaqësues të LPK-së, që u ka sjellë vetëm dëme dhe asgjë të mirë. U muarën vesh se duhet pasur kujdes gjatë bashkëpunimit me LPK-në, pasi tash ishin të qarta synimet e tyre për ta marrë udhëheqjen e njërive guerile të Kosovës. Pas Vitit të Ri të 1997 Ismet Avdullahu u kthye në Zvicër, ndërsa Zahir Pajaziti mbeti të kthehej në Kosovë me mjetet ushtarake që do t'i blente me të hollat që i solli Ismeti. Ato ditë kishte qenë në Tiranë " Daja "-Azem Sylja, i cili me ndihmën e Qerim Kelmendit, të cilin e kishte sjellë në Shqipëri Zahiri për t'u shëruar nga një plagë, që e kishte pas marrë në një aksion, organizoi një takim me Zahir Pajazitin dhe " Dajën "-Azem Sylën, ku Zahiri ia shprehi trup e shkurt pakënaqësinë e tij në lidhje me veprimet e tyre.

Zahiri u kthye në Kosovë me 20 janar të vitit 1997. Dëshironte ta shihte N.N-in, pasi që ato ditë policia serbe kishte marrë një fushatë të egër për të burgosur studentë të universitetit të Kosovës. Zahiri pasi nuk e shihte askund në Prishtinë N.N-in e thërret Ismet Avdullahun me telefon

për ta porositur atë që t'i pyesë shokët e tij se ku gjendet ai. Ismeti e pyet " Abazin " dhe e porosit t'i pyesë shokët e N.N.-it se ku gjendet ai. "Abazi" e paska pas pyetur "Mustafën"për N.N-in, por ai nuk i ka treguar të vërtetën edhe pse e ka ditur se N.N. ishte i burgosur, por i kishte pas thënë se "Abazit" gjendet në Prishtinë shëndosh e mirë. Këto fjalë Ismeti ia përcjell Zahirit dhe të nesërmen ai bëhet gati të shkojë në Vushtrri të merrte një armë dhe të bisedonte me disa studentë për angazhimin e tyre në radhët e njërive guerile.

Në veturë ishin Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha. Kishte shprehur dëshirë të shkonte edhe Ilir Konushefi me ta, por Zahiri nuk e lejon, duke i thënë se mjaft ishin dhe nuk ka nevojë më tepër.

Policia dinte çdo gjë për Zahir Pajazitin. Dinte edhe për aksionet që i kishte kryer, dinte edhe për rolin që e kishte në rezistencën e armatosur që rritej dhe përhapej në Kosovë. Dinte edhe për aftësitë e tij ushtarake, gatishmërinë për sakrificë. Policia serbe dinte dhe për trimëritë e tij që kur i kishte filluar aksionet e armatosura në Kosovë. Sigurimi i Serbisë më 31 janar e përcollën veturën e Zahir Pajazitit që kur është nisur nga Prishtina. I vunë prita në shumë vende gjatë rrugës Prishtinë-Vushtrri. Zahiri me shokë e kishin pas vërejtur përcjelljen dhe vendosën të qëndrojnë si Burrat e Dheut. I sulmuan kriminelët e Serbisë. Ranë në fushën e nderit, por nuk shkuan gjakhumbur. Shkijet pranonin se i kanë pasur dy të plagosur, por kjo nuk don të thotë se nuk kanë pasur edhe të vdekur, pasi që ata kurrë nuk i kanë treguar humbjet e tyre në ndeshjet që i kanë pasur me shqiptarët.

Vrasja e tre të rinjve në pritë afër Vushtrrisë me 31 janar të vitit 1997 preku zemrat e shqiptarëve në katër anët e botës. Trimëria e tyre rizgjoji krenarinë kombëtare, rriti shpresat e fitores, largoi frikën ndaj vdekjes, se kur vjen ajo me faqe të bardhë, është madhshtore, që nuk bën të qahet.

U organizuan të pamet në Kosovë dhe në diasporë. Këta tre heronj më nuk iu takonin vetëm familjeve të tyre. Ata me veprën që kryen, me trimërinë, guximin dhe sakrificën që bënë për çështjen e çlirimit dhe bashkimit kombëtar, u bënë anëtarë të çdo familjeje shqiptare. Ata tani i takonin popullit, kombit, Atdheut. Por, sikurse burrëria dhe trimëria nuk kanë kufij, ashtu edhe poshtërsia dhe ligështia nuk kanë kufij. "Abazi" me Bajram Ajetin vijnë në të pame që e kishte

organizuar Ismet Avdullahu për ramjen e Zahir Pajazitit me shokë, për të shprehur ngushëllime. Kur Ismeti i përcjell ata, befasohet shumë kur "Abazi"- Ali Ahmeti, kërkon nga ai të mos kundërshtojë se kanë vendosur ta shpallin Zahir Pajazitin anëtar të LPK-së. Ismet Avdullahu kundërshton rreptësisht dhe i kërcënon fizikisht po qe se bëjnë një falsifikim kaq të shëmtuar, kur dihet se ngjyrimet politike dhe ideologjike nuk kishin pasur kurrfarë rëndësie për Zahir Pajazitin. Ai nuk i formoi njësitë guerile dhe nuk kreu aksione të armatosura kundër shkijeve dhe veglave të tyre të verbëta për hir të PPK, Kryetar i Degës të së cilës në vendlindjen e tij në Orllan ai ishte, apo të ndonjë idhulli, por për hir të Kosovës, të tokës së saj të shenjtë, që është ujitut me gjakun e bijve më të mirë të popullit.

Pararoja staliniste e LPK-së e hidhëruar se nuk arriti të bëjë falsifikimin më banal që pjell vetëm koka e krisur e salinistëve të marrë, në Komunikatën nr.30, njoftoi opinionin se më 31 janar të vitit 1997 dhanë jetën për çlirimin e Kosovës "tre pjesëtarë të njësisë tona ushtarake për çlirimin e vendit". Por Komunikata ishte false, siç ishte fals shpirti i tyre i shitur për djallin e mallkuar, dhe nuk çonte peshë fare gënjeshtër e tyre, pasi që mjetet e informimit ndërkombëtar kishin njoftuar para tyre të vërtetën se "afër Vushtrrisë u vran në një pritë tre udhëheqës të UÇK-së, në mesin e të cilëve ishte komandanti i saj Zahir Pajaziti". Kaluan tri vite nga ramja heroike e Zahir Pajazitit, Hakif Zejnullahut dhe Edmond Hoxhës, por pararoja staliniste e LPK-së ka mbetur në ato pozicione të mëparshme, duke bërë përpjekje maksimale të arrijnë falsifikimin e ngjarrjeve dhe ndodhive historike, dhe nuk kuptojnë se një ditë do të zbulohen të gjitha të ligat, kurthat dhe komplotet që i bënë kundër UÇK-së, kundër pavarësisë së Kosovës dhe kundër lirisë së shqiptarëve.

Vdekja e Zahirit, Hakifit dhe Edmondit e tronditën Kosovën dhe ua bëri me dije shqiptarëve se pa sakrificë e pa gjak, nuk fitohet liria. Vrasja e tyre i dëmtoi rëndë njësitë guerile të Republikës së Kosovës, veçmas vdekja e Zahir Pajazitit ishte një humbje tepër e madhe. Ajo ishte një tragjedi kombëtare, pasi që pararoja staliniste e LPK-së dhe karrieristët nanoistë të LBDK-së i kishin duart e lira për të manipuluar në emër të UÇK-së dhe Shtabit Qendror, sepse nuk kishte mbetur personalitet i rangut të Zahir Pajazitit në njësitë e komanduara prej tij që do t'i kundërshtonte veprimet e tyre, të cilët i dëmtonin rëndë interesat kombëtare. Në përfundim të këtij shkrimi do ta shkpus një periudhë nga

libri i Muhamet Kelmendit "Pse nuk u ndërtua Fronti për çlirimin e Kosovës" që i vërteton pohimet e mia në lidhje me komplotet që i bëri LPK-ja kundër njësisë guerile të Republikës së Kosovës, kur thotë: "Kryesia në radhët e saja nuk ka pasur mosmarrëveshje për ndërtimin e UÇK-së nga emërtimi deri në janar të 1997 kur UÇK-ja nga burgosjet dhe vrasjet pësoi dëme të mëdha, kur praktikisht mbeti ky subjekt pa udhëheqje ushtarake të veten. Tash më nuk kishte Shtab Qendror. Tërë udhëheqja kaloi në kuadër të Kryesisë të KP të Degës j.v. Me këtë filluan të duken edhe fërkimet e para, sepse dy anëtarët e Sektorit (Sektorit me rëndësi të veçant, n.i.) Xhavit Haliti dhe Azem Sylja kishin krijuar lidhje me disa forca brenda vendit të cilat pretendonin të dilnin në udhëheqje edhe pse në asnjë sferë nuk kishin aftësi profesionale, njohuri e nuk zotëronin as artin e luftës dhe të ushtrisë. Këta të dy së bashku me disa mbrenda vendit krijuan klanin që bëri grusht politik".

Ja pra, vet nënkryetari i LPK-së, zotëri Kelmendi dëshmon se vrasja e Zahir Pajazitit e la UÇK-në pa udhëheqje ushtarake. Po, pse Muhameti nuk e vë në pah punën dhe përgjegjësitë e Zahir Pajazitit në UÇK? Kjo me siguri duhet të jetë për shkaqe të vazhdimit të procesit të kompleteve dhe falsifikimeve të mëtutjeshme të ngjarjeve, ndodhive dhe të historisë, që edhe Muhamet Kelmendi e ka hisen e tij në këto "maskarallaqe". Botimi i librit nga z. Kelmendi, zbulimi i kompleteve dhe falsifikimeve që i bënë bashkë Xhavit dhe Muhameti & kompani, është rrjedhojë e hidhërimit të M. Kelmendit ndaj shokut të tij Xh. Halitit, i cili e rroku kajten dhe u bë i pa "rahmet", duke i ndarë kolltuqet, pozitat, privilegjet dhe të mirat materiale me karrieristët-nanoistë të LBDK-së, ndërsa "shokun e tij të luftës" e la me "gishta në gojë".

*Botuar: "Bota sot" më 31 janar-4 shkurt 2000*

## PSE U VRANË DHE KUSH MUND TË JENË TË PËRZIER NË VRASJEN U JUSUF GËRVALLËS, BARDHOSH GËRVALLËS DHE TË KADRI ZEKËS!?

SHQIPËRIA KOMUNISTE NUK ISHTE E INTERESUAR PËR  
FORCIMIN E NJË ORGANIZATE KOMBËTARE, SIÇ ISHTE  
ORGANIZATA QË E DREJTONTE METUSH KRASNIQI, JUSUF  
GËRVALLA DHE BASHKËVEPRIMTARËT E TYRE

Riokupimi i Kosovës nga serbo-jugosllavët pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore; ngadhnjimi i djajve komunistë në Shqipëri mbi forcat djathtiste dhe ardhja në pushtet e bajraktarëve të farës ruse në cilësinë e vasalëve, në gjithë hapsirën tonë kombëtare, i sollën popullit tonë tragjedinë më të rëndë gjatë gjithë historisë së tij. Gjysmë shekulli populli ynë u përball me të ligat e shumta që iu erdhën nga armiqtë tanë shekullorë nëpërmjet "parisë" dhe "udhëheqjes" së tij, që ishte këmbë e krye e lidhur me Beogradin, Moskën dhe Pekinin. Këta kokëkrisur, për t'i ruajtur interesat e tyre personale dhe klanore u shndërruan në rrogatë, vasalë dhe skllevër të Rankoviqit, Titos, Stalinit, Hrushovit dhe Mao Ce Dunit.

Forcat e shëndosha kombëtare, edhe pse të pakta në numër, nuk u pajtuan me robërinë serbo-jugosllavo-bolshevike, por e kundërshtuan atë të keqe me të gjitha mjetet që mund t'i vinin në përdorim, edhepse kushtet për një rezistencë të mirëfilltë nuk ekzistonin. Formimi i organizatave ilegale në Kosovë, menjëherë pas okupimit të saj nga partizanët e Titos, ishte hapi i parë i një rezistence të organizuar. Burgosjet dhe dënimet e rënda të intelektualëve dhe veprimtarëve të dalluar, që i vunë themelet e rezistencës ilegale në Kosovë, nga ana e OZN-ës dhe UDB-së jugosllave, nuk i arritën qëllimet që kishin për demoralizimin e popullit tonë dhe shpërnguljen e tij për në Turqi. Përkundrazi, të gjitha masat e dhunës së organizuar që kryheshin kundër popullit tonë e forcuan shpresën e fitorës së çështjes shqiptare dhe të ngadhnjimit të drejtësisë mbi padrejtësinë, pasi që ishin të bindur se "zullumi këputet prej së trashuri", në një ditë, kur shqiptarëve do t'u vijë "shteku". Me burgosjen dhe dënimin e intelektualëve nacionalistë, që i përkisnin NDSH-së, menjëherë pas masakrës së Tivarit dhe shuarjes së



kryengrirjes së Drenicës dhe të Ana Moravës së Gjilanit, ishte një goditje shumë e rëndë për nacionalizmin shqiptar, ishte një humbje e madhe për Kosovën dhe për shqiptarinë.

Formimi i Organizatës "Partia Rrevolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë" nga Metush Krasniqi më 1957, ishte një përpjekje serioze për rimëkëmbjen e NDSH-së, ishte përpjekje me përkushtim për ringjalljen e nacionalizmit shqiptarë në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare, ishte një përpjekje e qëlluar për vënien e kontakteve me aleatët e kombit tonë anglo-amerikanët, ishte një përpjekje që Lëvizja jonë për çlirim dhe bashkim kombëtar të gjejë përkrahje nga shtetet demokratike të Evropës Perëndimore dhe të SHBA. Burgosja dhe dënimi i veprimtarëve të kësaj organizate me në krye Metush Krasniqin më 1958 do të ketë pasoja të rënda për Lëvizjen tonë kombëtare, pasi që ajo do të marri krejtësishtë tjetër kahje. Zbulimi dhe dënimi i veprimtarëve të organizatave ilegale të Kadri Halimit dhe Ali Aliut- më 1961- dhe më vonë të organizatës së Adem Demaçit- më 1964- bëri që Lëvizja jonë kombëtare të pësojë ndryshime rrënjësore. Ajo tani nuk drejtohej nga djathtistë siç drejtoheshin organizatat e mëparshme, (NDSH-eja dhe dy Organizatat që i drejtonte Metush Krasniqi) por drejtohej nga intelektualë majtistë, që kishin bindje komuniste (Ali Alija, Adem Demaçi etj.).

Udhëheqësitë e këtyre organizatave të mëvonshme, përpos LNÇKVSHJ, mbështetjen dhe përkrahjen nuk e pritnin dhe as nuk e kërkonin nga aleatët tanë të natyrshëm anglo-amerikanët dhe shtetet demokratike të Evropës Perëndimore, por mbështetjen dhe përkrahjen e pritnin nga kampi i llogores socialiste, nga Shqipëria, BRSS-ja dhe Kina. Marks, Engels, Lenini, Stalini dhe Enveri ishte udhëheqja ideore e shumicës dërmuese të veprimtarëve të organizatave ilegale që u krijuan në Kosovë. Mbështetjen për veprimtarinë e tyre e gjenin në shpjegimet teorike të Leninit, që i kishte paraqitur në librin e tij: "Revolucioni socialist dhe e drejta e popujve për vetvendosje". Partia Komuniste Shqiptare-PPSH-ja dhe Radio Tirana luajtën rol antikombëtar duke u bërë altoparlantë të Beogradit (1944-1948), të Moskës (1948-1962) dhe të Pekinit (1962-1976), dhe njëkohësisht shpërdanë egjërën komuniste (ideologjinë komuniste) në gjithë hapsirën tonë kombëtare.

Ushqimi i popullit tonë, veçmas i rinisë, me egjërën komuniste pati dhe ende ka pasoja tejet të rënda për Lëvizjen tonë kombëtare, që lufton për çlirim dhe bashkim kombëtar. Në veçanti dëme dhe pasoja të

rënda ka pësuar Shqiptaria, pasi që shumica dërmuese e "udhëheqjeve" shqiptare ende janë në agoninë e egjërës komuniste.

Nacionalizmi shqiptar ka pësuar goditje të rëndë dhe është shtruar për toke si rrjedhojë e ndjekjes këmba-këmbës të bartësve të tij nga këlyshët e Beogradit, të Moskës dhe të Pekinit, që u bënë "udhëheqje" e Shqipërisë dhe e Kosovës. Egjra (ideologjia) komuniste u bë ushqim shpirtëror i rinisë shqiptare në dy anët e kufirit, në sajë të gënjeshtreve dhe manipulimeve që i bënte PPSH dhe Radio Tirana, duke e çuar në qiell ideologjinë e kamufluar të pansllavizmit rus, marksizëm-leninizmin. Duhet kuptuar se vështirësitë me të cilat po përballohet sot populli ynë në gjithë hapësirën tonë kombëtare, nuk janë pasojë e perçarjeve të sotit, por janë rrjedhojë e mbjelljes së farës ruse në të gjitha trojet tona etnike, dhe të politikës antikombëtare të PKSH-PPSH-së dhe udhëheqjes së saj: Milladin Popoviqit, Enver Hoxhës, Dushan Mugoshës, Lirie Gegës, Mehmet Shehut, Koqi Xoxës, Hysni Kapos, Spiro Kolekës, Ramiz Alisë, Fatos Nanosit etj

Po qe se dëshërojmë të kemi sa më shumë fakte dhe dëshmi për ndriçimin e gjendjes në të cilën ndodhemi, për të nxjerrë mësimë që do të na shërbenin për tejkalimin e vështirësive në të cilat ndodhemi, është e domosdoshme të njihet veprimtaria e organizatave ilegale që u formuan në Kosovë gjatë sundimit serbo-jugosllav. Duhet cekur se e gjithë veprimtaria ilegale që u zhvillua në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare gjatë sundimit serbo-jugosllav nuk u konsolidua si duhet për t'u bërë një organizatë e fortë, që do të drejtonte dhe do të kryente veprimtari të llojllojshme ilegale, gjysmëlegale dhe legale, në vazhdimësi, deri sa të na vijë shteku për t'i prerë prangat e robërisë. Të gjitha organizatat ilegale që janë formuar në Kosovë janë zbuluar nga OZN-a dhe UDB-ja jugosllave menjëherë pas kryerjes së aksioneve të para, dhe- në shumicën e rasteve- është zbuluar pothuajse e gjithë struktura udhëheqëse e organizatave ilegale. Duhet cekur se burgosja dhe dënimi i veprimtarëve të veprimtarisë ilegale, edhe pse ishte një dështim për Lëvizjes tonë për çlirim dhe bashkim kombëtar, luajti rol me rëndësi në ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe të forcimit të shpresës te shtresat e gjera të popullsisë së robëria do të jetë e përkohshme dhe se një ditë prangat e robërisë do të këputen, pasi që "zullumi këputet prej së trashuri", por edhe për faktin se populli shihte se gjenden forca në mesin e tyre që punojnë për reallizimin e synimeve madhore kombëtare.

Duhet pranuar se rrethanat ndërkombëtare, (formimi i Byrosë informative) dhe ato jugosllave, (Plenumi i Brionëve) e ndihmuan Lëvizjen tonë për çlirim dhe bashkim kombëtar në shumë drejtime për të arritur suksese të rëndësishme në ngritjen e vetëdijes kombëtare, si dhe në realizimin e disa të drejtave kombëtare, që përbënin bazën e sukseseve të mëvonshme në të gjitha lëmitë e jetës, (Kushtetuta e 1974, formimi i Universitetit të Prishtinës, etj.)

Lëvizja jonë kombëtare, edhe pse nuk kishte Qendër (kokë) vendimmarrëse, një pjesë e veprimtarëve të saj ishte e vetëdijshme se me vdekjen e Titos, Jugosllavia do të futej në procesin e zhbërjes, si rrjedhojë e luftës së pakompromis që do të zhvillohet në mes shovinizmit serb dhe nacionalizmit kroato-sllloven, prandaj ndërmuarën ç'ishte e mundur që populli ynë të përgatitej për momentin e duhur "kur t'i vijë shteku" për ta hequr nga qafa zgjedhën e robërisë serbo-jugosllave njëherë e përgjithmonë. Kështu në fund të vitit 1976 u krijua "Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi" (LNÇKVSHJ), kryetar i së cilës u zgjodh atdhetari demokrat dhe mësuesi i atdhedashurisë Metush Krasniqi. Faktet dëshmojnë se Sigurimi i Shqipërisë nuk ka qenë i kënaqur me platformën e kësaj organizate, sepse ajo nuk mbështetej në ideologjinë e djallit të mallkuar, marksizëm leninizëm dhe as në veprat e kryedjajve komunistë: Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit dhe as të Enverit, por në ideologët e Rilindjes Kombëtare dhe në platformën politike të Lidhjes së Prizrenit.

CIA NË VITIN 1999 PATI DALË ME TË DHËNA TË DOKUMENTUARA SE NË ORGANET E LARTA SHETETRORE TË SHQIPËRISË PUNOJNË MË TEPËR SE 150 SPIUNË SERBO-JUGOSLLAVË.

Sigurimi i Shqipërisë, qysh me kontaktin e parë që pati me këtë organizatë, tregoi pakënaqësi dhe mllefosje ndaj udhëheqjes së kësaj organizate, pasi që ajo nuk e pat autorizuar përfaqësuesin e saj të dërguar në Tiranë (për t'u takuar me përfaqësues të organeve të shtetit të Shqipërisë), t'ua tregonte emrat e udhëheqësve të organizatës. Ajet Haxhiu kishte këmbëngulur që sëpaku të dinte për njeriun që e kishte dërguar, por nuk kishte pas arritur sukses. Kontaktet e mëvonshme të përfaqësuesve të Organizatës, (Jusuf e Bardhosh Gërvallës, Sabri Novosellës, Ramadan Pllanës, Sheremet Saraçit, Xhafer Durmishit etj,) me përfaqësues të Organeve shtetërore të Shqipërisë në Tiranë, Stamboll

dhe Vjenë e gjetiu treguan se Shqipëria nuk ishte e interesuar për rritjen dhe forcimin e një organizate thjesht kombëtare, siç ishte organizata që e drejtonte Metush Krasniqi, Jusuf Gërvalla dhe bashkëveprimtarët e tyre, por ishte e interesuar për formimin e organizatave komuniste.

Menjëherë pas formimit të LNÇKVSHJ, Sigurimi i Shqipërisë kishte angazhuar njerëz për formimin e organizatave ilegale, marksiste-leniniste në Kosovë. Njëri ndër të parët që më njoftoi se kishte biseduar me Bujar Hoxhën në Paris dhe i kishte propozuar për të formuar Partinë Komuniste-marksiste-leniniste të Kosovës, ishte Ramadan Pllana. Ky veprimtar nuk e pat kryer porosinë e B. Hoxhës, pasi që ishte i bindur se Kosovës i duhet një organizatë thjesht kombëtare, që do t'i bashkonte të gjitha shtresat e popullsisë në luftë kundër robërisë serbo-jugosllave, prandaj edhe iu bashkangjiti Organizatës së Metush Krasniqit dhe Jusuf Gërvallës me një grup shokësh, sepse aty e gjeti vendin e jo në ndonjë organizatë komuniste. Më vonë, me përkrahjen e Sigurimit të fshehtë të Shqipërisë u formuan disa organizata dhe grupe komuniste: Avdullah Prapashtica e pat formuar "Partinë Komuniste Marksiste-Leniniste Shqiptare në Jugosllavi, (PKMLSHJ), Hydajet Hyseni Organizatën marksiste-leniniste të Kosovës (OMLK-në), dikush tjetër e pati formuar "Partinë e Luftës Kundër Revizionizmit", etj.

Shtrohet pyetja pse PPSH dhe Sigurimi i Shqipërisë ishin të interesuar për formimin e organizatave komuniste në kohën kur në Kosovë ishte formuar një organizatë thjesht kombëtare, programi i së cilës do të mund t'i bashkonte të gjitha shtresat e popullsisë në luftë kundër robërisë serbo-jugosllave? Përgjigja është e ditur kur dihet se për Enverin dhe partinë ishte e qartë se çfarë rreziku paraqiste formimi dhe forcimi i një organizate thjesht kombëtare për regjimin dhe pushtetin e tyre, siç ishte LNÇKVSHJ e cila me programin e saj nuk parashihte që zgjidhja e çështjes së Kosovës do të vijë me "ngadhnjimin e revolucionit socialist në botë" dhe të fitores së marksizëm-leninizmit në Jugosllavi mbi "revizionizmin modern" të Titos, siç parashihte dhe besonte Enver Hoxha dhe klika e tij. Përgjegjja do të ishte edhe më e plotë, po që se do t'i cekim disa nga faktet që dëshmojnë se Enveri dhe partia nuk e kishte hallin e Kosovës dhe të shqiptarëve, që- edhe për fajin e tij- kishin mbetur nën robërinë serbo-jugosllave, por e kishin hallin e "ngadhnjimit të socializmit dhe komunizmit në botë", dhe "forcimit të diktaturës së proletariatit dhe luftës së klasave në Shqipëri", që ishin mekanizëm për

ruajtjen e pushtetit të tij me çdo mënyrë. Për Enverin dhe klikën e tij do të ishte tradhti ndaj socializmit dhe komunizmit po qe se përkrahet nacionalizmi shqiptar në Kosovë, kur dihet se ai i përdori të gjitha mjetet (tradhtinë, vrasjen pas shpine, ndihmën e të huajve etj.) për ta luftuar atë në gjithë hapësirën tonë kombëtare. Pra klikës së Tiranës nuk i shkonte përshtat krijimi i organizatave nacionaliste në Kosovë dhe as në botën e jashtme, por i përshtatej krijimi i organizatave komuniste, sepse-nëpërmjet tyre- e kontrollonte Lëvizjen kombëtare për çlirim dhe bashkim kombëtar dhe- sipas nevojës- mund të intervenonte me forma të njohura staliniste që ajo të mos i dalë prej dore në asnjë mënyrë.

Tani nuk është vështirë të kuptohet prapavija e veprimeve të njerëzëve përgjegjës të Shqipërisë kundër LNÇKVSHJ, prandaj ka shumë fakte që dëshmojnë se kundër LNÇKVSHJ dhe platformës së saj politike nuk ishte vetëm Jugosllavia dhe UDB-ja jugosllave por ishte edhe PPSH dhe Sigurimi i Shqipërisë. Njerëzit e pa informuar nuk do të pajtohen me këtë vlerësim, por fatkeqësisht kjo është një e vërtetë e hidhur ndër shumë të vërteta të tjera edhe më të hidhura, për të cilat opinioni ynë ende nuk është plotësisht i njoftuar. Siç dihet komunisto-çetnikët serbo-jugosllavë e krijuan Partinë Komuniste të Shqipërisë me disa shqipfolës më 1941. Që nga ajo ditë kur serbo-jugosllavët krijuan struktura udhëheqëse në Shqipëri, që do të punojnë sipas këshillave dhe diktatit të tyre, popullit tonë iu krijuan rrethanat e brendshme dhe të jashtme për të rënë nën robërinë serbo-jugosllavo-bolshevike.

Edhe pse forcat e djathta shqiptare dhe aleatët tanë anglo-amerikanët, bënë përpjekje për të krijuar rrethana të tjera, që do të dobësonin faktorin serbo-jugosllav dhe ruso-bolshevik, nuk patën sukses. Kolera komuniste dhe robëria serbo-jugosllave e mbuloi hapsirën tonë kombëtare. Kryedajtë e kuq në të dy anët e kufirit shqiptaro-shqiptar u bënë spiunë dhe vasalë të qendrave komuniste: Beogradit, Moskës dhe Pekinit. PKSH-PPSH dhe Radio Tirana u bënë autoparlantë të kryedajave komunistë: Titos, Stalin, Hrushovit dhe Mao Ce Dunit.

Sigurimi i Shqipërisë, që u krijua nga OZN-a jugosllave, kreu urdhërat e spiunëve serbë, rusë dhe kinezë që i krijuan çerdhet (klanet) e tyre në këtë institucion të rëndësishëm shtetëror, që fatkeqësisht edhe sot e gjithë ditën veprojnë kundër interesave shqiptare. (CIA - amerikane më vitin 1999 pat dalë me të dhëna të dokumentuara se në organet e larta shtetërore të Shqipërisë punojnë më tepër se 150 spiunë serbo-

jugosllavë). Se sa spiunë grekë dhe rusë punojnë në Shqipëri nuk dihet, por me siguri numri i tyre nuk është më i vogël se i spiunëve serbë. Po ashtu nuk dihet se sa spiunë të shërbimeve të huaja punojnë në Kosovë dhe Viset tjera shqiptare. Fatkeqësisht edhe pas gjithë këtyre të ligave që e gjetën Shqipërinë, Kosovën dhe Viset tjera shqiptare, një pjesë e madhe e inteligjencës dhe politikanëve tanë, nuk janë në gjendje të kuptojnë se burimi i të gjitha tragjediave që e gjetën popullin tonë, burimi i të gjitha përçarjeve që lindën në mes nesh, janë pasojë e krijimit të Partisë Komuniste Shqiptare në Shqipëri dhe ardhjes në pushtet të komunistëve shqiptarë. Pra, kolera komuniste që e përfshiu kombin tonë, solli në të njëjtën kohë edhe legalizimin e vijës antikombëtare në të gjitha trojet tona etnike dhe krijoi rrethanat dhe kushtet që në të gjitha vendbanimet shqiptare e në institucionet e tij shtetërore dhe kulturore të krijohen çerdhet e sigurimeve të fshehta të çakajve të Ballkanit dhe aleatëve të tyre. Pra, të gjitha këto të liga që na gjetën janë rrjedhojë e veprimtarisë antikombëtare të bajraktarëve të farës ruse, që luanin rolin e pushtetarëve në Shqipëri dhe Kosovë, por në fakt ata ishin spiunë dhe vasalë të serbo-sllavo-grekëve, kuptohet që ka pasur edhe përjashtime. Nuk mund të shpjegohet me një shkrim e gjithë veprimtaria antikombëtare e bajraktarëve të farës ruse, por duhet veçuar se kreu politik dhe shtetëror i Shqipërisë pengoi rritjen dhe forcimin e Lëvizjes tonë për çlirim dhe bashkim kombëtar, mu nga shkak se spiunët e armiqve tanë shekullor patën zënë pozita udhëheqëse në kreun e PKSH-PPSH-në, në Qeverinë dhe Sigurimin shtetëror të Shqipërisë. Enver Hoxha, Koqi Xoxe, Mehmet Shehu, Lirije Gega, Hysni Kapo, Ramiz Alija, Fadil Hoxha, Fatos Nanosi, etj, së bashku me Milladin Popoviqin dhe Dushan Mugoshën e mbollën, e rritën dhe e zhvilluan farën ruse- farën e pansllavizmit rus, që ndryshe quhet stalinizëm-rankoviçizëm në të gjitha trojet tona etnike. Më vonë "dyshi" Tito-Kardeli e mbollën një varietet tjetër të farës ruse në Jugosllavi-Kosovë, që quhej "titizëm" apo "socializmi vetqeverisës". Kjo farë ruse- për dallim nga fara e pansllavizmit rus (stalinizmi-enverizmi-rankoviçizmi), qytetarët e saj nuk i ushqeu vetëm me egjër komuniste, (ideologji bolshevike-leniniste) por edhe me ushqime tradicionale të popujve që e përbënin Jugosllavinë. Pra, edhe Kosova dhe shqiptarët e robëruar arritën ca suksese të rëndësishme në sja të zëvendësimit të rankoviçizmit me titizmin.

Faktet dëshmojnë se prishja e Enver Hoxhës me Titon nuk ka ardhur për çështje të Kosovës, siç mundohen ta paraqesin disa kokëkrisur shqiptarë, por erdhi si pasojë e prishjes së Titos me Stalinin, për çështje dominimi dhe për çështje të interesave të tyre shtetërore e kombëtare. Enver Hoxha për këta dy kryedjaj komunistë nuk paraqiste asgjë tjetër përpos se një piun në tabelën e shahut, lojë e pamëshirshme që luhej në mes dy kryedjajve komunistë. Fatkeqësisht Enver Hoxha nuk mblodhi mend kurrë. Ai mbeti axhami- vasal lojal, herë i njërit, herë i tjetrit kryedjall. Në vend që t'i shfrytëzonte konjunkturën politike që krijoheshin kohëpaskohe në dobi të kombit tonë, ai mbeti nën ndikimin e spiunëve serbo-ruso-grekë. E gjithë veprimtaria e tij politike shkonte në dobi të shovenizmit serb. Vetizolimi i Shqipërisë, mbështetja në "forcat e veta", ndalimi me kushtetutë i marrjes së kredive nga jashtë, "lufta e klasave", "mbrojtja e pastërtisë së marksizëm-leninizmit" etj, bënë që klasa politike shqiptare ta çojnë në vend amanetin e Pashiqit, i cili para se të vdiste iu pat thënë bashkëpunëtorëve të tij: " Pasi që nuk mundëm të pengonim bërjen e Shqipërisë, atëherë duhet të punojmë që ajo të jetë sa më e dobët ekonomikisht, pa forcë ushtarake e pa aleatë dhe autoritet të fuqishëm ndërkombëtarë".

#### VITET 1979-1981 PARAQESIN FILLIMIN E PERIUdhës KUR LËVIZJA JONË KOMBËTARE DO TË BËJË NJË HAP DREJT ÇLIRIMIT KOMBËTAR

Pra, kur në Kosovë u krijua Organizata kombëtare "Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi" Shqipëria e Enver Hoxhës nëpërmjet Radio Tiranës dhe shtypit të saj bënte një fushatë të egër kundër "imperializmit amerikan", "socialimperializmit rus", "revizionizmit modern jugosllav " dhe "revizionizmit kinez". Pra për Enver Hoxhën dhe PPSH-në nuk kishte detyrë parësore mbrojtja e interesave kombëtare, por "mbrojtja e pastërtisë së marksizëm-leninizmit", mbrojtja e "internacionalizmit proletar" dhe mbrojtja e "diktaturës së proletariatit". Këta tradhtarë të kombit çdo ditë betoheshin se rrugën e nisur nuk do ta lëshojnë, po që se detyrohen në vend buke të hanë edhe bar. Pra, Enver Hoxha në vend se në pleqëri të vijë në vete dhe të bëjë përpjekje për ndreqjen e gabimeve të rënda që i pat bërë sa ishte në moshën e re, dhe t'i mëshonte shkëlqim paçavres së pansllavizmit rus- stalinizmit, që edhe vetë rusët i kishin mëshuar shkëlqim, se i kishte futur në një rrugë të pa krye, diktatori i kuq

shqiptar, bënte aventura politike dhe ekonomike, që e çonin në tradhti edhe më të rënda kombëtare. Pra në këto rrethana dhe kushte që e kishte çuar Shqipërinë banda kriminele e Enver Hoxhës ishte e pamundur të kryente detyrën që e kishte ndaj pjesës së kombit që kishte mbetur jashtë kufijve shtetëror të Shqipërisë, me fajin e parisë shqiptare, por më tepër edhe me fajin e tij. Prandaj ishte e pamundur që organet shtetërore të Shqipërisë ta ndihmonin LNÇKVSHJ-në, kur- qysh në kontaktin e parë që e patën me Përfaqësuesin e saj-, kuptuan se nuk ishte organizatë komuniste-leniniste, por ishte një organizatë thjesht kombëtare, që kishte synime çlirimtare, por jo edhe ideologjike, siç dëshironin ata.

Vitet 1979-1981 paraqesin fillimin e periudhës kur Lëvizja jonë kombëtare për çlirim do të bëjë një kërcim cilësor përpara. Veprimtaria ilegale dhe legale do ta plotësonin njëra tjetrën. Vizita e Titos në Prishtinë u parapri me parulla antititiste dhe antijugosllave në gjithë Kosovën. UDB-ja jugosllave arriti t'i zbulonte disa celula të organizatave që vepronin atëherë në Kosovë, në mesin e të cilave u zbuluan edhe dy-tri bërthama të Komiteteve Qarkore dhe vendore të LNÇKVSHJ, që për pasojë pati largimin e dy anëtarëve të udhëheqjes qendrore të organizatës, Jusuf Gërvallës për në Slloveni- Gjermani dhe të Sabri Novosellës për në Shqipëri-Turqi. Edhe dy anëtarë të udhëheqjes qëndrore u burgosën, ndërsa në Kosovë edhe më tutje mbeti të vepronte shumica e udhëheqjes qendrore (Komiteti Qëndror) dhe Komitetet Qarkore e Komitetet e vendit, që drejtoheshin nga kryetari i saj Metush Krasniqi. Burgosjet e fundvitit 1979 dhe fillimit të vitit 1980, patën jehonë të madhe në Kosovë si çdo burgosje tjetër e mëparshme. Njerëzit e thjeshtë që i kishte lodhur robëria serbo-jugosllave, duke u nisur nga dëshira e madhe që veprimtarinë ilegale ta shihnin sa më të fuqishme, çdo burgosjeje që bëhej, nuk e merrnin si dështim, por e merrnin si fitore, se "rrushi sheh rrushin dhe piqet". Në veçanti pati bujë arratisja e Jusuf Gërvallës i cili kishte bërë emër në jetën kulturore dhe publike në gjithë hapsitën tonë kombëtare. Ai u bë legjendë e gjallë për gjindëshmërinë, guximin dhe aftësinë që tregoi për t'i ikur burgosjes së sigurtë në momentin e fundit, kur veç ishin bërë përgatitjet e fundit për burgosjen e tij nga udbashët e çartur jugosllavë.

Ardhja e Jusuf Gërvallës në Gjermani bëri bujë edhe në diasporën shqiptare. Ishte hera e parë që një intelektual i mirëfilltë, një intelektual dhe atdhetar që kishte bërë emër me veprimtarinë e tij artistike, të merret



haptas edhe me veprimtari patriotike. Ardhja e tij në Gjermani i gëzoi shumë atdhetarë që donin të punonin, por nuk dinin se si të vepronin, apo dinin çka duhet të punonin, por nuk kishin aftësi t'i kryenin punët që duhej t'i kryenin. Jusufi posa erdhi në Gjermani, në sajë edhe të vëllait e bashkëveprimtarit të tij Bardhoshit, i cili kishte fituar një përvojë të vlefshme pune dhe bashkëpunimi me njerëz të gjeneratave dhe shtresave të ndryshme, kuptoi se çka ishte parësore, çka dytësore dhe çka ishte e pa rëndësishme fare në veprimtarinë që duhej të kryhet. Veprimtaria e tij e gjërë kombëtare, publike, politike dhe organizative bënë ndryshime të mëdha sasiore dhe cilësore në rritjen dhe zgjerimin e veprimtarisë patriotike në Gjermani, Zvicër e shtete tjera të Evropës Perëndimore. Puna e tij ndikoi shumë edhe në aktualizimin e çështjes së Kosovës në mjetet e opinionit publik në Gjermani dhe atë ndërkombëtar. Ai ishte intelektual i parë i mirëfilltë i Kosovës i cili e filloi luftën kundër Jugosllavisë haptas pa u maskuar me maska dhe pa iu trembur syri se po e rrezikonte jetën e tij dhe familjen e tij nga shërbimi sekret jugosllav, që edhe në Evropën Perëndimore vepronte nëpërmjet emigracionit ekonomik shqiptar dhe emigracionit politik serb.

Jusuf Gërvalla duke parë se emigracioni (politik dhe ekonomik)shqiptar në Evropën Perëndimore mund të bëhej një krah i fortë i çështjes madhore kombëtare, nëse punohet me mend dhe me mençuri, filloi të punojë me përkushtim, që këtë kapital shqiptar ta vejë në shërbim të shqiptarisë. Shtëpia e tij u bë shkollë për atdhedashuri. Vinin dhe shkonin njerëz palë palë për të mësuar se si do t'i dilet në shtëpi me Jugosllavinë. Bënin pyetje të llojllojshme, shpeshherë edhe asosh që tregonin se niveli i vetëdijes kombëtare ishte tepër i ultë. Por, Jusufi kishte durim që bashkëbiseduesin ta dëgjonte deri në fund, dhe pastaj dalëngadalë i jepte përgjigje të duhur, pa e nënçmuar apo pa e qortuar atë që nuk i dinte edhe gjërat e thjeshta. Vëllai i tij Bardhoshi dhe bashkëshortja e tij Syzana u bënë bashkëpuntorët e tij më të ngushtë. Syzana përpos punëve të shtëpisë dhe përkujdesjes ndaj fëmijëve, e ndihmoi Jusufin në përgatitjen teknike të revistave dhe gazetave që ai i bënte gati për botim.

Bardhoshi ishte një intelektual i zgjuar. Ishte një poliglot i rrallë. I fliste dhe i shkruante shtatë gjuhë të huaja: gjermanishten, frengjishten, anglishten, serbokroatishten, sllovenishten, italishten dhe turqishten. Qysh nga dita e parë që ka shkruar në Gjermani ka kryer profesionin e

Punëtorit social. Një profesion që i mundësonte të kishte kontakte me njerëz të shtresave, moshave dhe profesioneve të ndryshme, por edhe të krijonte miqësi të sinqertë jo vetëm në mesin e bashkëkombësve të tij, por edhe në mesin e shtetasve gjermanë dhe të komuniteteve të ndryshme, që punonin dhe jetonin në Gjermani. Ai kryente punë për të cilat duhej t'i vende në veprim të gjitha aftësië e tij në shërbim të zgjedhjes së problemeve që iu dëlnin bashkëkombësve të tij në jetën e përditshme. Pra, Bardhoshi me aftësitë intelektuale dhe organizative, përvojën dhe miqtë që i kishte fituar në mërgim, u bë dora e djathtë e vëllait të tij Jusufit, pa të cilin Jusufi nuk do të kishte mundësi të kryente gjithë ato punë që shkonin në dobi të çështjes madhore kombëtare. Pra, Jusufi me punën e tij, të vëllait, bashkëshortes dhe të bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë, i vuri themelet e veprimtarisë së mirëfilltë kombëtare jashta atdheut. Ai krijoi bazën për nxjerrjen e gazetave dhe revistave duke krijuar mjete teknike për shtypjen e tyre. Shkroi tekste ku demaskohej politika antishqiptare e regjimit të Beogradit dhe të kukullave të tyre që i kishin vu në Kosovë. Ua la në disponim një numër të madh shkrimesh Ibrahim Kelmendit dhe Kadri Zekës, për t'i zgjedhur vetë ato që iu pëlqenin për organet e organizatave të tyre. (I. Kelmendi ishte themeluesi i "Frontit të Kuq Popullor", ndërsa Kadri Zekës ishte përfaqësues i Organizatës Marksiste Leniniste të Kosovës (OMLK-së) në Zvicër. Jusufi e ndihmoi I. Kelmendin për nxjerrjen e organit të organizatës së tij "Bashkimi". Në periudhën kohore shkurt 1980- janar 1981 ndihmoi në xjerrjen e numrave 2, 3 dhe 4. Edhe Kadri Zekën e ndihmoi në nxjerrjen e organit të OMLK-së "Liria". Për këtë më së miri na flet bashkëveprimtari i Jusufit, Xhafer Durmishi i cili sëbashku me Jusufin dhe Bardhoshin ishin anëtarë të KQ të LNÇKVSHJ, (Jusufi bënte pjesë në udhëheqjen e ngushtë të organizatës). Xhafer Durmishi në një shkrim të pabotuar jep të dhëna të shumta për veprimtarinë e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, Kadri Zekës dhe veprimtarëve tjerë.

## **JUSUFI NUK ISHTE NGA ATA QË VETËM JEPTE URDHRA DHE KËRKONTE LLOGARI PËR KRYERJEN E TYRE**

Për bashkëpunimin e Jusuf Gërvallës me Kadri Zekën, Xhafer Durmishi thotë: "Ai, (fjalën e ka për Jusufin, vërejtja ime) Kadri Zekës i ofroi ndihmë ashtu siç i kishte ndihmuar më parë Ibrahim Kelmendit. I la në disponim disa artikuj Kadri Zekës që të zgjedhë për numrin e tretë të Lirisë, që doli në mars 81, nën mbikqyrjen teknike të Jusuf Gërvallës, i

cili e radhiti dhe bëri të gjithë punën grafike për nxerrjen e numrit të tretë. Jusufi përgatiti teknikisht numrin 4-5 të Lirisë që doli në korrik dhe kontriboi me artikuj". Veprimtaria e tij ishte e gjerë. Kontaktet e tij me bashkombës bënë që shumë individë të kyçen në veprimtarinë ilegale, që zhvillohej në botën e jashtme. Faridin Tafallari, njëri ndër anëtarët e parë të LNÇKVSHJ që dha betimin para Jusuf Gërvallës në Gjermani dhe pastaj, me aktivitetin që kreu, u bë njëri ndër bashkëveprimtarët e ngushtë të Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, në librin e tij "Terror, Dhimbje, Qëndresë" jep shumë të dhëna që kanë të bëjnë me veprimtarinë patriotike dhe veprimtari ilegale të Jusuf Gërvallës, Bardhosh Gërvallës, Kadri Zekës, Sabri Novosellës, Ibrahim Kelmendit, Xhafer Durmishit, Xhafer Shatrit, Hasan Malës, Faredin Tafallarit, Emrush dhe Mustafë Xhemajli, Saime Zeka- Isufi dhe aktivistëve të shumtë të LPK-së, kontributi i të cilëve një ditë do të vihet në peshojën e historianit (shkencëtarit) të paanshëm dhe do të dihet saktësisht se kush nga ata çoi ujë në mullinin e shqiptarisë e kush në mullinin e armiqve tanë shekullorë.

Jusufi dhe Bardhoshi shumicën e kohës së lirë ua kushtuan kontakteve me bashkëkombës. Bisedat e tyre me ta ndikuan në rritjen e veprimtarëve që do të merren me çështje kombëtare. Zotëri Tafallari tregon kontaktin e parë që e kishte pasur me Jusufin dhe Bardhoshin. "Sokoli (pseudonimi i Jusufit) më pyeti për shumë gjëra dhe nuk ma ndante shikimin. Fliste si një intelektual dhe poet atdhedashës. Po ashtu edhe Bardhi. Jusufi më foli se si duhet të jetë një patriot shembull në gjithçka për të tjerët. Veç dashurisë për atdheun, (thoshte Jusufi) nevojitet vendosmëria, guximi, gatishmëria për sakrificë, etj.". Tafallari tregon se më vonë, kur ai u bë anëtar i organizatës së Jusuf Gërvallës- LNÇKVSHJ, e ka shoqëruar në shumë takime, që pati me punëtorë shqiptarë të cilët jetonin dhe punonin në Gjermani. Ai thotë: "Së bashku me Jusufin shkonim dhe takonim punëtorë kosovarë. Kudo që ishte i pranishëm Jusufi lente përshtypje të mirë te punëtorët. Ishte i mençur, i ditur dhe i thjeshtë. Nuk përtonte të udhëtonte edhe me qindra kilometra vetëm e vetëm për të sqaruar punëtorët kosovarë dhe për t'i përgatitur ata për të ardhmen".

Por Jusufi nuk ishte prej atyre që vetëm jepte urdhëra dhe kërkonte llogari për kryerjen e tyre. Ai raportet ndërnjerëzore i kuptonte të barabarta dhe të ndërsjellta. Njerëzit me të ishin të lirë t'i shprehnin

mendimet e tyre, sepse Jusufi i dëgjonte dhe i respektonte pa marrë parasysh se a pajtohej me botëkuptimet e tyre apo jo. Siç tregon Tafallari, në një takim tjetër që kishte pasur me Jusufin, kishte kërkuar nga ai ta shkruajë një dramë. Tafallari shpresonte se me shokët e tij do të arrijnë ta përgatisin për ta shfaqur me rastin e festimit të 28 Nëntorit- Ditës së Flamurit (1980)). Jusufi ishte një intelektual zemërbardhë. Ai i gëzohej suksesit të çdo shqiptari që arrinte suksese në jetën e përditshme, në familje dhe në shoqëri. Veçmas e gëzonte suksesi i veprimtarëve të lamive të ndryshme kur vinin një gur të çmueshëm në kalanë e shqiptarisë. Jusufi, brenda një kohe të shkurtër, e shkruan një dramë dhe ia jep z.Tafallarit. Tafallari me një grup shokësh e përgatitën dramën, por shfaqja nuk u dha, për shkak se dy persona që kishin role me rëndësi në atë dramë nuk erdhën ditën që duhej të shfaqej drama dhe kështu e gjithë puna e Tafallarit me shokë ra në ujë. Megjithatë kremtimii festës u bë. Përgatitjet e tjera nuk dështuan. Bardhoshi kishte pas siguruar një aparat projektimi filmash. Ai e shfaqti filmin shqiptar "Gumat mbi tela", ndërsa Jusufi iu kishte folur të pranishmëve për jetën dhe veprën e lavdishme të Skënderbeut dhe për krijimin e perspektivës për realizimin e synimet tona kombëtare. Pati recitime dhe në fund edhe pyetje nga të pranishmit. Jusufi me ëndje i sqaronte bashkombasit për paqartësitë e tyre në lidhje me çështje të ndryshme të aktiviteteve patriotike dhe gjendjes aktuale në Kosovë. Kontaktet që i pati me bashkëkombas e bindën Jusufin se është e nevojshme nxerrja e një reviste me anën e sëcilës do të ndihmonte bashkëkombësit për ta kuptuar sa më mirë gjendjen në të cilën ndodhej kombi ynë dhe për të propaganduar domosdonë e organizimit për ngjarje të bujshme që i parashihte se do të ndodhin pas vdekjes së Titos. Për këtë qëllim nxori revistën "Lajmëtar i lirisë" (numri i parë doli në gusht të 1980, numri dy në tetor dhe numri tre në janar të 1981). Një titull simbolik, me një përmbajtje që do të forconte shpirtin lirishtas dhe luftarak të bashkëkombësve të tij; një revistë që do të pranohet aq mirë, jo vetëm në diasporën shqiptare, por edhe në Kosovë e gjetiu ku arriti të shpërndahej dorë pas dore. Jusufi pra, ua solli bashkëkombësve të tij "Lajmëtarin e lirisë"- një revistë kombëtare, një revistë, që me aq përkushtim mbrojti shqiptarinë dhe të të drejtat e shqiptarëve të përkëmbur nga robëria e dyfishtë jugosllavo-bolshevike, një revistë që do të bëhet e kërkuar dhe e dashur për të vjetrin dhe për të riun, një revistë familjare. Dhe më të vërtetë Jusuf Gërvalla me revistën e tij u bë

Lajmëtari i Lirisë, jo vetëm për gurbetçarët, që jetonin jashtë atdheut, larg familjes, por edhe për shqiptarët që ëndrronin, e donin, e gjakonin dhe punonin pa kursim për Lirinë e shqiptarëve. Jusuf Gërvalla i nxori vetëm tre numra të Lajmëtarit të lirisë, në periudhën kohore gusht 1980- janar 1981. Me siguri botimi i revistës nuk do të ndërpritej po të mos e kishte botuar OLMK-ja revistën "Liria". Jusufi mbronte qëndrimin e tij personal dhe të organizatës së tij (LNÇKVSHJ-së) se të gjitha organizatat ilegale duhet të bashkohen në një organizatë të vetme, me një udhëheqje të vetme, me një statut, me një program dhe me një organ të vetëm. Prandaj me botimin e dy numrave të parë të organit të OLMK-së "Liria", Jusufi e ndërpreu revistën e tij. Ndërprerja e "Lajmëtarit të lirisë" u bë për shkakun se filluan bisedimet për bashkimin e organizatave, prandaj Jusufi donte që të japë shembullin konkret se bashkimi nuk vjen vetvetiu, por për të duhet të gjithë të kontribojnë me punë konkrete. Ai duke "matur me kandin e vet" mendonte se bashkimi i organizatave në një organizatë të vetme do të bëhet shumë shpejtë, por ashtu nuk doli. Edhe pse Jusufit iu patën lënë duart e lira për të vendosur kur do ta nxirrte organin e LNÇKVSHJ-së "Zëri i Kosovës" ai e zhagiti daljen e tij duke shpresuar se do të kontribonte në përshejtimin e bashkimit të organizatave në një organizatë të vetme. Vetëm kur dështuan bisedimet për bashkimin e LNÇKVSHJ dhe OMLK-së, që u mbajtën në Stamboll në tetorin e vitit 1981 në mes Kadri Zekës, që e përfaqësonte OMLK-në, dhe Sabri Novosellës e Bardhosh Gërvallës, që e përfaqësonin LNÇKVSHJ-në, Jusuf Gërvalla e nxori organin e LNÇKVSHJ-së, "Zëri i Kosovës" në nëntor të 1981, ndërsa numri dy del nga shtypi në janar të 1982. Edhe Kadri Zeka me veprimtarinë e tij ilegale në Zvicër, me bisedat që i pati me punëtorë dhe me botimin e revistës "Liria" krijoi një rreth aktivistësh që kryen një punë të mirë në organizimin e demonstratave gjatë vitit 1981 në Zvicër.

Shovinizmi serb ishte përgatitur të bënte ndryshimin e Kushtetutës së vitit 1974 qysh më heret, kur udhëheqja politike e Serbisë kishte dalë me të ashtuquajturin "Libri i gjelbërt", ku paraqitnin pakënaqësitë e tyre me ndryshimet kushtetutare që u bënë pas fitores së klanit të Titos mbi klanin e Rankoviqit. Demonstrata e studentëve të 11 marsit për përmirësimin e kushteve të studentëve, krijuan kushtet për organizimin e demonstratave të mëdha të 1 dhe 2 prillit të po atij viti, kur policia jugosllave vrau, plagosi dhe burgosi qytetarë të Kosovës.

Shqiptarët hynë në një luftë të pabarabartë me Jugosllavinë, që më tepër i shkonte në interes Serbisë sesa shqiptarëve që ishin nën thundren e okupatorëve serbo-jugosllavë. Klasa politike shqiptare e Kosovës në atë periudhë kohore, si edhe më herët, më tepër i mbronte interesat serbe sesa interesat shqiptare, ndërsa një pjesë e inteligjencës së lartë shqiptare, kreu punën e robit kur i përkrahnin haptas masat serbe për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës. Studentët dhe rinia shkollore ishte ajo shtresë e popullsisë që luajti rol me rëndësi duke mbajtur të ndezur zjarrin e rezistencës kombëtare kundër robërisë serbo-jugosllave.

Organizatrat ilegale që vepronin në Kosovë në situatën e krijuar nuk patën mundësi t'i bashkërendisin aksionet dhe veprimet e ndryshme ilegale dhe legale, për shkak se nuk patën arritur të bëjnë bashkimin e tyre në një organizatë të vetme me një qendër komanduese të vetme. Masat e dhunës dhe të terrorit që i ndërmuar Jugosllavia në Kosovë, ngjallën shpirtin luftarak tek veprimtarët, intelektualët dhe puntorët shqiptarë që jetonin dhe punonin në Evropën Perendimore për t'u solidarizuar me kërkesat e studentëve shqiptarë të Universitetit të Prishtinës, duke organizuar demonstrata në qendrat politike kryesore të Gjermanisë, Zvicrës dhe të Belgjikës. Këto demonstrata i organizuan Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla, Kadri Zeka dhe bashkëveprimtarët e tyre. Demonstrata u mbajtën në Munih, Shtutgard, Bon, Dyseldorf, Bern, Zurih, Gjenevë dhe Bruksel. Rëndësia e këtyre demonstratave ishte se nëpërmjet tyre njoftohej opinioni i gjerë i Evropës Perëndimore me padrejtësitë që i bëheshin popullit Shqiptar në Jugosllavi; njëjhej me dhunën serbe në Kosovë dhe me kërkesat e studentëve dhe të popullsisë shqiptare në Kosovë. Gjatë mbajtjes së demonstratave shpërndaheshin pamflete në gjuhën gjermane, franceze etj, me anën e të cilave jepeshin të dhëna të sakta për shkeljen e të drejtave njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve të Kosovës dhe të Viseve tjera shqiptare në Jugosllavi. Këto demonstrata patën një rëndësi të madhe edhe në ngritjen e vetëdijes kombëtare tek puntorët shqiptarë, që punonin në Evropën Perendimore dhe gjetiu jashtë atdheut. Patën bërë jehonë të madhe në Kosovë, Jugosllavi dhe shtete tjera të Evropës dhe të Amerikës. UDB-ja jugosllave, që i kishte çerdhet e saj kudo nëpër Evropë, bëri përpjekje të mëdha për t'i penguar punëtorët shqiptarë, që të mos marrin pjesë në demonstrata, në radhë të parë, duke i frikësuar ata për pasojat që do t'i kenë kur të kthehen në vendlindje (marrja e pasaportës, burgosjet etj).

Faredin Tafallari në librin e tij "Terror, dhembje, qëndresë", në mes tjerash, na tregon edhe për luftën e ashpër që bëhej në mes veprimtarëve shqiptarë, që i prinin masës nëpër demonstrata për t'i hudhur në ujë planet e spiunëve serbojugosllavë që punëtorët shqiptarë të mos marrin pjesë në demonstrata.

"POSA I PAMË SPIUNËT JUGOSLLAVË QË FOTOGRAFONIN DEMONSTRUESIT, DISA PREJ NESH NË KRYE ME BARDHOSHIN, IU SULËM, UA RRËMBYEM APARATET DHE I SHKELMUAM"

Tafallari thotë: "Në një demonstratë që u organizua në Shtutgard në prill 1981 nga Jusufi, njerëzit e UDB-ës dhe të konsullatës Jugosllave në Shtutgard kishin përgatitur njerëzit e tyre që të filmonin e të fotografonin pjesëmarrësit në demonstratë që- pastaj- t'i merrnin në pyetje kur të ktheheshin në Kosovë". Kështu ata donin t'i frikësonin bashkatdhetarët tanë në mërgim që të mos merrnin pjesë në demonstratë. "Në një shtëpi të përfaqësisë Jugosllave ishin grumbulluar 7-8 vetë me lloj-lloj aparatesh. Porsa i pamë, disa prej nesh me në krye Bardhoshin, iu sulëm shkallëve përpjetë dhe u futëm brenda. Ua rrëmbyem aparatet; aty ishte edhe një i quajtur Bashkim Hisari, shqiptar që në atë kohë punonte në konsullatë. Ky u mundua që të na sulmonte, por nuk ia arriti dot sepse Bardhi dhe të tjerë prej nesh, shkellmuam Bashkimin. Edhe ca të tjerë nga ata me aparate hangrën disa grushta si dhuratë për "punën" policore, kurse aparatet i thyem".

Duhet cekur se kërkesa kryesore që dëgjohet gjatë mbajtjes së demonstratave nëpër Kosovë dhe gjetiu jashtë Kosovës ishte "Kosova republikë", që binte në kundërshtim me kërkesën e LNÇKVSHJ, e cila luftonte për çlirimin e Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me shtetin amë- Shqipërinë. Njerëzit kishin paqartësi të shumta dhe nuk kuptonin se cila kërkesë është më reale dhe më e drejtë. Këto paqartësi dhe keqkuptime tejkaloheshin në tubimet që mbaheshin pas përfundimit të demonstratave apo gjatë tubimeve festive, kur bashkëkombësit tuboheshin në ndonjë sallë që rezorvohej qysh më parë. Zotëri Tafallari në librin e tij i jep të plota përgjigjet e Jusuf Gërvallës dhe të Kadri Zekës (që vetë i ka incizuar) ndaj pyetjeve që bashkëkombësit i shtruan në tubimin festiv të mbajtur më 28 nëntor 1981 për të festuar Ditën e Flamurit. Tafallari tregon se "Jusufi kishte gjetur një sallë të madhe dhe të bukur afër Ludwigsburgut për të festuar 28

Nëntorin. Për këtë kishte përgatitur edhe fletë-thirrjet. Ne ato i kemi shpërndarë te shumë bashkatdhetarë, në Gjermani por edhe në Zvicër. Pat ardhur edhe Kadri Zeka me të fejuarën e tij, Saime Jusufi (Bulja) dhe me shokë të tjerë. Kadriu ishte shumë i dashur dhe i afërt me shokët. Në Zvicër ai e kishte zhvilluar ndërgjegjen kombëtare të punëtorëve shqiptarë dhe i kishte aktivizuar ata për çështjen e Kosovës". Do t'i citoj disa pjesë nga përgjigjet e Jusuf Gërvallës dhe të Kadri Zekës, që i kam nxerr nga libri i lartpërmendur i z. Tafallarit.

Nga përgjigjet e Jusuf Gërvallës mësojmë për qëndrimin e tij ndaj kërkesës "Kosova republikë". Ai thotë: " Populli ka bërë një hap të drejtë, një hap të ligjshëm; ai ka bërë një hap që tani i lejon të kthehet dhe të presë përgjigjen përfundimtare të Qeverisë shoviniste të Beogradit. Populli pa dyshim është ai që di më së miri se deri kur duhet të presë që të realizohet kërkesa Kosova republikë. Populli është i pagabueshëm; unë, ti, ai tjetri mund të gabojmë të gjithë me radhë, për arsye se jemi njerëz, jemi individë. Populli, i cili po tregohet kaq i durueshëm për realizimin e kërkesës, pa kurrfarë dyshimi do të dijë se deri ku shtrihen kufijtë e durimit për fitimin e statusit të republikës, "Kosova republikë". (Duartrokitjet për një kohë e ndërprejnë bisedën e Jusufit) Prandaj ne si bij të popullit që jemi, kurrsesi nuk duhet ta vemë në gjumë mendjen tonë. Të jemi syçel, ta matim pulsën e popullit dhe të presim prej tij ato rrugë që na i cakton ai dhe të jemi gjithmonë të gatshëm që t'iu përgjigjemi. Nuk ka kurrfarë dyshimi se kur të tregohet jo-objektive pritja e mëtejshme për Kosovën republikë, populli do ta dijë vetë ta hedhë poshtë një kërkesë të tillë dhe të dalë me kërkesa tjera, me një fjalë me qëllimin e tij të fundit që është, ka qenë dhe do të jetë bashkimi i gjithë shqiptarëve, bashkimi i ligjshëm, bashkimi i ligjshëm i gjithë shqiptarëve me shtetin e tyre kombëtar". Përgjigja tjetër ka të bëjë me çështjen se çfarë të mire iu sjell shqiptarëve realizimi i kërkesës "Kosova republikë": "Në qoftë se më lejoni do të kthehesha shkurtimisht, përse i përket asaj pyetjeje që shtroi një shok pak më parë, d.m.th. se çka do t'i sjellë, çfarë të mirash do të kemi ne shqiptarët nga statusi i republikës. Ne duhet ta analizojmë e ta shtrydhim mendjen, të mendojmë ditë e natë për këtë, se një njeri i mençur thotë se "mendimi është e vetma parajsë nga e cila nuk mund të na përzënë". Një pikëmbështetje nga e cila mund të nisemi kur të analizojmë se çfarë të mirash do të sjellë statusi i republikës, është konkretisht vetë armiku ynë. Po të ishte një kërkesë boshe, një kërkesë në



ajër, një kërkesë mendjelehtë, një kërkesë që e kanë bërë aventurierët, një kërkesë që e kanë bërë ata që ëndrojnë pa baza, pa kurrfarë dyshimi se Beogradi qysh me 11 mars të këtij viti do të dilte me dokumentin për statusin e republikës së Kosovës. Dhe do të na thoshte: shqiptarë, urdhëroni, ja ku e keni republikën. Por a është kështu, ne po e shohim prej afër 9 muajsh. Të gjitha forcat, gjithë plehun, gjithë vlerin shovenist të shtatëdhjetë e kusur vjetëve, apo edhe të qindra vjetëve të mëparshëm, Beogradi tash e ka akumuluar, e ka grumbulluar për ta shtypur kërkesën Kosova republikë. Po të ishte kjo kërkesë me rëndësi të vogël, ose pa rëndësi, pa dyshim që Beogradi do të shfrytëzonte rastin dhe do të na bënte qejfin. Por kjo është një kërkesë shumë vitale për popullin shqiptar dhe prandaj qeveria e Beogradit, si qeveri e tërbuar në kulm, na e mohon me kaq këmbëngulje. A do të mund të na mohojë, apo jo, këtë do ta tregojë e nesërmja. Shenja se si do të përfundojë kjo punë, kemi qysh sot... Ç'do të thotë kjo? Vetë kërkesa që Kosovës t'i njihet statusi i republikës, është një kërkesë e cila flet qartë se në këtë moment populli shqiptar në Jugosllavi ka përqafuar idenë e luftës për një autonomi të vërtetë të shqiptarëve në Jugosllavi. Po a është e drejtë kjo? Le të kthehemi mbrapa në histori, në kohën e Lidhjes së Prizrenit, pastaj në kohën e kryengritjeve të mëdha të Kosovës më 1909-1912. Asokohe kushtet objektive nuk lejonin që populli ynë të dilte menjëherë me kërkesën e një pavarësie të plotë të Shqipërisë. Por populli në atë kohë u detyrua që të dalë me kërkesën për një autonomi. Sado që historia nuk përsëritet, por një rrugë e tillë na imponohet sot ne shqiptarëve në Jugosllavi dhe gjithë kombit tonë, kur është fjala për realizimin e të drejtave tona, qoftë në kuadër të kufijve të Jugosllavisë, qoftë për bashkimin e plotë të mbarë shqiptarëve që jetojnë në tokat e tyre, gjë që nesër do të realizohet patjetër".

Ja edhe disa fragmente të përgjigjeve të Kadri Zekës : "Ndoshta po zgjatem pak, por u shtrua një pyetje nga një shok. Erdhi puna deri atje sa t'i vihet një qyteti me tradita të lashta patriotike, emri i kryeudbashit Tito. Kam dëgjuar se këtu punëtorët tanë në Gjermoni kanë vendosur që kush e përmend emrin e Titos, dënohet me 5 marka gjermane. Prandaj unë s'do ta përmend shpesh që të mos dënohem aq shumë. Në kuadrin e masave që kanë marrë, si në shkollat, dhe në çdo fushë tjetër, tani kanë arritur ta pengojnë edhe radio-televizionin shqiptar, ta pengojnë me qëllim që në Kosovë të shqiptarët mos të mund të depërtojnë asnjë

ideologji tjetër, por vetëm ajo që na servisnin dhe na imponojnë shovinistët jugosllavë. Në kuadrin e këtyre masave, për të zhdukur çdo gjë shqiptare, çdo ndjenjë liridashëse tek shqiptarët, ata vendosën t'i vënë edhe një qyteti kosovar emrin e tij (të Titos)"!. "Po bëhën shumë pyetje: Ç'bënë Shqipëria? Duhet të jemi të sigurt se ka njerëz që shohin më larg se ne. Një çështje që ne në fillim na duket jo e drejtë, është menduar është studjuar dhe është përtej bregut. Kështu që neve na takon t'i kryejmë detyrat tona; që shqiptarët të mos i lëshojnë vatrat e t'i themi serbit: jemi në tokën tonë. T'i themi serbit: në se don të rrih si njeri, rri. Në qoftë se nuk do, atëherë shko kah të duash. Ky është qëndrimi ynë. Padrejtësive t'u bëjmë ballë. T'i fitojmë të drejtat tona me luftë. Përsa u përket të tjerëve që kanë obligime ndaj nesh, si komunistët e botës dhe proletariati ndërkombëtar, qoftë dhe vëllazërit tanë në Shqipëri, ata do t'i kryejnë detyrat e veta. Rroftë populli ynë heroik".

Edhe Viti i Ri 1982 tregon Tafallari, u festua nga bashkëkombasit e shumë që jetonin dhe punonin në Shtutgart me rethinë. Tafallari i përmend se në mesin e shumë aktivistëve ishin edhe Shaban Klaiqi, Islam Rafuna, Mejdi Rexhaj, Shaban Bobaj, Selim Koca, Nuhi Sylejmani etj. Ai thotë: "Punëtorët tanë na e kishin siguruar një sallë dhe u mblodhëm për të festuar Vitin e Ri. Jusufi dhe Bardhoshi i binin çiftelisë dhe sharkisë; Jusufi edhe këndonte. Kurse baca Jahir na bënte shumë për të qeshur me humorin e tij të këndshëm. Në këtë ndërtesë kishte edhe njerëz me origjinë sllave;(banonin) një nga këta hyri tek ne pa marrë leje dhe na foli në gjuhën sllave. Jusufi tha: "Ju lutem mos lejoni sontë të dëgjojmë gjuhë sllave". Dhe ashtu u veprua. Mbrëmja kaloi në një atmosferë kënaqësie. Aty nga mbarimi i mbrëmjes së Vitit të Ri, Jusufi na afroi dhe na tha: "Ju e dini se Kadri Zeka na ka ftuar në dasmën e vet dhe ne duhet të shkojmë. Por ne në dasmë nuk kemi pse të përziejmë mosmarrëveshjet tona organizative. Ne do të shkojmë si miq".

Tafallari na jep edhe të dhëna tjera se si janë organizuar për të shkuar në dasëm, si kanë kaluar dhe si ka përfunduar dasma. Ai thotë: "U vendos të shkojmë me makina. Bardhoshi në makinën e vet mori të shoqen e Jusufit dhe shoqen time; ne të tjerët, Jusufi, Nuhi Sylejmani, dhe disa të tjerë udhëtuam me një autobus. Kadriu na priti mirë. Dasma u bë në një shtëpi malore. Dasma si dasëm me këngë e valle, por bëhej në një vend të largët dhe të huaj, vetëm pjesëmarrja e bashkatdhetarëve e bënte atë thjesht shqiptare. Në mëngjes u kthyem; nuk donim t'ia ndalnim

këngës në minibusin që po na binte sërish në qytet. Jusufi ishte më i lodhur se ne sepse ai punonte edhe për nxerijen e gazetës "Zëri i Kosovës". Atë e mundonte edhe mosmarrëveshja me organizatën tjetër ku kishte edhe anëtarë që nuk pranonin ta merrnin dhe ta shpërndanin Zërin e Kosovës".

JUSUF GËRVALLA ISHTE I BINDUR SE VETËM NË BAZË TË BASHKËPUNIMIT VËLLAZËROR NË MES PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE ILEGALE DO TË KRIJOHESHIN KUSHTET PËR BASHKIMIN E TË GJITHA ORGANIZATAVE NË NJË ORGANIZATË TË VETME

Kryetari i LNÇKVSHJ Metush Krasniqi, që vepronte në Kosovë, duke ditur se në Kosovë vepronin edhe organizata tjera ilegale, bëri përpjekje për bashkimin e tyre në një organizatë të vetme. Bisedat që u zhvilluan gjatë vitit 1980/ 81 në mes tij dhe Hydajet Hysenit që i përfaqësonin dy organizata ilegale, LNÇKVSHJ dhe OLMK-në, nuk arritën sukses, për shkakun e vetëm se Hydajet Hyseni dhe Metush Krasniqi kishin qëndrime të kundërta në lidhje me çështjen e bashkimit të organizatave. Metush Krasniqi mbronte qëndrimin se bashkimi i organizatave në një organizatë të vetme nënkupton krijimin e një fronti të përbashkët veprimi, me një udhëheqje, me një program, me një statut dhe me një organ të vetëm, me qëllim të krijimit të kushteve për të qenë të përgatitur sa më mirë që, në momentin e duhur, kur të na "vijë shteku" t'i presim prangat e robritë, me dëme sa më të vogla për popullin tonë. Ndërsa Hydajet Hyseni e mbronte qëndrimin se duhet krijuar një front i përbashkët veprimi ku do të bashkohen të gjitha masat e gjëra popullore dhe organizatat ilegale, por atë front nuk mund ta udhëheqi askush tjetër përpos "marksistët- leninistëve të Kosovës". Metush Krasniqi duke parë se nuk ia vlen të harxhojë kohë dhe energji me një komunist injorant, i cili nuk kuptonte apo nuk donte të kuptonte se si arrihet bashkimi dhe çfarë rëndësie kishte ai për Lëvizjen tonë kombëtare i ndërpreu bisedimet për këtë çështje. E vetmja gjë për të cilën u muarën vesh dy udhëheqësit e dy organizatave ilegale ishte, që përfaqësuesit e organizatave të tyre që vepronin në botën e jashtme t'i vazhdojnë bisedimet e ndërprera për gjetjen e gjuhës së përbashkët, për bashkimin e organizatave të tyre në një organizatë të vetme.

Siç dihet, nga udhëheqja qendrore e LNÇKVSHJ që vepronte në Gjermani ishin Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla dhe Xhafer Durmishi,

kurse në Turqi ishte Sabri Novosella. Ndërsa udhëheqjen qendrore të OMLK-së në Zvicër e përbënin Kadri Zeka, Hasan Malaj, Saime Zeka. Pas atentatit të Shtutgartit Xhafer Shatri, edhe pse i kishin mbetur edhe disa muaj për ta kryer vuajtjen e dënimit, pat ikur nga burgu i Prishtinës dhe me ndihmën e shokëve (Hasan Malës etj.) pat ardhë në Zvicër dhe kështu ai e zuri vendin e Kadri Zekës.

Jusuf Gërvalla ishte i bindur se vetëm në bazë të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe vëllazëror në mes përfaqësuesve të organizatave ilegale do të krijoheshin parakushtet për bashkimin e të gjitha organizatave në një organizatë të vetme. Ai me punën e tij konkrete tregoi se ishte për një bashkim të mirëfilltë dhe parimor kur ndërpreu daljen e revistën e tij "Lajmëtari i lirisë" dhe zhagiti botimin e organit të organizatës së tij "Zëri i Kosovës". Të njëjtën gjë duhej ta bënin edhe përfaqësuesit e organizatave tjera, për të krijuar kushtet e një marrëveshjeje për bashkimin e tyre në një Organizatë të vetme, me një udhëheqje, me një program, me një statut dhe organ të vetëm. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e OMLK-së, deri pas atentatit të Shtutgardit, nuk treguan as gjestin më të vogël se janë për bashkimin e organizatave në bazë të parimit të respektit reciprok dhe bashkëpunimit vëllazëror.

Edhe pse Hydajet Hyseni ishte "pajtuar" me Metush Krasniqin që përfaqësuesit e dy organizatave që ishin në botën e jashtme t'i vazhdojnë bisedimet për bashkim, H. Hyseni i bllokoi bisedimet kur ua dërgoi përfaqësuesve të organizatës së tij në Zvicër "Tezat (e OMLK-së) rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës". Sipas atyre,,tezave" (vendimeve të H. Hysenit): "Fronti Popullor për Republikën e Kosovës" duhet të jetë jo një koalicion i paqëndrueshëm i krerëve të forcave të ndryshme politike, por një bashkim luftarak i pathyeshëm i të gjitha masave tona popullore; jo marrëveshjeje me fjalë në letër, por një bashkim në luftë e sipër..". Pra, H. Hyseni me anën e atyre "tezave" e bën të pamundur bashkimin e LNÇKVSHJ-së dhe të OMLK-së në një organizatë të vetme, me një udhëheqje, me një statut dhe me një organ të vetëm. Pra ai nuk e do "bashkimin e krerëve të forcave të ndryshme politike" (pra nuk e do bashkimin e Jusuf Gërvallës dhe të Kadri Zekës, vërejtja ime) dhe as nuk do të nënshkruhet kurrfarë marrëveshjeje në mes "krerëve të forcave të ndryshme politike" (pra nuk donë të bëhet kurrfarë marrëveshjeje në mes Kadri Zekës dhe Jusuf Gërvallës) por Hydajet Hyseni e do një "bashkim luftarak të gjitha masave tona popullore". Pra

ai nuk e don atë bashkim që OMLK-në do ta vente në pozitë të barabartë me LNÇKVSHJ, me atë organizatë në programin dhe statutin e së cilës askund nuk përmendej marksizëm-leninizmi dhe as internacionalizmi proletar. H. Hyseni me "tezat" që ia dërgon Kadri Zekës në Zvicër dëshironte të bëjë përçarje dhe të krijojë mosmarrëveshje e ngatërresa në mes veprimtarëve të dy organizatave që vepronin në Evropën Perëndimore, LNÇKVSHJ dhe OMLK-së, kur në një paragraf të "tezave" thuhet: "Bazë e Frontit duhet të jetë aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të pararojës marksiste-leniniste të vërtetë, që do të dalë nga lëvizja komuniste në Kosovë, e cila po rritet, bashkohet e forcohet çdo ditë". Nga kjo që u citua shihet se, sipas "tezave", udhëheqja e Frontit duhet të dalë nga "pararoja komuniste-leniniste e vërtetë". Pra, gjithnjë sipas "tezave", të gjitha organizatat, pra edhe LNÇKVSHJ, duhej të shkriheshin në "Frontin Popullor për Republikën e Kosovës", kurse OMLK-ja të mbetej organizatë pararojë me program, statut dhe organ të vetin, për ta udhëhequr "Frontin"?. Dhe kush mund të jetë në krye të "frontit" përpos krerëve të OMLK-së, që sipas H. Hysenit "ishte", " pararojë komuniste-leniniste e vërtetë". Se çfarë politike do të bëjë "Fronti" për realizimin e synimeve të tij, do të shihet nga ky pasus i marrë nga "Tezat rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës". Po e citoj: " Duhet ndjekur një politikë konsekuente internacionaliste, Fronti do ta lidhë luftën e tij me luftën që bëjnë popujtë e të gjithë botës për liri e socializëm dhe do të luftojë kundër imperializmit me atë amerikan në krye, kundër socialimperializmit sovjetik, kundër fashizmit dhe reaksionit të të gjitha ngjyrave". Shtrohet pyetja ku e gjente gjithë atë forcë dhe energji Hydajet Hyseni dhe marksistët-leninistët e OMLK-së për t'i "luftuar" përpos regjimit të Beogradit, edhe dy superfuqitë botërore SHBA-të dhe BRSS-në, fashizmin dhe reaksionin në botë?!

Siq tregon z.Tafallari në të gjitha tubimet apo takimet e rastit që punëtorët kishin me Jusuf e Bardhosh Gërvallën, Kadri Zekën dhe udhëheqës tjerë të organizatave që i përfaqësonin ata, e kanë shtruar çështjen e bashkimit të organizatave në një organizatë të vetme. Vetë Tafallari tregon se në verën e vitit 1981 kur është parë për herë të parë me Kadri Zekën e ka pyetur për çështjen e bashkimit të organizatave. Ai tregon se në këtë pyetje "Zeqa" (pseudonimi i Kadri Zekës) i ka dhënë këtë përgjigje: "Po, Faridin nuk ka dyshim që duhet të bashkohemi. Por ja

që ende nuk po gjendet një mendim i përbashkët. Po dhe kjo do ta gjej momentin. Ne me "Frontin e Kuq Popullor" jemi bashkuar dhe tani na duhet të gjejmë një mundësi bashkëpunimi edhe me Lëvizjen (LNÇKVSHJ)". Njerëzit kudo që takoheshin shtronin këtë pyetje: A thua vallë ku janë pengesat që nuk po arrihet bashkimi i LNÇKVSHJ dhe të OMLK-së, kur- siç dihet- pas demonstratave të 1981-shit, të dya këto organizata ilegale e pranuan kërkesën gjithpopullore "Kosova republikë". Pra këtë kërkesë e pat pranuar edhe LNÇKVSHJ, edhe pse binte ndesh me statutin e saj, (që parashihte jo statusin e Kosovës republikë në federatën jugosllave, por çlirimin e saj dhe të viseve tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me shtetin amë-Shqipërinë.)

Se nuk ishte pengesa për bashkim të përfaqësuesit e organizatave (LNÇKVSHJ dhe të OMLK) që vepronin në botën e jashtme tregon bashkëpunimi vëllazëror në mes Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, si në nxerrjen e shtypit ilegal ashtu edhe në organizimin e demonstratave në Evropën Perendimore, por edhe vrasja e tyre nga UDB-ja jugosllave, që- me siguri- u ndihmua edhe nga dora tradhtare e shqipfolësve të gjorë, tregon se Jusufi dhe Kadriu së shpejti do ta bënin bashkimin e Organizatave të tyre. Pengesa duhet kërkuar te udhëheqja e OMLK-së që vepronte në Kosovë, te H. Hyseni e të tjerë, kur Kadri Zekës ia dërguan "Tezat rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës" dhe kërkuar prej tij që në asnjë mënyrë të mos shkelen ato nga ana e tij. Sipas z.Tafallarit, Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka patën bashkëpunuar shumë mirë, por në radhën e veprimtarëve të OMLK-së që vepronin në Evropën Perendimore kishte edhe asish që krijonin pengesa dhe mosmarrëveshje në mes këtyre dy organizatave. Për këtë na tregon zotëri Tafallari kur në librin e tij të cekur shumëherë më parë thotë: "Unë di një rast të tillë: Jusufi me Bardhoshin sollën organin e Lëvizjes (LNÇKVSHJ) Zërin e Kosovës në Nagold. Në makinën e tyre e kishin edhe organin "Liria". Kur më dha Zërin e Kosovës, Jusufi m'i dha edhe disa numra të "Lirisë", duke më thënë : " Faridin, shpërndaj edhe këto; edhe pse ata të OMLK-së nuk po pranojnë të marrin Zërin e Kosovës për ta shpërndarë, ne do të shpërndajmë si Zërin e Kosovës ashtu edhe Lirinë".

NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS DHE TË KADRI ZEKËS KA MARRË PJESE, PËRPOS SIGURIMIT TË FSHEHTË SERBO-JUGOSLLAV, EDHE SIGURIMI I FSHEHTË I SHQIPËRISË

Edhe pse Metush Krasniqi dhe Hydajet Hyseni nuk arritën marrëveshjen për bashkimin e organizatave të tyre në një organizatë të vetme, përpjekjet për bashkim i vazhduan veprimtarët që iu përkisnin udhëheqjeve qendrore të LNÇKVSHJ-së dhe të OMLK-së, që vepronin në botën e jashtme. Si rrjedhim i gjithë këtyre përpjekjeve, me propozimin e Jusuf Gërvallës, në tetor të vitit 1981 vjen puna deri te takimi në mes përfaqësuesve të LNÇKVSHJ dhe të OMLK-së në Stamboll. Në atë takim muarën pjesë: Kadri Zeka në emër të OMLK-së, ndërsa Sabri Novosella dhe Bardhosh Gërvalla në emër të LNÇKVSHJ. Xhafer Durmishi në një shkrim të pabotuar na e shpjegon këtë takim në bazë të asaj se çka i ka thënë Bardhosh Gërvalla, që ishte pjesëmarrës në ato bisedime. Ai thotë: "Bardhoshi u kthye aty kah 9 tetori 81, më saktësisht një ditë para se të hapej panairi i librit i Franfurkut 81. Rugës për panair na u dha rasti së pari ta dëgjojmë Bardhin të tregojë për takimin e Stambollit".

Thelbin e bisedimeve ai e tregoi me këto fjalë : "Sabri Novosella: Mund të fillojmë bisedimet për çka jemi mbledhur, bashkimin e organizatave në një të vetme? Kadri Zeka: Ne jemi për krijimin e një fronti në bazë të këtyre tezave, pra për një front i cili do të udhëhiqet nga OMLK-ja! S.Novosella : Ne kemi menduar se do të vish për çështjen e bashkimit të organizatave. Është çështja e këtyre bisedimeve për shkak të të cilave ne e kemi pezulluar nxerrjen e "Zërit të Kosovës" qe disa muaj.! K.Zeka: Unë nuk kam autorizime me bisedue për bashkimin më shumë se ajo që thash e që është në teza!?" Bardhi vazhdon se, menjëherë pas mbylljes së bisedimeve, u vendos që të fillohet me nxerrjen e Zërit të Kosovës, si organ i LNÇKVSHJ. Jusufi u befasua nga mosrezultati i takimit, por edhe ishte i kënaqur që gjërat ishin qartësuar. Puna në nxerrjen e Zërit të Kosovës qe e shpejtë dhe numri i parë doli pas njëzet ditësh, pra në fillim të nëntorit 81 ".

Pra, siç po shihet, bisedat për bashkim dështuan sepse përfaqësuesi i OMLK-së, Kadri Zeka nuk kishte pasur autorizim nga organizata e tij të bëjë biseda për bashkim, por kishte pasur për detyrë të bëjë komentin e "tezave" dhe t'ia bëjë të qartë udhëheqjes së

LNÇKVSHJ-së se të gjitha organizatat dhe grupet ilegale që nuk i përkasin "lëvizjes komuniste në Kosovë"- OMLK-së, pra edhe LNÇKVSHJ-ja duhet të shkrihen në "Frontin për Republikën e Kosovës", ndërsa OLMK-ja duhet ta udhëheqi "Frontin"?!

Organet shtetërore jugosllave, në veçanti ato serbe, u befasuan me rritjen dhe zgjerimin e Lëvizjes tonë kombëtare që, për shkaqe taktike, përkrahte kërkesën "Kosova republikë", por nuk kishte hequr dorë nga synimet për krijimin e Shqipërisë etnike. Ata ishin të njoftuar me veprimtarinë e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës- dhe të veprimtarëve tjerë- që bënë përpjekje për bashkimin e organizatave të tyre dhe organizatave tjera në një front të përbashkët, që do të sillte ngritjen cilësore dhe sasiore të veprimtarisë ilegale dhe legale të lëvizjes tonë kombëtare që punonte për realizimin e të drejtave tona legjitime. Një bashkim të tillë e pengoi jo vetëm UDB-ja e Beogradit, por e pengoi edhe UDB-ja e Tiranës. Se pse Beogradi ishte kundër bashkimit të organizatave ilegale në një organizatë të vetme është e qartë, por pse edhe Shqipëria ishte kundër bashkimit të organizatave ilegale, siç mendonte udhëheqja e LNÇKVSHJ (të gjitha organizatat të bashkohën në një organizatë, me një program, me një statut, me një organ dhe me një udhëheqje që do të dilte nga veprimtarët e shquar të të gjitha organizatave ilegale) nuk është e qartë edhe sot e kësaj dite prej një pjese të popullsisë së Kosovës, sepse nuk i dinin dhe nuk i dinë objektivat madhore të PPSH dhe të udhëheqjes së Shqipërisë. Për PPSH ishte parësore fitorja e socializmit në botë, mbrojtja e marksizëm-leninizmit dhe internacionalizmit proletar. Formimi i një organizate të fuqishme që do t'i mbronte interesat e Kosovës dhe të kombit shqiptarë para interesave ideologjike për të cilën aq shumë ishte lidhur PPSH dhe Enver Hoxha, do të shkonte në kudërshtim me interesat e ngushta partiake të klasës politike të Shqipërisë, sepse do të dëmtoheshin dhe rrezikoheshin ato interesa. Prandaj, qysh në takimet e para që u bënë për bashkimin e LNÇKVSHJ dhe të OMLK-së, muarën masa të pengojnë bashkimin e këtyre organizatave në bazë të propozimeve konkrete që vinin nga udhëheqja e LNÇKVSHJ. Por diplomatët e Shqipërisë, që vepronin në Evropën Perendimore, përpos që bënë përçarje në mes të veprimtarëve të këtyre organizatave, ata në një mënyrë përkrahnin bashkimin e organizatave në bazë të "Tezave" të OMLK-së, që udhëheqjen e organizatës së bashkuar do ta merrte "pararoja komuniste-leniniste" (udhëheqja e OMLK-së) që



faktikisht ishte një dorë e zgjatur e sigurimit të fshehtë të Shqipërisë. Ky farë lloj "bashkimi" do t'ia siguronte PPSH-së kontrollin mbi organizatën e bashkuar dhe do ta shndërronte atë në një altoparlant i PPSH-së, që ajo të mos bëhet një qendër e fuqishme veprimi që do të merrej me çështje madhore kombëtare. Prandaj është më se e sigurt se në vrasjen e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës kanë marrë pjesë, përpos sigurimit të fshehtë serbo-jugosllav, edhe sigurimi i fshehtë i Shqipërisë.

Njëri ndër të parët që kërkoi ndihmë prej Jusufit ishte Ibrahim Kelmendi, një ish student i dështuar i Universitetit të Prishtinës, i cili- në mënyrë demonstrative- e kishte pas lëshuar universitetin, duke ua "dhënë fjalën" profesorëve se kanë për të parë se kush është Ibrahim Kelmendi. Ai pasi "nuk pati fat" për ta kryer fakultetin, vendosi "të provojë fatin në gurbet" dhe kështu ia mësyu Gjermanisë. Atje ai bie në kontakt me prijës të emigracionit kroat, me "diplomatë" të Shqipërisë dhe me aventurierë e anarkistë të ndryshëm. Tregoi shkathtësi të rrallë kur i bindi bashkëbiseduesit se ishte i "ndjekur" nga policia serbo-jugosllave, ndërsa pas "formimit" të organizatës ilegale "Fronti i Kuq Popullor" iu hapën rrugët për të "bashkëpunuar" me përfaqësuesit e organizatave ilegale që ishin formuar në Kosovë dhe i kishin degët e tyre në Evropën Perëndimore (siç ishte rasti me LNÇKVSHJ dhe OLMK-në. Siç kemi thënë, I. Kelmendi gjatë verës së vitit 1979 e pat nxjerr numrin e parë të organit të organizatës së tij që e quante "Bashkimi". Jusuf Gërvalla, edhe pse nuk përputhej me asgjë me I. Kelmendin, e ndihmoi në nxerrjen e nr.2, 3 dhe 4 të,,Bashkimit". Kur Jusufi ia ndërpreu ndihmën I. Kelmendit (janar 1981) "Bashkimi" pushoi së botuari. Shtrohet pyetja pse Jusuf Gërvalla nuk e ndihmoi më tutje I. Kelmendin? Siç dihet, me kalimin e kohës, njerëzit vet diferencohen dhe tregojnë se kush janë. Edhe I. Kelmendi rastësisht i "shplon këmbët", kur Jusufit i tregon se si ua ka "lëshuar mjekrrën" ustashëve kroat, kur ua kishte marrë 50.000 DM! Fjala është për një mashtrim të thjeshtë të I. Kelmendit i cili ustashëve kroatë iu paraqitet si "udhëheqës" i një organizate ilegale shqiptare që e "lufton komunizmin" dhe "regjimin titist të Jugosllavisë". Organizata e ustashëve kroatë, duke shpresuar se do të krijojë një aleancë të fortë në mes shqiptarëve dhe kroatëve për ta luftuar armikun e përbashkët, shovenizmin serb, vendosën ta ndihmojnë "organizatën e shqiptarëve", duke ia dorëzuar I. Kelmendit në dorë një shumë prej 50.000 DM. I. Kelmendi ato të holla në vend se t'i përdorë për çështje për të cilat ia

kishin dhënë ustashët, ai ato të holla ia dërgon familjes së tij në Pejë. Jusufi kurrësi nuk mund ta arsyetonte një veprim kaq të lig të I. Kelmendit, prandaj jo vetëm që nuk e ndihmon më, por edhe kërkoi prej tij që "më kurrë të mos ia shkeli pragun e shtëpisë". Faredin Tafallari ishte njëri ndër bashkëveprimtarët e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës i cili më së miri i njeh rrethanat që e shtynë Jusuf Gërvallën t'ia ndërpresin ndihmat Ibrahim Kelmendit. Ai në librin e cekur më parë thotë: "Më kujtohet një takim ku kam qenë edhe unë i pranishëm. Jusufi e pyeti Ibrahimin që t'i tregonte se sa të holla i kishte marrë nga një organizate kroate (emrin e saj nuk e di). Sipas fjalëve të Ibrahimit ka qenë puna për një shumë prej 50 mijë markash gjermane, që do të përdorreshin për të blerë armë. Këtë shumë e kanë marrë njerëzit e Ibrahimit, mandej i përdori ato për të rregulluar një lokal kafeneje në Pejë. Jusufit kjo gjë nuk i pëlqeu dhe e kundërshtoi veprimin e Ibrahimit si jo të mirë. Ibrahim i përgjigjej se "kur gjen budallenj pse të mos përfitosh". Jusufi ia ktheu: "Ato para janë marrë për diçka tjetër dhe për një çështje tjetër dhe janë përdorur për interesat tuaja. Për tjetër janë kërkuar dhe për tjetër janë shfrytëzuar". Pastaj vazhdon Tafallari: " Veç kësaj, për një farë kohe, Rizah Salihu ia ka kontrolluar korespodencën Jusufit; se me çfarë mënyre ia ka arritur kësaj, nuk e di. Por më pas u krijuan dyshime mbi Ibrahimin se vetëm ai ia dinte adresën Jusufit. Rizah Salihu, pas vrasjes së shokëve tanë, është burgosur nga policia gjermane. Pas demonstratës së organizuar në prill 1981 në Shtutgart, ne shkuam në një sallë; aty erdhi edhe Riza Salihu, por pjesëmarrja e tij nuk është mirëpritur as nga Jusufi as nga Kadriu". Se kush ishte anonimi Riza Salihu, nuk është ditur plotësisht atëherë- dhe as sot nuk dihet. Dihet me siguri se Ibrahim Kelmendi dhe Hysen Gega kanë qenë shokë të pandashëm të tij dhe kanë pasur bashkëpunim të ndërsjellë të vëllazëror. Sipas fjalëve që qarkullonin atëherë thuhej se Rizah Salihu e kishte pas formuar një grup komunist dhe se e kishte nxjerr një fletushkë me titull: "Zëri i Kosovës". Po ashtu është e sigurt se anonimi Riza Salihu ka bërë shpifje të liga kundër Jusuf Gërvallës, duke e shpallur "bashkëpunor të UDB-së". Sipas z. Tafallarit, shpifjet e Rizah Salihut paskan ndikuar në Hysen Gegën aq shumë sa që ai paska shprehur gatishmërinë ta vrasë Jusufin po qe se është e vërtetë ajo që thonte Salihu për të. Hyseni takohet me Jusufin dhe me bisedën e parë që e pati e kupton se të gjitha ato që i kishte thënë Salihu për Jusufin ishin shpifje. I tregon Jusufit se çka flitej për të në rrethin e ngushtë të

Rizah Salihut. Ai i tregon edhe për mendjelehtësinë e tij kur shpifjet në një moment ia kishin prishë shpirtin dhe ia kishin helmuar zemrën. Dhe në fund ndahen si vëllezër.

## KUSH KANË QENË ATA QË KANË FORMUAR "KOMITETIN..." PËR LIKUIDIMIN FIZIK TË JUSUF GËRVALLËS?

Por në Evropën Perëndimore, tek bashkëkombësit tanë, qarkullon edhe një variant tjetër i kësaj ngjarjeje. Thuhet se Ibrahim Kelmendi, Rizah Salihu dhe Hysen Gega e paskan formuar një Komitet që do të merrej me likuidimin fizik të Jusuf Gërvallës, ndërsa Hysen Gega qenka zotuar se do ta kryente vet ekzekutimin e dënimit. Thuhet se për atë qëllim paska shkuar në banesën e Jusufit dhe se me bisedat që i zhvilluan atë natë sëbashku, Hyseni e kupton se të gjitha ato që i ka dëgjuar për Jusufin nga anëtarët e atij Komiteti nuk kishte asgjë të vërtetë, por ishin gënjeshtër dhe shpifje. I tregon Jusufit fill e për pe çka flitej për të, dhe për çka kishte ardhuri te ai. Ky takim përfundon siç është më së miri, Hyseni dhe Jusufi bëhen miq dhe shokë të sinqertë, por Hysen Gega pati pasoja pse nuk e kreu detyrën. U burgos nga policia jugosllave, posa pat shkuar në Kosovë për ta vizituar familjen. Faredin Tafallari na i jep ca të dhëna të rëndësishme se kush ia ka përgatitur kurthen Hysen Gegës për të ra në duar të policisë jugosllave? Ai thotë: "Një mbasdite Dema (Demë Demaj kishte qenë shok i ngushtë i z.Tafallarit dhe të dy ishin bërë anëtarë të LNÇKVSHJ) erdhi në shtëpinë time dhe më tha se ka ardhur një shok nga Kosova, i cili është shumë i aftë"! Tafallari paska shkuar te Dema që të njihet me shokun e tij dhe pastaj paskan dalë në një restorant. Gjatë kohës sa Dema bisedonte me telefon me Jusuf Gërvallën, Sadik Blakaj e paska pyetur Tafallarin për organizatën që bënte pjesë, për udhëheqësit e saj, sa anëtarë i ka dhe kush është në ballë të saj, a jeni të organizuar në grupe apo në celula, me cilat organizata dhe me cilët njerëz bashkëpunojmë etj, por Tafallari iu shmangej pyetjeve dhe nuk i jepte kurrfarë përgjigjeje, në rend të parë se e kishte parë këtë njeri për të parën herë, por edhe në bazë të disa të dhënave biografike që ia kishte dhënë Dema për Sadik Blakajn. Tafallari thotë: "Dema më kishte thënë për Sadikun se ishte patriot dhe i zgjuar shumë, por se kishte edhe ndonjë të keqe. Më tha se ishte i dhënë pas femrave dhe i ndërronte; bile edhe këtë që e ka tani si dashnore, e ka pasur dikur nxënësen e vet, kurse gruan me 5-6 fëmijë e ka te shtëpia. Shtoj se edhe paratë i pëlqejnë. Por Faredin, ky aty ku rri dhe ha nuk bën kësi punësh, kurrësi. Nuk ka më të zotin dhe

më patriot se ky; ua kalon shumë të tjerëve". "Me t'i dëgjuar të gjitha këto,unë iu pata përgjegjur Demës: "Po si mund të jetë i vendosur për patriotizëm një njeri që ka kësi të metash? Unë këtij nuk i besoj dhe nuk e njoh për patriot edhe pse ti i beson"! Tafallari vazhdon: " Kur erdhën Jusufi me Bardhoshin, dëgjova se Sadik Blakaj i thoshte Jusufit: "Në vendet ku kam qenë, kam pasur shumë shokë dhe më dhimbsen, sidomos miqtë e mi në Francë e në Belgjikë. Por tani që kam ardhur këtu, dëshiroj të bashkëpunoj me ju. Shumë libra më kanë mbetur në Bruksel, ndër të tjera edhe veprat e shokut Enver". Jusufi iu përgjegj: "Nëse ke pasur shokë, ata duhet t'i kesh shokë edhe këtej e tutje, përgjithnjë". Duke biseduar Sadikut i rridhnin lotët. Jusufi tha: "Lotët nuk janë për burra; vetëm kur dy të rinj dashurohen dhe u vjen koha e prishjes, ata me lotë mundohen ta zgjasin dashurinë". Sadiku u pëpoq që të merrte vesh nga Jusufi se sa anëtarë kishte në organizatën e tij dhe kush i ndihmonte. Por Jusufi nuk i dha as një informacion: nuk pranoi që kishte ndonjë organizatë dhe as që ai merrej me punë të tilla". Nuk vonoi asnjë muaj kur Sadik Blakaj arriti suksesin e parë në dobi të UDB-së jugosllave. Demën e bindi që të mos shkonte për të marrë pjesë në tubimin festiv të 28 Nëntorit (të 1980) me qëllim që drama e përgatitur nga Tafallari dhe Dema me shokë të mos shfaqej atë natë. Por Sadik Blakaj nuk ishte i kënaqur vetëm me kaq. Tash e kishte radhën Hysen Gega të dënohet për "tradhtinë" që ia kishte bërë Rizah Salihut me shokë, kur detyrën që e kishte marrë për ta kryer nuk e kreu.

Se si ia mbushin mendjen Hysen Gegës të shkonte në Kosovë, për ta parë familjen dhe për t'i dërguar statutet dhe programet e organizatës së Ibrahim Kelmendit (që edhe vetë ishte anëtarë i saj) " Fronti i Kuq Popullor", e di më së miri vet H.Gega, por para se të udhëtojë për Kosovë, Sadiku ia kishte dhënë fjalën Hysenit se "bashkë do të shkojmë dhe bashkë do të kthehemi". Por Sadik Blakaj, para se të nisej me Hysen Gegën për Kosovë, një mbrëmje udhëtoi për diku. E kishin pas përcjellë Faredin Tafallari dhe Demë Demaj deri në stacion të trenit në Nagold. Dhe, para se të nisej treni, Sadiku i paska thënë Demës: "Shikoi duart e mia; këto nuk punojnë si duart e tua e të Faridinit, por fitojnë, ja kështu, të paprishura". Kur treni u nis, Sadiku paska thënë: "Demë, për atë bisedë, mos të dijë kush veç ti dhe unë". Sadiku me Hysenin shkuan në Kosovë. Se qysh e qiti në kurthën e UDB-së Sadik Blakaj bashkudhëtarin Hysen Gegën di më së miri të na tregojë H.Gega, por

Sadik Blakaj u kthye në Gjermani në janar të 1981, pa pasur kurrfarë problemi gjatë udhëtimit, ndërsa Hysen Gega u dënua 10 vjet burg nga gjykata e okupatitit serb në Kosovë.

Kur Jusuf Gërvalla mëson për burgosjen e H.Gegës kërkon shpjegime të hollësishme nga Tafallari. Tafallari ia shpjegoi rrjedhën e ngjarjeve, por- për të qenë të dhënat sa më të plota se si kanë rrjedhur ngjarjet- organizon një takim në banesën e tij ku marrin pjesë Jusuf Gërvalla, Faredin Tafallari, Sadik Blakajt dhe Demë Demaj. Po e japim një pjesë të dialogut që është zhvilluar në mes Jusuf Gërvallës dhe Sadik Blakës (që po e nxjerr prej librit të F.Tafallarit): "Po si ju ndodhi që Hysenin e zunë dhe ti u ktheve. Me sa di unë, kur jeni nisur fjalët i keni pasur ndryshe dhe i keni dhënë besën njëri- tjetrit se nuk do të ndaheni. Si ndodhi pra"? Sadiku mendohej ta linte në gabim Hysenin se gjoja nuk ka ditur të ruhet meqë ishte i pa përvojë dhe se paska pasur qejf të burgosej. Me mënyra e fjalë shumë të ulta mendohej ta bindte Jusufin se Hyseni ishte i paafat. Por Jusufi që e njihte mirë, iu drejtua: "Pasi Hyseni, nuk paska qenë i aftë, a do të kishe pranuar të shkoje me ndonjë tjetër"?.- "Ah, po-tha Sadiku. - Do të kisha pranuar me ndonjë si ti, se me cilindo nuk do të kisha shkuar." "Po me mua a pranon"? - e pyeti Jusufi. Po si, bile do të isha nisur qysh sonte".. "Po a mundesh të garantosh për këtë kalimin e kufirit"? - e pyeti Jusufi. Po tha "Po të garantoj që asnjë gjemb nuk ka për të hyrë në këmbë. Bile me shumë qejf do të kisha shkuar me ty". Me pyetjet që Jusuf Gërvalla ia shtroi Sadik Blakës dhe përgjigjet që i muar prej tij, u bë e qartë se Sadik Blakaj punonte për Sigurimin e fshehtë serbo-jugosllav. Pra u bë e qartë se ai e kishte dorëzuar Hysen Gegën në policinë jugosllave dhe shprehu dëshirën e flaktë që edhe Jusufin ta dorëzonte si Hysenin. Nuk mërzitej Sadiku se premtimet dhe garancat e tij dalin të rrejshme kur arrinte qëllimin. Pas këtij takimi-dikund në shkurt të 1981 - Demë Demaj pat vendosur të shkonte në Kosovë për ta vizituar familjen. Siç thotë Tafallari, ky qe konsultuar me Jusuf Gërvallën. Tafallari shënon këtë dialog që është bërë në mes Jusufit dhe Demës: "Baca Jusuf, unë dua të shkoj te shtëpia. Po ti si po më thua"?- "Unë të them të mos shkosh", u përgjigj Jusufi. Por Dema u tregua këmbëngulës për këtë. Ai i kërkoi Jusufit materiale nga shtypi ilegal që t'i merrte me vete dhe t'i shpërndante në Kosovë. Jusufi tha: "Nuk të jap asnjë nga materialet dhe ti, meqë nuk po më dëgjon, bënë si të duash". Dhe shtoi: "Po të mungon disiplina". Këtë e tha me keqardhje.

Jusufi nuk donte që shokët të rrezikoheshin pa qenë nevoja dhe kjo ikje pas asaj që kishte ndodhur me Hysenin e brengoste fort".

Dema shkoi në Kosovë dhe dikund kah fundi i marsit i bënte telefon F.Tafallarit dhe kërkon prej tij: "Thuaj Bardhoshit që të vijë të më marrë dhe ti jepja pasaportën tënde se më duhet që të kaloj kufirin për aty. Bardhoshi e njeh terrenin dhe ai duhet të vijë". Siç thotë Tafallari, edhe Ibrahim Kelmendi interesohej të dijë se si po bëhet puna e Demës, pasi që ai e kishte pyetur Tafallarin se "si po vendos për Demën", kjo don të thotë I. Kelmendi ishte në dijeni të kërkesave të Demës. Tafallari, edhe pse ishte kundër shkuarjes së Bardhoshit në Slloveni, ia përcjellë porosinë e Demës Bardhoshit. Por Bardhoshi i jep këtë përgjigje Tafallarit: " Ai kur shkoi, nuk na dëgjoi ne dhe tani kërkon ndihmë. Unë nuk shkoj, por as ti të mos rrezikosh, edhe pse e di që e ke shok të ngushtë; por ama kurrsesi të mos shkosh". Por, siç thotë Tafallari: "Ditët shkonin; nga Dema merrja telegrame. Një herë më thoshte se punën e kishte keq, një herë tjetër më lajmëronte se çdo gjë ishte në rregull. Telegramet ndryshonin nga njëri tjetri brenda pak kohe". Dema u kthye në Gjermani, por, siç thot Tafallari, ardhja e tij "...zgjoi interesim të madh te shokët, por njëherit edhe dyshim se ai ishte në lidhje me Sadik Blakën".

UDB-ja jugosllave çdo herë që planifikonte zhdukjen fizike të shqiptarëve të cilët i pengonin planet dhe programet e saj në lidhje me Kosovën dhe Viset tjera shqiptare, bënte parapërgatitjet e duhura dhe pastaj realizonte vrasjen e tyre. Kështu ndodhi edhe me vrasjen e Jusuf Gërvallës, Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës. Shpifjet e Rizah Salihut kundër Jusuf Gërvallës, ishin shenjat e para se UDB-ja po i bëte përgatitjet për vrasjen e tij. Ardhja e Sadik Blakës te Demë Demaj në Shtutgard dhe njohja e tij me Jusuf e Bardhosh Gërvallën, Faridin Tafallarin dhe veprimtarë tjerë, nëpërmjet Demë Demës si dhe bashkëpunimi i ngushtë në mes Sadik Blakës, Rizah Salihut dhe Ibrahim Kelmendit, ishin shenjat e sigurta se diçka e ligë po përgatitej kundër prijësve të organizatave ilegale që vepronin në botën e jashtme. Edhe burgosja e Hysen Gegës në Kosovë në sajë të ndihmës së Sadik Blakës dhe tentimi për ta burgosur Bardhoshin apo Tafallarin në Slloveni, kur ata do të shkonin për ta ndihmuar Demë Demën për ta kaluar kufirin Jugosllavi-Austri, tregonin se sigurimi i fshehtë jugosllav i kishte vënë në veprim të gjitha mekanizmat e saj brenda dhe jashtë vendit që të vinte

deri te burgosja apo te zhdukja fizike e veprimtarëve që punonin kundër interesave serbo-jugosllave.

F.Tafallari tregon më tej: "Nisën të dalin fjalë se UDB-ja do të kryente aksione konkrete kundër lëvizjes patriotike kosovare në mërgim dhe se donte të vriste prijësit, organizatorët. Më dëndur përmedej emri i Jusufit. Këtë fjalë e kishte dëgjuar edhe vëllai im gjatë pyetjeve në sigurimin e Prizrenit. Ne ia treguam këtë gjë edhe Jusufit, por ai si gjithmonë... nuk iu dha rëndësi këtyre paralajmërimeve. Bile një herë më tha: "Pse ty të dhimbset jeta për atdhe"?. Unë u zura ngushtë dhe iu përgjigja: "Jo, mua nuk më dhimbset, por po flitet për ty". Jusufi nuk i dha rëndësi kësaj çështjeje." Se kundër Jusufit po përgatitej atentat dinin edhe shumë veprimtarë në Kosovë. Tafallari në librin e tij "Terror, dhimbje, qëndresë" tregon se edhe Metush Krasniqi nëpërmjet Isah Demit, që ishin takuar në Prishtinë, i kishte dërguar të fala dhe porosi Jusufit. Tafallari thotë: "Isah Demi kur u kthye nga Kosova na tha se atje ishte takuar me Metush Krasniqin. Metushi e kishte porositur që t'i bënte shumë të fala Jusufit dhe t'i thoshte që të kishte kujdes, se armiku e ka në shënjestër, prandaj të ruhej. Bashkë me Isahin shkuam dhe e takuam Jusufin dhe Isahi i tregoi për Metush Krasniqin.

Jusufi pyeti: "Po si e njeh ti Metushin"? Dhe i dëgjoi me interesim të madh shpjegimet e Isahit. Në fund Jusufi tha: " Isah, kur të shkosh përsëri në shtëpi, të më lajmërosh dhe unë kamë për të dhënë porosi për Metushin". Tafallari tregon se para se të bëhej atentati i Shtutgartit "flitej me të madhe se diç do të ndodhte (se do të vritej dikush). Më së shumti përmendej emri i Jusuf Gërvallës. Shokët e tij ndjenin ankth, e njoftonin Jusufin, por ky nuk shqetësohej, vazhdonte punën patriotike".

**NË CILAT RHETHANA U KRY ATENTATI NDAJ VËLLEZËRVE GËRVALLA DHE KADRI ZEKËS NË SHTUTGART? KUSH MUND TË JETË I PËRZIER NË KËTË ATENTAT**

Pas përgatitjeve të duhura Sigurimi i fshehtë jugosllav realizoi planin dhe skenarin për zhdukjen fizike të tre udhëheqësëve të dy organizistave ilegale që vepronin në Kosovë dhe jashtë atdheut. Vrau Jusuf Gërvallën, njërin ndër udhëheqësit kryesorë të KQ të LNÇKVSHJ; Bardhosh Gërvallën, anëtarin e KQ të LNÇKVSHJ, dhe Kadri Zekën njërin ndër udhëheqësit kryesorë të OMLK-së. Siç dihet, pas demonstratave të mars-prillit 1981, situata politike në Kosovë dhe në Jugosllavi shkonte në dobi të polikës serbe për ndryshimin e Kushtetutës

së 1974. Në Kosovë kukullat e tyre Fadil Hoxha, Azem Vllasi e të tjerë, i shpallën demonstratat "kundërrevolucionare" e kështu ia mundësuan Serbisë dhe federatës jugosllave ta mbushin Kosovën me forca policore speciale, për të kryer dhunë dhe terror mbi popullsinë e Kosovës. Në Evropën Perëndimore vepronin çerdhet e sigurimit të fshehtë jugosllav, që kishin për detyrë t'i fusin njerëzit e tyre në organizatat ilegale që vepronin në Gjermani, Zvicër e gjetiu, për të krijuar përçarje dhe grindje në radhët e anëtarësisë së gjërë të organizatave ilegale. Këtë punë e ndihmuan edhe përfaqësuesit e diplomacisë së Shqipërisë që punonin në Vjenë, Paris, Stamboll dhe Ankara, që i përkrahnin edhe përfaqësuesit e LNÇKVSHJ edhe përfaqësuesit e OMLK-së për të mos i lëshuar pe njëra tjetrës, sa i përket çështjes së bashkimit të organizatave të tyre, dhe në këtë mënyrë bënë pengimin e bashkimit të tyre në një organizatë të vetme. Për këtë çështje ka folur Sabri Novosella me një shkrim të botuar me rastin e dhjetëvjetorit të formimit të LRSHJ me titull: "Si e krijuam Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi" që gjendet i shtypur si dokument në librin e z.Tafallarit (të cekur më parë). Do t'i citoj disa fragmente nga ai shkrim, ku shihet se diplomacia e Shqipërisë pengonte bashkimin e organizatave ilegale në një organizatë të vetme, duke i përkrahur të dy palët në qëndrimet e tyre për çështjen e bashkimit të organizatave, qëndrime këto që ishin në kundërshtim me njera tjetën. Sabri Novosella thotë: "Para se të vinin shokët nga Evropa (e ka fjalën për Bardhosh Gërvallën dhe Kadri Zekën të cilët së bashku me Sabri Novosellën i zhvilluan bisedimet në Stamboll për bashkimin e LNÇKVSHJ dhe OMLK-së, - vërejtja ime) e kisha njoftuar prof. Bujar Hoxhën se do të vijnë disa shokë nga Evropa për të biseduar rreth bashkimit të organizatave ekzistuese... Bujar Hoxha shprehu dëshirën që edhe ai të takohej me ata shokë... Posa arritën shokët në aeroport i njoftova për kërkesën e Bujar Hoxhës dhe kërkoja mendimin e tyre se a ta lajmërojmë. Që të dy propozimin e aprovuan, bile Kadri Zeka më njoftoi se para se të nisej e paska pasur një takim me Engjëll Kolanecin, i cili ishte diplomat në Vjenë... Të nesërmën, sipas marrëveshjes, në një restorant të Stambollit u takuam ne të tre me prof. Bujar Hoxhën dhe me një njeri të Ambasadës që e shoqëronte, të cilin e quante Rauf... Në fund të atij takimi prof. Bujari propozoi që Raufi të shkonte t'i merrte disa pako me cigare dhe shishe me konjak për t'ua dërguar shokëve në Evropë për përshëndetje. Pasi u ngrit Raufi, i propozoi edhe Kadriut që ta



shoqëronte, menjëherë i propozoi edhe Bardhoshit që edhe ky t'i shoqëronte. U kuptua se Bujari dëshëronte të më thonte diçka vetëm mua. Pasi mbetëm vetëm, iu drejtova: "Çka po na thua profesor"? M'u përgjegj tekstualisht: "Mos lëshoni pe". Bisedimet vazhduan edhe në mbrëmje të asaj dite. Kadriu ishte kureshtar se çka më tha prof. Bujari, por edhe unë u bëra kureshtar se çka i kishte thënë Engjëll Kolaneci para se të vinte Kadriu në Turqi. Që të dy "dekonspiruam". Kadriu na njoftoi se Engjëll Kolaneci i kishte thënë: "mbaj qëndrimet e tua", po ashtu edhe unë e njoftova për atë çka më tha prof. Bujar Hoxha. Që të tre u dëshpëruam keq".

Këto mosmarrëveshtje që u krijuan në mesin e udhëheqjes së dy organizatave që vepronin në Kosovë, Gjermoni, Zvicër dhe shtete tjera, krijuan paqartësi dhe huti në mesin e punëtorëve tanë dhe, në të njëjtën kohë, krijuan terrenin e përshtatshëm për spiunët serbo-jugosllavë për të mbjellë përçarje dhe ndasira në mesin e punëtorëve dhe veprimtarëve që jetonin dhe vepronin në botën e jashtme. Mosshpërndarja e "Zërit të Kosovës" nga ana e veprimtarëve të OMLK-së, ishte një fitore e madhe e sigurimit të fshehtë jugosllav, pa marrë parasysh se a e realizuan njerëzit e saj drejtpërdrejt apo tërthorazi, nëpërmjet spiunëve të saj që i kishin futur në organizatat ilegale apo spiunëve të saj që i kishte futur në Sigurimin e fshehtë të Shqipërisë dhe në diplomacinë shqiptare. Duhet cekur se të padijshmit, që nuk kuptonin asgjë nga polituka dhe atdhedashuria, shumë lehtë manipuloheshin nga demagogjia perfide e spiunëve të regjuri jugosllavë. Dhe kështu, pa vetëdije, kryenin urdhërat e tyre, për të shkatërruar çdo organizim të mbarë të bashkëkombësve të tyre që punonin me përkushtim për shqiptari. Punëtorët tanë nuk kuptonin se për çfarë arsyeje shtyhej bashkimi i organizatave. Faktikisht udhëheqja e organizatave ilegale (Jusuf e Bardhosh Gërvalla, Kadri Zeka e të tjerë) nuk ua tregonin anëtarëve të organizatës dhe as punëtorëve shkaqet e mosbashkimit të organizatave të tyre, nga frika se do të politizohet anëtarësia e gjërë, çka do të çonte në ndarjen e bashkëkombësve në dy taborre kundërshtarë, ashtu siç dëshëronte UDB-ja jugosllave. Me siguri ndarja do të vinte po të kuptonin bashkëkombësit tanë që jetonin dhe vepronin në botën e jashtme se mosbashkimi i organizatave në një organizatë të vetme vinte për shkaqe të pa rëndësishme fare (për momentin). Faktet dëshmojnë se zhagjitja e bashkimit të organizatave në një organizatë të vetme nuk është bërë për shkaqe parësore por për

shkaqe dytësore, pasi që ato ishin çështje të pushtetit, çështje se kush do ta marrë pushtetin e Kosovës pas realizimit të kërkesës: "Kosova republikë".

"Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi" (LNÇKVSHJ), mbronte qëndrimin se të gjitha organizatat ilegale duhej bashkuar në një organizatë të vetme; me një udhëheqje që i përfaqësonte të gjitha organizatat që pranonin bashkimin, me një statut, me një program dhe me një organ të vetëm. Në këto qëndrime nuk kishte synime karrieriste, dhe ishte e vetmja mënyrë për të arritur bashkimin e organizatave ekzistuese në një organizatë të vetme. Në anën tjetër përfaqësuesit e "Organizatës Marksiste Leniniste të Kosovës" (OMLK-ja) që vepronin në Zvicër, i kishin marrë "Tezat rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës" nga Hydajet Hyseni dhe ishin urdhëruar që në as një mënyrë të mos i shkulin "Tezat..." në lidhje me bashkimin e organizatave. Sipas "Tezave..." shifet se "Bazë e Frontit duhet të jetë aleanca e klasës puntore me fshatarësinë, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të pararojës marksiste-leniniste të vërtetë, që do të dalë nga lëvizja komuniste në Kosovë". Nga ky pasus i cituar shihet se OMLK-ja mbronte qëndrimin se duhet krijuar "Fronti Popullor për Republikën e Kosovës" nga aleanca e fshatarësisë me klasën punëtore, por "Frontin..." do ta udhëhiqte "pararoja marksiste-leniniste" që do të dalë nga "lëvizja komuniste në Kosovë". Pra, sipas "Tezave..." që i kishte përpiluar Hydajet Hyseni, "pararojë komuniste-leniniste e vërtetë" ishte OMLK-ja, organizata, që në krye të së cilës ai ishte vënë. Prandaj, sipas logjikës komuniste, vetëm H. Hysenit i takon udhëheqja e "Frontit..." dhe askuj tjetër. Dhe vetëkuptohet se kush do ta udhëhiqte "Frontin" atij do t'i takonte ta merrte pushtetin e Kosovës, pasi që ajo ta fitonte statusin e republikës në federatën jugosllave. Ja, pra, këto ishin shkaqet që e shtynë Hydajet Hysenin të mos bashkohej me LNÇKVSHJ, të cilën e udhëheqte Metush Krasniqi, që për shumicën dërmuese të ish burgosërvë politik, që kishin bindje politike komuniste e konsideronin të mbrapambetur, dhe reacionar, për shkak të bindjeve të tia nacionliste, demokratike dhe properendimore.

Bashkëpunimi i Jusuf Gërvallës me Kadri Zekën ishte vëllazëror, përkundër faktit se Kadri Zeka ishte vënë në një situatë të palakmueshme nga udhëheqja e organizatës së tij, kur e kishin autorizuar të bisedonte me përfaqësues të LNÇKVSHJ për bashkëpunim, por jo edhe për bashkimin

e organizatave të tyre në një organizatë të vetme. Me siguri spiunët serbë që kishin depërtuar në radhët e këtyre organizatave, kishin kuptuar se Kadri Zeka në një moment të përshtatshëm, edhe pa pëlqimin e organizatës do të merrej vesh me Jusuf Gërvallën për bashkimin e dy organizatave në një organizatë të vetme, prandaj edhe vendosën t'i vrasin së bashku për të penguar bashkimin e organizatave që ata i përfaqësonin në Evropën Perendimore. Pra, të gjithë faktorët që u përmendën më lart ndikuan drejtpërdrejt apo tërthorazi që puna të vijë deri te atentati i Shtutgartit. Por duhet cekur se edhe faktori i jashtëm ndihmoi Jugosllavinë në realizimin e këtij atentati makabër.

Shtrohet pyetja se kush mund të jetë i përzier në këtë atentat drejtpërdrejt dhe kush tërthorazi; kush e ndihmoi Sigurimin e fshehtë serbo-jugosllav me vetëdije dhe kush e ndihmoi pa vetëdije? Po që se merren në shqyrtim të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet që ndodhën në Shtutgart dhe rrethinë para se të ndodhte atentati dhe pasi u bë krimi, do të vijmë në përfundim se në vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës, përpos Sigurimit të fshehtë Jugosllav, kanë marrë pjesë tërthorazi edhe Sigurimet e fshehta të Gjermanisë dhe ai i Shqipërisë. Me keqardhje duhet thënë se shqiptarët e ligj dhe tradhtarët e kombit luajtën rol me rëndësi në përgatitjen e terrenit për këtë atentat, duke mbledhur informata për t'ua lehtësuar punën kriminelëve për ta kryer krimin pa pengesa. Nuk është e nevojshme ta zgjatim për t'i numëruar të gjitha shkaqet që ndikuan në kreun e UDB-së Jugosllave të ndërmarrin një aksion aq të rrezikshëm, në një territor të një shteti që aq shumë e ndihmonte Jugosllavinë, duke ia punësuar forcën e lirë punëtore, po të mos ishin në pyetje interesa madhore shtetërore. Është më se e sigurtë se Sigurimi i fshehtë gjerman ia ka dhënë dritën e gjelbërt Sigurimit të fshehtë Jugosllav për të bërë këtë krim, duke u nisur nga interesat globale të ruajtjes së tërësisë territoriale të Jugosllavisë, e cila me politikën e saj "të paangazhuar" bënte një balancim në mes Rusisë dhe Amerikës dhe dy pakteve ushtarake ekzistuese, ku edhe Gjermania kishte interesat e saj strategjike në atë mes.

Fatkeqësisht edhe Sigurimi i fshehtë i Shqipërisë, që ishte "arma e partisë" mos drejtpërdrejt, tërthorazi ka gisht gjithsejsh, pasi që ajo nuk donte në asnjë mënyrë të ndryshonte status-quonë në Ballkan, nga frika se do ta humbin pushtetin. PPSH-ja ishte kundër formimit të një Organizate të fortë me synime të qarta çlirimtare, që do t'i bashkonte

shqiptarët në baza kombëtare, sepse shumë lehtë ajo organizatë do të mund të krijonte aleancë me anglo-amerikanët (Metush Krasniqi ishte i njohur për qëndrimet e tia pro anglo-amerikane) rrjedhojë e së cilës do të vinte ndërrimi i status-quosë në Shqipëri. Por dihet mirë se OZN-a Jugosllave e ka krijuar Sigurimin e Shqipërisë, prandaj është plotësisht e arsyeshme dhe e logjikshme që Sigurimi Jugosllav i ka lënë bishtat e saj aty. Ka shumë fakte që dëshmojnë se këto dy sigurime (nanë e bijë) gjithmonë kanë bashkëpunuar ndërmjetveti, prandaj do të ishte e palogjikshme që të mohohej mundësia a bashkëpunimit ndërmjet tyre edhe në këtë atentat ku të dy klikat (e Beogradit dhe e Tiranës) i mbronin interesat e tyre sunduese dhe partiake. A thua nuk dinte asgjë Sigurimi i Shqipërisë për përgatitjet që i bënte UDB-ja për atentat, kur për të dinin dhe flisnin edhe punëtorët tanë që punonin në Gjermani dhe veprimtarët në Kosovë? Pse vallë diplomatët e Shqipërisë nuk ndërrmuarën kurrfarë masash për ta penguar një akt kaq mizor të Jugosllavisë?

**POROSIA E JUSUFIT: "NË QOFTË SE VRASËSIT JANË SHQIPTARË, MOS U ZBULOFSHIN KURRË!"**

Nuk ka dyshim se urdhërin për atentatin kundër Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës e Kadri Zekës e ka dhënë kreu i lartë i Sigurimit shtetëror të Jugosllavisë, ndërsa kryerjen e urdhërit e ka realizuar Sigurimi i fshehtë serbo-jugosllav. Shtrohet pyetja a do të kishte pasur mundësi ta kryente këtë atentat sigurimi i fshehtë serbo-jugosllav pa ndihmën e spiunëve të tij që i kishte futur në organizatat ilegale që vepronin në Kosovë dhe në botën e jashtme? Përgjigja është negative. UDB-ja jugosllave nuk do të kishte kurrfarë mundësie t'i tubonte tre udhëheqës kryesor të dy organizatave ilegale që vepronin dhe jetonin në Gjermani e Zvicër, për t'i vrarë të tre përnjëherë. Pra organizimin e takimit të tyre në banesën e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës nuk ka mundur ta bënte sigurimi i fshehtë serbo-jugosllav, në kohën kur ata dëshironin, pa ndihmën e spiunëve të tyre, që kishin depërtuar në organizatat ilegale dhe pa ndihmën e Qendrave të spiunimit që ajo i kishte krijuar në qytetet ku jetonin dhe vepronin Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. Sipas fakteve të njohura nga opinionin ynë i gjërë, vijmë në përfundim se në parapërtaditje të atentatit të Shtutgartit kanë marrë pjesë edhe shqiptarë tradhtarë që jetonin dhe vepronin në Gjermani e në Zvicër, të cilët kishin pasur, apo edhe ende kishin kontakte dhe bashkëpunim me udhëheqësit e dy organizatave (LNÇKVSHJ dhe OMLK-së) Jusuf e Bardhosh

Gërvallën dhe Kadri Zekën. Këta shqipëfolës, që ende rrahin gjoks për "atdhedashuri" e kanë ndihmuar Sigurimin e fshehtë serbo-jugosllav duke i njoftuar me të dhëna që kishin të bënin me jetën dhe veprimtarinë patriotike të Jusufit, Bardhoshit dhe të Kadriut; ku banojnë; me çfarë aktivitete të lira merren; me kend shoqërohen, etj. Fatkeqësisht në mesin e veprimtarëve shqiptarë ka të atillë që nuk kuptojnë apo nuk duan të kuptojnë se nuk është njerëzore, nuk është humane dhe nuk është e drejtë të keqpërdoret shpirtmadhësia dhe zemërgjërësia e Jusuf Gërvallës dhe të kërkojnë të mos bëhen hetime për vrasjen e tre Burrave të Dheut, duke e keqpërdorur porosinë e Jusufit i cili menjëherë pas atentatit, (edhe pse me vështitësi fliste nga pasojat e plagëve dhe të gjakderdhjes së tepruar) shprehu brengjen e tij të thellë se mos vrasja e tyre do ta pengonte bashkimin e shqiptarëve dhe të organizatave të tyre, kur i tha bashkëshortes dhe bashkëveprimtarës së tij Syzanës: "Në qoftë se janë (kriminelët-vërejtja ime) shqiptarë mos u zbulofshin kurrë!"

Ajo vrasje makabre, e cila i pat tronditur atëherë shpirtërisht shqiptarët kudo që jetonin, sot pas çlirimit të Kosovës, është bërë brengë e veprimtarëve dhe e atdhetarëve që veprojnë në katër anët e botës, për t'i gjetur shqipfolësit që ndihmuin drejtëpërdrejt dhe tërthorazi në vrasjen e Jusufit, Bardhoshit dhe të Kadriut. Është detyrë njerëzore dhe kombëtare e Prokurorisë së Kosovës, por dhe e Shoqatës së Avokatëve të Kosovës, të ngrenë padinë kundër personave të dyshuar, që kanë mundur të marrin pjesë në atentatin e Shtutgartit. Por për t'iu ra në fërkem kriminelëve shqiptarë që u vunë në shërbim të UDB-së së Beogradit, lypen përgjigje ndaj këtyre pyetjeve: 1). Kush e organizoi ndejën për të shikuar filma shqiptarë në shtëpinë e Murat Kryeziut në Bernhausen, që gjendet në afërsi të Shtutgartit, një ditë para se të ndodhte atentati? 2). Kush i ka sjellë filmat shqiptarë nga Shqipëria në Gjermani dhe kujt iu kanë dërguar ata filma? 3). Kush e pruni Kadri Zekën nga Zvicra në Gjermani, që edhe ai t'i shikonte filmat shqiptarë së bashku me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën. Për dy pyetjet e para opinioni ynë nuk di asgjë, ndërsa sa i përket pyetjes së tretë dihet se Ibrahim Kelmendi ka shkuar nga Gjermania në Zvicër për ta marrë Kadri Zekën. Edhe kjo çështje nuk është e qartë sa duhet deri sa të dihet përgjigja ndaj një pyetjeje tjetër: Si ndodhi kjo, kur dihet se Kadri Zeka, qëkur u fejua me Saime Isufin, kudo që shkonte (edhe në Gjermani) e merrte të fejuarën e tij. Ndërsa tani, kur qenë martuar, çfarë pengesash lindën që Saime Jusufi të mos shkonte me

burrin e saj në Gjermani si herat tjera? Saime Isufi ka për detyrë t'i përgjigjet edhe një pyetjeje po qe se dëshiron të zbardhet kjo vrasje nga organet e drejtësisë së Kosovës: Nga shumë burime flitet se kur është nisur Kadri Zeka për Gjermani, bashkëshortja e tij e ka porositur që, kur të shkojë në Gjermani të lajmërohet nëpërmjet telefonit se si ka kaluar rrugës. Plotësisht ka qenë e drejtë dhe e arsyshme brenga e Saimes për bashkëshortin e saj. Por Saimja duhet të tregojë se kur ia ka thënë atë porosi Kadriut a ishte aty pari Ibrahim Kelmendi apo ndokush tjetër? A ka pasur njohuri Ibrahim Kelmendi se Kadri Zeka ishte i detyruar t'i lajmërohet bashkëshortes së tij me telefon nga Gjermania për t'i treguar se si ka kaluar rrugën?

Dihet se një natë para atentatit, Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla, Kadri Zeka, Ibrahim Kelmendi, Faredin Tafallari e shumë të tjerë janë tubuar në shtëpinë e Murat Kryeziut për t'i parë (nëpërmjet videokasetave) këta filma shqiptarë: "Gërrsheti i lufrave", "Plumba perandorit" dhe "Udha e shkronjave". Siç shpjegon Tafallari, nga mesnata është kryer ndeja. Kadriu ka shkuar për të bujtur te Jusufi. Ndërsa për Ibrahim Kelmendin thotë: "Nuk më kujtohet a i thanë apo jo (fjalën e ka te Jusufi dhe Kadriu-vërejtja ime.) edhe Ibrahim Kelmendit që edhe ai të shkonte me ta, por di se Ibrahim Kelmendi u tha: "Mua më duhet të udhëtoj për Dyseldorf, pasi edhe atje dua t'i tuboj bashkatdhetarët për t'i shfaqur këta filma". Dhe ashtu u bë. Kadriu shkoi me Jusufin e Bardhoshin, kurse Ibrahim Kelmendi me Sylë Nuhën shkuan për Dyseldorf". Kjo që e thotë z.Tafallari bie ndesh me atë që ka thënë I. Kelmendi në një reagim të tij të botuar në Republika nr. 1 të vitit 1997. I. Kelmendi në atë shkrim pranon se me 16 janar (deri kah ora 22.00) ka marrë pjesë në bisedimet që i zhvilluan Jusufi dhe Kadriu për bashkimin e organizatave të tyre, dhe vetëm dy orë para se të bëhej atentati e merr ikën për Dyseldorf. Pra kjo don të thotë se I. Kelmendi nuk ka shkuar për Dyseldorf natën e 15/16 janarit të 1982 (menjëherë pasi i kanë shikuar filmat në shtëpinë e Murat Kryeziut) siç thotë Tafallari, por ka bujtur te Jusufi apo dikund tjetër në afërsi të Shtutgartit.

Për të ardhur deri te e vërteta e plotë se kush nga shqiptarët e ndihmuan Sigurimin e fshehtë Jugosllav për t'i vrarë udhëheqësit e shquar të organizatave ilegale Jusufin, Bardhin dhe Kadriun, duhet të merren në shqyrtim edhe këto çështje: a) Si erdhi Sigurimi i fshehtë Jugosllav deri te informata se Kadri Zeka do të dali te kabina e telefonit

për të biseduar me bashkshorten e tij Saime Jusufin?! (Organizimi i pritës në afërsi të banesës së Jusufit tregon se UDB-ja e ka ditur se Kadriu, Jusufi dhe Bardhi do shkojnë deri te kabina e telefonit). b) Kush ua shpjegoi kriminelëve serbo-jugosllavë që e planifikuan krimin se traditat shqiptare nuk lejojnë në asnjë mënyrë që Kadriu të dilte vetëm te kabina e telefonit, por me te kanë për të dalë edhe Jusufi e Bardhi për ta shoqëruar. Mënyra se si është kryer atentati dhe si u zhvilluan ngjarjet para se të bëhet atentati, tregojnë se ky krim është organizuar në mënyë perfide me ndihmën e njerëzve që kanë qenë në kontakt me Jusufin, Bardhoshin dhe Kadriun. Plani për vrasjen e tyre është shkoqitur nga ekspertë të lartë të lamive të ndryshme serbo-jugosllave, por pa ndihmën e shqiptarëve tradhtarë nuk do të realizohej dot. Dhe ndodhi saktësisht ashtu siç e kishte paraparë Sigurimi i fshehtë serbo-jugosllav. Kriminelët e porositur kishin marrë udhëzime të sakta se ku duhet ta zënë pritën. Ndoshta nuk e kanë paraparë se koha e pritjes do të jetë më e gjatë se sa e kanë paramenduar. Kishte kaluar mesi i natës i 16 janarit dhe kishte filluar pjesa tjetër e natës e 17 janarit të 1982, kur Kadri Zeka i tregon Jusufit se patjetër duhet të dalë deri te kabina telefonike për të folur me bashkëshorten e tij, pasi që Jusufi nuk kishte telefon në shtëpi. Jusufi nuk mund të kundërshtonte atë dëshirë të mysafirit, që ishte e arsyeshme dhe e natyrshme. U ngritën përnjëherë në këmbë dhe dolën jashtë, por Bardhoshi nuk pranonte ta linte vëllain dhe mysafirin vetëm në pikë të natës, pas gjithë atyre fjalëve që dëgjohen ndër shqiptarë se do vritet Jusuf Gërvalla nga UDB-ja e Beogradit. Fatkeqësisht ndodhi siç e kishte planifikuar Sigurimi i fshehtë Jufosllav (në sajë të ndihmës së pakursyer të shqiptarëve tradhtarë). Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi ranë në pritën e UDB-së së Beogradit afër garazhes ku e kishte pasur veturën Bardhoshi. Kriminelët e kryen krimin në territorin e një shteti të huaj, pa u frikësuar se do të zbulohet dhe ikën. Shtypi gjerman ka folur shumë për atë ngjarje që i tronditi shqiptarët kudo që jetonin ata. Janë dhënë shumë variante se kush ka mundur ta bëjë këtë krim, por variantin më të besueshëm e ka dhënë gazeta gjermane "Shtern".

Ajo gazetë i ka publikuar disa fakte që në asnjë mënyrë nuk mund të hudhen poshtë. Sipas gazetës, një shofer që i përkiste ambasadës Jugosllave, duke u kthyer nga Austria për në Gjermani ishte ndalur nga Sigurimi i fshehtë Gjerman, dhe pas hetimeve të para, shoferi ka deklaruar se nga Gjermania i ka përcjellë deri në Austri tre vetë, njëri prej

tyre i kombësisë shqiptare, të cilët në kabinën e parë telefonike që e kanë hasur gjatë rrugës e kanë lajmëruar dikend në Beograd se "e kanë kryer punën për të cilën ishin zotuar". Shoferi i paska lanë në Ausri dhe qenka kthyer për Gjermani. Se pse Gjermania nuk i ka çuar deri në fund hetimet për t'i gjetur kriminelët është çështje tjetër, por shtrohet pyetja a do të kishin mundësi të kryenin krimin ata tre kriminelë pa ua përgatitur terenin shqiptarët e ligj, pa iu ndihmuar tradhtarët e kombit shqiptar. Për të ardhur deri te e vërteta e plotë se kush nga "shqiptarët"ndihmuan Sigurimin e fshehtë Jugosllav drejtpërdrejt dhe kush tërthorazi, kush me vetëdije e kush pa vetëdije për t'i vra Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën e Kadri Zekën është e domosdoshme që opinioni i gjërë të kërkojë sqarime të nevojshme prej njerëzëve që më së shumti ishin të përfolur pas atentatit të Shtutgartit:

1) Rizah Salihu; duhet të sqarojë se për çfarë arsyeje pat shpifur për Jusuf Gërvallën se "ishte i dërguar nga UDB-ja", dhe pse u mundua ta bindë Hysen Gegën që duhet ta vrasë Jusuf Gërvallën. Kush propozoi (Rizah Salihu, apo Ibrahim Kelmendi) që të formohet "Komiteti për vrasjen e Jusuf Gërvallës" Si e lexonte postën sekrete të Jusuf Gërvallës, kur adresen e tij e dinte vetëm Ibrahim Kelmendi?

2) Ibrahim Kelmendi; duhet të sqarojë se kush e ka organizuar takimin në shtëpinë e Murat Kryeziut për t'i shikuar filmat shqiptarë? Me propozimin e kujt shkoi në Zvicër ai për ta marrë Kadri Zekën për t'i shikuar filmat shqiptar? Kur ka shkuar ai në Dyseldorf, më 16 apo 17 janar 1982? Ku ka bujtë ai më 16 janar 1982? Duhet të ndriçojë faktin se në çfarë rrethanash ai u gjind natën e kobshme të 16 janarit 1982 me Jusuf dhe Bardhodh Gërvallën e me Kadri Zekën deri dy orë para se të bëhet atentati mbi ta, dhe pastaj arriti të ikë pa pasur kurrfarë pasojash?

3) Sadik Blakaj; duhet të sqarojë burgosjen e Hysen Gegës? Pse dhe qysh e bindi Demë Demajn që të mos marri pjesë në tubimin festiv të 28 Nëntorit- Ditës së Flamurit ku, siç dihet, ka penguar të jepet shfaqja e përgatitur nga Tafallari me shokë? Etj.

4) Hysen Gega; duhet të sqarojë në lidhje me shpifjet e Rizah Salihut kundër Jusuf Gërvallës. Të tregojë për kontaktet dhe bisedat që i pat me Rizah Salihun, Ibrahim Kelmendin, Sadik Blakën, Demë Demën që kishin të bënin me Jusuf Gërvallën etj.. Të tregojë për takimin e parë që e pati me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën në banesën e tyre. Të tregojë si u burgos dhe a ishte fajtor Sadik Blakaj që ra në duar të UDB-së



jugosllave. Të japi sqarime se a është e vërtetë apo gënjeshtër se ai i përkiste një "komiteti" që merrej me vrasjen e Jusuf Gërvallës, etj.

5) Demë Demaj; duhet të sqarojë marrëdhëniet që i kishte me Sadik Blakën, Ibrahim Kelmendin dhe Rizah Salihun. Në veçanti duhet t'i sqarojë shkaqet e prishjes së tij me Faradin Tafallarin. Pse nuk u burgos në Kosovë edhe pse ishte burgosur Hysen Gega tre muaj para se ta merrnin në pyetje policët e Sekretariati i Punëve të Brendshme të Kosovës, në marsin e vitit 1981, kur siç dihej, Sadik Blakaj i kishte zbuluar raportet e H.Gegës me Demë Demën?

Opinionin shqiptar e ka të qartë nga përvoja e hidhur gati 100-vjeçare se Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën dhe Kadri Zekën na i ka vra "parja e shkaut" me dorën tradhtare shqiptare. Fatkeqësisht prej Luftës së Dytë Botërore, ortak me "dorën e zezë" serbe për të vranë shqiptarë, u bënë edhe bajraktarët e farës ruse të njohur përtej kufiri si stalinistë-enveristë të përbetuar, ndërsa këndej kufiri si rankoviçefc-jugosllav pa kombësi, (llumi i shoqërisë shqiptare) të cilët për idealet komuniste nuk lan të zezë pa e bërë. Po ata vranë shqiptarë që nuk e dashtën ideologjinë komuniste; vranë shqiptarë që nuk e dashtën vëllazërim-bashkimin me serbin; vranë shqiptarë që nuk donin kolektivizimin e pasurisë së tyre; vranë shqiptarë që nuk pranonin zakonet ruse në familje; vranë shqiptarë për t'ua marrë pasurinë që e krijuar me djersën e ballit; vranë shqiptarë që e donin më tepër shqiptarinë se sa ideologjinë komuniste. Sidomos u bë i ashpër llumpenproletariati shqiptar kundër aristokracisë shqiptare që i kishte vënë bazat e një shteti modern demokratik në Shqipëri, ndërsa në Kosovë u bë i ashpër kundër shpianikëve dhe pleqnarëve shqiptarë që krijuan bazën e fillozofisë dhe të Drejtës (Kanunit) shqiptar.

Pas vrasjes me atentat të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës në afërsi të Shtutgartit, presioni i veprimtarëve mbi organizatat e tyre për t'u bashkuar në një organizatë të vetme u shumfishua. Si rrjedhojë e gjithë atij presioni, në kryeqytetin e Turqisë në Ankara, më 17 shkurt 1982, pra një muaj pas atentatit, erdhi deri te takimi në mes përfaqësuesve të "Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare në Jugosllavi" (LNÇKVSHJ) dhe të "Partisë Komuniste Marksiste- Leniniste Shqiptare në Jugosllavi" (PKMLSHJ), që të bisedojnë për bashkimin e këtyre organizatave në një organizatë të vetme. Nga ana e LNÇKVSHJ muarën pjesë Sabri Novosella dhe Xhafer Durmishi. Ndërsa nga ana e PKMLSHJ muarën pjesë Avdulla

Prapashtica, Osman Osmani dhe Faton Topalli. Në këto bisedime, (dhe më vonë), LNÇKVSHJ nguli këmbë që të ruhet emri i gazetës së LNÇKVSHJ- "Zëri i Kosovës" dhe emri Lëvizje, ku fjalët e asaj kohe si Parti Komuniste e Organizata marksiste- leniniste u zëvendësuan me emrin Lëvizje për Republikë. Kjo ka qenë një zhvendosje nga orientimi klasor në orientimin kryesisht kombëtar.

Më në fund përfaqësuesit e dy organizatave njëzërit i prunë këto vendime: a) Formohet "Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi" (LRSHJ) nga bashkimi i organizatave të lartëpërmendura, b) Udhëheqjet e dy organizatave që u bashkuan do ta përbënin udhëheqjen e LRSHJ deri në zgjedhjet e rregullta. c) Organi i LRSHJ do të jetë "Zëri i Kosovës" (më parë ishte organ i LNÇKVSHJ). d). Të dilet me një komunikatë në Kosovë dhe në botën e jashtëme për t'u njoftuar opinioni i gjerë për formimin e LRSHJ. Pas tre muajsh, më 15 maj të 1982, kësaj organizate i bashkohet edhe OMLK-ja dhe kështu u vërtetua se qëndrimi i LNÇKVSHJ në lidhje me bashkimin e organizatave ishte më i arsyeshëm dhe më i drejtë. Xhafer Durmishi, në një shkrim të pabotuar, i ndriçon rrethanat dhe pengesat që lindën pas formimit të LRSHJ. Ai thotë: "Unë e Osman Osmani u kthyem në Gjermani më 22 shkurt 1982. "Zëri i Kosovës", numri i tretë, ishte në fazën përfundimtare. Unë pritja që të dalë si organ i LRSHJ. Ndërrimi në kokën e organit nga LNÇKVSHJ në LRSHJ ishte një çështje tepër e thjeshtë. Osman Osmani ndërhyri duke thënë: "Le të dalë edhe ky numër si organ i LNÇKVSHJ në mënyrë që armiku të mos kujtojë se mbas atentatit u shkatërrua LNÇKVSHJ. Si intrigant i talentuar e me udhëzime nga Stambolli, ne në rrethin e Shtutgartit nuk e kundërshtuam në këtë pikë. Ne e shtypëm komunikatën në 2000 ekzemplarë për ta komunikuar bashkimin, por Osmani prapë ndërhyri me arsyetimin: "Komunikata nuk bën të shpërndahet njëkohësisht me Zërin se mund të lindin keqkuptime..? Por të gjitha këto ishin dredhi e intriga të cilat kishin për qëllim të vononin çështjen deri më 15 maj, në mënyrë që aty të shtrohej prapë çështja e emrit të gazetës për LRSHJ. Pra, në këtë pikë ku ata vetëm nuk kishin mundur të bënin asnjë ndryshim, shpresonin tani- më 15 maj- se me ndihmën e Xhafer Shatrit do të bënin ndërrimin e emrit të organit".

Pra, nga rrëfimet e Xhafer Durmishit po shihet se pas nxerrjes së vendimit për formimin e LRSHJ, menjëherë filluan komplotet për moskonstituimin e saj nga Osman Osmani, (përfaqësues i PKMLSHJ) që

për pasojë pati mosinformimin me kohë të opinionit të gjerë për vendimet e takimit të Ankarasë dhe Zëri i Kosovës të dalë edhe një numër (numri tre) si organ i LNKVSHJ, edhe pse ai duhej të dilte si organ i LRSHJ. Xhafer Durmishi në shkrimin e tij të cekur më parë na jep një kronologji të shkurtër të veprimtarisë së organizatave dhe veprimtarëve që vepruan në Evropën Perendimore. Ai, kur bën fjalë për veprimtarinë që u krye pas atentatit të 17 Janarit të 1982, me pika të shkurtëra do t'i japë këto të dhëna:

"Mars 82: Del numri i Zërit të Kosovës (pas atentatit të 17 janarit) nga Xhafer Durmishi, i cili u ndihmua nga Syzana Gërvalla e aktivistë të rrethit të Shtutgartit; Prill 82: Demonstratë e shqiptarëve në Vjenë. Maj 82: Demonstratë e shqiptarëve në Bon. Në Biel-Bien takohen Xhafet Shatri, Oaman Osmani dhe Xhafer Durmishi. Përkundër kërkesave të Osman Osmanit dhe të Xhafer Shatrit për ndryshimin e emrit të organit, "Zëri i Kosovës" mbetet organ i LRSHJ.

Në takim ndahen detyrat, ku Xhafer Durmishi ngarkohet të vazhdojë me nxerrjen e organit të Lëvizjes, punë të cilën e bëri gjerë në mars 83. Takimi i 15 majit 82 është i pari dhe i fundit ku ishte e pranishme ajo pjesë që rridhte nga PKMLSHJ. Qershor 82: Del në Shtutgart numri i parë i Zërit të Kosovës si organ i Lëvizjes për Republikë.(e përgatit Xh. Durmishi-Vërejtja ime). Më 26/6 demonstratë shqiptare në Bern, ditën e fillimit të punimeve të Kongresit XII të LKJ. Janar 83: Mbledhje në banesën e Hafiz Gagicës. Marrin pjesë Xhafer Shatri, Hasan Mala, Ibrahim Kelmendi, Xhafer Durmishi. Zgjidhet Qendra Ekzekutive (emër i propozuar prej Xhafer Shatrit) e Lëvizjes. Ndahen këto detyra: Xhafer Shatri- nxerrjen e gazetës, Faredin Tafallari-arkatar, Hasan Mala lidhjet me Kosovën, Ibrahim Kelmendi lidhjet me organizata të jashtme, Xhafer Durmishi-çështjet organizative në mërgim, relacionet me klubet shqiptare.

Mars 83: Del numri i dytë i Zërit të Kosovës në Gjenevë nga Xhafer Shatri dhe Xhafer Durmishi. Dhe pas përfundimit të punimeve bëhet një mbledhje e Qendrës Ekzekutive. Hasan Mala dhe Faredin Tafallari votojnë për pikëpamjet e Xhafer Durmishit lidhur me qëndrimin ndaj klubeve shqiptare në mërgim. Korrik 83: Në një shtëpi malore në Zvicër bëhet një tubim i madh i aktivistëve më të dalluar të Lëvizjes në Evropë si dhe përfaqësues klubesh. Mirret një vendim për themelimin e një Bashkësie të klubeve shqiptare dhe demaskohet puna intriguere e

PKMLSHJ. Në mbledhjen e Qendrës Ekzekutive që mbahet pas tubimit Xhafer Durmishi kërkon dorëheqje për shkak të pikëpamjeve të kundërta me Ibrahim Kelmendin e Xhafer Shatrin në çështjen e klubeve shqiptare dhe punën e tyre".

PSE U IDEOLOGJIZUA LËVIZJA, KUR NË JANAR TË VITIT 1985, NË NJË MBLEDHJE TË REDAKSISË VENDOSËN QË NGA BALLINA E ORGANIT TË LËVIZJES TË HIQET CITATI I JUSUF GËRVALLËS?

Edhe z.Tafallari në librin e tij shkruan për mbledhjen e janarit të 1983, edhe pse për shkaqe objektive nuk kishte marrë pjesë në të. Ai thotë: "Xhafer Shatri, Hasan Mala, Xhafer Durmishi dhe Ibrahim Kelmendi ishin tubuar në banesë të Hafiz Gagicës në Ludswigsburg për të formuar Komitetin Qëndror të LRSHJ. Pra u formua KQ dhe detyrat u ndanë kështu: Xhafer Shatri kryetar, Xhafer Durmishi për organizimin, Hasan Mala për lidhje brenda në Kosovë, Ibrahim Kelmendi për organizatat e huaja dhe unë si arkatar. Të nesërmen erdhi në spital për të më vizituar Xhafer Durmishi që më tregoi për mbledhjen dhe më uroi për detyrën e arkatarit. E falënderova për besimin dhe e urova edhe atë për detyrën. Ky forum pra do të ishte përgjegjës për Lëvizjen në botën e jashtme". Siç shihet z.Tafallari e quan KQ, Qendren Ekzekutive, (që e ka të njëjtin funksion-kuptim) por e plotëson Xhafer Durmishin kur thotë se Xhafer Shatri përpos që është zgjedhur përgjegjës për gazetë është zgjedhur edhe kryetar i Lëvizjes për jashtë. Pra, u desh të kalojnë plot 11 muaj nga takimi i Ankarasë, për ta zgjedhur udhëheqjen e Lëvizjes, por siç po shihet- në atë udhëheqje mungonte përfaqësuesi i PKMLSHJ. Kjo tregon se forcat rrënuese në Lëvizje (LRSHJ) ishin shumë më të fuqishme se sa forcat e mirëfillta kombëtare dhe se bashkimi i organizatave është bërë sa për sy e faqe për ta neutralizuar presionin e anëtarësisë së organizatave që kërkonin bashkimin e organizatave në një organizatë të vetme, sepse interesat grupe dhe ideologjike ishin shumë më të theksuara sesa interesat e përgjithshme kombëtare. Merre me mend se ku e çon njeriun logjika moniste-komuniste. Sipas kësaj logjike ai që bëhet kryetar duhet t'i ketë nën dominimin e tij të gjitha mekanizmat e dominimit, në rend të parë mjetet e opinionit publik. Dhe në bazë të kësaj logjike, pasi që Xhafer Shatri u bë kryetar i Lëvizjes, medomos është dashur të jetë edhe përgjegjës i Zërit të Kosovës. Prandaj është dashur të silllet makina e Jusuf Gërvallës nga Gjermania në Zvicër-Gjenevë (me

plot rrezeqe); është dashur të vijë Xhafer Durmishi nga Gjermania në Zvicër për ta mësuar Xhafer Shatrin se si punohet me makinë dhe si përgatitet teknikisht gazeta, në vend se të mbetet teknika e shtypit ku ishte në Gjermani dhe ta nxirrte organin e Lëvizjes Xhafer Durmishi, siç i kishte nxjerrë më parë dy numra të Zërit të Kosovës. Kjo tregon se interesat grupe-ideologjike mbisundonin qysh nga momenti kur është krijuar udhëheqja e Lëvizjes dhe se, qysh nga ai moment kur është vendosur të krijohet Lëvizja, ka filluar për ta brejtur atë krymbi i interesave personale-klanore. Pra që nga ajo mbledhje, (Mbledhja në banesën e Hafiz Gagicës) selia e Lëvizjes kalon nga Gjermania-Shtutgarti në Zvicër-Gjenevë-Bil-Bien, dhe OMLK-ja e merr udhëheqjen e Lëvizjes, (pasi që i pari i saj i merr dy postet kryesore të organizatës, pra bëhet përgjegjës-kryetar i Lëvizjes për jasht dhe kryeredaktor i Zërit të Kosovës). Faktet tregojnë se Lëvizja çdo ditë që kalonte futej në një rrugë të pa krye, kur interesi personal, klanor dhe ideologjik dominonte mbi atë kombëtar. Dredhitë, ndërkamcat dhe mashtrimet u bënë vyrtite të një pjese të udhëheqjes së Lëvizjes. Siç thotë z.Tafallari "Me ndihmën e Xhafer Shatrit arritën të dalin jashtë vëllezërit Emrush dhe Mustafë Xhemajli. Xhafer Shatri i kooptoi në redaksinë e Zërit të Kosovës si dhe në udhëheqjen e Lëvizjes. Mirëpo këta të dy, të ndihmuar edhe nga Ibrahim Kelmendi, u përpoqën që ta ideologjizojnë Lëvizjen." Faktet dëshmojnë se përpjekjet e tyre nuk shkuan huq. Lëvizja plotësisht u ideologjizua kur në janar të 1985, në një mbledhje të redaksisë, vendosën që nga ballina e organit të Lëvizjes të hiqet citati i Jusuf Gërvallës: **"Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme"**. Dhe në vend të këtij citati të vendosej: "Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!".

Si kanë rrjedhur ngjarjet e mëtutjeshme në lidhje me veprimtarinë e aktivisë që vepronin në LRSHJ-LRSSHJ-LPK-në dhe përçarjet e thella që u krijuan gjatë vitit 1983-1999 është një temë më vete dhe nuk e ka vendin në këtë shkrim, por duhet thënë se me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës e të Kadri Zekës nga UDB-ja e Beogradit dhe nga UDB-ja e Tiranës, të ndihmuar nga tradhtarë dhe burra të ligj shqiptarë, Lëvizja jonë kombëtare muar një goditje tepër të rëndë, goditjen më të rëndë pas shkatërrimit të NDSH-së. Ajo (LRSHJ), qysh

me formimin e saj, muar goditje të rënda prej UDB-ës së Tiranës kur futën përçarje në mesin e bajraktarëve të Lëvizjes, ndërsa UDB-ja e Beogradit, si çdo herë më parë, dinte ku të godasë. Gjenu ynë popullor na mëson se "rrufeja nuk godet në fshisa por në lisa".

UDB-ja vazhdoi me vrasjen e Burrave të Dheut, që punonin për shqiptari. Ajo nuk e ndali veprimtarinë e saj vrastare pas atentatit të Shtutgardit, por e vazhdoi edhe më tutje të vrasë burrat më të mirë të kombit. E mbyti në burgun Qendror të Beogradit Zija Shemsiun, një veprimtarë të dalluar të çështjes kombëtare. Në Prishtinë, pas një qëndrese heroike, i vranë Rexhep Malën dhe Nuhi Berishën. Nuk vonoi shumë, e vranë atdhetarin Bajram Baftirin, etj. Në tetor të 1986 vdes në Spitalin e Prishtinës Metush Krasniqi nga pasojat e keqtrajtimeve që iu bënë sa ishte në Burgun hetues të Prishtinës. Më 1990 e vranë Enver Hadrin, kur ishte në vlugun e punëve për t'ua treguar fytyrën e vërtetë kriminelëve të Beogradit, etj. Fatkeqësisht Lëvizja (LRSHJ-LRSSHJ-LPK-ja) nuk qe e zonja të bënte pastrimin e radhëve të saj nga elementë përçarës dhe spiunë të UDB-së së Beogradit dhe spiunëve të UDB-së së Tiranës. Sot vetëm kokëkrisurit dhe naivët nuk janë duke e parë veprimtarinë antikombëtare të Lëvizjes-LPK-dhe të derivateve të saj: PDK-së dhe AAK-së. Koha po punon për shqiptarët dhe për shqiptarinë! Të Madhin Zot e kemi në anën tonë! Edhe Amerikën e fuqishme i Plotfuqishmi Perendi e ka urdhëruar të na ndihmoi. Kryephlivanat e Nanosit, shërbëtorët e tyre dhe bajraktarët e farës ruse e kanë fatin e zi! Përfundimin e kanë të trishtueshëm! Të gjithë do të përjetojnë fatin e "Babës së farës ruse"! Do të jenë të vdekur për së gjalli!

*Botuar: "Bota sot" më 26 shkurt -9 mars 2002*

*PS. Nëntitujt i ka vënë redaksia.*

# **ME RASTIN E DYVJETORIT TË QËNDRESËS DHE SAKRIFICËS SË FAMILJES SË SHABAN MURAT JASHARIT**

## **VEPRA E TIJ KOMBËTARE-FRYMËZIM PËR BREZAT E RINJ**

Me ngadhnjimin e rebelimit bolshevik në Shqipëri më 1997, faktori i Shqipërisë dhe i Shtetit shqiptar, që duhej të ishte faktori më i fortë dhe mbrojtësi legjitim i zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës e Viseve tjera shqiptare, u zhduk. Për Serbinë, Greqinë dhe aleatët e tyre tradicionalë ishte kjo një fitore me rëndësi për realizimin e planeve strategjike antishqiptare që i kishin thurur qysh moti ujqit e uritur serbo-sllavo-grekë.

Veprimtaria politike e subjekteve shqiptare " dikush thumbit dikush patkonit" dhe status-quoja e krijuar prej tyre "prit gomar sa të dali barë" ishte bërë vdekjeprurëse për çështjen madhore kombëtare. Fatmirësisht në të gjitha periudhat vendimtare të historisë sonë më të re, rinia jonë heroike muar pjesë drejtëpërdrejt në ngjarjet që çuan përpara zgjidhjen e çështjeve madhore kombëtare. Riaktivizimi i njëjësive guerile të komanduara nga Adem e Hamzë Jashari, Zahir Pajaziti dhe Salih Çeku që kryenin akcione ilegale në Llap, Prishtinë, Drenicë dhe Dukagjin, si dhe lindja e lëvizjes studentore për rimarrjen e objekteve shkollore dhe universitare, që treguan pjekuri politike dhe aftësi organizative, me demonstrata dhe manifestime që i organizuan në Prishtinë e qytete tjera të Republikës së Kosovës, arritën ta ndërrojnë status-quonë dhe ta mundin frikën, që ishin kultivuar me mjeshtri disa vite më radhë. Por ndikuan fuqishëm edhe në Qendrat e vendosjes ndërkombëtare dhe në opinionin e gjërë për domosdonë e zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës.

Përmbysja me dhunë e demokracisë së brishtë në Shqipëri dhe ardhja në pushtet e social-komunistëve nën udhëheqjen e Nanosit, për Qendrën antishqiptare që u krijua nga serbët, grekët dhe aleatët e tyre tradicional, ishte një fitore me rëndësi, pasi që realizuan pjesën e parë të planeve strategjike për zhdukjen e kombit shqiptar para përfundimit të shekullit të 20-të. Por armiqët tanë nuk ishin të kënaqur po qe se nuk realizonin edhe planet tjera që kishin të bënin me zgjidhjen e çështjes

shqiptare siç ua donte interesi i tyre kombëtar, prandaj kërkuan ndihmën e Nanosit, që ishte më i përshtatshëm për t'i ndihmuar aleatës së Greqisë, Serbisë, që edhe Kosovën ta përfshijë një variant i "revolucionit të vonuar demokratik" të Shqipërisë. Nanosi i thirri t'i shkojnë në Tiranë njerëzit e tij të besueshëm, që nuk dinë t'i kthejnë fjalë, R.Qosjen dhe H. Hysenin, për t'ua dhënë detyrat, por edhe u premtoi se do t'i bëjë në Kosovë të parë. Këta të zgjedhurit e Nanosit, pasi e përçanë LDK-në, bënë përpjekje për pengimin e mbajtjeve të Zgjedhjeve të dyta Presidenciale dhe Parlamentare dhe nuk i njohën ato, siç nuk i njohën as shkijet gjakatarë. Nanosi, duke ditur se rritja dhe forcimi i njësisë ushtarake në Kosovë jo vetëm që do ta pengonte realizimin e planeve të fshehta serbo-greko-ruse, që kishin të bënin me shqiptarët dhe tokat e tyre, por do të rrezikonte edhe pushtetin e tij në Shqipëri, i dha detyra konkrete pararojës staliniste të LPK-së dhe karrieristëve të sëmurë për pushtet të LBDK-së, ta marin udhëheqjen e njësisë guerile me mjete të stërholluara (perfide) dhe me anën e kompleteve, duke u premtuar ndihma pa kursim, që do t'u japë SHIK-u dhe njerëzit më besnikë të tij. Nanosi duke e ditur kapacitetin e kokës komanduese të pararojes staliniste të LPK-së, e cila nuk ishte në gjendje të bëjë propagandën e duhur për t'i përçarë sa duhet dhe si duhet shqiptarët në diasporë, iu dha atyre kuadro të specializuara për arritjen e atyre qëllimeve siç ishin Koço Danaj dhe Bedri Islami, oficerë të lartë të Sigurimit të Shqipërisë. "Pionierët e Enverit", pasi i kryen detyrat e para në Kosovë, edhe në diasporë i muarën detyrat tjera që duhet t'i kryenin sa më parë. Duhej përshpejtuar luftën frontale në Kosovë, pasi që, në mënyrën ilegale siç vepronin njësitë guerile, nuk kishin mundësi shkijet të ndërmerrnin aksionet e "tokës së djegur" në Kosovë. Nanosi me kompani nuk donte konsolidimin e forcave politike dhe ushtarake të Republikës së Kosovës, por donte të mbretërojnë ndarjet dhe përçarjet, kaosi politik dhe organizativ. Atë punë e kryen me zell përpos "pionerëve të Enverit"( në krye me H.Hysenin) edhe karrieristët e sëmurë për pushtet që nuk ishin drejtëpërdrejt nën komanden e tij. Drenica u shpall nga pararoja staliniste e LPK-së dhe "Zëri i Kosovës", "territor i çliruar" i Kosovës. Gazetarët që punonin për shkije, rus dhe grekë dërgoheshin në Drenicë nga pararoja staliniste për të "vërtetuar" rrenat e tyre se Drenica "është e çliruar". Dhe kështu stalinistët e Nanosit iu dhanë material e "fakte" shkijeve për ta mbushur Kosovën me policë dhe ushtarë, që lufta të përshpejtohet dhe shqiptarëve të mos u lihet kohë të përgatiten për



luftën, që tani ishte e qartë si drita e diellit se do të fillojë. Pararoja staliniste pasi i futi njerëzit e tyre me mjete të stërholluara (perfide) në Grupin koordinues të njërive guerile të Republikës së Kosovës, nën maskën e "bashkëpunimit" dhe koordinimit të punëve dhe ndihmës financiare, dikund në kafenetë e stacioneve të trenit në Zvicër, njësitë guerile që vepronin në Llap, Prishtinë, Drenicë dhe Dukagjin, të cilat udhëhiqeshin nga Adem e Hamzë Jashari, Zahir Pajaziti dhe Salih Çeku i pagëzuan me: "UÇK", ndërsa Grupin koordinues që e formoi Zahir Pajaziti me shokë për t'i koordinuar aksionet në tërë Kosovën e shpallën "Shtab Qendror" pa i pyetur fare se a iu pëlqen a nuk iu pëlqen pagëzimi, a iu pëlqejnë apo nuk u pëlqejnë "Komunikatat", që i shkruanin stalinistët e LPK-së në emrin e tyre në Zvicër, apo në Tiranë.

Fatkeqësisht Qeveria e Kosovës nuk ishte në gjendje të kuptojë ndryshimet që u bënë. Nuk u tregua e zonja t'i kryejë detyrat që ia ka përcaktuar Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Vetëm atëherë kur ushtarakët e Kosovës që gjindeshin në Evropën Perendimore, të cilit ishin të organizuar dhe të gatshëm për t'i kryer detyrat që ia shtronte Qeveria e Kosovës, kërkuan nga Bukoshi- në fillim të vitit 1998-, që sa më parë ta formojë Ministrin e Mbrojtjes. Së bashku me kërkesën ia dërguan edhe nënshkrimet e koordinatorëve, që Kolonel Ahmet Krasniqin e njohin udhëheqësin dhe njeriun e tyre të parë. Qeveria e Kosovës filloi të shpurthi, të lëvizi nga vendi, dhe në një mbledhje të saj në muajin mars të vitit 1998, e emëroi Kolonel Ahmet Krasniqin Kryes i detyrës së Ministër të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës. Por formimi i Ministrisë ishte vonuar shumë. Tirana nuk mbronte më interesat shqiptare. Udhëheqja e saj ishte lidhur me këmbë e kokë me serbë e grekë nëpërmjet marrëveshjes që e kishte firmosur Nanoisi në Kretë. Ministria e Mbrojtjes së Kosovës me seli në Tiranë u bllokua që nga dita e parë. Pengohet nga argatët e Nanosit, spiunët e Sigurimit të Shqipërisë, siç ishte Xhavit Haliti, Ibrahim Kelmendi e të tjerë, që- me vetëdije apo pa të- ishin të lidhur edhe me UDB-në e Jugosllavisë, pasi që punën të cilën e kryenin, duke i zbatuar urdhërat e Nanosit shkonin në dobi të Serbisë, Gëqisë dhe Rusisë.

Të njëjtën punë si të parët e kryen edhe karrieristët e sëmurë për pushtet të LBDK-së me në krye Qosen dhe Hysenin, pasi nuk lejuan bashkimin e faktorit politik dhe ushtarak të Kosovës. Këta të gjorë, ia lehtësuan shumë punët Serbisë për ta mbushur Kosovën me policë,

ushtarë dhe paramilitarë. I zuri Serbia pikat strategjike në Kosovë me armatim të rëndë, për ta rrahur me hekur dhe zjarr në çdo pjesë dhe cep të saj, pa vështirësi, prej së largu, pa e rrezikuar fare këmbësorinë e ushtrisë së saj, dhe priste momentin e duhur për ta filluar fushatën e "tokës së djegur", për ta bërë spastrimin etnik të Kosovës, siç parashihnin planet e saj. Nanoisi urdhëroi të mbushet Kosova me kallashët që bandat e tij e kallën Shqipërinë dhe i bindi kokëkrisurit e LPK-ës dhe të LBDK-së se me ta do ta kallin dhe shkatërrojnë Serbinë, se lehtë do ta bëjnë "bashkimin kombëtar", por duhet të udhëhiqen nga ideologjia e markësizëm –leninizmit dhe internacionalizmit proletar. Nuk lejonte Nanoisi të hynin në Kosovë armatime që bëjnë punë e që gjindeshin në Shqipëri, as armatime të rënda që Ministria e Kosovës mund t'i siguronte nga jashtë, se atëherë do të quhet tradhtar nga patronët e tij.

Testimi i parë i Serbis u bë në Drenicë për të parë përgatitjen ushtarake të njërive guerile dhe gatishmërinë e popullsisë. Është e gatshme për t'u mbrojtur apo për të ikur?! Forcat e armatosura të Serbisë i masakruan në shkurt të vitit 1998 familjet Ahmetaj, Sejdiu dhe familje tjera, por syrin ia kishin vënë familjes së Shaban Murat Jasharit, që ishte në dosjet e Serbisë si familje armike, që kishte punuar dhe luftuar kundër shkaut pa kursim. Si të mos e urrenin për vdekje mësuesin veteran Shaban Jasharin i cili pasi kreu Medresenë e Shkupit, kreu detyrën e mësuesit duke hapur dritë dhe dituri në Drenicën e Hasan Prishtinës e Ahmet Delisë, të Azem Bejtes dhe Shote Galicës, në Drenicën e kuqe të Shaban Polluzhës dhe Mehmet Gradicës, në Drenicën shpresëdhënëse të Fazli Grajqefcit e mijëra dëshmorëve të rënë në altarin e lirisë për çështje madhore kombëtar. Si të mos e urrente shkau i shkinës Shaban Jasharin që ishte njëri ndër veprimtarët e parë të organizatës së NDSH-së, Shaban Jasharin që kurrë nuk i ndërpreu lidhjet me veprimtarët e saj që gjendeshin në Kosovë dhe Evropë. Po, atdhetari nacionalist Shaban Jashari i edukoi djemtë e tij ta urrejnë shkaun dhe vetë ai ua gjeti lidhjet për t'i organizuar me atdhetarë për ta vazhduar punën e tij, se ishte plakur e nuk donte që me vdekjen e tij të shuhej një veprimtari, që edhe ai e kishte marrë stafetë nga babai i tij.

Atdhetari i spikatur Shaban Murat Jashari në vitin 1982 pasi kishte shkuar në Stamboll për t'u takuar me atdhetarin nacionalist, Komandantin e Forcave të Armatosura të Organizatës së NDSH-së, Hysen Tërpezën, për t'i mbajtur lidhjet si shumë vjet më parë, në atë rast takohet edhe me

Sabri Novosellën, që e njoftoi mixhën Shaban se e ka një Celulë të cilën e udhëheq Imer Berisha në Prishtinë, dhe ia dha ca porosi dhe ca material propogandistik për t'ia përcjellë atij. Mixha Shaban kthehet në Prishtinë, e kryen porosinë, por pas një muaji, në mars të vitit 1982, e sjell djalin e tij Hamzën te Imer Berisha për ta angazhuar në radhët e LNÇKVSHJ, në Organizatën e Metush Krasniqit dhe Jusuf Gërvallës, që ishte vazhduesja e NDSH-së. Po mixha Shaban disa herë kishte shkuar në Stamboll për të marrë material propogandistik dhe për të përcjellë informata në mes udhëheqjes që vepronte në Kosovë dhe në diasporë. Po, atdhetari nationalist Shaban Jashari, ishte ai që i këshillonte djemtë, nipat dhe mbesat dhe gratë e fisit se për Atdhe e për shqiptari nuk është gjë vdekja, se duhet flijuar kur e lyp nevoja jo vetëm pasuria por edhe jeta. Atdhetari i zgjuar Shaban Jashari nuk ishte prej atyre që i merrte gjërat e gatshme si ia japin të tjerët, ai i analizonte mirë e mirë ngjarjet politike që ndodhnin në Kosovë, në hapësirën kombëtare dhe në atë ballkaniko-evropiane. I studjonte me logjikën e fillozofisë popullore shqiptare, dhe vlerësimet e tija kurrë nuk dilnin të gabuara. Ai ishte i vetëdijshëm se shkau po përgatit masakra në Kosovë. E dinte se do të sulmohej familja e tij dhe e bashkëfshatarve të tij por çka mund të bënte ai për t'i penguar shkjet gjakatarë?! Gjërat më të mira, që ai dinte t'i bënte në moshën e tij, i bëri duke iu dhënë zemër bashkëfshatarëve, fëmijëve dhe grave të fisit se duhet të qëndrojnë në shtëpiat e tyre siç qëndruan brez pas brezi shqiptarët, dhe- po qe se e lyp nevoja- të mbrohen trimërisht me armë në dorë, se kështu ata e mbrojnë Atdheun, Nderin, Lirinë dhe Shqiptarinë, se ashtu kultivohet e forcohet Krenaria Kombëtare. Por, një gjë e dinte shumë mirë atdhetari nationalist Shaban Jashari, që e dinte edhe tërë Drenica heroike, epiqendra e kryengritjeve të shpeshta shqiptare kundër armiqve tanë, që shkjetë kishin synime të na i marrin viset tona të bukura e të pasura të cilat i Madhi Zot na i fali për t'i gëzuar ato brez pas brezi deri sa kjo botë të ekzistojë. Po dinin dhe e kishin të qartë se shtëpia e Shaban Murat Jasharit nuk do të dhunohet nga hordhitë e egra të Karpateve të Rusisë, nga shkjet gjakatarë, dhe se askush nuk do t'ua çelë derën kriminelve si mikut kur i hapet dera, për t'i dhënë mirëseardhje, por kulla e tij nga të gjitha drejtimet do të vjellë zjarr mbi ta, edhe në qofshin edhe me mijëra barbarë, se do të mbrohet me të gjitha forcat, me të gjithë anëtarët e familjes, burra, gra e fëmijë, që mund ta mbajnë armën në dorë, se djemtë e tij i kishin bërë përgatitjet e duhura me armatime dhe

municione të nevojshme, që fronti i rezistences larg të dëgjohej, se krisma e pushkës së Kullës historike do të jetë kushtrimi i dytë pas atij të parit, që u dha më 30 dhjetor të vitit 1991. Se atëherë ishin tjera rrethana, dhe se për shkaqe taktike dhe strategjike u kërkua nga Adem e Hamzë Jashari, Salih Çeku dhe Zahir Pajaziti që kryengritja që filloi në Kullën e atdhetarit të zgjuar Shaban Murat Jasharit të shtyhet për kohë më të mira kur do të na vijë "shteku", që fitorja të jetë e sigurtë dhe e mbarë.

Po shkijet gjakatar e dinin se me kend kanë punë, pasi që para shtatë vitesh kur e patën sulmuar familjen e Shaban Jasharit më 30 dhjetor të vitit 1991, u detyruan të kthehen me turp dhe të përgjakur kah kanë ardhur, me që nuk arritën të futen mbrenda në Kullën ku ishte formuar njësia e parë guerile e Kosovës në Drenicë nga komandanti i saj Adem Jashari, se aty qëndruan si burrat dhe luftuan me Ademin edhe anëtarët e njësitit gueril, vëllezërit e tij Rifati, Hamza dhe babai i tij atdhetari trim mixha Shaban, ndërsa nga jashtë i erdhën në ndihmë anëtarët tjerë të njësitit gueril Ilaz e Fadil Kodra, Sahit Jashari e vëllazërit Gecaj e të tjerë dhe shumë bashkëfshatarë. Si të mos mbrohet Kulla historike që hyri në historinë tonë kombëtare, ku u krijua njëra ndër bërthamat e para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila nën komandën e Adem Jasharit i kishte kryer më parë disa aksione, për t'u treguar shkijeve se kjo tokë ka zot dhe se ka ardhur koha që sundimi i shkijeve të përfundojë. Qëndresa e parë e familjes së Shaban Murat Jasharit dhe e njësisë guerile të Kosovës më 30 dhjetor të vitit 1991 i dhanë zemër dhe shpirt tërë Kosovës. Po, fitorja mbi forcat policore dhe ushtarake të shkaut ishte e shkëlqyer dhe madhështore se u dha shembull shqiptarëve si mbrohet Atdheu, si mbrohet nderi i familjes dhe si fitohet Liria. Ajo ndeshje e hapur, ajo betejë frontale që u zhvillua në mes forcave serbo-jugosllave dhe njësisë guerile të Kosovës e udhëhequr nga Adem e Hamzë Jashari i tregoi tërë botës se tradita luftarake dhe e sakrificës për liri tek shqiptarët, ruhet, kultivohet dhe forcohet, dhe në momentin e duhur shkrep si vetima, për t'i goditur bajlozët në lulë të ballit. Po kjo betejë e fituar nga shqiptarët do të shënohet në historinë tonë kombëtare me shkronja të arta se më 30 dhjetor të vitit 1991 filloi në Prekazin e Ulët, në Kullën e Shaban Murat Jasharit, kryengritja që solli çlirimin e Kosovës. Kjo ndeshje ushtarake me front të hapur në mes forcave okupuese serbo-jugosllave dhe njësisë guerile të Republikës së Kosovës, ku u plagosën tre policë të shkaut dhe një shqiptar, ëshë data historike e

fillimit të luftës së armatosur, fillimi i Kryengritjes së Kosovës kundër robërisë së shkaut. Se aksionet për një kohë të shkurtër u ndërprejnë për shkaqe taktike dhe strategjike, nuk duhet të mirret kursesi shuarje e veprimtaris çlirimtare, sepse Adem e Hamzë Jashari me anëtarët tjerë të njësisë guerile kryenin punë tjera me rëndësi, duke bërë zgjerimin e radhëve dhe bënin furnizimin e tyre me mjete të nevojshme ushtarake.

Qeveria e Kosovës po të mos kishte pasur mëdyshje për hapat që i mori në konstituimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe po të mos kishte kalkuluar më parë me forcat destruktive të udhëhequra nga R.Qosja, H. Hyseni, si dhe me pararojën staliniste të LPK-së, nuk do të ndodhte që ato forca të djallit të mallkuar ta bllokoni veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës me mjete të stërholluara (perfide), duke i futur njerëzit e tyre në Ministri, jo vetëm për ta spiunuar, por edhe për ta bllokuar punën e saj, duke i përdorur jo vetëm njollosjet e shpifjet, por edhe likuidimet ndaj atyre që e rrezikonin taktikën dhe strategjinë e Nanosit me kompani. Dhe të gjitha këto i bënë që të mos lejonin institucionalizimin e UÇK-së dhe të mos lejonin bashkimin e faktorit ushtarak dhe politik të Republikës së Kosovës. Siç duket, Qeveria e Kosovës, në momentin vendimtar kur duhej t'i mbronte institucionet e Republikës së Kosovës, kur duhej t'i financonte njësitë guerile të Republikës së Kosovës, që kishte kontakte të rregullta me përfaqësuesit e tyre në diasporë siç ishte Rifat Jashari, i cili edhe ai ishte njëri ndër ata që i formuan njësitë e para guerile të Kosovës. Po, ishte edhe Salih Çeku, (i cili së bashku me Adem Jasharin e Zahir Pajazitin ishin tre komandantët e parë të njësisë guerile të Kosovës). Sali Çeku ishte udhëheqës i Grupit koordinues për diasporë, që kishte për detyrë t'i mbajë lidhjet me njësitë guerile në Kosovë, për t'i ndihmuar me mjete ushtarake dhe financiare, siç ishin marrë vesh me Bukoshin më 1993. Por, siç po duket, Qeveria e Kosovës u mashtrua nga komplotistët e LBDK-së, nga Qosja dhe Hyseni dhe përfaqësuesit e pararojës staliniste të LPK-së, Ibrahim Kelmendi e Xhavit Haliti, dhe këta e futën në rrugë të pa krye, duke e përfshirë në aleancë me ta për ta luftuar Kryetarin e Kosovës dhe të LDK-së, dr. Ibrahim Rugovën. Më vonë Qeveria u mundua t'i përmirësonte gabimet trashanike, nëpërmjet të cilave ua bëri të mundur pararojës staliniste dhe karrieristëve të LBDK-së ta marrin udhëheqjen e njësisë guerile me komplete dhe mjete të stërholluara, por nuk pati sukses, se tani ato i udhëhiqnin argatët e Nanosit, që nuk lejonin institucionalizimin dhe

aftësimin e tyre me kuadro profesionale. Qeveria e Kosovës u bë e shurdhër ndaj kërkesave të njësitve guerile për mjete financiare dhe kështu UÇK-ja nuk pati mundësi në ato kushte të bëhet ushtria më e fortë e Ballkanit. Dhe kështu, njerëzit pa përgjegjësi së bashku me argatët e Nanosit i sollën Kosovës dhe popullit shqiptar pasoja të rënda dhe tragjedinë më të rëndë që e ka njohur ndonjëherë më parë. U kërcënua seriozisht qenia jonë kombëtare. U rrezikua Kosova dhe Viset tjera shqiptare për t'i humbur njëherë e përgjithmonë siç i humbëm Toplicën me Sanxhakun e Nishit dhe Çamërinë më parë. Po i Madhi Zot nuk dashti të bëhet si donin armiqtë e popullit shqiptar, ua mbushi mendjen të mëdhenjve të botës të na ndihmojnë. Na ndihmuan pa hile miqtë e popullit tonë, për të na e këthyer Kosovën, djepin e shqiptarisë, se e dinin mirë që nuk i takonte në asnjë mënyrë Serbisë.

Po kush tjetër përpos NATO-s do të kishte fuqi të bëj aq shumë shpenzime për ta kallur e djegur çdo gjë të rëndësishme e me vlerë, që ishte për shkijet në Serbi dhe për t'i detyruar kriminelët shkije të ikin nga Kosova me bisht për këmbë ashtu siç kanë ardhur. Dhe më në fund, pas shumë krimeve që i bënë shkijet, shumë vjet me radhë, e bindën botën se janë popull kriminel, se kanë mbetur të njëjtë siç kanë ardhur nga Karpatet e Ruis në Ballkan, se janë të egër dhe barbarë. Por tragjedia dhe gjithë këto të këqija që na gjetën, duhet të jetë vërejtja e fundit për shqiptarë, se Kosova nuk guxon të bjerë kurrën e kurrës nën ndikimin e njerëzve të Serbisë, as nën ndikimin e nanosëve e sorrosëve kosovarë, e lere më të udhëhiqet e të qeveriset nga ata të marrë që, për interesat e tyre të vogla, që janë shumë banale kur të krahasohen me interesat madhore kombëtare, u bënë piuj, u bënë vasalë, u bënë robër dhe skllëvër dhe nuk guxuan me asnjë fjalë t'i kundërshtojnë patronët e tyre, që i kishin shumicën në Tiranë. Këta të gjorë edhe pse e shihnin se Kosova po masakrohej dhe përgjakej nga shkijet gjakatarë, ku edhe ata e kishin hisen e fajeve bashkë me patronët e tyre dhe shkijet barbarë, nuk bënë asgjë që do të binte ndesh me mësimet dhe urdhërat e Nanosit, se shpresonin që do t'iu japin privilegje e pozita udhëheqëse, por të gjorët nuk janë në gjendje të kuptojnë se edhe patronët e tyre janë në të njëjtat pozita si ata, se edhe ata mbi veti kanë patronë, që ju japin urdhëra dhe detyra nga Athina, Beogradi e Moska.

Mallkuar qofshin! Farë e sosur- mos u shtofshin! Amin!

*Botuar në Bota sot më 8-9 mars 2000*

## SALIH ÇEKU ISHTE NJËRI NDËR THEMELUESIT E PARË TË UÇK

PASHA GJAKUN ILIR, S'KA JETË AS LUMTURI PËR NE, PA  
ÇLIRIMIN NGA I HUAJI E PA BASHKIM TË TOKAVE SHQIPTARE  
(HASAN PRISHTINA)

Shqiptarët gjatë shekullit të 20-të përjetuan shumë vuajtje, mjerim dhe tragjedira të njëpasnjëshme jo edhe pa fajin e tyre. Fatmirësisht viti i fundit lamtumirës shqiptarëve iu solli një fitore të shkëlqyeshme. Kosova u çlirua në sajë të përkrahjes së diplomacisë së mençur të SHBA-ve, ndërhyrjes ushtarake të NATO-s, sakrificës së pashembullt të popullit shqiptar dhe luftës së pakursyer të luftëtarve trima të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Përkujtimi i burrave të mëdhenj të kombit që jetuan, vepruan dhe dhanë jetën për Atdhe e shqiptari duke rënë në fushën e nderit për ta mbrojtur nderin e familjes e të kombit apo që u vranë tinëza dhe me tradhti nga dora e zgjatur e Serbisë, po përkujtohen dhe po nderohen në të gjitha anët e Kosovës dhe kudo në Diasporë. Njëri ndër burrat e mëdhej të kombit i cili me tërë qenien e tij iu përkushtua zgjidhjes së drejtë të çështjes shqiptare, çlirimit të tokave shqiptare dhe krijimit të Shqipërisë Etnike, ishte atdhetari nacionalist, politikani dhe demokrati i shquar, luftëtari trim dhe intelektual i mirëfilltë Salih Çeku, i cili luajti rol me rëndësi në të gjitha ngjarjet e rëndësishme të historisë sonë më të re.

Në këtë shkrim, për shkaqe objektive, nuk do ta prek veprimtarinë e Salih Çekut sa ishte student, kur dihet se qysh nga demonstratat e marsit të 1981 u kyç në rrjedhat e ngjarjeve kombëtare. Nuk do të flas gjerësisht as për sukseset e tij në kryerjen e porosisë dhe detyrave konkrete që ua kishin shtruar ideologët dhe udhëheqësit vizionarë Metush Krasniqi dhe Jusuf Gërvalla intelektualëve dhe atdhetarëve nacionalistë për të depërtuar në të gjitha organet shtetërore të okupatorit, në mënyrë që, momentin e duhur me të gjitha forcat dhe në të gjitha drejtimet, të shkatërrohej ky burg i madh i shqiptarëve i quajtur Jugosllavia Socialiste. Salih Çeku, pasi e kreu Fakultetin Jurudik, në vitin 1981 hyri si praktikant në Gjykatën për Kundërvajtje të Deçanit, ku me aftësitë e tija profesionale dhe autoritetin që krijoi, me vyrtytet që i

kishte, u bë gjyqtar në Gjykatën Komunale dhe pastaj Kryetar i Gjykatës Komunale. Kuadrot udhëheqëse të komunës së Deçanit arritën kulmin e suksesit kur Salih Çekun e bënë Kryetar të Komitetit Komunal dhe kështu Deçanin e kthyen nga një Qendër të njohur proserbe në një qendër të rëndësishme shqiptare.

Salih Çeku luajti rol me rëndësi në organizimin e bashkëvendësve të tij për tu solidarizuar me minatorët e Trepçës dhe për t'i ndihmuar ata materialisht. Ai përkrahu kërkesat e minatorëve të Trepçës në të gjitha mbledhjet dhe takimet që i pati në nivel komunal dhe krahinor, dhe kështu u konfrontua drejtpërdrejt me udhëheqjen e Kosovës. Salih Çeku me bashkëveprimtarë organizoi shkuarjen e qytetarëve të Deçanit për në Prishtinë në nëntorin e vitit 1989 për të kundërshtuar ndryshimet kushtetutare që kërkonte Beogradi.

Në fillim të vitit 1990 Salih Çeku së bashku me një grup shokësh themeluan- ilegalisht- degën e LDK-së në Deçan për shkak se sigurimi jugosllav kishte pozita të forta në Dukagjin e veçmas në Pejë dhe Deçan. Pas pak kohe, Salihu me bashkëpunëtorë e formojnë Shoqatën e Juristëve të Pavarur në Deçan. Me legalizimin e LDK-së u pa e udhës të formohet Këshilli Koordinues i Partive dhe Shoqatave që vepronin në Deçan. Kryetar u zgjodh Salih Çeku.

Që në fillim Salihu nuk ishte i kënaqur plotësisht me Programin e LDK-së, prandaj ia bëri kërkesën me shkrim Kryesisë së LDK-së në Prishtinë për të filluar procedurën e plotësimit të Programit të LDK-së me një paragraf ku do të thuhet: "LDK-ja për realizimin e qëllimeve të veta do të përdorë edhe forma tjera të veprimit". Kjo tregon se Salih Çeku ishte për përdorimin e të gjitha formave, për realizimin e çlirimit të Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare. Ai me guximin që tregoi në kundërshtimin e politikës së serbëve dhe kukullave të tyre u përjashtua nga posti i Kryetarit të Komitetit Komunal të Deçanit. Por edhe pse Salihu u largua nga ky vend udhëheqës, kështjella e fortë e shqiptarizmit që ishte ndërtuar me mundin dhe punën e madhe të Salihut dhe bashkëveprimtarëve të tij nuk u dëmtua fare. Salih Çeku, edhe më tutje, mbeti afër shokëve të tij sepse ata e caktuan bashkëpunëtor profesional në Gjykatën Komunale të Deçanit. Shoqata e Juristëve të Pavarur në Deçan nën udhëheqjen e Salih Çekut- Kryetar- dhe Rustem Bruqit-sekretar, luajti rol me rëndësi në Komunën e Deçanit, pasi që ajo në hapat e parë të saj përpiloi dhe vuri në veprim Statutin e Kuvendit Komunal të Deçanit



në bazë të Kushtetutës së Kaçanikut. Dhe kështu, Deçani në sajë të Salih Çekut dhe bashkëveprimtarëve të tij u bë epiqendra e Kosovës në organizimin institucional të Republikës së Kosovës në bazë të Kushtetutës së miratuar nga Parlamenti i saj. Pasuan burgosjet dhe dënimet e udhëheqjes së Deçanit. U dënuan me burgje Isa Demukaj, Xhevdet Lata, Njazi Hybi, Zeqir Ramosaj, Esat Mushkolaj, Pashë Kuqi, Brahim Ukëhaxhaj, Rrustem Tetaj, Mehmet Bojku etj. Salih Çeku, i cili ishte në Pejë gjatë kohës së arrestimeve, nuk dashti të ikë jashtë vendit pa u konsultuar me veprimtarët që kishin mbetur pa u burgosur. Ai, nëpërmjet një mikut, u konsultua me Xhevdet Latën, për të mbetur në Kosovë, ku e priste burgosja, apo të ikë jashtë vendit për t'i shpëtuar burgosjes. Xhevdeti dhe veprimtarët e tjerë, që ishin të paburgosur, e këshilluan dhe kërkuan prej tij që gjithësesi të largohet jashtë vendit. Ai në fillim kalon në Francë dhe pastaj në Gjermani duke e ditur se nga atje mund të punojë më tepër në detyrat që ia kishte shtruar vetes për jetësimin e vendimeve të Kushtetutës së Kaçanikut. Salih Çeku në Gjermani e gjet degën e LDK-ës të formuar. Ai e vuri në veprim dijen dhe përvojën e tij të organizimit, dhe në sajë të tij e bashkëveprimtarëve të tij, që ishin të kyçur në LDK, e riorganizoi diasporën duke e forcuar LDK-në, e cila në katër vitet e para të veprimtarisë së saj ishte Lëvizje kombëtare e jo parti politike klasike.

Por puna më e rëndësishme për Sali Çekun dhe bashkëveprimtarët e tij ishte krijimi i Ushtrisë Çlirimtare të Republikës së Kosovës, që ishte edhe synimi i prijësve vizionarë të Lëvizjes kombëtare për çlirimin e tokave shqiptare dhe bashkimit të tyre me Nënë Shqipëri. Salih Çeku me dijen, përvojën dhe pjekurinë kombëtare që kishte, ishte i vetëdijshëm se institucionet shtetërore të krijuara në fillim të viteve të 90-ta, nuk do të funksionojnë dhe as që do të jetësohet Kushtetuta e as do të realizohet Referendumi pa pasur Republika e Kosovës Ushtrinë dhe Policinë e saj. Ndikimi i tij ishte i madh jo vetëm në Gjermani dhe Zvicër, ku kishte veprimtar dhe shokë, por edhe në Kosovë. Shumë veprimtarë e shihnin domosdoshmërinë e një organizimi për vetëmbrojtje. Në këtë situatë udhëheqjes së Kosovës nuk i mbetej gjë tjetër pos të kërkojnë nga organet më të larta të Shqipërisë lejimin e territorit të saj për stërvitje ushtarake të rekrutëve të Kosovës, për formimin e bërthamave të para të Ushtrisë së Kosovës. Udhëheqja e Shqipërisë i lejoi dy qendra të stërvitjes për burrat trima të Kosovës. Sipas Marrëveshjes, mësimet

teorike dhe praktike do t'i bënin ushtarakët madhorë të Shqipërisë. Salih Çeku me shokë dhe me bashkëveprimtarë bëri organizimin dhe zgjedhjen e rekrutëve për në Shqipëri, që ata të përgatiten e të aftësohen për krijimin e bërthamave të para të Ushtrisë së Kosovës. Në grupin e parë muarën pjesë 52 rekrutë të ardhur nga shumica e komunave të Kosovës dhe nga Maqedonia. Stërvitjet dhe përgatitjet ushtarake u mbajtën në muajin tetor të vitit 1991. Ato zgjatën një muaj. Në mesin e këtyre rekrutëve ishin edhe Salih Çeku dhe Zahir Pajaziti. Grupi i dytë i filloi stërvitjet në muajin nëntor ku muarën pjesë po ashtu 52 rekrutë, në mesin e të cilëve ishte edhe Adem Jashari. Numri i rekrutëve i grupit të parë sipas komunave ishte: nga Podujeva 8; Prishtina 7; Ferizaji 10; Kaçaniku 9; Vushtrria 3; Gjilani 3; Vitia 3; Shkupi 3; Deçani 2; Gjakova 1; dhe Klina

Salih Çeku pasi i kreu stërvitjet në muajin tetor të vitit 1991 së bashku me Zymer Lulin kaluan kufirin ilegalisht dhe shkuan në Deçan. Salih Çeku me autoritetin që kishte nuk e pati vështirë të gjente njerëz të zotë për të marrë barrën e organizimit të njërive guerile në Deçan dhe Dukagjin. Për disa ditë sa i kaloi në Dukagjin e formoi Grupin gueril ushtarak dhe u kthye në Shqipëri për kryerjen e përgatitjeve për dërgimin e armatimit në Kosovë. Në Shqipëri i vijonte stërvitjet ushtarake grupi i dytë i rekrutëve të Kosovës. Nga ushtarët e grupit të dytë të stërvitur gjatë muajit nëntor të vitit 1991 u zgjedhën ushtarët e përgatitur më së miri për ta formuar Njësinë e Parë Ushtarake të Republikës së Kosovës me detyrë speciale, që të dërgohen armatimet e nevojshme në Kosovë për formimin e celulave të para të Ushtrisë së Republikës së Kosovës. Harxhimet për ushqim dhe sigurimin e armatimit e ka bërë Qeveria e Kosovës, ndërsa mësimet teorike dhe praktike i kanë bërë ushtarakët madhorë të Shqipërisë. Në mesin e eprorve të lartë të Shqipërisë që u dhan mësimet teorike dhe praktike ishin: Qani Mehmeti, Kastriot Hoxha, Hysen Imeri, e tjerë. Punët administrative në Tiranë i kanë kryer Ali Aliu dhe Zymer Berisha, përfaqësues të LDK-së në Shqipëri. Prej të gjithë ushtarëve të grupit të dytë, që i kryen stërvitjet ushtarake në nëntor të vitit 1991, u zgjedhën 35 ushtarët më të zotë për t'i dërguar 74 kallashnikovë, municione të nevojshme dhe bomba dore në Kosovë. Këta ishin ushtarët e parë të Republikës së Kosovës që e kaluan kufirin në formacionin ushtarak: Adem Jashari, Salih Çeku, Hasan Ferizi, Shkelzen Gjoni, Sami Tahiri, Osman Ferizi, Muharrem Bobaj, Hilmi Peci, Ramadan Begu, Nazmi Bajrami, Ejup Murseli, Shahin Bejtullahu, Lutfi Januzi, Fadil

Kadria, Ilaz Kadria, Avni Rama, Sabit Jashari, Shaqir Salihu, Xhemajl Kelmendi, Naim Gubetini, Shemsi Zeqiri, Xhavit Gubetini, Faton Gajtoni, ...Ismajli, Driton Restelica, Ekrem Sheholli, Qenan Aziri, Feriz Xhemajli, Nuri Bexheti, Bujar Zeneli, Orhan Ibrahim, Jakup Limani, Halil Polloshi, Ramadan Beka dhe Ejup Veseli.

Salih Çeku u zgjodh Komandant i Njësinë ushtarake dhe përgjegjës për fshehjen e armatimit. Ishte Njësia e Parë Ushtarake e Kosovës, e krijuar pas Luftës së dytë Botërore, me detyra konkrete e qëllime madhore. Ajo ishte e gatëshme në çdo moment për ta filluar luftën me ushtarët e okupatorit, po që se e pengojnë atë në kryerjen e detyrës që ishte zotuar për ta kryer. Ushtarët, të udhëhequr e të komanduar nga Komandanti i tyre Salih Çeku, mbrritën mirë në cak. Armatimi u fsheh nëpër baza të sigurta, por meritën më të madhe e kanë për ruajtjen dhe shpërndarjen e tij: Salih e Ramë Panxha, Demë, Fadil dhe Sherif Tolaj, vëllezërit e Salih Çekut, Hasani dhe Smajli, Saim, Sami dhe Bajram Tahiraj, Xhemajl Berisha, Avdyl Mulliqi dhe Zenun Idrizi. Gjysma e armatimit është shkepur menjëherë për armatosjen e njësive të para guerile. Për Drenicë dhe Llap armatimin e kanë marrë Adem Jashari dhe Xhafer Zena. Për Mitrovicë dhe Shalë të Bajgorës Nazmi Bajrami me një tjetër, për Fushë-Kosovë Sherif Islami, ndërsa gjysma e armatimit ka mbetur te vëllazërit e Salih Çekut dhe nuk është zbuluar edhe pse janë keqtrajtuar, edhe pse 12 herë është bastisur shtëpia e tyre nga policia e shkaut! Ai armatim i mbetur te vëllazërit e Salih Çekut, Hasani dhe Smajli është shpërndarë kur u thirr Kushtrimi i Lirisë nga Komandanti legjitim i UÇK-së Adem Jashari. Urdhërin për shpërndarjen e armatimit Smajl Çeku e ka marrë nga Salih Çeku nëpërmjet Zenun Idrizit, të cilin së bashku me Saim Tahirin i kishte dërguar Salih Çeku me detyra të veçanta për t'i kryer në Dukagjin në prill të vitit 1988.

Pasi u formuan njësitë e para guerile në Llap, Drenicë dhe Dukagjin, në fund të vitit 1991 u kryen disa aksione të suksesshme në këto tri regjione strategjike të Republikës së Kosovës. Ndër më të suksesshmit ishte qëndresa heroike e atdhetarit nacionalist, veteranit të arsimit shqip mixhës Shaban Jasharit me tre djemtë e tij Rifatin, Hamzën dhe Ademin më 30 dhjetor të vitit 1991, kur luftuan trimërisht si Burrat e Dheut, deri sa i detyruan forcat serbo-jugosllave të kthehen mbrapa kah kan ardhur, të përgjakur e të turpëruar. Kjo ndeshje e hapur luftarake në mes njësisë së parë guerile të krijuar në Drenicë dhe forcave të

okupatorit, pastaj zbulimi i disa celulave të njësive guerile në Llap, Drenicë dhe Dukagjin dhe zbulimi i grupit të Mentor Kaqit ishte shkaku pse diplomacia bëri presion në Prishtinë dhe Tiranë, që- për shkaqe strategjike- të mos shkohet më tutje në organizimin e Ushtrisë së Kosovës, por të lihet për më vonë një kohë më të përshtatshme. Presioni ishte shumë i drejtë. Kishte për qëllim që urrejtja patologjike e shkijeve ndaj të gjithë fqinjve të tyre, e veçmas ndaj shqiptarëve, të mos zbrazet që në fillim në Kosovë, por të kalonte tek vëllezërit e tyre të gjakut në Slloveni dhe Kroaci. Presioni ndikoi jo vetëm tek udhëheqja politike e Kosovës por ai presion ndikoi edhe tek prijësit dhe komandantët e tri Grupeve të njësive guerile, që vepronin në Llap, Drenicë e Dukagjin, si dhe bashkëveprimtarët e tyre.

Pasi që Salih Çeku ishte në Gjermani ku edhe ishte selia e Qeverisë së Kosovës, e pa të udhës që njësitë guerile të mos mbeten pa përkrahjen e Qeverisë, prandaj këmbënguli në mënyrë të vazhdueshme tek Bujar Bukoshi që të shqyrtohet kjo çështje në Qeveri. Ndërkohë u krijua Këshilli Koordinues i njësive guerile në përbërje të Salih Çekut, Zenun Idrizit, Saim Tahirit dhe Ismet Avdullahut, ku Kryetar i Këshillit u zgjodh Salih Çeku. Ky Këshill pati takim zyrtar me Bukoshin dhe me Aganin në Shtutgart, në muajin maj të vitit 1993 dhe kërkuan përkrahjen nga Qeveria në financimin e njësive ushtarake të formuar qysh në vitin 1991. Më në fund u pajtuan dy palët (takimi është mbajtur veçmas me Aganin, veçmas me Bukoshin) që njësitë të financohen nga Qeveria e Kosovës, por të ruhet fshehtësia ushtarake dhe njësitë të jenë të kontrolluara nga Këshilli.

Njësitë ushtarake guerile në Llap, Drenicë dhe Dukagjin komandoheshin nga komandantët e tyre, prandaj nuk kishte rezik që të dalin jashtë kontrollit. Ato kryenin aksione në rend të parë për ta ndihmuar ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe për ta ndihmuar diplomacinë amerikane, që ishte zotuar se Kosova do të jetë detyrë e saj parësore për ta zgjidhur në dobi të shqiptarëve, ngadalë dhe me mençuri, për të mos i sjellë Kosovës humbje të mëdha njerëzore dhe dëme materiale. Të gjitha aksionet guerile që janë marrë në Llap, Drenicë dhe Dukagjin, të komanduara nga Adem Jashari, Salih Çeku dhe Zahir Pajaziti, kanë pasur për qëllim pengimin e Serbisë në kolonizimin e Kosovës, kanë pasur qëllim mbajtjen gjallë të shpirtit luftarak të shqiptarëve dhe përgatitjes së tyre në pikëpamje psikike dhe shpirtërore

për të qenë të gatshëm në momentin e duhur të kyçen në luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare. Salih Çeku pas takimit që pati me Aganin dhe Bukoshin në Shtutgart dhe marrëveshjes që është lidhur në mes tyre, shkoi në Shqipëri, duke shpresuar se Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë do t'ia mundësonte blerjen e një sasie të armatimit në një vlerë prej 150.000 DM, me qëllim që armatimi të futej në Kosovë për t'u fshehur në vende të caktuara dhe pastaj të përdorej në momentin e duhur. Lindën shumë mosmarrëveshje në udhëheqjen e ngushtë të Shqipërisë dhe të Kosovës, prandaj Salih Çeku u kthye në Gjermani pa kryer punë. Atëherë u detyrua të siguronte armatim në sasira të vogla në Gjermani dhe Zvicër që të dërgohet në Kosovë nëpërmjet Italisë dhe Shqipërisë.

Serbia filloi planin për kolonozimin e Kosovës me shkje të Shqipërisë, Kroacisë dhe të Bosnjes. Ndërtoheshin shtëpi për ta në shumë vende të Kosovës. Salih Çeku për të krijuar frikë tek shkiyet e ardhur në Kosovë, vendosi të ndërmarrë një aksion për shkatërrimin e disa shtëpive të ndërtuara për refugjatë serbë në Junik. Aksione të ngjashme muarrën edhe Adem Jashari dhe Zahir Pajaziti me njësitë e tyre guerile.

Në qershor të vitit 1994, Salih Çeku, pasi i bëri përgatitjet e duhura për aksionin e planifikuar në Junik u nis për në Shqipëri me një kombi së bashku me Zenun Idrizin dhe Saim Tahirin, ndërsa Osman Ferizi shkoi me aeroplan. Ndodhi një fatkeqësi që s'e kishte pritur askush. Në Bari të Italis hajnat ua vodhën kombin, kuptohet edhe municionin, jelekët antiplumb dhe një shumë të hollash. Vazhduan rrugën për Shqipëri duke shpresuar se atje do të gjinden disi për të mos mbetur detyra pa u kryer. Zenun Idrizi, i cili ishte përgjegjës për sigurimin e materialit ushtarak, bëri përpjekje për të huazuar të hollat e nevojshme për kryerjen e aksionit të planifikuar. Gjeti aq të holla sa për t'u kthyer mbrapa.

Salih Çeku në fillim të vitit 1995 e mban një mbledhje me bashkëveprimtarët e tij në zyrën e LDK-së në Shtutgart. Ishin Zenun Idrizi, Saim Tahiri, Osman Ferizi dhe Zymer Luli. U vendos që aksionin e pakryer në Junik ta kryejnë vetëm dy persona. Aksionin e kryen me eksploziv në fillim të muajit prill të vitit 1995 Zenun Idrizi dhe Ismet Çeku, ndërsa eksplozivin e siguroi Saim Tahiri. Dy shtëpia u shkatërruan plotësisht, ndërsa njëra pjesërisht. Aksioni arriti qëllimin e duhur pasi që shkiyet e ardhur ikën menjëherë dhe nuk u kthyen kurrë më. Pas këtij

aksioni kryhet aksioni tjetër në Stacionin e Policisë në Irzniq nga Zenun Idrizi dhe N.N-i. Sipas shtypit serb plagosen rëndë dy polic dhe një plagoset lehtë. Aksioni tjetër kryhet në fillim të muajit gusht të vitit 1996 nga Salih Çeku, Zenun Idrizi dhe N.N-i në Baballoç në vendëbanimin e ndërtuar për shqijet e Shqipërisë. Sipas shtypit të shqijeve janë dëmtuar rëndë tri shtëpi dhe një makinë për hapjen e kanaleve. Shtypi i shqijeve njofton atëherë se 1500 kolonët e komunës së Deçanit janë shumë të shqetësuar për fatin e tyre. Pra aksioni pati sukses të plotë, sepse edhe qëllimi i Salihut me shokë ishte që kolonët e Serbisë të mos e ndiejnë veten si në shtëpitë e tyre, se Kosova nuk ka qenë dhe nuk mund të bëhet shtëpia dhe atdheu i tyre, se ajo ka qenë, është dhe do të jetë Atdheu i shqiptarëve për të cilin aq shumë kanë bërë sakrifica.

Salih Çeku, duke e parë se pyjet e Deçanit dhe të Dukagjinit po shfryrëzohen dhe po dëmtohen për së tepërmi nga "Serbia Shuma", vendos të shpërndajë trakte dhe letra në adresa të caktuara, duke kërkuar prej shqiptarëve që të mos e ndihmojnë Serbinë për t'ua shkatërruar malet e tyre. Traktet i përgatiti Salih Çeku në Shtutgart dhe i dërgoi në Deçan nëpërmjet Demë Tolës, Zenun Idrizit dhe Sokol Idrizit, për t'i shpërndarë nëpër adresa të caktuara. Kur u pa se traktet dhe letrat nuk sollën suksesin e duhur, vendosi që ta sulmojë me eksploziv këtë organizatë serbe, që po ua shkatërronte shqiptarëve pasuritë e tyre pyjore. Siç dihet, kësaj organizate iu shkatërruan disa mjete të punës, por më e rëndësishme ishte se shqiptarët më nuk bashkëpunonin me këtë organizatë, dhe kështu, eksploatimi dhe shkatërrimi i pyjeve u ndërpre pothuajse plotësisht. Këtë aksion e kreu njësit i Salih Çekut i krijuar më 1991 nën udhëheqjen e N.N-it, siç i kishte kryer më parë edhe shumë aksione edhe më të komplikuar dhe më të vështira se ky. Por, ende nuk ka ardhur koha të shkruhet për aksionet dhe veprimtarinë e grupit të Deçanit në tërësi dhe as që është qëllimi i këtij shkrimi. Këto aksione u cekën vetëm për t'i hudhur poshtë rrenat e "rrahagjoksëve" të LPK-së, të cilët rrenin mërgimtarët në ndeja dhe tubime informative, dhe pastaj edhe me Komunikata të UÇK-së, se njerëzit dhe njësitë e tyre po i kryejnë aksionet ushtarake në Kosovë. Salih Çeku dhe bashkëveprimtarët e tij që i kishin kryer aksionet dhe të tjerët që u kishin ndihmuar në kryerjen e tyre nuk bëzanin, edhe pse iu vinte vështirë që "atdhetarët" e LPK-së binin në nivelin e qyqes dhe qyqarëve, kur përvetësonin punën dhe mundin e të tjerëve për qëllime karrieriste dhe të përfitimeve materiale.

Serbët i humbën tri lufta. Kapitalin e krijuar më parë me rrena e dredhi e humbën me masakrimet që i bënë në Bosnje dhe në Kroaci. Kryederri i shkijeve bënte përgatitjet e duhura për ta filluar luftën në Kosovë. Rinia jonë studentore dhe luftëtarët trima të njësive guerile të Republikës së Kosovës ndërruan statusquon në Kosovë. Dhe kur duhej bashkimi i të gjitha forcave shqiptare për krijimin e kredibilitetit të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, duke i mbajtur zgjedhjet e dyta Parlamentare dhe Presidenciale, të cilat i përkrahnin diplomatët e zgjuar të SHBA-ve, këto zgjedhje bojkotohen nga një grusht partiakësh të shtirë dhe bajraktarësh naivë. Serbia ndihmohet me punën konkrete dhe propagandën e nanoistëve e të qosiqve, që nuk patën sukses ta marrin "kalanë" nga brenda. Atyre iu ndihmuan edhe stalinistët dredhaxhinj dhe enveristët e padijshëm, që jetonin në diasporë, të cilët me përkrahjen e Nanosit dhe me përdorimin e mjeteve të marrjes së "kalasë" nga brenda, duke u mbshtetur në parimin e xhunglës "qëllimi i arsyeton mjetet"- e muarën udhëheqjen e njësive guerile të Republikës së Kosovës. E ndihmuan me propogandë Serbinë duke e shpallur Drenicën të çliruar dhe të lirë, me qëllim që të shpërthente lufta sa më parë, nga frika se mos po ndërmerri veprime të shpejta Qeveria e Kosovës për ta formuar Ministrinë e Mbrojtjes duke i angazhuar kuadrot ushtarake të cilat ishin të organizuara në shumë shtete të Evropës Perendimore dhe në Kroaci, Bosnje dhe Slloveni. Pararoja staliniste, pasi i arriti sukseset e para, e vuri në veprim planin e përgatitur më parë, që atdhetarët e luftëtarët trima të ditve të para, themeluesit e njësive të para guerile, udhëheqësit legjendarë, që e mbajtën barrën kryesore të organizimit dhe të kryerjes së aksioneve ushtarake që nga "91-shi, i bënë "dëshmorë" duke iu organizuar prita, që profesionalistët e krimeve mizorisht t'i vrajnë. Disave iu përgatitën stupca e grushta dhe ua futën frikën në palcë. I detyruan t'ua marrin "patin" dhe t'ua bëjnë "temenanë" e të flasin si papagaj. Po stalinistët e gjorë e argatët e Nanosit, dhe argatët e këtyre argatve që po veprojnë në Kosovë, e dinë mirë se trimat dhe luftëtarët e të vërtetes askush nuk mund t'i ndalë, nuk mund t'i ndalë kërcënimi as lajkat dhe as premtimet, sado të mëdha që të jenë. Ata vetëm plumbi i ndal për të mos e folur të vërtetën. Nuk kalkulojnë për përfitime personale dhe nuk i frikohen vdekjes, sepse liria e të menduarit dhe e të shprehurit dhe e mbrojtjes së të vërtetës ka vlefë më të madhe se jeta e një robit, e një skllavi, jeta e një të marri, që pranon diktatin!

Pararoja staliniste e LPK-së krahas mjeteve të përmendura e vuri në përdorim edhe një kurthë ("truk") të përgatitur shumë vjet më parë, duke caktuar "përgjegjës" për formimin e njëjësive ushtarake në "dokumenta" dhe në fantazi, për qëllime të vjedhjes së historisë në momentin e duhur. Ata i mendonin dhe i planifikonin komplotet se e dinin që vet nuk mund të krijonin njësi guerile dhe as ushtri, meqë nuk kishin fuqi dhe as ndikim askund në Kosovë dhe as në diasporë, por shtireshin se diçka të rëndësishme po punojnë, sa për t'i mashtruar "atdhetarët" romantikë, që kishin kryer edhe burgje nepër burgjet e Jugosllavisë, por burgosja e tyre në radhët e LPK-ës ishte sa tragjike aq edhe komike, sepse ata nuk luanin kurrfarë roli dhe as që i pyeste kush për ndonjë gjë, se ata i kishin afruar vetëm për dekor, që mërgimtarëve t'ua marrin edhe lekun e fundit, në emër të Kosovës dhe të fondit "Vendlindja thërret". Ata duke u bërë ndrikulla të njëjësive guerile të Republikës së Kosovës pa dëshirën e krijuesit të tyre dhe duke i pagëzuar me UÇK e me Shtab Qëndror, bënë falsifikimin më të shëmtuar që ka bërë ndokush në botë. Pastaj kryen punë tjera për të cilat Gjykata e Hagës dhe Gjyqi i Kosovës së lirë do t'ua japi dënimin e merituar për komplete, kurtha, tradhtira, vrasje pas shpine e vepra tjera trishtuese. Po, do të përgjigjen edhe për faje tepër të rënda që nuk lejuan institucionalizimin dhe depolitizimin e UÇK-së, duke prishur Marrëveshjen që u arrit në Norvegji në maj të vitit 1998 në mes Ahmet Krasniqit dhe Adem Demaçit për bashkimin e UÇK-së dhe të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, në komandim dhe në veprime luftarake, që duhej të krijonin bashkarisht Shtabin Suprem të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës.

Edhe partitë u ringjallën, veçmas partiakët e shtirë, karrieristët e sëmurë për pushtet dhe bajraktarët naivë që bënë aleanca me njëri tjetrin dhe i prishnin ato për çdo javë, sepse nuk mund të mirreshin vesh për ndarjen e posteve udhëheqëse. Ata ishin të interesuar që në udhëheqjen e Kosovës të kenë poste sa më të larta, pasi që me instiktin e mijve të bardhë e kuptonin se do të bëhet një tërmet i fortë në Kosovë, ku më të "diturit" do të përfitojnë privilegje dhe pozita udhëheqëse. Luanin rolet e atdhetarëve me namë, por në anën tjetër i vinin ndërskamsa njëri-tjetrit, për t'ia thyer buzë e dhëmballët. U bënë pehlivanët pikë e pesë, nuk donin biseda as takime. Dhe- kur vinin miqtë e popullit shqiptarë e diplomatët e shquar amerikanë për t'i bindur këta pehlivana se këto



momente historike për shqiptarët janë shumë të rrezikshme, se është i domosdoshëm bashkimi dhe bashkëveprimi i shqiptarëve kudo që janë, dhe i udhëheqjes së tyre për të arritur atë që po e kërkojnë- këta "udhëheqësa" e çonin kokën lart dhe bëheshin edhe më "azgana" e nuk pranonin ndërmjetësim as nuk donin takim me njëri tjetrin. Fatkeqësisht nuk patën sukses t'i pajtojnë dhe as t'i bashkojnë së paku për bisedime, për ta bërë një Qeveri të përbashkët, që Kosova të përfaqësohet prej saj, që të ketë përparësi në bisedime me shkijet gjakatarë, që të mos përfaqësohet Ajo nga fise dhe bajraktarë, po nga institucionet e saj legjitime, që kanë votën e popullit, e që demokracia e perendimit- edhe pse nuk i pranonte haptas votimet në Kosovë si legjitime, me vetë faktin që tinza kërkonin të mbahen ato, për ta nxjerrë një Qeveri të Kosovës, jep të kuptohet se shqiptarët kanë humbur shumë kohë dhe shumë shanse për të arritur sa më shpejt te Pavarësia e Kosovës dhe liria e shqiptarëve. Edhe pse Kosova kaltej flakë, edhe pse populli shqiptar masakrohej, edhe pse me dhunë (nga shkijet) largohej, pehlivanët, azganat dhe "baballarët" e kombit e të partisë, bënin plane dhe skenare, bënin aleanca dhe ndërskamca për të dalë në ballë të votrës dhe në krye të vendit për të ushtruar pushtet mbi shqiptarë të Kosovës, pa pasur dije, meritë dhe krebilitet.

Formimi i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, Salih Çekun e gëzoi pa masë. Një gjë të tillë e kishte kërkuar nga udhëheqja e Kosovës shumë vjet më parë. Ai ishte i bindur se pa një luftë të armatosur në momentin e duhur, nuk mund të arrihet çlirimi dhe bashkimi kombëtar. Pra, kishte bindje të plotë se duhet kombinuar dy format e luftës për çlirimin e Tokave Shqiptare, atë paqësore dhe të luftës së armatosur. Ishte ndër Komandantët e parë që e shkriu Grupin e Tij në Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, pa i qitur kurrfarë kushti Ministrit të Mbrojtjes kolonel Ahmet Krasniqit. Ai kishte një respekt për të dhe familjen e tij, pasi që edhe familja e tij kishte një traditë luftarake dhe të atdhedashurisë siç e kishte edhe familja e Ahmet Krasniqit. Edhe familja e tij i kishte bërë ballë shkijeve dhe malazezëve sikur familje e Ahmetit shkijeve. Të dy familjet ishin djegur shumëherë nga shkijet barbarë. Në Dukagjin është e njohur familja e Salih Çekut me trimëritë e babëgjyshit dhe të mixhës së tij Curr Belleja dhe Hysen Belleja, siç është e njohur familja e Ahmet Krasniqit në Kosovë me Aziz Zhilivodën. Salih Çeku e çmonte edhe personalitetin e Ahmet Krasniqit

për biografinë e tij të pasur, aftësitë e tija ushtarake dhe vyrtytet e tij, që i pat vërejtur gjatë takimit të parë që e pat me të. Salih Çeku e dinte se pa ushtarakët shqiptarë që ishin përgatitur nepër akademitë e ish-Jugosllavisë, as që mund të mendohet të krijohet një Ushtri e fortë dhe e aftë, për ta përballuar ushtrinë e okupatorit. Ai i vlerësonte lart oficerët tanë, ata atdhetarë trima që u shkolluan në kushte shumë të vështira, jashtë Kosovës, larg familjes, të vetmuar e të ndjekur këmba këmbës nga sigurimi ushtarak i Jugosllavisë, por ideali i fortë, dëshira e madhe për t'u aftësuar, që në momentin e duhur t'i dalin zot Kosovës e Viseve tjera shqiptare dhe tua nxerrin hakun shqiptarve që i vranë dhe i masakruan shkijet gjakatarë, qëkur këmba e tyre shkeli në Kosovë.

Po, Salih Çeku i muar urdhërat dhe i kreu detyrat e marra nga Ahmet Krasniqi. Detyrat e para Salih Çeku ua dha për t'i kryer dy veprimtarëve të ditëve të para të themelimit të njësisve guerile në Dukagjin, Zenun Idrizit dhe Saim Tahirajt në prill të vitit 1998. Të dy, pasi i kryen detyrat veç e veç në Deçan me rrethinë, i raportuan Salih Çekut, ndërsa ai Ahmet Krasniqit. Grupi i Deçanit kreu edhe një detyrë që kishte një rëndësi të madhe për Ministrinë e Mbrojtjes. Zenun Idrizi e hapi Qendres Stërvitore Ushtarake në Viçidol afër Tropojës, ndërsa në Papaj e hapën Qendrën tjetër Salih Çeku, Tahir Zema dhe Ilmi Nebihu. Duhet cekur një të vërtetë se këto Qendra stërvitore ka mundur t'i hapë vetëm Grupi ushtarak i Deçanit, pra në këtë rast Zenuni dhe Salihu, pasi që kishin familje të fortë dhe nacionaliste, ku kuqaloshët e Deçanit nuk guxonin haptas t'i pengonin, pasi që në Shqipëri vlenin ligjet e të fortit, qëkur Shqipërinë e veshën në të zeze kuqaloshët e Shqipërisë me bandat greke dhe hajnat e rrugaçat e vendit. Edhe armatimi i parë është blerë nëpër fshatarët e Tropojës nga Zenun Idrizi dhe janë armatosur ushtarët e Brigada 134 heroike të Komandant Tahir Zemës. Nga Qendra e Stërvitjes janë armatosur edhe shumë fshatra të Deçanit e të Kosovës.

Salih Çekut edhe pse iu afruan pozita udhëheqëse në Shtabin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës në Tiranë, aty ku ishte selia e Shtabit, ai nuk i pranoi pozitën duke u arsyetuar se "dua ta mbroj Kosovën me armë në dorë " dhe ashtu u bë siç tha Salihu. Tahir Zemaj ishte Komandant i Brigadës 134, ndërsa Salih Çeku ishte Ndihmës Komandant për moral dhe çështje politike të asaj Brigade. Më vonë edhe njësitë tjera të UÇK-ës, që vepronin në Kosovë, e kopjuan nga forma këtë Brigadë, duke iu vënë numra, por fatkeqësisht, iu mungonin kuadrot

profesionale të cilat, në të vërtetë, "komandantët" e vetëshpallur nuk i donin. Siç dihet, Salih Çeku muar pjesë në të gjitha betejat e asaj Brigade, por Beteja e Logjes do të hyjë në historinë e luftës çlirimtare të Kosovës. Ajo ishte Beteja më e shkëlqyeshme ndër të gjitha betejat. Betejë tjetër e rëndësishme e Brigadës 134 pa dyshim ishte edhe shpëtimi i popullsisë civile pa pasoja, duke i tërhequr në Shqipëri, pas fushatës serbe në verën e vitit 1998, kur faktori ndërkombëtar ia dha dritën e gjelbër Serbisë për marrjen e asaj fushate për shkak se "Pehlivanët" e Kosovës nuk duan ta formojnë një Qeveri të përbashkët nga forcat institucionaliste dhe ato antiinstitucionaliste të Republikës së Kosovës. Vrasja e Kolonel Ahmet Krasniqit në Tiranë, është kryevepër e porositur nga Qendra antishqiptare serbo-greke, njerëzit e së cilës kanë depërtuar në udhëheqjen politike të UÇK-së, në Qeverinë dhe në SHIK-un e Shqipërisë, e aprovuar nga karrieristët e sëmurë për pushtet të LBDK-ës, të pararojes staliniste të LPK-së dhe oficerëve vasalë me shumë fytyra, me gojë e sy ciklopi, që i përdorën shumë luge për ta ushqyer shpirtin e tyre të shitur, të kyçur në Ministri për të bërë komplete dhe për ta penguar suksesin e saj.

E vranë së bashku forcat e djallit atdhetarin, nacionalistin, Burrin e madh të kombit shqiptar Ahmet Krasniqin, se e dinin se ai di dhe mundet ta ndërtojë Ushtrinë më të fortë në Ballkan. U mundua Ahmeti me mish e me shpirt ta bashkojë faktorin politik dhe ushtarak të Republikës së Kosovës, për ta institucionalizuar UÇK-në dhe për ta bërë atë Ushtri Kombëtare. Dhe mu për atë edhe e vranë spiunët e grekut dhe shkaut Ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës. Ato ditë të zisë kombëtare Salihu ishte në Tiranë, por pas varrimit të Ushtarakut madhor shkoi në Papaj te ushtarët e Brigadës heroike, të Brigadës 134. Komandanti i saj kërkohej të vritet nëpër Tiranë, por i ndjeri Ahmet Krasniqi, para se ta vrasin, Tahir Zemës i pat dhënë pushimin që i takonte sipas rregullave ushtarake. Po ç'ndodhi më vonë, kur Halil Bicaj zuri vendin e Ahmet Krasniqit në Ministrinë e Mbrojtjes? Çdo gjë ndryshoi. Tahir Zemën e penguan dhe nuk e lejuan ta marrë për ta komanduar brigadën e tij që riorganizohej dhe bënte stërvitje ushtarake në Papaj. I dhanë detyra tjera, por në Papaj nuk e lejuan të shkojë. Po Salih Çeku nuk e la Brigadën e tij jetime. Ai prej saj kurrë s'u nda, edhe pse shpesh herë ka kërkuar nga Ministria që të vijë Komandanti i saj Tahir Zemaj apo një tjetër me grada më të larta se të tijat. Nuk ishte Salih Çeku prej atyre "komandantëve" që nuk ia dinte "hallin" vetit, siç ishin disa që u bënë

gjenerala pa e fituar as një betejë. Salih Çeku, duke qenë oficer rezervë, gjithmonë i nderonte gradat më të larta ushtarake, se e dinte se ashtu krijohet ushtria, se e dinte se ashtu bëhet komanda, se e dinte se ashtu fitohet lufta. Në Papaj e kaloi dimrin duke bërë përgatitje për beteja të tjera që do të bëhen në Kosovë. Në Popaj u studjua në detale terreni afër vijës së kufirit dhe u hartua plani për thyerjen e tij. Në atë plan punuan së bashku Salih Çeku, Agim Ramadani dhe Anton Çuni dhe këta së bashku edhe me Rustem Berishën e thyen Kufirin shqiptaro-shqiptar, me këto njësi ushtarake: Brigada 134 e komanduar nga Salih Çeku deri sa ra dëshmorë; Brigada 131 e komanduar nga Rustem Berisha, ndërsa Ndihmës Komandant dhe Shef Shtabi i kësaj brigade ishte Agim Ramadani, dhe Batalioni Diversanto-Vëshgues i komanduar nga Anton Çuni. Po në këtë Betejë, në Betejën e Kosharës, ranë dëshmorë: (që me siguri Parlamenti i Kosovës do t'i shpallë Heronj kombëtarë) Salih Çeku dhe Agim Ramadani.

Thonë se historia nuk përsëritet, por shqiptarëve po iu përsëritet vazhdimisht historia. Sa shumë ngjajnë në mes tyre dy ngjarje të rëndësishme kombëtare dhe personalitetet që ndikuan fuqishëm në ato ngjarje. E para, u zhvillua në fillim të shekullit të 20-të, që solli pavarësinë e Shqipërisë, ku më tepër për fajin e prijësëve dhe bajraktarëve shqiptarë sesa të "Evropës shtrigë" mbetën jashtë kufijve shtetëroër me tepër se dy të tretat e teritorit etnik dhe më tepër se gjysma e popullsisë! E dyta, ngjarja tragjike e viteve të fundit të të njëjtit shekull, që rrezikoi për vdekje Kosovën dhe qenien tonë kombëtare, tash krejtësisht me fajin e karrieristëve të sëmurë për pushtet, partiakëve të shtirë dhe bajraktarëve të padijshëm. Pasojat do të ishin edhe shumë më të mëdha sikur në mesin e personaliteteve që u gjindën në ballë të këtyre ngjarjeve të mos kishte burra të dijshëm, atdhetarë trima dhe vizionarë, siç ishte Hasan Prishtina e Luigj Gurakuqi, Salih Çeku, Adem e Hamzë Jashari e Zahir Pajaziti, Ahmet Krasniqi e Agim Ramadani, Fehmi Lladrofi e Adem Ukëhaxhaj, e të tjerë dhe veçmas ndihma e madhe e dy Burrave të Mëdhej të SHBA-ve, Vilsonit dhe Klintonit, e miqve të popullit tanë të Evropës.

Dy personalitete që ndikuan fuqishëm në ato ngjarje, Hasan Prishtina dhe Salih Çeku, juristë nga profesioni, mbrojtësit e të vërtetës dhe drejtësisë, mbrojtës pa kompromis të çështjes madhore kombëtare, që nuk bënë kalkulime për interesat e ngushta personale, se para veti kishin

interesat madhore kombëtare. Si njërit si tjetrit ju paraqitën pengesa të mëdha nga bashkëveprimtarë të paaftë e të padijshëm, por ata me gjakftohtësi dhe me arësye i vlerësonin gjërat dhe me shembullin e tyre iu tregonin të tjerëve se si dëmtohet më së tepërmi armiku, se si fitohen beteja ushtarake dhe diplomatike, si çlirohen tokat shqiptare dhe fitohet pavarësia, si bëhen shumë punë të mbara e mbi të gjitha si bëhet Shqipëria Etnike. Fatkeqësishtë të shumtë ishin që nuk merrnin vesh nga politika dhe as nga arti ushtarak. Nuk dinin t'i dallonin rrethanat dhe situatat politike, nuk ishin të aftë t'i caktojnë orientimet, nuk dinin në kend për ta mbështetur e nga kush për t'u larguar, kend e kanë aleat të natyrshëm e kend armik të përjetshëm, se ishin të verbëruar nga bajraktarizmi, tekat dhe xhelozitë, interesat personale, grupe dhe regjionale. Bënin luftë për dominim dhe për pushtet, e të gJORIT nuk e dinin se me çlirimin e Atdheut do të kenë mjaftë vende udhëheqëse për të gjithë, por sipas aftësisë së tyre.

Është e pabesueshme se sa përputhet jeta dhe vepra e Salih Çekut me veprën dhe jetën e Hasan Prishtinës. Hasan Prishtina kritikon politikën e xhonturqve ndaj Shqipërisë në Parlamentin e Turqisë, ndërsa Salih Çeku ngrit zërin i pari prej udhëheqjes shqiptare në Kosovë në organet më të larta të Kosovës. Hasan Prishtina organizoi kryengritje të armatosur në Kosovë, po edhe Salih Çeku e bëri të njëjten punë. Hasan Prishtina shiti dhe shkriu pasurinë që e kishte për arsim dhe për Shqiptarizëm, po edhe Salih Çeku i harxhoi të hollat që i kishte për nevoja të familjes për t'i ushqyer fëmijët, por i harxhonte edhe të hollat vëllait të tij Hasanit, që i fitonte me djersën e ballit, duke paguar banesë për udhëheqjen e Kosovës kur vinte në Gjermani, që Qeveria e Kosovës të hollat t'i kursente për nevoja edhe më të mëdha. Salih Çeku me gjithë veprimtarët e tij, për aksionet ushtarake që i kryenin nuk i kërkuan askuj të holla, por ka ndodhur që prej njerëzve që i njihnin mirë të huazonin një shumë të hollash, në mesin e të cilëve ishte Fadil Tolaj, që për Salih Çekun ishte një bankë shpëtimtare, që kur i lypte e zgjidhte qesen, huazoi por edhe fali. Njëzet palë rrobe ushtarake që i bleu Zenun Idrizi më 1994 për nevojat e Grupit ushtarak me të hollat e Fadilit u blenë.

Kjo ngajshmëri në mes jetës dhe veprës së Hasan Prishtinës dhe Salih Çekut lehtë mund të shpjegohet, pasi që Salih Çeku përpos bazës së fortë atdhetare që kishte, ai u ndikua edhe nga burrat e mëdhenj të kombit, dhe mu për këtë idealet dhe parimet jetësore të Salih Çekut

përputheshin plotësisht me të Hasan Prishtinës, të cilin edhe si atdhetar, edhe si politikan, edhe si burrë shteti e çmonte shumë. Është i njohur fjalimi që e mbajti Hasan Prishtina në katundin Harilaq afër Prishtinës më 1912, kur pat thënë: " Atdheu ka qenë dhe është ideali më i shenjtë për ne. Pasha gjakun ilir, s'ka jetë as lumturi për ne pa çlirim nga i huaji e pa bashkim të tokave shqiptare". Dhe për të arritur këto synime të drejta e të natyrshme Hasan Prishtina mësonte: "Duhet veprime e jo fjalë, unitet e jo përçarje, trimëri e jo frigë". Ja pra, këtu, te ky ideolog i nacionalizmit shqiptar e gjeti frymzimin dhe forcën Salih Çeku dhe shumë burrat të mëdhenj të kombit.

Po Kosova jonë heroike si e priti çlirimin e saj? Bota u habit me vitalitetin e popullit shqiptar, me dashurinë e tij për truallin, respektin dinjitoz për çlirimtarët e tij dhe për burrat e mëdhenj të shteteve e miqtë e sinqertë që iu gjendën kur ishte në rrezik të humbë çdo gjë që kishin në jetë. Viti i parë i çlirimit të Kosovës është viti ku shqiptarët e Kosovës po mundohen t'i shërojnë plagët e shumta, t'i largojnë nga mendja tragjeditë e shumta familjare dhe kombëtare. Po, shqiptarët po mundohen t'i shërojnë plagët që ende kullojnë gjak! Si të shërohet zemra e kallur flakë e nënave shqiptare për fëmijët e tyre të masakruar nga shqijet gjakatarë! Si të shërohet zemra e grave për burrat që i lanë me fëmijë jetimë! Si të shërohet zemra e plagosur e motrës për vëllanë, e vëllait për vëllanë, e fëmijës për babanë, e shokut për shokun, e luftëtarit për bashkëluftëtarin që ra në fushën e nderit, për të mos vdekur kurrë! Si të shërohet zemra e Kombit, kur atij i mungon koka udhëhqese!? Si të shërohen plagët e popullit kur në krye i kanë dalë të pa diturit, bajraktarët, partiakët e shtirë dhe karrieristët e sëmurë për pushtet, njerëzit e shitur, që asgjë tjetër nuk shohin përpos kolltukut dhe pozitës udhëheqëse dhe privilegjit. Populli po e sheh dhe po e vëzhgon pjellen e keqe të tij, atë egjër të mbjellur me mjeshtri nga vampirët e pansllavizmit rus, nga vampirët e shovinizmit serb dhe atij grek, nga leninistët, stalinistët, socialistët, komunistët, titistët, internacionalistët, llumpenproletarët dhe ateistët, që po u prin kryehajni, kryespioni i armiqve tanë, djalli dhe shtrigani, dhumpiri i gjallë i quajtur Fatos Nanosi, që e shkatërroi dhe e veshi në të zezë Shqipërinë, e kalli dhe e dogji me bandat kriminele greko-mafioze-staliniste dhe e kthei në koloni të Greqisë, duke e bërë utrinë të thiut e të bitit të thiut!

Po dhumpiri është i pangjishëm në krime, në gjak dhe iu mësy të ia bëjë edhe shumëherë më zi Kosovës, që at tokë të shenjtë shqiptare t'ia

bënte tapi Serbisë. Po i Madhi Zot nuk lejoi një dënim kaq të rëndë për shqiptarë! Bëri mrekulli duke ua mbushur mendjen të mëdhenjve të kësaj bote ta mbrojnë Kosovën dhe shqiptarët e pambrojtur me diplomaci dhe me NATO-n, forcën më të madhe të botës. Po, ky argat i djallit të mallkuar dhe i armiqve tanë shekullorë, ka blerë njerëz të ligj e të padijshëm në Shqipëri dhe në Kosovë. I ka bërë skëllevër dhe papagaj! Po shkatërrojnë në nismë çdo punë të mirë e të mbarë për Shqipëri, Kosovë dhe shqiptarë. Por populli nuk ngutet! Ai do t'i "rrahi" me "friska" duarve e veshve, me "gugjuma" kresë në zgjedhjet e lira që do të mbahen në Shqipëri dhe Kosovë, duke mos ua dhënë votën, për t'u treguar se nuk ua kanë besen, për përçarjet që i bënë dhe për marifetet e tyre gjatë gjithë kohës sa Kosova rerezikohej për vdekje. Do t'u tregojë populli, me votat e tij, se ata nuk do të kenë vend më në Kosovën e lirë dhe Shqipërinë demokratike, se vendi i tyre po përgatitet në Gjyqin e Hagës por edhe në Gjyqet e Kosovës dhe të Shqipërisë, dhe do të dënohen për krimet që i bën ndaj Kosovës, për krimet që i bën ndaj Shqipërisë dhe popullit shqiptar, që e penguan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës të institucionalizohet, që i thyen marrëveshjet, që rrahën, plagosën dhe vranë shqiptarë përshkak se i njihnin institucionet e Republikës së Kosovës, që penguan UÇK-në të bëhet Ushtria më e madhe e Ballkanit!

Po, drejtësia thotë populli, vonon po nuk harron. Do të dënohen këta argatë të Nanosit që përvetësuan dhe përvehtësuan pasuri shoqërore, shtëpia, lokale, fabrika, punishte në emër të UÇK-së, dhe kështu i sollën dëme të mëdha luftëtarëve trima të radhëve të para, komandantëve legjendarë dhe bijve e bijave më të mira të kombit, që u bënë ushtarë të UÇK-së, të cilët nuk shkuan në luftë për hatrin e karrieristëve dhe partiakve të shtirë, as nuk shkuan për poste e privilegje. Po ata shkuan se e dëgjuan zërin e Kushtrimit të Kosovës martire, Kushtrimin që e bën Shaban, Hamzë dhe Adem Jashari, kushtrimin e Salih Çekut e Zahir Pajaziti, Agim Ramadanit dhe Ahmet Krasniqit, Adem Ukëhaxhajt dhe Fehmi e Xheva Lladrofeit. Po, do të dënohen të gjithë ata të gJORë, që po rrejnë duke i shtrembëruar ngjarjet historike, duke i falsifikuar të vërtetat. Po mundohen të gJORët me rrena ta përvetësojnë UÇK-në dhe krijuesit e saj, që nuk kanë pasur asgjë të përbashkët me ta! Po këta hajna të historisë kanë blerë edhe ca ushtarakë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, bashkëveprimtarë të Salih Çekut dhe Agim

Ramadanit, që po shpifin e rrejnë për kolegët e tyre të cilët ranë dëshmorë duke mundur t'i ndajnë këta dy heronj për së vdekuri, pasi sa ishin gjallë nuk patën sukses t'i përçajnë dhe as t'i ndajnë! Por kot e kanë këta kokëkrisur dhe të marrë se nuk do të kenë sukses. Të gjithë e dinë se ata ishin shokë të pandashëm të idealit në stërvitje ushtarake dhe në beteja. Ata ishin largëpamës dhe vizionarë, strategë të luftës dhe atdhetarë trima. Ata e dinin forcen e bashkimit të idesë dhe armës, prandaj bënë përpjekje për t'i bashkuar subjektet politike dhe ushtarake të Kosovës. Ata të dy me Ministrin Ahmet Krasniqin, ushtarakun e aftë që muar pjesë drejtpërdrejt në luftën serbo-shqiptare, Tahir Zemën, edhe ca të tjerë, ishin forcat më të shëndosha të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës.

Se Salih Çeku, Agim Ramadani dhe Anton Çuni ishin strategët e thyerjes së kufirit shqiptaro-shqiptar është e njohur. Po është e njohur dhe e vërtetë se ishin ushtarakët dhe ushtarët e Brigadës 134 me komandantin e saj Salih Çekun, Brigada 131 me komandantin Rustem Berisha dhe Zëvendës Komandantin dhe shefin e Shtabit Agim Ramadanin, dhe Batalioni Diversanto Vëshgues me komandantin Anton Çuni, që e thyen kufirin të cilin ua kishin vënë shqiptarëve në zemër të atdheut me padrejtësi. Pse bëhen rrena në opinion kur thuhet se ky ushtar e ai ushtar ishin ushtarë të Brigadës " Agim Ramadani " të cilët ranë dëshmorë në mësyemjen e parë për ta thyer kufirin shqiptaro-shqiptar, kur dihet se kufirin e kanë thyer brigadat e cekura më lart. Brigada 138 "Agim Ramadani" u formua pas ramjes së tij në fushën e nderit për shkaqe djallëzore e jo për shkaqe të nderimit. Komplotistët më 11 maj dy brigadave dhe batalianit që e thyen Kufirin ua dhanë një numër dhe ia vunë emrin e Heroit Agim Ramadani. Po Salih Çeku a nuk u vra në të njëjtën betejë me Agim Ramadanin?! A nuk meritonte Brigada heroike 134 që e komandonte Salih Çeku ta mbajë emrin e Komandantit?! Dhe pse Brigada 131 të mos e mbajë emrin e Agim Ramadanit?! A nuk ishte Salih Çeku ai që prej formimit të asaj Brigade i mbeti besnik dhe nuk iu nda kurrë. Këto janë lojëra komuniste, lojëra të turpshme, lojëra komplotistësh, që u munduan ta vrasin Heroin Salih Çekun edhe një herë pas vrasjes! Po nuk arritën asgjë tjetër përpos veten ta bëjnë horë. Këto janë lojra të ndyera staliniste dhe kush merr pjesë në to, nxihet me ngjyrë të zezë, që kurrë nuk i hiqet nga fytyra, dhe faqezi do të quhet për së gjalli e për së vdekuri!



Thyerja e kufirit shqiptaro-shqiptar do të hyjë në historinë shqiptare dhe botërore, se është kufiri i dytë që u thye pas atij të Berlinit, me një dallim se kufiri që i ndante shqiptarët u thye me forcën e armës nga vetë shqiptarët. Dhe, pa dyshim, kjo ngjarje do të sjellë bashkimin e shqiptarëve, dështimin e vasallëve dhe tradhtarëve, dhe krijimin e Shqipërisë Etnike!

Detyrat ndaj atdheut nuk mbarohen kurrë. Ata që, për shkaqe të ndryshme, nuk kanë dhënë atë që kanë pasur mundësi dje, e kanë shansin sot ta kryejnë një pjesë të detyrimeve që e kishin ndaj Kosovës. Kosova ka nevojë për ndihmën e të gjithë shqiptarëve kudo që gjenden ata. Në rend të parë duhet t'u ndihmojmë invalidve të luftës, fëmijëve dhe familjeve të dëshmorëve. Vetëm kujdesi ynë vëllazëror ndaj tyre do t'iu ndihmonte në zvogëlimin e dhembjes për të dashurit e tyre, që u masakruan apo ranë në altarin e lirisë.

Do të ishte turp për shqiptarët si popull dhe si komb, po qe se edhe një jetimi të vetëm i mungojnë gjërat kryesore për jetesë. Shtëpiat dhe banesat e para duhet të sigurohen për ta. Shkollimi dhe punësimi i jetimëve të luftës është detyrë me përparësi për udhëheqjen e ardhshme të Kosovës. Me mbajtjen e tubimeve apo akademive përkujtimore nuk kryhen detyrimet ndaj dëshmorve dhe heronjve tanë. Do të ishte krim, do të ishte tradhti ndaj idealeve të dëshmorëve tanë po qe se shokët dhe bashkëveprimtarët e tyre, klasa politike dhe ata që veten e quajnë atdhetarë të kenë banesa apo shtëpia dhe të gjitha të mirat në sofër, ndërsa fëmijëve jetimë t'u mungojnë të gjitha, përpos lavdërimit dhe përkëdheljes. Fëmijët dhe familjet e dëshmorëve e të masakruarve dhe invalidët e luftës nuk kanë nevojë për lavdërime dhe për përkrahje morale, po qe se ajo nuk shoqërohet edhe me përkrahje konkrete, që do tua përmirësonin kushtet e jetesës. Vetëm atëherë kur i bindim jetimët, invalidët e luftës dhe familjet e tyre se nuk janë jetimë, kemi të drejt morale të mbajmë tubime dhe akademi përkujtimore për dëshmorët dhe heronjtë tanë. Vetëm atëherë kemi të drejtë morale të tregojmë se kemi qenë bashkëveprimtarë me ta, apo i kemi njohur. Vetëm atëherë kemi të drejtë të quhemi njerëz! Vetëm atëherë kemi të drejtë të quhemi shqiptarë! Dhe vetëm atëherë kemi të drejt të themi se jemi në rrugë të mbarë për të realizuar synimet dhe amanetin e dëshmorëve tanë.

*Botuar: "Bota sot" më 20-26 prill 2000*

## VRASJA E AHMET KRASNIQIT PATI PASOJA TË RËNDA PËR KOSOVËN DHE PËR SHQIPTARINË

NË VRASJEN E AHMET KRASNIQIT KANË GISHT TË HUAJT, QË KANË PASUR GISHT EDHE NË VRASJEN E BURRAVE TË DHEUT, QE PUNUAN ME PËRKUSHTIM PËR INTERESA MADHORE KOMBËTARE

Njëra ndër periudhat më të vështira të popullit tonë, që i kalojë me pasoja shumë të rënda, ishte periudha kur dy të tretat e Atdheut dhe më shumë se gjysma e popullit shqiptar ra nënë robërinë serbo-jugosllave-greke.

Vështirësitë dhe pasojat u shumëfishuan kur gjithë kombin tonë e përfshiu robëria sllavo -komuniste. "Fara ruse" e mbjellë me mjeshtri në të gjitha trojet tona nga emisarë të pansllavizmit rus, të maskuar me "lëkurë të qengjit", dhe ushqimi i gjeneratave të reja me "egjërën komuniste", i sjelli kombit tonë tragjedinë më të rëndë gjatë gjithë historisë së tij. Kjo "farë" e djallit të mallkuar, nëprmet "egjres komuniste" bëri që ishte e mundur për t'i keqpërdorur dhe për t'i shkatrruar vlerat tona kombëtare, që u krijuanë me shekuj nga populli ynë siç ishin: mikëpritja, bujaria, trimëria, solidariteti dhe Besa Shqiptare. Bajraktarët e "farës ruse" duke u mbështetur në tri shtylla të faqeve të zeza: në diktaturën e proletariatit, në luftën e klasave, në internacionalizmin proletar, dhe në ushqimin shpirtërorë të shumë gjeneratave me "egjërën komuniste", krijuan "njeriun e ri", një krijesë hibride, gjysmë njeri- gjysmë robot. Ajo farë krijese, nga përdorimi i egjres komuniste si ushqim të përditshëm shpirtëror, humbi aftësinë për të menduar dhe për të gjykuar. Zotin nuk e njohin! Fjalë jep shumë por nuk i mban. Rrena, shpifja dhe krimi i flejnë në zemër. Për partinë dhe për kryepartiakun japin çdo gjë që kanë. Urdhërat për shpifje, kërcënime dhe krime i kryjnë me përpikëri, duke u mbështetur në parimin se "qëllimi i arsyeton mjetet". Për ta gënjeshtro, shpifja dhe tradhtija janë virtyte. Prijësit e tyre me gjakftohtësinë e një kasapi me përvojë të gjatë në profesion, iu japin urdhëra bajraktarëve të farës ruse për të vlarë me tradhti nacionalistë, veprimtarë të dalluar të çështjes kombëtare, kundërshtarë politikë, shpianikë dhe bashkëkombas, kur nuk arritën t'i

bëjnë argatë të pa gojë, apo nuk arrinë t'i bëjnë "të vdekur për së gjalli", që të mos u ndihet kund zëri, nga dëshira e sëmuar për tu bërë "të parë", nga lakmia për të zënë pozita udhëheqëse, nga kajta për t'u bërë pasanik duke përvetësuar pasuri të huj.

Siç dihet "fara ruse" e ushqyer me "egjirën komuniste" në trojet tona krijoi lugetër, vampir, "njerëz" zemërgurë, "njerëz" faqezi, dyfityrësh, që u vuan në shërbim të kryedajave komunist të Beogradit, Moskëves, Pekinit dhe në kohën e fundit u vuan në shërbim të vampirëve të Athinës dhe të kriminelëve të Beogradit me qëllim që ata t'u ndihëmojnë të bëhën "sundues" të shqiptarëve. Këta të gJORë janë bërë dorë e zgjatur e të huajve kur po i detyrojnë mjëranët zemër gurë, për të ngritur dorë mbi burrat më të mirë të kombit. Dhe, a ka dëm më të madh për një popull, a ka fatkeqësi më të madhe për një komb, kur ai në momentet vendimtare të historisë së tij mbetet pa udhëheqje të aftë, mbetet pa dietarë dhe trima që do të dinin t'i shfrytëzonin rrethanat e përshtatshme për realizimin e aspiratave të popullit të tij. Fatkeqësisht, në gjitha periudhat e rëndësishme historike, kur çështja kombëtare mund të zgjidhej drejt në dobi të interesave tona, agjencitë serbo-sllavo-greke kanë arritur ta bëjnë të pa aftë klasën tonë politike, për të mos i realizuar synimet shekullore të popullit tonë. Ata i kanë përdorë të gjitha mjetet për ta bërë parinë tonë "të vdekur për së gjalli", me shpifje të llojllojshme, apo duke "e blerë me pare". Ndërsa ata më të aftit, Burrat e Mëdhenj të Kombit, që nuk arrijtën dot t'i bëjnë "të vdekur për së gjalli" me kurrfarë mënyre, i vranë me dorën e tradhtarëve shqiptarë, që i përkisnin fundërrinës së popullit tonë. Vrasja e Haxhi Zekës nga një dorë e zgjatur e Serbis u bë për shkak se ai ishte një atdhetar i kulluar, strateg dhe largëpamës, që dinte se kush mund të bëhën aleatë të shqiptarëve. Vrasja e Hasan Prishtinës, Luigj Gurakuqit dhe Isa Boletinit u bë nga sigurimi i fshehtë i Serbisë me qëllim që shqiptarëve t'u varrosin shpresën e çlirimit dhe bashkimit kombëtar. Vrasja e Jusuf Gërvallës, njërit ndër udhëheqës të kryesor të "Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare" me atentatin e Shtutgardit, ku u vranë edhe Bardhosh Gërvalla vëllai dhe bashkëveprimtari i tij i ngusht, dhe Kadri Zeka, njëri ndër udhëheqës të OMLK-së, u bë nga UDB-ja e Beogradit dhe nga UDB-ja e Tiranës, me qëllim që të mos rritet dhe forcohet rezistenca jonë kombëtare kundër robërisë serbo-jugosllave në baza të shëndosha kombëtare, ashtu qysh e parashihnin udhëheqës të shquar të

LNÇKVSHJ, Metush Krasniqi dhe Jusuf Gërvalla, por ajo të ndahet dhe të përçahet në baza ideologjike dhe regjionale, duke ditur se si e tillë ajo nuk do të ketë mundësi të ju nxirrte probleme ndërshtetërore.

Vrasja e Ahmet Krasniqit pati dhe ende do të ketë pasoja të rënda për Kosovën dhe për shqiptarinë. Me këtë vrasje armiq të tanë shekullor dhe forcat kundrainstitucionale të Kosovës, që me vetëdije dhe pavetëdije u bënë vegla në duar të kriminelëve të Beogradit, të pansllavistëve të Moskës dhe të shovenistëve të Athinës, kanë arritur shumë qëllime, por më kryesorët ishin :

1.U bë pengimi i bashkimit të faktorit ushtarak të Republikës së Kosovës.

2.U bë i pamundshëm rritja dhe forcimi i FARK-ut, që u krijua në bazë të Marrëveshtjes së Oslos.

3. U pengua institucionalizimi dhe profesionalizimi i UÇK-së, që ishin dy faktorët kryesor për formimin e një Ushtrie Kombëtare të Republikës së Kosovës që shumë shpejt do të shëndrrohej në Ushtri Kombëtare Shqiptare.

4. Rriten dhe thellohen përçarjet ndërnjerëzore dhe ndërshtetërore.

5. Hapi rrugën e vrasjeve tjera politike të veprimtarëve të dalluar të çështjes kombëtare, veprimtaria e të cilëve shkonte në dëm të interesave serbo-greke dhe të komplotistëve kokëkrisur të Kosovës.

6. U bë i pamundshëm çlirimi i Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nga vetë shqiptarët;

7. Si rrjedhim i të gjitha këtyre që u përmendën më lartë, serbët arritën shumë lehtë ta realizojë skenarin e tyre për spastrimin etnik të Kosovës, në sajë edhe të ndihmës së madhe të forcave kundrainstitucionale të Kosovës, dhe të spiunëve dhe vazalëve të tyre që kanë zënë pozita udhëheqëse në institucionet shtetërore të Shqipërisë.

Populli ynë, nga përvoja e tij e hidhur, e di se në vrasjen e Ahmet Krasniqit kanë gisht të hujtë, sikur që kanë pasur gisht edhe në vrasjen e Burrave të Dheut, që punuan me përkushtim për interesa madhore kombëtare, por nuk e kanë plotësisht të qartë pse në vrasjen e tij murën pjesë një numër i madh i personaliteteve publike, që patën dhe kanë pozita udhëheqëse në subjektet politike dhe shtetërore të Republikës së Kosovës, gjegjësisht të Kosovës. Për t'i pasur të qarta shkaqet e verasjes së Ahmet Krasniqit, duhet pasur të qartë situatën politike që mberetnonte

në gjithë hapsirën tonë kombëtare : ndasitë, përçarjet dhe grupimet dhe aleancat politike që bëheshin dhe zhbëheshin për qëllime karrieriste.

## KUR DHE SI FILLUAN KOMPLETET KUNDËR AHMET KRASNIQIT

Kështu klasa politike e Kosovës, pas të ashtuquajturut "revolucion i vonuar demokratik" i Shqipërisë ishte i rreshtuar në katër grupe.

Grupimin e parë e drejtonte kryepërlivani i Nanosit Xh. Haliti, përgjegjës i "Sektorit të Rëndësisë së Veçantë" dhe anëtar i Kryesisë së LPK-së, me këshilltarët që i kishte në SHIK-un e Shqipërisë, (njëri ndër kryesorët ishte Shaban Braha). Ai me A.Sylën bëri përvehtësimin e njërive guerile të Republikës së Kosovës me mjetet e marjes së "kalasë nga mbrenda" dhe kështu arriti të manipulojë në shumë drejtime me SHP të UÇK-së, që e përbënin argatët e tij më të besueshëm.

Grupimin e dytë e drejtonte R.Qosja që i kishte futur nën këmbë klanet e H. Hysenit dhe të B. Kosumit. Ky grupim në sajë të ndihmës së A.. Sylës, Nanosit, Mejdanit dhe Klosit u bë ortak me grupimin e Xh. Halitit për të manipuluar me SHP të UÇK-së, që u plotsua edhe me argatë të R.Qosjes. Me çlirimin e Kosovës nga NATO-ja dy palët (klani i Xh. Halitit dhe klani i R.Qosjes) e ndanë pushtetin duke formuar të ashtuquajturën " Qeverinë e Thaçit".

Grupimi i tretë e drejtonte B. Bukoshi i cili në fillim të viteve 1990-tave ishte me forcat institucionale të Republikës së Kosovës, pastaj bëhet i "pavarur", dhe kur duhej me të gjitha forcat t'i ndihmonte forcat institucionale, bëhet me Qosjen. Me këtë grupim bëjnë aleancë të mësheftë klani i H. Hysenit, që kishte pozita udhëheqëse në LDK-në, disa komisione të "Tre përçindshit", klani i Ibrahim Kelmendit, i cili përpos që e kishte nën kontroll kryesinë e LPK-së, i kishte nën urdhërat e tij edhe një grup ushtarakësh që i kishte dërguar në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në SHP të FARK-ut me detyra speciale për ta penguar kërkë subjektë ushtarak të Republikës së Kosovës, në mesin e të cilëve ishin : Xhafer Jashari, Halil Bicaj, Fadil Demiri etj.

Grupimin e katërt e përbënin forcat institucionale të Republikës së Kosovës, (LDK-ja NDSH-ja, PSHDK-ja, PLK-ja, PSDK-ja) nën udhëheqjen e kryetarit të Republikës së Kosovës dhe kryetarit të LDK-së dr. Ibrahim Rugovës, dhe veprimtarëve tjerë të subjekteve politike që i përkisnin këtij grupimi.(Mark Krasniqi, Rexhep Avdullahu, Gjergj Dedaj,

Kaqusha Jashari etj). Ky grupim politik organizoi dy herë zgjedhje nacionale të pavarura nga Beogradi, krijoi institucione shtetërore në bazë të votës së lirë të popullit dhe i vuari bazat e shtetësisë së Republikës së Kosovës, bëri ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, krijoi miq dhe aleatë në të gjitha anët e botës, krijoi lidhje komunikimi me shtetet e Bashkësisë Evropiane dhe në veçanti krijoi lidhje bashkëpunimi me SHBA-të, krijuan njësitë e para guerile dhe bënë përgaditjet e nevojshme për fillimin e luftës çlirimtare.

### **Përvetësimi i njësive guerile të UÇK-së nga pararoja staliniste e LPK-së u bë edhe me fajin e Qeverisë së Kosovës**

Pse nuk filloi lufta në Kosovë për shkatërrimin e Jugosllavisë, që do të kishte pasoja shumë të rënda për Kosovën dhe kombin shqiptar, marita kryesore u takon diplomatëve të shquar të SHBA-ve, që ishin miq të kombit tonë, që kërkuan nga Ibrahim Rugova dhe Salih Berisha që të mos e fillojnë luftën me Jugosllavinë deri sa " t'u vie shteku". Këto subjekte politike e kanë përkrahur luftën çlirimtare (duke i krijuar njësitë e para guerile të komanduara nga Adem e Hamzë Jashari, Salih Çeku dhe Zahir Pajaziti) me mjete materjale, ndërsa pjesa dërmuese e ushtarëve të UÇK-së i përkiste antarësisë së gjërë të këtyre partive. Fatkeqësisht njësitë guerile u përvetësuan nga LPK-ja me fajin e Qeverisë së Kosovës, në veçanti të kryeministrit Bukoshi, pasi nuk u përkrahën me mjet financiarë. Formimi i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës në mars të 1998 krijoi kushtet për institucionalizimin dhe profesionalizimin e Luftës çlirimtare, por spiunët serbo-sllavo-grekë arritën ta bindin pararojen staliniste të LPK-së për t'i krijuar kushtet e fillimit të luftës frontale para kohe me Serbinë, dhe shkëljen e Marrëveshtjes së Oslos për të penguar forcimin e FARK-ut.

Siç dihet, lufta për pushtet, i futi në shamakun e tradhtisë kombëtare forcat kundrainstitucionale, kur në vend se të nsdihmojnë në bashkimin e të gjitha forcave politike dhe ushtarake të Republikës së Kosovës, për realizimin e synimeve tona kombëtare, ato tërë veprimtarinë e tyre e drejtuan në luftë kundër institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës dhe subjekteve politike që i krijuan ato institucione. Duhet cekur se subjektet politike dhe klanet e individëve që i përbënin forcat kundrainstitucionale, edhe pse kishin mosmrrëveshje të thella mes tyre

për shumë çështje, në lidhje me luftën dhe ndarjen e pushtetit, ato kur ishte çështje e luftimit të forcave institucionale ishin së bashku në të gjitha veprimet e tyre mafioze dhe kriminale. Por kur ishte në pyetje ndarja e pozitive udhëheqëse dhe marrja e pushtetit u treguan të pamshirshëm ndaj njëri -tjetrit. Bëheshin dhe zhbëheshin lloj-lloj aleancash jo parimore në mes individëve dhe klaneve me ndikim që e përbënin LPK-në dhe LBDK-në. Në këso aleancash prin Grupimi i dytë që udhëheqej nga R.Qosja. Ky grupim politik edhe pse ishte në aleancë të haptë me klanin e Xh. Halit, lidhi aleancë të fshehtë me Qeverinë e Bukoshit ku bënte pjesë edhe klani i Ibrahim Kelmendi, që kishin për qëllim për të ndarë në mes tyre pushtetin e Kosovës, ndërsa Xh. Halitin & Kompani ta lanë me "gishta në gojë" por siç dihet ajo nuk ndodhi, sepse në komplete dhe ndërskamsa ishte më i zoti Xh.Haliti, por dhe kishte përkrahjen e Nanosit, Mejdanit dhe Klosit.

Krijimi i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës në marsin e 1998, edhe pse me vonesë të madhe, krijoi bazën e një organizimi institucional të luftës çlirimtare të popullit tonë që ishte nënë robërinë serbo-jugosllave. Ardhja në krye të Ministrisë së Mbrojtjes të një atdhetari, që rridhte nga një familje me tradita të larta të atdhedashurisë dhe të trimërisë, të kolonel Ahmet Krasniqit, njërit ndër ushtarakët shqiptarë me përgaditje të lartë profesionale, që i kishte të kryera dy akademi ushtarake : "Akademinë Ushtarake të Ushtrisë Tokësore" dhe "Akademinë Komanduese të Shtabit të Ushtrisë Tokësore", bëri që të alarmohen armiqtë tanë shekullor nga droja se krijimi i " Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës", për të cilat punonte me përkushtim Ahmet Krasniqi, do t'ua prishnin planet dhe skenarët që i kishin thurur për "zgjidhjen e çështjes shqiptare" siç ua donte interesi i tyre kombëtar. Edhe forcave kundërinstitucionale të Kosovës, që me vetëdije apo pa vetëdije ishin vënë në shërbim të çakajve të Ballkanit, nuk iu shkonte në interes krijimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe i FARK-ut, prandaj i vunë në veprim të gjitha mjetet për ta penguar krijimin e një Ushtrie Kombëtare të institucionalizuar dhe të profesionalizuar, për të cilën punonte Ahmet Krasniqi, nga frika se do të vinin në pushtet forcat institucionale, ndërsa Marrëveshja e Zürih-ut nuk do të realizohej... Ahmet Krasniqi bëri përpjekje të mëdha për bashkimin e faktorit politik dhe ushtarak të Republikës së Kosovës, që ishte kushti i parë për të j'iu kundërvënë me sukses makinerisë ushtarake të Serbisë, në realizimin e

aspiratave të saj antishqiptare. Bashkimi i Grupit ushtarak të Deçanit me Ministrinë e Mbrojtjes i parapriu takimit të Oslos që u mbajt në maj të 1998-es, në mes përfaqësuesve të UÇK-së dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrojtjes në krye me Adem Demaçin dhe Ahmet Krasniqin, që solli marrëveshjen për formimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK). Sipas marrëveshjes, FARK-u do të komandohej nga Shtabi i Përgjithshëm, ndërsa Komandant Shtabi u caktua Ahmet Krasniqi. Ajo marrëveshje ia mundësoi Ahmet Krasniqit dhe Ministrisë së Mbrojtjes formimin e Pjesës së SHP të FARK-ut në Tiranë, formimin e "Qendrës për Rekrutim, Stërvitje dhe Përgaditjen e Kuadrit Ushtarak" në afërsitë kufirit Shqipëri-Kosovë, dërgimi i ushtarakëve në Kosovë për forcimin e njësisve të UÇK-së; trajnimi i ushtarakëve për komandantë të brigadave (në Bosnjë dhe Hercegovinë); arritja e marrëveshjeve ushtarake me kreun ushtarak të Kroacisë, të Bosnjes dhe Hercegovinës dhe të disa shteteve muslimane për ndihmë ushtarake dhe teknike, ku një pjesë e atyre marrëveshjeve filluan edhe të realizohën; formimi i Brigadës 134. dhe bërthamave të brigadave 131 dhe 133, dhe dërgimi i tyre në frontin e luftës në Kosovë, krijimi bataljanit Diversanto -vëzhgues edhe i disa brigadave tjera siç ishte Brigada "Skënderbeu", brigadat 141, 142, 132, që bëheshin gati të hynin në frontin e luftës në Kosovë dhe sukseset që i arriti komandant Tahir Zemaj me 22 ushtarakë që e shoqëronin, dhe disa të tjerëve që iu bashkuan në Kosovë, kur e krijuan Shtabin e Zonës së Tretë Operative të Rrafshit të Dukagjinit së bashku me kuadrin komandues të forcave territoriale të komanduara nga Ramush Haradinaj dhe pastaj sukcesi i FARK-ut në Betejën e Logjës, etj. Këto suksese të Ahmet Krasniqit dhe SHP të FARK-ut, që u krynë mberenda një kohe të shkurtër, i vuan në veprim qendrat e agjenturave serbo-sllavo-greke në Shqipëri dhe në Kosovë, por edhe forcat kundërinstitucionale të Kosovës për ta penguar Ahmet Krasniqin dhe SHP të FARK-ut në veprimet e tyre, që kishin për qëllim forcimin dhe konsolidimin e FARK-ut.

Të gjithë ata që i kanë përcjellur rrjedhat e ngjarjeve në Kosovë, Shqipëri dhe në botë, gjatë dhjetvjetshit të fundit të shekullit 20, (dhe e kanë lexuar feltonin tim "Pse jemi kështu siç jemi" të botuar në "Bota sot" më 21 maj- 19 qershor 2001) e kanë të qartë pse dhe kush e vrau Ahmet Krasniqin. Në këtë shkrim nuk mund t'i përsërisim gjërat që janë thënë në atë felton, por dua ta përsëris një fakt se shumë të liga dhe



tragjedi që e gjetën Shqipërinë dhe Kosovën në vitet e fundit të shekullit 20, janë pasojë e Marrëveshjes së Zürih-ut, që është lidhur në pranverë të 1993 në mes PSSH dhe LPK-së. Siç dihet, ajo marrëveshje i detyronte të dy palët ta ndihmojnë njëra tjetren për të ardhur në pushtet në të dy anët e kufurit, duke i përdorë të gjitha mjetet e lejueshme dhe të pa lejueshme. Stalinistët e Shqipërisë duhej ta rrxonin nga pushteti Salih Berishën dhe PDSH-në, ndërsa enveristët dhe kuqaloshët e Kosovës duhet ta largojnë nga skena politike dr. Ibrahim Rugovën dhe ta shkatërrojnë LDK-në. Këto synime planifikonin t'i realizojnë në rend të parë duke u mbështetur në parimin se "qëllimi i arsyeton mjetet", prandaj edhe vuan kontakte me fqinjët tanë për të kërkuar ndihmen e tyre. Në bazë të asaj Marrëveshjeje është përgaditur i ashtuquajti "revolucion i vonuar demokratik i Shqipërisë". Kuptohet që edhe Kosovës i erdhën shumë të liga nga ajo marrëveshje: Tentimi për shkatërrimin e LDK-së në Kuvendin e saj të Tretë, mosnjohja e zgjedhjeve të dyta parlamentare, mosnjohja e institucioneve shtetërore të dala nga zgjedhjet parlamentare, që u bënë në Kosovë pa kontrollin e Beogradit, përvehtësimi i njërive guerile të Republikës së Kosovës me mjetet e "marjes së kalasë nga mbrenda", pengimi i formimit të Qeverisë së Kosovës nga të gjitha forcat politike dhe ushtarake, që e kërkonin diplomatët e shquar të SHBA-ve; pengimi dhe mos lejimi i bashkimit të forcave ushtarake në një subjekt të vetëm komandues, në FARK; krijimi i Qendrës për përpilimin e "listave të zeza" për lëshimin e "vendimeve" për shpifje, kërcënime dhe për vrasjen e veprimtarëve të dalluar të çështjes kombëtare, që nuk pranonin të bëhën argat të pagojë të tyre; vrasjet politike që u bënë para lufte, gjat lufte dhe pas luftës; formimi i Qeverisë së Thaçit në Tiranë; krijimi i mafisë së kuqe pas çlirimit të Kosovës; krijimi i kushteve për enklavizimin e disa teritoreve të Kosovës; tentimi për destabilizimin e Kosovës dhe të Ballkanit, etj, etj, ishin pasojë të Marrëveshjes së Zyrihut.

**KUSH ISHTE KOMISARI POLITIK I FATOS NANOS, I CILI URDHËROI FARK-un PËR MBYLLJEN E QENDRËS STËRVITORE NË PAPAJ**

Ngjarrjet e mëvonshme, që ndodhën në Pjesën e SHP të FARK-ut në Shqipëri, në diasporë, dhe Kosovë, tregojnë se në pengimin dhe eliminimin fizik të Ahmet Krasniqit, përpos qarqeve më të larta politiko-ushtarake të Beogradit, Athinës, dhe Tiranës vazale, janë marrë edhe

krerët e forcave kundërinstitucionale të Republikës së Kosovës. T'i shiqojmë faktet :

1. Siç dihet, kur Ahmet Krasniqi ndodhej në garnizonin e FARK-ut në Papaj afër kufirit Shqipëri-Kosovë në qershor të vitit 1998, dhe i bënë përgaditjet e fundit për dërgimin e brigadave të para operative të UÇK-së për në Kosovë, pat ardhur një zyrtarë i komesariatit të Policisë së qytetit Baram Curri për t'ia përcjellë vendimin e Fatos Nanosit se Garnizonin e FARK-ut në Papaj dhe "Qendrën për Rekrutim, Stërvitje dhe Përgaditjen e Kuadrit Ushtarak" në Vuqidol duhet "sa më parë për ta mbyllin".

2. Dy ditë më vonë, kur Ahmet Krasniqi këthehet për Tiranë, Sigurimi i fshehtë i Shqipërisë ia përgaditi atij një pritë. U sulmua me armë zjarri, por fatmirësisht askush nuk pësoi nga ai sulm i papritur. Plaçkitet kombi i SHP të FARK-ut, me gjithë dokumentacionin e brigadave që murën Urdhërin Luftarak nga Ahmet Krasniqi për të hyrë në Kosovë. Me këtë akt terrorist të agjenturave serbo-sllavo-greke, që kishin depërtuar në SHIK-un e Shqipërisë, ia bënë me dije Ahmet Krasniqit dhe bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë se do të vriten po qe se punojnë me përkushtim për forcimin e Ushtrisë Kombëtare të Kosovës -FARK-ut.

3. Agjencia serbe në Dyseldorf të Gjermanisë organizoi një takim me një numër ushtarakësh shqiptarë në krye me Xhafetr Jasharin dhe Halil Bicën për të nënshkruar peticione, me kërkesen për ndërrimin e Ahmet Krasniqit nga posti i krysit të detyrës së Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës. Vetë fakti se peticioni i është dërguar Qeverisë së Bukoshit për ndërrimin e Ahmet Krasniqit, kur ai në bazë të Marrëveshjes së Oslos ia vuri themelet Ushtrisë Kombëtare të Republikës së Kosovës, me krijimin e Pjesës së SHP të FARK-ut në Tiranë, dhe në Kosovë i futi njësitë e para operative të UÇK-së nën komandën e Tahir Zemës, tregon se agjenciat serbo-sllavo-greke kishin ndikim në të gjitha strukturat udhëheqëse të shqiptarëve dhe se kishin mundësi të pengonin çdo veprimtari të mbarë që shkonte kundër interesave serbo-sllavo-greke. Prandaj, nuk është vështirë për të kuptuar se për hesap të kujë kërkohej dorëheqja e Ahmet Krasniqit, nga një grup ushtarakësh që i drejtonte I. Kelmendi. Forcat kundërinstitucionale me vetëdije apo pa vetëdije çonin ujë në mullinin e serbit, kur nuk pranonin bashkimin e faktorit politik dhe ushtarak të Republikës së Kosovës, për të cilin luftonte me mish dhe me shpirtë Ahmet Krasniqi dhe shumë burra të

fortë të Atdheut, diplomatët e shquar të SHBA-ve dhe miqtë e nderuar të kombit tonë. Prandaj, është plotësishtë e kuptueshme pse pengohej Ahmet Krasniqi nga agjencurat serbo-ruso-greke, nga pehlivanërt e Nanosit, nga bajraktarët e "farës ruse" si dhe nga argatët e Qosjes dhe rrogatët e Xh. Halitit & Ibrahim Kelmendit.

4. Në Shqipëri dhe në diasporën shqiptare pehlivanat e Nanosit dhe bajraktarët e "farës ruse" filluan një fushatë të gjërë shpifjesh të liga kundër dr. Ibrahim Rugovës, kolonel Ahmet Krasniqit, ushtarakut madhor Tahir Zemës dhe FARK-ut, gojarisht dhe nepërmjet gazetës së tyre poçavër "Zëri i Kosovës". Ahmet Krasniqi dhe Tahir Zemaj akuzohen me akuza shpifëse se në "marrëveshje me Jugosllavinë e mbetur" kanë krijuar "forca paralele me ato të UÇK-së", qëllimi i të cilëve është që "sëbashku me APJ" të bëjnë shkatërrimin e UÇK-së me një "sulm të përbashkët". Nga ushtarakët e Kosovës askush nuk e mbrojti Ahmet Krasniqin dhe Tahir Zemën nga shpifjet kaq të ulta, përpos njërit ushtarak i cili e bëri shkrimin por u pengua nga kompetentët ku ai punonte për ta botuar atë punim në ndonjë gazetë apo revistë shqiptare që botoheshin në Kosovë apo në diasporë. Ndërsa Bukoshi akuzohet nga klani i Emrush Xhemajli & Gafurr Elshanit se nuk po e ndihëmon UÇK-në me as një metelik nga "Fondi i Qeverisë së Kosovës", edhe pse Bukoshi iu kishte dhënë të hpolla gjatë vitit 1996 në emër të UÇK-së, edhe pse me pëlqimin e Bukoshit Ministria e Mbrojtjes, nga fondi i saj, ua kishte dhënë afër 8 miljan DM përfaqësuesëve të UÇK-së në periudhën prill-gusht 1998. Forcat kundërinstitucionale të Kosovës dhe spiunët serbë mundoheshin t'ia përgadisnin një kurthë të rrezikshme Republikës së Kosovës, kur bënë shantazhe ndaj Kryetarit të saj dr. Ibrahim Rugovës, për t'i pranuar grupet ushtarake (UÇK-në), që i kishin përvetësuar me anë të kompleteve, si Ushtri të Rregullt të Republikës së Kosovës. Rugova kishte informata të mjaftueshme për nivelin e organizimit të njëjësive guerile, prandaj e dinte se do të ishte fatale për Republikën e Kosovës të pranohen ato si Ushtri e Republikës së Kosovës. Ai e pati përkrahur Analizën Ushtarake të kolonel Ahmet Krasniqit që i është dërguar atij, Bukoshit dhe S. Berishës në janar të vitit 1997, dhe më vonë e pati përkrahur edhe Marrëveshjen e Osllos, që parashihte formimin e FARK-ut. Dhe, me siguri po të mos ishte shkëlur marrëveshja e Osllos, dhe të ishte bashkuar faktori politik dhe ushtarak i Republikës së Kosovës, Rugova do ta pranonte të bëhej Komandant Suprem i FARK-un, kuptohet kur do të aftësohej për të kryr

operacione operative, ashtu siç planifikonte Ahmet Krasniqi, me analizën e tij ushtarake të shkruar më 1996 (është botuar në Bota sot më 19 qershor - 4 korrik 2001 më titull : "Vlerësim i situatës ushtarake në Republikën e Kosovës–janar 1997"). Fatkeqësisht Marrëveshtja e Oslos u shkel nga forcat kundërinstitucionale të Republikës së Kosovës; UÇK-ja nuk u institucionalizua por u përvehtësua nga LPK-ja dhe LBDK-ja, prandaj zotëri Rugova nuk ra në grackën që ia kishin përgaditur kokëkrisurit shqiptarë dhe armiqtë tanë, për të rrahur gjoks se "UÇK-ja është Ushtria e Republikës së Kosovës", dhe se ai është "Komandant Suprem i saj", kur e dinte se UÇK-ja me organizimin që e kishte nuk ishte e zonja t'i qëndronte sulmeve të ushtrisë serbe. Dhe çfarë tragjedie do ta gjente kombin tonë, po sikur Kryetari i Republikës së Kosovës dr. Ibrahim Rugova, do ta pranonte UÇK-në për ushtri të Republikës së Kosovës, kur në fakt ajo ishte "ushtri" e Xh. Halitit dhe e R.Qosjes, (pas shkeljes së Marrëveshjes së Oslos).

### **Cila është prapavija e shpifjeve se gjoja Ibrahim Rugova nuk e ka njohur UÇK-në si ushtri të Kosovës?**

Siç dihet, pas dështimit të përpjekjeve amerikane dhe të Parlamentit të Kosovës, për formimin e një Qeverie të përbashkët prej të gjitha forcave politike dhe ushtarak të Republikës së Kosovës (korrik-gusht 1998), forcat serbe fituan dritën e gjelbër nga faktori ndërkombëtarë për fillimin e ofanzivës kundër UÇK-së. Nga kjo ofanzivë njësitë e UÇK-së nuk patën sukses t'i përballojnë makinerisë ushtarake të okupatorit, që kishte armatim të rëndë dhe u detyruan për t'u larguar për në Shqipëri, jo vetëm shumica e popullësisë të komunës së Deçanit por edhe "komandantët" dhe ushtarët e UÇK-së. Edhe në Drenicë dhe gjetiu njësitë e UÇK-së u detyruan ta lëshojnë "teritorin e çliruar", pasi që ishte e pamundur të mbrohen nga tenkset dhe njësitë e blinduara serbe me pushë gjysmautomatike 10-she, dhe kallashnikovë.

Fillimi i shtatorit të vitit 1998 ua bëri me dije argatëve të XH. Halitit dhe rrogarëve të R.Qosjes që e përbënin SHP të UÇK-së se nuk e kishin çliruar as një kilometër të teritorit të Kosovës, por Serbia për qëllime strategjike i kishte lënë të bëjnë parada dhe të rrafijn gjoks se e kanë çliruar 60% të teritorit të Kosovës, për të fituar të drejtën të bënte pastrimin etnik të Kosovës me preteks se po e ndjek UÇK-në. Vetëm të

marrët, analfabetët politik dhe tradhtarët e kombit edhe sot shpifin shpifje debile, kur e akuzojnë Rugovën se "nuk e ka njohur UÇK-në për ushtri të Kosovës", dhe nuk e dinë apo nuk duan ta dinë se po të kishte "rrafur gjoks" Rugova se "UÇK-ja është Ushtri e Republikës së Kosovës" dhe se ai është "Komandant Suprem" i saj, me humbjen e "teritoreve të lira" që i kishte "çliruar" UÇK-ja, Republika e Kosovës dhe Kryetari i saj do të detyroheshin t'i fillonin bisedimet për paqe me Serbinë-Jugosllavinë. Dhe, sipas rregullave ndërkombëtare, kur dy ushtri të dy shteteve luftojnë në mes tyre dhe lufta përfundon, organizohen bisedat për paqe. Në tavolinën e bisedimeve fituesi gjithmonë i parashtroi kushte humbësit, dhe në rastin e Kosovës, pala serbe si fituese e luftës, do t'i parashtonte kushte delegacionit të Republikës së Kosovës për paqe. Akademia e Shkencave Serbe e kishte përgaditur planin për ndarjen e Kosovës dhe e kishte publikuar ende pa filluar lufta. Ja pra çfarë humnere ia përgaditën Kosovës forcat kundërinstitucionale. Po Rugova tregoi zgjuarësi dhe largëpamësi kur për UÇK-në dha deklarata diplomatike dhe reale, se janë "fshatarë" që po e mbrojnë "pragun e shtëpisë" dhe "nderin e familjes", dhe gjithnjë kërkonte angazhimin e forcave të NATO-s, për një fazë kalimtare deri sa Kosovës t'i njihet subjektiviteti ndërkombëtar, pasi e njihte shumë mirë situatën politike, ushtarake dhe ekonomike të Shqipërisë, Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare, që shkonte më tepër në favor të çakajve të Ballkanit se sa të shqiptarëve. Pra, politika e urtë dhe e zgjuar e kryetarit të Republikës së Kosovës dr. Ibrahim Rugovës, solli intervenimin e SHBA-ve dhe aleatëve të saj ushtarakisht në Kosovë për t'i djegur planet dhe skenaret serbo-ruso-greke që i kishin thurë kundër Kosovës dhe kombit shqiptar.

PSE HASHIM THAÇI DHE XHAVIT HALITI, PASI SHKATRRUAN SHTABIN E ZONËS SË III TË RRAFSHIT TË DUKAGJINIT, KËRKUAN TAKIM ME BUJAR BUKOSHIN DHE AHMET KRASNIQIN?

5. Edhe në Kosovë, të njëjtat shpifje i bënte gazeta e studentëve kuqalosh "Bota e re", emisarët e LPK-së dhe një numër i vogël i ekstremistëve kokëkrisur të LKÇK-së, që e kishin shpallur veten "komandantë" të njësive të UÇK-së.

6. Pas sukseseve të rëndësishme të Ahmet Krasniqit dhe ushtarakëve të FARK-ut në krye me Tahir Zemën, që i treguan në frontin e luftës në Kosovë, veçmas pas fitorës së Betejës së Loxhës, dhe sidomos

pas realizimit të Marrëveshjes së Osllos edhe në teren, kur Tahir Zemaj dhe Ramush Haradinaj me bashkëpunëtorët e tyre në Propoçan krijuan Shtabin e Zonës së III Operative të Rrafshit të Dukagjinit, alarmohet Drejtoria Politike e UÇK-së, në krye me Hashim Thaçin, dhe shumë shpejtë e shkatrruan atë organizim të mbarë, duke e bindur Ramush Haradinajn të pendohet që kishte marrë pjesë në krijimin e Shtabit së bashku me Tahir Zemën, dhe t'i hajë fjalët e dhëna me rastin e formimit të Shtabit se edhe si "ushtarë do t'i kryej detyrat që do t'ia caktonte Tahir Zemaj".

7. Argatët e Xh. Halitit në krye me H. Thaçin, pasi e shkatrruan Shtabin e Zonës së III Operative të Rrafshit të Dugagjinit dhe krijuan armiqësi mes Tahir Zemës dhe Ramush Haradinajt, kërkuan takim në Tiranë me Bujar Bukoshin dhe Ahmet Krasniqin. Takimi zgjati disa ditë me ndërprerje, dhe, si përfundim i atyre bisedimeve, Bukoshi doli me një komunikatë se Qeveria e Kosovës nuk e ka krijuar FARK-un dhe se përpos UÇK-së nuk ka kurrfarë forcash tjera ushtarake. Me këtë deklaratë, Ahmet Krasniqit iu bë tradhtia e parë publike nga Kryeministri i Kosovës Bujar Bukoshi, i cili, në vend se ta njoftonte opinionin për Marrëveshjen e Osllos apo ta lejonte Ahmet Krasniqin të flas për atë marrëveshje, pasi që u pa se Marrëveshja u shkel nga forcat kundërinstitucionale, dhe se nuk kishte pse ta ruante më si sekret ushtarak, ai krijoi huti dhe përçarje edhe në forcat e shëndosha kombëtare, të cilat ishin në dijeni të arrijtjes së marrëveshjes së Osllos në mes Ahmet Krasniqit dhe Adem Demaçit, që parashihte që dy subjektet ushtarake : UÇK-ja dhe Ministria e Mbrojtjes do t'i formojnë Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës(FARK-un) që do të përbëheshin nga UÇK-ja (njësi operative të FARK-ut), Aviacioni Luftarak, Mbrojtja Teritoriale, dhe njësitë e Ministrisë së Mbrendshme.

**Forcat kundërinstitucionale të Kosovës në krye me Qosjen, morën detyra konkrete për pengimin e Ahmet Krasniqit dhe FARK-ut.**

8. Edhe LPK-ja, (të dya klanet : klani i Xh. Halitit edhe klani i I. Kelmendit) e penguan punën e SHP të FARK-ut në Shqipëri nëpërmjet emisarëve të tyre, duke iu krijuar probleme të mëdha eprorëve të FARK-ut, që merreshin me logjistikë në Shqipëri, nëpërmjet Polisisë Rugore dhe Policisë Financiare, duke ua plaçkitur armatimin që e blenin në

Shqipëri, apo e sillshin nga jashtë. Shpeshherë burgoseshin eprorët ushtarakë, rojet e Ministrisë dhe shoferët e kamionëve, që banin armë për FARK-un.

9. Edhe forcat kundërinstitucionale të Kosovës në krye me Qosjen morën detyra konkrete për pengimin e Ahmet Krasniqit dhe FARK-ut. H. Hyseni luajti rolin e falltorit kur doli jashtë Kosovës me qëllim të bashkimit në veprim të të gjitha klaneve dhe individëve me ndikim që i përbënin forcat kundërinstitucionale, për pengimin dhe eliminimin e Ahmet Krasniqit nga skena politike dhe ushtarake të Kosovës.

10. Ndërsa Gani Sylja, njëri ndër argatët më të besueshëm të H. Hysenit, dhe Shaip Bilalli ish - udhëheqës i Partisë së Prosperitetit të Maqedonisë, ia përgaditën një kurth të rrezikshme Ministrisë së Mbrojtjes, kur luajtën lojën e ndërmjetësit mes Ministrisë dhe tre tregëtarëve me nënshtetësi turke, për lidhjen e një marrëveshjeje për blerjen e armatimit modern për njësitë operative të UÇK-së, në një vlerë prej 49 miljan DM. Tregtarët e morën një kopare prej 8 miljan e 700 mij DM. Sipas marrëveshjes armatimi duhej të dorzohej në fund të korrikut 1998 Tahir Zemës dhe njërive të tjera operative të UÇK-së në Kosovë, por më vonë u kuptua se në fakt ajo marrëveshje nuk ishte asgjë tjetër përpos një kurrthë e ngrehur nga karrieristët e sëmuar për pushtet të LBDK-së, qëllimi i të cilëve ishte për ta penguar armatosjen dhe forcimin e FARK-ut, dhe të bëjnë përvetësimin (vjedhjen) e një shume të konsiderueshme të mjeteve që i kishte caktuar Qeveria e Bukoshit për Ministrinë e Mbrojtjes. Tregtarët turq i morën të hollat nga Ministria e Mbrojtjes, por armatimin nuk e dorzuan, ndërsa Bukoshi,, hidhërohet" që Ministria ishte tradhtuar, dhe më nuk derdhi të holla për armatimin e njërive të UÇK-së. Ndërsa me tregtarët turq e angazhoj të mirrej njeriun i tij i besueshëm që punonte në Përfaqësinë e Republikës së Kosovës në Shqipëri zotëri Kadri Balën. Fatmirësisht, veprimtarë të dalluar të çështjes kombëtare dhe aktivistë të LDK-së, çdo ditë sillnin ndihëma financiare dhe mjete ushtarake në Pjesën e SHP të FARK-ut në Tiranë, dhe në këtë mënyrë zbutej deri dukund kriza financiare e FARK-ut. Duhet theksuar se Ahmet Krasniqi dhe SHP i FARK-ut çdonjërit që ka sjellë ndihma me vleftë prej 100 e deri një milion e më tepër DM, apo valuta tjera i kanë regjistruar dhe i kanë dërguar në Bankën e Kosovës "Dardania" në Tiranë, dhe donatorëve iu kanë lëshuar vërtetime dhe falenderime për ndihmat që ia kanë sjellë Ministrisë së Mbrojtjes. Pra,

mosrealizimi i marrëveshjes për blerjen e armatimit ishte tradhtia e dytë, pas asaj të Oslos, që ia bënë Ministrisë së Mbrojtjes dhe FARK-ut përfaqësuesit e LPK-së-UÇK-së dhe krerët e LBDK-së nepërmjet Xh. Halitit & kompani dhe Gani Sylës dhe Shaip Bilallit & kompani.

**Ahmet Krasniqi dha shembull konkret se shqiptarët duhet harruar mosmarrëveshjet, xhelozitë dhe hasmëritë që i kishin mes vete për shkak se ishin në luftë me Serninë**

Ahmet Krasniqi edhe pse ishte i vetëdijshëm se kundër tij dhe SHP të FARK-ut po bëhën komplete të rrezikshme, nuk e ndali veprimtarinë e tij për bashkimin e subjekteve politike dhe ushtarake të Republikës së Kosovës, duke u mbështetur në parimet e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe vëllazëror, tolerancës, mirëkuptimit dhe tejkalimit të problemeve në mënyrë vëllazërore. Ai dha shembull konkret se shqiptarët duhet harruar mosmarrëveshjet, gjelozitë dhe hasmëritë që i kishin në mes vete për shkak se ishim në luftë me Serbinë. Kështu, ai, edhe pse ishte në dijeni se Halil Bicaj dhe Xhafer Jashari ishin nënshkrues të peticionit, që kërkonin dorëheqjen e tij nga Kryesi i Detyrës së Ministrit të Mbrojtjes, ndaj tyre pati qëndrim vëllazëror, kur u paraqitën në SHP të FARK-ut në Tiranë për sistemim. Ai, duke u mbështetur në traditën dhe trashëgiminë tonë kombëtare, se kur fillon lufta me të huajin, falen apo pushojnë hasmëritë. (ngatrrerat, hidhërimet, gjaqet etj), Halil Bicën e caktoi Kryeshef të SHP të FARK-ut, duke u mbështetur në aftësitë dhe përvojën luftarake që kishte fituar në luftën serbo-bosnjake, ndërsa Xhafer Jasharin e caktoi Kryeshef të SHP të FARK-ut për Logjistikë dhe Zëvendës të Ministrit për logjistikë në bazë të aftësive profesionale që i kishte fituar gjatë shkollimit.

"BESËN PO UA JAP SE, PASI TA ÇLIROJMË KOSOVËN, KURRFARË DETYRE UDHËHEQËSE NUK DO TË MARR PËR VETE!"- I THA AHMET KRASNIQI SAMI LUSHTAKUT

Ahmet Krasniqi nuk ishte prej atyre që heqin dorë nga synimet posa t'i u paraqitet pengesa e parë. Ai ishte një personalitet me karakter të fortë. Pengesat që i dilnin jo vetëm që nuk e dobësonin, por e forconin dhe e bënë më këmbëngulës në realizimin e qëllimeve madhore kombëtare. Kështu ai edhe pse mori urdhërin nga Nanosi për t'i mbyllur dy Qendrat e FARK-ut në Vuqidol dhe në Papaj, jo vetëm që nuk i mbylli



këto qendra, por hapi edhe dy qendra të tjera në afërsi të Kukësit, në Kalimash dhe në Kolsh.

Se Ahmet Krasniqi nuk kishte synime karrieriste dëshmon fakti se ai pasi mori vesh për nënshkrimin e peticioneve në Dyzendolf të Gjermanisë, ia ofroi dorëheqjen B. Bukoshit, por ai dorëheqjen e tij nuk e pranoi, pasi që ishte i vetëdijshëm se shumica e ushtarakëve do të kundërshtonin një vendim të tillë, sepse ai kishte ardhur në krye të Ministrisë së Mbrojtjes në mënyrë institucionale, me pëlqimin e përfaqësuesve (kordinatorëve) të grupeve ushtarake që ishin krijuar në shtetet e Evropës Perëndimore, të Kroacisë dhe të Sllovenisë, por ishte kundër çdo logjike të pranonte dorëheqjen e tij pas gjithë atyre sukseseve që i kishte arritur pas Marrëveshjes së Oslos.

### **Demaçi nuk pranoi të takohej me Ahmet Krasniqin me arsyetimin se nuk kishte kohë të dilte jashtë Kosovës**

Ndërsa pas fushatës së shpifjeve të kryedajave të LPK-së, që e bënë nepërmjet "Zërit të Kosovës" se Ahmet Krasniqi ka krijuar "forca paralele" me ato të UÇK-së, dhe shpifjeve të tjera debile, ai kërkoi nga Bukoshi që të zbardhet Marrëveshja e Oslos dhe të shpjegohet domethënia e FARK-ut, por Bukoshi nuk dashi vetë të bëjë shpjegime të nevojshme dhe as Ahmet Krasniqin nuk e lejoi të njoftonte opinionin për Marrëveshjen e Oslos. Ahmet Krasniqit s'i mbetet tjetër përpos t'i njoftonte personalitetet që kishin ndikim tek faktori politik shqiptar për Marrëveshjen e Oslos, për ndihmat që i janë dhënë UÇK-së në të holla dhe për pengesat që po i dalin në forcimin e FARK-ut. Ai pati biseduar nepërmjet telefonit edhe me disa komandantë të UÇK-së, që Xh. Haliti & kompani i fajësonin se ata po e "kundërshtojnë Marrëveshtjen e Oslos", me qëllim që tua shpjegonte shkurtimisht Marrëveshjen e Oslos dhe domosdonë e bashkimit të faktorit ushtarak, po qe se kanë synim çlirimin e Kosovës. Po e ceku një bisedë me telefon që e pati Ahmet Krasniqi me Sami Lushtakun gjatë muajit gusht të vitit 1998. Atë bisedë e pata dëgjuar unë dhe Hilmi Nebihu. Ai pasi i shpjegoi Sami Lushtakut se për bashkimin e UÇK-së dhe të Ministrisë është arritur marrëveshja, e luti si për gjak që të ndikojë ku ka mundësi ta "bashkojmë UÇK-së", ta "trashim UÇK-në" dhe ta "çlirojmë Kosovën"! Dhe në përfundim të bisedës i tha: "Besën po ua jap se pasi ta çlirojmë Kosovën kurrfarë detyre

udhëheqëse nuk do të marr për veti! Do të kthehëm të shes specia në Kroaci, ku pata shitur më parë, vetëm të bashkohemi dhe ta çlirojmë Kosovën!". (Ahmet Krasniqi pasi përfundoi lufta serbo-kroate, edhe pse e pati ndihmuar Ushtrinë Kroate me armatim dhe mjete luftarake, qe burgosur dhe dënuar me dy vjet burgim për shkak se pati kundërshtuar për të marrë pjesë në luftën kroato-serbe ushtarët shqiptarë, që shërbenin shërbimin ushtarak në APJ dhe i kishte zënë lufta në Kroaci. Pas daljes nga burgu Ahmet Krasniqi për të siguruar kafshatën e gojës qe detyruar të punonte si shitës i pemëve dhe i perimeve në Kroaci).

Ahmet Krasniqi gjatë muajit gusht të vitit 1998, nepërmjet meje bëri përpjekje për t'u takuar me Adem Demaçin në Shqipëri ose dikund tjetër, duke shpresuar se me të do t'i sqaronin dhe do t'i largonin shumë probleme që i vinin nga Xh. Haliti & kompani, por Demaçi nuk pranoi takimin duke u arsyetuar se nuk ka kohë të dal jashtë Kosovës (Në atë kohë ishte Zëdhënës i Përgjithshëm i UÇK-së në Prishtinë.).

Ndërsa për t'i neutralizuar dëmet dhe pengesat e mosrealizimit të marrëveshjes për blerjen e armatimit prej 49 miljan DM me tregtarë turq, Ahmet Krasniqi e dërgoi një delegacion të SHP të FARK-ut në Bosnjë dhe Hercegovinë me një porosi për blerjen e një armatimi modern për njësitë e UÇK-së në Kosovë. Delegacioni ushtarak i Ministrisë së Mbrojtjes edhe pse e arritën marrëveshjen me palen boshnjake, se të hollat do t'i marrin vetëm atëherë kur armatimi arrin në vendin e duhur në Kosovë, Bukoshi e shkeli marrëveshten, duke mos i dhënë të hollat për blerjen e armatimit të kontraktuar. Edhe delegacioni tjetër arriti sukses me kreun ushtarak të një shteti misliman të Azisë, kur premtuan t'ua sjellin armatimin e nevojshëm FARK-ut falas, me një kusht që Shqipëria të mos u sjellë probleme ndërkombëtare, kur do ta shkarkonte armatimin në ndonjë port të Shqipërisë. Po ku do të linin pehllivanët e Nanosit të futen armët moderne nga jashtë, kur e kishin marrë urdhrin nga Nanosi, Mejdani dhe Klosi që vetëm kallashët e Shqipërisë që vetëm kallashët Shqipërisë të dalë nga përdorimi, të dërgohen në Kosovë.

Çështja e legalizimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Pjesës së SHP të FARK-ut ishte detyrë e Qeverisë së Bukoshit, por kur Ahmet Krasniqi kuptoi se Bukoshi ishte kunder legalizimit të këtij subjekti ushtarak të Republikës së Kosovës, si mbeti tjetër përpos vetë të bënte përpjekje për legalizimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të SHP të FARK-ut në Shqipëri. Edhe pse kërkesa e Ministrisë së Mbrojtjes dhe e SHP të FARK-ut për

legalizim u bë në formën e shkruar, gjatë fundit të qershorit të 1998, Ahmet Krasniqi nuk mori kurrfarë përgjigje nga Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë. Edhe kërkesat tjera të Ahmet Krasniqit, që t'u lejohet qarkullimi pa pengesa i mjeteve të transportit të Ministrisë së Mbrojtjes nëpër Shqipëri, t'u jepet leja për mbajtjen e armëve ushtarëve të UÇK-së, që e kishin për detyrë të kujdesen për sigurinë fizike të stafit udhëheqës të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të SHP të FARK-ut, etj, Ahmet Krasniqi dhe SHP i FARK-ut nuk morën kurrfarë përgjigje nga Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë.

Siç po shifet Ahmet Krasniqi pati shumë pengesa nga të gjitha anët, por pengesa më e madhe i erdhi nga Bukoshi i cili nuk e bëri legalizimin e Ministrisë së Mbrojtjes, të SHP të FARK-ut dhe të Ahmet Krasniqit në organet përkatëse të Shqipërisë.

Pra, sipas ngjarjeve që u zhvilluan gjatë vitit 1998 Qeveria e Kosovës ishte në hamendje se me cilën palë të bënte aleancë : me forcat institucionale apo me forcat kundërinstitucionale. Më në fund Bukoshi me Qeverinë e tij bëri aleancë të mësheftë me Qosjen dhe Ibrahim Kelmendin. Prandaj mospërkrahja e Ahmet Krasniqit nga Qeveria e Bukoshit dhe nga vetë Bukoshi sa duhet dhe si duhet, ishte rrjedhim i veprimtarisë dhe bindjeve politike të Ahmet Krasniqit, i cili nuk ra nën ndikimin e forcave kundërinstitucionale, por përkundrazi ai mendohej për t'i bindur krerët e tyre se çlirimi i Kosovës nuk mund të arrihet duke i luftuar institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, por duke i përkrahur ato që janë krijuar me mund të madh, dhe duke i krijuar së bashku institucionet shtetërore që ende nuk ishin krijuar.

### **Xhafer Jashari pengoi dhe sabotoi armatoshjen e njësisë operative të UÇK-së që i pati krijuar Ministria e Mbrojtjes**

Ahmet Krasniqi pasi mori vendimin për formimin e Drejtorisë Informative të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, dha urdhër për nxerrjen e organit të Ministrisë së Mbrojtjes. Drejtori i kësaj Qendre ushtaraku Rifat Haxhijaj, i kreu me përpikëri detyrat dhe brenda një kohe të shkurtër e bëri të gatshëm nr 1 të organit të Ministrisë së Mbrojtjes "Revistë ushtarake" për botim, por Qeveria e Bukoshit ndaloj daljen e saj nga shtypi. Numri i parë i kësaj reviste u botua disa ditë para se të vritej Ahmet Krasniqi, ndërsa numri i dytë pas vrasjes së tij, pa dijen

dhe pëlqimin e Bujar Bukoshit dhe me punën e palodhshme të Rifat Haxhiajt.

Ahmet Krasniqi u pengua edhe nga një numër i ushtarakëve që i përkisnin stafit udhëheqës të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Pjesës së SHP të FARK-ut, të cilët ishin dërguar nga forcat kundërinstitucionale të Kosovës me detyra speciale. Në rend të parë ata kishin për detyrë të vëzhgonin dhe të pengonin punën dhe veprimtarinë e Ahmet Krasniqit dhe të bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë, në mënyrë perfide. Ata të shumtën e rasteve nuk i kryenin detyrimet që i kishin ndaj subjektit ushtarak, ndërsa për moskryetjen e detyrave gjithmonë gjenin një shkak të "arsyeshëm", se "janë të sëmuar", se "kanë probleme familjare" etj, por qëllimi i tyre ishte pengimi i Ahmet Krasniqit dhe i SHP i FARK-ut, në kryerjen e detyrave ushtarake për të cilat ishin përcaktuar. Kështu kryeshefi i SHP të FARK-ut Halil Bicaj që kur u caktua në atë pozitë udhëheqëse e deri sa u vra Ahmet Krasniqi vetëm një herë ka shkuar në një Qendër stërvitore për vizitë, ndërsa Agim Mehmeti që ishte zv. ministër i Ministrisë së Mbrojtjes dhe zv. Komandant i SHP të FARK-ut nuk e pa të udhës së paku një herë të shkonte në një Qendër stërvitore për të kontrolluar nivelin e aftësimit të njësive ushtarake të UÇK-së për kryerjen e detyrave luftarake ose thjeshtë për ta bërë një revistë ushtarake. Ndërsa Xhafer Jashari pengoi dhe sabotoi armatosjen e njësive operative të UÇK-së që i pati krijuar Ministria e Mbrojtjes

#### **ÇKA I SHKROI AHMET KRASNIQI BUJAR BUKOSHIT NË NJË LETËR DËRGUAR NË GUSHT TË VITIT 1998**

Pas gjithë këtyre pengesave që ju paraqitën Ahmet Krasniqit nga të gjitha anët, atij nuk i mbeti tjetër përpos t'i luftonte të gjitha këto forca të së keqes, këta dyftyrësh, që hanin me shumë lugë, këta demagogë, që tjetër flisnin e tjetër vepronin. Ishte fundi i muajit gusht kur Ahmet Krasniqi u bind plotësisht se duhej ndërruar status-quoja në SHP të FARK-ut dhe në Qeverinë e Bukoshit. Ai nuk ishte i knaqr me raportet Qeveri e Kosovës-Ministri e Mbrojtjes- Pjesa SHP të FARK-ut, dhe as nuk ishte i kënaqur me raportet ndërnjerëzore në këto raporte. Ishte fundi i muajit gusht kur vendosi të "rrebelohet". Me Bukoshin vendosi të ndërrojë formën e komunikimit. Deri në takimin e fundit që ai e pati me Bukoshin (mesi i gushtit 1998) me të komunikonte vetëm gojarisht. Pas atij takimi ku merrnin pjesë : Bujar Bukoshi, Ahmet Krasniqi, Agim Mehmeti, Halil Bicaj dhe Xhafer Jashari, Ahmet Krasniqi vendosi të

komunikojë edhe me shkrim, pasi që e kuptojë se kundër tij luhej një lojë e rrezikshme, për t'ia ngarkuar në shpinë fajet e Qeverisë së Bukoshit dhe fajet e një numri të caktuar të ushtarakëve që mbanin pozita udhëheqëse në Pjesën e SHP të FARK-ut në Tiranë. Ai në fund të gushtit ia shtroi me shkrim këto kërkesa Bujar Bukoshit :

1. Të finansohen Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës nga Fondi i Qeverisë sipas parallogarisë që i duhën për armatim, veshmbathje, dhe ushqim, të mbështetur në standarde ushtarake.

2. Të legalizohet ministri i Mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës, në organet përkatëse të Shqipërisë.

3. Të bëhen ndryshime në Ministrinë e Informatave dhe në TV-në e Kosovës.

4. Të bëhen sqarime të nevojshme me përfaqësues të UÇK-së, për t'i bindur se është në të mirën e Kosovës rrespektimi i Marrëveshtjes së Oslos.

5. Po që se përfaqësuesit e UÇK-së edhe më tutje nuk e rrespektojnë Marrëveshjeje. Oslos, të dilet në opinion me sqarime të nevojshme për ndriqimin e kësaj Marrëveshjeje. Ahmet Krasniqi ia doezoi Bukoshit me shkrim edhe llogarinë e të gjitha harxhimeve që i kishte bërë Ministria e Mbrojtjes në periudhën kohore mars-gusht 1998.

SI U BËNË PËRGADITJA PËR VRASJEN E AHMET KRASNIQIT

Kreu ushtarak serb i dinin shumë mirë aftësitë ushtarake të Ahmet Krasniqit dhe të ushtarakëve tjerë shqiptarë që i kishin kryer akademitë ushtarake në Jugosllavi. Ata e dinin se po të lejohej të vepronte edhe më tutje Ahmet Krasniqi në forcimin e FARK-ut, dhe dërgimin e formacioneve ushtarake nga Shqipëria në Kosovë do t'ua dëmtonte rëndë interesat e tyre ushtarake-strategjike në Ballkan, dhe do t'ua bënte të parealizueshme skenarët dhe planet që i kishin përgaditur kundër popullit tonë. Edhe forcat kundërinstitucionale në krye me Xh. Halitin & I. Kelmendin dhe R.Qosjen & kompani, kur u bindën se nuk do të kenë sukses për ta bërë për veti Ahmet Krasniqin, për t'i luftuar subjektet shtetërore të Republikës së Kosovës, dhe se veprimtaria e tij po i dëmtonte interesat e tyre grupore dhe karrieriste, u pajtuan me përfaqësuesit e agjenturave serbo-sllavo-greke, që kishin zënë pozita udhëheqëse në LPK-në dhe LBDK-në, dhe në udhëheqjen e SHP të UÇK-së, ta largojnë

Ahmet Krasniqi nga skena politike dhe ushtarake e Kosovës. Këto forca pastaj nuk e patën vështirë ta fusin në këto komplete Klosin dhe SHIK-un për t'iu ndihmuar në organizimin e atentatit kundër Ahmet Krasniqit, kuptohet me një pagesë të majshme nga fondet që janë mbledhur nga qytetarët e Kosovës për ta ndihmuat luftën çlirimtare të Kosovës. Siç dihet, kriminelët i bënë parapërgaditjet, u caktua koha e ekzekutimit dhe u caktua vendi i pushkatimit. Dhe nuk është rastësi që u zgjodh vendi në afërsi të "Shtëpisë së Partisë", aty ku më 1941 ishte formuar "Partia Komuniste Shqiptare" nga M. Popoviqi, D. Mugosha dhe E. Hoxha. Pra donin ta bënin pushkatimin e Ahmet Krasniqit në afërsi të shtëpisë ku ishte lidhur aleanca në mes çetnikëve serbosllavë me yllin komunist në ballë, dhe hiçkërkërkushëve- mendjeshkurtëve të Shqipërisë, për t'u treguar nacionalistëve shqiptarë kudo që janë në botë se fara ruse i ka të thella rrënjët në tokat shqiptare, dhe se popoviqët dhe mugoshët kanë ndërtuar qerdhe të shumta nepër Shqipëri dhe në trojet tjera shqiptare dhe se nuk është punë aq e lehtë, siç mendojnë shumë "veprimtarë", se me propogandë dhe retorikë do të zhbihet nga trojet shqiptare fara ruse dhe do të shkatërrohen çrddhet e agjenturave serbo-sllavo-greke.

Por para se t'i ndriçojmë përgaditjet për vrasjen e Ahmet Krasniqit duhet të japim përgjigje në këto pyetje :

Pse armiqtë tanë dhe vazalët e tyre të Tiranës zyrtare, së bashku me forcat kundërinstitucionale të Kosovës zgjodhën vrasjen si mjet për largimin e Ahmet Krasniqit nga skena ushtarake dhe politike e Kosovës, kur kanë mundur thjesht ta largojnë duke e pranuar kërkesen e tij për dorëheqje nga pozitat udhëheqëse që i mbante. (Ahmet Krasniqi pati paraqitur dorëheqje nga funksionet që i mbante njëherë në qershor dhe herën tjetër në gusht të vitit 1998, por stafi udhëheqës i Ministrisë dhe B. Bukoshi nuk e patën miratuar dorëheqjen e tij).

## **Cilat kanë qenë arsyet kryesore për vrasjen e Ahmet Krasniqit?**

Për forcat kundërshqiptare ishin shumë faktorë që ndikuan në marrjen e vendimit për vrasjen e Ahmet Krasniqit, por ndër kryesorët ishin :

1.Vendosmëria e Ahmet Krasniqit për jetësimin e Marrëveshjes së Oslos; puna e tij këmbngulse për shpartallimin e pengesave që i vinin nga të gjitha anët, fatkeqësisht edhe nga nuk i kishte pritur; hartimi i

planit për futjen e njësive operative të UÇK-së, Brigadën "Skënderbeu", Brigadën 141, 142, 132 dhe Bataljanin Diverzanto-Vëzhgues në frontin e luftës në Kosovë gjatë muajëve shtator-tetor 1998. Me Brigadën "Skënderbeu" pati vendosur të futej edhe vetë në Kosovë. Planet dhe përgaditjet e Ahmet Krasniqit u kishin rënë në vesh argatëve të Xh. Halitit dhe të I. Kelmendit. Vetëkuptohet që edhe agjenturat serbo-sllavo-greke dinin për përgaditjet që i bënte Ahmet Krasniqi për të hyrë në Kosovë. Prandaj dorheqja e Ahmet Krasniqit nga kreu i subjektit ushtarak të Republikës së Kosovës nuk do t'i bënte të përealizueshme planet e tij. Të përealizueshme do t'i bënte planet e tij për futjen e brigadave operative të UÇK-së në Kosovë vetëm vrasja e tij.

2. Mundësia për përvetësimin(vjedhjen) e mjeteve financiare, që ishin paraparë për blerjen e armatimit dhe materjalit ushtarak nga Qeveria e Bukoshit për njësitë operative të UÇK-së. Po qe se merret në shqyrtim marrëveshja që është lidhur në mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe tre tregëtarëve me nënshtetësi turke, për blerjen e armatimit për njësitë operative të UÇK-së me një vlerë prej 49 miljan DM, dhe i analizojmë detajet se kush e organizoi, kush e ndërmjetësoi dhe e përgaditi takimin në mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe tregtarëve turq (në rangun e dytë të personave që ua përgaditën kurrthën Ministrisë së Mbrojtjes ishin Gani Sylja dhe Shaip Bilalli); pse të hollat në një shumë prej 8 milion e 700 mijë DM, në emër të paradhënies u janë dhënë tregtarëve turq pa dijen e Ahmet Krasniqit; kush vendosi në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe kush ua ka dhënë të hollat tregtarëve turq; dhe së fundi si ka përfunduar ajo marrëveshje dhe pse u caktua nga Bukoshi të merret me atë marrëveshje njeriu më i besueshëm i tij Kadri Balaj, të jep të kuptosh se marrëveshja për armatim nuk ishte asgjë tjetër por vetëm një kurth i përgaditur nga kreu i forcave kundërinstitucionale, (menjëherë pas arrijtjes së Marrëveshjes së Osllos), me të cilën donin t'i arrinin dy qëllime : a). Ta pengonin armatosjen e njësive operative të UÇK-së që përgaditeshin në qendrat e stërvitjes që ishin krijuar nga SHP i FARK-ut në afërsi të kufirit Shqipëri-Kosovë, dhe b) Përvetësimin(vjedhjen) e një shume disa milionëshe të mjeteve financiare të Ministrisë së Mbrojtjes për xhepat e disa krerëve të forcave kundërinstitucionale të Kosovës.

3. Ta mohonin Marrëveshjen e Osllos. Forcat kundërinstitucionale të Republikës së Kosovës ishin të vetëdijshme se me ndriqimin(zbardhjen) e Marrëveshjes së Osllos nga Ahmet Krasniqi,

opinionin ynë do t'i konsiderojë fajtorë krerët e LPK-së dhe të LBD-së, për shkeljen e Marrëveshjes së Oslos, dhe më nuk do të pinë ujë shpifjet e tyre se Rugova dhe LDK-ja janë fajtorë për mosbashkimin e faktorit ushtarak të Republikës së Kosovës. Se është kështu dëshmon fakti se edhe pse Xh. Haliti dhe argatët e tij e mohojnë egzistimin e kësaj marrëveshjeje, ende nuk u ndriçua ajo nga përgjegjësit e ish-Qeverisë së Bukoshit dhe as nga përgjegjësit e ish- Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës.

CILA ISHTE POROSIA E AHMET KRASNIQIT PËR BRIGADËN "SKËNDERBEU", PËR BRIGADAT 141, 142, 134, PËR BATALIONIN DIVERSANTO-VËZHgues DHE PËR BATALIONIN E POLICISË USHTARAKE?

Ishte gushti i vitit 1998, kur forcat serbe patën marrë një fushatë të egër kundër njësive të UÇK-së dhe popullsisë civile të Drenicës dhe të Dukagjinit, pas dështimit të diplomacisë amerikane që mendohej t'i detyronte forcat politike (institucionale dhe kundërinstitucionale) për të bërë një qeveri të përbashkët. Siç dihet Mehmet Hajrizi e pranoi mandatin për formimin e Qeverisë që ia dha Kryetari i Kosovës dr. Ibrahim Rugova, por planin amerikan për krijimin e Qeverisë së Kosovës nuk e përkrahën B. Bukoshi me ministrat e tij, R.Qosja me LBDK-në, dhe A.Demaçi me Shtabin e Xh. Halitit që quhej SHP i UÇK-së. Si rrjedhim i papërgjegjësisë së plotë të forcave kundërainstitucionale, që ishin çuar peshë "për ta marrë pushtetin" mbi qytetarët e Kosovës, kur fuqi dhe dije nuk kishin ta fitonin as një betejë kundër ushtrisë serbe, dhe çka ishte më e keqja, nuk donin t'i dëgjonin as këshillat e miqve të kombit tonë që ishin vënë në krye të diplomacisë së SHBA-ve. Siç dihet pas dështimit të diplomacisë amerikane për formimin e Qeverisë së Kosovës, populli martir i Kosovës mbeti pa përkrahjen e faktorit ndërkombëtar dhe kështu Serbisë i erdh "langu në bisht" për t'u çepuar jo vetëm njësive të UÇK-së, por edhe popullsisë civile. Drenica dhe Dukagjini u shkelën nga forcat serbe. Njësitë territoriale të Ramush Haradinajt pa kurrfarë komande u larguan në Shqipëri. Edhe njësitë operative të UÇK-së, që ishin nën komandën e Tahir Zemës, u detyruan t'i lëshonin pozicionet që i mbanin dhe të mos e pranojnë luftën frontale me ushtrinë serbe, në rend të parë se ishte grumbulluar një popullsi e madhe civile në territoret ku i mbanin njësitë operative të UÇK-së, që i komandonte komandant Tahir Zemaj. Tirana dhe Durrësi ishin të mbushur me civilë nga Dukagjini dhe ushtarë



e "komandantë" të vetshpallur të UÇK-së, në mesin e të cilëve ishte edhe Xh. Haliti, A.Syla, H.Thaçi, I. Kelmendi, R. dhe H. Haradinaj, "komandant çorri" dhe shumë "çorra" tjerë me nofka të llojllojshme. Këto kushte dhe rrethana shumë të vështira për shqiptarët, që mbetën pa përkrahjen e faktorit ndërkombëtarë dhe sulmoheshin nga forcat e Kasapit të Ballkanit, në vend që të ndikonte në vetëdijësimin e krerëve të forcave kundërinstitucionale për t'u bashkuar me forcat institucionale për krijimin e Qeverisë së përbashkët, që e kërkonte Parlamenti i Republikës së Kosovës dhe aleatët tanë, ata bënë lista për pushkatimin e burrave më të mirë të kombit, që nuk arritën t'i bënin argatë dhe skllevër të tyre. Në këto rrethana Ahmet Krasniqi pati kërkuar nga Salih Berisha të ndërrmerte ç' ishte e mundur për bashkimin e faktorit politik dhe ushtarak të Kosovës, ndërsa vetë bënte përgaditjet e fundit për t'i futur në Kosovë njësitë operative të UÇK-së, që ishin përgaditur në qendrat e stërvitjes të FARK-ut afër Tropojës dhe Kukësit.

**Vendimi për vrasjen e Ahmet Krasniqit është bërë gjatë muajit gusht, por përgaditjet e përsheptuara për vrasjen e tij kanë filluar nga fillimi i shtatorit 1998-es**

Ishte fillimi i shtatorit të 1998 kur komandanti i SHP të FARK-ut kolonel Ahmet Krasniqi vendosi t'i vizitojë njësitë operative të UÇK-së : Brigadën "Skënderbeu, brigadat 141, 142, 134, Batalionin Diversantovëzhgues dhe Bataljanin e Policisë Ushtarake. Me të patën shkuar disa anëtarë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të SHP të FARK-ut. Gjatë vizitës komandanti i SHP të FARK-ut kolonel Ahmet Krasniqi bëri vlerësimin e përgaditjeve të çdo njësie ushtarake veç e veç, dhe konstatoi se të gjitha njësitë ushtarake janë në gjendje të kryejnë aksione operative kundër ushtrisë serbe në Kosovë. Pehlivanat e Nanosit, agjencitë serbo-sllavo-greke, SHIK-u, dhe bajraktarët e farës ruse e përcillnin me interesim veprimtarinë e Ahmet Krasniqit nëpërmjet ushtarakëve që ishin hyrë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në SHP të FARK-ut me detyra speciale nga krerët e LPK-ja dhe të LBDK-së.

Hyrja e Ahmet Krasniqit në Kosovë me njësitë operative të UÇK-së, që planifikonte të bëhej gjatë gjysmës së dytë të shtatorit dhe gjysmës së parë të tetorit të 1998-es i alarmoi agjencitë serbo-sllavo greke dhe forcat kundërinstitucionale të Republikës së Kosovës dhe vendosën ta

bëjnë pengimin e një veprimi të tillë. "Qendra e Krimit" e krijuar nga krerët e LPK-së, LBDK-së, Shtabit të Xh. Halitit që quhej SHP i UÇK-së dhe të disa individëve që kishin pozita të larta shtetërore në mesin e të cilëve kishte edhe spiunë serbë dhe grekë, morën vendimin për vrasjen e Ahmet Krasniqit. Vendimi për vrasjen e tij është bërë gjatë muajit gusht, por përgaditjet e përshpejtuara për vrasjen e tij kanë filluar nga fillimi i shtatorit të 1998-es, ndërsa përgaditjet përfundimtare në javën e dytë dhe javën e tretë të shtatorit, derisa ai ishte për vizitë në qendrat e stërvitjes të FARK-ut afër kufirit Shqipëri-Kosovë. Faktet dëshmojnë se në përgaditjen për vrasjen e Ahmet Krasniqit kanë marr pjesë edhe disa ushtarakë që i përkisnin stafit udhëheqës dhe komandues të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe të SHP të FARK-ut, të cilët ishin bërë klysh dhe argatë të Xh. Halitit, I. Kelmendit dhe të H. Hysenit. T'i shikojmë faktet me radhë :

**Pse SHP i FARK-ut pranoi propozimin për vendosjen e Ahmet Krasniqit në shtëpinë e oficerit të SHIK-ut Shyqiri Toskës, që Ministria e Mbrojtjes e kishte marrë me qira për nevoja të Drejtorisë Informative?**

a). Ahmet Krasniqi banonte në një banesë që ia kishte siguruar Shaip Muja në qendër të Tiranës, (afër Piramidës) qëkur pati shkuar në Shqipëri me stafin e Ministrisë së Mbrojtjes, për të krijuar Pjesën e SHP të FARK-ut në Tiranë. Të vritet Ahmet Krasniqi në qendër të Tiranës nuk ishte edhe aq lehtë, prandaj Qendra e Krimitu u ka dhënë për detyrë argatëve të tyre që kishin arritur të depërtojnë në stafin udhëheqës të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të SHP të FARK-ut, për t'ia ndërruar banesën Ahmet Krasniqit derisa ai i vizitonte qendrat e stërvitjes të FARK-ut. (java e dytë e shtatorit 1998). Këta tradhtarë të kombit arrijnë ta bindin SHP të FARK-ut për të dhënë pëlqimin për t'ia ndërruar banesën Ahmet Krasniqit, gjoja se për qëllime të " sigurisë "së tij. Shtrohet pyetja pse SHP i FARK-ut nuk e kundërshtoi propozimin e klyshëve të I. Kelmendit, Xh. Halitit dhe të H. Hysenit, që Ahmet Krasniqit t'i caktohet banesa në shtëpinë e oficerit të SHIK-ut Shyqiri Toskës, që Ministria e Mbrojtjes e kishte marrë me qira për nevoja të Drejtorisë Informative? Po të ishte bërë propozimi për ndërrimin e banesës për qëllime të "sigurisë" së Ahmet Krasniqit, do të ishte kontradiktore t'i caktohej banesa në

shtëpinë e oficerit të SHIK-ut Shyqiri Toskës, kur ishte shtëpia tjetër e Ministrisë së Mbrojtjes, që ishte marrë me qira për nevoja të Pjesës së SHP të FARK-ut, dhe ishte në një vend më të përshtatshëm për t'ia siguruar mbrojtjen fizike të Ahmet Krasniqit. Ajo shtëpi ishte në lagjën ku jetonte Azem Hajdari, afër rrugës Tiranë-Elbasan dhe në afërsi me Ambasadën amerikane. Ishte e pajisur me dy kamera që e përcillnin çdo lëvizje në rrugën e lagjës nga shtëpia e deri në rrugën automobilistike Tiranë-Elbasan? Por klyshët laramana, që kishin pozita udhëheqëse në SHP të FARK-ut, ia caktuan banesën Ahmet Krasniqit në shtëpinë e oficerit të SHIK-ut Shyqiri Toskës, (se ashtu iu kishin thënë padronët e tyre) që ishte afër Medresesë, në lagjën e "Shtëpisë së Partisë". Në banesën e re Ahmet Krasniqit i dërgohet gardëroba personale, duke përfshirë këtu edhe një revolver me dy bomba dore dhe një kallashnikov, që i mbante në dhomen e tij të gjumit.

### **Pse pak kohë para atentatit u largua nga stafi i sigurisë së Ahmet Krasniqit ushtari me emrin "Shpendi"?**

b). Ahmet Krasniqit ia larguan njërin nga rojet më të afta që i kishte SHP i FARK-ut, ushtarin me nofkën "Shpendi", në mënyrë shumë të poshtur duke i ngjitur fjalë (duke e shpifur), se ka bërë planë për ta vrarë Ahmet Krasniqin. Se ishte shpifje tregon fakti se "Shpendi" dërgohet në garnizonin e FARK-ut në Papaj afër Tropojës, me qëllim që kur të bëhet atentati ndaj Ahmet Krasniqit të mos gjindet në shërbimin e rojeve personale të Ahmet Krasniqit dhe SHP të FARK-ut. Por kur vritet Ahmet Krasniqi ai prapë sillet në shërbimin e mëparshëm dhe bëhet përgjegjës për çështjen e sigurimit të kuadrit komandues të SHP të FARK-ut.

Ahmet Krasniqi këthehet nga Veri i Shqipërisë në Tiranë më 19 shtator 1998. Ai merr vesh për ndërrimin e banesës nga kolegët e tij, por atij kjo gjë nuk i bëri përshtypje fare dhe nuk e kundërshtoi vendimin e kolegëve, duke u mbështetur në Rregulloren Ushtarake se çdo organ ushtarak i kryen detyrat e tij në bazë të kushteve dhe rrethanave që i krijohen ndërkohë. Ai natën e parë e kalon në banesën e re. Natën e dytë nuk u kthye në banesë, si duket e kalon natën te ndonjë mik i tij në Tiranë. Të nesërmen, më 21 shtator 1998, e kalon tërë ditën në biseda të ndara dhe të përbashkëta me një numër ushtarakësh të Brigadave 134,

131, dhe 133, të cilat ishin kthyer nga Kosova. Pati biseda me Tahir Zemajn, Salih Çekun, Agim Ramadanin dhe të tjerë. U diskutuan shumë çështje që kishin të bënin me veprimtarinë e subjektit ushtarak që i përkisnin, sukseset, mosesukseset dhe pengesat që u dolën në kryerjen e detyrave ushtarake. U fol edhe për masat që duheshin ndërmarrë për tejkalimin e pengesave dhe të vështërsive, që do të mundësonte futjen me sukses të njësive operative të UÇK-së, që ishin bërë gati për të marrë pjesë në frontin e luftës në Kosovë. Dikush nga ushtarakët i propozon Ahmet Krasniqit ta kalojnë sëbashku një mbrëmje, që do të merrnin vendime konkrete për punën e mëtutjeshme. Ky propozim përkrahet nga Ahmet Krasniqi dhe ai e cakton takimin në Restorantin "Nëna Mbretëreshë" në Tiranë, që ishte shumë afër nga selia e Pjesës së SHP të FARK-ut.

**PSE SHIK-U DHE POLICIA SHQIPTARE E KONTROLLUAN DREJTORINË INFORMATIVE TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE DHOMËN E GJUMIT TË AHMET KRASNIQIT?**

Argatët e forcave kundrainstitucionale që kishin depërtuar në pozita udhëheqëse në SHP të FARK-ut i kryen detyrat e para që ua kishte caktuar Qendra e krimi. Radhën e kishte SHIK-u, të tregonte se detyrën që e ka marrë për ta kryer do ta kryej me përkushtim. Ishte nata e 17 shtatori i vitit 1998 kur forcat e policisë sëbashku me pjestarë të SHIK-ut (afër 30 veta) kontrolluan shtëpinë e Shyqiri Toskes, që ua kishte lëshuar me qira Ministrisë së Mbrojtjes për nevoja të Drejtorisë Informative. Shtrohet pyetja pse nuk u bë më heret kontrollimi i kësaj Qendre, por u bë pasi Ahmet Krasniqit ju rregullua dhoma e gjumit në atë shtëpi? Përgjigja është e qartë. SHIK-u dhe klyshët e I. Kelmendit, Xh. Halitit dhe të H. Hysenit i bënin përgaditjet e fundit për pushkatimin e Ahmet Krasniqit. Dhe për të qenë të sigurtë se do ta kryejnë detyrën me sukses që e kishin marrë nga Qendra e krimi, donin ta çarmatosnin Ahmet Krasniqin. Ata e dinin se Ahmet Krasniqi i mbante në dhomën e gjumit një kallashnikov, një rëvolver dhe dy bomba dore. Duhet cekur dy fakte që dëshmon se Ahmet Krasniqi dhe SHP i FARK-ut ishin nën mbikqyrjen e forcave kundrainstitucionale të Kosovës, të SHIK-ut dhe të agjenturave serbo-sllavo-greke, kur çdo gjë që punohej në SHP të FARK-ut e merrnin vesh kryepëhlivanat e Nanosit. Është e mjaftueshme të cekën vetëm dy fakte, që do të vërtetonin pohimet e mia. Kur SHIK-u dhe policia shqiptare e bëjnë kontrollimin e Drejtorisë Informative të Ministrisë së

Mbrojtjes, e kontrolluan edhe dhomen e gjumit të Ahmet Krasniqit. Ata kishin informata të sigurt se Ahmet Krasniqi e kishte një revole personale dhe dy bombe dore në ormanin e gardorobës. Pra, ata e thyen ormanin e gardorobës për të marrë rëvolën dhe dy bombat personale të Ahmet Krasniqit. Kjo dëshmon se klyshët e Xh. Halitit. I. Kelmendit dhe të H. Hysenit, që kishin depërtuar të futën në SHP të FARK-ut i kryenin detyrat me përkushtim, por shtrohet pyetja pse nuk ndërrmuarën asgjë kolegët e tij, pas këtij rasti të çarmatosjes së SHP të FARK-ut, dhe të Ahmet Krasniqit, për të siguruar armë për mbrojtjen e Ahmet Krasniqit dhe stafit udhëheqës të këtij subjekti ushtarak të Republikës së Kosovës, kur në Shqipëri në çfardo kohe mund të siguroheshin armë për mbrojtje personale : revolver dhe kallashnikov?

Kjo ishte faza e parë e përgaditjeve për vrasjen e Ahmet Krasniqit. Faza e dytë fillon pasi kthimit të Ahmet Krasniqi nga Veriu i Shqipërisë (ku i pat vizituar njësitë operative të UÇK-së, që duhej të hynin në Kosovë) në Tiranë. Edhe në këtë fazë, në përgaditjet për vrasjen e Ahmet Krasniqit kanë marrë pjesë tri palë : 1. Qendra e krimit, 2. SHIK-u dhe 3. Një numër ushtarakësh që i përkisnin stafit udhëheqës të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Pjesës së SHP të FARK-ut.

Qendra e krimit ashtu si në fazën e parë edhe në fazën e dytë të përgaditjeve për vrasjen e Ahmet Krasniqit pati rolin vendimmarrës. Në këtë fazë ajo e bëri edhe mbikqyrjen e përgaditjeve për këtë krim, dhe bëri kordinimin e punëve që i kryente SHIK-u dhe punëve që i kryenin ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes që ishin bërë argat dhe klysh të forcave kundrainstitucionale të Republikës së Kosovës. Sipas skenarit të përgaditur më parë nga Qendra e Krimit dhe SHIK-u, Ahmet Krasniqi duhej të vritet në orët e vona të mbrëmjes kur të kërthet në banesë. Vendi (lagjja)se ku gjendet shtëpia e Shyqiri Toskes (ku duhej të banonte Ahmet Krasniqi) i përgjigjej të gjitha kushteve për ta kryer pa vështërsi atentatin dhe pa pasoja të largohën kriminelët nga vendi i krimit. Kriminelët ishin bërë gati ta ngrehin gishtin e krimit në çdo moment që urdhëron Qendra e krimit. Çdo lëvizje e Ahmet Krasniqit vëshgohet nga klyshët e forcave kundrainstitucionale të Republikës së Kosovës që kishin arritur të hyjnë në stafin e Ministrisë së Mbrojtjes. Mbrëmja e 21 shtatorit të 1998 ishte shumë e përshtatshme për realizimin e planit dhe skenarit të Qendrës së krimit për vrasjen e Ahmet Krasniqit. Në Restoranin "Nëna Mbretëresh" ishte Ahmet Krasniqi, Kryeshefi i SHP të

FARK-ut, tre ushtarakë nga sigurimi, nga një ushtarak nga Drejtoria personale, Drejtoria informative dhe Shërbimi i finansave, dhe disa ushtarakë të brigadave 134, 131 dhe 133, që kishin marrë pjesë në frontin e luftës në Kosovë. Takimi kishte karakter pune, por për nderë të ushtarakëve që kishin marrë pjesë në frontin e luftës në Kosovë, Ahmet Krasniqi shtroi një darkë për ta. Në pasdarken e asaj mbrëmje u shqyrtua situata ushtarake në Kosovë dhe gjendja aktuale në Ministri të Mbrojtjes dhe në SHP të FARK-ut. Në veçanti u rrafën çështjet e mosrealizimit të marrëveshtjes së armatimit që u nënshkrua në mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe tregëtarëve turq, dhe shkëlja e marrëveshtjes së Oslos nga forcat kundrainstitucionale të Republikës së Kosovës. Më në fund u muarrën vendime të rëndësishme që kishin të bënin me forcimin e UÇK-së. Planet e Ahmet Krasniqi për futjen në frontin e luftës në Kosovë të të gjitha njësive operative të UÇK-së, që ishin bërë gati nepër qendrat e stërvitjes, u miratua edhe nga ushtarakët e brigadave 134, 131 dhe 133. Në atë takim është dashur të merrte pjesë edhe kolonel Tahir Zemaj, por Ahmet Krasniqi nuk pat lejuar të vinte për shkaqe të sigurisë së tij personale. Kjo tregon se Ahmet Krasniqi ishte i vetëdijshëm se në çdo moment ishin të rrezikuar një numër i konsiderueshëm i ushtarakëve të FARK-ut, nga forcat kundrainstitucionale të Republikës së Kosovës, në mesin e të cilëve ishin Ahmet Krasniqi, Tahir Zemaj, Salih Çeku, Agim Ramadani, etj. Atë natë Ahmet Krasniqi donte që vet të kujdesej për sigurinë personale të kolonel Tahir Zemës, kur i dha urdhër Hilmi Nebihut që personalisht të kujdeset për sigurinë fizike të kolonel Tahir Zemës.

Takimi ka përfunduar rreth orës 23.00, dhe të gjithë kanë hyrur në tri vetura. Në veturën e parë ishte Ahmet Krasniqi, tre ushtarakë të brigadave operative 134, 131 dhe 133, një ushtarak nga Drejtoria informative dhe shoferi i kombit. Në dy veturat tjera ishin të tjerët. Afër pompes së benzinit veturat ndalën nga pjestarë të policisë dhe të SHIK-ut të Shqipërisë, për ta bërë kontrollimin e dokumentacionit të ushtarakëve për të ditur identitetin e tyre. Veçmas kontrollohet pasaporta e Ahmet Krasniqi nga pjestarë të policisë dhe të SHIK-ut, dhe me radiolidhje e njoftojnë dikend për identitetin e Ahmet Krasniqi. Kjo tregon se bëheshin përgaditjet përfundimtare nga kriminelët për ta kryer egzekutimin e pushkatimit të Ahmet Krasniqi. Ende pa kaluar te ambasada amerikane zbresin nga kombi tre ushtarakë të brigadave të

lartëpërmendura, që aty pari banonin, dhe në veturë mbesin vetëm Ahmet Krasniqi, ushtaraku i Drejtorisë Informative dhe shoferi. Vetura në të cilën ishte Ahmet Krasniqi kishte marrë drejtimin e Medresesë sëbashku edhe me një veturë tjetër në të cilën ishin ushtarakë të Ministrisë, por policia e ndal për të dytën herë veturën e dytë që e shoqëronte kombin ku ishte Ahmeti Krasniqi. Kombi arrinë shumë shpejtë para Medresesë dhe pastaj lakon rrugën djathtas për të hyrë në rrugicën, që e shpinte para derës së shtëpisë së Shyqiri Toskës. Vlen të theksohet se rrugica ishte e pa ndrikuar dhe shumë e ngushtë, sa që kur kalon ndonjë veturë, këmbësori është i detyruar të pështetet për muri, për të qenë i sigurt se nuk do të shkelet nga vetura. Vetura arrinë para dyrëve të shtëpisë së Shyqiri Toskës, ku ia kishin përgaditur banesën Ahmet Krasniqit tradhtarët. Zbresin nga vetura shoferi dhe ushtaraku për ta hapur dyert e oborrit. Pa pritmas dëgjohet zëri i prer i një njeriu me maskë: "Mos luni!". Kishin qenë tre persona të maskuar dhe të armatosur me kallashnikov dhe rovole. Një kriminel e kishte zënë kryqin e rrugicës që ishte nja dhjetë metra larg shtëpisë së Shyqiri Toskës, dhe rrinte në gjendje gadishmerie për të shtirë me kallashnikov kushdo që do të pengonte në realizimin e krimit. Dy kriminel tjerë që u paraqitën papritmas para veturës. Ua drejtojnë revolverët shoferit dhe ushtarakut që mundoheshin t'i hapin dyertë e oborrit. Ahmet Krasniqi ende ishte mbrenda në veturë. Por kur e shef këtë skenë trishtuese, zbret me shpejtësi për për ta mbrojtur usharin e tij, që ishte në lulën e rinisë. Por kriminelët ishin përgaditur për krim, nuk kishin mëshirë ndaj askuj që donte tua prishte planet dhe t'i pengonte në kryerjen e detyrës. Njëri nga dy kriminelët ia futë grykën e kallashit në fytyrë Ahmet Krasniqit, ndërsa kriminel tjetër bëri kontrollin e shoferit dhe ushtarakut mos kanë rastësishtë ndonjë armë dhe i detyroi të shtrihën në tokë. Krimineli tjetër që e mbante Ahmet Krasniqin në thumb të kallashit e pyste kriminelin tjetër se "a është ky " (nënkuptohet që e pyste për Ahmet Krasniqin). Kur krimineli i këthen përgjigje se "është vet ai", krimineli ngreh gishtin e krimit dhe kështu përfundoi skenari i vrasjes së Ahmet Krasniqit, i cili ishte përgaditur për një kohë të gjatë nga bisha-njerëz, shpirtshitur, dyfytërsha, zemërgur dhe kriminel të regjitur të profesionit për të kryer atentate politike. Pra siç po shifet në vrasjen e Ahmet Krasniqit kanë marrë pjesë: Qendra e krimit, ushtarakë tradhtarë që ishin bërë argatë të forcave kundrainstitucionale, pjestarë të policisë dhe SHIK-ut të

Shqipërisë, dhe kriminelë (atentatorët) të paguar nga Qendra e krimit, me paratë e fondeve që ishin mbledhur për ta ndihmuar çlirimin e Kosovës. Janë bërë shumë vrasje politike në Shqipëri dhe në Kosovë para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës, por kjo vrasje dhe vrasja e Azem Hajdarit janë vrasjet më monstroze nga të gjitha vrasjet. Mënyra dhe organizimi i vrasjes së Ahmet Krasniqi, tregon se ai ka qenë i tradhtuar nga të gjitha drejtimet, edhe nga ata që kurrë nuk është pritur. Por më së shumti dhembë tradhtia që i është bërë nga mbrenda nga disa ushtarakë që ishin futur në stafiin e Ministrisë së Mbrojtjes. Dhe nuk është rastësi që Ahmet Krasniqi natën e krimit është lënë pa kurrëfar mbrojtje. Shtrohet pyetja ku ishte organi që ishte përgjegjës për mbrojtjen e Ministrit të Mbrojtjes dhe Komandantit të SHP të FARK-ut? Ku ishte stafi dhe bashkëuntorët e tij të ngushtë. Në këto pyetje dhe në shumë pyetje tjera duhen të përgjigjen mos sot, një ditë jo të largët gjithsejsh.

**SHTOHET PYETJA: A ISHTE RASTI QË PËRPUTHEJ, "PUSHIMI MJEKËSOR" I ADEM DEMAÇIT ME VRASJEN E AHMET KRASNIQIT, APO ISHTE NJË GJEST I ADEM DEMAÇIT QË SHPREHU REVOLTËN DHE MOSPAJTIMIN E TIJ ME QENDREN E KRIMIT**

Pas një distance trivjeçare nga vrasja e Ahmet Krasniqit janë qartësuar shumë detaje të errta të atij krimi, edhe në bazë të deklaratave të personaliteteve dhe personave publik të jetës politike të Kosovës dhe të pararojes staliniste të LPK-së. Vlenë të shënohet deklarata e Zyrës së përfaqësuesit politik të UÇK-së zotëri Adem Demaçit, e cila më 20 shtator të 1998 (një ditë para vrasjes së Ahmet Krasniqit) njofton opinionin e gjërë se Adem Demaçi "për shkak të stërngarkimit me punë, mjekët kanë konstatuar se ai ka një tendosje të tepruar të nervave dhe një keqësim të diabetit (sëmundja e sheqerit). Për këtë arsye mjekët e kanë këshilluar zotëri Demaçin që të deaktivizohet nga të gjitha punët e veta të përditshme dhe të pushojë sa më gjatë. Në njoftim, gjithashtu thuhet se të gjitha takimet e parapara të zotëri Demaçit me miq të huaj dhe të vendit si dhe takimet e caktuara me gazetarë shtyhën për një afat të pacaktuar." (Citati është marrë nga shkrimi i botuar me titull : Adem Demaçi në pushim të gjatë mjekësor të botuar në "Bota sot", më 22 shtator 1998). Shtrohet pyetja ishte rastësi që përputhej "pushimi mjekësor" i Adem Demaçit me vrasjen e Ahmet Krasniqit, apo ishte një gjest i Adem Demaçit që shprehu revoltën dhe mospajtimin e tij me Qendrën e krimit,



që kishte vendosur për ta vrarë Ahmet Kranin. Koha do të tregoi se ku është e vërteta, por nuk ka qenë normale që Adem Demaçi të mos e gjykonte vrasjen e Ahmet Krasniqit, sëpaku pas kalimit të "pushimit mjekësor", kur dihet se ishin bashkëautorë të Marrëveshjes së Oslos dhe ishin kryesues të dy delegacioneve të subjekteve ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të UÇK-së.

Sa i përketë thënjeve (prononcimit) të Xhafer Shatrit, ish-ministër i Informimit në Qeverinë e Bukoshit, në lidhje me vrasjen e Ahmet Krasniqit, vlenë të citohen këto fragmente nga shkrimi i tij i botuar në revistën Pasqyra Nr.19 të 23-30/09/1999 me titull : "Pse u vra Ahmet Krasniqi". Ai thotë : "Pa hyrë se kush janë dorasit, e përsërisim, kjo është qështje e gjyqit, shkaqet që quan deri te vrasja e Ahmet Krasniqit dhe te mbajtja ose te vetëmbajtja peng e oficerve duhet kërkuar bashkë me përgjegjësinë parasegjithash te institucionet e Kosovës, të cilat dështuan, sepse, falë këmbënguljes së udhëheqësve të tyre me vetëdije nuk përgaditën as luftën dhe as paqen ". Vlerësim i Xh.Shatrit se përgjegjësinë për vrasjen e Ahmet Krasniqit e mbajnë "institucionet e Kosovës" që sipas tij "dështuan" për shkak të "udhëheqësve të tyre" që me "vetëdije nuk e përgaditën as luftën dhe as paqen" është e vërtetë po që se e ka menduar Qeverinë e Kosovës-Qeverinë e Bukoshit. Opinioni ynë është i njoftuar se Xh.Shatri mbante njërin ndër postet më të rëndësishme, pas kryeministrit, në Qeverinë e Kosovës, pra për nënt vite e mbajti postin e Ministrit të Informatave në Qeverinë e Bukoshit. Po ashtu dihet se Qeveria e Kosovës është dalur në egzil për shumë arsye por njëri ndër më kryesotët ishte se do të ketë mundësinë të punonte pa pengesë të mëdha në përgaditjen e qytetarëve lojal të Republikës së Kosovës për çlirimin e Kosovës "kur të na vie shteku". Shtrohet pyetja ku është përgjegjësia e Xh.Shatrit që bënte pjesë në "subjektin e Kosovës" që kishte për detyrë ta "përgadiste luftën dhe paqen". Sa jam i njoftuar Xh.Shatri jo vetëm që ka qenë në dijuni por edhe ka ndihmuar në organizimin e takimit të Oslos në mes Ahmet Krasniqit dhe Agim Mehmetit, që përfaqësonin Ministrinë e Mbrojtjes, dhe Adem Demaçit, Xhavit Halitit, Shaban Mujës dhe Fatmit Zymberit që e përfaqësonin UÇK-së, prandaj bie poshtë kritika e tij kur i akuzon "oficerët më të mirë të Kosovës" që "mbaheshin ose vetëmbaheshin peng" në Shqipëri, kur ai shumë mirë ka qenë i njoftuar me arrijtjen e Marrëveshtjes së Oslos, dhe se në bazë të asaj marrëveshtjeje ushtarakët tanë kanë shkuar në Shqipëri,

për të përgaditur njësitë operative të UÇK-së, dhe në formacionet ushtarake për të hyrë në Kosovë. Xh.Shatri mirë e din se kush e shkeli marrëveshtjen e Osllos, prandaj nuk është e logjikshme dhe e moralshme nga ana e tij kur shtron këto pyetje: " A janë penguar këta njerëz? (mendon në ushtarakë që i përkisnin Ministrisë së Mbrojtjes që kishin shkuar në Shqipëri) Kush i ka penguar? Pse u janë dhënë njerëzëve me miljana DM. nga fondi i luftës vetëm pse thirreshin në emër të UÇK-së?, kur ai më së miri din të përgjigjet në ato pyetje, pasi mbante resorin e Ministrisë së Informimit në Qeverinë e Kosovës, dhe në bazë të pozitës që kishte, e pat formuar sigurimin e tij të msheftë në gjithë Evropën Perendimor, ku njoftohet me imësi për çdo gjë që ndodhte në diasporën shqiptare por edhe në Kosovë dhe Shqipëri. Prandaj askush më mirë se ai nuk dinë të përgjigjet në pyetjet që vet i shtron. Kurse sa i përketë çështjes së dhënjes së parave "njerëzëve me miljana DM nga fondi i luftës, vetëm se thirreshin në emër të UÇK-së", këtë pyetje lë t'ia bëjë Demaçit, sepse ai ia prezentoj Ahmet Krasniqit për antarë të SHP të UÇK-së, Xh. Halitin në takimin e Osllos, prandaj paratë që i ka marrë Xh. Haliti nga Ministria e Mbrojtjes në emër të UÇK-së i janë dhënë në saje të besimit që kishte Ministria e Mbrojtjes ndaj Demaçit, e jo ndaj Xh. Halitit. Por do të ishte mirë që Xh.Shatri të na përgjigjet pse Qeveria e Bukoshit ku bënte pjesë edhe vetë, gjatë vitit 1996, dhe më vonë i jepte tëholla Xh.Halitit në emër të UÇK-së, në vend se ato tëholla të ua jepte njësisive guerile të Republikës së Kosovës, (komandantëve të tyre : Adem Jasharit, Zahir Pajazitir, Salih Çekut etj)? Po qe se Xh.Shatri mendon se me dhënjën e dorëheqjes nga posti i Ministrit të Informatave që e mbante në Qeverinë e Bukoshit, në kohën më të vështirë kur kallej flakë Kosova, nga barbarët serb, i ka shly fajet që i takojnë për "mosorganizimin e luftës dhe të paqes" gabohet rënd. Ai përkundrazi i ka rritur fajet sepse me dhënjën e dorëheqjes Ministria e Informimit është mbyllur mu në kohën kur është dashur të punonte me kapacitete të shumëfishuara. Dorëheqja nuk mund ta pastroj nga bashkëfajsjia që ka me B. Bukoshin për tjetërsimin e Qeverisë së Kosovës nga çështjet madhore kombëtare. Me Bukoshin do t'i ndajnë "meritat", "sukseset" dhe mossukseset që i pati Qeveria e Kosovës –Qeveria e Bukoshit, kurse historia jonë kombëtare një ditë do të japi vlerësimin e paanshëm dhe të drejtë për Qeverinë Bukoshi. Edhe Bukoshi deri tash nuk e ka folur as një fjalë për Marrëveshjen e Osllos dhe as për marrëveshtjen për blerjen e armatimit

që Ministria e Mbrojtjes e ka lidhur me tregtarë turq. Ndërsa Xh. Haliti dhe pehlivanat tjerë të Nanosit dhe argatët e tyre e mohojnë në tërësi marrëveshtjen e Osllos. Për atë marrëveshje deri tash nuk foli as Adem Demaçi. Vlen të ceket se i vetmi përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes që është dëshmitarë i gjallë, që muar pjesë në bisedimet e Osllos është ish-Zv. Ministri i Mbrojtjes A.Mehmeti, i cili me rastin e mbajtjes së tubimit përkujtimor të trevjetorit të vrasjes së Ahmet Krasniqit që u mbajt në një fshat afër Llucernit në Zvicrër, të tubuarëve pasi ju foli për biografinë e shkurtër të Ahmet Krasniqit, ju trgoj nga bina kopjet e dokumentacionit të Ministrisë së Mbrojtjes, që i kishte ndarë nepër dosje të posaçme, siç ishin : Marrëveshtja e Ahmet Krasniqit me Bardhyl Mahmutin, Plani i luftës, Lista e brigadave, Lista e shpenzimeve të çdo njësie ushtarake, disa shënime, që sipas tij janë fjalët e Adem Demaqit që i ka thënë gjatë takimit të Osllos, dhe së fundit na e tregoi edhe një hartë topografike të Kosovës, por me as një fjalë nuk na shpjegoi për përmbajtjen e atyre dokumenteve. Për marrëveshtjen e Osllos na i dha vetëm këto të dhëna që opinionin qysh moti ka mësuar për to : se kush ishin pjesëmarrës në takimin e Osllos. Ai me as një fjalë nuk na tregoi se për çka janë marrëveshje përfaqësuesit e dy subjekteve ushtarake të Kosovë dhe me as një fjalë nuk i hudhi poshtë shpifjet e forcave kundrainstitucionale se "nuk është arrijtur kurrfarë marrëveshjeje në Oslo". Në fund të bisedës që e bente me masën nga bina për marrëveshtjen e Osllos i dha vetëm këto sqarime: "... Nga Oslla shkuam në Tiranë me shpresë se do të luftojmë bashkë"?! Shtrohet pyetja a janë të mjaftueshme këto sqarime dhe a është krejt ajo çka na tha A. Mehmeti për atë takim, kur dihet se historia do ta japi fjalën e saj se kush nga dy forcat kundërshtarë të Republikës së Kosovës, forcat institucionale apo forcat kundrainstitucionale do të shpallën fajtorë për mos bashkimin e faktorit ushtarak të Republikës së Kosovë dhe sabotuese të zgjedhjes së çështjeve madhore kombëtare. Nuk po zgjatëm më tepër duke i cituar pehlivanat e Nanosit dhe argatët e tyre që e përbënin SHP të UÇK-së, të cilët jo vetëm që e mohuan Marrëveshtjen e Osllos por mohuan edhe pjesëmarrjen e FARK-ur në luftën çlirimtare të Kosovës.

Fushata e ligë e shpifjeve kundër Ministrit të Mbrojtjes Ahmet Krasniqit, në kohën kur ai bënte përpjekje të mëdha për bashkimin e faktorit politik dhe ushtarak të Republikës së Kosovës dhe forcimin e UÇK-së, e dirigjuar nga kryepehlivanat e Nanosit, Xh. Haliti dhe I. Kelmendi, si dhe mos mbrojtja e tij sa ishte gjallë dhe pas vrasjes së tij

nga këto shpifje, nga Qeveria e Bukoshit dhe Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës, është fakti tjetër i pa mohueshëm që tregon se në këtë krim janë të përzier përpos agjenturave serbe-sllavo-greke, (që i kishin futur njerëzit e tyre në subjektet vendimmarrëse të shqiptarëve dhe spiujëve serbë dhe grekë që kishin pozita udhëheqëse në institucionet shtetërore të Shqipërisë) dhe pararoja staliniste e LPK-së, krerët e LBDK-së, por dhe individë që kishin poste të rëndësishme politike dhe shtetërore në subjektet shtetërore të Republikës së Kosovës.

Vetëm te shqiptarët mund të ndodhë një anomali kaq e shëmtuar, që ju vritet Ministri i Mbrojtjes në kohë lufte, dhe Qeveria që njihej nga shumica dërmuese e shqiptarëve nuk bëri asgjë sëpaku për ta ndriqur vrasjen e kolegut të tyre. Çka është më e keqja as stafi i Ministrisë së Mbrojtjes nuk bëri asgjë për ta mbrojtur sëpaku pas vrasjes kolegun e tyre nga shpifjet e liga të bajraktarëve të farës ruse, që shpifnin se Ahmet Krasniqi ka "krijuar forca paralele me ato të UÇK-së, -FARK-un....". Është detyrë njerëzore dhe përgjegjësi institucionale dhe kombëtare që së paku ish- kryeministri i Qeverisë së Kosovës B. Bukoshi, ish -Ministri i Informimit në atë Qeveri Xh. Shatri dhe ish- Zv.Ministri i Mbrojtjes A. Mehmeti, ta ndriqojnë vrasjen e Ahmet Krasniqit me të dhënat që i kanë, dhe ta ndriqojnë Marrëveshtjen e Osllos dhe Marrëveshtjen për armatimin që është lidhur në mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe tregtarëve me nënshtetësi turke. Fatkeqësishtë deri tash personat e lartëpërmendur jo vetëm që nuk kontribuan në ndriqun e vrasjes së kolegut të tyre, por e mjegullulluan ngjarjen dhe e dezinformuan opinionin publik me gjysmë të vërteta dhe të pavërta që i lëshuan kohë pas kohe. Për të qenë anomalija edhe më e madhe mjetet e informimit publik të Kosovës, (të ashtuquajtura "të pavarura") përpos gazetës kombëtare "Bota sot", nuk janë marrë me ndriqimin e rrethanave, shkaqeve dhe motiveve të vrasjes së Ahmet Krasniqit dhe as që kanë bënë përpjekje simbolike për të aktualizuar çështjen e zbulimit të këtij krimi monstruoze.

Ndriqimi i kësaj vrasje monstruoze nga organet e drejtësisë të Kosovës pas zgjedhjeve të 17 nëntorit të këtij viti, duhet të jetë një detyrë parësore, një detyrë mbi detyrat, kur dihet se në vrasjen e Ahmet Krasniqit kanë gisht përpos kreut politiko-ushtarak të Beogradit, Athinës dhe Tiranës vazale, edhe shumë personalitete publike të Kosovës. Pra, zbulimi i kriminelëve që dhan urdhër, të kriminelëve që murrën pjesë në organizimin e vrasjes, zbulimi i kriminelëve që dhanë pëlqimin për tu

bërë ky krim, dhe së fundi zbulimi i kriminelëve që bënë egzekutimin e pushkatimit, dhe dënimi i të gjithë kriminelëve që muarën pjesë në këtë krim, pa marrë parasysh se ç'farë pozitash partiake apo shtetërore kanë pasur, apo edhe sot i kanë, ka rëndësi të dorës së parë, për shumë arsye, por njëra ndër to është se do t'i prehën rrugët krimit të organizuar në Kosovë. Po ashtu do të ndikonte në përmirësimin e sigurisë së qytetarëve dhe të stabilizimit politik të Kosovës, pasi që do të shkatërrohet Qendra e krimit, që na i vrau burrat më të mirë të kombit në mesin e të cilëve edhe Ahmet Krasniqin. Me siguri organet hetimore të UNMIK-ut dhe të Kosovës po qe se merren serjozishtë me dosjen e vrasjes së Ahmet Krasniqit do vijnë deri te faktet që dëshmojnë se në vrasjen e Ahmet Krasniqit përpos agjenturave serbo-sllavo-greke kanë marrë pjesë edhe shumë tradhtarë shqiptarë që i përkisnin familjes së djajve : a) Pararojës staliniste të LPK-së. b) Karrjeristëve të sëmuar për pushtet të LBDK-së. c) Pehlivanave të Nanosit. d) Bajraktarëve të "farës ruse". Dh) Ushtarakët tradhtar që u bënë klysh të forcave kundrainstitucionale të Republikës së Kosovës, që ishin futur me detyra speciale në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në SHP të FARK-ut, për ta penguar dhe për ta vëzhguar Ahmet Krasniqin në veprimtarinë e tij kombëtare dhe ushtarake. Pra, në bazë të dhënave që që i kemi del se në vrasjen e Ahmet Krasniqit kanë marrë pjesë drejtëpërdrejtë dhe tërtorazi shumë burra të ligjë, shumë faqezi shqiptarë, dhe shumë tradhtarë, që fatkeqësisht edhe sot një pjesë prej tyre ende njifën për "burra të mirë" nga shqiptarët, vetëm pse dijnë të flasin mirë, apo vetëm pse kishin dhe kanë detyra udhëheqëse në subjektet politike dhe shtetërore të Republikës së Kosovës. Fatmirësishtë kryesit e kësaj vrasje monstruoze nuk kanë mundur t'i zhdukun gjurmët e krimit të tyre, edhe pse vrasja është organizuar në mënyrë profesionale. Këto që po i them tash dhe që i kamë thënë para tri vitesh me disa shkrime të botuara në kombëtarën "Bota sot" i ka vërtetuar edhe njeriu më përgjegjës i Republikës së Kosovës zotëri Januz Tërrstena, ish-Ministër i Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës. Ai e ka njoftuar opinionin publik se ka të dhëna të plota se kush kanë gisht në vrasjen e Ahmet Krsniqit. Ai në një tubim me bashkëkombasit në Vjenë të mbajtur më 20 qershor të 1999 pat thënë : "Ne e dijme saktësishtë se kush e ka vrarë kolonel Ahmet Krasniqin. Ne i kemi ofruar Prokurorisë së Tiranës të gjitha të dhënat e sakta për personat që kanë gisht në këtë vrasje, por kjo Prokuroiri ka pezulluar hetimet rreth kësaj vrasje. Dhe ne e dimë pse janë

pezulluar këto hetime, sepse prapa këtij akti terrorist fshihet një klan i madh politik shqiptar në Shqipëri dhe Kosovë".(Shiko shkrimin e Bajrush M me titull: Tërrstena: "Në Qeverinë tonë ka gabime, por në "Qeverinë Thaçi" ka sherr", botuar " Bota sot", 22 qershor 1999). Edhe kolonel Tahir Zemaj nepërmjet intervistave të tija të botuara në "Bota sot" disa herë ka pohuar se i din dorasit e vrasjes së Ahmet Krasniqit. Për zbardhen e vrasjes së Ahmet Krasniqit nuk kanë folur organet e drejtësisë së Shqipërisë, por duke ditur (në bazë të shumë fakteve) se në vrasjen e Ahmet Krasniqit kanë marrë pjesë edhe personalitete të larta që janë vu në krye të subjekteve shtetërore të Shqipërisë, as që është pritur se "organet e drejtësisë" të atij shteti, që po drejtohet nga spiuj serbo-grek do të bëjnë zbardhin e kësaj vrasjeje. Fatkeqësishtë, edhe pas tri vjetësh, për këtë vrasje nuk ka folur ende stafi udhëheqës i Ministrisë së Mbrojtjes dhe i SHP të FARK-ut, që sipas të gjitha gjasave një numër prej tyre ka marr pjesë në organizimin e krimit, ndërsa shumica prej tyre kanë qenë në dijeni të përgaditjeve që bëheshin për vrasjen e Ahmet Krasniqit, por nuk kanë ndërmarr asgjë për t'i penguar kriminelët në realizimin e planit që kishin për t'ia shuar jetën atdhetarit, ushtarakut dhe strategur të shquar kolonel Ahmet Krasniqit. Shtrohet pyetja: Si është e mundur që bashkëpunorët e Ahmet Krasniqit që bënin pjesë në stafin udhëheqës të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të SHP të FARK-ut, që tri vite dëgjojnë shpifje të llojllojshme nga kolegët e tyre ushtarakë : Agim Çeku, Naim Maloku, Salih Veseli, Bislim Zyrapi dhe nga patronët e tyre Xh. Haliti dhe H.Thaçi për Ahmet Krasniqin, Ministrinë e Mbrojtjes dhe për SHP të FARK-ut, dhe me as një fjalë nuk i hudhin poshtë shpifjet dhe gënjeshttrat e tyre, kur dihet se kanë aq shumë fakte për tua mbyllur gojën që më kurrë të mos shpifin.

Po shpresojmë se populli ynë në zgjedhjet e 17 nëntorit do t'i zgjedhin për deputetë burra të fortë dhe të aftë që i përfaqësojnë subjektet institucionale të Republikës së Kosovës që do të bijnë ligje dhe vendime të rëndësishme për zbulimin e kriminelëve shqiptarë dhe serb, që muarën pjesë bashkë për ta katondisur si është më zi Kosovën. Kriminelët janë të gjithë njësoj dhe të gjithë duhet të dënohen, pa marrë parasysh se ç'far gjuhe flasin. E flasin shqipën apo serbishtën, e flasin rusishtën, maqedonishtën apo greqishtën nuk ka rëndësi. E rëndësishme është se ata janë kriminel, se kanë bërë krime, dhe duhet dënuar sipas ligjit, për t'iu dhënë dënimin e merituar për krimet e bëra, dhe për vuajtjet shpirtërore

që u kanë shkaktuar njerëzëve, por edhe për tu dhënë mësim edhe të tjerëve, që nuk janë të formuar si njerëz, se i pret burgosja dhe dënimi, po qe se i bëjnë dikuj keq, po qe se vrasin njerëz dhe bëjnë krime.

*Botuar në "Bota sot" më 11-21 nëntor 2001*

## DISA DITË ME USHTARËT DHE OFICERËT E UÇK-së

(Reportazh)

Me tetë bashkëkombas, pas një rruge të gjatë dhe të vështirë arritëm para derës hyrëse të "Qendrës për Rekrutim, Stërvitje dhe Përgatitjen e Kuadrit Ushtarak". Edhe pse ushtari kujdestar e njihte oficer Miftarin që na shoqëronte, ai na ndali për t'i kryer formalitetet e nevojshme. Urdhëroi një ushtar të na i marrë shënimet personale. U entusiazmova shumë kur për herë të parë pash një garnizon dhe një ushtri të rrëgullt të Republikës së Kosovës. Në oborr të garnizonit që ishte në mes të pyllit kishte plot gjallëri, çka më përkujton bletët e një zgjoji. Më ra në sy një grup ushtarësh që kishin zënë vend nja nëzet metra larg derës hyrëse në anën e djathtë të saj. Ishin ulur në formë harku. Një ushtarak në dukje dyzetyvjeçar shkonte sa te njëri sa te tjetri. Si dukej i këshillonte rekrutët si pastrohen armët apo si mbërthehen e zbërthehen ato. Pak më larg tyre ishte grupi tjetër më i madh që bënëin të njëjtën punë. Edhe në anën e majt të hyrjes ishte një grup ushtarësh. Armët e tyre ishin të mbështetura në shpinën e gjerë të një lisi vigan, ndërsa në një tavolinë të improvizuar kishin vënë një hartë. Kurreshtja më shtyri ta pyesja oficer Miftarin se ç'bënëin ata ushtarë atje? Si duket, më tha Miftari, përpunojnë të dhëna nga harta topografike. Janë pjesëtarët e Njësitit vëshgues që kryejnë detyra speciale për njësitë tona operative. Bëra ca hapa drejt tyre, por z.Miftari më ndali. Ka rregull këtu, Shefqet, më tha. Sëpari do të shkojmë në komandë. Pasi të njihesh me komandantin, do t'i tregojmë për dëshirën tënde për të shkruar diçka për jetën e ushtarëve dhe oficerëve tanë në këtë Qendër.

Arritëm para ndërtesës ku flamuri kombëtarë valonte në një shtizë të gjatë druri, që ishte ngulur në tokë. Një grup ushtarësh kishin zënë vend mu para shkallëve që të çonin në komandë. U përshëndetëm dhe u njohëm. Në mesin e ushtarëve kishin qenë edhe dy oficerë të cilët me kurrfarë shenje nuk dallonin prej ushtarëve tjerë. Gëzimi kishte ardhur nga Zvicra, ndërsa Shpendi nga Gjermania. Nuk zgjatëm shumë llafe me ta dhe hymë brenda në komandën e Qendrës. Ishte një burrë dyzetyvjeçar. E bënte të pashëm trupi i tij i ngjeshur sportiv. Uniforma ushtarake i rrininte bukur. Na priti përzemërsisht dhe më bëri përshtypjen se këtë burrë e kisha njohur qysh moti. Ishte komandant Jahiri, oficer i ish



armatës jugosllave i cili ka ardhur nga Zvicra para tre muajsh në këtë Qendër. Gruan dhe fëmijët i ka lënë në Zvicër, ndërsa familjen e gjërë në Kosovë. Më foli shkurtimisht për "Qendrën për Rekrutim, Stërvitje dhe Përgatitjen e Kuadrit Ushtarak".

Rritja dhe zgjerimi i UÇK-së, tha komandanti, shtroi nevojën për formimin e kësaj Qendre për pranimin e rekrutëve, stërvitjen dhe përgatitjen e tyre fizike, ushtarake e psikologjike, për t'u aftësuar të bëhen ushtarë të denjë të njësiteve tona ushtarake. Çdo ditë vijnë me dhjetëra rekrutë nga diaspora, kryesisht të rinj, pa pasur njohuri ushtarake dhe pa kondicion të mjaftueshem. Me ta punojnë oficerët më të aftë që i kemi në Qendër dhe është për t'u habitur se sa shpejt i përvetësojnë mësimet e artit ushtarak dhe me sa perkushtim i pastrojnë e i ruajnë armët. Vetëm atëherë kur ushtarët përgatiten mirë fizikisht, ushtarakisht e psikikisht për t'i kryer detyrat me sukses jepet urdhëri dhe caktohet vendi se ku do të shkojnë. Bisedën e ndërprejmë të pa përfunduar për shkak se darka ishte bërë gati. Ishte kënaqësi e këndshme kur në tavolinë pamë një bukë misri dhe një enë me qumësht të nxehtë. Kuzhinieri, një burrë i shkurt nga trupi, në një moshë pesëdhjetëvjeqare, na u drejtua me këto fjalë: "Urëdhroni zotërinj, mirë se ju ka pru Zoti!" Kemi edhe bukë të grytë edhe djathë, po qe se ndokush nuk e han bukën e misrit". Si duket të gjithë kishim qenë përmalluar për bukë misri, pasi që askush nuk kërkoi tjetër gjë përpos asaj që ishte shtruar në sofër. Qetësinë e thellë e prishën krismat e lugëve që i jepnin një ritëm tingëllues jo harmonik kuzhinës ku nuk dëgjohej asnjë zë tjetër. Akrepat e orës tregonin se po afrohet gjysma e natës. Komandant Jahiri m'u afrua dhe më pyeti: "Don të vish nesër me Njësitin e vëzhguesve? Do të depërtojmë në prapavijën e armikut për të bërë vëzhgimin dhe përgjimin e forcave të armikut. Do të jetë një ditë e gjatë që do të na sjellë lodhje dhe mundime, prandaj po qe se nuk mund t'i përballosh ato, mos eja". Si të mos vij, kur Ju më privilegjoni dhe më nderoni duke ma dhënë mundësin për të mësuar nga afër për punën e ushtarëve tanë.

Ishte ora pesë e mëngjesit. Dielli bëhej gati ta tregojë bukurinë dhe madhësinë e tij në horizont. Njësi i vëzhguesve që përbëhej nga shtat veta ishte bërë gati dhe pinin kafën e mëngjesit. Edhe unë u bëra gati për nisje por, pak me vonesë, pasi nuk më kishin zgjuar me kohë, duke më privilegjuar të flija një gjysmë ore më shumë. Kisha parandjenjën se uniforma ushtarake dhe kallashi më rrinin mirë. U bëra

ushtar në moshën pesëdhjetë e pesë vjeçare. Çfarë ndenjash gëzimi e krenarie më lindën në ato momente. Ku të kisha kohë t'i ve në letër ato ndjenja, kur ushtarët më pritnin. Kafënë e piva me tri gërrqamë, pasi komandanti e dha urdhërin për nisje.

Papritmas garnizoni u gjallërua. Ushtarë, rekrutë dhe oficerë- sa çel e mbyllë sytë- e mbushën hapsirën para komandës, që ishte vendi i posaçëm për rreshtim. Çdo gjë bëhej me rregull. Oficerët para tyre jepnin urdhëra. Sa çil e mshil sytë ushtarët dhe rekrutët me oficerët e tyre grupe-grupe muarën drejtime të ndryshme. Një grup vraponte, tjetri bënte ushtrime gjimnastikore, një tjetër grup ende qëndronte në rresht. Të kënaqej zemra, shpirti dhe syri kur shihje burra të pjekur dhe djelmosha që kryenin urdhërat dhe porosinë e eprorëve të tyre. Pasi kaluam një orë rrugë nëpër territoret tona të çliruara, bëmë një pushim të shkurtër. Me dy palë dylbi shërbeheshin për të bërë vëzhgime. Më erdhi radha edhe mua t'i ve dylbitë në sy. Sa mirë shihen pozicionet e armikut. Aparati i përgjimit u vu në shërbim nga komandant Jahiri. Brenda pak kohe hyri në ndërlidhjet e komandës së armikut oficer Nasini. I futa dëgjojsat në vesh. Dëgjohej zëri i një oficeri serb që urdhëronte të bombardohej fshati Smolicë. Krisma dhe ushtima e topave muar malin. Tymi dhe flaka kapluan qiellin. Para syve më parakalonin gra, fëmijë e pleq që lëshonin shtëpitë e tyre për t'u strehuar dikund maleve. Vaji i fëmijëve ma këputi shpirtin. Fillova të mallkoj këtë botë të fliqur, këtë botë të padrejtësive të mëdha. I mallkova edhe udhëheqësit tanë, "subjektet" shtetërore dhe partiake, që janë çuar peshë duke u munduar t'ia nxjerrin sytë njëri- tjetrit për interesa të tyre personale dhe partiake. Deri kur ky popull i gjorë do të presë që ata të vetëdijësohën për përgjegjësinë që kanë. Mu kujtua thënja e gjeniut popullor i cili nga përvoja e hidhur e tij na mëson se "i mjerë i forti sa i ligë është, dhe lum i ligu sa i fortë është".

Urdhëri i Komandantit për të vazhduar rrugën më tutje për të hyrë thellë në prapavijën e armikut m'i ndërpreu meditimet. Duhet t'i zbulojmë forcat armike që i kanë pru para dy ditësh, më tha komandanti. Nuk dimë për numrin e tyre dhe as për vendin se ku janë vendosur. Aparati i përgjimit na jep të dhëna të nevojshme, por nuk janë të mjaftueshme. Ato duhet të plotësohen edhe me të dhëna tjera, që do t'i mbledhim me anë të vëzhgimeve.

Filluam rrugën me kujdesin e syve pishë të oficerit Nazin dhe ushtarit Rrahim, që i përdornin dylbitë herë pas here. Arritëm në cakun të

cilin e kishte shënuar në hartën topografike komandanti. Aparati i përgjimit u vu në shërbim. Edhe dylbitë shkonin prej dore në dorë, duke shikuar me radhë pozicionet e armikut. Dielli ngutej të prerojë. Rrezët e tij të kuqremta depërtonin me vështirësi aty ku ne kishim zënë vend. Komandanti dukej i kënaqur me punën që kishin kryer sot. Me pedantëri shenonte ca shenja në hartën topografike, që unë si kuptonja ç'domethënie kanë. Dielli më nuk dukej kur komandanti dha urdhërin për t'u kthyer në Qendër. Oficer Gëzimi i printe kolonës, pasi ai rrugën e njeh shumë mirë. Edhe dylbitë i përdorte kohë pas kohe për t'u siguruar se nuk do të binim në ndonjë kurthë të armikut. Posa dualëm në territoret tona të çliruara filluam bisedën me komandantin. Ma shpjegoi rëndësinë e madhe të vëzhgimeve dhe të përgjimit. Nëpërmjet vëzhgimeve tha, ne me saktësi i dimë forcat e armikut dhe stacionimin e tyre. Ne në bazë të këtyre të dhënave e bëjmë mbrojtjen tonë dhe i përgatisim sulmet për të arritur objektivet tona. Edhe përgjimet na hyjnë në punë për marrjen e informatave të nevojshme për forcën e armikut dhe për humbjet e tyre. Sa herë që vëzhgojnë ekspertët tanë hyjnë në ndërlidhjen e komandës së ushtrisë dhe policisë serbe. Do t'ua tregoj një rast, më tha komandant Jahiri, për aftësitë e Njësitit tonë. Kur brigada jonë luftonte në fshatin Logjë, ushtria serbe dhe paramilitarët serbë ndërmuarën një ofensivë të fuqishme të mbështetur nga helikopterë, tanke dhe artilleria e rëndë e tyre. U zhvillua një betejë e përgjakshme, ku forcat serbe pësuan humbje të mëdha dhe u detyruan të tërhiqen. Nga mllëfi i humbjeve të mëdha në njerëz dhe mjete materiale mësyen përseri. Njësitë tankiste serbe iu ishin afruar pozicioneve tona. Na mungonin antitanket. Ishte vështirë t'u përballohej atyre. Ekspertët tanë të ndërlidhjeve arritën të hyjnë në rrjetin e ndërlidhjes së ushtrisë serbe. Oficer Nasini që e flet gjuhën serbe shumë mirë i dha urdhër të prerë komandantit të njërive tankiste: "Kthehuni menjëherë! Shqiptarët do të na mbysin të gjithëve!" Si duket zëri i oficerit tonë është përputhur me zërin e oficerit serb dhe kështu tanket serbe e ndërrojnë drejtimin dhe kthehen prapa. Dhe për të pasur ky "truk" yni sukses ekspertët tanë me anë të instrumentit që dispononin bllokuan ndërlidhjet e komandës serbe.

Arritëm në Qendër pasi muzgu i natës e kishte mbuluar garnizonin si duvaku nusen. Rojet e tij ishin në gjendje gatishmërie për sulm. Kuzhinierin dhe zv. Komandantin i gjetëm në kuzhinë. Kaloi mezi i natës kur u krye darka. Barcoletat e zotëri Brahimit na disponuan të rrimë

edhe ca kohë. Thonë se të qeshurit është edhe ilaç. Diçka duhet të ketë të vërtetë nga kjo thënie, pasi që në sytë e vëshguesve shihej ngazdhimi, kënaqësia, çlodhja dhe freskia.

Krevati që më është caktuar të fle qysh natën e parë kur erdha në Qendër ishte afër dritarës në katin e dytë. Ferku i mëngjesit nuk më kishte zgjuar si zakonisht. Nuk ma kishte prishur gjumin as zhurma e ushtarëve kur janë zgjuar dhe as lindja e diellit, rrezet e arta të të cilit më kishin mbuluar ftyrën. Ishte bërë ora dhjetë, kur zëri i një ushtari që kërkonte komandantin më zgjoi nga gjumi. Isha vetëm në dhomë. Shkova te Burimi i garnizonit. Piva ujin e tij të ftohtë, që rriedhte prronit teposhtë si biluri. Gurgullima e ujit me cicërrimën e zogjve krijonin një simfoni të përkryer që më solli harmoni dhe qetësi shpirtërore. Më tutje në lëndinë e mbuluar me bar dëgjohej biseda e një grupi të rinjsh që kishin ardhur për t'u bërë ushtarë të UÇK-së.

Gjatë bisedës që pata me ta kuptova se ky grup i të rinjve, prej shtatë vetësh, kishin ardhur nga Turqia. Gjashtë prej tyre ishin shtetas të Republikës së Kosovës, nxënës të Medresës së Stambollit, ndërsa shoku i tyre më i vjetër ishte shtetas i Turqisë me origjinë shqiptare. Nxënësit i kishin ndërprerë mësimet, ndërsa shoku i tyre e kishte ndërprerë punën dhe së bashku kishin mësy rrugën drejt Kosovës. Kishin ardhë në Shqipëri. Ca ditë i kishin kaluar në Tiranë dhe Shkodër dhe pastaj nëpërmjet Tropojës kishin mbërritur në këtë Qendër. Pritnin komandantin për ta pyetur se a do tu lejohet t'i kryejnë detyrat fetare po qe se pranohen në këtë Qendër. Nuk pranuan t'ua shënojnë emrat në këtë shkrim timin, përpos dy vetave, pasi që familjet e tyre nuk e kishin dhënë pëlqimin që ata t'i ndërpresin mësimet. Po kush mund ta ndali vrullin rinor, patriotizmin e rinisë tonë për të vepruar, për tu bërë forcë e pathyeshme e Lëvizjes sonë kombëtare për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Pas pak kohe erdhi komandanti. Një bisedë e ngrohtë vëllazërore u bë në këtë lëndinë e cila gjendej ndërmjet kronit dhe pishave të gjata që hija e tyre na mbronte nga rrezet e nxehta të diellit. Na prekën fjalët e Avdullahut, fjalët e të cilit na i përkthente shoku i tij Fehmiu, nxënës i vitit të tretë të Medresës së Stambollit. Më vjen keq dhe turpërohem, tha Avdullahu që nuk di ta flas gjuhën shqipe, gjuhën e babgjyshit dhe babait tim, por zemra dhe gjaku në damarë më rrahin shqip. Masakrat e barbarëve serbë ma kanë turbulluar gjakun dhe me padurim pres t'u bashkangjitem shqiponjave trima të UÇK-së. Unë me këta vëllezërit e mi

do të jemi krenarë dhe shumë të gëzueshëm po qe se do të na pranoni në radhët tuaja. Besojmë se nuk do të na pengoni në kryerjen e detyrave tona fetare. Komandanti, pasi i dëgjoi një nga një edhe gjashtë nxënësit e ardhur nga Turqia, i falënderoi në emër të oficerëve, rekrutëve dhe ushtarëve të Qendrës. Ardhja juaj në mesin tonë na gëzon dhe na bën krenarë që jemi shqiptarë. Kurse sa i përket kërkesës suaj do të bëjmë çmos t'ua sigurojmë kushtet e domosdoshme. Tani do ta njihni një oficer tonin që e fal namazin rregullisht së bashku me dhjetëra ushtarë. Komandanti nxori bllokun nga çanta. Ia lëshoi sytë dhe shpejt u ngrit në këmbë. Si dukej ende ka për të punuar sot. Më bëri me shenjë që ta shoqëroj. Hymë brenda në Komandën e Qendrës për të vazhduar bisedën që e patëm filluar natën e parë kur erdha në Qendër. Një hartë e Kosovës rrinte vjerrë në mur përballë meje. Një hartë tjetër ushtarake ndodhej mbi tavolinën e tij të punës ku ishin të fiksuara shumë shenja me ngjyra të ndryshme, të cilat tregonin pozicionet e armikut dhe pozicionet tona. Ishin të shënuara edhe forcat në njerëz dhe mjetet luftarake për çdo pozicion të armikut në një bllok të posaçëm që gjendej mbi tavolinë. Pastaj komandanti nxori hartën topografike të cilën e kishte përdorur gjatë vëzhgimeve. Shiko, Shefqet, më tha, ne ishim këtu kur e bëmë pushimin e parë, pastaj vazhduam rrugën dhe arritëm në këtë kodër ku i kryem detyrat për të cilat kishim ardhë. Me vëzhgime i zbuluam forcat rezervë të armikut, çka për ne ka rëndësi të madhe kur i përgatisim planet e njëjseve tona operative për sulm. Tani do t'i kemi të plota shënimet për forcat e armikut që gjenden në teritorët e Deçanit, të Junikut dhe të Rekës së Keqe.

Pas dreke rekrutë të rreshtuar nëpër njësi e të udhëhequr nga oficerët e tyre muarën rrugën shpatit përpjetë për të shkuar në Poligonin e shejtarisë (qitjes). Komandanti nuk pati kohë të më shoqëronte, por për mua nuk kishte fare rëndësi, pasi kisha krijuar rrethin tim shoqëror. Më shoqëruan Muhameti, Afrimi dhe Mustafa, të cilët nuk ishin të obliguar të shkonin në poligonin e shejtarisë pasi ata i kishin kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme dhe vetëm pritnin urdhërin të nisen në ndonjë njësi operative të UÇK-së. Arritëm të fundit në poligon. Çdo rekrut gjuante shenjë në fillim me tre plumba dhe pastaj edhe me pesë plumba tjerë. Rezultatet shënohen për çdo rekrut. Më në fund më erdhi radha edhe mua. Me një plumb edhe unë e godita mesin e shenjës me një kallashnikov rus. Këthehem në Garnizon me një rregull dhe disiplinë

ushtarake pa e prishur rrjeshtin, edhe pse diskutohej për rezultatet e gjuajtjes së shenjës në poligon.

Dielli bëhej gati për t'i kaluar kodrat e larta që shtriheshin pas shpinës së garnizonit. Unë me një grup ushtarësh bënim biseda për jetën e tyre para se të vinin në këtë Qendër. Shumica prej tyre kishin ardhur nga Zvicra e Gjermania. Ishin djem të rinj që pritnin me padurim t'u bashkangjiten njësive të rregullta të UÇK-së. Biseduam deri sa erdhi koha e fjetjes, që duhej të përfillej nga të gjithë. Bëhem gati të shkojë në shtrat. Isha te kroni, kur komandanti më gjeti për t'u përshëndetur me mua pasi sonte do të shkonte në një detyrë që duhej ta kryente natën. Nesër në mëngjes nuk do të jetë në garnizon. U larguam ca metra larg ushtarëve që lanin dhëmbët dhe pastronin këmbët. Kam përshtypjen, më tha komandanti, se jeni të kënaqur nga gjithë kjo që keni mësuar nga jeta e rekrutëve, ushtarëve dhe oficerëve tanë në këtë Qendër. Është e tepërt të flas se çka duhet të shkruash e çka të mos shkruash për krejt çka ke parë e dëgjuar këtu, pasi edhe vet e din se çka është sekret ushtarak dhe çka nuk është. Ne jemi të vetëdijshëm se kemi edhe shumë të meta në punën tonë. Vërejtjet tuaja do të na ndihmojnë shumë për t'i larguar ato. Ju do të jeni të mirseardhur të na vizitoni edhe herat tjera. Shpresojmë se pozicionet e armikut që ne i vëzhguam së bashku do t'i shpartallojmë së shpejti. Do të bëjmë çudira me moralin e lartë, vullnetin e pathyeshëm dhe vrullin rinor të ushtarëve të njësive tona të rregullta të UÇK-së. Kosova martire ishte dhe do të mbetet gjithmonë djep i shqiptarisë, më tha komandant Jahiri, por me siguri ka ardhur koha që Ajo të bëhet varr i Serbisë.

Bëhem gati të shkoj në krevat, por gjumë nuk kam. Nesër herët duhet të nisem për Tiranë. Rruga është e gjatë dhe e vështirë. Por përshtypjet e fituara për tri net sa isha me ushtarët, rekrutët dhe oficerët tanë, do të ma bëjnë rrugën edhe më të mundimshme, sepse është shumë vështirë të ndahesh nga këto shqiponja mali, që po përgatiten t'i dalin zot Kosovës, t'iu dalin zot Viseve tona të shenjta, për t'ua dhënë dajakun e merituar hordhive të karpateve të Rusisë, që aq shumë na sollën vuajtje, dhembje dhe varre.

Dielli që po lind për ne shqiptarët e robëruar, pas një acari, shtrëngate dhe nate të gjatë, do të na sjellë një jetë të re, që nuk e kemi përjetuar deri tash, e për të cilën qe dy mijë vjet u derdh aq shumë djersë, lot dhe gjak.

*Botuar: "Revistë ushtarake" Nr.2, tetor 1998*

## KAPITULLI I PESTË

### V. OFICERËT TANË NË SHËRBIM TË ATDHEUT

## OFICERËT TANË NË SHËRBIM TË ATDHEUT

Rezistenca jonë kombëtare ishte faktor vendimar për ruajtjen e qenies sonë kombëtare ndër shekuj. Ajo bëhej në forma dhe përmbajtje që lejonin kushtet e brendshme dhe ato të jashtme, por ajo kurrë nuk u shua deri në ditët e sotit.

Me fitorën e klanit të Titos mbi atë të Rankoviqit më 1966, rrethanat e brendshme ndryshuan shumë në Jugosllavi, e veçmas në Kosovë. Kosova frymonte më lehtë pas ndryshimeve kushtetutare që pasuan pas Plenumit të Brioneve. Intelektualët atdhetarë, kudo që kishin pozita udhëheqëse në organet e pushtetit në Kosovë, bënë ç'ishte e mundur për të shfrytëzuar këto ndryshime për të mirë të çështjes sonë kombëtare, në mënyrë legale, gjysmë legale dhe legale për përparimin dhe emancipimin e popullit tonë në të gjitha fushat dhe lamitë e jetës.

Një detyrë me rëndësi që shtrohej për t'u kryer nga atdhetarë dhe intelektualë ishte propagandimi dhe plotësimi i parakushteve për regjistrimin e djelmoshave shqiptarë nëpër akademitë ushtarake të Jugosllavisë, me qëllim që Kosova ta përgatisë dhe aftësoi kuadrin e saj ushtarak, që- në momentin e duhur- t'i dalin zot atdheut në udhëheqjen e luftës çlirimtare, për t'i këputur prangat e robërisë dhe për ta fituar lirinë.

Në këto kushte dhe rrethana të përshtatshme që u krijuan, shumë familje anembanë Kosovës i dërguan fëmijët e tyre nëpër akademitë ushtarake të Jugosllavisë.

Të rinjtë shqiptarë u detyruan të përballojnë shumë vështirësi të natyrës objektive dhe subjektive për t'i vazhduar studimet, për ta kryer deyrën që ua kishte shtruar familja dhe ata vetvetes. Vetëm ata djelmosha që e patën një vullnet dhe dëshirë të fortë, një edukatë atdhedashurie nga familja, një karakter të pathyeshëm i kryen studimet; u punësuan për t'i përsosur aftësitë e tyre teorike dhe praktike të straegjisë dhe takikës së luftës.

Këta djelmosha tanë, që i fituan gradat ushtarake pas mundit dhe sakrificave të mëdha, nga një shresë njerëzish trajtoheshin në dy mënyra: 1. Për një shresë njerëzish që sistemin e të menduarit dhe të gjykuarit e kishin të mangët dhe me defekte patologjike, dhe që nuk shihnin më larg se hundën e vet, këta djelmosha ishin oficerë jugosllavë, që do t'i mbrojnë interesat jugosllave, e jo ineresat e kombi tonë. Për ta oficerët tanë do të jenë njerëz të dështuar në jetë dhe në familje, do të jenë larg



familjeve, por edhe do të jenë të detyruar të martohen me shkina etj. 2. Për njerëz që sistemin e të menduarit dhe të gjykuarit e kishin të shëndoshë, dhe shihnin edhe pas kodrës, këta oficerë ishin kuadri ynë ushtarak me rëndësi të madhe kombëtare, që duhet përkrahur, forcuar dhe ruajtur, sepse këta në momenin e duhur do të jenë prijësit tanë usharakë, që me dijen dhe përvojën e fituar në ushtrinë jugosllave, do të dinë qysh është më së miri t'i përballojnë sulmet e saja, dhe popullin tonë ta udhëheqin drejt fitores përfundimtare.

Sa vështirë e patën oficerët tanë ta ushtrojnë profesionin e ushtarakut në armatën e huaj, në armatën e okupatorit tonë; jashtë Kosovës, larg familjes dhe të afërmeve të tyre. Vetëm ideali i lartë që një ditë do të ketë nevojë ajo Gjysmë Shqipërie e robëruar dhe e copëtuar nga kasapët serbo-sllavë, për dijen dhe aftësitë e tyre ushtarake, bëri që të mos u ligështohet zemra, dhe të mos u dobësohet arësyeja. Ata ishin të vëzhguar dhe të përcjellë nga sigurimi i armatës jugosllave, që ishte në duart e serbëve dhe serbofilëve. Edhe gjesti më i vogël i oficerëve shqiptarë, që tregonte se ata nuk janë "projugosllavë", jo vetëm që do t'i largonte nga ushtrimi i profesionit të usharakut, që do të bëjnë huq ëndrrat e pastërta rinore për t'i dalë zot tokës së Arbërit, por edhe do të trajtohen si nacionalistë, dhe do të gjykohen me burgje të gjata. Oficerët tanë çdo ditë ishin në provim. Çdo ditë ishin të rrezikuar, që tërë mundi t'u shkonte huq me një gjest të vogël të përkrahjes së ushtarit shqiptar, kur cenohej personaliteti i tij nga kolegët e tyre serbë. Ata duhej çdo ditë të jenë artistë të mirë, të luajnë rolet e "jugosllavizmit" në mënyrë të përsosur. Ata në radhë të parë me martesë duhet të tregohen "projugosllavë" po që se dëshirojnë t'u çelen dyert e studimeve të larta ushtarake, për t'i njohur fshehtësitë e artit ushtarak në përgjithësi, dhe atij jugosllav në veçanti.

Sa vuajtje dhe plagë shpirtërore është dashtë të përballojnë oficerët tanë, të shkaktuara nga shovenistë serbë dhe nga shpifësit dhe kokëkrisurit shqiptarë. Sa plagë të pashëruara kanë ende oficerët tanë të shkaktuara nga bashkëkombasit e tyre, duke i shpifur e njolllosur në mënyra të ndryshme edhe sot e kësaj dite, edhe pse dihet përkushtimi i tyre për çështjen tonë kombëtare.

Shkatërrimi i Jugosllavisë filloi kur Armata e Jugosllavisë e sulmoi Republikën e Sllovenisë. Politikanët dhe kuadri ushtarak i Sllovenisë ishin të vendosur për ta mbrojtur atdheun dhe popullin e tyre

me të gjitha mjetet që kishin. Ata nuk njolloseshin për pozita që kanë pasur apo për martesë të përziera me pjesëtarë të kombeve tjera. Ishin të gjithë tok dhe pavarësinë e fituan lehtë dhe shpejt. E njëjta gjë ndodhi edhe me Kroacinë dhe kroatët. Edhe boshnjakët ndoqën të njëjtën rrugë. Ata edhe ministrin e Jashtëm e sollën nga SHBA. Ishte i lindur në vend të huaj, por asgjë se pengoi atë, pse nuk ishte i lindur në Bosnje për të punuar me përkushtim për vendin e prindërve të tij, dhe as bashkombasit e tij nuk i pengoi se ai vinte nga Amerika, me pikëpamje e bindje që nuk përputheshin në tërësi me ato të bashkëkombasve të tij.

Po tek ne shqiparët e Kosovës nuk u vazhdua ajo rruga normale dhe e natyrshme që duhej vazhduar! Si të vazhdohet kur dihet se politikanët tanë ishin vendosur në poste udhëheqëse nga Beogradi. Çfarë anomalie e shëmtuar! Përpos politikanëve kukulla që e përkrahën ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës, ato ndryshime i përkrahën edhe mësimëdhënës fakultetesh me tituj "shkencorë"- Dr. e tituj tjerë-, të cilët lehnin për qefin e çetnikëve të Beogradit, për ta bindur popullin dhe "përfaqësuesit" e tij në Parlamentin e Kosovës që të votonin për ndryshimet kushtetutare që i kërkonte Serbia, sepse- siç thonin ata- " Kosova asgjë nuk humb". Çka duhet të bënin oficerët tanë, që ishin të shpërndarë në të gjitha pjesët e Jugosllavisë, në këto kushe kur kreu politik i Kosovës tradhtoi. Lëvizja jonë kombëtare edhe pse arriti ca suksese në dy vitet e para të viteve 90-ta, ato mbetën të pakryera dhe kështu Republika e Kosovës mbeti pa parlament, pa ushtri dhe institucione të domosdoshme për ta jetësuar pavarësinë dhe lirinë e sajë. Në këto kushte edhe kuadri ynë ushtarak u detyrua t'i marrë rrugët e botës për shkaqe ekonomike dhe politike. Një pjesë e tyre u zu nëpër fronet e luftërave serbo-kroate dhe serbo-boshnjake, ku ata treguan zotësi të jashtëzakonshme në taktikën dhe strategjinë e luftës.

Pasi që UÇK-ja dhe Lëvizja studentore për rimarrjen e objekteve mësimore e ndërruan status-quonë në Kosovë, edhe kuadri ushtarak filloi të organizohet në diasporën shqiptare, duke shprehur gatishmerinë, në mënyrë publike, se janë të gatshëm në çdo moment të vihen në shërbim të Luftës Çlirimtare të Kosovës, në mënyrë institucionale, me urdhërin e Qeverisë së Kosovës. Kërkesa dhe dëshira e tyre u muar në konsiderim nga Qeveria, dhe ajo e formoi Ministrinë e Mbrojtjes. Shumë oficerë tanë sot gjenden në Frontin e luftës çlirimtare.

Një pjesë tjetër po bëjnë përgatitjet e duhura t'u bashkangjitën shokëve të tyre. Aftësitë dhe përvojat e tyre luftarake, dita ditës po japin rezultate më të mëdha. UÇK-ja sot me sukseset e saj u bë faktorë parësor për realizimin e aspiratave shekullore të popullit tonë për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Lufta gjashtëmujore e UÇK-së, kalitja luftarake e ushtarëve të saj nëpër beteja të shumta nxori në dritë shumë ushtarakë të zotë, të cilët me aftësitë e tyre komanduese ushtarake treguan se mund të komandojnë njësitë e UÇK-së nëpër frontet më të vështira të luftës çlirimtare. Prandaj një ushtri siç është kjo e jona, me një kuadër profesional që është shkolluar nëpër akademitë ushtarake jugosllave, dhe me një përvojë të fituar nëpër frontet e luftës kroato-serbe e boshnjako-serbo-kroate, si dhe një kuadër ushtarak që u krijua gjatë luftës gjashtëmujore, pa një shkollim adekuat, por me një përvojë të fituar në frontet e luftës shqiptaro-serbe në Drenicë, Dukagjin dhe Llap, mishërojnë dhe bashkojnë dijen, gatishmërinë për sakrificë dhe atdhedashurinë për tu bërë një ushtri e fortë, e cila do të përballojë të gjitha vështirësitë dhe pengesat që do të dalin në rrugën e saj të shenjtë për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar.

Republika Kosovovës sot është në luftë, prandaj askush nuk ka të drejtë të sillet me papërgjegjësi. Veçmas përgjegjësi të madhe historike dhe kombëtare ka klasa politike shqiptare, e cila duhet të ndërgjegjësohet që interesat partiake dhe personale të flaken si një leckë pa vlerë, për derisa populli ynë nuk i realizon aspiratat e tija shekullore për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Edhe mjetet e informimit publik kanë përgjegjësi të madhe, të mos u mundësohet individëve pa përgjegjësi të bëjnë shpifje për ta njollosur kuadrin tonë usharak, apo për ta përçarë atë në baza të ndryshme. Në një kohë kur kuadri ynë ushtarak me vepra tregoi se është forca jonë më e shëndoshë kombëtare, e papërçarë në baza partiake, regjionale apo klanore. Askush nuk ka të drejtë të njollosë oficerët tanë, të shpifë për këta atdhetarë trima, për udhëheqësit tanë ushtarakë.

Çlirimi i Kosovës dhe i Viseve tjera shqiptare është detyrë parsore e Lëvizjes sonë kombëtare, prandaj çdonjëri që vepron kundër këtyre qëllimeve të larta kombëtare, me vetëdije apo pa vetëdije, me qëllim apo pa qëllim, do të vijë koha për të dhënë llogari dhe për t'u përgjegjur për dëmet që i kanë sjellë çështjes sonë kombëtare.

Çdonjëri duhet t'i kryejë detyrat që i takojnë dhe askush nuk ka të drejtë ta pengojë tjetrin në kryerjen e detyrave për të cilat është përcaktuar apo është autorizuar nga organi kompetent t'i kryejë.

*Botuar: "Java Shqiptare", më 19.07.1998.*

*dhe në "Revistë Ushtarake" Nr.1.shtator 1998*

## MBI KEND BIE PËRGJEGJËSIA PËR VRASJEN E AHMET KRASNIQIT

Një Qendër antishqiptare dha urdhërin.

Një dorë e zgjatur katile e Serbisë bëri krimin.

E vranë kolonel Ahmet Krasniqin, Ministrin e Mbrojtjes dhe Komandantin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës, se në Të panë zotësinë për ta riorganizuar UÇK-në dhe për ta bërë atë forcë të pathyeshme ushtarake, me të gjitha parametrat e një ushtrie moderne dhe profesionale, që do të ishte e aftë për ta çliruar çdo pëllëmbë të robëruar të tokës shqiptare.

Po, e vranë ushtarakun madhor Ahmet Krasniqin armiq të tanë, se ai do t'ua prishte planet e tyre djallëzore, se ai do t'i shkatërronte planet antishqiptare të Beogradit, Athinës, Shkupit dhe aleatëve të tyre.

Vdekja në këto momente tragjike të kombit tonë, të strategut të luftës, veprimtarit dhe atdhetarit të dalluar, që me përkushtim punoi përpos punëve profesionale ushtarake, edhe për bashkimin e të gjitha forcave politike e ushtarake shqiptare, do të jetë një humbje e madhe për popullin tonë e UÇK-në, e cila aq shumë ka nevojë për kuadro të larta ushtarake, për atdhetarë të mirëfilltë, që janë të painfektuar nga sëmundjet partiake, ideologjike, karrieriste dhe klanore, siç ishte Ahmet Krasniqi.

T'i përgjigjesh pyetjes që sot shtrohet kudo ndër shqiptarë,-se kush e vrau Ahmet Krasniqin-, nuk është lehtë dhe thjeshtë. Një gjë është e sigurtë, se urdhërin për këtë atentat politik e ka dhënë Qendra antishqiptare, serbo-sllavo-greke, e cila vitin që shkoi e realizoi pjesën e parë të skenarit antishqiptar, duke e kallur Shqipërinë dhe institucionet e Shtetit të saj nëpërmjet stalinistve shqiptarë, dhe solli në pushtet forcat proslavo-greke.

Pjesa e dytë e skenarit antishqiptar filloi me burgosjet dhe atentatet politike gjatë këtij viti të atdhetarëve demokratë, atentate që kanë për qëllim ndezjen e luftës qytetare në mes Veriut dhe Jugut të Shqipërisë në njërën anë dhe lënien e Kosovës nën kthetrat dhe mëshirën e çetnikve të Beogradit në anën tjetër. Zhdukja fizike me atentate e Azem Hajdarit dhe Ahmet Krasniqit në Tiranë dhe plagosja e Sabri Hamitit në Prishtinë tregon qartë se këto atentate janë përgatitur nga një Qendër komanduese,

që patën për qëllim arritjen e efekteve politike, e në rend të parë, për t'i dobësuar forcat e shëndosha kombëtare, dhe mbjelljen e frikës ndër shqiptarë, që të mos e kundërshtojnë linjën antikombëtare, që sot e gjithë ditën po punon për interesa të armiqve tanë në Shqipëri, Kosovë dhe në Viset tjera shqiptare, si dhe në diasporën tonë.

Për vrasjen e Ahmet Krasniqit do të jenë përgjegjës, përpos armiqve tanë shekullorë, edhe: Liderët e partive politike shqiptare të Kosovës, që popullin e gjojnë e përçanë në baza ideologjike partiake dhe klanore, të cilët po mundohen t'ia nxerrin sytë njëri-tjetrit për pozita udhëheqëse shtetërore pa e bërë ende shtetin.

Do të jenë përgjegjës para historisë për vrasjen e Ahmet Krasniqit udhëheqësit e subjekteve shtetërore të Republikës së Kosovës, të cilët po bëjnë luftë të pa kompromis për t'i mbajtur sa të jenë gjallë pozitat dhe kolltuqet e fituara më parë.

Do të jenë përgjegjës para historisë për vrasjen e Ahmet Krasniqit edhe pararoja komuniste e LPK-së, që po silllet nëpër rrugët e Tiranës dhe Evropës Perendimore duke i thelluar përçarjet e shqiptarëve në baza ideologjike dhe duke penguar bashkimin e tyre në baza të shëndosha kombëtare.

Por përgjegjësinë më të madhe për vrasjen e Ahmet Krasniqit do ta ketë Qeveria e Kosovës dhe në veçanti Kryeministri, që Ministrin e Mbrojtjes e ngarkoi me detyra dhe përgjegjësi të mëdha kombëtare, por pa ia dhënë pavarësinë për të vepruar dhe mundësinë për t'i vënë në veprim të gjitha aftësitë e tij ushtarake e organizative, për ta forcuar faktorin ushtarak të Republikës së Kosovës- UÇK-në. Një UÇK e institucionalizuar me siguri do ta detyronte klasën politike të Kosovës të bëhet e ndërgjegjshme për përgjegjësinë historike dhe kombëtare që ka; por as nuk do t'u lejonte ta çojnë Kosovën në këtë gjendje të mjerë që e çuan si pasojë e përçarjeve të tyre partiake dhe klanore. Është dashtë të kallet e të bëhet rrafsh me tokë Drenica dhe Dukagjini! Është dashtë të mbeten pa kulm mbi krye një e katërta e popullsisë së Kosovës, të cilët u detyruan të gjejnë shpëtimin nga masakrat serbe duke u fshehur nëpër male, apo për t'u shpërngulur jashtë Kosovës, nëpër katër anët e botës! Është dashtë të masakrohen, të vriten e të zhdukën me mijëra shqiptarë, gra, fëmijë, pleq dhe njerëz të paarmatosur! Është dashtë, më në fund, të vritet edhe Ahmet Krasniqi nga dora e zgjatur e Serbisë, për t'u legalizuar Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, të cilën Ahmet Krasniqi

e udhëhoqi në kushte jashtëzakonisht të vështira, pa përkrahjen e duhur të Kryeministrit, me pengesa të mëdha që i krijonin sigurimet e huaja të infiltruara në SHIK-un e Shqipërisë, me pengesa të mëdha të krijuara nga pararoja staliniste e LPK-së, e cila e pengoi bashkimin e forcave të armatosura ushtarake, dhe me punën e tyre pa përgjegjësi i sollën dëme të mëdha UÇK-së dhe çështjes sonë kombëtare.

Opinionit shqiptar kërkoi nga organet shtetërore të Qeverisë së Shqipërisë dhe të Qeverisë së Kosovës t'i zbulojnë dorasit e atentateve politike, që u kryen në Tiranë dhe Prishtinë kundër Hajdarit, Krasniqit dhe Hamitit.

Por, të shpresosh se SHIK-u do t'i zbardhë këto atentate që u kryen në Tiranë, është papjekuri politike, kur është më se e sigurt se njerëzit e saj kanë qenë të përzier në përgatitjen e këtyre atentateve. Ndërsa të pritësh se Organet shtetërore të Republikës së Kosovës do t'i gjejnë sot kriminelët e dy atentateve politike që u bënë ndaj dy personaliteteve të rëndësishme të dy institucioneve shtetërore të Kosovës është jo reale.

Por një gjë duhet shpresuar, se një ditë drejtësia ka për të fituar, dhe kriminelët e këtyre atentateve, sëbashku me ideologët e tyre, do të zbulohen dhe Organet gjyqësore të Tiranës dhe Prishtinës do t'ua japin dënimet e merituar.

*Botuar "Bota sot" 16 tetor 1998 dhe në "Rimëkëmbja" nëntor/98*

## PSE DHE KUSH E VRAU AHMET KRASNIQIN

Ne shqiptarët, për dallim nga popujt e Evropës Perendimore, dallohemi për shumë çka prej tyre. Jemi pothuajse populli i vetëm që ende nuk e kemi zgjedhur çështjen kombëtare. Jemi populli i vetëm në Evropë, i cili ende nuk e ka një klasë politike, që njeh dhe respekton rregullat e lojës politike dhe vlerat e shoqërisë demokratike. Jemi populli i vetëm në Evropë që çdo vjet i përkujton Burrat e Mëdhenj të Kombit që na i zhdukën fizikisht armiqtë shekullorë të kombit tonë, me anë të shqipfolësve të sojit të qenit, që të huajt ua hudhnin ca kocka për t'i lëpirë, dhe kështu i mashtruan për të punuar për hesape të tyre, siç i mashtrojnë pedofilët fëmijët jointelegjentë me bombone dhe ca karamеле.

Deri sa viti 1997 ishte viti i krimeve masive që Shqipërinë e shtriu përtokë dhe mijëra familje i veshi në të zeza, viti 1998 ishte viti i krimeve të zgjedhura, ku u vranë ato personalitete që me punën e tyre këmbëngulëse u bënë luftëtarë të denjë për zgjidhjen e çështjes madhore kombëtare siç ishin: Azem Hajdari dhe Ahmet Krasniqi, që pengonin dhe ua prishnin planet armiqve shekullorë të kombit tonë të cilët kishin për qëllim realizimin e ëndrrave të tyre të marra për të na zhdukur si popull dhe si komb.

Një javë pas vrasjes mizore të Azem Hajdarit, u vra nga e njëjta bandë kriminelësh kolonel Ahmet Krasniqi, Ministër i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, vrasjet e të cilëve prekën thellë shpirtin liridashës të njerëzve të ndershëm dhe i mbushi vrer zemrat e shqiptarëve në gjithë hapësirën kombëtare dhe në diasporë, përpos një numri të vogël mjeranësh të manipuluar nga djajtë bolshevikë, që shprehnin kënaqësi dhe gëzim duke ngrehur dolli dhe organizuar darka gëzimi për të festuar krimin e kriminelve dhe tradhtinë e social-komunistëve shqiptarë, që ua shkurtuan jetën Dy Burrave të Dheut, që njëri ishte bërë simbol i demokracisë shqiptare, ndërsa tjetri ishte ushtaraku madhor me një përvojë dhe dije të lartë të artit ushtarak për të cilin aq shumë kishte nevojë UÇK-ja dhe Kosova.

### KUSH KRYEN URDHËRAT E QENDRAVE ANTISHQIPTARE

Opinionin ynë dhe ai ndërkombëtar u interesua të dijë se kush e organizoi dhe kush i kreu këto krime të cilat sa ishin tragjike aq ishin edhe monstruoze. Tani pas një motmoti gjërat janë qartësuar dhe çdo gjë është



e kuptueshme se kush urdhëroi dhe kush i kreu atentatet politike gjatë vitit të kaluar ndaj personaliteteve të shquara të kombit tonë. Të gjitha krimet që janë bërë në Shqipëri dhe në Kosovë gjatë këtyre tri viteve të fundit, e kanë burimin tek Qendra Antishqiptare e krijuar nga sigurimet e fshehta të Serbisë, Greqisë dhe Ruisë, që e projektuan dhe e mbikqyrën të ashtuquajturin "revolucion të vonuar demokratik" të Qosjes, dhe i prunë në pushtet lakejtë dhe spiunët e tyre, me ndihmen dhe bekimin e të majtës evropiane. Se ajo Qendër dha urdhër për burgosje, atentate politike dhe i krijoi kushtet për kaos e anarki, për kriza të thella morale dhe ekonomike, për lulëzimin e krimit të organizuar shtetëror, ndërsa kukullave të tyre në Tiranë nuk ua lejojnë të bëjnë punë tjetër përpos punën e robotëve, komandat e të cilëve përgatitën dhe drejtohen nga Athina, Moska dhe Beogradi.

Para se të kërkojnë shkaqet dhe motivet e krimit është e domosdoshme të dihen rrethanat politike në hapësirën kombëtare dhe atë ndërkombëtare, që ndikuan për t'u kryer ky krim. Dihet mirëfilli se armiqtë tanë kanë bërë plane, memorandume dhe skenare, për të na zhdukur si popull dhe si komb.

#### NANOSI- BABË I ENVERISTËVE KOSOVARË

Rebelimi komunist i 1997 ishte i përgatitur e i mbështetur nga Qendra antishqiptare serbo-ruso-greke dhe konsiderohet si faza e parë e një projekti që ka për bazë Programin e pansllavizmit rus, të Naçertanies dhe Memorandumeve serbe, si dhe Megalo-idesë greke, që Shqiptarët të hedhen në det para përfundimit të shekullit 20-të, apo të shkombëtarizohen dhe të zhduken si komb. Spastrimin etnik të Kosovës dhe kthimin e saj nga djepi i shqiptarizmit në tokë serbe, e parashihte faza e dytë e të njëjtit projekt, që Shqipërisë para dy vitesh ia futën futën e zezë.

Në bisedimet e Kretës në mes Kasapit të Ballkanit dhe spiunit greko-serb, u ndanë rolet dhe detyrat dhe kështu filluan përgatitjet për ta goditur Kosovën. Nanosi pasi u bë nënë dhe babë për enveristët e Kosovës, nuk e pati vështirë që Kosovës t'ia mihë varrin pa e kuptuar fare këta të gjorë. Punën e parë që e kreu Nanosi dhe që kishte rëndësi të madhe strategjike për serbët ishte përçarja e LDK-së që ai e bëri nëpërmjet Hydajet Hysenit në Kuvendin e Tretë të saj. Ndërsa Qosja kryente punën e tij si edhe më parë, duke u bërë avokat i politikës antikombëtare të Nanosit me kompani, pa gjetur në punën e tyre asnjë

halë. Nanosi me Mejdanin, këta të dy i patën thirrur tinëz në Tiranë për t'i përgëzuar për punën e kryer dhe për t'u caktuar punë edhe detyra edhe më me rëndësi. Ata po sa u kthyen, edhe pse Kosova kallej flakë, formuan partinë e tyre të re. Me ndërrimin e "status-qous" në Kosovë nga Lëvizja Studentore dhe UÇK-ja, të gjitha subjektet politike e shtetërore u ringjallën. LDK-ja me ca parti të vogla i shpallën Zgjedhjet e reja Presidenciale dhe Parlamentare. Subjektet politike që e dinin se nuk do t'i fitonin zgjedhjet, u përcaktuan që të mos marrin pjesë në to, me arsyetimin se nuk mund të bëhet fushatë zgjedhore në kushte okupimi. Më vonë i morën edhe shkaqet e krimeve të para serbe në Drenicë. Shumë shpejtë karrieristët Lëvizjën studentore e përçanë, ndërsa bërthamat e para të UÇK-së, që punonin në ilegalitet të plot, me një organizim të mirë të luftës guerile, LPK-istët nga diaspora me urdhërin e Nanosit ia ndërruan taktikën dhe strategjinë e saj. E futën popullin të papërgatitur dhe para kohe në luftë frontale me shkje, që kishin armatim të rëndë e modern, ndërsa në Kosovë enveristët e Nanosit shpërndanin kallasha me fishekë e pa fishekë, me gjilpërë e pa gjilpërë, por e rëndësishme ishte që ato do të hyjnë për para në punë. E shpallën veten krah politik të UÇK-së dhe i vunë pusitë në Durrës, Tropojë e Kukës, që pa lejen e tyre askush të mos futet në Kosovë. Qosja me Hydajet Hysenin e ca të tjerë, u bënë projektues të një varianti të "revolucionit të vonuar demokratik" të Qosjes, që për kushtet e Kosovës ishte edhe më shkatërrimtar se ai i Shqipërisë.

**KOLONEL AHMET KRASNIQI NUK DO TË SHKOJË GJAKHUMBUR**

Këta të dy (Qosja dhe Hyseni) e përfituan Adem Demaçin për t'i bashkuar të gjithë enveristët shqiptarë të Kosovës nën të njëjtin kulm të ashtuquajtur LBD-ja e Kosovës, dhe më vonë të gjithë enveristët së bashku e formuan të ashtuquajturën LBDK-në, që pastai bënë aleancë politike me LPK-në, për t'i shkatërruar të gjitha themelet e shtetësisë së Republikës së Kosovës, duke u mbështetur në parimin e njerëzve pa njerëzi: "Për inat të resë më vdektë djali". Më vonë Demaçi dhe Pararoja staliniste e LPK-së u bënë udhëheqje dhe zëdhënësë politike e UÇK-së.

Në këto kushte tejet të komplikuar ku "qeni s'e njeh të zonë", Ahmet Krasniqi muar detyrën e Ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës. Që nga dita e parë Ahmet Krasniqi hasi në pengesa të mëdha

dhe të llojllojshme nga karrieristë të sëmurë për pushtet dhe partiakë të shtirë.

Gjatë muajve prill dhe maj të vitit 1998 pati kontakte me përfaqësues të të gjitha subjekteve politike, shtetërore dhe ushtarake të Republikës së Kosovës, qëllimi i të cilave ishte bashkimi i të gjitha këtyre forcave në një Front të përbashkët veprimi, që do t'i bashkonte të gjithë shqiptarët pa dallim bindjesh politike apo ideologjike, për realizimin e çështjeve madhore kombëtare, duke kërkuar nga të gjithë t'i njihnin Institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës si Presidencën-Presidentin, Parlamentin dhe të plotësohen kërkesat e opinionit tonë dhe kërkesat e miqve të kombit tonë për ta formuar Qeverin e Re prej të gjitha subjekteve të përfshira apo të papërfshira në Parlamentin e Kosovës. Është më se e sigurtë se të gjitha përçarjet që u krijuan, u bënë për shkak se udhëheqjet e Kosovës nuk u muarën vesh se kush do të bëhet i pari, kush i dyti dhe kush i treti. Sidomos Qosja donte të bëhej i pari. Bukoshi donte të jetë edhe disa mandate i dyti. Ndërsa H. Hyseni donte gjithësej të bëhet i treti. Ndërsa nuk ishin vetëm këta që i donin këto poste. Edhe të tjerët i lakmonin këto vende udhëheqëse. Veçmas Bardhyl Mahmuti i kishte "mbrehur dhëmbët" për t'u bërë i treti, prandaj aleancat bëheshin dhe çbëheshin "sahat e dakik". I ndjeri Ahmet Krasniqi sa ka harxhuar energji për t'i pajtuar këta kojtaxhinj dhe kojtaxhinj tjerë, që nuk shihnin asgjë tjetër në këtë botë përpos kolltukut të tyre. Më në fund Ahmet Krasniqi pas përpjekjeve të mëdha arrijti të vërë kontakt edhe me krerët e UÇK-së, ku delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes e përfaqësonte Ahmet Krasniqi, ndërsa delegacionin e UÇK-së Adem Demaçi. Ahmet Krasniqi duke ditur se me Demaçin njihemi që nga 1963, kur u pata bërë anëtar i LRBSH, ideologu dhe kryetar i së cilës ishte ai, më tregoi se do të ketë një takim me Demaçin i cili gjendej në Norvegji.

AHMETI U REGJISTRUA NË AKADEMINË USHTARAKE, ME SUGJERIMIN TONË

U gëzova pa masë kur mësova se do të bëhej ky takim, prandaj edhe e mora në telefon Hajdin Abazin, të cilin e njoh që nga viti 1979. I tregova se Baca Adem është në Norvegji dhe se dua të bisedoj me të, por nuk e kamë numrin e telefonit të tij. Hajdini më tha: "Prit pak se unë do ta gjej pasi e di se te kush rri". Pas pak ma gjeti numrin e telefonit dhe unë nëpërmjet telefonit i tregova për personalitetin e Ahmet Krasniqit dhe i thashë se me Ahmetin duhet të flasë pa dorëza dhe se duhet të ketë besim

të plot në të, pasi që ai ka qenë anëtarë i Lëvizjes (kuptohet i LNÇKVSHJ, të cilën e drejtonin Metush Krasniqi, Sabri Novosela, Jusuf Gërvalla, etj.). Pastaj i tregova se ai është dërguar në Akademi Ushtarake për t'u bërë kuadër i Lëvizjes, se është nipi i Aziz Zhilivodës etj. Demaçi pastaj më pyeti për martesën e tij. I tregova se edhe martesa është bërë me pëlqimin tonë, se përndryshe nuk kishte kurrfarë mundësie për t'i vazhduar studimet e larta të artit ushtarak, (Akademinë Komanduese). Baca Adem më tha: " Shumë mirë bërë që m'i tregove këto gjëra se po flitet gjithqysh", prandaj rri ti pa gajle, më tha, se do të kem besim të plot në Ahmetin". Pasi u kthye Ahmeti nga takimi më tha: "Shefqet e di që këto fjalë që po t'i them do të mbesin në mes meje dhe teje, prandaj edhe po t'i them. Baca Adem është shef i UÇK-së". Pastaj vazhdoi: "E kemi bërë një marrëveshje dhe shumë besoj se punët tash e tutje do të ecin si është më së miri". Opinioni i gjerë nuk ka ditur për këtë Marrëveshje që është lidhur në mes UÇK-së dhe Ministrisë së Mbrotjtjes së Republikës së Kosovës, pasi që ajo është mbajtur e fshehtë nga të dyja palët.

#### KA ARDHUR KOHA TË NJIHEMI ME MARRËVESHJEN DEMAÇI-KRASNIQI

Vetëm atëher kur Ahmet Krasniqi njollosej nga enveristët e Kosovës edhe pas vdekjes duke e shpallur edhe "tradhtar" në gazetën e tyre "Zëri i Kosovës", u detyrova ta zbuloj një pjesë të Marrëveshjes që lejonin kushtet objektive, që ma pat botuar gazeta jonë kombëtare "Bota sot", më 18 janar 1999, me titull: "Në vend të përkujtimit të Ahmet Krasniqit", dhe pak ditë më vonë është botuar në "Rimëkëmbja" dhe në mjetet elektronike "Info Kosova". Tani pasi NATO-ja na e çliroi Kosovën me ndihmën e trimave të UÇK-së, ka ardhur koha dhe është e domosdoshme që opinioni ynë të njihet me Marrëveshjen që është lidhur në mes Adem Demaçit dhe Ahmet Krasniqit. Po qe se në këtë shkrim do t'i shënoj vetëm ato pjesë të Marrëveshjes që s'i kam qitur në dritë më parë, lexuesit e nderuar do të kenë vështirësi të kuptojnë se për çfarë Marrëveshjeje bëhet fjalë. Prandaj lexuesit do ta kenë Marrëveshjen lexuesit do ta kenë në tërësi, me një dallim që pjesët e saj që për herë të parë opioni do t'i mësojë, do t'i shënoj me shkronja të zeza. 1). Pra në atë takim (në mes Ahmet Krasniqit dhe përfaqësuesit të UÇK-së) është vendosur që UÇK-ja, përpos Shtabit të Përgjithshëm, do ta ketë edhe një Shtab në Tiranë, në përbërje të oficerëve shqiptarë, që i kanë kryer studimet nëpër akademitë jugosllave dhe përfaqësues të LPK-së dhe

LKÇK-së, ku Ahmet Krasniqi do të jetë komandant i Shtabit dhe koordinator në mes dy Shtabeve të UÇK-së. 2). Shtabi i UÇK-së në Tiranë do të kujdesej për furnizimin me armatim të njërive të UÇK-së. 3). Të gjitha komunikatat që do t'i shpallte Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së do të korigjohen nga Ahmet Krasniqi, para se të publikohen në mjetet e opinionit publik. 4). Shtabi i UÇK-së në Tiranë do të merrej me aftësimin e kuadrit ushtarak dhe të ushtarëve, duke i përcjellë në Kosovë në mënyrë të organizuar dhe në formacione ushtarake, që do të jenë të aftë për t'i kryer të gjitha detyrat taktike dhe operative në teren. 5). Përpos forcave elite të UÇK-së do të formohen edhe Njësitë e Mbrojtjes Teritoriale të Kosovës, Njësitë e Policisë, dhe Njësitë e Aviacionit Ushtarak. 6). Njësitë e Mbrojtjes Teritoriale do t'i udhëheqë zotëri Ramadan Qehaja me të cilin do të konsultohet Adem Demaçi, apo ndonjë person që ai e cakton. Po qe se zotëri Qehaja do të pranonte këtë detyrë, do ta njoftohet Ahmet Krasniqin me anë të shifrës (parullës) se "çaji po pihet shumë", ndërsa po qe se zotëri Qehaja detyrën nuk e pranon do të thuhet me anë të shifrës se "çaji nuk po pihet se dëm po na bën". Pas një kohe ka ardhur përgjigja pozitive dhe kështu Marrëveshja ka marrë vlerën e nënshkrimit nga të dy palët edhe pse ajo është bërë vetëm gojarisht. 7). Njësitë elite të UÇK-së, Njësitë e Mbrojtjes Teritoriale, të Policisë Ushtarake dhe të Aviacionit Ushtarak do të quhen: Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës. (pra në shkrimin e parë nuk është përmendur fare emri i Adem Demaçit dhe as i Ramadan Qehajës për shkak objektivë, se Kosova ende ishte nën okupimin serb)

## PARAROJA STALINISTE BOJKOTON PROFESIONALIZMIN E LUFTËS

Marrëveshja ia mundësoi kolonel Ahmet Krasniqit ta bëjë selinë e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, Shtabin dhe Qendrat e Stërvitjes në Shqipëri. Fatkeqësisht mosmarrëveshjet shtoheshin dita ditës në mes tij dhe përfaqësuesve të LPK-së, pasi që ata i venin interesat e tyre klanore dhe ideologjike mbi interesat kombëtare.

Mosmarrëveshja e parë lindi për shkak se Ahmet Krasniqi donte ta siguronte shumicën e armatimit nga jashtë, sepse kushtonte më lirë dhe ishte i një cilësie të lartë, ndërsa pararoja staliniste në krye me Xh. Halitin donin ta siguronin nga fshatarët e Shqipërisë, kuptohet se armatimi u pengua të sillej nga jashtë, përpos në sasira të vogla, pasi që nuk lejonte SHIK-u dhe as Nanosi me Kompani. Në këto rrethana Ahmet Krasniqi u

detyrua të pranonte që përfaqësuesit e LPK-së që me propozimin e Demaçit u futën në Shtabin e UÇK-së në Tiranë, të caktohen përgjegjës për armatim, kuptohet edhe të qeverisin me miljona marka nga Fondi i Qeverisë së Kosovës, ndërsa në të njëjtën kohë shpifnin nëpërmjet "Zëri i Kosovës" kundër Ahmet Krasniqit, Qeverisë dhe Bukoshit se nuk janë duke e ndihmuar me asnjë metalik UÇK-në. Mosmarrëveshjet u shtuan shumë kur kah fundi i muajit qershor të 1998, kur hyri në mënyrë të organizuar, e përgaditur dhe e aftësuar Brigada e parë në Kosovë me 24 ushtarakë dhe Tahir Zemën komandant të saj, (Brigada 134 që e komandonte Tahir Zmaj ishte complete me kuadër ushtarak dhe me ushtarë, ndërsa dy brigadat tjera ishin të kompletuara vetëm me kuadrin ushtarak) me ç'rast LPK-istat shpikën gënjeshtër se në Kosovë veprojnë dy ushtri, njëra ishte UÇK-ja dhe tjetra FARK-u i Bukoshit. I ndjeri Ahmet Krasniqi e shihte rrezikun nga komplotet që po ia kurdisnin UÇK-së armiq të tanë nëpërmjet pararojes staliniste të LPK-së, dhe karrieristëve të sëmurë për pushtet të LBDK-së, prandaj pat kërkuar disa herë nga Bukoshi që të dalë në opinion për të shpjeguar që FARK-u nuk është ushtri tjetër e Kosovës, por është UÇK-ja me të gjitha gjinitë tjera ushtarake që ishin në formim e sipër, që ishin paraparë me Marrëveshjen që ishte lidhur në mes tij dhe përfaqësuesit e UÇK-së, por Bukoshi kurrsesi nuk lejoi që opininonit të gjerë t'ia shpjegojë marrëveshjen.

Mosmarrëveshjet u rritën edhe më shumë kur Brigada e dytë (Brigada 141) u bë gati të hyjë në Kosovë, atëherë kur rrezikoheshin territoret e kontrolluara nga UÇK-ja dhe sidomos Juniku. Brigada u pengua të futej në Kosovë dhe siç dihet pas dy javësh Juniku ra në duar të shkaut. Në këto kushte kur ishin bërë kontrata të sillen armatime të rënda dhe moderne nga jashtë, jo vetëm që ishte e pamundur të silllej në Shqipëri e pastaj në Kosovë, por as kallashët e municioni nga fshatrat e Shqipërisë nuk mund të siguroheshin nga Ministria, sepse emisarët e LPK-së dhe të LBDK-së që ishin futur në Ministrinë e Mbrojtjes e njoftonin SHIK-un dhe ende pa mbërritur armatimi i blerë në Tropojë, bllokohej rrugës, ndërsa pa fije mëshire burgoseshin individët përgjigjës dhe kështu Ministria e Mbrojtjes mbeti e bllokuar.

Pararoja staliniste e LPK-së, poashtu i bojkotuan Qendrat e stërvitjes dhe të rinjtë që vinin nga diaspora i grabitnin në Durrës dhe pa kurrfarë stërvitjesh dhe përgaditjesh të duhura dërgoheshin në Tropojë apo Kukës dhe me një kallash në shpinë, duke i lavdëruar se "shqiptari lindë i

mësuar për luftë", i futnin në Kosovë, ndërsa të rinjtë që vinin nga Kosova i lenin maleve të Tropojës të flenin pa mbulojë dhe shtrorë, me një copë bukë, dhe nuk i lejonin të shkonin të ushqeheshin në kuzhinat e dy Qendrave për Stërvitje të Ministrisë së Mbrojtjes, së paku të ushqehen e të flegjë si njerëz, në kushtet e një garnizoni ushtarak, dhe pas disa javësh u jepnin pak municion dhe nga një kallashnikov e i përcjellnin deri në kufi, ku siç dihet shumë herë kanë rënë në pritë të shkaut shumë të rinj, dhe sa dihet deri tash, askush nuk është marrë në përgjegjësi etj etj.

#### AHMET KRASNIQI NË MES TË PENGESAVE TË DYFISHTA

Një gjë duhet cekur se Ahmet Krasniqi ka pasur një pengesë të madhe nga Bukoshi, i cili ia zhagiste lëshimin e Vendimit, që ai është emëruar nga Qeveria Ministër i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës. Moslëshimi i Vendimit e pengonte Ahmetin për dy arsye: e para se nuk kishte mundësi t'i urdhëronte ushtarakët për mobilizim, dhe e dyta se ai nuk kishte mundësi të prezantohet si Ministër i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës në Ministrinë e Mbrojtjes së shteteve mike, apo të shteteve që ai kishte lidhje me kuadra të larta ushtarake, për të kërkuar armatime apo ndihma ushtarake, etj. Dhe kështu, Bukoshi e ka endur për dy muaj disa herë Ahmet Krasniqin nga Zvicra në Gjermani dhe më në fund ai u vra e vendimi nuk ju ka lëshuar fare.

Edhe një të vërtetë duhet ta dijë opinioni ynë: se në qerren e Ahmet Krasniqit është ngarkuar lloj-lloj plehu pa dijen dhe pëlqimin e tij. Dua ta cek një fakt që dëshmon se Ahmet Krasniqi nuk ka ditur se kah po i vijnë komplotet më të mëdha e më të rrezikshme, e kah më të voglat dhe më pak të rrezikshmet. Kur në opinion pat dalë komunikata e Shtabit Operativ të Rrafshit të Dugagjinit se nuk e "njohim Adem Demaçin si zëdhënës të UÇK-se", dhe as "Rexhep Qosjen që është një udhëheqës i dështuar...", por njohin vetëm "institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës...", Ahmet Krasniqi ka qenë aq i nervozuar dhe i tendosur, që i është thyer urdhëri i Tij dhe Rregullorja ushtarake se "UÇK-ja është e depolitizuar", dhe si e tillë askujt nuk i lejohet propagandë partiako-ideologjike, edhe pse ai luftën më të madhe e ka bërë me partiakët e shtrirë dhe karrieristët e sëmurë për pushtet e pozita, për domosdoshmërinë e njohjes së institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës. Unë që Ahmet Krasniqin e njoh mirë që nga viti 1968, nuk e kam parë kurrë më të nervozuar se atë ditë. Për këtë mund të dëshmojnë edhe anëtarët tjerë të Redaksisë së "Revistës Ushtarake" anëtar i së cilës isha edhe unë për tre

muaj. Opinioni ynë pas një motmoti të vrasjes së Ahmet Krasniqit i ka të qarta shumë gjëra për vrasjen e tij.

## OPINIONI YNË DO TË KËRKOJË ZBULIMIN E KRIMINELËVE

Ministri i Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, zotëri Jonuz Tërstena, në një deklaratë që e pati dhënë në një tubim të mbajtur në Vjenë kah fundi i qershorit të këtij viti e bëri të qartë vrasjen e Ahmet Krasniqit kur tha: "Ne e dimë saktësisht se kush e ka vrarë kolonel Ahmet Krasniqin. Ne i kemi ofruar Prokurorisë së Tiranës të gjitha të dhënat e sakta për personat që kanë gishtë në këtë vrasje, por kjo Prokurori ka pezulluar hetimet rreth kësaj vrasjeje. Dhe ne e dimë pse janë pezulluar këto hetime, sepse prapa këtij akti terrorist fshihet një klan i madh politik shqiptar në Shqipëri dhe në Kosovë".

Këto të dhëna të zotëri Jonuz Tërrensrenës i ka vërtetuar edhe gazetari i njohur Christ Hedges me shkrimin e tij të botuar në "New York Times" kah fundi i muajit qershor, ku për vrasjen e Ahmet Krasniqit e akuzon H.Thaçin dhe autoritetet e Shqipërisë.

Opinioni ynë, në bazë të këtyre të dhënave, ka për obligim të ngrejë çështjen e zbulimit jo vetëm të dorasve, por edhe të të gjithë atyre që fshihen pas këtij krimi, kur dihet se kemi të bëjmë me informata që i kanë dhënë njerëzit kompetentë, siç është zotëri Tërstena dhe zotëri Hedges, që i pari i përfaqëson Organet e Ndjekjes Penale të Republikës së Kosovës, ndërsa i dyti, përpos që ka informata të mbledhura në terren, ka në disponim edhe informatat e CIA-s (Shërbimi Sekret Amerikan). Ministria e Brendshme e ka kryer punën e saj me ndërgjegje të plotë dhe në mënyrë profesionale. Pse Organet e Drejtësisë së Shqipërisë nuk don ta kryejnë detyrën që u takon, sipas rregullave ndërkombëtare, sepse në teritorin e tyre është bërë krimi, është plotësisht e kuptueshme, kur dihet se në atë krim janë të përzier edhe shumë persona që mbajnë poste kyçe në institucione shtetërore të Shqipërisë. Duhet shpresuar se organet kompetente të Shtetit të Kosovës, që do të dalin pas zgjedhjeve të lira, do t'i marin parasysh të gjitha dëshmitë e dokumentuara, do të gjejnë edhe dëshmi tjera, dhe do t'ua japin hakun të gjithë atyre që janë të përzirë në krime. Po të ndodhë që kriminelët të zënë vende udhëheqëse në Organet e Shtetit të Kosovës, jo vetëm që nuk do të zbulohen krimet e bëra, por ato do të bëhen të përditshme- siç u bënë të përditshme sot e gjithë ditën në Shqipëri.



Unë që kam pasur rastin t'i vëzhgoj për së afërmi shumë ngjarje e komplete që zhvilloheshin kundër Ahmet Krasniqit, qëkur u zgjodh Ministër i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, e kam për obligim që të dëshmojë para Organeve Hetimore të Republikës së Kosovës po qe se më ftojnë si dëshmitar, shumë gjëra kam për t'i sqaruar. Dëshmitari i dytë duhet të jetë Adem Demaçi, i cili do të shpjegojë në hollësi pse u shkel Marrëveshja dhe kush bëri tradhti. Edhe një gjë e ka borxh Demaçi opinionit t'ia shpjegojë: Qysh u bë të sëmuret dy ditë para se të pushkatohet Ahmet Krasniqi?! Dhe a thua aq i sëmurë ishte sa të mos i shkruajë dy-tri fjalë, që të kundërshtonte dhe të protestonte, që të mos bëhen atentate politike as në Prishtinë dhe as në Tiranë. Por, po e zëmë se Demaçi ishte i sëmurë shumë, dhe nuk kishte mundësi as të hapi gojën, as të mbaj lapsin në dorë, por pasi u shërua, pse vallë për atentatet e bëra në Tiranë fare s'u dëgjua?! Dëshmitari i tretë, Hydajet Hyseni duhet të jetë, ndërsa Qosja pas tij dëshmitar i katërt vjen, të cilët të dytë janë kreatorë të të gjitha të zezave që e gjetën Kosovën.

Pasi Nanosi është mësuesi i tyre (i Qosjes dhe i Hysenit) dhe patroni që urdhëron, duhet edhe ai dëshmitar së bashku me Klosin e Mejdanin në Gjyqin e Kosovës së Lirë, të vërteten (me hatër apo me zor) ta dëshmojnë.

Sa i përket pararojës staliniste të LPK-së, ata janë të përzier me kokë e duar, jo vetëm në këtë krim, por edhe në shumë krime tjera, sa që numri i tyre do ta kalonte me siguri numrin treshifror. Ndërsa Bardhyl Mahmutinatën e krimit që u bë në Tiranë-, ishte në një tubim në Suedi. Ai ishte përbe në fjalën e partisë se do t'u japin dënimin e merituar "tradhtarëve" që po e dëmtojnë interesin e LPK-së dhe të LBDK-së. Edhe shumë individ që punonin në Ministrin e Mbrojtjes të dërguar me emisione speciale, duhet të jenë dëshmitarë, dhe me siguri një numër prej tyre kanë marrë pjesë në krim. Dhe pas gjithë këtyre të vërtetave të zbuluara nga Ministri i Brendshëm i Republikës së Kosovës zotëri Tërstena, nga analisti dhe gazetari i njohur zotëri Christ Hedges, si dhe këto të vërteta që i kam qitur në dritë unë, do të jenë të mjaftueshme për gjykatësin hetues për t'i gjetur kriminelët e vegjël dhe kriminelët e mëdhenj, për t'i gjetur kriminelët që kanë marrë pjesë në përgatitjen e krimit, kriminelë që kanë dhënë urdhër të bëhet krimi, kriminelët doras, dhe kriminelët që kanë ditur saktësisht se po përgatitet krimi dhe nuk kanë bërë asgjë për ta penguar atë.

Dhe pas gjithë këtyre të vërtetave që kanë dalur në shesh, nuk është vështirë për t'u bindur se Ahmet Krasniqi u vra, sepse po të lejohej të vepronte sipas planeve ushtarake dhe synimeve të tija nacionaliste, do të bëhej pastaj pengesë e fortë dhe e pakalueshme për realizimin e planeve të Qendres antishqiptare serbo-ruso-greke, për zgjedhjen e çështjes kombëtare shqiptare siç ua donin interesat e tyre, edhe pse ata i kishin futur njerëzit e tyre në vende udhëheqëse në Shqipëri. Edhe karrieristët e sëmurë për pushtet të LPK-së dhe të LBDK-së e shihnin Ahmet Krasniqin dhe Ministrinë e Mbrojtjes pengesen e vetme, që do t'ua prishnin planet për ta vënë në veprim një variant të "revolucionit të vonuar demokratik" të Shqipërisë në Kosovë, për ta marrë pushtetin sipas modelit të social-komunistve të Shqipërisë. Ahmet Krasniqi pra u vra se ishte i vendosur për t'i çarë të gjitha bllokat, për t'i shkatërruar të gjitha planet antishqiptare, për t'i penguar të gjitha komplotet që thureshin kundër UÇK-së. Ai i njihte dhe i respektonte institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës dhe bënte çmos për ta institucionalizuar dhe për ta depolitizuar UÇK-në. Ai bëri përpjekje të mëdha për ta kthyer atë nga një ushtri partiake që ishte e paorganizuar dhe e paarmatosur si duhet, në një ushtri të rregullt të Republikës së Kosovës, e armatosur me armatime bashkëkohore dhe e udhëhequr nga ushtarakë të zot, që kishin dije dhe përvojë të lartë nga shkencat e artit ushtarak.

Duhet shpresuar se Ahmet Krasniqi dhe shumë të tjerë që u vranë me urdhërin e armiqve tanë nëpërmjet veglave të tyre, që bashkëpunojnë edhe me dreqin e mallkuar për të zënë pushtet, nuk do të shkojnë gjakhumbur, dhe se drejtësia shqiptare kriminelëve do t'ua japë hakun e merituar, ndërsa i Madhi Zot edhe më rëndë do t'i dënojë.

*Botuar: "Bota sot" 21-24 shtator 1999*

*PS. Ky shkrim është botuar në katërt vazhdimë. Vazhdimi i fundit nuk është botuar në tërësi, si duket për ta kursyer Demaçin nga kritikën e mia. Ky është shkrimi i plotë që i është dërguar Redaksissë së "Botës sot" për botim.*

## PARA GJYQIT TË DREJTËSISË DO TË DALIN JO VETËM DORASI, POR EDHE URDHËRUESIT E ATENTATIT NDAJ AHMET KRASNIQIT

Dihet se rastet i takojnë njerëzit për t'u bërë shokë dhe miq të mirë e të pandashëm për të kryer punë të mbara, por edhe për t'u bërë armiq. Njohja me Avdyl Lahun më bëri ta njoh Adem Demaçin. Njohja me Demaçin më bëri të njoh një plejadë atdhetarësh që kohën më të bukur të jetës ia kushtuan Kosovës dhe lirisë së shqiptarëve. Njohja me Sabri Novosellën më bëri ta njoh Metush Krasniqin, atdhetarin nacionalist dhe udhëheqësin e shquar të Lëvizjes tonë kombëtare, ndërsa njohja me familjen e Aziz Zhilivodës më bëri të njihem me Ahmet Krasniqin.

Ishte viti 1967 kur u ktheva në shtëpi nga vuajtja e dënimit nga burgu famëkeq i Goli Otokut. Siç është zakon tek ne shqiptarët, pas vuajtjes së dënimit në familjen time vinin të më vizitonin burra të shtyrë në moshë, miq e dashamirë të familjes por edhe kryefamiljarë që nuk i njihja nga fshatrat për rreth Strocit. Prej të gjithë vizitave që më patë bërë përshtypje, dhe që ende e kam të freskët në kujtesë, është vizita e djemve të Aziz Zhilivodës me kusherinj. Më tepër se dhjetë burra patën ardhur të më nderojnë për përpjekjet e mia të vogla e simbolike, që ia bëra një argat shqiptarisë. Që nga ajo ditë, dy familje: Familja e Qerim Jasharit nga Stroci dhe Familja e Aziz Zhilivodës nga Zhilivoda u afruan me njëra-tjetrën dhe krijuan në mes tyre një miqësi dhe shoqëri të fortë dhe të singertë.

Shkonim dhe vinim me djemtë e Aziz Zhilivodës dhe me Qerim dhe Qerkin Krasniqin, kushërinjtë më të afërt të Aziz Zhilivodës. Ishte vjeshta e vitit 1997 kur për herë të parë isha mysafir i djemve të Aziz Zhilivodës, që edhe më parë i njihja.

Atë natë u njoha me Ahmetin, nipin e Azizit, i cili ishte nxënës i Shkollës së Mesme Teknike në Prishtinë. Shërbente në odë pa iu dëgjuar zëri, se ashtu e donte zakoni i odës. Të bënte përshtypje qetësia e tij shpirtërore, që i përngjante një plaku të mençur e të zgjuar që kishte një përvojë të gjatë jetësore. Viti shkollor 1968/69 ishte viti që krijoi mes meje dhe Ahmetit një shoqëri të singertë dhe respekt të ndërsjelltë. Thjesht u bëmë shokë të idealit. Shpesh takoheshim dhe bisedonim për

çështje aktuale në dyqanin e Sabri Novosellës, që ishte vendtakim për shumë ish të burgosur politik nga mbarë Kosova, apo takoheshim në banesën e Metush Krasniqit në Prishtinë, i cili punonte në administratën e Shkollës Teknike në Prishtinë, si referent për çështje të nxënësve. Demonstratat e vitit 1968, dhe përkujtimin e tyre i përjetuam së bashku me Ahmetin nëpër rrugët kryesore të Prishtinës dhe në Varrezat e Qytetit, ku patëm vënë kurora lulesh mbi varrin e dëshmorit Murat Mehmetit.

Në përcaktimin e Ahmet Krasniqit për të studjuar artin ushtarak, përpos familjes, ndikoi në veçanti Metush Krasniqi, i cili kishte bindje të thellë se Ahmeti me zgjuarsinë, seriozitetin, pjekurinë dhe origjinën familjare që e kishte, do të bëhet një oficer i aftë dhe i besueshëm për çështje të rëndësishme ushtarake, që do t'i duhej Lëvizjes tonë për çlirim dhe bashkim kombëtar. Regjistrimi i Ahmet Krasniqit në Akademinë ushtarake nuk do të bëhej kurrë, po të mos ndodhnin ndryshime të rëndësishme në Jugosllavi, kur klani i Titos fitoi mbi klanin e Rankoviçit në Plenumin e Brioneve më 1996. Metush Krasniqi ishte njëri ndër intelektualët dhe udhëheqësit më largpamës të Lëvizjes sonë kombëtare për çlirim dhe bashkim kombëtar. Ai kërkonte nga veprimtarët e çështjes kombëtare dhe intelektualët që t'i shfrytëzonin të gjitha situatat e volitshme politike për aftësimin e kuadrove të domosdoshme, që i duhen Lëvizjes nga radhët e familjeve të dëshmuara për atdhedashuri, si dhe kërkonte që ata kuadro të futën në vende të rëndësishme të aparatit shtetëror, për t'i njohur sa më mirë dobësitë e atij sistemi, që në momentet e volitshme kur shqiptarëve "ju vjen shteku" t'i presin prangat e robërisë me humbje sa më të vogla. Ahmet Krasniqi në rrethanat e volitshme që u krijuan arrijti të regjistrohet dhe ta kryej me kohë Akademinë Ushtarake- Gjinia e Këmbësorisë në Beograd. Ahmet Krasniqi gjatë kohe sa ishte kadet, pushimet verore dhe ato dimërore i kryente në Zhilivodë në familjen e tij, por nuk ka ndodhur asnjëherë që të mos kthehet sëpaku një orë te unë.

Më mungon koha të mirrem me shkrimin e kujtimeve, por shokut tim Ahmet Krasniqit ia kami borxh unë, shokët e tij të fëmijnisë dhe të shkollimit, bashkëveprimtarët dhe ushtarët e tij që e kryen shërbimin ushtarak me uniformat e ushtres së okupatorit, dhe ushtarët dhe ushtarakët që e kryen shërbimin ushtarak me uniformat e UÇK-ës, që t'i shkruajmë dhe mundësisht t'i dërgojnë për botim në gazetën kombëtare "Bota sot", me qëllim që të hudhen poshtë me fakte shpifjet dhe

gënjeshttrat e argatëve të serbit dhe grekut, të shqipfolësve kokëkrisur, të cilët u munduan ta njollosin Ahmetin jo vetëm sa ishte gjallë, kur bënte përpjekje të jashtëzakonshme për bashkimin e faktorit ushtarak dhe politik të Kosovës, për institucionalizimin e UÇK-së, për forcimin e saj me kuadro dhe armatime të nevojshme dhe për ta bërë atë ushtri të vërtetë kombëtare, por edhe pas vrasjes së tij mizore, që u bë nga një dorë e shitur kriminel (por urdhëri për ekzekutim u bë nga një Qendër antishqiptare e krijuar bashkarisht nga Serbia, Greqia, Rusia, dhe rrogtarë e spiunë të tyre, që i kanë gjetur në subjektet shtetërore dhe partiake të Shqipërisë dhe në strukturat partiake të partive apo organizatave të shqiptarëve të Kosovës).

Ishte vera e vitit 1973, koha e pushimeve verore. Me rrogën e mësuesit të gjuhës shqipe nuk kisha mundësi t'i kryeja pushimet askund tjetër përpos se në vendlindjen time në katundin Strofc. Bënte vapë, por hija e një arre në oborrin tim më sjellte freski dhe pushim të këndshëm. Knaqësinë time ma shtoi pa pritë e pa kujtuar Ahmet Krasniqi i cili hyri në oborrin e shtëpis time i veshur me uniformën ushtarake. Si të duket-më tha?: "Nipi i Aziz Zhilivodës me uniformen ushtarake të ushtrisë së okupatorit"! Të paskan shumë hije Ahmet! - i thash, por uniforma e ushtrisë shqiptare do të ketë edhe me tepër hije. Folëm gjanë e gjatë për shumë çështje.

Muzgu i mbrëmjes na zëri nën hijen e arrës pa e hetuar kohën që iku aq shpejt. Edhe pse darka ishte bërë gati, Ahmeti nuk ndejti të darkojë se e kishin paralajmëruar se do të kishte mysafirë. E përcolla shokun tim deri te Dardha e Migjës Amrush. Ai me hapa të shpejtuar mësyu Zhilivodën që nuk kishte më tepër se 15 minuta rrugë këmbë, ndërsa unë u zhdjerga teposhtë për në shtëpi, i gëzuar shumë që Ahmeti arriti ta kryejë njërën nga detyrat e para, që ishte zotuar se do ta kryente. Deri vonë nuk më zuri gjumi atë natë. Ahmeti më rrinte para sysh me gradat e ushtrisë jugosllave. I paramendoja pengesat psikike që do t'i ketë Ahmeti tek bashkëvendasit dhe në fshatin e lindjes në Zhilivodë. Si do të sillen ndaj tij injorantët dhe "patriotët romantikë", ata të cilët nuk shohin më larg se hundën e tyre, ata të cilët nuk dinë të mendojnë dhe as të gjykojnë? Por mendimi se familja e tij, Metush Krasniqi, Sabri Novosella dhe unë që i kishim dhënë zemër të regjistrohet në akademinë ushtarake, që e kishim përkrahur moralisht për t'i kryer studimet, dhe e kishim udhëzuar që të mos bjerë në kurthat e njerëzve të ligj, ishte një gëzim i

madh, se ishim të bindur se një ditë ushtaraku Ahmet Krasniqi dhe shumë djelmosha tjerë, që do ta ndjekin rrugën e tij, do t'i dalin zot Kosovës me dijet dhe përvojën ushtarake që do t'i fitonin në akademitë dhe garnizonet e okupatorit tonë.

Pas një viti, përafërsisht në të njëjtën kohë, Ahmeti hyri në oborrin tim. Nuk e kishte veshur uniformën ushtarake. Kam ardhur me punë Shefqet-më tha. Mirë se të ka pru Zoti, Ahmet, " nuk ka shtëpi pa derë" thotë një fjalë e urtë popullore, i thashë. Kërkova të më tregojë se ku e ka hallin dhe çka e mundon. Kam një hall Shefqet. E kam vështirë ta vendos vet. Kërkoj ndihmën tënde, por do t'i pyes edhe Bacin Metush dhe Sabriun. Ju do të më ndihmoni për ta zgjidhur problemin, që po më mundon tepër shumë. M'i tregoi planet që i ka për vazhdimin e studimeve në laminë e artit ushtarak. Nuk kisha çka të kundërshtoja. Çdo gjë ishte në rregull dhe më gëzonte pa masë që kishte një vullnet aq të fortë për të arritur kulmin e dijeve në artin ushtarak. " Po, i thashë, plane të mira dhe qëllime të mrekullueshme. " A ka qëllime më të larta se kur njeriu me tërë qenien e tij i kushtohet aftësisimit të tij profesional me të vetmin qëllim, që një ditë ato njohuri dhe dije t'i vejë në shërbim të atdheut dhe vendlindjes së tij, që e rriti dhe e edukoi, që ia mësoi gjuhën, zakonet, që ia dha pjekurinë dhe burrërinë.

Po u kujtua pak dhe më tha: "Por për t'i arritur të gjitha këto që t'i thashë po më dalin ca pengesa të natyrës objektive por edhe subjektive. Prejardhja e familjes time po më qet pengesa edhe në punët e përditshme pasi që "KOSI" po më përcjell këmba- këmbës, e lere më të më lejojë të vazhdoj studimet e mëtutjeshme. Arma e vetme që mund ta përdor dhe që do t'i amortizonte pengesat e do të hapi perspektivën për t'i vazhduar studimet do të ishte martesë ime e përshpejtuar".

I ndërhyra në bisedë.- Po çfarë pengese paraqet martesë kur atë mund ta bësh shpejt dhe mirë pa e pritur as dimrin.- Lem ta kryej- më tha. Po qe se e marr një vajzë shqiptare për t'i ndarë gëzimet dhe hidhërimet e jetës, për të krijuar ardhmërinë tonë të përbashkët, të gjitha planet që t'i tregova do të bien në ujë. Dyert e studimeve të larta do të më mbyllën. Aftësitë e mia ushtarake do të mbeten të mangëta. Qëllimet do të mbeten të parealizuar. Të marr për grua një vajzë nga radha e kombit që na krijoj aq shumë vuajtje dhe aq shumë dhimbje, nuk ma thotë zemra, edhe pse një martesë e tillë do t'i amortizonte pengesat dhe vështirësitë që i ceka.

Jam në një luftë të thellë shpirtërore. Se a do të fitojë arsyeja apo do të fitojnë ndjenjat varet shumë prej teje, Bacit Metush dhe Sabriut. Pres ndihmën e juaj. Si të përgjigjem? Sekondat u bënë minuta, minutat u bënë orë, derisa m'u zgjidh gjuha për t'ia dhënë mendimin shokut tim, i cili kishte një biografi të bardhë pa asnjë njollë. Për ta dhënë një mendim të arsyeshëm duhet gjërat të peshohen mirë dhe drejt. Pengesat dhe synimet e Ahmetit i ndava në dy boshçe.

Vuajtjet e Ahmetit, të familjes së tij dhe mbarë popullit shqiptarë, të shkaktuara nga serbo-sllavët i vuara në boshçen e parë. Në boshçën e dytë i vuara planet e Ahmetit, të shokëve të tij dhe të Lëvizjes për çlirim dhe bashkim kombëtar. Boshçja e dytë peshoi më rëndë në peshojen e arsyes. Po sikur t'i kisha bërë matjet e boshçeve me peshojen e ndjenjave me siguri do të rëndonte më tepër boshçja e parë, ajo që do të pengonte Ahmetin të vazhdonte rrugën e nisur. Dëgjo Ahmet! Unë po të them se çka kisha për të vepruar unë po të isha në vendin tënd. Rrugën e filluar nuk do ta ndërpreja, prandaj edhe ti Rrugën që e ke filluar për hir të idealeve të larta, për të cilat edhe ke shkuar në Akademinë ushtarake ta studjosh artin ushtarak, nuk bën ta lësh për gjysmë... Kaloi të gjitha pengesat me arsye dhe zgjuarsi. Lojën e arkëtimit në shoqëri me kolegët jugosllavë vazhdoje pa ngurim. Kosova do të ketë nevojë për dijen dhe përvojën tënde ushtarake dhe për dijen e shumë ushtarakëve tjerë që do të ndjekin rrugën tënde.

Bëj përpjekje ta gjesh një vajzë pa ngarkesa shoviniste, që të don me shpirt.

Interesi kombëtar të ka drejtuar të futesh shtigjeve të panjohura të një rruge me zikzake dhe pengesa të llojllojshme. Kam besim se ke forca shpirtërore dhe morale t'i tejkalosh edhe pengesat psikologjike, dhe shpirtërore, për hir të interesave madhore kombëtare. Ahmeti më dëgjonte me vëmendje të jashtëzakonshme, por nuk i mohoi dhe as nuk i pohoi me asnjë fjalë mendimet e mia. Nuk e zgjati ndejën dhe lypi izën me arsyetimin se do të shkonte në Prishtinë. E përcolla shokun tim deri te "Roga e Sanës", aty ku rruga këmbësore e çonte për Hamidije, Plemetin dhe Obiliq, aty ku duhej ta merrte autobusin për Prishtinë...

## FORMIMI I MINISTRISË SË MBROJTJES NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS SHKONTE NË KUNDËRSHTIM ME PLANET STRATEGJIKE DHE TAKTIKE TË SERBISË QË KISHTE PËR KOSOVËN.

Nëntori i vitit 1979 na shpërndau dhe na bëri pikë e pesë. Atëherë kur unë dhe disa celula të Organizatës ramë në burg, Jusuf Gërvalla dhe Sabri Novosella u detyruan të marrin rrugën e kurbetit, ndërsa Metush Krasniqi e vazhdoi edhe më tutje aktivitetin ilegal në Kosovë. Siç kam mësuar më vonë, ai kishte bërë përpjekje për t'i bashkuar organizatat dhe grupet ilegale, që vepronin atëherë, për ta mbajtur të ndezur zjarrin e rezistencës tonë kombëtare, ndërsa Ahmet Krasniqi që ishte i lidhur drejtpërdrejt me Metush Krasniqin në organizatën e LNÇKVSHJ-së kishte detyra speciale në aspektin ushtarak, që përpos Metush Krasniqit askush nuk ka mundur t'i dinte nga Udhëheqja e ngushtë e Organizatës...

Ishte vjeshta e vitit 1996. Binte shi i rreptë. Mbrëmje e mërzitshme, kur gjendesh larg vendlindjes dhe njerëzve që të duan dhe i do. Si të ndihesh mirë kur je larg familjes, je jashtë atdheut, i cili e pret ndihmën tënde dhe ndihmën e çdo shqiptari, për të mos e lënë të pa mbrojtur, për të mos e lënë në atë gjendje, që donte ta poshtronte këmba e huaj mizore. Krisma e telefonit më shkëputi nga leximi i një libri që më jepte njohuri për jetën e amshueshme. U lajmërua Sefedin Krasniqi. Pas bisedave të zakonshme që ishin edhe më të shkurta se zakonisht më tha: Don të bisedojë me ty një shok yti. U lajmërua një zë i njohur pa u prezentuar se kush ishte. Shefqet si je? Një sekondë mjaftoi për ta deshifruar se kush ishte. I thash: Ahmet ti je?! Po ku je or Burr i Dheut, se menjëher po vij të të takoj. Nuk e zgjatëm bisedën dhe u muarëm vesh me Sefën që ai të vinte me Ahmetin te unë në La Chaux-de Fonds, në një qytet të bukur të Zvicrës Romandë. Edhe pse ardhja e tyre nuk vonoi më tepër se një orë e gjysmë, mua m'u duk se pritja ishte tepër e gjatë. Kishim qenë përmalluar shumë për njëri tjetrin. Sefa dhe familja ime e kuptuan dëshirën tonë që kohën që e kishim në dispozicion të mos e ndajmë me ta. Tri orë bisedë në katër sy kaluan sa çel e mshel sytë. Shumë biseda mbetën të pakryera. U trajtuan shumë çështje aktuale. Po më prekset ishin evokimet e kujtimeve për shokët që na lanë dhe shkuan në botën e amshueshme me sy çelur për ta parë Kosovën dhe viset tjera shqiptare të çliruara dhe të bashkuara me Nënë Shqipëri. I shprehëm ngushëllime njëri tjetrit për Metush Krasniqin dhe Jusuf Gërvallën. Më



foli edhe për takimin e fundit që e kishte pasur me Metushin në Zagreb më 1986. Nuk kishte kohë më tepër të rrinte për t'i kryer bisedat e nisura, për t'i trajtuar çështjet për të cilat kishte biseduar me Bujar Bukoshin me Xhafer Shatrin e me njerëz tjerë. E përcolla shokun tim të vjetër, që aq shumë ishte plakur. Po si të mos plakët shoku im, jeta e të cilit "në liri" ishte shumë më e vështirë se e të burgosurit në burgjet serbe. A jetohet tërë jetën duke aktruar në shoqëri me katilët e popullit tënd. Sa vështirë e pati shoku im të ushtrojë profesionin e ushtarakut në ushtrinë e huaj, në armatën e okupatorit, jashë Kosovës, larg familjes. Vetëm ideali i lartë se një ditë do të ketë nevojë ajo gjysmë Shqipërie e robëruar dhe e copëtuar nga kasapët serbo-sllavo-grekë për dijen dhe aftësitë e tija ushtarake, bëri që të mos i ligshtohet zemra, bëri që të mos i dobësohet arsyeja. Ai dhe shumë ushtarakë tjerë ishin të vëzhguar dhe të përcjellë këmba-këmbës nga Sigurimi ushtarak i Armatës Jugosllave. Edhe gjesti më i vogël i oficerëve shqiptarë, që tregonte se ata nuk janë "projugosllavë", jo vetëm që do t'i largonte nga ushtrimi i profesionit të ushtarakut, por edhe do të denoheshin me burgje të gjata...

Ishte marsi i vitit 1998 kur situata politike në Kosovë ishte e tendosur. Serbia, Greqia dhe aleatët e tyre përgaditeshin për të na e dhënë grushtin e fundit, që shqiptarët kurrë më të mos ngrihen në këmb, por të mbeten argat e skllëvër dhe lëndë ndërtimi për kombet e tyre. Shqiptarët as për së afërmi nuk ishin bërë gati për një ndeshje, që ishte vendimtare për ardhmërinë e tyre. Armiqtë tanë i kishin skenarët, planet dhe ushtritë e tyre të gatshme që të na sulmojnë. Vetëm pritej shkak. Grupet e armatosura ilegale që i udhëhiqnin Adem e Hamzë Jashari, Zahir Pajaziti e Salih Çeku vepronin në kushte dhe rrethana jashtëzakonisht të vështira, pa armatime të nevojshme dhe ishte e pamundur që ato grupe guerile ta mbajnë luftën frontale me shkaun, ndërsa argatët dhe nxënësit e Nanoisit punonin me hapa të shpejtuar për ta këthyer luftën guerile, që bëhej në Kosovë kundër forcave serbe, në luftë frontale, mu ashtu siç i shkonte për shtati (konvenonte) Serbisë. Duhej të bëhet një riorganizim i shpejtuar dhe një përgatitje e përsheptuar, për t'i qitur në ujë planet dhe skenaret e armiqve tanë. Qeveria e Kosovës edhe pse ishte vonuar shumë dha shenja se do të bëjë ç'është e mundur për të krijuar strukturën organizative që do të merrej me çështje të mbrojtjes së Kosovës. Ushtarakët e Kosovës të cilët gjendeshin në diasporë, treguan gadishmërinë e tyre për ta kryer

punën që u takon, qysh kur armiqtë tanë më 1997 e kallën Shqipërinë, dhe në strukturat shtetërore të saj i vunë vasalët dhe spiunët e tyre.

Formimi i Ministrisë së Mbrojtjes nga Qeveria e Republikës së Kosovës, shkonte në kundërshtim me planet strategjike dhe taktike të Serbisë për Kosovën. Armiqtë tanë e panë të nevojshme për ta prishur dhe penguar çdo nismë të mirë të shqiptarëve, çdo organizim që do t'i pengonte planet dhe skenarët e tyre. Tani, pasi në krye të Shqipërisë e kishin Nanosin, ishte një lehtësim dhe ndihmesë e madhe për ta. Nanosi nuk e kishte vështirë t'ua bënte shërbimet e duhura si grekve ashtu edhe serbëve. Sigurimi i Shqipërisë i kishte njerëzit e tij në të gjitha subjektet politike të Republikës së Kosovës, por edhe në LPK-në, Organizatën staliniste që vepronte në diasporë. Të gjithë sigurimcat e Sigurimit Shtetëror të Shqipërisë morën detyra konkrete nga njerëzit e Nanosit. Njëra ndër detyrat më me rëndësi të spiunëve të grekut dhe serbit, që vepronin në SHIK-un e Shqipërisë e që ishin nën urdhërin e Nanosit, ishte që të mos lejohet formimi i një ushtrie të mirëfilltë të Republikës së Kosovës. Për të arritur ato qëllime, duhej të mirrej udhëheqja e njësive guerile, e cila gjatë tetë vjetëve të veprimtarisë së saj kreu aksione që u shkonin për shtati vetëm interesave kombëtare të shqiptarëve. Siç dihet, me përkrahjen e Nanosit dhe SHIK-ut të Shqipërisë, stalinistët e Kosovës e morën udhëheqjen e njësive guerile që vepronin në Kosovë. Komandantët e parë të tyre ose u qitën në kurtha për t'i vlarë shkau, ose u eliminuan me mjete perfide.

Formimi i Pjesës së SHP të FARK-ut në Tiranë nga Ahmet Krasniqi në prill-maj të 1998, që pasoi pas arritjes së Marrëveshjes për bashkimin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe UÇK-ës në mes Ahmet Krasniqit dhe Adem Demaçit në Oslo të Norvegjisë, ishte një fitore e rëndësishme e shqiptarëve, por fatkeqësisht, nuk pati jetë të gjatë, pasi që Nanosi nuk lejoi të jetësohet dhe kështu ai, nëpërmjet argatëve të tij dhe "pionerëve të Enverit", që i kishte në krye të ca subjekteve politike të Republikës së Kosovës, në diasporë dhe në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, penguan me të gjitha mënyrat Ahmet Krasniqin në synimet e tija për ta formuar një ushtri kombëtare, penguan forcimin dhe institucionalizimin e UÇK-së, për të cilën Ahmet Krasniqi punoi aq shumë, duke u munduar t'i bindte shumë personalitete me ndikim se vetëm me bashkimin e shqiptarëve në baza

kombëtare dhe me bashkimin e faktorit ushtarak dhe politik të Kosovës mund të arrihet çlirimi i Kosovës.

Nanosi e Klosi me argatët e tyre dhe "pionerët e Enverit" kur e panë se Ahmet Krasniqi ky, Burrë i Madh i Kosovës, i cili, edhe pse në kushte tejet të vështira, mu para hundëve të spiunëve të grekut dhe shkaut që vepronin të lirë në Tiranë, po ua prishte shumë planet atyre që i thurnin kundër shqiptarëve dhe shqiptarisë,- e vranë në Tiranë dhe ua bënë me dije nacionalistëve shqiptarë se Dushani dhe Milladini janë të gjallë në Shqipëri.

Pushkatimi i Ahmet Krasniqit, në mënyrën dhe në rrethanat si u krye, duhet t'i bindte shqiptarët nacionalistë se farën e keqe, që e mbollën të huajt në truallin shqiptar, nuk do të thahet prej vetvetiut, por varet prej tyre a do të rritet dhe forcohet, apo do të zhduket dhe thahet një herë e përgjithmonë.

VETËM PENA E SHKRIMTARIT TË MIRË DO TË MUNDË TA SHKRUANTE REALISHT E BUKUR DRAMËN SHPIRTËRORE TË AHMET KRASNIQIT

Është fatkeqësi që nuk kamë mundësi dhe aftësi t'i vëj në letë me mjete artistike përjetimet shpirtërore të Ahmet Krasniqit, kur arrinte suksese, siç ishte Marrëveshja me Adem Demaçin, për bashkimin në një komandë komanduese të Ministrisë dhe UÇK-së, apo nënshkrimi i Marrëveshtës për blerjen e armatimit të rëndë nga një shtet mik, futja e brigadave të para në Kosovë nën komandën e ushtarakut madhor Tahir Zemës, dhe sukseset ushtarake të këtij në Betejën e Logjës dhe beteja tjera, dërgimi i një grup ushtarakësh në Bosnje për kryerjen e një kursi të përshpejtuar për aftësimin e tyre për t'i udhëhequr dhe komanduar brigadat që ishin në formim e sipër. Vetëm pena e shkrimtarit të mirë do të mundte arrinte ta shkruante realisht e bukur dramën shpirtërore të Ahmet Krasniqit, kur spiunët e grekut dhe shkaut dhe argatët e Nanoisit i sjellnin pengesa dhe mossuksese Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ahmet Krasniqit, kur masakrohej popullsia e pambrojtur e Kosovës nga ushtria e Serbisë, kur i vritej ushtari apo ushtaraku në frontin e luftës me shkaun. Edhe sot nuk më hiqet nga mendja ajo skena trishtuese e një lufte të brendshme që luhej në shpirtin dhe trupin e Ahmet Krasniqit, i cili përpëlitej tërë natën pa shtënë gjumë në sy . Me netë të tëra mbeti pa gjum (në banesën që banonim bashk unë, Ahmeti Krasniqi, Hilmi Nebihu dhe Naim Muja), kur Tahir Zemës nuk pati kurrfarë mundësie Ministria e

Mbrojtjes t'ia dërgonte armatimin e planifikuar, pasi që e penguan argatët e Nanosit, të cilët nuk donin të ketë suksese ushtarake Ministria e Mbrojtjes, nga friga se me forcimin e Ministrisë, ata nuk do ta kenë pushtetin mbi shqiptarë të Kosovës.

Për këto ngjarje, dhe ngjarje tjera, mund të shkruhen drama e romane me personalitete dhe ngjarje reale, që për shpirtin e lexuesit me zemër të bardhë, dhe shpirt të pastër do të ishin tronditëse, kur do të kuptonin se deri ku mund të shkojë marrëzia e karrieristëve të sëmurë për pushtet dhe të partiakëve të shtirë, të cilët, për hirë të interesa të tyre personale, grupe, klanore dhe partiake, penguan çdo punë të mirë të shqiptarëve, penguan forcimin e UÇK-së dhe institucionalizimin e saj, nuk lejuan bashkimin e faktorit ushtarak dhe politik të Kosovës dhe më në fund arritën kulmin e poshtërsive kur e vranë Ministrin e Mbrojtjes, Kolonel Ahmet Krasniqin, atë Burrë të Madh të shqiptarisë, i cili bënte pjesë ndër njerëzit më me rëndësi në organizatën LNÇKVSHJ, i cili kishte mar detyra speciale nga Metush Krasniqi që nga 1976.

Puna, jeta dhe vepra e Ahmet Krasniqit dëshmoi se ai me përpikëri filloi realizimin e detyrave që ia kishte shtruar Metush Krasniqi dhe që ai ia kishte shtruar vetvetes. Ahmet Krasniqin nuk e vuri në ballë të ushtarakëve të Kosovës partia, se parti nuk pati dhe as që donte të kishte, se për te parti ishte shqiptaria, nuk e vuri në krye të ushtarakëve të Kosovës klani, se klan nuk kishte dhe as që donte të kishte. Në krye të ushtarakëve e emëruan ushtarakët koordinatorë, që i përfaqësonin të gjithë ushtarakët e Kosovës që ishin jashtë Kosovës, duke ditur për aftësitë e tij luftarake e strategjike, duke ia njohur prejardhjen nacionaliste të familjes së tij dhe qëndrimin burrëror që e mbajti gjatë gjithë asaj kohe që kreu profesionin e ushtarakut në ushtrinë e okupatorit. E vranë Ahmet Krasniqin armiqtë tanë me dorën katile të shqiptarëve të shitur që u bënë spiunë dhe vasalë të serbit dhe grekut, duke ditur se përvoja dhe aftësitë e tija organizative dhe ushtarake do të çonin deri te formimi i një ushtrie të rregullt dhe të fuqishme kombëtare, që do të çonte në çlirimin e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nga vetë shqiptarët me ndihmën materiale dhe diplomatike të aleatëve dhe miqve të popullit shqiptar të Amerikës së fuqishme, Anglisë liridashëse, Gjermanisë-aleatës së Amerikës, burrave të mëdhenj të botës, zotërinjë Klinton, Bleir, Shirak, Solanës, Klarkut, Shrederit, mikeshës së madhe të kombit

shqiptar dhe diplomates së shquar të SHBA-ve zonjës Olbrajt dhe miqve të shumtë që shqiptarët i kanë në katër anët e botës.

Tani opinioni ynë i ka të qarta shumë ngjarrje, për të cilat, para një viti apo para dy vitesh, nuk dinte asgjë. Shumë prapaskena të njerëzve të ligë, që i luajtën në kurriz të popullit të shumëvuahtur shqiptarë janë të njohura. Krimet e kriminelëve serbë i ka gjykuar gjithë bota. Gjyqi i Hagës do t'i gjykojë me radhë po qe se denimi i tyre do të zgjatë një shekull. Fatkeqësisht krimet e kriminelëve shqiptarë, që vranë shqiptarë për arsye se nuk mendonin si ata dhe që nuk donin t'i kryenin urdhërat e Nanosit dhe argatëve të tij, kanë mbetur deri tash të pagjykuar, përpos nga individë guximtarë. Për habi, ata kriminelë endën, sorollaten, e pispillohën të lirë në hapësirën shqiptare. Disa prej tyre kanë zënë pozita udhëheqëse në subjekte politike të Kosovës, disa të tjerë kanë përvehtësuar pasuri shoqërore, ndërsa argatët e tyre, llam-takami i shoqërisë shqiptare po i kryen urdhërat e tyre, duke rrahur dhe vrarë njerëz autoritativë, që i do populli, dhe të gJORët nuk po e kuptojnë se punën e shkaut dhe të grekut po e bëjnë.

Po duhet ta kenë të qartë kriminelët që i urdhërojnë mjeranët të bëjnë krime, se ata janë më kriminelë se veglat e tyre që po e ngrehin gishtin e kimit, dhe si të parët, si të dytët, nuk do të vonojë shumë kur do të duhej të japin llogari para drejtësisë shqiptare apo asaj ndërkombëtare për krimet që bënë mbi shqiptarët. Dhe, po qe se vdesin në fatkeqësi komunikacioni, apo për shkaqe tjera, nuk do t'i shpëtojnë dënimit se do të dënohen për së vdekuri dhe vendimi do t'u varet në gurin e varrit, me një epitaf kuptimplotë për t'u treguar kalimtarëve të rastit, por edhe bashkëvendasëve të tij se krimi kurrë nuk vjetërohet. Rrogarët e armiqve tanë me në krye Nanonosin, do ta hanë kryet e vet, pa të keqen e shqiptarëve. Argatët e rrogarëve të armiqve tanë do të jepin llogari para drejtësisë shqiptare. Ndërsa nxënësit dhe pionerët e argatëve të rrogarëve të armiqve tanë do të falën apo do të dënohen më së lehti që është e mundur, po qe se sinqerisht pendohen për veprat e tyre të ndyera dhe i tregojnë kryekriminelët që i mashtruan me parulla patriotike apo iu dhanë tëholla për të vrarë atdhetarë. Gjaku i bijve më të mirë të kombit: Shaban, Adem e Hamz Jasharit, Zahir Pajazitit, Azem Hajdarit, Ahmet Krasniqit, Agim Ramadanit, Salih Çekut, Komandant Kumanovës e dhjetëra Burrave të Dheut, që u qitën në prita të kiminelëve të Serbisë, apo u likuiduan me mjete perfide, duke ua përgatitur rrethanat e vrasjes nga

ushtria dhe policia e shkaut apo veglat e tyre –shqiptarët tradhtarë, nuk guxon të mbetet pa u shpague, nuk guxon të mos zbulohen dhe të mos dënohen para drejtësisë shqiptare, mos për asgjë tjetër, për të marrë mësim fara e ligë që na e mbollën të huajt, për të mbledhurat mend të tjerët që të mos punojnë për llogari të huaj, se i pret dënimi. Atdheu ka nevojë për shtetin ligjor dhe për drejtësi më tepër se për bukë dhe për ujë. Drejtësia do të fitojë. Të ligjtë do të humbin. Populli është i pagabueshëm dhe shuplaka e tij është e madhe! Mjeri ai i mjeri që e provon flakareshin e tij, se ai më nuk është i gjallë edhe pse bukë ha dhe ujë pi. Atij i thonë njeri i vdekur për së gjall. Atij i thonë edhe stërvinë.

Një komb që në mesin e tij ka shumë njerëz të vdekur për së gjalli e gjejnë të këqijat dhe të ligat pa prituri dhe pa kujtuar, po që se atyre iu besohet. Shqiptarët janë provuar me shumë të liga dhe me shumë telashe që ia sollën në shtëpi, përpos të huajtë, edhe ajo fara e keqe. Populli shqiptar duhet ta hjerri atë bar të keq, i cili tani është dalë në mejdan. Edhe plakati dhe pleqtë, që kohën e kalojnë, duke i ndier dhimbjet e trupit nga pasojat e robërisë dhe varfërisë, edhe rinia jonë heroike, edhe fshatarët, punëtorët dhe intelektualët sot po e njohin atë farën e keqe, e cila po mundohet ta marrë pushtetin e Kosovës së çliruar nga NATO-ja dhe luftëtarët trima të UÇK-së me anë të lajkave, premtimeve të rrejshme, kërcënimeve dhe krimeve.

Populli ynë e ka shansin historik që me dorën e tij, duke mos i dhënë votën asaj fare të keqe, por njerëzve që ia ka besën, që i njeh se janë të mirë, që janë të ndershëm, që janë të drejtë dhe që janë të aftë për t'i kryer detyrat që u besohen me përgjegjësi, ata të cilët interesin kombëtar në as një mënyrë nuk e shkelin për interesa banale, siç janë ato personale, grupe apo partiake. Pra, vetëm me njerëz të tillë, me atdhetarë nacionalistë dhe demokratë të vërtetë që dinë se ku i kanë aleatët shqiptarë, që e urrejnë komunizmin dhe majtizmin ashtu sikurse edhe robërinë, mund të fitohet pavarësia e Kosovës, mund ta rrisin numrin e miqve dhe ta zvogëlojnë numrin e armiqve, mund t'i përmirësojmë kushtet jetësore të familjeve të dëshmorëve, të invalidëve të luftës dhe të popullsisë së Kosovës. Mund të arrihet me hapa të ngadalshëm, po të sigurt-bashkimi kombëtar. Me njerëz të tillë do të vihen para drejtësisë kriminelët serbë dhe kriminelët shqiptarë, do t'ia prehën rrënjët farës së keqe që bashkëpunoi dhe po bashkëpunon me armiq të kombit shqiptar, pasi që me humbjet që do t'i pësojë në zgjedhjet e tetorit të këtij viti, do ta

humbin edhe përkrahjen e serbit, rusit dhe grekut, duke ditur se argatët e tyre që u bënë njerëz të vdekur për së gjalli nuk do të kenë fuqi të luajnë rolin e udhëheqësve partiak dhe as baballarëve të kombit.

*Botuar: "Bota sot" më 11-13 tetor 2000*

*PS. Nëntitujt i ka vënë redaksia.*

## KAPITULLI I GJASHTË

### VI. PERSONALITETE DHE FAKTORË QË NDIKUAN NË RRJEDHAT E NGJARJEVE HISTORIKE



# **NË PËRKUJTIMIN E 13 VJETORIT TË PAVDEKËSISË SË METUSH KRASNIQIT**

## **IDEOLOGJIA E TIJ-NACIONALIZMI SHQIPTAR**

Viti 1999 për popullin shqiptar ishte viti i tragjediave të mëdha familjare dhe kombëtare, por edhe viti që solli prerjen e prangave të robërisë serbe për shqiptarë të Kosovës, dhe hapi perspektivë të shkëlqyer për kurorizimin e aspiratave të natyrshme të popullit tonë për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Më në fund pas shumë përpjekjeve të vazhdueshme, gjeneratë pas gjenerate, në mënyra dhe mjete të ndryshme që lejuan kushtet dhe rrethanat e brendshme dhe ato të jashtme, puna dhe munda me përkushtim i Burrave të Mëdhenj të kombit dhanë frytin e suksesshëm, që solli çlirimin e Kosovës. Shkijet gjakatarë u detyruan të ikin me bisht për këmbë kah kanë ardhur, pas dajakut që muarën nga NATO-ja dhe luftëtarët trima të UÇK-së, duke shkretuar dhe lënë pas vetes shkatërime, kallje, djegie dhe varre masive, siç di të bëjë vetëm dora katile e shkaut.

### **Mësuesi i atdhedashurisë**

Sot kur Kosova ka filluar t'i shërojë plagët e rënda dhe po i bën hapat e parë kah Pavarësia e saj, nuk mund të mos i përkujtojmë me nderimet më të mëdha Prijësit e Lëvizjes sonë Kombëtare, që punuan dhe vepruan tërë jetën e tyre me përkushtim, për të mbajtur të ndezur zjarrin e rezistencës sonë kombëtare, të cilët shkuan në botën e amshueshme me sy çelur, pa ditur se si dhe kur do të zgjidhen çështjet madhore kombëtare; nuk mund të mos i përkujtojmë luftëtarët trima të cilët e luftuan pushtuesin serb, qëkur shkeli thundra e tyre në tokën shqiptare.

Kosova, që nga kohërat e lashtësisë së largët, ka dhënë Burra të Dheut, të cilët kundërshtuan dhe luftuan synimet e fqinjve tanë, për të na i gllabëruar trojet tona dhe për të na zhdukur si popull nga faqja e dheut. Njëri ndër Burrat e Dheut, që dallohej me kjoartësinë politike dhe orientimin properendimor që kishte, me ideologjinë kombëtare që udhëhiqej, dhe me punën konkrete që kreu, është Metush Krasniqi i cili

me plot të drejtë nga bashkëveprimtarët e tij quhej: Mësues i atdhedashurisë dhe ideolog i nacionalizmit shqiptar.

Njëri ndër faktorët kryesorë që ndikuan në krijimin e personalitetit të Metush Krasniqit pa dyshim është faktori i familjes, që e rriti, e edukoi dhe e shkolloi, për tu bërë një burrë i zoti që do ta vazhdonte dhe do ta çonte më përpara punën e pakryer të shumë gjeneratave, punën e lënë gjysmë nga babai i tij Asllani, i cili kishte marrë pjesë në aradhat e Idriz Seferit për pavarësinë e Shqipërisë, ndërsa më vonë edhe në aradhat e Mulla Idriz Gjilanit për ta luftuar robërinë serbo-sllave dhe komunizmin rus. Faktori i dytë që ndikoi fuqishëm në shpirtin liridashës të Metushit për ta urryer çdo gjë serbo-sllavo-komuniste ishte tradhtia që komunistët serbë ia bënë Konferencës së Bujanit, ndërsa faktori i tretë që ndikoi shumë në Metush Krasniqin ishte njohja e tij me mësuesin atdhetar dhe ideologun e NDSH-së, Gjon Sereçin, që u bënë shokë dhe bashkëveprimtarë. Pushkatimi i Gjon Sereçit nga komunistët çetnikë dhe dënimi me burgje të gjata të shumë anëtarëve të Organizatës së NDSH-së, e trazuan dhe e prekën thellë shpirtin e Metush Krasniqit, por i dhanë edhe forcë dhe energji të pashtershme për ta vazhduar punën dhe veprën e nisur të Gjon Sereçit me përkushtim.

Se me të vërtetë Metushi Krasniqi meriton të quhet Mësues i Atdhedashurisë, tregojnë shumë fakte, por mbi të gjitha duhet cekur punën e tij të palodhshme në edukimin dhe arsimimin e brezit të ri në baza të shëndosha kombëtare. Ai kudo që shkonte i trajtonte problemet që kishin të bënin me çështjet kombëtare. U shpjegonte njerëzve se robëria serbo-sllave është shkaktare e të gjitha të ligave, vuajtjeve, mjerimeve dhe varfërisë që mbretëronin kudo në Kosovë. U tregonte rrugën që do të na sillte lirinë dhe drejtësinë. Ishte i afërt me të gjitha shtresat e popullsisë pasi që kishte një thjeshtësi të natyrshme. Prezenca e tij në oda burrash, në takime intelektualësh apo në takime rasti me njerëz të moshave dhe profesioneve të ndryshme, të linte përshtypjen e një personaliteti të jashtëzakonshëm, që ishte krejtësisht i veçantë prej të tjerëve në sjellje, në biseda dhe në qëndrimin e tij të sinqertë e korrekt ndaj bashkëbiseduesit, me kjarhtësinë e trajtimit të problemeve, me tolerancën që kishte ndaj bashkëbiseduesit, i cili kishte botëkuptime dhe mendime të ndryshme për çështjet për të cilat bisedohej.

## **Metush Krasniqi e thërisnin me epitetin "Nacionalisti"**

Metush Krasniqi për dallim nga shumica e udhëheqësjes dhe prijësve të Lëvizjes sonë kombëtare për çlirim dhe bashkim kombëtar, nuk kishte bindje marksiste-leniniste, por kishte bindje nacionaliste, por shpirti i tij i madh dhe zemërgjërësia e pakufishme bënte që ndaj njerëzve me bindje komuniste, por që thonin se interesat e atdheut i venin mbi interesa ideologjike, i konsideronte shokë të mirë, duke ndier dhimbje për ta, që ishin aq shumë të manipuluar nga kjo ideologjia e djallit të mallkuar, siç e quante shpesh ai marksizëm-leninizmin. Përkundrazi, shumica e ish të burgosurve politikë duke ndier "epërsinë" e tyre që kishin bindje komuniste, Metush Krasniqi e quanin me epitetin "Nacionalisti", që kishte një domethënie "nënçmimi" për ta, me që sipas tyre, nacionalistët ishin njerëz të "prapambetur", ashtu siç ishin të "prapambetur" edhe njerëzit fetarë, që i besonin Zotit. Ai i çmonte lart të arriturat demokratike të Evropës Perendimore, ndërsa pluralizmin partiak e shihte si mekanizëm që zhvillimet demokratike i çon përpara e nuk lejon degjenerimin e shoqërisë, korrupsionin politik dhe atë ekonomik. Ishte një demokrat i vërtetë, human, zemërbardhë, i cili iu ndihmonte shumë njerëzve me të gjitha mundësitë që kishte.

Me siguri, Metush Krasniqi kur është përcaktuar për profesionin e mësuesit, kishte për qëllim edukimin dhe arsimimin e brezit të ri në baza të shëndosha kombëtare, sepse popullit i duhen djem dhe vasha të dijshme dhe trime, për t'i dalë zot popullit dhe tokës mëmë, çdo herë kur e lyp nevoja. Viti shkollor 1947/48 e gjeti mësues në Shipashnicë dhe pastaj pasi e kreu Shkollën Normale në Gjakovë, më 1950, punoi edhe në shumë fshatëra tjera të Anamoravës, si në Hogosht, Korotin, Shipashnicë, Muqivërc, Roganë, Srezofcë etj, ku përpos mësimin të rregullt organizonte edhe shumë kurse për të rriturit, për t'ua mësuar shkrimleximin analfabetëve, që numri i tyre ishte i madh në vendlindjen e tij si kudo në Kosovë.

Në vitin 1950 Metush Krasniqi përpos punës që kryente në procesin mësimor e muar nismën me disa anëtarë të NDSH-së, siç ishin Mark Gashi, Sejdi Kryeziu, Qemail Kallaba, Mehmet Dërmaku etj, për formimin e Organizatës ilegale, që faktikisht ishte vazhdim i organizatës së NDSH-së, por për shkaqe të konspiracionit iu dha emri: "Partia Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë".

Veprimtaria kryesore e Metush Krasniqit me shokët e Organizatës ishte që ta pengojnë shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi, por kryenin edhe punë tjera organizative dhe strategjike, që kishin rëndësi afatgjate. Autoriteti i Metush Krasniqit i cili rritej çdo ditë e më tepër, dhe puna e suksesshme në arsimimin dhe edukimin jo vetëm të brezit të ri por edhe të të rriturve për t'u bërë luftëtarë trima të çështjes madhore kombëtare, iu bie në sy këlyshve të Beogradit dhe- më 5 tetor 1956- e burgosën për herë të parë, por për munges faktesh dënohet vetëm me dy muaj burg për delikt verbal. Duke qenë i vetëdijshëm se përcillej nga këlyshët e UDB-ës, detyrohet të shesë një pjesë të pasurisë së patundshme për të blerë shtëpi në Shkup, me qëllim që atje ta vazhdonte më lehtë veprimtarinë e nisur ilegale, por edhe të mbillte farën e atdhedashurisë në rrethin e Shkupit, ku për dy vjet punoi mësues. Më 5 nëntor 1958 Metush Krasniqi burgoset në Shkup për të dytën herë, dhe me 7 mars 1959 dënohet me 18 vite burg të rëndë dhe tri vjet kufizim i të drejtave qytetare pas vuajtjes së dënimit. Qëndrimi burrëror dhe trimëria për ta akuzuar pushtuesin serb në seancat gjyqësore, pa bërë përpjekje për ta mbrojtur vetveten, rritën autoritetin e Metush Krasniqit ndër bashkëkombas dhe e forcuan shpresën te popullsia e Anamoravës se Liria nuk është larg, se këmba e shkaut nuk do të ketë vend në Kosovën martire. Metush Krasniqi edhe në burgjet serbe tregoi karakterin e lartë të luftëtarit të pathyeshëm, edhe pse torturat serbe ishin të mëdha dhe të llojllojshme. Ai me krenari i mbajti prangat në këmbë prej 18 kilesh plot 18 muaj, ndërsa e duroi izolimin e plot 33 muaj. Metushin e provuan ta thyejnë edhe me uri, duke ia zvogëluar dyfish racionin që i takonte sipas Rregullores së burgut, por Metush Krasniqi mbeti i fortë dhe krenar sikur ditën e parë kur shkeli këmba e tij në burgun e shkaut.

Fatmirësisht, kur Kosova gjendej në rreziket më të mëdha nga armiqtë tanë dhe popullsia jepte shenjat e demoralizimit, i Madhi Zot i krijonte situatat e favorshme për popullin e robëruar shqiptar. Plenumi i Brioneve i mbajtur kah mesi i vitit 1966, bëri që klani i Titos të fitonte mbi atë të Rankoviqit. Kosova filloi të frymon lirisht. Shqiptarët e larguan frikën dhe e forcuan shpresën e molisur. Të burgosurve politikë iu zvogëluan dënimet. Kështu Metushi, Demaçi dhe të gjithë të burgosurit politikë që ishin nëpër burgjet e Jugosllavisë përfituan nga kjo situatë, që u krijua në Jugosllavi. Festën e 28 Nëntorit të 1996 Metushi e feston në

shtëpi, fatkeqësisht pa babain që i kishte vdekur tri ditë para se t'i kthehej në shtëpi biri i tij i dashur.

Si prind, Metushit i dolën detyra të mëdha. Duhej shkolluar fëmijët që ishin rritur pa përkëdheljen e tij, që ishin rritur në skamje dhe në përbuzje nga këlyshët e UDB-së. U punësua në Shkollën Teknike "19 Nëntori" në Prishtinë, referent për çështje nxënësish më 1967, ku gjatë kohës sa punoi, shumë të rinj i orientoi në rrugën që shpinte për t'u bërë luftëtarë të denjë të zgjidhjes së çështjes kombëtare, në mesin e të cilëve ishte Ahmet Krasniqi, një nxënës shembullor dhe i shkëlqyshëm, i cili i vazhdoi studimet e artit ushtarak me përkrahjen, porosinë dhe detyrën konkrete që ia ngarkoi Metush Krasniqi. Udbashët nuk e lënë të qetë edhe këtu Metushin. Më 1976 e largojnë nga puna me arsyetimin se ka bindje nacionaliste. Metushi nuk rrinte durkryq, ai iu përvishet studimeve në Fakultetin e Drejtësisë, dhe i kryen me kohë, edhe pse i shtyrë në moshë. Me ndihmën e shokëve pastaj punësohet në Drejtorinë e Transportit Hekurudhor në Fushë -Kosovë.

Në organizimin e demonstratave të para që i organizoi Grupi i të rinjve më 1968 pati hise edhe Metush Krasniqi, duke ua dhënë këshillat e tij të vleshme të Rinjve nëpërmjet Sabri Novoselës. UDB-ja e burgosi Metush Krasniqin dy ditë pasi u kryen demonstratat, por pas 24 orëve e lëshojnë duke mos pasur kurrfarë provash për ta mbajtur më tepër në burg. Metush Krasniqi ishte edhe largpamës. Ai parashihte se me vdekjen e Titos, nuk do të ketë personalitet që do ta mbante nën kontroll shovinizmin serb dhe nacionalizmin kroat, prandaj i muar të gjitha masat për formimin e një Organizate që do të bënte përgatitjet e duhura që, në momentin e përshtatshëm, populli ynë të jetë i gatshëm dhe i aftë për t'i prerë prangat e robërisë, për ta fituar lirinë. Pas konsultimeve dhe përgatitjeve të duhura në mbarim të 1976 dhe në fillim të vitit 1977 formohet "Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe e Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi" (LNÇKVSHJ), ku punët më të mëdha i kryen Metush Krasniqi, Sabri Novosella dhe Jusuf Gërvalla.

Më 1979 Sabri Novosela dhe Jusuf Gërvalla detyrohen ta lëshojnë Kosovën për shkak të mundësisë së burgosjes së tyre, ndërsa Kryetari i Organizatës Metush Krasniqi me pjesën më të madhe të Udhëheqësisë së Organizatës mbetën në Kosovë për të kryer detyrat që parashihte Statuti i saj. Ishin fillimet e viteve 1980-ta, kur Lëvizja jonë Kombëtare kishte marrë hov të madh në Kosovë dhe Viset tjera

Shqiptare. Ekzistonin grupe dhe Organizata me programme dhe statute të ndryshme. Metush Krasniqi u vu në ballë të përpjekjeve për bashkimin e tyre në një Qendër organizimi dhe veprimi, por enveristët kosovarë nuk e donin atë bashkim i cili më parë nuk ua siguronte udhëheqjen e Lëvizjes, dhe më vonë edhe marrjen e pushtetit në Kosovë prej tyre, dhe kështu Lëvizja mbeti e ndarë në baza ideologjike. Metushi burgoset pas demonstratave të '81-it dhe mbahet në burgun hetues të Gjilanit tetë muaj. Për mungesë faktesh, detyrohen ta lirojnë, pasi që Metush Krasniqi, si çdo herë më parë, ishte memec para hetuesve dhe kriminelëve udbashë. Ndërsa përpjekjet e Jusuf Gërvallës për t'i bashkuar shqiptarët në baza kombëtare, pa marrë parasysh bindjet e tyre ideologjike dhe besimin fetar, i kushtoi me jetë. U bë atentat në veturën ku ishin Jusufi, Bardhoshi dhe Kadriu më 17 janar të vitit 1982.

Me 4 nëntor 1985, Metush Krasniqi burgoset për të pesten herë, ku për dallim prej herave tjera, nuk e keqtrajtojnë çetnikët e Beogradit, por veglat e tyre të verbëra, Selim Broshta dhe Zymber Zymberi me kompani. Dhe sot këta udbashë nderohen prej shqiptarëve, në vend se të leqiten prej tyre, jo vetëm rrethi që i njeh, por edhe pasardhësit dhe familja e gjërë e tyre, kur dihet se Metush Krasniqi e kanë mbytur me dru këta kriminel të pjellës shqiptare, dhe për t'i fshehur këmbet e gjarprit tinzar, e lëshuan Metushin si të "pafajshëm" pasi mjeku i burgut kishte konstatuar se jeta e tij numërohet në ditë. Vendimin e "pafajësisë" e lëshoi Gjyqi i Qarkut të Prishtinës, pasi i kishte marrë urdhërat nga UDB-ja e Prishtinës, edhe pse gjatë hetimeve disa të burgosur kishin pohuar se kanë punuar me Metush Krasniqin punë ilegale. Edhe pse Metush Krasniqi u shtri në Spitalin e Prishtinës, mjekët nuk mundën t'ia shpëtojnë jetën që ia kishin shkatërruar sa burgjet e mëparshme aq edhe burgosja e fundit. Më 15 tetor të vitit 1986 ndërroi jetë, për të shkuar në botën e amshueshme, ndërsa Lëvizja jonë Kombëtare mbeti pa udhëheqësin e saj më largëpamës, ideologun e nacionalizmit shqiptar, mësuesin e Atdhedashurisë dhe veteranin e shkollës shqipe të Kosovës, që kishte një kjartësi politike e aftësi të jashtëzakonshme organizative dhe besim të madh në të gjitha shtresat e popullsisë së Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare.

Me zhdukjen fizike të Jusuf Gërvallës dhe Metush Krasniqit, dhe para një viti edhe të ushtarakut madhor kolonel Ahmet Krasniqit, që i kreu studimet e artit ushtarak me porosinë e Metush Krasniqit e pastaj u

bë edhe anëtar i LNÇKVSHJ, populli ynë përjetoi goditjet më të rënda,  
ku pasojat e asaj goditjeje po i shohim sot të gjithë.

*Botuar : "Bota sot" më 18 tetor 1999*

*PS. Nëntitujt i ka vënë redaksia.*

## DRENICA EDHE NJË HERË NA E ZBARDHI FYTYRËN DHE NA RIZGJOI KRENARINË KOMBËTARE

Kur iu mbush mendja çetnikëve të Beogradit se populli ynë në Kosovë ra në krrahmën e vdekjes, Serbia bëri përgatitjet e duhura propagandistike dhe ushtarake për ta sulmuar Drenicën, epiqendrën e kryengritjeve të shumta shqiptare, për të na goditur dhe dërmuar me themel shpresën e fitorës, shpresën e çlirimit dhe bashkimit tonë kombëtar, me mjete barbare, siç di dora katile serbe, duke shpresuar se do t'i realizojnë planet dhe ëndrrat e tyre të marra për të na shfarosur dhe për të na i gllabëruar trojet tona të shenjta, që të parët tanë brez pas brezi na i ruajtën me sakrifica të mëdha.

Si shumë herë më parë, edhe këtë herë u gabuan në llogaritje hordhitë barbare të Karpateve të Rusisë dhe përkrahësit e tyre tradicionalë se do ta fitojnë betejën përfundimtare ndaj nesh, për të na trajtuar pastaj si "bagëti në oborrin e kasapit", por s'do të arrijnë dot kurrë.

Çdo herë, në të gjitha periudhat e rëndësishme të historisë sonë kombëtare Drenica luajti rol me rëndësi. Edhe sivjet ajo e muar në dorë flamurin e rezistencës sonë kombëtare, për ta ngritur lart në qiellin e saj të dëlirë, ashtu siç është e dëlirë zemra e racës së pastër shqiptare. Drenica edhe këtë herë u bë epiqendra e vlimeve të mëdha shqiptare, epiqendra e ndryshimeve të mëdha shqiptare. Ajo u bë dorë magjike që shqiptarët e përgjumur, të lodhur e të molisur, i ngriti në këmbë, duke i vetëdijësuar se liria nuk falet por fitohet me sakrifica të mëdha. Drenica u bë mehlem i shërimit të plagëve të rënda që na i shkaktuan karrieristët e sëmurë për pushtet dhe partiakët e shtirë. Ajo u bë gisht tregues të na tregojë si mbrohet atdheu, si fitohet liria dhe si përfitohen miq liridashës në katër anët e botës. Drenica kryengritse e Hasan Prishtinës, Ahmet Delisë e Azem Bejtës dhe Shote Galicës. Drenica e kuqe e Shaban Polluzhës dhe Mehmet Gradicës. Drenica shpresëdhënëse e Fazli Grajqefcit dhe mijëra dëshmorëve të rënë në altarin e rinisë për çështje madhore kombëtare, edhe këtë vit na e zbardhi fytyrën duke i treguar gjithë botës se tradita luftarake dhe e sakrificës për liri tek shqiptarët ruhet, kultivohet e forcohet dhe, në momentin e duhur, shkrep si vetima



për t'i goditur bajlozët në lule të ballit, si vetima kur godet gjatë natës së turbulluar me të reshura të shumta.

Po, Drenica jonë heroike, e përgjakur, e djegur dhe e masakruar, me qëndresën e burrave të saj, veçmas me sakrificat e mëdha të familjeve Jashari, Ahmeti e Sejdiu, na treguan rrugën e fitorës, mënyrën se si mundet Serbia katile dhe si arrihet liria. Ajo na bindi se vetëm të bashkuar si një trup i vetëm, duke i lënë anash të gjitha grindjet, mosmarrëveshjet e ngatërresat, do të bëhemi të zotë ta mundim makinerinë e hekurt të dhunës dhe terrorit serb.

Drenica krenare, altar i trimërisë dhe atdhedashurisë, ngriti në këmbë burrat trima të Dukagjinit dhe rininë tonë heroike për t'i rrokur armët e për të bërë front të përbashkët qëndrese, suksesesh e fitoresh. Ajo na e forcoi UÇK-në, forcën tonë ushtarake, i dha zemër dhe krah asaj për tu bërë faktor dhe subjekt vendimtarë, për të arritur çlirimin dhe bashkimin tonë kombëtar.

Drenica e djegur flakë, e përgjakur dhe e masakruar si shumë herë më parë nga hordhitë barbare serbe të Karpateve të Rusisë, dha kushttrimin e lirisë. Zëri i Shabanit, Ademit dhe Hamzës, kushtrimi i tyre për liri, duhet të na vetëdijësojë për t'i bashkuar të gjitha forcat morale, materiale dhe njerëzore për këtë betejë përfundimtare, e cila do të jetë e mundimshme dhe e vështirë, por gjithësesi fitimplote, që do të kurorëzojë të gjitha përpjekjet e deritashme për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar. Me punën tonë kambëngulëse, me qëndresën dhe vullnetin e pathyeshëm, me organizimin tonë të mirëfilltë kombëtarë, do ta çojmë në vend amanetin e Shabanit, Ademit, Hamzës dhe mijëra dëshmorëve e heronjve tanë. Fitorja do të jetë e jona! Shqiptari do ta gëzojë lirinë dhe më nuk do të jetë rob i askujt!

*Shkruar më 15.05.1998.*

*Botuar në "Revistë ushtarake" Nr.1. shtator 1998 dhe "Zëri" më 6 nëntor 1998*

## MBETËM PA SHOKUN TONË TË VJETËR

Na la shoku ynë i vjetër. Na la shoku ynë i rinisë së hershme me plotë iluzione dhe ëndrra. Na la shoku ynë i burrërisë së fortë dhe i fjalës. Na la shoku ynë i përvuajtur, i thjeshtë e zemërgjërë Avdyl Lahu.

Sa shpejt kaluan vitet, sa shpejt kaloi koha nga ato ditët e bukura të shtatorit të vitit 1960, kur i filluam mësimet e mesme në Prishtinë. Thonë se rastet i takojnë njerëzit për t'u bërë shokë të pandashëm, shokë për t'i ndarë së bashku gëzimet dhe hidhërimet, për ta luftuar të keqen dhe të shëmtuarën sëbashku. Po ishte ai rasti i një refuzimi për të bajtur parulla ku i thurej lëvdatë tradhtisë, ku lavdohej robëria. Po ai rast na i bashkoi mendimet, na i bashkoi veprimet simbolike të vazhdimit të Asaj rrezistencës së gjatë me shekuj nga gjenerata të shumta. Nuk donim t'i përcillnim përshendetje dhe gëzime Atij që, pasi kishte bërë përpjekje të na zhdukë si komb, na futi nën zgjedhën e tij. Ne nuk kishim për t'i përcjellë as përshëndetje dhe as gëzime Atij! Po shoku ynë, patëm shumë halle e shumë gajle. Po, edhe gëzime kemi pasur! Gëzime edhe të mëdha bile. Shpresa për ta mundur të keqen; shpresa se gjeneratës tonë do t'i takojë privilegji i flijimit për Qëllime të larta kombëtare e njerëzore, për ta realizuar Endrrën e kahmotshme të popullit tonë, na gëzonte shumë. Edhe rezistenca simbolike, edhe sukseset e bashkëkombësve tanë në arritjen e dijës; në fitimin e titujve të lartë shkencorë, na gëzonin pa masë.

Ishim ulur në oborrin e shkollës me shumë shokë. Ishin me ne edhe Hajradini dhe Ruzhdiu. Nuk kishim mundësi çdo njëri prej nesh ta blenim Rilindjen, por kishim mundësi ta blejmë me radhë. Po, ishte organizimi ynë i parë, për ta pasur çdo ditë në duart tona gazetën tonë të përditshme me emrin i saj të madh. Lajmi më i gëzuar i asaj dite të bukur pranverore ishte se profesor Dervish Rezhaja u bë doktori më i ri në Evropë, nga lamia e biologjisë. Gëzim dhe krenari të përziera së bashku. Ty, shoku ynë i dashur të qeshte fytyra më tepër se ne. Si duket gëzimi yt ishte më i madh, apo kishe edhe një gëzim tjetër atë ditë, por ne nuk e dinim. Numri i nxënësve shqiptarë ishte i vogël. Edhe tekstet dhe lektura shkollë na mungonin shumë. Shënimet që na i diktonin profesorët tanë i huazonim nga njëri tjetri. Sa shkrim të bukur që kishe! Po, sa i vështirë ishte për ta lexuar! Edhe ato libra të pakta, me prozë e poezi që i siguronim, i huazonim mes nesh. Pritnim në radhë për t'i lexuar ato, për

një natë, apo për dy ditë si: "Lulja e Kujtimit", "Sikur të isha djalë", "Gjarpnajt e gjakut". Po "Lahuten e Malësisë"- disa blej, i patëm lexuar së bashku në një banesë të një shoku. Ti lexoje bukur e rrjedhshëm, prandaj atë natë lexove më së tepërmi. Më vonë na u botuan përmbledhjet e veprave të Çajupit, Migjenit, Naimit në nga një libër. Këto vepra u bënë ushqim shpirtëror për shpirtin e rinisë shqiptare që kishte aq vullnet të madhë për të zënë dije. Kishte aq shumë dëshirë për ta larguar errësirën që na i kishte mbuluar Trojet tona, njerëzit tanë.

Po, shoku ynë, sa ëndrra të bukura thurrim për Kosovën dhe Viset tjera Shqiptare! Sa ëndrra të bukura thurrim për Shqipërinë! Edhe Qyqavicën edhe Gollakun e mbillnim me lloj-lloj pemësh, për ta furnizuar me fryte jo vetëm Shqipërinë, por edhe Evropën. E, sa rrugë të gjëra bënim plan t'i ndërtonim, kur të bashkohet kombi ynë, kur t'i bashkojmë trojet tona, të copëtuara me thikë nga kasapët e Evropës dhe fqinjve tanë. Nuk përtoje të sillje edhe shifra, sa do të bëhemi në këtë vit, e sa në atë vit. Sa do të bëhemi të fortë dhe sa do të kemi begati në këtë vit, e sa në atë vit. Varëfërinë e patëm dënuar me vdekje! Tradhtinë po ashtu. Sa të lumtur bëheshëmi në ato çaste! Çfarë gëzimi përjetonim ne, me fantazirat tona të bukura e të pastra si loti. Dëshira e përzier me fantazinë, për tu bërë realitet duhej punë e madhe. Po, ishim të vetëdijshëm se të gjitha ato të mira që i gjakonim nuk vijnë vetë, nga qielli, si pikat e shiut, pa punë të mundimshme dhe vullnet të fortë. Ishim krenarë, se ishim të bindur që gjenerata e jonë do të jetë ajo që do ta kurorëzojë ëndërrën shekullore të popullit tonë, për të pasur një jetë të denjë si i ka hije njeriut, të jetë: i lirë në vend të vetë, pa qenë skllav i askujt, por i barabartë me popujt tjerë të Globit tokësorë të vetëm, që i Madhi Zot e krijoi me bukuri dhe pasuri të shumta, të mjaftueshme për të jetuar si është më mirë, po që se nuk keqpërdorën këto të mira nga njerëzit e pangirë, nga njerëzit e çuar peshë, pa ndjenja njerëzore dhe humane.

Sa kujtime të bukura kanë mbetur në kujtesën time shoku ynë i dashur. Vizitat e tua në Gjytetin e Strofcit, në qytetin gjermadhë dardan. Sa përshtypje të patën bërë "Tabja e Topit", "Roga e Prekokes", "Ujësjellësi Qëndror i Kështjellës", "Kroni i Etheve", "Guri i Madh" dhe "Rogat e Isufit". Po, shoku ynë, fakte të shumta, të një qytetërimi të lashtë. Po anomalia jonë shqiptare. Si duket fletëm shumë, apo ndryshuam shumë, si rrjedhim i presioneve të mëdha nga lindja dhe nga

perëndimi, për të na zhdukur nga trojet tona, apo është në pyetje gjeni shkatërrues. Ku ta dish? Apo të dyja së bashku?! Sa llafazan na bëheshe kur më flisje për qytetin e vendlindjes sate, Gllamnikut dardan. Sa prindër të mirë pate. Prindër dhe shokë. Po ku t'i gjesësh vëllazur si ti që pate? Çfarë nderi të bënin ty dhe shokëve tuaj! Ti ishe i priveligjuari i tërë familjes! Ti ishe më i dashuri i familjes!

Shoku ynë i dashur, ende pa i kryer shkollat e mesme, fati e dashti që jetën tonë ta pasurojmë edhe me një përvojë të hidhur, por me një kalitje të shkëlqyer për jetë. Goli Otoku ishte shkollë e jonë e dytë. Puna e rëndë, përballohej me energjitë rinore dhe vullnetin e pathyeshëm për të qenë dinjitozë në vështirësi dhe pengesa, për të qenë krenarë para të huajit, kur ai e ka për qëllim të na nënçmojë, pa marrë parasysh rreziqet që mund të dilnin.

Ishim të rinj atëherë, me plotë energji. Me plot optimizëm për jetën. Me vullnet të fortë për të zënë dije, se e dinim, që ajo na duhet për raundin e dytë apo të tretin, për t'u kacafytur me errësirën, padrejtësinë, Kulshedrën dhe gjarpërinjtë helmues, me çfarë të huajt na i mbushën trojet tona me mjeshtëri, me anë të pareve dhe dredhive. Për njëri-tjetrin ishim shokë, vëllezër, prindër. Sa biseda të flakta bënim për të arriturat tona në shkencë, letërsi, gjuhë. Në mesin tonë kishim edhe poetë të talentuar, i kishim edhe disa që bënin përpjekjet e para të shkruajnë poezi. Tekiu, Haxhiu, Sabriu, shpesh na i lexonin poezitë e tyre. Ne të tjerët: unë, ti, Shabani, Fadili, Azemi, Shefkiu e Hasani i dëgjonim me vëmendje, duke bërë vërejtje me vend e pa vend. Po, ishim të rinj atëherë. Njëzetvjeçarë. Ndonjeri prej nesh, një vjet më tepër, apo dy vjet.

Po shoku ynë, shkove para nesh në Botën tjetër, për t'u takuar me shpirtrat e atyre burrave dhe vashave të Viseve tona, që mundi dhe puna e tyre ende po na mbajnë gjallë. Çka do t'u thonim pasardhësve tanë sikur të mos e kishim vepren e tyre të madhe. Ajo vepër e tyre, edhe neve na nxiti që ta vazhdojmë punën e tyre me ca përpjekje të vogla, për ta mbajtur të ndezur zjarrin e rezistencës sonë kombëtare, për të shkuar përpara drejt realizimit të idealeve të larta kombëtare dhe njerëzore.

Çfarë mallkimi na ka zënë, a thua vallë?! Pse vallë, nuk u ndoq ajo rruga e natyrshme: Fillim, vazhdim, përfundim i punës së nisur, por gjithnjë: Fillim, pushim, fillim, pushim. Është në pyetje gjeni i jonë shkatërrues apo mospjekuria jonë, që të mos veprojmë si të tjerët, që të mos ecim me kohën, apo të dyja së bashku. Po, shoku ynë Avdyl, ike

para nesh në Botën e amshueshme. E di që do të pyesin shpirtrat e heronjve dhe dëshmorëve tanë për trojet tona, që ata i lanë me gjak, që ato të mbesin shqiptare deri në kjamet. Do të pyesin për nipërit dhe stërnipërit, mbesat dhe stërmbesat e tyre. Po ti mos i shqetëso duke ua treguar të vërtetën e plotë. Mos u thuaj se gjenerata, që më së tepërmi është pritur prej saj, ra në provimin e jetës dhe në provimin e historisë. Ata do të pyesin, për shkollarët e gjeneratës së parë, të dytë dhe të tretë, pas robërisë së tretë sllave, për të cilët prindërit tanë shpresuan shumë, se do të dinë t'i rrinë karshi robëruesit: me dije, zgjuarsi dhe trimëri. Thuaju se dështuam tërësisht. Po mos harro t'u thuash se tani kanë lindur Pipa të rinj, të shëndetshëm dhe imunë nga sëmundjet krahinore, partiake dhe ideologjike, nga veset e shumta si xhelozia e marrë, inatet, kryeneçësitë dhe naiviteti politik. Thuaju, se ata Pipa i kanë rrënjët thellë në brendësinë e tokës nënë. Ata më, nuk do t'i luajnë erënat e huaja. As të lindjes, as të perëndimit. Ata do t'i injorojnë, sidomos ernat e lindjes, që na kanë sjellë sëmundje, priftime, tërmete, kancere... Po, po, tregoj edhe për kaosin tonë, për organizimin tonë, për organizimin tonë të prapshtë, për marrëzitë tona të shumta, për anomalitë shqiptare, që për çdo vit po i shtojmë dhe rrisim në atë shkallë, sa që edhe botën e tmeruam me to.

Po, shoku ynë i rinisë, po shoku ynë i shtrenjtë, po shoku ynë i idealeve të larta njerëzore, nuk kemi menduar kurrë se do të vijë një ditë që do të na i plagosi rëndë ëndrrat tona, shpresat tona të bardha. E sa ëndrra të bukura thurnim për Nënë Shqipëri. Kush ka menduar se Nëna jonë do të plagoset për vdekje nga djemtë e saj të pashpirt, djemtë e saj të prapshtë, nga bijtë e saj të çoroditur që punuan dhe po punojnë për interesa të huaja.

Po, shoku ynë Avdyl Lahu, sëmundja e rëndë të lodhi fizikisht shumë, por shpirtërisht nuk mundi dot të të dobësojë fare. Hallet e mdha kombëtare ishin hallet tuaja më të mëdha se dhembjet e forta që ta ngacmonin shpirtin dhe trupin tënd të lodhur. Dëgjoje TVSH rregullisht, dëgjoje lajmet e radiostacioneve të huaja. Shtypin nuk mundje ta lexojë vetë, por ta lexonin me zë djemtë. Sa të rëndoi! Sa të shqetësoi! Sa fortë ta rriti plagën e zemrës plagosja e Shqipërisë për vdekje! Si është e mundur, thojë? Si është e mundur të shkatërrohej shteti?! Si është e mundur thojshë, të kallet Shqipëria?!

Çfarë mallkimi, o Zot! Çfarë mallkimi, o i Madhi Zot! Të lindësh në robëri! Të jetosh në robëri! Të vdesësh në robëri! Çfarë tragjedie

njerëzore! Çfarë tragjdie kombëtare! Po, shoku ynë, ike shpejt nga kjo botë e bukur, por ne s'patëm kurrë jetë të bukur! Po, shoku ynë, ike nga kjo botë e padrejtësive të mëdha ku "bijnë poshtë të mdhenjtë e të vegjlit çohen", por ne kurr nuk u çuam në këmbë! Ecëm dhe ende po ecim në duar e këmbë! Ende nuk u mësuam të ecim me këmbët tona! Po, shoku ynë, shkove nga kjo botë e brengosjeve të mëdha, e varfërive dhe skamjeve të mdha, e padrejtësive të mëdha, e pasurive të mëdha.

Po, shoku ynë, i idealeve të larta, shkove në Botën e amshueshme, me brengën e madhe në zemër, me sytë çelë, se ç'do të bëhet me Kosovën dhe Viset tjera shqiptare? Se ç'do të bëhet me Shqipërinë dhe popullin tonë të ndarë dhe të përçarë në baza krahinore, në baza ideologjike, në baza grupore dhe klanore?!

Deri kur më kështu, shoku ynë i dashur, shoku ynë i fjalës dhe i besës, vëllai ynë i dashur, deri kur kështu, edhe në momentet e fundit të jetës, ta shijojmëeliminimin e robërisë?! Edhe në momentin e fundit të jetës të na ngulfatë brenga për Atdheun, brenga për pasardhësit! Se ku do t'i lëmë? Qysh do t'i lëmë?

I Madhi Zot të mëshiroftë!

*Botuar në "Glob" Nr. 9, maj, 1997*

## PORTRETI I NJË OFICERI MADHOR SHQIPTAR

Ngjarrjet e mëdha kombëtare të 1968-ës na njohën në rrugët e Prishtinës, atë Natë të Madhe, për të marrë pjesë në një ngjarje të rëndësishme kombëtare, kur Grupi i të Rinjve ia kishin vënë për detyrë vetes t'i prijë rinisë shkollore dhe studentore, për kërkesa kombëtare. Këto demonstrata treguan se Lëvizja jonë kombëtare po i forcon rradhët dhe se ajo tani është në një nivel më të lartë organizimi dhe gatishmërie për realizimin e aspiratave të populli tonë.

Shovinizmi serb sulmohej në të gjitha anët e Jugosllavisë pas Plenumit të Brionëve, kur fitoi klani i Titos mbi atë të Rankoviqit. Kosova e largoi frikën. Ishe krijuar klimë e përshtatshme që forcat atdhetare të punojnë në drejtime të ndryshme të përparimit dhe emancipimit.

Dhe Ti, shoku im ushtarak. Ti bir i babajt të mbytur nga dora e shkaut në Aksionin e Mbledhjes së Armëve, Ti që aq shumë e urreje robërinë, hyre në këtë shkrim timin. Ty që me gjithë vëllain dhe tre djemtë e xhaxhait ju leçitën për shumë kohë bashkëfshatarët tuaj me urdhërin e këlyshëve të Beogradit, për shkak se Xhaxhai yt Aziz Zhilivoda me "mashinkë" në dorë, për shumë vite bëri rezistencë maleve të Qyqavicës, kundër tradhtisë komuniste dhe robërisë serbo-jugosllave. Ti që u edukove në baza të shëndosha kombëtare nga familja jote e njohur për atdhedashurinë dhe trimërinë e burrave të saj, mos të lëndojnë shpifjet e njerëzve të papërgjegjësi, qëllimkëqinj dhe xhelozë, që nuk po zgjedhin mjete për të penguar në kryerjen e detyrave me përgjegjësi të madhe që t'u kanë besuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Ti i fillove studimet e artit ushtarak me vetëdije të plotë se do të kesh shumë vështirësi dhe pengesa, por përkrahja pa rezervë nga familja dhe nga atdhetari nacionalist dhe mësuesi i atdhedashurisë Metush Krasniqi të dhanë krahë e të dhanë forcë për t'i vazhduar mësimet dhe për ta mësuar artin usharak. Rrugë me plot rreziqe dhe të panjohura por ti ia dole në fund faqebardhë.

E di se nuk e ke pasur lehtë Ahmet Krasniqi t'i fshefësh ndjenjat, qëllimet, dëshirat në mendje dhe në zemër. Nuk e ke pasur lehtë të ruhesh nga sigurimi ushtarak që të përcillte dhe të vështronte çdo ditë.

Por ti ishe i vetëdijshëm se për ta ishe i dyshimtë, pasi që u rrite dhe u edukove në një familje nacionaliste. Xhaxhai yt u bë legjendë e gjallë me qëndresën e tij nëpër malet e Qyqavicës. Ti ishe i vetëdijshëm se duhet të luash rolin e ushtarakut me orientim "projugosllav", se përndryshe detyrat që ia pate shtruar vetes për t'i mësuar fshehtësitë e arti usharak, i shtyrë nga idealet e larta kombëtare, do të binin në ujë. Pengesat e mëdha objektive dhe subjektive i shpartallove me vullnetin tënd të fortë, me karakterin e pathyeshëm, me qëllimet e larta kombëtare. Dëshira e madhe për të mësuar artin ushtarak, nuk ishte dëshirë thjeshtë e një të riu, për një profesin që të kishte lindur rastësisht, por ajo dëshirë e flaktë ishte krijuar nga një qëllim i lartë, për ta luftuar robërinë me dije dhe zotësi ushtarake, për ta nxjerrë hakun në momentin e duhur, për të gjitha të ligat, mjerimet dhe padrejtësitë, që ia sollën popullit tonë çetnikët e Beogradit dhe okupatorët serbo-sllavë.

Ajo kohë erdhi shoku im ushtarak. Na erdhi momenti i duhur, për të cilin aq shumë kanë punuar dhe kanë sakrifikuar shumë gjenerata të popullit tonë trim. Amanetin e dëshmorëve tanë duhet ta kryejmë githsesi. Ti ishe nxënësi i Metush Krasniqit, i atij atdhetari të paepur për çështjen tonë kombëtare, i cili të përkrahu, të udhëzoi e të dha zemër për t'i kaluar pengesat dhe vështëresitë e shumta objektive dhe subjektive, që të dolën përpara, gjatë studimeve dhe pas studimeve. Ai shumë shpresonte se një ditë do t'i tregosh aftësitë dhe përvojën e madhe ushtarake të fituara në akademitë dhe garnizonet e armikut tonë shekullor, për t'i përzënë me turp nga trojet tona hordhitë sllave, duke u dhënë dajakun e merituar për të gjitha ato krime, vuajtje dhe padrejtësi që na i sollën.

E di se ti me tërë qenien tënde, me tërë aftësitë tuaja iu ke përkushtuar çështjes sonë kombëtare. Ti po i kryen detyrat që t'i ka besuar Qeveria e Kosovës dhe ushtarakët e Republikës së Kosovës. E di se nuk e ke lehtë të veprosh sa ke dëshirë dhe sa ke aftësi. Pengesa të shumta të natyrës objektive duhet sa më parë të largohen me përkushtimin tënd dhe përkushtimin e njerëzve kompetentë. Shpresoj se ditë të mira po afrohen për ty, kuadrin ushtarak të Kosovës, për ata atdhetarë trima të UÇK-së, dhe për popullin tonë. Liria po troket në dyert



e çdo shqipari, por Ajo na shtron deyra secilit prej nesh për t'i kryer me përkushtim dhe me përgjegjësi.

*Shkruar më 25.06.1998*

*Botuar në "Java Shqiptare" më 19 korrik 1998 pasi që Pararoja staliniste e LPK-së dhe karrieristët e LBDK-së nëpërmjet shtypit të tyre bënë përpjekje për ta njollosur Ahmet Krasniqin, i cili kryente detyrën e Ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës.*

## KAPITULLI I SHTATË

### VII DIASPORA SHQIPTARE- KRAH I FORT I ÇËSHTJES MADHORE KOMBËTARE

## RIORGANIZIMI I DIASPORES SHQIPTARE NE BAZA KOMBËTARE.

Duhet të jemi të vetëdijshëm për situatën në të cilën po kalon vendi ynë. Çdo pjesë e atdheut tonë është e rrezikuar nga serbo-sllavo-grekët, por më tepër nga vetë shqiptarët. Shteti amë ka halle të mëdha nga varfëria, mafia politike e huaj dhe e vendit, dhe pushtetarë të pazotë e tradhtarë. Çamëria nën sundimin grek është kah jep shpirt. Toplica nuk po përmendet fare nga politikanët tanë edhe pse ajo para 120 vitesh ishte tokë shqiptare. Barbarët grekë dhe serbë i masakruan dhe etnikisht i pastruan këto krahina shqiptare. Serbo-sllavo-grekët me aleatët e tyre po bëjnë çmos të na zhdukin si komb, duke i vënë në veprim skenarët e tyre për ta bërë spastrimin etnik të Kosovës dhe helenizimin e Shqipërisë së Jugut, në planë të parë, dhe asimilimin e pjesëve tjera të Shqipërisë dhe zhdukjen e qenies kombëtare në plan të dytë.

Diasporën shqiptare, që ka mundur të bëhet një krah i fortë i çështjes sonë kombëtare, partiakët e shtirë dhe karrieristët e sëmurë për pushtet e ndanë dhe e përçanë në baza partiake, klanore, ideologjike dhe regjionale për interesa të vogla grupe dhe personale. Vetëm të marrët dhe naivët nuk e kanë sot të qartë se pushtetarët dhe klasa politike shqiptare po i sjellin dëme të mëdha Kombit dhe Atdheut me luftën e tyre për pushtet dhe kolltuqe, dhe kështu, armiq të tanë po i ndihmojnë dhe po iu japin forcë për t'i realizuar planet e tyre antishqiptare pa një mund të madh. Derisa sigurimet e huaja nëpërmjet partiakëve të shtirë dhe tradhtarëve, që i kanë zënë postet udhëheqëse shtetërore, po përgatisin luftë qytetare në Shqipërinë e cunuar, në Kosovë e kanë vënë në veprim skenarin e vitit të kaluar, me të cilin e kallën Shqipërinë dhe e shkatërruan Shtetin shqiptar. Edhe pse është e qartë se serbët dhe aleatët e tyre po ia përgatisin Kosovës kurthën dhe fatin e zi, siç ia përgatitën Toplicës para 120 vitesh, pushtetarët dhe kryepartiakët e Kosovës, janë hallakatur mendësisht dhe helmuar shpirtërisht e nuk po kuptojnë se lufta për pushtet ka kuptim të bëhet vetëm pasi ta përzëmë ariun rus dhe dhelprën plakë nga Kosova. Edhe sa kohë populli i gjorë duhet të presë që ata të merren vesh në mes vedi për ta formuar një Qeveri të përbashkët?! Apo ndoshta po presin një mrekulli që të zgjohet nga varri Anton Çeta për t'i pajtuar e për t'i përkdhelur si kalamajtë e hastretit?!

Deri kur udhëheqësit e Kosovës do të jetojnë në iluzione se Kosova do ta fitojë pavarësinë me patriotizëm verbal, siç po përbehen të gjithë me plotë gojën se janë për pavarësinë e Kosovës, duke harruar se shkau po e përgatit terrenin për ta marrë "hisen që i takon" të Kosovës dhe partiakëve të shtirë t'ua lenë një pjesë të saj të lirë sa për t'u kacafytur mes tyre e për t'u rrasur mejdan.

### **Me porosinë serbe u vranë atdhetarët e mëdhenj**

Kjo tragjedi që po e përjeton kombi ynë është përgatitur që më parë nga armiqtë e kombit tonë, në radhë të parë, duke ia zhdukur fizikisht atij udhëheqësit më të zotë e duke ia vënë në ballë më të paafët apo edhe argatët e tyre për të punuar për ta. Nuk është rastësi që sivjet në Tiranë u pushkatuan me urdhërin e një Qendre antikombëtare, nga dora e zgjatur e Serbisë, dy udhëheqësit më të zotë që i kishte kombi ynë: Azem Hajdarin, që i demaskonte këlyshët e huaj që u bënë altoparlantë dhe argat të sllavo-grekve, dhe Ahmet Krasniqin atdhetarin e flakt, i cili me porosinë e ideologut të Nacionalizmit shqiptar Metush Krasniqit, që ishte shok i tij i ngusht, kishte shkuar për të studjuar artin ushtarak, që në momentin e duhur të vihet në shërbim të Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare. Zhdukja fizike e këtyre Burrave të Dheut i sollën dëme dhe pasoja të mëdha çështjes sonë kombëtare. Shqipërisë po i përgatitet një kob edhe më i madh se ai i vitit që shkoi, ndërsa Kosovës spastrimi etnik, që shkau i shkinës t'i gëzojë pasuritë dhe bagatitë e saj të mëdha. Në këtë gjendje që ndodhet kombi ynë, çdo njeri që ka vetëdije njerëzore dhe kombëtare, nuk mund ta bëjë gjumin e qetë dhe t'i gëzojë të mirat shpirtërore dhe materiale që ia ka dhuruar i Madhi Zot, kur çdo ditë parakalojnë para syve njerëz të masakruar, sy fëmijësh të trishtuar nga tmerret e luftës, njerëz me halle të mëdha pa kulm mbi kokë e pa kafshatën e bukës.

### **Të ecim gjurmëve të organizimit të komuniteteve të tjera**

Për ne mërgimtarët e gjerë, që për shkaqe ekonomike apo politike u larguam nga vendlindja dhe muarëm rrugët e botës në sy, duke i rrezikuar pasardhësit tanë nga një asimilim i plotë, mund të bëjmë një punë të madhe, që së paku të krijojmë një bazë të shëndoshë e cila do ta

ndihmonte rininë tonë t'i përballojë asimilimit, siç po i përballon me sukses komuniteti izrealit, italian, spanjoll, portugez etj. Njerëzit që kanë arsye të shëndoshë e mendje të kthjellët, marrin përvojën e të tjerëve për tejkalimin e problemeve që u lindin, apo thjeshtë, për të arritur zhvillim ekonomik dhe mirëqenie e begati. Po pse ne që, së paku, jetojmë në Evropën Perendimore mos ta shfrytzojmë përvojën e komuniteteve tjera që u detyruan si ne shqiptarët të gjejnë punë e strehim jashtë atdheut të tyre. Pse nuk e marrim shembullin e jahudive, që në të gjitha vendet e botës i rezistuan asimilimit, duke i krijuar lokalet e tyre të dëfrimit dhe argëtimit, lokalet e punës dhe afarizmit, institucionin e arsimimit dhe edukimit, krijuan mekanizmin e ndihmës dhe solidaritetit vëllazëror në mes tyre.etj.

Për t'i arritur objektivat që i arriti komuniteti izrealit, intelektualët dhe veprimtarët atdhetarë, kudo që gjenden jashtë atdheut, duhet të organizohen në rradhë të parë për ta riorganizuar Diasporën shqiptare, dhe për ta vënë në baza të shëndosha kombëtare, duke i formuar Bashkësitë (Komunitetet) Shqiptare në të gjitha vendet ku gjetën strehim. Vetëm Bashkësia Shqiptare e udhëhequr nga intelektualë dhe veprimtarë atdhetarë, të painfektuar nga helmet e ideologjive të huaja, të paprekur nga sëmundjet karrieriste për pushtet, mund ta kryejnë një detyrë sa të rëndësishme aq edhe të shenjtë, siç është bashkimi i shqiptarëve në baza kombëtare, humanitare dhe solidare, pa dallim bindjesh politike dhe besimit fetar.

Nuk është punë e lehtë të shërohen plagët që ia shkaktuan kombat dhe diasporës klasa politike shqiptare në përgjithësi dhe partiakët e shtirë në veçanti, por me një punë vetëmohuese, me një bashkëpunim vëllazëror, me një tolerancë demokratike ndaj bashkëbiseduesit me botëkuptime e bindje të ndryshme, do të arrihen objektivat e formimit të Lobit Shqiptarë në tërë globin tokësor.

Në Australi ka dhjetë vjet që funksionon Komuniteti Shqiptaro-Australian. Në Amerikë, edhe pse e goditën për vdekje Lobin shqiptar partiakët e shtirë të Kosovës, po forcohet dhe po funksionon me sukses në krye me atdhetarin në zë zotëri Dioguardin. Lidhja Shqiptare po konsolidohet dhe po vepron në Kroaci dhe Itali. Bashkësitë Shqiptare kanë filluar të lindin në Gjermani, Belgjikë, Suedi etj. Komunitetet Shqiptare po organizohen në Austri, Angli dhe- që nga viti i kaluar- në Zvicër. Në muajin shtator të këtij viti u themelua në Zvicër Këshilli

Themelues i Komunitetit (Bashkësisë) Shqiptar, i cili po bënë një punë të mirë në riorganizimin e Diasporës shqiptare në baza kombëtare. Edhe pse organizimi i shqiptarëve në baza kombëtare po bëhet me emra të ndryshëm, qëllimi dhe synimet janë të njëjta, që Diaspora shqiptare ta luajë rolin që i takon, për t'u bërë një krah i fortë i çështjes sonë kombëtare, dhe shqiptari të gjallërojë në tërë globin tokësor duke i ruajtur vlerat e tij kombëtare, duke i ruajtur traditat, zakonet dhe gjuhën e tij të bukur, duke e mbajtur të gjallë dashurinë për atdheun dhe vendlindjen, për të pasur të drejtë të jetë krenar për prejardhjen e tij të lashtë dhe fisnike.

*Botuar: "Bota sot", më 30 dhjetor 1998; "Drita.nr.24.1999*

## DIASPORA SHQIPTARE NË MOÇALIN E PARTIAKËVE

Se organizimi i diasporës shqiptare në baza partiako-ideologjike dhe regjionale u tregua i dëmshëm dhe i kobshëm për çështjen tonë kombëtare e kanë të qartë të gjithë, përpos partiakëve të sertë e të shtirë, të cilët janë të verbëruar nga interesat e tyre partiake, lokale dhe klanore. Formimi i degëve të partive shqiptare në Evropën Përendimore në Amerikë dhe Australi, së pari i LDK-së e pastaj edhe i degëve të partive tjera të Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare, krijuan kushtet dhe terrenin që shqiptarët kudo që gjenden jashtë atdheut të përçahën dhe të ndahen jo vetëm në baza regjionale, ashtu siç na kan ndarë armiqtë tanë shekullorë me ndihmën e pakursyer të Ruisë dhe aleatëve të saj, por shqiptarët u përçanë edhe në baza partiake, dhe kështu diaspora shqiptare- në vend që të luajë atë rolin që i takon, të jetë një krah i fortë i Kosovës, i Viseve tjera shqiptare dhe i shqipërisë,- u bë një moçal i partiakëve të sertë e të shtirë, i karrieristëve të sëmurë për pushtet, për të nxjerrë përfitime për interesa të tyre partiake, lokale, klanore dhe personale.

Siç dihet, para se të rrëzohen diktaturat e kuqe, në diasporën shqiptare u bënë përpjekje të mëdha nga atdhetarë dhe prijës të Lëvizjes sonë kombëtare, që atëherë vepronte në ilegalitet të plotë, për ta formuar një Organizatë të fortë kombëtare, që të jetë e aftë dhe e zonja në momentin e duhur, t'i prijë popullit tonë në betejën përfundimtare, që do të çonte në çlirimin e Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me Nënë Shqipëri.

Atentati i kobshëm në afërsi të Shtutgartit më 17 janar 1982, ua mundësoi pararojës komuniste dhe partiakëve të shtirë e të sertë për t'i marrë frejt e Lëvizjes në duart e veta. Shkrimi i tri organizatave (LNÇKVSHJ, PKMLSHJ dhe OMLK), në një organizatë të vetme në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ) nuk pati jetë të gjatë. Pararoja staliniste dhe partiakët e sertë shumë shpejt e përçanë anëtarësinë e LRSHJ duke i krijuar tri organizata: "Lëvizjen me adresë". "Lëvizjen pa adresë" dhe "Komitetin". Me rrëzimin e diktaturës staliniste në Shqipëri, u krijuan kushtet që atdhetarët, veprimtarët dhe intelektualët e dalluar t'i bashkojnë të gjitha forcat intelektuale, njerëzore dhe materiale të diasporës shqiptare në një qendër komanduese dhe

organizative, që Lëvizja jonë kombëtare të forcohej dhe aftësohej për ta kryer detyrën që i takon asaj, për ta çuar në vend amanetin e heronjve dhe dëshmorëve tanë: çlirimin dhe bashkimin kombëtar. Pasi kjo detyrë e rëndësishme nuk u krye, partiakët e sertë nuk e patën vështirë t'i formojnë degët e partive të tyre në Evropën Perindimore, në Amerikë dhe Australi, në radhë të parë për përfitime materjale, duke mos menduar fare për pasojat që do të lindin me një organizim të tillë partiak dhe regjional.

Që në fillim rivaliteti në mes LDK-së dhe LPK-së (pa adresë), u bë i ashpër. Strategjia e LPK-së për ta shkatërruar LDK-në duke e marrë "kalanë nga brenda" dështoi. Dështoi po ashtu, edhe e ashtuqytura "marrëveshje" e të ashtuquajturave "subjekteve" shqiptare për t'i kordinuar së bashku aksionet e përbashkëta me karakter kombëtar. Lufta për terren dhe anëtarë u bë e ashpër, veçmas në mes LDK-së dhe LPK-së. Edhe demonstratat, tubimet informative dhe tubimet përkujtimore për dëshmorët tanë filluan t'i bëjnë ndaras. Ky degjenerim i "subjekteve" shqiptare solli përçarje dhe ndasi të mëdha jo vetëm në radhën e bashkëvendasve por edhe në mes të shokve të idealit, që as UDB-ja jugosllave nuk kishte pasur sukses t'i përçante sa ishin nëpër burgjet jugosllave. Si rrjedhojë e kësaj lufte të pakompromis në mes "subjekteve" shqiptare dhe klaneve të tyre, diaspora shqiptare u nda dhe u përça në baza partiake, regjionale dhe klanore. Kjo situatë ndikoi që shumë veprimtarë, intelektualë dhe atdhetarë të largohen nga të ashtuquajturat "subjekte" shqiptare pasi e kuptuan se mundi dhe puna e tyre nuk po e ndihmonte çështen kombëtare, por interesat partiake, klanore dhe personale të karrieristëve të sëmurë për pushtet. Me largimin e veprimtarëve të dalluar, veçmas nga LDK-ja dhe LPK-ja, nga radhët e këtyre partive u larguan edhe shumë anëtarë të tyre. Për fatin tonë të keq, në vitin që shkoi, kur pritej vdekja e qetë e këtyre dy partive dhe partive tjera jashtë atdheut, Shqipërinë e për lau dhuna bolshevike. Social-komunistat e kallën Shqipërinë dhe e zhdukën shtetin shqiptar. Ardhja në pushtet e klikës tradhtarë të Fatos Nanos, bëri që marksistë-leninistët e Kosovës dhe të Viseve të tjera shqiptare, veçmas në Evropën Perendimore, ta rrisin aktivitetin e tyre. Në radhët e LPK-së përsëri kthehen enveristët e luhatshëm, të cilët më parë ishin larguar. Në këtë organizatë-parti hynë edhe atdhetarë të dëshmuar më herët, por që nuk ishin zhblllokuar nga dogmat marksiste-leniniste. Fatkeqësisht ata ende



nuk janë në gjendje të kuptojnë se çfarë dëme na solli ajo ideologji e djallit të mallkuar, që Popoviqët dhe Mugoshët e mbollën në trojet tona. Ata edhe sot nuk po e kuptojnë se të përkrahet moralisht dhe materialisht kallja e Shqipërisë dhe zhdukja e shtetit shqiptar, të përkrahet banda tradhtare e Nanos, të cilën e prunë në pushtet armiqtë tanë shekullorë dhe aleatët e tyre, është tradhti kombëtare, e jo veprimtari kombëtare, siç mundohet ta tregojnë klani pararoj i LPK-së. Në anën tjetër, veprimtarët e paktë që gjendeshin në LDK-në, në vend se të largoheshin nga ajo parti për t'u bashkangjitur me veprimtarë tjerë, që më herët e kishin kuptuar se në vend të organizimit partiak dhe regional të diasporës shqiptare duhej bërë organizimin e mirëfilltë kombëtarë, e dyfishuan aktivitetin e tyre për ta ringjallur këtë parti, duke shpresuar në ëndrra të kota se me marrjen e "kalasë nga brenda" do të bënin një punë me rëndësi kombëtare, duke harruar faktin se ajo strategji u tregua e pasuksesshme, edhe kur u provua më heret nga LPK-ja. Vlenë të veçohet aktiviteti i pararojës komuniste të LPK-së, e cila me zhurmën e saj të madhe, kinse të përkrahjes morale dhe materiale UÇK-së, po mundohet ta përmirësojë imazhin e saj të rrëzuar për toke për përkrahjen e pa rezervë të kriminelëve në Tiranë dhe veprimtarinë e tyre të mëhershme. Ata po i sjellin dëme të mëdha UÇK-së, duke rrahur gjoks se ajo është krahu ushtarak i saj. Fatëmirësishtë UÇK-ja me komunikatën e saj të 02.01 të këtij viti hoqi çdo dilemë se ajo është e varur nga LPK-ja apo nga " subjektet " tjera shqiptare, duke ua tërhequr vërejtjen e fundit të gjithë atyre që po çojnë pluhur dhe po bëjnë zhurmë duke rrahur gjoks se ata janë të autorizuar të flasin në emër të saj.

Këto rrethana po ndikojnë që diaspora shqiptare të dergjet në moçalin e partiakëve të sertë, duke mos mundur ta kryejë detyrën që i takon asaj. Ndërkaq veprimtarë të shumtë kanë mbetur si kurriat në mjegull kur e humbin udhën dhe nuk dinë kah t'ia mbajnë. Ata e mallkojnë këtë organizim të prapshtë, që po çon ujë në mulli të shkaut, por janë të pafuqishëm ta ndërrojnë këtë situatë dëshpëruese dhe tejet të mjerë. Çka të thuhet për mosveprimin e tyre: kanë frikë nga partiakët e sertë apo ndoshta presin mëshirën e tyre për të urdhëruar shuajen e degëve, pipave dhe rrembave të partive të tyre?! Një gjë e tillë nuk duhet pritur nga ata, sepse organazimi i diasporës shqiptare në baza kombëtare, do të ishte kundër interesave të tyre të ngushta partiake dhe klanore.

## **UÇK-ja BËRI QË BOTA TA MARRË MË SERIOZISHT ÇËSHTJEN E KOSOVËS**

Viti që shkoi i solli kombit tonë tragjedinë më të rëndë, pas kasaphanës së Ambasadorëve në Londër, që na i copëtuan trojet tona pa mëshirë. Viti i anomalive dhe tronditjeve të mëdha shqiptare, për habinë e shumë analistëve, i solli Kosovës prishjen e status-quosë e cila ishte vdekjeprurëse për çështjen tonë kombëtare. Lindën dhe u forcuan: 1. Lëvizja studentore për rimarrjen e objekteve shkollore, dhe 2. Dalja në skenë e UÇK-së, forcës më të organizuar dhe më serioze për ta vazhduar traditën e rezistencës sonë shekullore për çlirim dhe bashkim kombëtar. UÇK-ja, si forcë e pavarur nga partitë politike, i tregoi Serbisë dhe qendrave të vendosjes ndërkombëtare se populli ynë do t'i përdorë të gjitha mjetet, pra edhe ato luftarake, po që se ato nuk heqin dorë nga qëllimet e tyre djallëzore që Kosova dhe Viset tjera shqiptare të mbeten nën sundimin sebo-sllav. Po ashtu UÇK-ja bëri që faktori i jashtëm ndërkombëtar ta marrë seriozisht çështjen e Kosovës, ndërsa popullit tonë i çeli rreze shprese se liria po afrohet, ndërsa te okupatori gjakatar krijoi huti dhe frikë. Është për t'u habitur që kryepartiakët e sertë të partive shqiptare ende po punojnë në mënyrën e deritashme shatërvjeçare "dikush thumbit, dikush patkonit" dhe ende nuk janë vetëdijësuar për fajet e tyre të mëdha, që Lëvizjen tonë kombëtare e sollën në këtë gjendje të mjerë. Përçarjet ndërpartiake, aferat e ndryshme dhe luftërat klanore e kanë degjeneruar dhe e kanë plagosur për vdekje Lëvizjen tonë kombëtare. Fatmirësisht lindja e forcave të reja në Kosovë, patjetër do t'i hudhë jashtë përdorimit mekanizmin hipnotizues-vetëmashrues dhe monopolin e Parisë "sokoleshë" dhe kryepartiakëve falltorë. Kjo thyerje do të sjellë ngrirjen cilësore të rezisencës gjithëpopullore dhe daljes në skenë të prijësve popullorë, që do ta çojnë në vend amanetin e heronjve dhe dëshmorëve tanë.

Me prishjen e status-quosë në Kosovë ka qenë e natyrshme të prishej ajo edhe në diasporë, çka do të sillte formimin e Bashkësisë shqiptare dhe armën e fuqishme prej gjysmë milioni njerëzish ta bënte kapital të fuqishëm për çështjen tonë kombëtare. Një pjesë e veprimtarëve dhe intelektualëve po bëjnë sehir, duke qenë indiferentë ndaj çështjes kombëtare, një pjesë tjetër duke hyrë në radhën e "subjekteve" politike shqiptare po u japin kredibilitet forcave të sëmura për pushtet, stalinistëve dhe spiunëve të llojllojshëm, për ta luajtur lojën e armiqve tanë

shekullorë, për ta bërë diasporën tonë të vdekur përsa u përket interesave të vërteta kombëtare.

Në rrethanat në të cilat gjendet kombi ynë dhe kriza e thellë që e ka kapluar në të gjitha aspekte e jetës nuk i japin të drejtë askuj të veprojë me papërgjegjësi. Çdonjëri që është i gatshëm që me dijeni dhe aftësitë e tij të kontribuojë për ta ndërruar këtë gjendje të mjerë, jo vetëm me këshilla por edhe me punë konkrete, duhet t'i njohë mirë shkaqet që na prunë në këtë gjendje të vështirë, në këtë kaos idesh dhe veprimesh, duke bërë përpjekje që pasojat t'i luftojë dhe t'i asgjësojë me mundësitë që ka, pa u kursyer dhe pa u frikësuar nga faktorët që i krijuan ato.

Sot kur kombit tonë po i kanosej ekzistenca e tij nga armiqtë tanë shekullorë, kur Shteti ynë amë u shkatërrua dhe tani ëshë në duar të spiunëve greko-sllavë, çdonjëri që ka logjikë dhe vetëdije të shëndoshë kombëtare, duhet të mendojë seriozisht duke e rivlerësuar punën e tij të deritashme, se çka bëri për çështjen tonë kombtare? Puna e tij e ndihmoi apo e pengoi organizimin tonë në baza të shëndosha kombëtare?! I ndihmoi apo i pengoi partiakët e shtirë e të sertë në përçarjet, grindjet dhe mosmarrveshjet që i krijuan ata gjatë këtyre shtatë vjetëve të fundit? Është njerëzore që njeriu të gabojë, por, po ashu ëshë shumë njerëzore edhe të pendohet kur të gabojë, dhe të bëjë përpjekje që gabimet t'i përmirësojë. A nuk ishte gabim trashanik dhe me pasoja të rënda, organizimi i diasporës tonë në baza partiake dhe regjionale?! Më në fund a nuk u tregua se ai organizim yni ishe i prapshtë, i dëmshëm dhe me pasoja të rënda për çështjen tonë kombëtare.?!  
**BASHKËSIA SHQIPTARE DO T'I SHËRONTE TË GJITHA PLAGËT TONA**

Ëshë e ditur se diaspora shqiptare ka luajtur rol me rëndësi në të gjitha Lëvizjet politike dhe kulurore të popullit tonë. A thua vallë, kjo gjeneratë e diaspores shqiptare, e cila numerikisht përbën një të katërtën e popullsisë së Kosovës, dhe përbënë një forcë kolosale, po të jetë e organizuar në baza të shëndosha kombëtare nuk do ta kryente deyrën që i takon, për t'u bërë një shtytës i fortë dhe fakor i fuqishëm për realizimin e synimet tona kombëare?! Mosriorganizimi i diaspores shqiptare në baza kombëtare deri në vitin që shkoi nuk u bë për shkaqet e ditura të politikës së Parisë tonë të madhe dhe partive tjera "prit gomar sa të del bar". Por, me prishjen e status-kuosë në Kosovë patjetër duhej të bëhej prishja e saj edhe në diasporë. Këtë ndryshim cilësor të organiziomit të diasporës sonë

nuk do të na bëjnë të huajt, pra as jahuditë e as grekët etj, por as partiakët karrieristë të sëmurë për pozia e pushtet dhe as spiunët e armiqve tanë. Atë duhet ta kryejnë në radhë të parë atdhetarët, veprimarët, intelektualët dhe të gjitha ato shtresa të popullsisë shqiptare, që e kanë kuptuar se organizimi në baza pariake dhe regjionale duhet sa më parë të vdesë. Kjo do të arrihet po qe se atdhetarët, veprimtarët dhe intelektualët dalin sa më parë nga burgjet pariake ku vullnetarisht janë mbyllur, duke i lënë nëpër parti vetëm partiakët e shirë e të sertë dhe karrieristët e sëmurë për pushtet dhe pozita. Dalja e tyre nga burgjet pariake do të krijonte kushte që veprimtarët, atdhetarët dhe intelektualët e diasporës shqiptare të organizohen për ta bashkuar diasporën tonë në baza të shëndosha kombëtare, duke e bërë Bashkësinë Shqiptare, të vetmen Qendër politike dhe organizative, për të gjithë shqiptarët jashtë atdheut.

Përçarjet e deritashme të krijuara nga partiakët e shtirë, karrieristët dhe spiunët e ndryshëm, do t'i tejkalojmë. Nuk do ta njohim copëtimin e tokave tona nga Kasapët e Kasaphanës së Londrës, as copëtimin e Viseve tona nga Kasapët sllavë, që partiakët e shtirë dhe karrieristët e sëmurë për pushtet i njohën dhe në ato baza na ndanë e na përçanë. Bashkësia Shqiptare do t'i tejkalonte këto përçarje dhe do të luante rolin që i takon, për hir të çështjes sonë kombëtare, për hir të Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare, për hir të Nënës Shqipëri, për hir të shumë gjeneratave që me mund dhe gjak të derdhur rrëkë na i ruajtën trojet tona, për hir të heronjve dhe dëshmorëve tanë, për hir të pasardhësve tanë, që mos t'i lëmë pa liri, pa atdhe, pa ardhmëri, pa krenari kombëtare, të shpërndarë nëpër rrugët dhe metropolet e botës.

Do t'i harrojmë të gjitha mosmarrëveshjet, ngatërresat dhe përçarjet që krijuan në mes nesh partiakët e sertë, karrieristët e sëmurë për pushtet dhe spiunët e ndryshëm, për të cilët karriera dhe interesi personal vjen mbi interesa kombëtare. Bashkësia Shqiptare me sukseset që do të arrinte ajo do t'i shëronte të gjitha plagët tona. Ajo do të bëhet faktori më i rëndësishëm për ta shëruar Lëvizje tonë kombëtare nga helmet e partiakëve falltorë dhe klaneve të tyre për dominim, manipulim dhe mashtrim. Ajo do të rilindte energjitë e shterura shqiptare. Ajo do ta rikthente krenarinë tonë kombëtare të fjetur. Ajo do të bënte mrekullira, po qe se formohet me përkushtimin më serioz të forcave të shëndosha kombëtare, të atdhetarëve të dëshmuar, intelektualëve dhe veprimtarëve, që interesin kombëtar kurdoherë e kanë mbi atë partiak, personal dhe

lokal-regjional. Bashkësia Shqiptare do të ishte qendra e vetme e disporës shqiptare që do të kujdesej për çdo bashkëkombas të saj. Çdonjëri do t'i kryente detyrat që di dhe mund t'i kryejë më së miri.

Gjendja në të cilën gjendet sot kombi ynë, nuk na lejon të pajtohemi me këtë organizim të prapshhtë që na e krijuan partiakët e sertë, duke na përçarë e duke na bërë pikë e pesë. Prandaj, është detyrë parësore dhe domosdoshmëri për atdhetarë, veprimtarë dhe intelektualët e shumtë, që sot gjenden jashtë atdheut, t'i bashkojnë radhët, mendimet, përpjekjet dhe veprimet për formimin sa më parë të Bashkësisë Shqiptare në të gjitha vendet ku gjenden shqiptarët jashtë atdheut. Vetëm Bashkësia Shqiptare do të jetë në gjendje të bëjë bashkimin e shqiptarëve jashtë atdheut (diasporën tonë) në baza të shëndosha kombëtare, në ç'mënyrë edhe do të luante rolin e saj që i takon, bashkimin e të gjitha forcave tona intelektuale, njerëzore dhe materiale, për t'u bërë një krah i fortë i çëshjes sonë kombëtare, për arritjen e aspiratave shekullore të popullit tonë, për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar.

*Shkruar më 24.01.1998.*

*Botuar: "Euro zëri" më 17.04.1998.*

## DIASPORA SHQIPTARE NUK DUHET TË TJETËRSOHE

Diaspora shqiptare luajti rol me rëndësi në të gjitha periudhat e rëndësishme të historisë sonë më të re. Ajo edhe tash e tutje duhet ta luajë rolin që i takon për t'u bërë një krah i fortë i çështjes sonë kombëtare. Detyrat e saj janë të shumta, por të pa realizueshme po qe se ajo nuk organizohet në baza kombëtare. Në dhjetëvjetshin e fundit të shekullit të 20-të ajo, edhe pse kreu shumë punë me rëndësi kombëtare, nuk qe e aftë t'i kryente edhe shumë detyra që i takonin për arsye se ishte e copëzuar në baza partiake dhe regjionale. Me çlirimin e Kosovës diaspora, në vend se të gjallërohet dhe të riorganizohet në baza kombëtare, ajo ka filluar të tjetërsohet pasi që shumica e mërgimtarëve kanë filluar të mirren vetëm me punët e tyre personale e familjare. Kuptohet se Kosova ëshë plagosur rëndë nga barbarët serbë dhe një pjesë e madhe e popullsisë së saj po mundohet t'i shërojë plagët e luftës. Shumë familje gjatë luftës kanë humbur të dashurit e tyre, kanë humbur shtëpi e pasuri. Kuptohet që mërgimtarët kanë detyrë parësore t'i ndihmojnë familjet dhe të afërmit e tyre, por shumë familje nuk kanë askend të punësuar jashtë vendit. Ato jo vetëm që kanë hallin e banimit por kanë hallin e mbijetesës fizike, sepse iu mungojnë gjërat elementare të jetesës. Më së keqi kanë mbetur familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës dhe pensionistët, për të cilët interesimi i shoqërisë shqiptare nuk është i mjaftueshëm. Edhe pse dëshmorët dhe familjet e tyre po "mbrohen" nëpër tubime përkujtimore, në ndeja dhe biseda të rastit ato kanë mbetur në mëshirën e individëve me zemër të madhe dhe shoqatave të huaja humanitare. Nënë Tereza dhe ca shoqata tjera të vogla humanitare të shqiptarëve të Kosovës nuk kanë mundësi t'i përthekojnë të gjitha nevojat e shqiptarëve të Kosovës që kanë nevojë për ndihma humanitare. Ka ardhur momenti që Kosova, Shqipëria dhe Viset tjera shqiptare të ndërmarin aksione të përbashkta në nivel kombëtar, e njëra ndër to është që sa më parë të jetësohet formimi i një fondacioni i cili do ta merrte barrën e kujdesit për familjet e dëshmorëve, për jetimët dhe invalidët e luftës dhe skamënorët në gjithë hapsirën kombëtare. A nuk u treguan shqiptarët e Shqipërisë solidarë me popullin vëlla të Kosovës kur Serbia me terror e largoi nga Kosova për ta bërë pastrimin etnik të saj. A nuk u treguan vëllezërit tanë që jetojnë në viset e tyre në

Maqedoni solidarë dhe dorëshlirë ndaj vëllezërve të tyre në Kosovës dhe në Shqipëri çdo herë kur u kërkua ndihma e tyre.

Populli shqiptar është human dhe zëmërgjerë, por fatëkeqësishtë ka një të metë të madhe, mosaftësinë për t'u organizuar. Po qe se shqiptarët arrijnë ta formojnë një fondacion për ndihma humanitare në nivel kombëtar, problemet sociale do t'i tejkalojmë si është më së miri, dhe do të bëhen hapa të rëndësishëm për organizime tjera, që do të çonin në krijimin e kushteve që shqiptarët si komb të bëjnë edhe shumë punë tjera të mbara. Mendojmë se Krijimi i Fondacionit "Japim për Zotin" në Kosovë, Shqipëri, në Viset tjera shqiptare dhe në diasporë, që do të qeverisej nga njerëzit më autoritativë të shoqërisë shqiptare, do të krijonte një institucion mbarëkombëtar, i cili do të kujdeset për çdo familje dhe individ që i mungojnë mjetet e jetesës për të pasur një jetë normale. Familjet e dëshmorëve e të masakruarëve (martirëve), jetimët dhe invalidët e luftës në Kosovë dhe skamnorët në gjithë hapësirën kombëtare do të jenë nën kujdesin e atij Fondacioni. Po qe se në atë Fond çdo vit kryefamiljarët do të derdhnin së paku 10 DM, 10 FS, apo 10 dollarë për anëtarët e familjes së tyre, ndërsa pasanikët sipas mundësisë dhe zemrës, Fondacioni "Japim për Zotin" do t'i kryente me sukses detyrat humanitare në gjithë hapësirën tonë kombëtare. Po qe se ky organizim do të ketë sukses, rëndësia e tij do të jetë e shumëfishtë, pasi që do të jetë një shtytës i fortë i organizimeve tjera në nivel kombëtar, që do të sillte perparime në të gjitha fushat e jetës, por edhe begati dhe paqë në çdo familje shqiptare.

Shqiptarët nuk guxojnë të tjetërsohen si individ dhe si komb. Solidariteti ndërnjerëzor i tyre ka qenë i fortë gjatë shekujve. Ai luajti rol me rëndësi në ruajtjen e qenies sonë kombëtare, prandaj duhet të vazhdohet dhe të forcohet se është vrytyt yni kombëtar. Edhe sot kur shqiptarët në gjithë hapësirën e tyre kombëtare po ballafaqohen me probleme të shumta të jetesës, solidariteti për ta ndihmuar njëri-tjetrin është i ngulitur në shpirtin e tyre, por sa më parë duhet krijuar institucioni ku shqiptari ta ketë besimin, që mjetet e tubuara do të shkojnë në vendin e duhur për çka edhe janë mbledhur.

*Shkruar më 27.11. 2000.*

*Botuar : "Bota sot", më 21 maj 2002.*

## NDIHMA VËLLAZRORE KA QENË, DHE DUHET TË JETË VIRTUT YNI KOMBËTAR

Populli ynë gjatë historisë së tij të gjatë ka pasur shumë vështirësi dhe pengesa të natyrave të ndryshme, por në sajë të këmbëngulësisë së tij për të ecur përpara drejt zhvillimit dhe përparimit, arriti t'i kapërcejë shumicën prej tyre. Duhet cekur se ai me sukses i shpëtoi zhdukjes dhe asimilimit, për të cilën punuan me purkushtim dhe me të gjitha mjetet çakajtë e Ballkanit të ndihmuar nga Rusia Cariste dhe BRSS-ja komuniste. Sot, edhe pse nuk i kemi punët ashtu siç është dashur t'i kemi, prapëseprapë jemi kombi me perspektivën më të mirë për të qenë faktori politik dhe ekonomik kryesor i Gadishullit Ilirik, në sajë të kushteve që na i ka dhuruar i Madhi Zot. Jemi populli më i ri i Evropës. Kemi pozitë gjeostratigjike të shkëlqyeshme. Kemi klimë dhe bukuri natyrore të mahnitshme. Kemi pasuri nëntokësore e mbitokësore të mjaftueshme, që po të shfrytëzoheshin si duhet, shqiptarëve dhe qytetarëve të tjerë që jetojnë në trojet tona do t'ua siguronin një jetë të begatshme dhe të lumtur, ashtu siç i ka hije njeriut.

Siç dihet kombi ynë është në udhkryqin e tij historik. Se cilën rrugë do ta marrë ai, rrugën e shpëtimit apo të greminës, rrugën e përparimit, apo të kaosit, rrugën e drejtë që qonë përpara apo rrugën pa krye që na lë të vendnumrojmë, veret prej veprimtarisë së gjërë të shoqërisë shqiptare si tërësi. Rol vendimtarë për suksesin e shoqërisë shqiptare duhet të luajnë veprimtarët e lëmenjve të ndryshëm dhe qytetarët që kanë vetëdije të shëndosh kombëtare, politike dhe fetare. Këto forca të përparimit që gjenden në të gjitha qelizat e shoqërisë shqiptare (në familje, subjekte politike e shtetërore, arsimore, kulturore etj) po qe se organizohen dhe veprimtaria e tyre drejtohet në realizimin e qëllimeve të caktuara (të vlefshme) shoqërore, sukseesi nuk do të mungojë.

Fatkeqësisht, pas çlirimit të Kosovës po bëhet tjetërsimi i shqiptarëve me të madhe. Po merr kah tragjik ndarja e shqiptarëve në baza politike, ekonomike dhe regjionale! Joprofesionalizmi, karrierizmi dhe interesat personale të një pjese të lidershipit shqiptar po i dëmtojnë shumë interesat madhore kombëtare. Xhambazët politik dhe klanet e tyre, në sajë të punëve të pista, mbrenda natës u bënë pasanikë të Kosovës. Shtresa më e madhe e popullësisë me djersën e ballit dhe me një mund të



madhë po arrin ta sigurojnë ekzistencën. Fatkeqësisht, një pjesë e madhe e popullësisë, si jetimët, familjet e dëshmorëve dhe familjet e të masakruarëve (martirëve), invalidët e luftës, pensionistët, minatorët, skamnorët dhe individë të shtresave të ndryshme të popullësisë po vuajnë për gjërat elementare të jetesës.

### **Kombi ynë është madhshtor, kur ai është i organizuar për punë dhe vepra të mira**

Shtrohet pyetja : Në këto kushte dhe rrethana tejet të vështira për kombin tonë, a mund të bëjmë ndryshime cilësore në tejkalimin e këtyre vështirësive dhe problemeve të mëdha sociale që na kanë kapluar? Përgjigjja do të ishte pozitive, vetëm nëse veprimtarët që gjindën në të gjitha qelizat e shoqërisë shqiptare punojnë me përkushtim punën që dinë ta kryejnë më së miri. Përdërisa nuk bëhet realizimi i synimeve tona kombëtare, atdhetarët e kanë frontin e hapur të veprimit legal-institucional. Ata duhet të bashkohen kudo që janë për të krijuar front të përbashkët veprimi, për të bërë pengimin e bashkimit të hajnave dhe kriminelëve nën maskën e "patriotizmit". Ata kanë për detyrë t'i demaskojnë me fakte plangëprishësit e kombit shqiptarë kudo që janë, dhe kushdo qofshin ata, pa ngurim dhe pa frikë. Ata kanë për detyrë të bashkohen(sepse vetëm të bashkuar bëhen të fortë) për të marrë aksione të ndryshme rajonale dhe gjithëkombëtare. Siç dihet, populli ynë e ka luftuar gjithmonë të keqen dhe të ligën duke marrë aksione të rëndësishme kombëtare. Me këtë rastë duhet cekur disa prej tyre që u kryen pas viteve të "90-ta. Siç dihet kur Kosova i formoi themelet e shtetësisë së saj, serbo-jugosllavët i larguan nga puna po thuajse të gjithë shqiptarët e Kosovës. Zemra e madhe shqiptare nuk i la pa bukë familjet që nuk kishin pasur rezerva të ushqimit.

### **Kosova të mos gjunjëzohet nga skamja dhe uria**

Vëllazërit tanë nga Maqedonia, Presheve dhe Bujanofci i zbrazën hambarët dhe koshet e tyre. Drithi dhe mielli i tyre u nda së bashku me vëllazërit e tyre nga Kosova. Veçmas rol me rëndësi luajti diaspora shqiptare. U hapën shumë shoqata humanitare për t'i ndihmuar minatorët trima që e mbrojtën çështjen kombëtare me grevën e urisë në zgafellat e

punës. U krijua shoqata "Familja ndihmon familjen", për t'i ndihmuar familjet që nuk kishin askënd të punësuar jashtë vendit. U formuan edhe shumë shoqata të tjera, kontributi i të cilave së bashku bëri që Kosova të mos gjunjëzohet nga skamja dhe uria që kishte palanifikuar okupatori, duke u mbështetur në thënjen popullore "Skamja të çon në derë të hasmit". Duhet cekur se populli i varfër i Shqipërisë e habiti botën me solidaritetin e tij të padëgjuar më parë, kur ia hapi dyert e shtëpive popullit të Kosovës. Edhe kthimi i shpejtë i shqiptarëve të përzënë nga ushtria dhe policia serbe, pas çlirimit të Kosovës, ishte madhështor, siç është madhështor kombi ynë kur ai është i organizuar për punë dhe vepra të mira. Edhe rindërtimi i Kosovës u bë i shpejt dhe u pëlqye nga të huajt.

**ATDHEUT I DUHET SOT MË SHUMË SE KURRË NDIHMA E DIASPORËS**

Por, fatkeqësisht, të gjithë njerëzit nuk i kanë aftësitë, dijen dhe mundësitë për të ecur vet, pa ndihmën e shoqërisë, përpara. Dhe, sot o kurrë, bie një barrë e rëndë mbi shqiptarët që i Madhi Zot ua ka dhënë mundësitë dhe kushtet për të siguuruar të mira materjale të mjaftueshme për familjet e tyre, që një pjesë të atyre të mirave t'ua ndajnë familjeve që nuk kanë kushte elementare për të jetuar. Duhet të na mbetet kafshata në fytë kur e dimë se sot me mijëra nëna shqiptare në Kosovë, Maqedoni dhe Kosovës Lindore, përmeqaten nga halli se nuk i kanë as gjerat elementare të jetesës për t'i rritur fëmijët e tyre jetimë, që ua lanë amanet për t'i ruajtur burrat e tyre kur u bënë ushtarë të UÇK-së, apo kur u rrëmbyen për t'u vrarë vetëm pse nuk ishin si ta (me kombësi apo me bindje politike). Shqiptarët dhe shqiptaret, të zotët e shtëpisë dhe zonjat e shtëpisë, burrat dhe gratë, djelmoshat dhe vashat, pleqtë dhe plakat që e gëzojnë jeten me plot të mira, apo i kanë gjërat elementare të mjaftueshme për jetesë, nuk duhet ta bëjmë gjumin e qetë, kur e dimë se shumë familje dhe individë në gjithë hapsirën tonë kombëtare nuk i kanë mjetet elementare të jetesës. Nuk duhet të jetë i gëzuar ai prind që i ka të gjitha të mirat në jetë, kur e di se shumë fëmijë anekënd Shqipërisë etnike nuk i kanë kushtet e shkollimit sikurse fëmijët e tyre, nga shkaku se babai i tyre u bë kurban i çështjes madhore kombëtare. Nuk duhet ta ndiejë veten mirë ai djalë dhe ajo vashë që i fitonë vetë mjetet e jetesës, kur e di se shumë moshatarë të tyre nuk i kanë mundësitë të gjejnë punë. Nuk duhet ta ndiejë mirë veten ai veprimtar që punoi me përkushtim gjatë një dhjetëvjteshi apo edhe më shumë, dhe tash, pas çlirimit të Kosovës, është

tjetërsuar me arsyetimin se tash "çdo kush duhet të merret me vervehten". Mendimi i disave se problemet e mëdha sociale që i kemi në gjithë hapsirën kombëtare "duhet t'i zgjedhin institucionet shtetërore", bie ndesh me proceset e zhvillimit njerëzor edhe të etikës njerëzore, kur dihet se edhe shtetet e zhvilluara (ekonimikisht) të Bashkësisë Evropiane, SHBA-të etj, kanë probleme sociale me të cilat merren në rend të parë shoqatat humanitare (jo qeveritare, që kujdesen për qytetarët vendas apo qytetarë të huaj, që kanë nevojë për ndihma të ndryshme humanitare).

Është e njohur se diaspora shqiptare lufti një rol të rëndësishëm në të gjitha fazat e zhvillimit të kombit tonë, duke filluar nga periudha e zhvillimit të Romantizmit dhe Rilindjes Kombëtare e deri në luftën e fundit shqiptaro-serbojugosllave. Populli ynë (dhe as diaspora) nuk guxon të tjetërsohet. Ai edhe më tutje duhet të jetë në vllugin e punëve të shumta për ta ndihmuar atdheun. Ndihma vetëmohuese e tij është më se e nevojshme në këto momente kur Atdheu ynë po sulmohet me mjete perfide nga jashtë dhe nga mbrenda, nga të huajt dhe nga plangprishëit e tij shqipfolës. Solidariteti dhe ndihma vëllazërore me mejete materjale për shtresat e popullësisë që ju mungon minimumi i jetesës jo vetëm që do ta zbuste në një masë të mirë gjendjen e rëndë sociale që mbretëron në të gjitha vendbanimet shqiptare, por edhe do të përmirësonte pamjen (imazhin) e shqiptarëve para faktorit ndërkombëtarë, në këto momente kur armiqtë tanë shekullorë dhe veglat e tyre shqipfolëse me të gjitha mjetet dhe mënyrat po provojnë të na njollosin me shpifje dhe gënjeshtër të llojllojshme.

Populli ynë nuk guxon të tjetërsohet, kur, siç dihet, ai ka trashëguar shumë virtyte që të tjerët ia kanë lakminë. Dihet se shqëptarët (si popull dhe si komb) nuk e kanë njohur tjetërsimin si dukuri shoqërore, aq më tepër sot nuk na ka hije tjetërsimi kur jemi në rrugë e sipër për realizimin e synimeve tona kombëtare..

#### VËLLAZËRIMI NDËRSHQIPTAR DO TË NA SIGUROJË REALIZIMIN E SYNIMEVE TONA KOMBËTARE

Diaspora nuk bënë të hujitet, të rebelohet dhe të tjetërsohet nga fakti se Qeveria e Kosovës dhe kompetetntët që i ka caktuar ajo (H. Hysenin & Compani) nuk bënë asnjë përpjekje sado të vogël që së paku qytetarët e Kosovës që jetojnë dhe punojnë jashtë Atdheut ta fitojnë të drejten elementare të njeriut për të votuar, e drejtë kjo që e njohin organizatat kryesore ndërkombëtare.

Shqiptarët jashtë Atdheut tashmë duhet ta kenë të qartë se "pionerët e Enverit" dhe nanoistët kanë mbetur të njejtë siç ishin para luftes dhe gjatë luftës, antikombëtarë, argatë dhe mashë të qendrave antishqiptare : Beograd, Moskë, Athinë dhe Tiranë vazale, (të këtyre qendrave). (Kjo e drejtë iu ka marrë shqiptarëve jashtë atdheut nga UNMIK-u, kuptohet për hatër të Serbisë-Rusisë dhe Greqisë, por pse së paku me as një fjalë nuk e kundërshtuan këtë vepër të shëmtuar të UNMIK-ut kompetentët, e në rend të parë dy Qeveritë e Kosovës?!) Shqiptarët jashtë atdheut tanimë e kanë të qartë se plangprishësit e Kosovës nuk e kanë hallin e Kosovës dhe as hallin e interesave madhore kombëtare, por e kanë hallin e grazhdit të tyre, e kanë hallin për ta rjepur atë çka ka mbetur pa u rjepur nga Serbia.

Para luftës Kosova dhe Viset tjera shqiptare qenë ndihmuar në forma të ndryshme nga bashkëkombasit e tyre. Pse sot të mos vazhdojë e njëjta ndihmë, kur siç dihet nevoja për ndihmë janë në rritje e sipër. Pse të mos krijohet "Fondacioni për Kosovën", i cili në Emër të Zotit do të merrej me zgjedhjen e problemeve sociale në gjithë hapsirën kombëtare? Pse të mos riaktivizohet shoqata humanitare "Familja ndihmon familjen" që para luftës lufti një rol me rëndësi në zbutjen e problemeve sociale në Kosovë? Pse të mos ndihmohet edhe mëtutje shoqata humanitare "Nënë Tereza"? Kosova, Shqipëria dhe Viset tjera shqiptare, që kanë nevojë për ndihmë të llojllojshme nga diaspora shqiptare. Sa më e mirë dhe më e fuqishme të jetë ndihma vëllazërore ndërmet shqiptarëve, aq më shpejtë do të ecim përpara në realizimin e synimeve tona kombëtare. Shqiptarët kudo që janë në një mënyrë apo në një tjetër e kanë për detyrë ta ndihëmojnë vendin tonë. Përndryshe edhe shumë kohë do të mbesim në vendnumrim apo edhe do të shkojmë mbrapa në vend se të shkojmë përpara për t'i zënë dhe për t'i kaluar të tjerët, që në një kohë kur ne i kishim pallatet të ndërtuara prej mermeri, kishim ujësjellës qendror, banjo publike, amfiteatëro, ata jetonin si bagëtija nëpër kasolle. Ne jemi popull i lashtë me vlera të larta njerëzore dhe kombëtare. Ato vlera i kemi trashëguar brez pas brezi dhe i kemi amanet prej të parëve që t'i ruajmë si sytë e ballit, po që se duam të mos na zerë mallkimi i Zotit që na i dhuroi viset më të bukura dhe më të pasura të Evropës.

Pra, i kemi të gjitha kushtet që të ecim përpara për realizimin e synimeve tona madhore, por vetëm nëse e ndihmojmë njëri tjetrin në halle që i sjell jeta, dhe në veprime të mbara. Dhe kështu do ta bindim botën me vepra konkrete, e jo me fjalë boshe, se me të vërtetë jemi komb me tradita

shtetmbajtëse, jemi komb me tradita të lashta shtetërore, se dimë të krijojmë dhe të mbajm shtet. Ta detyrojmë Evropën (me punën tonë konkrete) ta pranojë të vërtetën e pa mohueshme se Kosova ishte koloni serbe. Ta bindim Evropën se koha e kolonive ka perenduar qysh moti dhe se tentimi i saj që Kosova të mbetej edhe për një kohë të gjatë "utrinë katundi" për mafinë e kuqe shqiptare dhe mafinë ndërkombëtare, sa është e dëmshme për kombin shqiptar, po aq e dëmshme është edhe për Bashkësinë Evropiane, NATO-n dhe SHBA-të.

Po qe se nuk i shumëfishojmë përpjekjet në punë dhe vepra të mira, çka do të sillte ndryshime cilësore në vetëdijen tonë kombëtare, politike dhe qytetare, por në të njëjtën kohë do të përmirësonte pamjen (imazhin) e shqiptarëve në botë, e keqja dhe e liga që kanë shtënë rrënjë në gjithë hapsirën tonë kombëtare, do të shtohet, rritët dhe shumëfishohet aq tepër, sa që virtytet tona kombëtare as që do të duken gjëkund. Kjo situatë do të jetë e favorshme për çakajtë e Ballkanit dhe aleatët e tyre, pasi që ne do të mbesim edhe më tutje lëndë ndërtimi për popujt e plakur të Evropës, do të mbetemi gazi i botës. Por ne shqiptarët kemi pasur edhe më parë situata të ndërlikuata dhe vështërësi të mdha, por i tejkaluam ato. Me siguri edhe vështirësitë e sotme do t'i tejkalojmë. Shqiptarët do t'i arrijnë synimet e tyre madhore. Kriminelët që vrasin shqiptarë dhe çakajt e Ballkanit i pret gazepi, turpi, injorimi dhe dënimi.

*Botuar : "Bota sot" më 14-16 dhjetor 2003*

# PËRMBAJTJA

|                                                                                                                                    |                  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| <b><u>NË VEND TË HYRJES.....</u></b>                                                                                               | <b><u>7</u></b>  |
| <b><u>PARATHËNIA.....</u></b>                                                                                                      | <b><u>10</u></b> |
| MOS I FALNI VRASËSIT!.....                                                                                                         | 10               |
| <b><u>KAPITULLI I PARË.....</u></b>                                                                                                | <b><u>19</u></b> |
| NGA KUSH I VIJNË RREZIQET KOSOVËS.....                                                                                             | 20               |
| PËRÇARËSIT E KANË VENDIN TE DERA.....                                                                                              | 24               |
| PUSHTETARË, MOS LUANI ME FATET E KOMBIT DHE TË ATDHEUT.....                                                                        | 29               |
| PSE PO PENGOHET FORMIMI I QEVERISË SË KOSOVËS.....                                                                                 | 31               |
| ME MBROJTJEN E GAZETËS KOMBËTARE "BOTA SOT" MBROHET FJALA E LIRË, MBROHET E VËRTETA, MBROHET DREJTËSIA DHE MBROHET SHQIPTARIA..... | 37               |
| PAS NGJARJES SË STRELLCIT RAMUSH HARADINAJ DUHET TA THOTË TË VËRTETËN EDHE PSE ËSHTË E HIDHUR.....                                 | 41               |
| KONFERENCA E RAMBUJËS PËRFUNDOI ASHTU SIÇ DËSHËROI KASAPI I BALLKANIT.....                                                         | 46               |
| KRIMINELËT JANË TË HUMBUR, PËRFUNDIM I KEQ PO I PRET.....                                                                          | 49               |
| SA ZOTRA KANË SHQIPTARËT?!.....                                                                                                    | 53               |
| <b><u>KAPITULLI I DYTË.....</u></b>                                                                                                | <b><u>55</u></b> |
| KOSOVA NË UDHËKRYQIN E SAJ HISTORIK.....                                                                                           | 56               |
| VETËM BASHKIMI YNË E SHPËTON KOSOVËN.....                                                                                          | 59               |
| TË MËSOJMË NGA PËSIMET.....                                                                                                        | 61               |
| SHQIPTARËT DO TË SHPËTOJNË NGA KTHETRAT SERBO-GREKE VETËM ME NACIONALIZËM.....                                                     | 70               |
| ATA QË E MUARËN FLAKARESHËN E POPULLIT DUHET TË RRINË KOKËULUR DHE NË MARRE.....                                                   | 74               |
| ZGJEDHJET NACIONALE DO TË VENDOSIN PËR FATIN E KOSOVËS DHE TË SHQIPTARISË.....                                                     | 80               |
| PEHLIVANËT E NANOSIT, ARGATËT E TYRE DHE KRIMINELËT, LARG PARLAMENTIT TË KOSOVË.....                                               | 85               |
| PSE PO LIHEN TË LIRË KRIMINELËT.....                                                                                               | 92               |
| <b><u>KAPITULLI I TRETË.....</u></b>                                                                                               | <b><u>95</u></b> |
| INTERVENIMI I NATO-S NË GADISHULLIN ILIRIK BËRI QË SKENARËT SERBO-GREKO-RUSË PËR ZHDUKJEN E KOMBIT SHQIPTAR TË DËSHTOJNË.....      | 96               |

|                                                                                              |     |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| PSE KA KRIM TË ORGANIZUAR NË KOSOVË DHE A MUND TË ÇRRËNJOSET AI NGA TROJET TONA ETNIKE?..... | 107 |
| PSE DËSHAKËT E KOSOVËS PO E FORMOJNË PARTINË E TYRE.....                                     | 117 |
| KUSH PO IA PËRGADITË HUMNERËN KOSOVËS?.....                                                  | 121 |
| Kush e ka keqëpërdorë dhe kush po e keqëpërdorë luftën çlirimtare të popullit tonë?.....     | 130 |

## **KAPITULLI I KATËRT..... 143**

|                                                                                                                         |     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| SI U KRIJUA UÇK-ja, KUSH DHE KUR E KRIJUAN ATË.....                                                                     | 144 |
| DY ATENTATE ME PASOJA TË RËNDA PËR LËVIZJEN TONË KOMBËTARE.....                                                         | 152 |
| PSE U VRANË DHE KUSH MUND TË JENË TË PËRZIER NË VRASJEN U JUSUF GËRVALLËS, BARDHOSH GËRVALLËS DHE TË KADRI ZEKËS!?..... | 176 |
| VEPRA E TIJ KOMBËTARE-FRYMËZIM PËR BREZAT E RINJ.....                                                                   | 223 |
| SALIH ÇEKU ISHTE NJËRI NDËR THEMELUESIT E PARË TË UÇK.....                                                              | 231 |
| VRASJA E AHMET KRASNIQIT PATI PASOJA TË RËNDA PËR KOSOVËN DHE PËR SHQIPTARINË.....                                      | 250 |
| DISA DITË ME USHTARËT DHE OFICERËT E UÇK-së.....                                                                        | 288 |

## **KAPITULLI I PESTË..... 295**

|                                                                                                                   |     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| OFICERËT TANË NË SHËRBIM TË ATDHEUT.....                                                                          | 296 |
| MBI KEND BIE PËRGJEGJËSIA PËR VRASJEN E AHMET KRASNIQIT.....                                                      | 301 |
| PSE DHE KUSH E VRAU AHMET KRASNIQIN.....                                                                          | 304 |
| PARA GJYQIT TË DREJTËSISË DO TË DALIN JO VETËM DORASI, POR EDHE URDHËRUESIT E ATENTATIT NDAJ AHMET KRASNIQIT..... | 315 |

## **KAPITULLI I GJASHTË..... 328**

|                                                                                    |     |
|------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| IDEOLOGJIA E TIJ-NACIONALIZMI SHQIPTAR.....                                        | 329 |
| DRENICA EDHE NJË HERË NA E ZBARDHI FYTYRËN DHE NA RIZGJOI KRENARINË KOMBËTARE..... | 336 |
| MBETËM PA SHOKUN TONË TË VJETËR.....                                               | 338 |
| PORTRETI I NJË OFICERI MADHOR SHQIPTAR.....                                        | 343 |

## **KAPITULLI I SHTATË..... 346**

|                                                                       |     |
|-----------------------------------------------------------------------|-----|
| RIORGANIZIMI I DIASPORES SHQIPTARE NE BAZA KOMBËTARE.....             | 347 |
| DIASPORA SHQIPTARE NË MOÇALIN E PARTIAKËVE.....                       | 351 |
| DIASPORA SHQIPTARE NUK DUHET TË TJETËRSOHET.....                      | 358 |
| NDIHMA VËLLAZRORE KA QENË, DHE DUHET TË JETË VIRTUT YNI KOMBËTAR..... | 360 |

## **PËRMBAJTJA..... 366**







